RAPORT

PËR

ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

2017

Raporti "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2017" është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 155 datë 03.10.2018.

[Shqiptaria.com]

[shqiptarja.com]

P ËR M B A J T J A

H RJE	*5*
OPINIONI MBI ZBATIMIN E BU HETIT FAKTIT TË VITIT 2017	*6*
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	*10*
PJESA E PARË:	
ANALIZA E IMPLEMENTIMIT TË BU HETIT 2017	*51*
1. TREGUESIT E KONSOLIDUAR FISKALË TË BUXHETIT 2017	53
2. PROGRAMIMI BUXHETOR	58
3. IMPLEMENTIMI I BUXHETIT	67
4. MOS ZBATIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË SANKSIONUAR ME LIGJJ NË SISTEMIN E THESARIT	129
5. PROKURIMI PUBLIK	145
6. RAPORTIMI I BORXHIT PUBLIK	160
7. KEQADMINISTRIMI I SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR	184
8. KEQADMINISTRIMI I SKEMËS SË RIMBURSIMIT TË TVSH	191
9. RAPORTIMI I TË DREJTAVE TË LIGJSHME TË SHTETIT	196
10. RAPORTIMI I BUXHETIT	207
11. RIORGANIZIMI I MINISTRIVE DHE PROBLEMET E KONSTATUARA	217
12. DËMET DHE PARREGULLSITË NË EKZEKTIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2017	220
PJESA E D TË:	
MBI MENA HIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK	*223*
1. MBI NIVELIN E AUDITIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK	222
2. MBI NIVELIN E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT NË SEKTORIN PUBLIK	232
3. DREJTORIA E PERGJITHSHME E HARMONIZIMIT DHE SISTEMET E SAJ TE KONTROLLIT	246
4. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE KLSH	248
PJESA E TRETË:	
AUDITIMET E PERFORMANCËS	*249*
ANKESI NR.1	
LISTA E SUBJEKTEVE TE AUDITUARA PER EFEKTE TE KËTIJ RAPORTI	*261*

[shqiptarja.com]

HYRJA

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke i kushtuar vëmendjen çështjeve që lidhen me zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2017, mbi respektimin e kërkesave të kuadrit rregullator ligjor, specifikisht kërkesave të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017",i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50 datë 05.02.2017 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Objektivi kryesor i këtij auditimi është dhënia e opinionit për Raportin që Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017" duke audituar jo vetëm rregullaritetin e transaksioneve por edhe saktësinë e raportimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e buxhetit, përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe fondeve të kontigjencës, raportimin e borxhit publik, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Është hera e parë që për formulimin e opinionit, Kontrolli i Lartë i Shtetit është bazuar në standardet e auditimit të INTOSAI-i duke respektuar kërkesat e ISSAI 1700.

Në vëmendjen kryesore të auditimit, kanë qënë çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e saktësisë së treguesve të konsoliduar fiskalë të buxhetit:

1. *Të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore*
2. *Deficiti e burimet e financimit të tij*
3. *Saktësia e raportimit të Borxhit Publik dhe Shërbimit të tij.*
4. *Sisitemet e kontrollit në zbatim të buxhetit që garantojnë disiplinën fiskale.*

Grupi i auditimit ka patur si objektiv cilësinë e raportimit të treguesve të realizimit të buxhetit, transparencën ndaj publikut, dhe dhënien e opinionit për mënyrën se si janë menaxhuar financat publike gjatë vitit 2017, si dhe ndjekjen e objektivave strategjikë të qeverisë bazuar në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020.

Qëllimi i punës audituese në përgatitjen e Raportit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2017, ka qënë identifikimi edhe i risqeve kryesore për financat publike në konteks afatmesëm dhe afatgjatë, kjo në këndvështrimin e një audituesi të jashtëm publik. Nisur nga auditimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, konstatimet në punën tonë audituese mbi programimin, realizimi, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2017, observimet dhe ballafaqimi i problematikave, Kontroll i Lartë i Shtetit, konkludon me një opinion të pavarur "Mbi Zbatimin e Buxhetit të vitit 2017".

[shqiptaria.com]

OPINIONI I AUDITIMIT MBI ZBATIMIN E BUXHETIT

KLSH ka audituar përputhshmërinë e hartimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2017, bazuar në pasqyrat e konsoliduara vjetore të transaksioneve financiare të shtetit, raportin e zbatimit të buxhetit vjetor 2017, raportin e borxhit publik, raportin e përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës, raportin mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (KBFP) për vitin 2017. Opinioni dhe Raporti i zbatimit të buxhetit të shtetit për vitin 2017, bazohet në kërkesat e nenit 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 31 të Ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neneve 62 dhe 63 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Opinioni i Auditimit

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinionin, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se për disa zëra buxhetorë, përfshirë nivelin e deficitit dhe borxhit publik, për shkak të rëndësisë dhe përhapjes së çështjeve të përmendura në këtë raport, ka devijime materiale (sasiore dhe cilësore) në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me Ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50 datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Baza për opinionin e auditimit

Procesi i buxhetimit, rishikimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të tij rezulton të jetë akomodues dhe legjitimues ndaj shkeljeve të disiplinës fiskale nga entet publike, duke mundësuar marrjen e angazhimeve financiare pa fonde në dispozicion si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Në kushtet e presioneve në treguesin e deficitit dhe borxhit publik, ndikuar nga problematikat sistemike të evidentuara në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017 nga entet publike, nga ana e strukturave përgjegjëse janë marrë masa jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përfshirë mos planifikim të plotë të shpenzimeve, mosrespektim të radhës prioritare për buxhetimin e projekteve në vazhdim, çeljen e fondeve në SIFQ të ndryshme nga limitet e vendosura në treguesit fiskal, buxhetim të shpenzimeve për projekte të reja në AN. 3, kryerjen e shpenzimeve të pa mbështetura me plan buxhetor, mos lejim përdorimi fondesh buxhetore të miratuara nga Kuvendi për njësitë e pushtetit vendor, mos raportim të plotë të shpenzimeve për disa zëra buxhetor, dhe riklasifikim të shpenzimeve ndërmjet zërave të tabelës së konsoliduar të treguesve fiskal faktik, me qëllim raportimin e treguesit të deficitit dhe disa zërave buxhetor brenda kufijve të miratuar. Detyrimet e prapambetura dhe stoku në rritje i rimbursimit të TVSH nuk reflektohen në treguesit e konsoliduar fiskal, treguesin e deficit, dhe treguesin e borxhit publik, duke mos dhënë një

[Shqipëria.com]

pamje të drejtë të aktivitetit financiar publik për vitin 2017. Gjithashtu u konstatuan, mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për të cilat strukturat përgjegjëse për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportimin e tij, nuk kanë marrë masa konkrete për të eliminuar parregullsitë dhe për të reflektuar saktë treguesit buxhetor.

Procesi i ekzekutimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet sistemit të thesarit nga të gjitha hallkat, rezulton me thyerje të përhapura të zbatimit të kontrolleve dhe masave parandaluese, detektuese, dhe korrigjuese që do të garantonin disiplinimin fiskal të sektorit publik. KLSH ka konstatuar që shumë nga masat dhe përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, eliminimin e mundësive për mos raportimin në kohë të shpenzimeve, dhe marrjen e angazhimeve financiare pa fonde buxhetore, në bashkëpunim dhe me FMN, kanë rezultuar joefikase dhe të pazbatuara. Entet publike vijojnë të mos marrin miratimin e Thesarit përpara fillimit të procedurave të prokurimit, dhe mos raportimin e saktë dhe në kohë të angazhimeve dhe shpenzimeve buxhetore. Gjithashtu u konstatua, që strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), megjithëse në dijeni të shkeljeve nga entet publike, si në rastet e shkeljeve të afateve të regjistrimit të angazhimeve dhe shpenzimeve, nuk kanë marrë asnjë masë administrative konkrete për të disiplinuar procesin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ndërkohë këto struktura kanë kontribuar në krijimin e mundësive për kapërcimin e kontrolleve si në rastin e mos regjistrimit të planit buxhetor sipas PBA-së, lejimit të regjistrimeve të fragmentarizuar të urdhër- prokurimeve, kontratave, dhe faturave në SIFQ për shkak të mungesës së fondeve buxhetore disponibël.

Gjithashtu opinioni i dhënë në Raportin Vjetor mbi funksionimin e sistemit të KBFP për vitin 2017 pëgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), nuk reflekton situatën reale të implementimit të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pasi kampioni i përzgjedhur nuk është përfaqësues, metodologjia e monitorimit nuk është aplikuar siç duhet dhe bazohet vetëm në përpunimin e pyetësorëve të vetëdeklarimit të njësive të sektorit publik.

KLSH ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë" të këtij opinioni. KLSH është e pavarur nga institucionet subjekt auditimi, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike respektive të auditimit të përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Njësive Publike

Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për: drejtimin e procesit të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", i ndryshuar, dhe nxjerrjen dhe garantimin e zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre; kontrollin e procesit të raportimit të treguesve fiskal; administrimin e sistemit të thesarit, në përputhje me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50 datë 05.02.2017 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. *Drejtimi i Njësive Publike* është përgjegjës për: procesin e hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor për institucioneve që drejtojnë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, dhe zbatimin e akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre; veprimtarinë e institucioneve që drejtojnë në sistemit të thesarit, në përputhje me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50 datë 05.02.2017 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse treguesit fiskalë të raportuar nuk paraqesin anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2017, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në zbatim të ISSAI-ve, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Procesi i punës audituese e KLSH-së kalon në këto etapa:

Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësive publike. Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutin të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi

[Shqiptaria.com]

material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Komunikojmë me drejtuesin/drejtimin edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Gjithashtu, u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

[shqiptarja.com]

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PJESA 1

ANALIZA E ZBATIMIT TË BUXHETIT

1. TREGUESIT E KONSOLIDUAR FISKALË TË BUXHETIT 2017

Sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, **të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit për vitin 2017**, janë realizuar në vlerën 430,492 milionë lekë (ose realizuar 98.6%), nga 436,400 milionë lekë të planifikuara me ligjin nr.130/2016, datë 15.12.2016, "*Për buxhetin e vitit 2017*", ose 5,909 milionë lekë më pak nga planifikimi fillestar. Ndërkohë që krahasuar me një vit më parë këto të ardhura janë rritur me 23,389 milionë lekë (*ose rreth 5,7% më shumë krahasuar me vitin 2016*).

Sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, **shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2017,** u realizuan në vlerë 461,410 milionë lekë, nga 467,600 milionë lekë të planifikuara sipas planit fillestar, duke reflektuar mos shpenzim të fondeve të planifikuara në masën 6,190 milionë lekë. Ndërsa nëse i referohemi planit përfundimtar, sipas Aktit Normativ nr.3, datë 06.11.2017, konstatojmë se, shpenzimet nuk janë realizuar për vlerën 12,690 milionë lekë. Ndër të tjera, mos realizimi i shpenzimeve është ndikuar nga mosrealiimi të ardhurave në krahsim me planin, ecuria ekonomike dhe detyrimi ligjorë për të mbajtur nivelin e deficitit nën 2% të PBB-së. Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2017 shpenzimet buxhetore janë realizuar me 27,637 milionë lekë më shumë se viti 2016 *ose rreth 6,37%.*

Sic raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, **deficiti buxhetor gjatë për vitin 2017,** ishte parashikuar në vlerën 31,200 milionë lekë dhe është realizuar në masën 30,919 milionë lekë ose realizuar në masën 99,1%. Deficiti i raportuar rezulton të jetë sa 1.99% e PBB-së, cka në aspektin formal rezulton brenda limitit ligjor prej 2% të PBB-së. *Kemi konstatuar se niveli faktik i deficit është i nënvlerësuar me qëllim raportimin e tij brenda kufinjve ligjor, duke mos raportuar shpenzimet në nivelin e plotë të tyre si dhe duke ndërmarrë veprime riklasifikuese manuale në përgatitjen e treguesve fiskal për të netuar vlerën e deficitit me burimin e financimit të tij. Me qëllim mbajtjen e deficitit nën limitet e miratuara, duke mos shkurtuar shpenzimet, janë krijuar detyrime të prapambetura.* Nga analiza e të dhënave rezulton, Deficiti Buxhetor ka arritur vlerën më të lartë në muajin Dhjetor për 20,385 milionë lekë dhe që përfaqëson 66% të Deficitit të Përgjithshëm Buxhetor. Ky përqëndrim në muajin Dhjetor ka ardhur jo vetëm si rezultat i realizimit të fondeve në fund të vitit por vecanërisht i rregjistrimit të shpenzimeve të ndodhura më parë në këtë muaj. Rregjistrimi me vonesë i shpenzimeve apo mosrregjistrimi i tyre në vitin 2017 është trajtuar gjerësisht në këtë raport. Si konkluzion vlerat faktike të deficit mujor të raportuar nuk japin një pasqyrim të drejtë të këtij treguesi dhe zbatimin e kërkesave ligjore në vite elektorale.

2. PROGRAMIMI BUXHETOR DHE REGJISTRIMI I TIJ NË SIFQ

KLSH konstaton se, *devijimet e shumta që kanë pësuar të ardhurat dhe shpenzimet që nga faza fillestare e planifikimit të tyre, deri në fazën e realizimit faktik, si dhe devijimet e shumta në mënyrën e mbulimit të financimit të deficitit buxhetor nga financim të brëndshëm në atë të huaj, tregojnë për mungesë të*

[Shqiptarja.com]

aftësisë buxhetuese por edhe menaxhuese të financave publike. Ky fenomen është konstatuar si për zërat e shpenzimeve, ashtu edhe për të ardhurat.

Dokumenti i PBA 2017-2019, është hartuar në mënyrë formale dhe nuk është eficent duke venë në dyshim standardet dhe vërtetësinë e programimit të produkteve. Konstatohet se, në hartimin i dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019, ka probleme në drejtim të respektimit të kërkesave dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr.08, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" dhe Udhëzimit plotësues nr.4/2, datë 08.07.2016 dhe konkretisht:

- Nga auditimi mbi *planifikimin, detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore* për vitin 2017, për disa institucione KLSH, ka konstatuar veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.08, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" dhe Udhëzimin plotësues nr.4/2, datë 08.07.2016 dhe konkretisht nenin 65 ku citohet: "Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti mban parasysh këtë radhë prioritare**:** a- investimet në proces nga viti i kaluar, b- objektet e paraqitura në Kuvend gjatë shqyrtimit të projekt buxhetit", dhe nenin 66 ku citohet: "Nëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të projekt buxhetit të vitit, NPA e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve të publikuara." KLSH, ka konstatuar se, për disa institucione, megjithëse vlera e miratuar e fondeve të investimeve kapitale me financim të brendshëm ka qenë e njëjtë si në projektbuxhetin e vitit 2017, ashtu edhe me miratimin e buxhetit sipas Ligjit 130/2016, lista e përfundimtare e investimeve kapitale të miratuara me ligj, është e *ndryshme nga lista e miratuar në projekt buxhetitn* e vitit 2017.
- Nga auditim mbi Rregjistrimin e Planit të Buxhetit të shtetit për vitin 2017, sipas Tabelës 4, "Treguesit Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar" të Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017" në Sistemin Informatik Financiar të Qeferisë (SIFQ), u konstatua se, ky plan paraqitet me diferenca në SIFQ, në nivel zërash buxhetor dhe në total, përmbledhur si më poshtë:

1. *Të ardhurat e përgjithshme*[1] *për vitin 2017*, paraqiten në vlerën 442,901 milionë lekë, ndërkohë ky zë në SIFQ, paraqitet për 408,800 milionë lekë pra *me një diferencë për 34,101 milionë lekë më pak.*
2. *Shpenzimet për vitin 2017*[2], paraqiten në vlerën 474,101 milionë lekë, ndërkohë ky zë në SIFQ, paraqitet për 459,627 milionë lekë pra me një diferencë për 14,474 milionë lekë më pak.
3. *Deficiti për vitin 2017*[3], paraqiten në vlerën 31,200 milionë lekë, ndërkohë ky zë në SIFQ, paraqitet për 50,826 milionë lekë pra me një diferencë për 19,626 milionë lekë më shumë.

Veprimet e lartpërmendura faktojnë se celjet e fondeve, monitorimi dhe ekzekutimi i buxhetit nëpërmjet sistemit të thesarit nuk është në përputhje me tavanet buxhetore të miratuara, veprim i cili mbart riskun e kryerjes së shpenzimeve nga ana e njësive shpenzuese pa pasur një plan shpenzimi.

[1] *Referuar Tabelës nr. 4, të Aktit Normativ nr. 03*

[2] *Referuar Tabelës nr. 4, të Aktit Normativ nr. 03*

[3] *Referuar Tabelës nr. 4, të Aktit Normativ nr. 03*

Referuar të dhënave të regjistruara në SIFQ, konstatohet se, në zbatim të Ligjit 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" janë çelur projekte investimi me financim të brendshëm në vlerën 5,094.9 milionë lekë, projekte të cilat rezultojë të mbyllur me miratimin e Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 "Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2017, të miratuar me Ligjin 130/2016", fakt i cili tregon *për një buxhetim të dobët dhe formal* nga ana e ministrive të linjës. Gjithashtu konstatohet se, ka projekte investimi të cilat janë celur për herë të parë me miratimin e Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 "Për nje ndryshim në buxhetin e vitit 2017, të miratuar me Ligjin 130/2016", por referuar kontratës së regjistruar në SIFQ, konstatohet se këto projekte investimi janë kontrata në vazhdim nga vitet e kaluara në vlerën 6,830.8 milionë lekë, kryesisht të FZHR-së. Në disa raste janë konstatuar që faturat e rregjistruara kanë rezultuar me data më të hershme se celjet me akt-normativ dhe fondet janë celur për vlera më të vogla se faturat faktike të prapambetura.

KLSH, gjykon se, Aktet Normative në fund të vitit u japin mundësinë institucioneve të ndërmarrin angazhime buxhetore pas datës 15 Tetor 2017, në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit, të ndryshuar, por që nuk arrijnë t'i realizojnë ato, duke mbartur në këtë mënyrë riskun e realizimit fiktiv të tyre si dhe riskun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Kemi konstatuar 3 raste në vlerën totale për 50 milionë lekë, kontrata të lidhura dhe realizuara në periudhën kohore 28-31 Dhjetor 2017, të cilat logjikisht janë të pa mundura të realizohen.

Nga analiza e raporteve të monitorimit të kontratave shumëvjecare u konstatuan dhe raste të kryerjes së pagesave për projekte të cilat nuk kanë patur celje me Ligjin e Buxhetit për vitin 2017. Të gjitha rastet e analizuara individualisht janë konfirmuar me databazën e pagesave të vitit 2017 me burim sistemin SIFQ. Këto celje buxhetore pa fonde të miratuara janë legjitimuar duke u përfshirë më pas në Aktin-normativ nr. 2 ose nr. 3. *Nga testet e projekteve të përfshira në AN2 dhe AN3 u konstatuan, 90 raste në vlerë rreth 700 milionë lekë.*

3. IMPLEMENTIMI I BUXHETIT

3.1 Mbi realizimin e të ardhurat buxhetore të vitit 2017

Të Ardhurat e Buxhetit të Shtetit, janë në vlerën 430,492 milionë lekë, referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar dhe planifikimit fillestar të buxhetit. Këto të ardhura janë realizuar 97.2% në krahasim me AN3 dhe 98.6% me planin fillestar. *Planifikimi optimist i të ardhurave ka lejuar planifikim më të madh të shpenzimeve brenda limiteve të deficitit të vendosura me ligj. Mos realizimi i të ardhurave, vecanëritsht atyre tatimore dhe vendore, ka ndikuar në rritjen e stokut të rimbursimit të TVSH për tu shlyer dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura, të paraportuara në treguesit fiskal në kushtet e limiteve të deficit të raportuar afër 2%.*

Të Ardhurat Tatimore, zënë peshën kryesore ose 93% të të gjithë të ardhurave, në vlerë 398,629 milionë lekë, kundrejt 398,200 milionë lekë të planifikuara në ligjin nr. 130/2016, ose në masën 100%. Krahasuar më AN3 ky realizim është në nivelin 98.3%. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2016, këto të ardhura janë rritur me 28,745 milionë lekë më shumë ose janë rritur në masë 8% më shumë.

[shqiptaria.com]

Të ardhurat nga tatimet referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë realizuar në vlerën 131,869 milionë lekë, ose 93% në krahasim me planin përfundimtar. Të ardhurat nga TVSH (bruto) paraqesin një realizim prej 88.5% në krahasim me planin përfundimtar dhe 97.7% në krahasim me planin fillestar.

Plani i të ardhurave totale për tu mbledhur nga administrate tatimore për vitin 2017 paraqitet në vlerë bruto 238.34 miliardë lekë dhe rimbursimi i TVSH-së është planifikuar në shumën 16.6 miliardë lekë, për një plan neto në vlerë 221.73 miliardë lekë. Të ardhurat faktike bruto të mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2017 paraqiten në 228.58 miliardë lekë dhe rimbursimet e kryera paraqiten në shumën 13.9 miliardë lekë. *Si rrjedhojë, të ardhurat për tu mbledhur nga administrate tatimore, bruto paraqiten me mosrealizim në shumën 9.85 miliardë lekë ose 4.1%.* Në terma neto, si rezultat i mosrealizimi të vetëdijshëm të rimbursimit të TVSH-së në shumën 2.7 miliardë lekë, mosrealizimi i të ardhurave për tu mbledhur nga administrate tatimore është në vlerën 7.15 miliardë lekë ose 3.2%. *Problematika theksohet kur konstatohet që të ardhurat tatimore (pa kontributet e sigurimeve shoqërore) në terma bruto paraqiten me mosrealizim në masën 12.5 miliardë lekë ose 7.9% më pak se plani.* Performanca e ulët në terma bruto e të ardhurave tatimore, në kushtet e stokut në rritje të rimbursimit të TVSH, duhej të shoqërohej me shkurtim shpenzimesh me qëllim ruajten e decifitit nën 2%, *veprim që nuk është ndërmarrë dhe ka ndikuar negativisht në stokun e rimbursimit të TVSH, cili në fund të vitit kap një vlerë prej rreth 11.4 miliardë lekë.*

Nga auditimi në DPT, janë konstatuar problematika në lidhje me skemën e rimursimit të TVSH, probleme në vlerësimin e situatave me mospërputhje në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit (2017), për subjektet që kanë kryer transaksione gjatë vitit ushtrimor, etj. Vetëm për një subjekt i cili është në Top-listën e debitorëve, u konstatua një borxh i fshehur dhe njëkohësisht një vlerë e munguar e Tatim Fitimit, për vitin 2017 në shumën 5.72 miliardë lekë.

Të ardhurat nga doganat, referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë realizuar në vlerën 159,090 milionë lekë. Krahasuar me planin përfundimtar, të ardhurat doganore për vitin 2017, janë realizuar në masën 100.9%, pra 1,370 milionë lekë më shumë, ose 2,790 milionë lekë më shumë kundrejt planit fillestar. Referuar të dhënave të mësipërme, plani fillestar i të ardhurave doganore për vitin 2017, është parashikuar në vlerën 156,300 milionë lekë. Të ardhurat fiskale doganore për vitin 2017, janë realizuan 10,663 milionë lekë më shumë se vitin 2016, ose rreth 6.9 % më shumë se viti i kaluar. Nga auditimet në administratën doganore në qendër dhe në degë kanë rezultuar veprime e mosveprime në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit doganor, si dhe të dispozitave tjera ligjore e nënligjore mbi bazën e të cilave e ushtron veprimtarinë, *që kanë sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total 2,138 milionë lekë.* Disa nga problematikat kryesore të sistemit doganor trajtohen më gjerësisht në këtë raport.

Të ardhura nga Pushteti Vendor, janë realizuar për 18,447 milionë lekë, kundrejt 15,400 milionë lekë të planifikuar sipas planit fillestar, ose realizuar në masën 119.8%, ose më shumë për 3,047 milionë lekë. Në krahasim me planin përfundimtar këto të ardhura janë realiuar në masën 88%.

Të Ardhurat jo Tatimore, janë të ardhura që zënë 4,8% të të ardhurave gjithsej, ose 20,778 milionë lekë, kundrejt 24,400 milionë lekë të planifikuara, realizuar

në masën 85,2%, ose 3,622 milionë lekë më pak. Fitimi neto i Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, ka rezultuar në vlerë 908 milionë lekë dhe është derdhur në buxhetin e shtetit dhe raportuar në këtë zë. Trendi i realizimit të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë, ka ardhur çdo vit në ulje.

Nga auditimet e KLSH është konstatur që ashtu si dhe një vit më parë, kosto e kontratave swap, instrumenti i përdorur nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin e likuiditetit në valutë, arriti mbi 1,553 milionë lekë, *ky shpenzim vazhdon të mos raportohet si një zë më vehte dhe vazhdon të kontabilizohet në formën e një të ardhure negative, duke denatyruar natyrën dhe koston e këtyre transaksioneve.* Duhet theksuar se pavarësisht se është kërkuar nga KLSH, prezantimi i drejtë i këtij shpenzimi si kosto borxhi, edhe për këtë vit konstatohet se kosto e swap-it në shumën 567 milionë lekë, nuk planifikohet dhe nuk raportohet si shpenzim buxhetor faktik.

Gjithashtu është konstatuar që një pjesë e të ardhurave nga privatizimi të krijuara përgjatë vitit 2017 nuk kanë shkuar për kryerjen e investimeve kapitale sipas kufizimeve të vendosura në Ligjin e Buxhetit, por kanë financuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt privatizimin në shumën 90,396 mijë lekë ose 22%, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.02.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".

3.2 Shpenzimet buxhetore

Referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar, konstatohet se shpenzimet e buxhetit faktik në vlerën 461,410 milionë lekë.

Shpenzimet korrente, janë shpenzimet për personelin, për interesat, shpenzimet operative të mirëmbajtjes, shpenzimet për subvencionet, shpenzimet për fondet speciale, shpenzime për buxhetin e pushtetit vendor dhe shpenzimet e tjera, të cilat zënë rreth 82% të shpenzimeve të planifikuara gjithsej dhe 82,9% të shpenzimeve faktike gjithsej. Kështu shpenzimet korrente janë realizuar të raportuara në vlerë 382,287 milionë lekë, nga 390,169 milionë lekë të planifikuara sipas ligjit nr. 130/2016, ose realizuar në masën 98,2% me një mosrealizim kundrejt planit me 7,882 milionë lekë, ose 2% më pak se plani.

Shpenzimet Kapitale, janë realizuar në vlerën 68,455 milionë lekë nga 74,431 milionë lekë të planifikuara sipas buxhetit fillestar ose janë realizuar në masën 92%. Trendi i *shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm*, referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar rezulton në rritje. Konkretisht gjatë vitit 2017, ky zë është rritur me 18 % krahasuar me vitin 2016. *Shpenzime kapitalet me financim të huaj*, konsiderohen të gjitha ato burime financiare, që i jepen Qeverisë Shqiptare, ose institucioneve të tjera qeveritare, në formën e kredive ose ndihmave (grante) nga institucione financiare ndërkombëtare, qeveritë e vendeve të ndryshme, institucione apo organizma jopublike. Trendi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar rezulton në rritje. Konkretisht gjatë vitit 2017, ky zë është rritur me 9,5 % krahasuar me vitin 2016.

Në një analizë më të detajuar në terma të realizimit mujor të shpenzimeve për investime, rezulton se pjesa më e madhe e investimeve kapitale (24.8%) është përqendruar në muajin Dhjetor. Nga auditimet e KLSH janë konstatuar problematika të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqitën si më poshtë vijon:

1. Letër Kreditë-të në mbyllje të vitit ushtrimor përdoren për mos djegien e fondeve dhe njëkohësisht për të rritur fiktivisht zërin Investime Kapitale në

[shqiptaria.com]

Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar në vlerën 211milionë lekë. Vlen të theksohet që kjo dukuri është përmirësuar në krahasim me vitet e mëpashme.

2. Nga auditimi me përzgjedhje i kampionit të marrë konstatohet se, përvitin 2017, janë angazhuar fonde të planifikuara si investime për kryerjen e shpenzimeve operative si, shpenzime për paga dhe sigurime, shpenzime postare, të telefonisë celulare, shpenzime udhëtimi, dieta etj., në vlerën 1,536 milionë lekë. Kjo problematike konstatohet vecanërisht në zërin shpenime kapitale me financim të huaj, ku pavarësisht natyrës së shpenzimit raportohet dhe buxhetohet automatikisht si shpentim kapital.

3. Nga auditimi me përzgjedhje të kampionit, KLSH ka konstatuar se, në SIFQ në kundërshtim me Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar janë kryer pagesa në vlerën 26.9 milionë lekë, pas datës 30 janar 2018.

4. KLSH ka konstatuar se në vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk raportohen dhe nuk deklarohen si shpenzim në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kjo krijon kushtet për akumulimin e kamatvonesave si pasojë e vonesës në shlyerjen e tyre, nënvlerësimin e shpenzimeve të vitit dhe deficitit të vitit buxhetor, pagesën e tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vulllnetar të vendimeve dhe thyerje të radhës së shlyerjes së vendimeve dhe selektivitet në përzgjedhjen e vendimeve për pagesë (mosrespektimi i FIFO). Në shumë institucione nuk ekziston databaza e vendimeve gjyqësore në mënyrë që nga ana e KLSH të raportohet efekti i detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë. Efekti i pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2017 për largim të padrejtë të punonjësve nga puna nëpëmjet llogarive të shpenzimeve operative vlerësohet në rreth 2 miliardë lekë dhe për vendimet e tjera gjyqësore në rreth 1 miliardë lekë. Në auditimin e zhvilluar në MFE u konstatua se detyrimet e padeklaruara nga mos ekzekutimi i vendimeve të gjykatave për rikthim në pozicionin e punës ishin rreth 70 milionë lekë, megjithëse përgjatë periudhës objekt auditimi paraqiteshin mesatarisht 50 vende vakante.

Për vendimet gjyqësore me objekt çështjet e privatizimit nuk ka një informacion në lidhje me detyrimet e shtetit, pasi nga auditimi në Minsitrinë e Financave dhe Ekonomsië u konstatua se nuk ka një databazë të këtyre vendimeve dhe informacioni mungonte. Në të njejtën linjë, edhe për vendimet gjyqësore me objekt ceshtjet e Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut u konstatua se vendime gjyësore të miratuara për pagesë nga viti 2016, rezultonin sipas detyrimeve të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pa kontabilizuara për rreth 500 milionë lekë. *Për vendimet gjyqësore të cilat nuk janë të autorizuara për pagesë, KSLH e ka të pamundur të vlerësojë efektin, duke qenë se ato nuk regjistrohen në databazë të vendimeve gjyqësore dhe as në kontabilitet. KLSH parashtron rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm të vendimeve gjyqësore dhe futjen e tyre në procesin e ekzekutimit buxhetor, duke marrë parasysh efektin e mundshëm në vitet e ardhshme në formën e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe trajtimin e plotë të përgjegjësisë në lidhje me vendimmarrjen me kosto financiare të nënpunësve publike, në të njejtën linjë me kërkesën e vazhdueshme për hartimin dhe miratimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale". Kjo pasi është konstatuar se në të gjitha subjektet që ekzekutojnë vendimet gjyqësore nuk përcaktohet përgjegjësia në lidhje me detyrimet që lidhen me to, në*

shqiptaria.com]

kundërshtim edhe me kërkesat e Udhëzimit Standart të Zbatimit të Buxhetit, në të cilin kërkohet nxjerrja e përgjegjësive nga ana e Titullarëve të institucioneve për cdo rast të vendimeve gjyqësore.

5. KLSH ka konstatuar se granti i Buxhetit të Shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për pushtetin vendor është tejkaluar përkundrejt planit me 6,199 milionë lekë, si rrjedhojë e faktit që fondi i mbartur për FZHR nga viti 2016 në shumën 4,7 miliardë lekë, është i pa shoqëruar me plan buxhetor për vitin 2017. Sipas të dhënave të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, vlera e realizimit faktik të projekteve të mbartura nga viti 2016 është në shumën 4.7 miliardë lekë. Megjithëse janë kryer shpenzime përgjatë muajve, ndryshimet përkatëse nuk janë reflektuar duke hapur plan për këtë zë që akumulon shpenzime për buxhetin vendor. Kjo promblematikë edhe te tjera në lidhje me zërin e shpenzimeve të pushtetit vendor është trajtuar në vijim të këtij raporti.

6. Shpenzimet e financuara nga disbursimet e huasë së marrë për projekte specifike nuk janë raportuar për 3,793 milionë lekë si pasojë e mosreflektimit të raportimeve të njësive të zbatimit të projekteve. Nga auditimi konstatohet se sipas raportimeve në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2017 rezulton se realizimi i treguesve të huamarrjes së huaj për vitin 2017 në terma bruto për kredinë për financim projektesh është rreth 27,200 milionë lekë, ndërkohë që sipas raportimit faktik në treguesit fiskal të konsoliduar paraqitet në shumën 23,407 milionë lekë. Mos paraqitja e vlerës reale të huasë së marrë për projekte të huaja për vitin 2017 në treguesit fiskalë të konsoliduar*, ka nënvlerësuar financimin e deficitit me rreth 3.793 milionë lekë dhe në të njejtën kohë deficiti i raportuar është nënvlerësuar me 3.793 milionë lekë.* Për të njejtin tregues, disbursimet e vitit 2017 për huanë e marrë për projekte me financim të huaj, Ministria e Financave ka dy raportime të ndryshme. *Efekti i vlerësuar i këtyre mos raportimeve të të dhënave të plota për aktivitetin 12 mujor të Buxhetit të Shtetit vlerësohet jo vetëm në tejkalim të shpenzimeve kapitale dhe huadhënies neto (kryesisht për projektet me financim sektorin energjitik), por edhe në drejtim të deficitit të deklaruar, duke e nënvlerësuar atë.*

7. Gjithashtu nga analiza e urdhër prokurimeve të rregjistruara në SIFQ u konstatuan 206 prokurime në vlerë 6.3 miliardë lekë të ndërmarra pas datës 15.10.2017 në shkelje të nenit 51 të Ligjit të Buxhetit pavarësisht se me nenin 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore" mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar. Në kushtet kur nuk regjistrohet PBA në SIFQ (trajtuar më hollësisht në këtë raport) nuk mund të japim siguri nëse këto prokurime janë në përputhje me VKM apo në shkeljetë LOB. Sa më lartë gjetja u verifikua dhe me të dhënat e marra nga APP. Referuar tabelës ""*prokurimet e publikuara" rezultojnë në total 51 raste me vlerë fondi limit pa TVSH 2.3 miliardë lekë të publikuara pas datës 15.10.2017.* Rastet e mësipërme mbeten objekt i mëtejshëm investigimi për të verifikuar nëse ato janë prokurime pjesë e projekteve me plan buxhetor 3 vjeçar të miratuar.

3.3 Fondi i Kontigjencës dhe Rezervës

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit (FRBSH) dhe Fondi i Kontigjencave (FK), janë pjesë përbërëse e Buxhetit Vjetor të Shtetit dhe e Pasqyrës Vjetore Fiskale të tij. Këto fonde planifikohen çdo vit nga Ministria e Financës dhe

[shqiptaria.com]

Ekonomisë, përdoren me kërkesa të institucioneve qendrore dhe miratohen nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe Këshilli i Ministrave. Për vitin 2017, me ligjin fillestar të buxhetit Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe fondet e kontigjencave janë planifikuar për 14,000 milionë lekë, ku fondi rezervë zë 10.8% të totalit të tyre. Me aktin normativ nr.2, këto fonde janë programuar në vlerë 16,200 milionë lekë, pra janë shtuar për 2,200 milionë lekë, ose më shumë se programimi fillestar për 15.7%. Programimi përfundimtar i këtyre fondeve, i realizuar me aktin normativ nr.3, i ka zbritur këto fonde në 14,700 milionë lekë, pra janë zvogëluar për 1,270 milionë lekë, ose 8% më pak më pak se akti normativ nr.2.

Janë përdorur gjithsej në vlerë 10,519 milionë lekë, pra më pak se programimi përfundimtar i tyre, në vlerë 4,181 milionë lekë, ose 28.4% më pak. Kështu fondi rezervë nuk është përdorur për 98 milionë lekë, ose 4.1% më pak, ndërsa fondi i kontigjencave nuk është përdorur për 4,083 milionë lekë, ose 33.2% më pak. *Në përdorimin e këtyre me totalin e fondeve të miratuara të buxhetit të shtetit, është ruajtur kufiri ligjor prej 3%.*

Nga auditimi i dosjeve të vendimeve për përdorimin e Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit rezultoi:
- Në 5 VKM, në vlerë 19 milionë lekë, ose rreth 1% e vlerës së këtij fondi, Vendimet e Këshillit të Ministrave, janë marrë me vonesë për likuidimin e vendimeve të GJEDNJ.
- Në 3 VKM, në vlerë 136.8 milionë lekë, ose 5.9% e vlerës së këtij fondi, në dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave, nuk janë relacionet shpjeguese për shpenzimet që kërkohen nga institucionet përfituese për përdorimin e këtij fondi, në kundërshtim me udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit. Në këto vendime, nuk specifikohet natyra e shpenzimeve, kriteret dhe mënyra e llogaritjes si dhe arsyetimi mbi pamundësinë e financimit nga buxheti 2017.
- Në 4 VKM, në vlerë 212 milionë lekë, ose 9.2% e vlerës së këtij fondi, dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave, nuk kanë preventiv shpenzimesh nga institucionet përfituese për përdorimin e këtij fondi, në kundërshtim me udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit.
- Në 4 VKM, në vlerë 210.7 milionë lekë, ose 9.2% vlerës së këtij fondi, nuk janë miratimet e Ministrisë së Financave për përdorimin e këtij fondi.
- Në 4 Vendime të Këshillit të Ministrave, në vlerë 162,128 mijë lekë, ose 7% të vlerës së këtij fondi, fondi rezervë është përdorur si "shtesë buxheti", fonde të cilat, duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të buxhetit.
- Në 2 dosje të Vendime të Këshillit të Ministrave, në vlerë 90.5 milionë lekë, ose 3.9% të vlerës së këtij fondi, fondi rezervë është përdorur edhe pse gjatë shqyrtimit të relacionit dhe projektit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, u gjeten mangësi. Nga institucioni kërkues i këtij fondi nuk ishin sqaruar apo plotësuar mendimet e MFE, në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të përdorimit të fondit rezervë.

Nga auditimi i dosjeve të Vendimeve për përdorimin e Fondit të Kontigjencave, rezultoi se për vitin 2017, *fondet e kontigjencave nuk janë përdorur sipas përcaktimeve të ligjit organik të buxhetit: për nevojën e financime të reja, apo për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave dhe as sipas përcaktimeve të Ligjit vjetor nr. 130, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017",* të ndryshuar me akte normative, ku Fondi i Kontigjencës është miratuar

në vlerën 4,000 milionë lekë "Kontigjenca për risqet e borxhit" dhe 1,000 milionë lekë për investime me Aktin Normativ nr.2, datë 16.08.2017.

3.4 Fondi i të Përndjekurve Politikë

Fondi i të Përndjekurve Politikë për vitin 2017 është realizuar në vlerën 2,298 milionë lekë sipas Tabelës Fiskale, nga 2,352 milionë lekë (ose realizuar 98%) të planifikuara në AN 3. apo 2,000 milionë lekë planifikuar me ligjin nr.130/2016 datë 15.12.2016, "*Për buxhetin e vitit 2017*".

Nga auditimi konstatohet se, baza ligjore për Fondin e ish të Përndjekurve Politikë është e paplotësuar dhe me probleme. Pas ndryshimeve të rëndësishme në ligj të vitit 2014 ende nuk kanë dalë aktet nënligjore përkatëse. Vlera e njohur e detyrimeve por ende e papaguar në fund të vitit 2017 është rreth 31,450 milionë lekë. Nëse buxhetimi dhe çelja e fondit të ish të përndjekurve do të vazhdojë të mbajë ritmet e deritanishme me afërsisht 2 miliardë lekë në vit *ky detyrim do të mund të shlyhet vetëm pas 16 vitesh.* Për të ruajtuar vlerën reale të kompensimit duke patur në konsideratë kohën e gjatë, do të duhej që detyrimet e njohura ndaj kësaj shtrese të indeksoheshin me inflacionin.

Gjithashtu duhet theksuar se ky nuk është detyrimi final ndaj ish të përndjekurve politikë, pasi nga Ministria e Drejtësisë pretendohet se ka akoma rreth 300 dosje të kategorisë parësore dhe rreth 24,000 dosje të kategorisë joparësore që presin të shqyrtohen në rrugë administrative. Deri në vitin 2017 është miratuar dëmshpërblim për rreth 7,382 dosje çka na bën të kuptojmë se mund të flitet për trajtimin e më pak se 30% të totalit të dosjeve.

Shpërndarja e fondit për vitin 2017 midis dy kategorive ka qënë në raportin 74% (1,697 milionë lekë) për kategorinë parësore dhe 26% (604 milionë lekë) për kategorinë jo parësore, me një diferencë të vogël nga parashikimi ligjor (70% me 30%). Nga evidenca e marrë nga sistemi E-dëmshpërblime me pagesat e vitit 2017, dhe testimet e shumta me subjektet përfituese të kategorisë parësore konstatohet se Paragrafi i Dytë, Neni 1, i Ligjit Nr. 94/2014 që përcakton se *"Me kryerjen e pagesës, për të gjitha subjektet parësore, brenda kështit më të ulët, fillon pagesa e kështit pasardhës e kështu me rradhë",* nuk është zbatuar dhe pa për funduar shpërndarja brenda kështit më të ulët për të gjitha subjektet e kategorisë parësore është vazhduar me shpërndarjen e kësteve pasardhëse, për arsye se proçedura e parashikuar në Udhëzimin Nr.5 datë 15.04.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për shpërndarjen e këtij fondi përcakton se subjektet përfituese duhet të paraqesin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dëshminë që janë gjallë çdo tre muaj. *Gjithashtu, KLSH ka rirekomanduar që të ardhurat nga privatizimet, të shkojnë në masën 20% për shlyerjen e deturimeve të përndjekurve politikë.*

3.5 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR)

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve ka pasur një programim jo efektiv për vitin 2017, duke mos financuar një nga tre shtyllat kryesore përbërëse të tij konkretisht shtyllën e tretë "Programi i Mbështetjes për Ekonominë" dhe duke dështuar në ofrimin e mbështetjes financiare për Ndërmarrjet Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM-të). FZHR megjithëse është burim financimi për gjashtë programe buxhetore, vetëm programi "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" është i identifikueshëm dhe del si zë më vete në tabelën fiskale, kurse të gjitha projektet e tjera, të cilat financohen nga FZHR nëpërmjet programeve të tjera

[shqiptaria.com]

buxhetore raportohen të pa diferencuara dhe në një zë me të gjitha shpenzimet e tjera kapitale. Si pasojë është e vështirë të identifikohet vlera totale e investimeve që financon FZHR çdo vit. Realizimi në Tabelën Fiskale për programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" nuk është i saktë, pasi mungon raportimi për dhjetë projekte, si dhe evidenca Plan/Fakt e Drejtorisë së Thesarit për këtë program nuk rakordon me evidencën Plan/Fakt të Drejtorisë së Buxhetit.

Fondi i Mbartur në vitin 2017 nga vitet e kaluara për Programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" ka pësuar ndryshime gjatë vitit në shkelje të proçedurës së parashikuar në udhëzimin e zbatimit të buxhetit dhe vlera e tij nuk mund të përcaktohet saktë. Fondi i Mbartur në vitin 2017 për Programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" në Tabelën Fiskale rezulton me realizim ndërkohë që nuk ka planifikim.

3.6 Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Deficiti i degës së pensioneve për vitin 2017, *rezultoi në shumën 27,458 milionë lekë, ose rreth 817 milionë lekë më pak nga plani fillestar prej 28,275 milionë lekë. Ky tregues u rrit me 317 milionë lekë apo rreth 1% më shumë, në krahasim me vitin 2016, ku deficiti ishte 27,141.5 milionë lekë,* ndërsa në raport me PBB[4]-në ky tregues është përmirësuar nga 1.77 pikë në vitin 2016, në 1.03 pikë në vitin 2017. Rezultat i rritjes së deficitit, krahasuar me një vit më parë, është rritja më shumë e shpenzimeve me 6,752 milionë lekë, se rritja e të ardhurave me 6,435 milionë lekë. Faktorë që kanë ndikuar në rritjen e deficitit në vitin 2017, ndër të tjera janë: *rritja e shpenzimeve të pensioneve me rreth 1,900 milionë lekë si pasojë e indeksimit, 4 muaj më herët se vitet e tjera (ndërsa për 4 vite rresht nga 2013-2016, indeksimi është bërë në muajin gusht, për vitin 2017, ky indeksim u bë në muajin mars)* [5]; si dhe *mosrealizimi i të ardhurave me rreth 900 milionë lekë, si pasojë e rritjes së pagës minimale për efekt pensioni 3 muaj më vonë nga indeksimi i pensioneve.*

Për të shmangur risqe që lidhen me politizimin e procesit të indeksimit, si dhe për të minimizuar impaktin e procesit në rritjen e deficitit si pasojë e shtimit të muajve por edhe luhatjeve të vetë koeficientit të indeksit në muaj të ndryshëm të vitit, theksojmë nevojën e aplikimit të indeksimit të pensioneve dhe politikave që lidhen me këtë proces, në periudha të njëjta çdo vit, sikundër është vepruar deri në vitin 2016.

Deficiti i degës së pensioneve të fshatit, ka rezultuar 11,371.11 milionë lekë, nga 11,593.2 milionë lekë një vit më parë, pra 222 milionë lekë më pak, ose 1.92% më pak. Edhe pse në vlerë nominale, rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar[6], deficiti i skemës konsiderohet i lartë nëse konsiderojmë që skema mbulon vetëm 21.4% të numrit të përgjithshëm të përfituesve. Në fund të vitit 2017 të ardhurat nga dega e pensionit të fshatit

---

[4] PBB = 1,555,200 milionë lekë

[5]

Viti	VKM	Hyn ne fuqi
2013	583, date 17.07.2013	01.08.2013
2014	456, datë 09.07.2014	01.08.2014
2015	651, datë 22.07.2015	01.08.2015
2016	549, datë 27.07.2016	01.08.2016
2017	130, datë 22.02.2017	01.03.2017

[6] Përmirësimi ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve nga 53,168 që ishin në vitin 2016, në 58,528 në vitin 2017, duke dhënë një impakt të vlerësuar prej 203,6 milionë lekë në kontributet e vitit korent.

lshiptaria.com

kanë mbuluar vetëm 23% të shpenzimeve të kësaj dege, nga 22% që mbuluan një vit më parë.

Ndërsa skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, dhe përthith 85% të shpenzimeve shpenzime (pra me një diferencë prej 10% të ardhura mbi shpenzimet), ky raport paraqitet në kah të kundërt për skemën e fshatit, ku kjo e fundit rezulton të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve. Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%. Kjo pasi periudha e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, për efekt pensioni, njihet e njëjtë si për të vetëpunësuarit në qytet, pavarësisht se tarifa e kontributit vjetor të tyre është mesatarisht rreth 57% më e ulët se e qytetit, dhe diferenca për kontributet e tyre mbulohet nga buxheti i shtetit.

Për vitin 2017, deficiti i degës së pensioneve të qytetit *është në shumën 16,087 milionë lekë*, nga 15,548 milionë lekë që ishte një vit më parë, pra këtë vit deficiti është më shumë për 539 milionë lekë, ose 3% më shumë se një vit më parë. Rezultat i rritjes së deficitit, krahasuar me një vit më parë, është rritja e shpenzimeve me rreth 8% më shumë, ose me 6,649 milionë lekë dhe rritja e të ardhurave 9% më shumë ose me 6,110 milionë lekë (pra rritja e shpenzimeve ka tejkaluar rritjen e të ardhurave me 539 milionë lekë). Në fund të vitit 2017 të ardhurat nga dega e pensionit të qytetit kanë mbuluar rreth 81.5% të shpenzimeve të kësaj dege, nga 80,7% që mbuluan në vitin 2016.

Numri mesatar vjetor i kontribuesve në skemën e pensioneve, për vitin 2017, është 763.998 kundrejt 718.286 kontribues që ishte një vit më parë me nje rritje prej 45.712 kontribuesish, ose rreth 6.4% më shumë se një vit më parë. Raporti i kontribuesve për 1 përfitues, për vitin 2017 tregoi përmirësime duke u rritur në 1.23 kontribues për 1 përfitues, nga 1.17 që ishte në vitin 2016.

SUBJEKTET	Nr. mesatar 2016	Nr. mesatar 2017	Diferenca 2017/2016	
Publike	155,401	158,002	2,601	1.6%
Private	445,763	481,467	35,704	8%
Totali (nga DPT)	***601,164***	***639,469***	***38,305***	***6.4%***
Të vetëpunësuar në bujqësi	53,168	58,528	5,360	10.1%
Të siguruar vullnetarë	7,323	8,027	704	9.6%
Të siguruar të tjerë (nga shteti)	40,780	41,015	235	0.6%
Kontribues nga PASH	15,851	16,959	1,108	7%
TOTALI	**718,286**	**763,998**	**45,712**	**6.4%**

3.7 Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetsor (FSDKSH)

Nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor *janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në vendimmarrjet e organeve drejtuese të këtij institucioni, në menaxhimin e burimeve njerëzore, në administrimin e fondeve të rimbursimit të barnave, në monitorimin e kontratave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore lidhur me detyrat funksionale të punonjësve të Fondit, si dhe evidentohet dobësim i sistemeve të kontrollit gjatë vitit 2017,* në të gjitha aspektet e funksionimit të këtij institucioni, që ka sjellë *efekte negative për buxhetin e shtetit në shumën 3,865 milionë lekë.* Një përmbledhje e problematikave të konstatuara, trajtuar në këtë raport, paraqitet më poshtë.

[Shqiptarja.com]

1. Rritje shumë e lartë e vlerës së Rimbursimit për vitin 2017, në *vlerë 1,992 milionë lekë ose 23.6%,* por jo e numrit të përfituesve nga skema.
2. Pasoja negative të konsiderueshme në buxhetin e shtetit në vlerë 409 milionë lekë nga mos-hyrja në fuqi e Listës LBR 2017 megjithëse e miratuar nga Fondi.
3. Mosreflektim i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditime të mëparshme me pasoja të konsiderueshme në buxhetin e shtetit si rrjedhojë e kontratës së Check-up, kur numri i përfituesve vijon në ulje nga viti në vit. Kosto e pajustitifikuar nga fillimi i kontratës në vlerë *182 milionë lekë dhe pagesa e pajustifikuar e TVSH nga fillimi i kontratës në vlerë 413.7 milionë lekë*
4. Mosreflektim i çmimeve të reja nga FONDI me pasoja në buxhetin e shtetit në vlerë 132 milionë lekë.
5. Mosveprime dhe Rimbursime të kryera në mënyrë të parregullt të cilat kapin vlerën e 700 milionë lekë.
6. Konstatohet mungesë e pajustifikuar bashkëveprimi nga ana e Fondit me organet tatimore kundër paligjshmërisë dhe evazionit fiskal.
7. Konstatohet se për 30 rastet e shqyrtuara nga KA-ja gjatë vitit 2017 janë tejkaluar kompetencat e parashikuara në përdorimin e barnave në shumën 139 milionë lekë.

3.8 Mbi administrimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore

Në 27 bashkitë e audituara për qëllime të Raportit të Zbatimit të Buxhetit 2017, rezulton se deviacioni në nivelin e të ardhurave të realizuara, krahasuar me planifikimin është në vlerën 3,265 milionë lekë, deviacion që reflekton një problematikë të shtuar në lidhje me administrimin e taksave dhe tarifave vendore si e ardhur e munguar në buxhetet e këtyre bashkive dhe pengesë në realizimin e projekteve të planifikuara në shërbim të komunitetit.

Nga auditimet konstatohet keq menaxhim i sipërfaqeve pyjore, kullosore, hapësirave për plazhe, të sipërfaqes së tokës bujqësore të ndarë për numrin e familjeve si dhe taksave të tjera sipas rëndësisë së tyre. Gjithashtu janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore të mbledhjes së të ardhurave fiskale në vlerën 2,019 milionë lekë. Gjithashtu konstatohet se për pasuritë e kaluara me VKM në pronësi të këtyre njësive vendore, nuk është bërë e mundur zbatimi i kushteve të kontratës duke lënë detyrimet kontraktore të pa arkëtuara dhe rritur nivelin e borxhit.

Shpenzimet e pushtetit vendor. Për vitin 2017, sipas treguesve fiskalë të konsoliduar janë raportuar shpenzime për buxhetin vendor të realizuara në shumën 46,487 milionë lekë nga 46 milionë lekë të planifikuara me sipas AN.3 dhe 46,816 milionë lekë pas shpërndarjes së Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës.

Nga auditimi mbi shpenzimet e pushtetit vendor konstatohet se niveli i realizimit të shpenzimeve të financuara nga granti i buxhetit të shtetit për pushtetin vendor është realizuar në shumën 28,575 milionë lekë, nga 22,376 milionë lekë të planifikuar në formën e transfertave. *Tejkalimi i këtij zëri paraqitet në shumën 6,199 milionë lekë në shpenzimet e kryera nga pushteti vendor dhe të financuara nga transferta e buxhetit për pushtetin vendor.* Nga ana tjetër konstatohet se realizimi faktik i shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta paraqitet me realizim në shumën 17.9 miliardë lekë nga rreth 24 miliardë lekë të planifikuara me AN.3 duke përfshirë edhe të planin e të

ardhurave nga transferimi i rentës. *Mosrealizimi në këto burime financimi paraqitet në rreth 6 miliardë lekë***.**

Për buxhetin e vitit 2017, në 33 subjekte të pushtetit vendor, nga të cilat 28 bashki, 2 prefektura, 1 këshilla qarku dhe 2 ndërmarrje në vartësi, auditimet e ushtruara nga KLSH, janë konstatuar mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi. Këto shkelje kanë sjellë një dëm ekonomik në total në vlerën prej 350 milionë lekë, nga e cila vlera prej 58.6 milionë lekë përfaqëson mungesë të ardhurash (qira, taksat vendore, taksa e ndikimit në infrastrukturë etj), duke mbetur si shkelje ligjore në fushën e shpenzimeve buxhetore vlera 291.9 milionë lekë. Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017 nga Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, janë audituar 33 subjekte, të cilat kanë zhvilluar gjithsej 555 procedura prokurimi me vlerë 10,138 milionë lekë. Nga procedurat e zhvilluara, janë audituar 347 prej tyre, në vlerën 8,722 milionë lekë, ose 62 % të numrit të procedurave, apo 86 % të vlerës së kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë. Nga auditimi janë konstatuar me shkelje 203 procedura prokurimi, me dëm ekonomik në vlerën 285 milionë lekë.

Gjithashtu, rezulton se në mjaft njësi të vetëqeverisjes vendore, është akumuluar një borxh i konsiderueshëm, nga fatura të palikuiduara ndër vite, për arsye te kryerjes së punimeve apo shërbimeve pa u siguruar më parë fondet e nevojshme për kryerjen e tyre. Në bilancet e Bashkive rezultojnë mjaft detyrime të krijuara nga viti 2012 e para, por prej tyre, nuk ka një analizë të borxhit të krijuar në çdo vit nga pamjaftueshmëria e aftësisë paguese, faktorët që kanë ndikuar në krijimin e kësaj vështirësie financiare etj. Nga auditimet e kryera rezulton se për 28 Bashkitë e audituara deri në datë 31.12.2017, paraqitet një borxh (fatura të pa likuiduara dhe vendimet gjyqësore) në vlerën 2,994 milionë lekë.

Mbi tejkalimin dhe kufizimin e shpenzimeve për Pushtetin Vendor, si rrjedhojë e keqplanifikimit buxhetor, dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi i të dhënave në SIFQ konstatohet se pjesë e tejkalimit të transfertave të pakushtëzuara përkundrejt planit të miratuar është rregjistrimi pa plan shpenzimi i fondeve për infrastrukturën vendore dhe rajonale, për pjesën e projekteve të mbartura nga viti 2016. Sipas të dhënave të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, vlera e realizimit faktik të projekteve të mbartura nga viti 2016 është në shumën 4.7 miliardë lekë.

Në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar shoqëruese në planin e miratuar me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" , konstatohet se nuk është paraqitur plani për projektet e Fondit të Zhvillimit Rajonal të mbartur nga viti 2016. Për këto shpenzime faktike, nuk është përfshirë plan në tabelën e treguesve fiskalë edhe pas dy ndryshimeve me Akt Normativ të ligjit të buxhetit, megjithëse plani për to ishte paracaktuar që të mbartej deri në Dhjetor 2017 dhe pas rakordimit me degët e Thesarit do të përcaktohej shuma e tij, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017". Për të mbajtur të paprekur deficitin e vitit 2017, sipas planifikimit në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vititi 2017", të ndryshuar, nuk janë marrë masat e nevojshme në mënyrë që të reduktoheshin shpenzimet kapitale me financim të brendshëm me ndryshimet përkatëse të planit, por është lejuar kryerja e shpenzimit pa plan për shpenzimet e programit të infrastrukturës vendore dhe rajonale të mbartura nga viti 2016. I*nstrumenti i përdorur për të mbajtur në kontroll shpenzimet e pushetit vendor, për të mos korrigjuar*

[shqiptarja.com]

shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, është ai i kufizimit të kryerjes së shpenzimeve, nëpërmjet vendosjes së limitit në përdorimin e cash për dy muajt e fundit të vitit në 3.4 miliardë lekë, me shkresën nr. 15973, datë 09.11.2017, gati 3 ditë pas AN.3, datë 06.11.2017. Në këtë mënyrë, rezulton se për qëllime të mbajtjes në kontroll të shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor, janë vendosur kufizime mbi të drejtën për të shpenzuar, për fonde të cilat janë miratuar për tu shpenzuar me Akt Normativ nr.3. *Frenimi i regjistrimit të shpenzimeve ka rezultuar në krijimin e detyrimeve shtesë të prapambetura për pushetin vendor.*

Gjithashtu konstatohet që *në planifikimin e shpenzimeve për pushtetin vendor nuk është përfshirë disbursimi përkatës i nënhuasë së marrë në pushtetin vendor për projektin e Bulevardit verior të Tiranës në shumën 1,646 milionë lekë.* Në tabelën e treguesve faktik fiskalë të konsoliduar sipas SIFQ kosntatohet se ky projekt është i raportuar në shumën 1,646 milionë lekë në seksionin e shpenzimeve të buxhetit vendor të financara nga kapitulli 2, financimi i huaj. Nga analiza e raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë reuzlon se fakti në lidhje me këtë projekt në zërin e shpenzimeve të pushtetit vendor është 0 lekë**,** pasi ai është raportuar në zërin e huadhënies neto në shumën 1,646 milionë lekë (edhe këtu i pashoqëruar me plan buxhetor), duke u riklasifikuar nga jashtë pas raportimit në fiskale. *Në këtë mënyrë, shpenzimet e zërit për buxhetin vendor janë nënvlerësuar në shumën 1,646 milionë lekë, duke sjellë efektin e mbulimit të tejkalimit të planit të buxhetit vendor me 1,646 milionë lekë.* Një gjë e tillë është kryer si pasojë e mosplanikimit të shpenzimeve të buxhetit vendor të financuara nga kapitulli me anë të AN.3.

Nga auditimi i performancës lidhur me reformën administrative-territoriale KLSH ka konkluduar, se nuk janë reflektuar parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Për pasojë, rezultojnë mospërputhje mes objektivave të reformës dhe politikave fiskale dhe buxhetore të qeverisë qendrore të cilat kanë cenuar autonominë vendore duke minuar kështu forcimin e decentralizimit dhe autonomisë së bashkive. Gjithashtu, *Reforma Administrative-Territoriale nuk ka përmbushur objektivat: legjislacioni i ri nuk zbatohet plotësisht, procesi i përthithjes së funksioneve të reja, punonjësve, aktiveve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve nuk është arritur të realizohet me sukses. Në shumicën e bashkive rezulton nivel i ulët efektiviteti në mbledhjen e të ardhurave të veta dhe në përdorimin e fondeve në dispozicion.*

4. SISTEMET E KONTROLLIT NË SISTEMIN E THESARIT

Nga auditimi i sistemit të thesarit janë konstatuar thyerje të sistemeve të kontrollit përgjatë gjithë hallkave, të vendosura me qëllim disiplinimin fiskal gjatë ekzekutimit të buxhetit. Njw përmbledhje e thyerjeve kryesore paraqitet si vijon:

Urdhër prokurimet rregjistrohen në thyerje të afatit ligjor: konstatuar 579 raste të rregjistrimeve në SIFQ, në shumën 15.4 miliardë lekë nga 13 BI-online ku veçojmë: Bashkia Tiranë (284 raste) dhe AKSHI (123 raste). KLSH konstaton se rregjistrimet e urdhër–prokurimeve janë formale pasi në mbi 80% të rasteve ato janë rregjistruar pas firmosjes së kontratës, pra urdhër-prokurimi është rregjistruar në SIFQ formalisht vetëm për efekt të plotësimit të fushave që lejojnë më pas krijimin e dokumentit kontratë dhe pagesë respektive.

Mungesë informacioni dhe raportimi mujor për urdhër-prokurime të njësive pa akses direkt në SIFQ: Në përputhje me Ligjin nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar, neni 149 i tij, çdo institucion shpenzues duhet të paraqitet në Degën e Thesarit për të marrë vulën e konfirmimit të fondeve disponibël përpara se të fillojë proçesin e prokurimit. Për institucionet pa akses direkt në SIFQ ky process nuk dokumentohet pasi nuk ekziston mundësia e rregjistrimit në SIFQ. Proçes ky i domosdoshëm për kontrollin dhe shmangien e marrjes së angazhimeve pa fonde buxhetore dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të ri të faturave të prapambetura. Aktualisht, Drejtoria e Thesarit nuk ushtron kontroll, nuk mbledh informacion për prokurimet e shpallura dhe kontratat e pritshme, informacion që duhet raportuar në zbatim të Nenit 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 13.01.2017. Ky informacion do të shërbente për monitorimin e zbatimit të buxhetit, menaxhimin e likuiditetit, planifikimin koherent të programeve buxhetore të ardhshme dhe shmangien e rishpërndarjeve buxhetore të shumta gjatë vitit.

Nga auditimi i të dhënave të urdhër–prokurimeve të rregjistruara gjatë 7 mujorit të parë të vitit 2018, KLSH konstaton se problemi i mosrregjistrimit të të gjithë urdhër-prokurimeve nga të gjitha institucionet dhe mosrregjistrimi në afatet e përcaktuara me qëllim konfirmimin dhe bllokimin e fondeve buxhetore disponibël, vazhdon të mbetet. Sipas drejtimit të DPTH, kjo procedurë është nën kontrollin e APP në momentin e kontrollit të dokumentacionit për fillimin e procedurave të prokurimit pasi "është përgjegjësi e APP për të mos pranuar urdhër-prokurime pa vulën e thesarit".

Urdhër prokurime/kontrata të rregjistruara vetëm për vlerë të barabartë me fondet në dispozicion ndryshe nga vlera e prokuruar: Nga krahasimi i të dhënave me burim APP për të gjitha prokurimet e kryera gjatë vitit 2017 me të dhënat e marra nga SIFQ u konstatuan mospërputhje në datat e kontratës, në datat e urdhër-prokurimeve dhe ajo që është më e rëndësishme në vlerat e kontratave. Nga krahasimi i të dhënave të SIFQ me të dhënat e APP, nga 41 raste të zgjedhura për testim, në 17 prej tyre rezulton se urdhër-prokurimet janë të rregjistruara në vitin 2017 në APP ndërsa në SIFQ janë rregjistruar në vitin 2018. Dhe në 9 raste vlera e kontratës e rregjistruar në APP është e ndryshme nga ajo e rregjistruar në SIFQ me një diferencë prej totale prej 1.7 miliardë lekë (më pak në SIFQ). Ky testim evidentoi shkeljen e procedurës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 2 dhe VKM për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura që kërkojnë konfirmimin në Thesar të fondeve disponibël përpara shpalljes së procedurës së prokurimit. Gjithashtu evidentoi dhe fenomenin e rregjistrimeve të pasakta në SIFQ, të urdhër-prokurimeve dhe kontratave me vlera të fragmentarizuara, shpesh të barabarta me vlerën e faturës për tu paguar, dhe jo me vlerën e plotë të prokuruar, duke tejkaluar kontrollin për disponibilitetin e fondeve.

Duke vlerësuar si tepër shqetësues dhe me risk të lartë për raportimet e zbatimit të buxhetit rastet e rregjistrimeve të kontratave jo me vlerën e plotë të prokuruar, u kërkua informacion në lidhje me çeljet buxhetore të secilit prokurim/kontratë e rregjistruar në SIFQ në momentin e fillimit të procedurës së prokurimit dhe nga ku u konstatua se në momentin e prokurimit të kontratës çelja buxhetore disponibel ishte shumë më e vogël se vlera e prokurimit dhe kontratës së nënshkruar. Kështu,u konstatuan 6 raste me diferencë në vlerën e prokuruar kundrejt celjes buxhetore të miratuar prej 1.38 miliardë lekë prej të

[shqiptarja.com]

cilave 5 raste janë të projekteve të Bashkisë Tiranë me diferencë në vlera të çeljeve buxhetore prej 667 milionë lekë.
Nga auditimi në aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u konstatuan dy kontrata të lidhura gjatë vitit 2017 me vlerë rreth 174 milionë lekë të paraportuara në SIFQ, të pambështetura plotësisht në çelje buxhetore dhe për të cilat procedura e prokurimit kishte filluar pa u regjistruar urdhër prokurimi në SIFQ. Fakte këto që mbështesin konstatimet e mësipërme në lidhje me copëzimin e kontratave dhe urdhër-prokurimeve në rregjistrim me vlera jo të plotë por të barabarta me fondin disponibël, si dhe marrjen e angazhimeve financiare në tejkalim të fondeve të çelura buxhetore në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH. Për më tepër kur angazhimet e marra janë të pambështetura në fonde buxhetore sipas ligjit, nuk njihen si detyrime të shtetit.

Mbartja e kontratave shumëvjecare me vlera jo të plota dhe të copëzuara sipas faturave të lëshuara: Në zbatim të Udhëzimit nr.8 datë 13.01.2017, neni 37, kontrata për investime duhet të rregjistrohet për vlerën e tyre të plotë dhe e shoqëruar me planin e pagesave në vite. Në vitin 2016 me lindjen e detyrimit të të gjithë njësive për rregjistrimin e kontratës në SIFQ, cdo kontratë duhej të rregjistrohej në SIFQ për vitin korrent e shoqëruar me planin e pagesave sipas PBA. Nga investigimi i balancave hapëse për disa projekte dhe i pagesave të kryera më pas përgjatë vitit 2017 rezultoi se këto vlera nuk janë marrë nga kontrata fizike të depozituara në Degët e Thesarit dhe të azhornuara me pagesat e kryera por në të vërtëtë ato janë bazuar në llogaritjen e: e faturave të paguara (pjesa e zbatuar e projekteve) plus fatura të prapambetura (të papaguara për punime tashmë të kryera). Pra vlera e angazhimeve të raportuara nga SIFQ nuk paraqet vlerën e plotë dhe të saktë të angazhimeve në rang sistemi buxhetor. Më shqetësues është fakti se ky fenomen nuk konstatohet vetëm tek kontratat e mbartura ndër vite por edhe tek ato të lidhura dhe të rregjistruara rishtaz gjatë vitit 2017. Nga rastet e përzgjedhura për testim nga kjo tabelë janë konstatuar disa problematika, edhe të kombinuara në një projekt të vetëm si: rregjistrimin e copëzuar të kontratës, ndryshime të vlerave të angazhimit, shkurtim të fondeve buxhetore me AN3 ndërkohë që projekti mbart detyrime, mos rregjistrim të planit të pagesave sipas PBA për 2017-2019.

Janë konstatuar pasaktësi në regjistrimin e angazhimeve në vlerë dhe afate regjistrimi nga përdoruesit e autorizuar të sistemit (BI online) dhe nga degët e thesarit për njësitë të cilat nuk kanë akses direkt në SIFQ në shkelje të Udhëzimit nr.2 dt.06/02/2012, pikës 176 dhe 178:

Nga auditimi i të dhënave të angazhimeve, kontratave dhe pagesave respektive KLSH ka investiguar dhe konstatuar dhe fenomenin e rregjistrimit të kontratave në të njëjtën ditë ose 1-2 ditë diferencë në kohë me rregjistrimin e faturës së parë. Pra institucionet me akses apo jo në SIFQ edhe pse në dijeni të afateve ligjore për rregjistrimin e cdo dokumenti për investim: nga urdhër-prokurime deri te fatura, në mënyrë të vetëdijshme jo vetë nuk i zbatojnë këto afate por autorizojnë rregjistrime me vlera pjesore të barabarta me faturën dhe jo me vlerën reale të kontraktuar, si psh rasti i Bashkisë Tiranë (dy kontrata në vlerë totale 1.46 miliardë lekë) dhe FZHSH (një kontratë në vlerë 926 milionë lekë).
Një tjetër fenomen i konstatuar është rasti i pagesave pjesore të faturave me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël dhe mbartjen e detyrimit të mbetur në vitin pasardhës.

Raportime të pasakta të investimeve publike ku mungojnë: plani i pagesave (angazhimet për 3 vite) sipas PBA-së në 90% të projekteve të listuara, vlera plotë e angazhimit të projektit të ri dhe vlera e saktë e kontratave të mbartura. Në sistemin SIFQ, që prej muajit Prill 2016 janë shtuar fusha për të rregjistruar kontratën në mënyrë të plotë dhe sipas skedulit të pagesave dhe PBA-së së miratuar. Kjo si domosdoshmëri kontrolli dhe monitorimi jo vetëm për buxhetin faktik por dhe për qëllim planifikimi të buxhetit të vitit të ardhshëm. Aktualisht ky kontroll nuk përdoret dhe informacioni për shpërndarjen në vite të kontratës plotësohet në mënyrë rastësore dhe i jo i detyrueshëm. Aktualisht, në momentin e rregjistrimit të kontratës në SIFQ (nga BI online apo në Degët e Thesarit) vlera e kontratës mbi çeljen buxhetore rregjistrohet në SIFQ në vitin jo-fiskal 2020 (2021) si angazhim pa fonde buxhetore.

Në lidhje me moszbatimin e afateve të rregjistrimit të kontratave në Degët e Thesarit në 72% të rasteve me vlerë 62.9 miliardë lekë: Në zbatim të pikës 17 të Udhëzimit specifik nr.26 dt. 20/11/2012 "Pas miratimit nga nëpunësi zbatues dhe nepunesi autorizues i njesise brenda pese diteve pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si me siper paraqitet ne gjuhen shqipe (ne rastin e kontratave të lidhura ne gjuhe te huaj) bashke me njoftimin perfundimtar zyrtar per shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjese per thesarin ne dege". Në vijim janë analizuar dhe grupuar data të kontratave të rregjistruara me datën e krijimit në sistem ku rezultojnë gjithsej 16795 raste ose 72% e gjithë kontratave të rregjistruara gjatë vitit 2017 në shkelje të afateve të përcaktuara me vlerë 62.9 miliardë lekë në udhëzimin e sipërcituar. Numri më i lartë i shkeljeve konstatohet në njësitë e qeverisjes vendore: tipikisht Bashkia Tiranë, Durres, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Mos rregjistimi i faturave brënda afateve ligjore konstatuar rreth 24 mijë raste me vlerë 29.1 miliardë lekë si dhe 393 raste të moszbatimit të afatit nga Dgët e Thesarit për kryerjen e pagesës: Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të këtyre afatit 30 ditor si nga ana e njësive shpenzuese ashtu edhe nga Degët e Thesarit. Nga auditimi u konstatuan 23,701 mijë raste me vlerë 29.1 miliardë lekë faturash të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor nga njësitë publike. Nga analiza me vizualizim i shkeljes për mos respektim të afateve vërehet se ky fenomen është më i përhapur në Institucionet vendore me një numër prej 11550 transaksionesh në vlerën 9,830 milionë lekë (vecanërisht Bashkia Tiranë) të ndjekura nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Gjtihashtu, nga një total prej 181 mijë pagesa të rregjistruara gjatë vitit 2017 për shpenzime dhe mallra rezultojnë 393 raste me vlerë 514 milionë lekë me tejkalim të afatit 30 ditor të kryerjes së pagesës nga momenti i regjistrimit në sistemin e thesarit.

Kryerja e pagesave për fatura të grupuara në një urdhër shpenzim: 131 raste në vlerën rreth 1.4 miliardë lekë. Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2017, konstatohet se janë likuiduar me një urdhër shpenzim disa fatura njëkohësisht, kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet në periudhën në të cilën ai është kryer dhe lind detyrimi. Nga analiza e faturave te likujduara me një urdhër shpenzim konstatohet se vetëm në zërin e shpenzimeve për AQT (investime publike llog. ekonomike: 230 dhe 231) janë bërë pagesa në grup në 40 raste me

vlerë 1 miliardë lekë[7]. Kjo krijon mundësinë e mosidentifikimit të qartë dhe unik të një fature/detyrimi, kohën kur ka ndodhur shpenzimi dhe nuk lejon monitorim të progresit të realizimit kontratave në mënyrë korrente.

Mbi rregjistrimin dhe raportimin e stokut të faturave të prapambetura. Niveli i stokut i konstatuar në fund të vitin 2017 është raportuar nga MFE 16.4 miliardë por sipas procedurave të testimit rezulton të jetë të paktën në vlerën 19 miliardë lekë: Kjo balancë sipas të dhënave të DPTH, paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara më 31.12.2017, klasa 4 si "shpenzime të periudhave të ardhshme" në shumën 16.4 miliardë lekë. MFE nuk jep garanci nëse njësitë ekonomike kanë deklaruar në Thesar të gjithë faturat e prapambetura dhe ato të krijuara rishtas deri në datën e raportimit.

Grupi i auditimit analizoi pagesat e kryera gjatë vitit 2017 ku u konstatuan 6857 pagesa të faturave dhe detyrimeve të prapambetura në shumën 8.7 miliardë lekë. Ndërkohë u analizuan pagesat e kryera gjatë 7-mujorit 2018 ne zërin shpenzime kapitale ku rezulton se pagesat e lidhura me fatura që mbajnë datë 2017 janë në vlerë 11.5 miliardë lekë, duke treguar që gjatë vitit 2017 detyrimet e prapambetura janë rritur dhe jo të gjitha deklarimet e faturave të prapambetura nga institucionet janë të sakta dhe të plota. Si rrjedhim kjo balancë duhej të ishte raportuar të paktën 19 miliardë lekë. Kjo shifër në gjykimin e grupit të auditimit është më e lartë duke marrë në konsideratë edhe llogaritë e tjera dhe pasaktësitë e konstatuara në datat e faturave.

Mosmarrja e masave administrative, të vlerësuara nga KLSH në të paktën 7 miliardë lekë, nga NPA për shklejet e ligjit në menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve ligjore për parandalimin e detyrimeve të prapambetura: KLSH konstaton se nuk raportohen informacione mbi asnjë masë të marrë kundrejt NA-ve të institucioneve që marrin angazhime financiare pa fonde buxhetore, pengojnë dërgimin e faturave në thesar dhe nuk zbatojnë afatet e rregjistrimit të kontratave të angazhimeve brenda afatit ligjor. Neni 71, gërma (f dhe gj) e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë', i ndryshuar, parashikon gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 1 deri në 3 paga mujore (për rregjistrimin me vonesë të kontratave) dhe 3 deri 7 paga për moszbatim të afateve të dorëzimit të urdhër-shpenzim. Kështu , gjoba të përllogaritura, por të pa vendosura nga NPA, për cdo vonesë në dorëzim të faturës në Thesar vlerësohet të ishin minimalisht rreth 7 miliardë lekë.

5. RAPORTIMI I BUXHETIT

5.1 Raportimi i treguesve fiskalë dhe Deficitit

KLSH ka konstatuar riklasifikime të kryera jashtë raportit standart të SIFQ, të kryera manualisht me qëllim mbulimin e tejkalimit të planit të disa zërave buxhetorë dhe deficitit, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në të cilin citohet se "Sistemi informatik financiar i Qeverisë (SIFQ)" është sistemi financiar, nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit". Gjithashtu, sic parashtruar në pjesën mbi borxhin publik, huadhënie e huaj dhe shpenenzimet që ka mbuluar nuk janë raportuar të plota në tabelën e treguesve fiskal.

[7] KLSH ka përjashtuar rastet e pagesave në grup për shpenzime utilitare: energji, ujë etj.

shqiptaria.com

Zërat kryesore buxhetore të cilat paraqiten në tejkalim dhe të raportuara në seksione të ndryshme të tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar përfshijnë kryesisht shpenzimet kapitale me financim të huaj, huadhënien neto, shpenzimet për pushtetin vendor, deficitin dhe huanë e kthyer nga projektet.

Shpenzimet për pushtetin vendor paraqiten në shumën 48,132 milionë lekë në SIFQ dhe janë të raportuara në shumën 46,487 milionë lekë në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Nga auditimi rezulton se një pjesë e diferencës, ekziston për shkak të raportimit të shpenzimeve me burim financimi të huaj të vendorit në zërin e huadhënies neto në formën e huasë së disbursuar për vendorin. Me anë të riklasifikimit të kryer nga MFE jashtë SIFQ tejkalimi i planit të pushteti vendor i paraqitur sipas SIFQ është mbuluar për këtë zë, duke denatyruar informacionin financiar përkundrejt fondeve të miratuara. Me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, *nuk janë miratuar fondet për shpenzimin kapital të pushtetit vendor nga financimi i huaj.*

Shpenzimet kapitale me financim të huaj paraqiten në shumën 30,258 milionë lekë sipas SIFQ, ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar janë paraqitur në shumën 22,278 milionë lekë, duke i raportuar nën planin përfundimtar të tyre në shumën 24,570 milionë lekë. Tejkalimi i këtyre shpenzimeve të riklasifikuara është paraqitur në zërin e huadhënies neto në formën e huas së së dhënë për dy sektorët e tjerë përveç vendorit në të cilën është realizuar nënhuadhënia.

Huaja e kthyer në shumën -1,909 milionë lekë e raportuar në zërin hua e kthyer nga huadhënia neto, paraqitet e keqklasifikuar, duke qenë se sipas raportit të SIFQ, raportohet poshtë zërit të deficitit në zërin të tjera edhe riklasifikimi i saj ka efekt në shtesën e deficitit me 1,909 milionë lekë. Nga ana tjetër, hua e kthyer nga huatë e dhëna si mbështetje buxhetore nga vitet e kaluara vlerësohet të jetë në shumën 262 milionë lekë. Efekti neto në deficit si pasojë e raportimit jo të saktë vlerësohet të jetë në shumën 1,647 milionë lekë si diferencë ndërmjet huasë së kthyer për projektet e huaja me huasë së kthyer nga mbështetja buxhetore.

Në zërin e huadhënies neto, është raportuar mbështetje buxhetore për sektorin energjitik nga burime të brendshme në shumën 1,500 milionë lekë, ndërkohë që nga auditimi është konstatuar se mbështetja buxhetore faktike për vitin 2017 rezulton në shumën 2,500 milionë lekë. Efekti i keqklasifikimit prej 1,000 milionë lekë është raportuar në llogarinë (604-transferta), duke raportuar për të njejtin transaksion në dy llogari të ndryshme buxhetore. *Klasifikimi i gabuar nuk vlerësohet me ndikim në deficit, por në cilësinë dhe saktësinë e treguesve të raportuar të shpenzimeve.*

Huaja e dhënë për sektorin energjitik nuk është raportuar e plotë duke qenë se nuk janë përfshirë efektet e mosraportimit të projekteve me financim të huaj në shumën 1,934 milionë lekë. Huaja e dhënë për sektorin të tjera nuk është raportuar e plotë duke qenë se nuk janë përfshirë efektet e mos raportimit të projekteve me financim të huaj në shumën *170 milionë lekë, e cila duhet të riklasifikohet në zërin e shpenzimeve kapitale e gjitha.*

Huaja e disbursuar e raportuar në zërin e shpenzimeve kapitale, jo në formën e huadhënies neto, nuk është raportuar e plotë duke qenë se nuk janë pëfshirë efektet e mosraportimit të projekteve me financim të huajnë shumën 1,689 milionë lekë. Huaja totale e tejkaluar si pasojë e mos pasqyrimit të disbursimeve për katëse si pasojë e tre efekteve të mësipërme vlerësohet me

[shqiptaria.com]

efekt në deficit në shumën 3,793 milionë lekë (refrohuni dhe seksionit mbi borxhin publik), duke qenë se raportimet e projekteve specifike nuk janë raportuar për llogari të vitit buxhetor 2017, kur është kryer edhe disbursimi sipas konfimimeve të strukturave të borxhit, por janë raportuar në vitin 2018. Kjo ka nënvlerësuar tre zëra buxhetorë, huadhënien neto, shpenimet kapitale me financim të huaj dhe deficitin e raportuar.

Në total efekti i tejkalimit të deficitit të raportuar vlerësohet në shumën 5,440 milionë lekë, e përbërë nga 3,793 milionë lekë si pasojë e diferencave në disbursime ndërmjet vlerave të pasqyruara si shpenzim nga thesari në krahasim me borxhin dhe 1,647 milionë lekë si pasojë e riklasifikimit të arkëtimit nga marrëveshjes së nënhuasë. Si rrjedhojë, deficiti i vlerësuar rezulton në shumën 36,452 milionë lekë, duke tejkaluar kufijtë e vendosur me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar. *Në të njejtën kohë ndryshon edhe raporti i deficitit në raport me PBB duke arritur vlerën prej 2.34%, duke kaluar kufirin prej 2%*, në kundërshtim me nenin 4/1 "Parimet dhe rregullat fiskale të ligjit nr.9936 datë 26.26.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, *pa marrë në konsideratë efektin e detyrimeve të prapambetura.*

mln lekë

Treguesi	Plan A.N.3	Plani An.3+F.R+ F.K	Fakti SIFQ	Fakti publikuar ne fiskale	Fakti KLSH	Fakti KLSH riklasifikim+shpz pa raportuara
Vendori duke perfshire financimin e huaj	**46,400**	**46,816**	**48,132**	**46,487**	**48,133**	**48,133**
Shpenzime kapitale	**73,330**	**73,462**	**76,436**	**68,455**	**71,530**	**73,389**
Financim I brendshem	48,060	48,192	45,589	45,589	45,589	45,589
Financim te huaj	24,570	24,570	30,258	22,278	25,352	27,211
Nga TR arsimit te larte	700	700	589	589	589	589
Net Lending	**4,500**	**5,500**	**1,500**	**9,217**	**6,406**	**9,078**
Hua e dhene	6,000	7,000	1,500	11,126	6,406	9,340
Hua e kthyer	(1,500)	(1,500)	-	(1,909)	-	(262)
Deficiti	**(31,199)**	**(31,299)**	**(32,827)**	**(31,012)**	**(32,921)**	**(36,452)**
PBB	**1,596,382**	**1,596,382**	**1,555,202**	**1,555,202**	**1,555,202**	**1,555,202**
Deficiti/PBB	**-1.95%**	**-1.96%**	**-2.11%**	**-1.99%**	**-2.12%**	**-2.34%**

Detyrimet e prapambetura dhe stoku i rimbursimit të TVSH, trajtuar më hollësisht në pjesët e tjera të këtij raporti, nuk është përfshirë në llogaritjet më sipër. *Nëse detyrimet e prapambetura të krijuara gjatë vitit 2017 të paguara në 7 mujorin e parë të 2018 (11.5 miliardë lekë) dhe rritjen e stokut të rimbursimit të TVSH gjatë 2017 (7.2 miliardë lekë) do të ishin raportuar në treguesit fiskal si shpenzime të periudhës, niveli i deficitit të raportuar do të qe të paktën 3.54% e PBB-së. Në pëfundim, treguesi nga evidencat e marra niveli i raportuar në treguesit fiskal nuk jep një pamje të drejtë të deficit buxhetor për vitin 2017 dhe rruajtjes së limiteve në vite elektorale.*

5.2 Mbi raportimin financiar publik

Mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik rregullohet mbi bazë të "*Planit kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal dhe Institucioneve Shtetërore Qendrore dhe Lokale dhe njësive që varen prej tyre*" të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.04.1998, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 248, datë 10.04.1998 të Këshillit të Ministrave*". Duhet theksuar se VKM nr. 248, datë 10.04.1998 dhe VKM nr. 25, datë 20.01.2001 janë hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve

3, 5, dhe 74, të Ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993 "*Për kontabilitetin*", Ligj i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 9228, të datës 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006. *Pra bazë mbi të cilën rregullohet kontabilitetit publik është e shfuqizuar, konstatim ky i bërë vite me rradhe nga* KLSH.

Në lidhje me Standardet e Kontabilitetit Publik në Strategjinë MFP 2014-2020 thuhet se: Qëllimi i standardeve është të përmirësojnë cilësinë e raportimit të përgjithshëm financiar nga institucionet e sektorit publik, duke çuar në vlerësime më të informuara të vendimeve të Qeverive për alokimin e burimeve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Megjithëse plani kohor i strategjisë aktuale është deri në vitin 2020, *KLSH konstaton që progresi i bërë në lidhje me hartimin e bazës ligjore dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit nuk është i mjaftueshëm dhe objektivat në këtë fushë janë shumë vështirë të realizohet, duke patur në konsideratë dhe situatën aktuale të raportimit financiar publik. Ministria e Financave nuk ka dorëzuar në Kuvend pasqyrat financiare të konsoliduare për vitin 2017 dhe si rrjedhojë KLSH nuk jep një opinion në lidhje me to.* Në detaj në këtë raport janë përshkruar disa nga problematikat kryesore në lidhje me raportimin financiar publik. Me qëllim testimin e progresit të bërë si dhe në kushtet e riorganizimit të ministrive, KLSH ushtroj një auditim pilot, asistuar dhe nga ekspert të SAI-t Polak, mbi pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. KLSH ka konstatuar devijime materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që rezultuan në një opinion të kundërt duke qenë se nuk paraqesin situatën dhe përformancën financiare për vitin 2017. Defiçencat e theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, kanë sjellë detyrime të pakontabilizuara për vendime gjyqësore, fatura investimesh dhe fatura të shpenzimeve operative, çka duke marrë parasysh nivelin e materialitetit dhe shkallën e gjerë të përhapjes së tyre, i bëjnë pasqyrat financiare të pasakta.

KLSH ka ushtruar auditime financiare për të përcaktuar nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjeketit që auditohet, si dhe përdormi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar. Në këto auditime është dhënë opinion në lidhje me informacionin financiar të paraqitur, në bazë të ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200, dhe bazuar në evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të administruara nga auditimi. Për vitin 2017, janë realizuar 14 auditime të pasqyrave financiare. Në përfundim të këtyre auditimeve janë dhënë 9 opinione të pakualifikuara të paraqitura në tabelën në vijim. Janë dhënë 4 opinione të kualifikuar[8], në Bashkinë Fier, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Selenicë, 1 opinion i kundërt në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe 2 refuzime për opinion në shoqërinë F.A.F dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

8 Një opinion i kualifikuar nënkupton se informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare përmban anomali materiale të cilat nuk janë të përhapura në të gjitha pasqyrat, por efekti I të cilave ndikon vendimmarrjen e përdoruesve të caktuar.

[shqiptarja.com]

SUBJEKTET OBJEKT AUDITIMI	OPINIONI I AUDITUESIT			
	Opinione të pakualifikuar	Opinione të kualifikuar	Opinione të kundërt	Refuzim për Opinion
	Ministria e Drejtësisë	Bashkia Durrës	MFE	F.A.F
	Prokuroria e Përgjithshme	Bashkia Fier		ISSH
	MMSR	Bashkia Vlorë		
	Prefektura e Qarkut Lezhë	Bashkia Selenicë		
	Ministria e Zhvillimit Urban			
	Ministria e Integrimit Evropian			
	Aparati i Kuvendit			
	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik			
	Qendra Spitalore "Dr.Xhafer Kongoli"			

6. RAPORTIMI I BORXHIT PUBLIK

6.1 Kufijtë e borxhit publik për vitin 2017

Referuar planit të kufijve të huammarrjes dhe ndryshimeve me Aktin Normativ nr. 3 konstatohet se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit vjetor të buxhetit. Masa e tejkalimit të kufijve të huamarrjes shtetërore sipas pikës a) të nenit 58 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është shkaktuar nga tejkalimi i *huasë së marrë për financimin e projekteve, që përbën disbursimin bruto për projektet me financim të huaj në shumën 9,630 milionë lekë*. Të gjithë zërat e tjerë mbi të cilët janë vendosur kufijtë për rritjen vjetore nëpërmjet financimit të deficitit, financimi i brendshëm, ripagesat për projekte me financim të huaj dhe mbështetja buxhetore, rezultojnë se janë respektuar duke u paraqitur me nën realizim dhe që kanë ndikuar edhe në uljen e efektit total të tejkalimit të kufijve të huamarrjes totale vjetore në shumën 6,173 milionë lekë. *Huamarrja afatgjatë e marrë për projekte paraqitet në tejkalin të kufijve të vendosur për rritjen vjetore, sipas së cilës janë planifikuar 17,570 milionë lekë, ndërkohë që realizimi në treguesit fiskal paraqitet në shumën 23,407 milionë lekë, por sipas raportimeve të borxhit është ne vlerën 27,200 milionë lekë. Mos raportimi i plotë, ka nënvlerësuar zërat e shpenimeve në treguesit fiskal dhe deficitin e raportuar (trajtuar në seksionin mbi raportimin e treguesve fiskal.*

KLSH konstaton se ndryshimet e shpeshta të strukturës dhe reduktimi i organikës së Drejtorisë së Menaxhimit të Borxhit nuk kontribuon në mirëmenaxhimin e borxhit publik. Përfshirja nën Drejtorinë e Buxhetit dhe bashkimi me këtë drejtori nuk ka kontribuar në mirëorganizimin e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave sipas nevojës për reduktimin e risqeve që shoqëron këto aktivitete.

Megjithë programimin në përputhje me dispozitat ligjore përsa i përket ankandeve dhe financimit të brendshëm, problematika janë konstatuar në programimin e huamarrjes së jashtme, e lidhur kjo edhe me gjendjen e likuiditetit. Konstatohet se nevojat për financime nuk planifikohen sic duhen, duke marrë në konsideratë dhe disbursimin për borxhin e jashtëm, duke shkaktuar tepricë likuiditeti në llogarinë e qeverisë. Këto teprica likuiditeti në valutë e ekspozojnë stokun e mjeteve monetare kundrejt riskut të kursit të këmbimit, ku vetëm për vitin 2017, në treguesit fiskalë të konsoliduar është raportuar një humbje nga rivlerësimi i tepricave të likuditeteve në valutë si pasojë e uljes së kurseve të këmbimit në fund të vitit në shumën 2,848 milionë lekë. Kjo humbje nga lëvizja e kursit në rënie përgjatë vitit është mundësuar

nga mbajtja e likuiditeteve të larta, ku gjendja e mjeteve monetare në të katër monedhat paraqitet mbi 12,000 milionë lekë në fund të vitit 2017 dhe përgjatë vitit arrin edhe në vlera prej 45 miliardë lekë. Për më tepër, në kushtet e tepricave të larta të likuiditetit konstatohet se nuk merren masa për investimin e tyre në instrumenta afatshkurtër për të reduktuar koston që rezulton nga interesat për sigurimin e likuiditetit. Emetimi në vitin 2018 i Eurobondit me vlerë 500 milionë Euro, do të ketë ndikime në nivelin e likuiditetit, tregun e brendshëm, si dhe të shoqërohet me kosto si rrjedhojë e përdorimit të kontratave SËAP.

6.2 Treguesit kryesore të borxhit publik

Stoku i borxhit publik të raportuar për vitin 2017 paraqitet i nënvlerësuar bazuar në respektimin e kërkesave ligjore për raportimin e tij dhe në respektim të standarteve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe ato të lidhura me raportimn e borxhit publik. Nga auditimi konstatohet se deri në fund të vitit 2017, sipas vetëdeklarimeve të enteve buxhetore, të raportuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë akumuluar detyrime të prapambetura në shumën 16 miliardë lekë dhe sipas auditimit të KLSH vlera e detyrimeve të prapambetura ka rezultuar në shumën jo më pak se 19 miliardë lekë. *Vlera e detyrimeve të prapambetura, si shpenzim i konstatuar, nuk është raportuar në tabelën e treguesve fiskalë, cka do të sillte një deficit mbi 2% të PBB, por është raportuar si shpenzim i periudhave të ardhshme. Nëse merren në konsideratë këto detyrime, stoku i borxhit publik të raportuar, nga 1,088 miliardë lekë, do të ishte në rreth 1,104 miliardë lekë, i cili në raport me PBB do të jepte një tregues të borxhit në nivelin mbi 71%. Nëse marrim në konsideratë edhe shlyerjen e stokut të rimbursimit të TVSH në vlerë 11 miliardë lekë (trajtuar në seksion më vetë), borxhi publik do të jepte një tregues në nivelin 72% të PBB.* Në strategjinë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", është vendosur objektivi i arritjes së borxhit publik në nivelin 65.5% të PBB në fund të vitit 2017. Konstatohet se që nga hartimi i strategjisë niveli i borxhit publik është luhatur rreth niveleve 70-74% e PBB.



Burimi: KLSH

Monitorimi i treguesit të borxhit është tepër i rëndësishëm që të kryhet duke marrë në konsideratë edhe implementimet buxhetore që lidhen me koncensionet. Në këtë mënyrë, cdo kontratë e lidhur për koncensionet është një kontratë me flukse detyruese disavjecare, për të cilën nevojitet financimi i realizimit të projektit. Referuar të dhënave aktuale në lidhje me 11 kontratat koncensionare rezulton se shpenzimet faktike nga buxheti i shtetit rezultojnë nëshumën 6,493 milionë lekë. Ndërkohë që projeksionet në lidhje me mbështetjen e nëvojshme buxhetore, duke marrë parasysh edhe projektet për të cilat është dhënë miratimi nga ana e MFE për mbështetjen buxhetore të nevojshme të cilat pritet të hyjnë në fuqi vitin e ardhshëm, parashikohet që të rezultojnë me flukse dalëse në shumën 18,115 milionë lekë në vitin 2021. *Për*

[Shqiptaria.com]

këtë arsye, në planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit është e rëndësishme që të merren në konsideratë këto kosto financiare që mbartin këto projekte, megjithëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk raporton në përputhje me standartet ndërkombëtare të raportimit, që kërkojnë që këto kontrata të raportohen në stokun e borxhit publik.

6.3 Performanca e marrëveshjeve të nënhuasë dhe garancive

KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 5,391 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2017, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse. Stoku i deyrimeve që përfituesit kanë ndaj shtetit në fillim të vitit paraqitet në shumën 11,352 milionë lekë, ndërkohë që në fund të vitit paraqitet në shumën 16,924 milionë lekë, me një rritje prej 50% brenda vitit 2017. Nga totali i pagesave të kryera për principalin dhe interesat e mësipërme, vetëm për marrëveshjet e nënhuasë dhe arkëtimi në vitet 2010-2017 respektivisht prej tyre dhe teprica e detyrimeve të akumuluara paraqitet:

Pagesa nga Buxheti i Shtetit dhe arkëtime 2010-2017



	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Pagesa nga Buxheti per nenhuate	2,120,	2,287,	2,436,	2,757,	3,432,	4,412,	6,437,	6,418
Arketuar nga nenhuate	2,285,	2,116,	1,234,	1,114,	1,170,	1,424,	1,844,	2,054

Stoku i detyrimeve në sipas fund viteve 2010-2017



	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Detyrimi fund viti	373,	1,05	4,62	6,83	5,66	7,47	11,5	16,9

Burimi: KLSH

Nga auditimi kostatohet se për vitin 2017, masat e marra për arkëtimin e detyrimeve ekzistuese kanë qenë të pamjaftueshme për aq kohë sa janë krijuar detyrime të reja në shumën 5,391 milionë lekë.

Për vitin 2017 garancitë e huaja janë ulur në terma bruto me 3.583 milionë lekë. Ulja e këtyre garancive nuk është realizuar si pasojë e pagesave tëkryera nga huamarrësi, por nga buxheti i shtetit, në rolin e garantuesit të këtyre marrëveshjeve të huasë, në kushtet e dështimit për të paguar nga ana e detyruesit kryesor. Pagesat e kryera nga buxheti i shtetit ndër vite për garancitë dhe arkëtimet për këto pagesa të kryera nga detyruesi kryesor paraqiten:

Pagesa dhe arkëtime nga garancitë



Stoku i detyrimeve për garancitë



Fshatarja.com

Burimi: KLSH

Përgjatë të gjithë periudhës në analizë konstatohet se situata në lidhje me garancitë paraqitet problematike duke filluar që nga viti 2011, dhe me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për mbështetjen e sektorit energjitik, aftësia paguese mbetet e ulët. Stoku i detyrimeve ne 31.12.2017 rezulton se është në të njejtën situatë si 2 vitë më parë, kur u realizua kjo shuarje e detyrimeve me kompensim, si pasojë e akumulimit të detyrimeve të reja me reth 4 miliardë lekë në 2 vjet.

Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2017 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjitik. Për vitin 2017 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 5,722 milionë lekë në 8,552 milionë lekë, me një rritje vjetore prej 2,831 milionë lekë ose 49.5%.

Konstatohet se masat e marra janë të pa mjaftueshme për zgjidhjen e situatës së krijuar ku risku i kreditit të këtyre institucioneve është mjaft i lartë. Megjithë konstatimet e mësipërme, problematika zgjerohet duke marrë parasysh edhe lëshimin e garancisë së re përgjatë vitit 2017 për OST që paraqitet në situatë financiare të rënduar për aq kohë sa ka detyrime të akumuluara ndaj shtetit dhe është përballë paaftësisë paguese për detyrimet e krijuara rishtazi përgjatë vitit 2017. Po i njëjti konstatim vlen edhe më riskoz për financat publike për garancinë e dhënë ndaj KESH për kontratën e huasë datë 30.06.2016 në shumën 218 milionë Euro, e cila është bërë efektive në vitin 2018. Gjëndja e detyrimeve që subjektet përfituese (vecanërisht sektori i energjisë dhe ujësjellsave) kanë ndaj shtetit në lidhje me nënhuatë dhe garancitë do të vijoj të ritet nëse nuk shoqërohet me reformat e përshtatshme financiare për në këto sektor.

6.4 Bonot e privatizimit

Konstatohet se Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk disponon informacion në lidhje me gjendjen e emëtuar të bonove të privatizimit, gjendjen e emëtuar por të pashpërndarë, sasinë e bonove të përdorura dhe asgjësuara ndër vite dhe sasinë aktuale të bonove të privatizimit në qarkullim.

Nga ana e Bankës së Shqipërisë raportohet të jenë shpërndarë për tu emëtuar 72.7 miliardë lekë, ndërkohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton së janë emetuar 74.9 miliardë lekë bono privatizimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë sipas raportimit të bërë në Mars 2015 deklaron se në procesin e privatizimit janë përdorur 10 miliardë lekë, ndërkohë që sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë rezulton se deri në Maj 2015 janë asgjësuar rreth 22 miliardë lekë bono privatizimi. Nga ana tjetër, sipas raportimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në vitin 2015 rezulton se janë emëtuar por nuk janë shpërndarë rreth 23.7 miliardë lekë (74.9 miliardë lekë të emëtuara – 51.2 miliardë të shpërndara publikut), ndërkohë që sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë rezulton gjendje të emëtuara por të pashërndara gjendje në arkën stok rreth 10.6 miliardë lekë. Në këtë mënyrë, diferencat e mësipërme janë tepër domethënëse për dobësitë që e kanë përcjellë procesin e emëtimit, shpërndarjes, përdorimit dhe asgjësimit të bonove të privatizimit. Efekti i këtyre ndryshimeve në të dhënat e publikuara mbetet edhe më problematik duke marrë në konsideratë faktin që Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton që janë të shpërndara dhe të papërdorura në Mars 2015 rreth 41 miliardë lekë,

[shqiptarja.com]

ndërkohë që Banka e Shqipërisë vlerëson se janë aktualisht të shpërndara dhe të pakthyera në vitin 2017 rreth 45 miliardë lekë bono privatizimi. Efekti i shumës prej 4 miliardë lekë në mosrakordim mund të jenë më së paku bono privatizimi të cilat janë përdorur po nuk janë sjellë për asgjësim në Bankën e Shqipërisë, të cilat në çdo kohë mund të rifuten në treg.

Nga auditimi rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e VKM duke qenë se janë pranuar për asgjësim bono privatizimi nga subjekte të cilat nuk janë të autorizuara për pranimin e tyre. Në Bankën e Shqipërisë rezulton se janë dorëzuar bono privatizimi nga ana e Bankës Credins në shumën 1.24 miliardë lekë për vitin 2017. Lejimi i përdorimit të bonove të privatizimit në Bankën Credins dhe pranimi i bonove të privatizimit për asgjësim nga Banka Credins është në kundërshtim me VKM nr. 283 datë 30.04.1996 "Për dorëzimin dhe asgjësimin nga Banka e Shqipërisë të bonove të privatizimit mbas përdorimit". Mos dorëzimi i bonove të përdorura përgjatë vitit dhe të grumbulluara nga Raiffesen Bank, mbështet konstatimin mbi monitorimin e dobët të këtij procesi dhe efektet e mundshme të rifutjes në qarkullim që ka mosdorëzimi në kohë i bonove të privatizimit për asgjësim. Në këtë mënyrë, duke qenë se nuk ka një procedurë rakordimi, nuk krijohet siguri që të gjitha bonot e përdorura përgjatë vitit, të pranuara në bankat e nivelit të dytë, të jenë dorëzuar për asgjësim në Bankën e Shqipërisë.

7. ADMINISTRIMI I SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR

Sektori i energjisë në paaftësi paguese: Viti 2017, paraqet një performancë jo të mirë të kompanive me kapital shtetëror të cilat veprojnë në sektorin energjitik. Risku i kreditit të këtyre kompanive ka vendosur në vështirësi buxhetin e shtetit duke kryer pagesa të vazhdueshme në lidhje me garancitë jo performuese si dhe në formën e mbështetjeve buxhetore. Referuar pozicionit financiar dhe obligimeve që këto kompani kanë ndaj shtetit, krahasuar dhe me një vit më parë, situata paraqitet:

mijë lekë

LLOJI I TË DREJTËS	KESH	OST	OSHEE	TOTALI
Nenhua	3,677,334	1,552,651		5,229,985
Garanci	2,887,762	1,390,652		4,278,414
Mb. Buxhetore	2,500,000			2,500,000
Borxh Tatimor	8,363,592		10,442,684	18,806,276
TOTALI 31.12.2016	17,428,688	2,943,304	10,442,684	30,814,675
Nenhua	6,760,919	2,635,352		9,396,271
Garanci	4,408,912	2,530,443		6,939,355
Mb. Buxhetore	1,500,000		2,500,000	4,000,000
Borxh Tatimor	2,928,405		6,081,070	9,009,475
TOTALI 31.12.2017	15,598,236	5,165,795	8,581,070	29,345,101

Rritja vjetore e mbështetjes buxhetore ndaj OSHEE është realizuar me dy kredi në formën e mbështetjes buxhetore në shumën 2.5 miliardë lekë. Rritja e detyrimeve prej nënhuave nga ky sektor paraqitet në rreth 4 miliardë lekë, ndërkohë që rritja e detyrimeve nga garancitë vlerësohet 2.6 miliardë lekë. Gjatë vitit 2017 sektori ka përfituar nga amnistia e faljes së detyrimeve tatimore një vlerë prej rreth 9.6 miliardë lek, cka ka ndikuar në ruajten e treguesit total stabël, ndërkohë e zhveshur nga kjo falje detyrimet janë rritur me rreth 9.2 miliardë lekë. Në fund të vitit 2017 detyrimet në total nga ky sektor vlerësohen në rreth 29.3 miliardë lekë.

shqiptaria.com

Sektori i ujësjellësve: Kompanitë me kapital shtetëror përgjegjëse për administrimin e veprimtarisë së ujësjellës kanalizimeve vlerësohet që në një pjesë të tyre të kenë performancë të dobët për sai përket marrëdhënieve të nënhuasë dhe në të njejtën kohë dhe garancive për projekte specifike. Të analizuara sipas nënhuasë dhe institucioneve zbatuese të marrëveshjeve të nënhuasë, detyrimet paraqiten për shtesën vjetore të vitit 2017:

mijë lekë

Institucioni	Detyrimi 01.01. 2017	Detyrimi 31.12.2017	Rritja vjetore
Ujesjelles	4,908,346	5,656,160	747,814
Ujesjellesi Vlore	*1,527,996*	*1,743,436*	*215,439*
Ujesjellesi Korce	*780,427*	*1,002,125*	*221,697*
Ujesjellesi Durres	*1,040,332*	*1,147,492*	*107,159*
Te tjera ujesjelles	*1,559,590*	*1,763,109*	*203,518*

Të drejtat e shtetit për të arkëtuar nga këto kompani në krahasim me një vit më parë paraqiten:

mijë lekë

Viti	Nenhua	Garanci	TOTALI
2016	4,908,346	1,170,380	6,078,727
2017	5,656,160	1,309,408	6,965,569

8. ADMINISTRIMI I SKEMËS SË RIMBURSIMIT TË TVSH

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në kundërshtim me pikën 4 të nenit 125 të Rregullores nr.19 datë 22.02.2017 "Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore" nuk disponon një regjistër të standardizuar të miratuar me të dhëna të plota mbi kërkesat e regjistruara për rimbursim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga auditimi konstatohet se të dhënat e dërguara nuk rakordojnë me të dhënat e regjistrit elektronik të gjeneruar prej sistemit C@ts.

Mbi ritjen stokut të rimbursimit të TVSH, si rezultat i performancës së nën plan të të ardhurave dhe mos shkurtimin e shpenzimeve buxhetore. Stoku i kërkesave për rimbursim TVSH në fund të vitit 2016, të miratuar dhe të pa likujduar rezulton në vlerën 4,233 milionë lekë. Për vitin 2017, rezulton se është kërkuar dhe çertifikuar për rimbursim vlera 22,490 milionë lekë e cila përbëhet nga vlera e transferuar për detyrime të tjera 1,528 milionë lekë dhe për likujdim nga kërkesat vetëm të vitit 2017 ka rezultuar vlera 20,963 milionë lekë. *Gjatë vitit 2017, janë likujduar gjithsej 13,774 milionë lekë. Nga analiza e të dhënave konstatohet se kanë mbetur pa likujduar deri më datë 31.12.2017, kërkesa të miratuara në vlerën 11,422 milionë lekë (stoku), i cili përbën detyrime të prapambetura të shtetit. Megjithëse kjo shumë ka plotësuar kushtet ligjore për rimbursim dhe është çertifikuar nga administrata tatimore ajo nuk rezulton e evidentuar në regjistrat e detyrimeve të DPT-së si angazhim i marrë. Kjo vlerë përfaqson të drejta të subjekteve përfitues dhe detyrime të DPT ndaj tyre, por nuk pasqyrohet si detyrim i lindur dhe i kontabilizuar "de facto" prej DPT më datë 31.12.2017 por qëndron pezull në mënyrë të pajustifikuar në këtë datë duke denatyruar situatën financiare të njësisë publike por dhe të tatimpaguesit njëkohësisht.* Ndikim në krijimin dhe ritjen e këtij stoku detyrimesh të prapambetura ka dhe performanca nën plan e realizimit të të ardhurave tatimore.

[Shqiptaria.com]

Mbi thyerjen e afateve dhe rradhës së pagesave në procesin e rimbursimit të TVSH. Nga auditimi konstatohet se, sipas të dhënave elektronike të DPT të gjeneruara prej sistemit informatik C@ts të përpunuara nga ana jonë konstatohet në *586 raste nga 901 kërkesa të trajtuara, janë tejkaluar afatet e rimbursimit, për një vlerë rimbursimi prej 11,171 milionë lekë.* Kjo vlerë përfaqëson 65% të kërkesave ose rreth 50% të vlerës totale të rimbursimit për vitin 2017. Ditët nga kërkesa në rimbursim shkojnë deri 405 ditë.

Nëse do ti referohemi likujdimeve të kryera gjatë vitit 2017 *rezulton se pothuajse në të gjitha rastet e pagesave prej 13,774 milionë lekë, kemi thyerje të radhës së rimbursimit* nisur jo vetëm prej afateve të parashikuara ligjore por edhe datës së miratimit të rimbursimit pas plotësimit të kushteve proceduriale të administratës tatimore. *Mosrespektimi i afateve dhe rradhës ka ndikime të rëndësishme në marëdhëniet administratë-tatimpagues, krijon selektivitet, ekspozon njësinë drejt risqeve morale dhe financiare por gjithashtu pasqyron një model aspak pozitiv në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji, ku vet administrata tatimore e cila efektivisht duhet të jet "gardian" i tij e thyen në mënyrë të vetëdijshme atë.*

Mbi rimbursimin e TVSH për kontratat koncesionare. Në këndveshtimin e KLSH, risk të lartë paraqet edhe procesi i trajtimit nga ana e administratës tatimore të rasteve të rimbursimit të TVSH-së për kontratat konçesionare në fushën e energjisë (HEC), ku nga ana kësaj administrate çertifikohet dhe paguhet TVSH-ja për vlera punimesh të cilat tejkalojnë vlerat e kontraktuara me Shtetin Shqiptar të cilat janë të pamiratuara prej organeve kompetente sipas detyrimeve kontraktuale por dhe legjislacionit të fushës përkatëse. Megjithëse vlerat e punimeve për veprat e ndërtimit nuk janë përfunduar dhe testuar ende, për to vijon rimbursimi i TVSH-së pavarësisht riskut teknik për funksionimin e tyre dhe garantimin e të ardhurave të tatueshme në vijim të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit. Më poshtë paraqiten të dhënat analitike lidhur me pjesën dhe vlerën që këto kërkesa zënë në totalin e rimbursimit vjetor.

Emërtimi	Tatimpagues HEC	Gjithsej 2017	Pjesa e HEC në %
Numri i kërkesave	15	901	1.7%
Vlera e miratuar në milionë lekë	4,993	22,491	22.2%

Nga auditimi i ushtruar në DPT, ka rezultuar se për një nga tatimpaguesit që zë rreth 81.5% të vlerës totale të kërkuar prej tatimpaguesve HEC-e ose 18.1% të rimbursimit të miratuar në rang kombëtar, *njohja nga ana DPT të TVSH-së për investimin total, i cili megjithëse nuk ka përfunduar ende ka tejkaluar koston e parashikuar të vlerës së investimit duke arritur 2-fishin e saj, kosto e cila rezulton e pa u mbuluar me një shtesë marrëveshje me Shtetin Shqiptar, (e realizuar pas faktit dhe jashtë periudhës së kontrollit), në gjykimin tonë përbën një preçedent të rrezikshëm, si në rastin konkret por dhe për raste të ngjashme vijim, ku vlera investimesh konçesionare certifikohen përpara se Shteti Shqiptar nëpërmjet përfaqësuesve të tij të miratojë paraprakisht këto vlera investimi me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për këtë, vlera e TVSH-së e cila paraqitet në kushte të mungesës së ligjshmërisë shkon në 50 % të vlerës totale të TVSH-së së kredituar nga ana e këtij tatimpaguesi, vlerë e llogaritur minimalisht në shumën 2,054 milionë lekë.* Më hollësisht kjo problematikë është trajtuar në vijim të këtij raporti.

Ishtipetria.com

9. RAPORTIMI I TË DREJTAVE TË LIGJSHME TË SHTETIT

Rritja e borxhit tatimor me rreth 10.5 miliardë lekë dhe atij doganor me rreth 1 miliardë lekë, gjatë vitit kur është zbatuar amnistia fiskale, tregon që këto amnisti, të cilat duhet të ndodhin shumë rrallë, duhet të jenë të mirëmenduara dhe patjetë të shoqërohen me marrjen e masave konkrete në drejtim të mbledhjes së borxhit nga organet tatimore dhe miradministrimin e skemës së tatimeve, për të qenë efikase. Mënyra e administrimit të këtij procesi në mbledhjen e detyrimeve tatimore dhe doganore ka mangësi në ndjekjen e veprimeve proçeduriale nga ana e administratës duke mos ezauruar në kohë dhe me efikasitet të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në ligjislacionin tatimor dhe doganor për të siguruar mbledhjen e borxhit. Procesi i faljes së borxhit tatimor dhe doganor ka rezultuar me probleme administrative, si rezultat i të cilave, nga regjistrat e borxhit në fund të vitit 2017 rezultojnë të papërfshira rreth 12.3 miliardë lekë detyrime.

9.1 Borxhi tatimor

Vlera e borxhit tatimor të raportuar nga DPT në fund të vitit 2017 kap vlerën 95.5 miliardë lekë. Konstatohet se borxhi i raportuar ka një rënie me 51.6 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë, ndikuar nga efektet të Ligjit të faljes nr. 33/2017 në vlerën prej 49.8 miliardë lekë, fshirjes së borxhit tatimor të akcizës me justifikimin e borxhit "të transferuar" drejt DPD në vlerën 12.3 miliardë lekë, dhe rritjes së borxhit tatimor gjatë vitit me rreth 10.5 milardë lekë. Pra konstatohet se situata e borxhit si rezultat i administrimit dhe mbikqyrjes të nga organet tatimore, zhveshur nga efektet e amnistisë fiskale, paraqitet me rritje në masën 7% në raport me fillimin e vitit. *Në total rritja e borxhit gjatë vitit 2017 përbën më shumë se 10% e stokut të tij në fund të periudhës raportuese.* Nga të dhenat e paraqitura nga DPT, numri i subjekteve debitorë në fund të vitit 2017 është 13.633. Subjektet aktive janë në numër 61.773 ose 45% e numrit total te subjekteve debitore dhe detyrimet e tyre janë në vlerë 44,927 milionë lekë ose 47% e totalit të borxhit. Subjektet pasive janë në numër 75,860 ose 55% e numrit total te subjekteve debitore dhe detyrimet e tyre janë në vlerë 50,578 milionë lekë ose 53% e totalit të borxhit. Nga analiza e të dhënave, rezulton se 10 subjektet e para (0.01%) kanë 27.3% të shumës total të borxhit tatimor. Ndërsa 50 subjektet e para (0,036%) kanë rreth 52.7% të vlerës totale të borxhit tatimor. Vlera më e madhe e borxhit tatimor rezulton në DRT Tiranë dhe Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj të cilët zënë rreth 74% të borxhit në total. Nga Ligji i faljes nr. 33/2017 kanë përfituar rreth 194.654 tatimpagues në shumën 49,826 milionë lekë për lloje të ndryshme detyrimesh tatimore apo penalitetesh, prej të cilave shuma e falur vetëm për 50 tatimpaguesit përfitues më të mëdhenj nga rezulton në 21,961 milionë lekë ose rreth 44% e shumës totale të falur.

9.2 Borxhi doganor

Vlera e borxhit doganor të raportuar nga DPD në fund të vitit 2017 kap vlerën 23.95 miliardë lekë. *Konstatohet se borxhi i raportuar ka një rënie me 841 milionë lekë në krahasim me një vit më parë, ndikuar nga efektet të Ligjit të faljes nr. 33/2017 në vlerën prej 1.83 miliardë lek, dhe rritjes së borxhit doganor gjatë vitit me rreth 1 milardë lekë. Pra konstatohet se situata e borxhit si rezultat i administrimit dhe mbikqyrjes të nga organet doganore, zhveshur nga efektet e amnistisë fiskale, paraqitet me rritje në masën 4% në raport me fillimin e vitit. Në total rritja e borxhit gjatë vitit 2017 përbën më shumë se 4.1%*

[Shqiptaria.com]

e stokut të tij në fund të periudhës raportuese. Nga të dhenat e paraqitura nga DPD, numri i subjekteve debitorë në fund të vitit 2017 është 2,187. Struktura e borxhit doganor në fund të periudhës ushtrimore 2017, përbëhet nga borxhi doganor 6,163 milionë lekë, penalitetet në vlerën 15,192 milionë lekë dhe kamatvonesa në vlerën 2,592 milionë lekë. Borxhin kryesor e kanë subjektet ndaj Degës së Doganës Tiranë me 19.5% të vlerës së borxhit total ose 4,670 milionë lekë, Dega e Doganës Durrës me 14% të vlerës së borxhit total, apo 3,331 milionë lekë dhe Dega Doganore Fier me 47% të vlerës së borxhit me 11,149 milionë lekë. Nga analiza e të dhënave, rezulton se 74% të totalit të borxhit doganor në fund të vitit 2017 e zënë detyrimet e këtyre 20 debitorëve të mëdhenj. Nga Ligji i faljes nr. 33/2017 borxhi doganor është pakësuar në shumën 1.83 miliardë lekë, ku 50.5% e kësa vlerë është përfituar nga 20 subjekte.

9.3 Borxhi jashtë regjistrave të tatimeve dhe doganave

Konstatohet se gjatë realizimit të amnistisë fiskale, janë fshirë nga rregjistrat e borxhit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, detyrimet e akcizës për 49 tatim pagues me vlerë 12.3 miliardë lekë, prej të cilave vetëm ARMO në vlerë rreth 10.7 miliardë lekë, (këtu përfshihen detyrime, penalitete dhe kamatvonesa). Problematika e trajtuara më hollësisht në këtë raport, ndërmjet DPT, DPD dhe MFE, ka rezultuar në crregjistrimin e këtij boxhi nga regjistrat dhe sistemi i DPT pa u realizuar procesi i transferimit të tij tek DPD, dhe duke bërë që kjo vlerë borxhi të mbetet jashtë regjistrave të shtetit dhe rrezikuar kështu interesat e ligjshme të tij.

10. RIORGANIZIMI I MINISTRIVE

Procesi i rioganizimit ka sjellë ndryshime me krijimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Europës dhe Punës të Jashtme. Nga auditimet e zhvilluara nga KLSH[9] është konstatuar se procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare dhe të buxhetit është realizuar vetëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është formuar nga bashkimi i ish-Minsitrisë së Energjisë dhe Industrisë, ish-Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe nga Ministria e Turzmit dhe Mjedisit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e cila përthithi një pjesë të ish-MZHETTS dhe një pjesë të ish-MMSR nuk e ka kryer procesin e konsolidimit si në drejtim të pozicionit ashtu edhe në drejtim të përformancës financiare. Edhe pse nga aparati i ish-MZHETTS u hartua lista e aseteve, ajo nuk u konsolidua dhe nuk u raportua në pasqyrat financiare të aparatit të MFE për vitin 2017 me një efekt prej rreth 300 milionë lekë, pavarësisht Në të njejtin akt, është urdhëruar edhe konsolidimi i aseteve të ish-MMSR që i korespondojnë fushave të përgjegjësisë të përthithura sipas programeve specifike, i cili rezulton të mos jetë ekzekutuar si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga ana e përfaqësuesve të ish-MMSR (në MSHMS) me grupin e ngarkuar për zbatimin e urdhrit (sipas memos përkatëse drejtuar Minsitrit të Financave dhe Ekonomisë). Investime në proces të realizuara në vitin 2017 nga ish-aparatet e ministrive të mësipërme sipas programeve të përthithura, të papërfshira në pasqyrat financiare të aparatit të MFE, rezultuar nga lëvizja e cash-it në thesar është në shumën 710.5 milionë

9 Gjetjet e këtij auditimit, përvec ato të lidhura me MFE, janë raportuar në fazë Projketraporti

lekë. Shpenzime operative të papërfshira në pasqyrën e performancës rezultojnë në shumën 302.6 milionë lekë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila përthithi një pjesë të aktivitetit të ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale në të njejtën mënyrë si MFE nuk e ka kryer procesin e përthithjes për programet respektive të marra nga ish-MMSR dhe asetet koresponduese. Punonjësit e ish-MMSR rezulton të mos kenë kryer dorëzimin e detyrës në momentin e largimit nga puna, si rrjedhojë procesi i invetarizimit për aktivet e qëndrueshme dhe qarkulluese të ish MMSR-së, referuar urdhrit të Titullarit të këtij institucioni, mbeti jo i plotë duke u përqëndruar vetëm në gjendjen fizike të aseteve në disa zyra pa çmime dhe vlerë sipas gjendjes kontabile nga ish MMSR. Efekti i aktivitetit investues dhe operativ të pa pasqyruar vlerësohet në rreth 1.8 miliardë lekë për 11-mujorin e ekzekutuar nga Aparati i ish-MMSR. Efekti i aseteve të pakonsoliduara, sipas raportimit të vitit 2016 (pasi raportimi 11-mujor për ish-MMSR nuk është kryer) vlerësohet në rreth 1 miliardë lekë.

Ministria e Turizimit dhe Mjedisit e cila ka përthithur një pjesë të aktivitetit të ish-MZHETTS nuk ka pasur ndikim në aparatin e saj si pasojë e përthithjes së programeve buxhetore duke qenë se këto programe kanë financuar njësi varësie të ish-MZHETTs, të cilat me ndryshimin e fushave të përgjegjësisë kaluan në varësi të MTM.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rezulton të ketë kryer konsolidimin si pasojë e përthithje së aktiviteti nga aparatet të cilat u shkrinë si pasojë e ndryshimit të fushave të përgjegjësisë. KLSH ka konstatuar se bashkimi është kryer në bazë të raportimeve të secilës njësi individuale të aparatit të ish-MZHU, ish-MEI dhe ish-MTI për aktivitetin 11-mujor dhe pasqyrave financiare deri në Nëntor 2017. Me Aktin Normativ nr. 3, datë 06.11.2017, u transferuan nga Ministria e Mjedisit dy projekte koncesionare ("Ndërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë" dhe "Dhënies me koncension e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie"). Nga auditimi rezulton se në Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit vlera e këtyre aktive është pakësuar për 2,141 milionë lekë, referuar pagesave të bëra në lidhje me këto investime, ndërkohë që kjo shtesë aktivesh nuk është pasqyruar në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit rezulton në përthithje të një programi nga ish-MZHU i cili është shoqëruar me transferimin e funksioneve të monitorimit të tij. Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale, i transferuar, ekzekutohet nga ana e njësive të qeverisjes vendore dhe raportimi nëlidhje me asetet e krijuara nga ky program realizohet nga këto njësi. Në këtë mënyrë, ndryshimi i njësisë së monitorimit të programit nuk është shoqëruar me problematika në drejtim të pasqyrave financiare.

11. PROKURIMI PUBLIK

Për vitin 2017, Autoritetet Kontraktore për plotësimin e nevojave për shërbime, mallra e punë civile prokuruan me procedurat e prokurimit elektronik 109.6 miliardë lekë[10]. Nga krahasimi i vlerës së prokuruar me PBB rezulton se vetëm

[10] *Burimi APP*

[shqiptaria.com]

7% e PBB është prokuruar me procedurat e prokurimit elektronik[11], tregues ky i ulët krahasuar me të dhënat e vendeve të rajonit.

Gjatë vitit 2017, Autoritetet Kontraktore kanë vazhduar të përdorin në një shkallë të lartë procedurën me negocim pa shpallje paraprake e cila zë 31.8% të numrit total të procedurave të prokurimit, të zhvilluara gjatë vitit 2017 apo 8.3% të vlerës totale. Konstatohet se në 67% e rasteve të përdorimit të kësaj procedure janë për mbulimin e nevojave të fillim vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Përdorimi i kësaj metode për të "mbuluar nevojat" e fillimit të vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve mbart risqet: keqplanifikimet e nevojave dhe shmangien e konkurrencës, me pasojë efektivitet shume të ulët të prokurimit. Në procedurat e prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore kemi konstatuar nje efektivitet të ulët të procedurës së prokurimit ku vetëm 10 operatorë ekonomike kanë fituar 40% të fondit të prokuruar (993 milionë lekë) me efektivitet 0%. Nga analizimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit për vitin 2017 rezultojnë se sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e nevojshëm për identifikimin e rasteve kur vlera e kontratave është përtej fondit limit, konstatuam në kampionin e përzgjedhur për testim, 14 raste me fond të prokuruar 609.9 milionë lekë ndërkohë që fondi limit është 395.6 milionë lekë, pra me një diferencë në vlerën (214 milionë lekë)

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike me burim të brendshëm financimi në 115 subjekte të audituar për efekte të zbatimit të buxhetit të vitit 2017, shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit, zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve kanë sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 870 milionë lekë ndërsa procedurat jo në përputhje me bazën rregullative kapin vlerën e 3,522 milionë lekë.

12. PËRMBLEDHJE E SHKELJEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

12.1 Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm në buxhetin e shtetit dhe detyrimet debitore deri më 31.12.2017

I.	TË ARDHURA TË MUNGUARA PËR BUXHETIN E SHTETIT	000/lekë
1	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR	12,748
2	NGA SHKELJET E LEGJISLACIONIT NË MBLEDHJEN E SIGURIMEVE SHOQËRORE	
3	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E KODIT DOGANOR	2,136,644
4	NGA KEQADMINISTRIMI I PRONËS SHTETËRORE TË DHËNË ME QERA DHE KONCESIONE	2,499,022
5	NGA SHKLEJET NË ZBATIM TË LEGJISLACIONET PER TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE	39,984
6	NGA KEQADMINISTRIMI I PROJEKTEVE ME FINANCIM TË HUAJ	55,875
7	TË TJERA	76,418
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË MUNGUARA ME EFEKT NË BUXHETIN E SHTETIT, VITI 2017	**4,820,691**

II.	DËMI EKONOMIK PËR BUXHETIN E SHTETIT	000/lekë
1	NË SHPENZIMET PËR PAGA, SIGURIME DHE SHPËRBIME	11,289
2	NË SHPENZIMET OPERATIVE	62,301
3	NË FONDIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR	156,970
4	NË SHPENZIMET PËR INVESTIME	572,723

[11] *Bazuar në të dhënat e siguruaranga INSTAT mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB)*

ishqiptaria.com

5	NË ZBATIMIN E PROJEKTEVE ME FINANCIM TË HUAJ	252,871
6	TË TJERA	183,225
	TOTALI I DËMIT TË KONSTATUAR ME EFEKT NË BUXHETIN E SHTETIT, VITI 2017	**1,239,379**

TOTALI I DËMIT (I+II) = 6,060 milionë lekë

III.	**TË DHËNAT MBI SHTESËN E DETYRIMEVE DEBITORE**	000/lekë
1	VLERA E BORXHIT TATIMOR NË SEKTORIN E TATIMEVE (DPT)	10,500,000
2	VLERA E BORXHIT DOGANOR NË SEKTORIN E DOGANAVE (DPD)	1,000,000
	SHTESA E DETYRIMEVE PËR VITIN 2017	**11,000,000**

12.2 Të ardhura apo shpenzime të realizuara në kushtet e parregullsive në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, me efekte negative për buxhetin e shtetit e vitit 2017

I.	**EFEKTE NEGATIVE NË TË ARDHURAT E BUXHETIT**	000/lekë
1	NGA SHKELJET E REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE (MFE)	15,866,118
2	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR	30,409,381
3	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E AMINISTISË FISKALE	12,029,713
4	NGA KEQADMINISTRIMI I PRONËS SHTETËRORE TË DHËNË ME QERA DHE KONCESIONE	292,858
5	NGA SHKLEJET NË ZBATIM TË LEGJISLACIONET PER TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE	2,429,599
6	NGA KEQADMINISTRIMI I PROJEKTEVE ME FINANCIM TË HUAJ	27,937
7	TË TJERA	717,583
	TOTALI I EFEKTEVE NË ZBATIM TË BUXHETIT TË SHTETIT, VITI 2017	**61,773,189**

II.	**EFEKTE NEGATIVE PËR SHPENZIMET E BUXHETIT**	000/lekë
1	NGA SHKELJET E REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE (MFE)	62,697,242
2	NË SHPENZIMET PËR PAGA, SIGURIME DHE SHPËRBIME	256,302
3	NË SHPENZIMET OPERATIVE	3,226,255
4	NË FONDIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR	
6	NË SHPENZIMET PËR INVESTIME	2,651,446
7	NË ADMINISTRIMIN E BUXHETIT NË PUSHTETIN VENDOR	0
8	NË KONCESIONIMIN E PRONËS SHTETËRORE	0
	TË TJERA (shpenzime nga ngritja e platformës së panevojshme në MAS)	**123,350**
	TOTALI I EFEKTEVE NË ZBATIM TË BUXHETIT TË SHTETIT, VITI 2016	**68,954,595**

TOTALI I MOS EFEKTIVITETIT (I+II) = 130,727 milionë lekë

[shoinformacion.com]

PJESA 2

RAPORTIMI I FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Duke vlerësuar rolin e rëndësishëm e të vecantë të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollin Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si udhëzuese dhe koordinatore në ngritjen, modernizimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar të sektorit publik në rang kombëtar, sjellim në vëmëndjen tuaj disa nga cështjet e rëndësisë për të cilat në gjykimin dhe përgjegjësinë tonë si auditues shtetëror mbeten vetëm të konstatuara dhe në paveprim të strukturave drejtuese përgjegjëse për marrjen në shqyrtim të situatës dhe problematikave që këto konstatime ngrenë.

2.1 Në lidhje me strukturat e auditit e brendshëm dhe eficensen e tyre

1. Nga auditimi konstatohet se struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, DH/AB, nuk ka një analizë të plotë të sektorit publik për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe cilësinë e tij në rang kombëtar. *Konstatohen njësi të vetëqeverisjes vendore të cilat nuk kanë mbulim me auditim në një nga format e parashikuara në ligji rasti i Bashkive Poliçan, Has, Pukë, Konispol, Rrogozhinë dhe Delvinë apo kanë struktura të cilat nuk janë funksionale përmendim Bashkitë Cërrik, Belsh dhe Kurbin; 15 Institucione të Pavarura. Ndërsa për shoqëritë publike me kapital shtetëror nuk ka informacion të plotë.*

2. Për mbulimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me kapacitete audituese sipas përcaktimeve ligjore, konstatohet se, gjatë këtij viti 38 njësi ose 32% e totalit të NJAB-ve e zhvillojnë veprimtarinë e tyre me më pak se tre auditues në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*".Me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura niveli i audituesve të çertifikuar ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit ndërkohë që aktualisht në proces çertifikimi janë 36 auditues të punësuar dhe jashtë sistemin janë rreth 1600 auditues të çertifikuar (1911[12] auditues të çertifikuar nga të cilët vetëm 308 të punësuar në sektorin publik). *Konstatohen 24 njësi me 1/3 ose më shumë staf me punonjës të paçertifikuar, përmendim Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, etj. Gjithashtu, evidentohet se 10 njësi kanë drejtues të paçertifikuar.*

3. Në lidhje me Komitet e Auditimit të ngritura në zbatim të VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm në njësitë publike*", megjithëse në auditimin e vjetshëm, u kërkua që DH/AB të kishte një rol aktiv në ngritjen dhe mirëfunksionimin e Komiteteve të Auditimit si një instrument që do të siguronte pavarësinë e strukturave dhe aktivitetit të audituesve të brendshëm, konstatohet se nuk ka hapa apo masa konkrete në këtë drejtim. *Megjithëse*

[12] *Sipas rregjistrit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*

lsh.gov.al

kanë kaluar mbi tre vite nga miratimi i ligjit të ri të AB-së, janë krijuar vetëm 8 Komitete Auditimi, nga të cilat 5 prej tyre kanë raportuar në DH/AB.

4. Raporti mbi funksionimin e sistemit te kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për vitin *2017, raporton realizimin e planit të auditimeve në masën 100.1%, por me një analizë të hollësishme konstatohen 46 struktura janë me mosrealizim të planeve të auditimit ndërsa në 61 raste konstatuam raste të raportuara me tejkalim deri në 200% të planeve dhe 10 njësi nuk kanë raportuar asnjë aktivitet auditimi.*

5. DH/AB shprehet raport *se 40 njësi AB ose 30% e sistemit AB nuk garantojnë sigurojnë kontrollin e vlerësimin e cilësisë".* Nga auditimi KLSH ka konstatuar ky numër është edhe më i lartë po të marrim në konsideratë raste të tilla si: 15 njësi AB që raportojnë një realizim plani 100-200% por me tregues performance shumë të dobët si psh: *përqindja mesatare e zbatimit të rekomandimeve prej 36% dhe gjetje në vlerë prej 17 milionë lekë në total*.

6. Manuali i Auditimit të Brendshëm Publik përcakton se "*Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë NJAB, - të paktën një herë në 5 vjet; .....*" DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara gjatë vitit 2017 duhej të kishte vlerësuar jo më pak se 23 NJAB (119:5). Fakti që, gjatë këtij viti nga DH/AB, janë kryer vetëm 5 kontrolle të cilësisë ose rreth 22% e detyrimit të përcaktuar sipas manualit, tregon se kjo strukturë me kapacitetet që ka, e ka të pamundur të arrijë përmbushjen e objektivit prej 23 vlerësime të jashtme të cilësisë.

7. DH/AB raporton për vitin 2017 se strukturat e 119 njësivetë auditimit të brendshëm përmes 400 audituesve që ushtrojnë funksionet në to, kanë konstatuar një nivel dëmi ekonomik në shkallë sitemi prej 7,848 milionë lekë, vlerë që krahasuar me vitin 2016, është 3.7 herë më e lartë. *Megjithatë, analiza tregon se në këtë vlerë shuma prej 6,029 milionë lekë i përket vetëm një auditimi të kryer nga NJAB e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në auditimin e ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, fakt që tregon se në shkallë sistemi niveli i shkeljeve të konstatuara është realisht vetëm 1,819 milionë lekë dhe më i ulët se viti 2016 ose më i ulti në 5 vitet e fundit.*

2.2 Mbi indikatorët e performancës në zbatim të Urdhërit nr. 89 datë 28.12.2015.

Gjatë auditimit KLSH testoi dhe saktësinë e disa indikatorëve të performancës të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.89 dt. 28.12.2015 të cilet kanë si synim matjen e performancës mirë-funksionimin, efikasitetin dhe efiçencën e sektorit publik. Kështu u konstatua se: Indikatori 16 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 19 të Metodologjisë, nuk parashikon vlerësim për njësitë që i kanë audituesit në proçes certifikimi dhe lë vend për gjykim dhe ndërhyrje në vlerësimin përfundimtar. Nga vlerësimi i 28 njësive AB ose 24% e gjithë njësive të AB: Përqindja e devijimit në kampion me 65% vetëm për grupin e Bashkive, e cila e aplikuar në totalin e njësive të vlerësuara 61, do të ndryshonte vlerësimin e përgjithshëm të indikatorit nr. 16 nga 53% në 44%.

Indikatori 20: i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 23 çon në rezultate dhe vlerësim të gabuar (mbivlerësim) pasi indikatori llogaritet në mënyrë të gabuar pa marrë parasysh numrin minimal të audituesve të përcaktuar në ligj (2+1 auditues). Në këtë mënyrë indikatori nuk realizon objektivin e tij sipas

Metodologjisë pika 4.1: "vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitit të njësisë publike me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi".

Indikatori 19: Cilësia e raporteve të audituesve të brendshëm e përpiluar sipas Aneksit 22, në fakt plotësohet nga punonjësit e DH/AB pas leximit të 115 raporteve vjetore të dërguara nga NjAB-të.Pasi raportet shpërndahen midis 3 specialistëve, lexohen dhe në gjykimin e tyre bëhet vlerësimi në pike. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përpunim të dhënash dhe intervalet në përqindje janë të pakuptimta. Në gjykimin tonë, do të ishte më efektive dhe efiçiente zëvëndësimi i këtij indikatori më një tregues tjetër cilësie I punës së AB si psh treguesi i zbatimit të rekomandimeve (tregues i rekomanduar dhe nga SIGMA në pasaportën e indikatorëve).

DH/AB duhet të propozojë rishikimin e menjëhershëm të anekseve dhe shpjegimeve të dhëna në to me qellim përmirësimin e cilësisë së përpunimit të tyre, rritjen e saktësisë dhe relevancës së vlerësimit dhe të reflektojë rezultatet në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Problematikat e konstatuara në lidhje AB kërkojnë gjithashtu vëmendjen e menjëhershme të Bordit të Kontrollit të Bredshëm Financiar Publik për të bërë analizë dhe propozime konkrete për përmirësime ligjore në funksion të shndërrimit të sistemit AB në një vlerë e shtuar për sektorin publik dhe jo për t'ia lënë në dorë çdo gjë ndërgjegjësimit të titullarëve nëpërmjet trajnimeve.

Në lidhje me *indikatorët e menaxhimit të Buxhetit dhe operacioneve të Thesarit;* Drejtoria e Thesarit dhe Drejtoria e Buxhet janë përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e indikatorëve respektivë tek DH, për efekt konsolidimi në Raportin vjetor të KBFP. Nga informacioni i marrë, u konstatua se përveç përcjelljes së tabelave të indikatorëve në format Excel, nga specialistet e drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit tek specialistet e MFK, nuk përcillet ndonjë analizë mbi monitorimin, vlerësimin e indikatorëve Thesar, Buxhet dhe problematika të dala gjatë vitit me qëllim përpilimin e rekomandimeve që më pas do të diskutohen e miratohen në Parlament. Përjashtim bën vetëm indikatori 7: Raporti fakt/plan i shpenzimeve korente" i shoqëruar me një shpjegim për vlerësimin mesatar në rang ministrie linje. Për dy grup indikatorët e mësipërm, DH në rolin e saj si konsoliduese e të dhënave bën vetëm një përmbledhje mekanike të shifrave dhe një analizë të thjeshtë statistikore krahasimore me një vit më parë dhe në disa raste identifikon performuesin më të mirë apo më të dobët. Në gjykimin e grupit të auditimit, DH/MFK nuk kryen kontrollo analitike për të siguruar saktësinë e tyre pavarësisht se kush e ka përgjegjësinë e përpilimit të tyre.

2.3 Analiza e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit ka kryer monitorimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në disa institucione për të vlerësuar nga afër ecurinë e zbatimit të nenit 18 të ligjit të MFK ku thuhet se Nëpunësi Parë Autorizues duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në zbatim të kuadrit të sipërcituar, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionet dhe materialet lidhur me monitorimet e kryera nga DH/MF, ku rezultoi se:

– se në kundërshtim me nenin 18, pika 1 e Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuarrezultoi se në dokumentacionin e dërguar pranë

Ishqipteria.com

kësaj drejtorie *nuk ka evidenca nëse në pyetësorët dhe raportet e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga njësitë e nivelit të parë të qeverisjes së përgjithshme kanë raportuar në mënyrë të konsoliduar, pra duke përfshirë rezultatet edhe për njësitë e varësisë.* Specifikisht, u mor në shqyrtim pyetësori i vetëvlerësimit i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka qenë edhe subjekt monitorimi nga DH/MFK për besueshmërinë e pyetësorit, dhe rezultoi se pyetësori është plotësuar vetëm për "Aparatin e Ministrisë së Financës" dhe jo për njësitë e varësisë dhe për më tepër gjatë monitorimit nga DH/MFK nuk është verifikuar nëse ky pyetsor përfshinte institucionet e varësisë në përputhje me manualin.

– Për përzgjedhjen e institucioneve që do të monitorohen, nga auditimi nuk rezulton të jetë kryer dhe dokumentuar një analizë për përzgjedhjen e njësive që do të monitorohen. I vetmi dokumentacion që na u vu në dispozicion është memoja përcjellëse për planin e monitorimeve drejtuar Sekretares së Përgjithshme të MFE, ku vetëm janë listuar subjektet që do të monitorohen dhe datat përkatëse.

– Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e Menaxhimit Financiar nuk janë përgatitur materialet për konkludimet e monitorimit, përcaktuar në manual si: "Në përfundim të vizitës në terren punonjësi i DH/MFK kryen një vlerësim të përgjithshëm mbi besueshmërinë e procesit të vetë vlerësimit të njësisë publike, i cili përfshihet në raportin vjetor të KBFP. Nga auditimi u konstatua se vizitat në terren, nuk janë shoqëruar me dokumentacionet përkatëse, protokolle takimesh, apo letra pune sipas aneksit 9 "Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren", pika 3.

– Nga auditimi u konstatua se monitorimet e njësive publike janë kryer në një periudhë shumë të reduktuar kohore, referuar afateve për dërgimin e pyetësorëve pranë drejtorisë (në fund të muajit shkurt), si dhe afatit për përfshirjen e rezultateve në raportin vjetor të KBFP (fund të muajit maj) dhe si rezultat ky monitorim kryhet vetëm për efekt të raportit vjetor, dhe jo si një monitorim i vazhdueshëm i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie, cituar edhe në kuadrin ligjor të sipërpërmendur.

– Në lidhje me ndjekjen e rekomandimeve të rezultuara gjatë monitorimit dhe raportit vjetor të KBFP, manuali udhëzon se ky proces do të kryhet në monitorimin e ardhshëm të njësive, por nisur nga numri i monitorimeve të kryera gjatë një viti, si dhe metodologjia sipas së cilës kjo përzgjedhje kryhet, ndjekja e rekomandimeve i përket një periudhe shumë të largët (mesatarisht 115 njësi publike që dorëzojnë pyetësorë/mesatarisht 15 monitorime në vit = 7 vjet).

2.4 Nxjerrje e akteve në zbatim të buxhetit në kundërshtim me ligjinme efek legjitimimin e krijimit të detyrimeve të parapambetura.

Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nëpërmjet Drejtorisë së MFK, përgjigjet për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik.Gjatë vitit 2017, raportohet hartimi i Udhëzimit nr.23 datë 22.12.2017 "Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017", si një detyrim ligjor i përvitshëm, në të cilën përcaktohen afatet dhe procedurat e nevojshme për mbylljen e llogarive vjetore nga njësitë publike dhe konsolidimi i tyre nga ana e Ministrisë së Financave. Nga shqyrtimi i neneve të këtij udhëzimi konstatojmë se ky udhëzim, jo vetëm nuk përbën ndonjë përmirësim të legjislacionit në fushën e kontabilitetit por disa nene të tij janë në kundërshtim

me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve nënligjore të tij. Kështu:

- Konstatojmë se përcaktimi "të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të rregjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave" bie në kundërshtim me Ligjin nr.9936 dt. 26.06.2008, neni 61 ku përcaktohet metoda e njohjes së shpenzimit. Nëpërmjet këtij udhëzimi autorizohet mosrregjistrimi i faturave në raste kur nuk ka fonde disponibël, raste të cilat gjithashtu bien në kundërshtim me Nenin 40 "E drejta për të kryer shpenzime", Neni 50 "Angazhimet buxhetore", Neni 51 "Menaxhimi i shpenzimeve", Neni 52 "Kryerja e shpenzimeve" të Ligjit, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura, dhe duke cënuar vërtetësinë e pasqyrave financiare.
- Në pikën 19 dhe 20 të këtij Udhëzimi, autorizohet njohja dhe rregjistrimi i faturave të lidhura me shërbime apo punime të papërfunduara dhe të pamarra në dorëzim. Që të dy këto pika që aktualisht janë në kundërshtim njëra tjetrën për sa i përket kriterit të njohjes së shpenzimit, mbi të gjitha janë në shkelje të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 20 dhe pika 19.

2.5 Mungesa e akteve te nevojshme për riorganizimin e ministrive.

Megjithëse ka ndodhur një proces riorganizimi i Ministrive dhe disa institucioneve qëndrore (shoqëruar me përthithje programesh, aktivesh dhe detyrimesh), nga DH/MFK nuk është hartuar ndonjë udhëzim tjetër i posaçëm për të trajtuar çështjen e ndryshimeve strukturore para mbylljes së vitit fiskal. Kemi konstatuar vetëm një ndryshim krahasuar me Udhëzimin e një viti më parë në nenin 27 ku shtohet paragrafi "Për të gjitha Ministritë dhe institucionet për të cilat gjatë vitit 2017 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimet e programeve buxhetore në Aktin Normativ nr.3, datë 06.11.2017, rakordimi i planit për buxhetin e vitit 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të bëhet me ministritë dhe institucionet që i administrojnë këto fonde aktualisht". DH/MFK ka gjykuar të mjaftueshëm se me përcaktimin se kush rakordon planin buxhetor kjo do të mbulonte dhe rregullimin kontabël të përthithjes dhe konsolidimit të pasqyrave financiare 11-mujore të Ministrive dhe programeve që pushuan së ekzistuari pas Nëntorit 2017, megjithëse Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017 "Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017" rregullon rakordimin e planit buxhetor por jo kontabilitetin.

PJESA 3

AUDITIMET E PERFORMANCËS

Një qeverisje e mirë shprehet përmes një performance të mirë dhe vendet e zhvilluara perëndimore e kanë kthyer fokusin e tyre pikërisht tek auditet e performancës. Gjithnjë duke e mbajtur vëmendjen tek shtimi dhe rritja e cilësisë së auditimeve, auditimet e performancës janë shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni po përballet çdo ditë me një sfidë të fortë për ta përqëndruar punën tek auditimi i performancës, sepse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike, duke lidhur objektivat strategjike me fondet publike. Sfida më e madhe për këtë lloj

auditimi është që ai mos të zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në rradhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet.

Zhvillimi i auditimeve është në linjë dhe në përputhje të plotë me objektivat e planit strategjik 2018-2022 të KLSH. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 dhe gjysmës së parë të vitit 2018, u realizuan 16 auditime performance ne reformat qeveritare, projektet dhe shërbimet social-ekonomike, projektet infrastrukturore, projektet mjedisore dhe energjitike, si dhe projektet dhe shërbimet social-kulturore. Për gjysmën e dytë të vitit 2018, auditimet e performancës po përqendrohen mbi rritjen e kapaciteteve në administratën publike, shërbimet studentore dhe tarifimi i tyre, mirëmbajtja e rrugëve, etj.

Konkretisht, të ndara sipas fushave respektive janë:

1. Reformat qeveritare	2. Projektet mjedisore dhe energjetike
Menaxhimi i borxhit publik Strategjia antikorrupsion Varfëria në Shqipëri dhe roli i shtetit në zbutjen e saj Performanca e Arkivit të Shtetit Të ardhurat në pushtetin vendor	Cilësia e ajrit Menaxhimi i mbetjeve spitalore Zonat e mbrojtura bregdetare
3. Shërbimet social-kulturore	**4. Shërbimet socio-ekonomike**
Performanca e MAS në zhvillimin e sportit	Efektiviteti i granteve në AZHBR Cilësia e ndërtesave shkollore Kostimi i shërbimeve spitalore Unifikimi i pikave doganore me Kosovën Performanca e ISHTI
5. Projektet infrastrukturore	
Urgjenca mjekësore Receta dhe nënshkrimi elektronik	

Nga periudhën 2017-2018 spikasin auditime të tilla si:

Cilësia e ndërtesave shkollore, mesazhi kryesor i të cilit është: "Nxitje e reformave për vlerësimin e cilësisë së godinave shkollore parauniversitare, duke i cilësuar si "mësuesi i tretë" për ndikimin e tyre shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit aq delikat të mësimdhënies e mësimnxënies në sistemin e arsimit. Sot sfida për arsimim sa më cilësor gjithëpërfshirës e të barabartë qëndron në rritjen bashkëpunimit të gjithanshëm të institucioneve qendrore e vendore, sipërmarrjeve e bizneseve, partnerëve të tjerë zhvillimorë, publikut, etj., për të kërkuar e përshtatur edhe lidhjen e godinave shkollore me shkallën arsimore, për të ndërtuar një sistem të godinash shkollore të hapur me zhvillimet e teknologjinë bashkëkohore që të lehtësojë arsimimin, sot e në të ardhmen në përputhje me sistemin e BE."

Performanca e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve në zhvillimin e sportit, **m**esazhi kryesor i të cilit është: "Gjendja aktuale e sportit në Shqipëri vuan mungesën e vizionit dhe joefektivitetin e politikave për zhvillimin e tij nga ana e qeverive të ndryshme dhe Ministrisë përkatëse, fondet e pakta të akorduara çdo vit në favor të tij nga Buxheti i Shtetit, si dhe joefiçiensën në përdorimin e burimeve të ndryshme të fondeve për sportin. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit nuk kanë derdhur tërësisht për llogari të Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit, të

[Shqiptaria.com]

ardhurat nga kompanitë e basteve përgjatë viteve 2013-2016, duke i shkaktuar buxhetit të MASR një efekt financiar negativ, joekonomicitet dhe të ardhura të munguara prej 22,964,841 lekësh. Të ardhurat e munguara të vitit korrent, deri në muajin Korrik 2017, janë 7,976,440 lekë, shumë kjo e destinuar për zhvillimin e sportit."

Kostimi i shërbimit spitalor, mesazhi kryesor i të cilit është: "Sistemi aktual i vlerësimit të kostove për shërbimet spitalore është një vlerësim që mbart shpenzime të tepërta dhe nuk reflekton kostot e vërteta, duke orientuar kërkesat e institucioneve shëndetësore spitalore drejt vlerësimit të shpenzimeve dhe jo sipas kostove të tyre. Mungesa e specialiteteve pranë shërbimeve në spitalet rajonale dhe bashkiake, si dhe mungesa e performancës së shërbimit parësor ka krijuar rritjen e kostove dhe përqendrimin e pacienteve në qendrën më të madhe universitare QSUT. Implementimi i paketave shëndetësore përbën një nismë të mirë për miratimin e protokolleve për këto paketa, por mënyra e vlerësimit financiar të tyre bie ndesh me ligjin e prokurimeve publike, duke rritur kostot e këtyre shërbimeve shëndetësore. Riorganizimi i hartës së spitaleve mbi bazën e treguesve të performancës së shërbimit spitalor përbën një kusht të nevojshëm dhe të domosdoshëm për uljen e kostove të tepërta për sistemin shëndetësor"

Cilësia e ajrit, mesazhi kryesor i të cilit është: ''Masat e marra nga qeverisja qendrore dhe lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vendin tonë nuk kanë qenë efektive dhe eficiente. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit (SKCA) e miratuar në vitin 2014, ende nuk është zbatuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e SKCA-së. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit nuk është miratuar dhe si rrjedhojë asnjë Bashki në Shqipëri nuk ka miratuar Planet Vendore të Veprimit të Cilësisë së Ajrit. Monitorimi i cilësisë së ajrit nuk i përmbush plotësisht standardet e vendosura nga direktivat përkatëse të BE-së. ISHMP nuk kryen inspektime sa i përket tejkalimit të normave të shkarkimeve të elementëve ndotës të ajrit sepse nuk zotëron asnjë mjet/laborator për matjen e këtyre shkarkimeve në terren. ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës.''

Menaxhimi i borxhit publik mesazhi kryesor i të cilit është: "Mos vlerësimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i një seti indikatorësh thelbësorë të qëndrueshmërisë dhe kostos së borxhit publik, nuk siguron ekonomicitet dhe efiçiensë në menaxhimin e tij. Rezultatet e treguesve përgjegjës për vlerësimin e qendrueshmërisë dhe kostos së borxhit publik si: Borxh i Jashtëm/ Eksporte, Borxh i Jashtëm/Rezervave Valutore dhe Indikatori i Hendekut Primar Afatshkurtër, tregojnë se aftësia ripaguese e ekonomisë sonë kundrejt borxhit publik, është në rënie. Këto rezultate lidhen drejtpërdrejtë me koston që përballon shteti për shlyerjen e interesave dhe principalit. Mos zbërthimi i strategjive afatmesme të menaxhimit të borxhit publik në plane konkrete veprimi dhe strategji alternative, nuk i mundësojnë Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë diversifikimin e risqeve për të arritur në një menaxhim efiçient të borxhit publik."

Implementimi i strategjisë antikorrupsion mesazhi kryesor i të cilit është: "SNKK dhe PV janë krijuar për të qenë në linjë me një nga 5 rekomandimet e BE-së dhe rezultati final i tyre duhet të reduktonte ndjeshëm korrupsionin në vend me anë të përfshirjes së të gjitha palëve të interesit. Pavarësisht këtij synimi, SNKK dhe rrjedhimisht PV që e detajon atë vuajnë planifikimin e dobët

të objektivave të saj, specifikisht të objektivit A11 audituar nga KLSH. Ky planifikim i dobët shprehet në formulimin e nënobjektivave jo-SMART, moskonsultimin apo konsultimin fiktiv të palëve të interesit në hartimin e këtyre dokumenteve, mungesën e metodologjisë që përkthen objektivat operacionalë në strategjikë, mungesën e koherencës midis PV dhe SNKK, si edhe miratimit të kësaj Strategjie me akt nënligjor (VKM), ndërkohë që ajo parashtron detyra edhe për institucionet e pavarura nga ekzekutivi. Në drejtim të implementimit, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore për periudhën mars 2015- shtator 2017 dhe Ministria e Drejtësisë për periudhën shtator - dhjetor 2017) me rol kyç në hartimin, implementimin dhe monitorimin e SNKK dhe Planit të Veprimit, nuk kanë zotëruar asnjë hallkë të detyrave dhe përgjegjësive të veta, duke rezultuar në një Strategji të pazbatuar, pa monitoruar dhe rrjedhimisht të pa raportuar për arritjet dhe mosarritjet. Gjithsesi, KLSH vlerëson përpjekjet e Ministrit të Drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, përmes veprimtarisë së Task Forcës, përgjatë 3-mujorit të dytë dhe tretë 2018. Prefekturat, si një nga palët kryesore në zbatimin e Strategjisë janë joaktive si në afatet, ashtu edhe cilësinë e raportimit dhe rezultojnë të mos kenë realizuar produktet finale të parashikuara. Duke e konsideruar të dështuar në masën më të madhe Strategjinë Antikorrupsion dhe Planin e Veprimit për ta vënë në jetë atë, si edhe për të siguruar implementimin e një nisme kaq jetike për vendin e për të eliminuar në vijimësi riskun e transferimit të KKK nga njëri institucion në tjetrin, KLSH rekomandon krijimin e një Agjencie Kombëtare Antikorrupsion. Kjo agjenci sugjerohet të jetë nën varësinë e Kryeministrit dhe përgjegjëse për rihartimin, rizbatimin dhe monitorimin e mëtejshëm të SNKK dhe PV, duke marrë fillimisht dakordësinë e Kuvendit për dokumentet strategjikë në formën e një Ligji të posaçëm. Gjithashtu, për përfshirjen e institucioneve jashtë-qeveritare në këtë Strategji, sinergjizimin e përpjekjeve anti-korrupsion nga qeveria dhe institucionet kushtetuese, shoqëria civile, donatorët e huaj dhe aktorë të tjerë publikë, Kuvendi mund të përfshijë në Ligjin e miratuar për këtë Strategji, një aneks mbi raportet dhe rolin e këtyre aktorëve në Strategjinë Antikorrupsion dhe konkretisht me Agjencinë Kombëtare Antikorrupsion. Marrëdhëniet dhe roli i aktorëve jashtë-qeveritarë, sugjerohet të fokusohen në rakordimin e strategjive individuale të këtyre aktorëve me Strategjinë Antikorrupsion të qeverisë."

Varfëria në Shqipëri dhe roli i shtetit në zbutjen e saj, për të cilën u ushtrua aktiviteti auditues në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Fier, konkludoi se: "Në Shqipëri nuk ka një vlerë të miratuar nga qeveria të minimumit jetik dhe kufirit të varfërisë, mbi të cilën të bazohen politikat dhe studimet e përkujdesit social. Skema aktuale e Ndihmës Ekonomike, si instrument i MSHMS dhe institucioneve të varësisë për përkujdesjen sociale, nuk është efektive në zbutjen e varfërisë referuar numrit të familjeve që dalin nga skema për shkak të punësimit dhe përmirësimit të kushteve social-ekonomike të tyre. Ineficienca e sistemit elektronik lidhet me aplikimin e formulës së unifikuar të pikëzimit, e cila nuk është vlerësuar në bazë të kushteve koherente të familjeve në nevojë. Mbështetja e qeverisë me programin e Ndihmës Ekonomike do të ishte efektive nëse kontributi do të vlerësohej paralelisht me nivelin e përgjithshëm të çmimeve, me produktet e shportës së konsumit dhe me studime dinamike për riintegrimin e individëve në shoqëri."

[shqiptarja.com]

PJESA E PARË

ANALIZA E IMPLEMENTIMIT TË BUXHETIT 2017

[Shqiptarja.com]

[shqiptarja.com]

1. TREGUESIT E KONSOLIDUAR FISKALË TË BUXHETIT 2017

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit për vitin 2017, janë realizuar në vlerën 430,492 milionë lekë, nga 436,400 milionë lekë (ose realizuar 98,6%) të planifikuara me ligjin nr.130/2016, datë 15.12.2016, "*Për buxhetin e vitit 2017*", ose **5,909 milionë lekë më pak nga planifikimi fillestar**. Ndërkohë që krahasuar me një vit më parë këto të ardhura janë rritur me 23,389 milionë lekë (*ose rreth 5,7 % më shumë krahasuar me vitin 2016*). Referuar realizimit faktik të të ardhurave për vitin 2017, konstatohet se planifikimi fillestar ka parashikuar një rritje të të ardhurave në masën 7,2% më shumë për vitin 2016, ndërkohë është realizuar një rritje në masën 5,7%. Grafiku në vijim paraqet dinamikën e ndryshimit të të ardhurave të përgjithshme nga planifikimi fillestar deri në realizim.

Grafiku 1: Dinamika e të ardhurave viti 2017



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Trendi i realizimit të të ardhurave në 5 vitet e fundit jepet në grafik, ku vihet re rritja e të ardhurave për vitin aktual buxhetor.

Grafiku 2: Të ardhurat tatimore në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Grafiku në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e të ardhurave sipas klasifikimit buxhetor.

[shqiptaria.com]

Grafiku 3: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave viti 2017



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2017, **u realizuan në vlerë 461,410 milionë lekë**, nga 467,600 milionë lekë të planifikuara sipas planit fillestar, duke reflektuar **mos shpenzim të fondeve të planifikuara në masën 6,190 milionë lekë**. Ndërsa nëse i referohemi planit përfundimtar, sipas Aktit Normativ nr.3, datë 06.11.2017, konstatojmë se, shpenzimet nuk janë realizuar për vlerën 12,690 milionë lekë. Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2017 shpenzimet buxhetore janë realizuar me 27,637 milionë lekë më shumë se viti 2016 *ose rreth 6,37%.* Grafiku në vijim paraqet dinamikën e ndryshimit të shpenzimeve të përgjithshme nga planifikimi fillestar deri në realizim.

Grafiku 4: Dinamika e shpenzimeve të përgjithshme



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në mënyrë grafike ecuria e shpenzimeve faktike të buxhetit të shtetit për 6 vite rezulton si në vijim:

Grafiku 5: Shpenzime të përgjithshme në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

[Shqiptaria.com]

Grafiku në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor.

Grafiku 6: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve të përgjithshme



	Shpenzime Korente	Fondi Rezer./Kontigj.	Shpenzime Kapitale	Huadhenie per energjine	Fond Shpronesimi
Ligji I Buxhetit	390,169	1,500	74,431	1,500	
Buxheti Faktik 2017	382,287		68,455	9,217	1450
Diferenca	7,882	1,500	5,976	-7,717	-1,450

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Realizimi i treguesve të buxhetit të vitit 2017, si dhe krahasimi i zërave buxhetorë në harkun kohor 2012-2017, paraqitet sinë grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 7: Realizimi i treguesve të buxhetit të vitit 2017



	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Te ardhura	330,383	327,178	366,721	379,206	407,103	430,492
Shpenzime	376,241	394,118	438,849	437,408	433,773	461,410
Deficiti buxhtor	-45,858	-66,940	-72,128	-58,202	-26,670	-30,919

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Deficiti buxhetor gjatë për vitin 2017, **ishte parashikuar në vlerën 31,200 milionë lekë dhe është realizuar në masën 30,919 milionë lekë ose realizuar në masën 99,1%.** Krahasuar me vitin 2016, **deficiti buxhetor është rritur në masën 4,249 milionë lekë ose është rritur në masën 16%**. Ky deficit është realizuar, 6% financim i brendshëm nga 65 % të planifikuara Ligjin Fillestar të Buxhetit dhe 94 % financim i huaj nga 35% të planifikuara me Ligjin Fillestar të Buxhetit. Grafiku në vijim paraqet devijimet që ka pësuar Financimi i Deficitit Buxhetor nga faza e planifikimit të tij deri në realizimin faktik të buxhetit të vitit 2017.

[shqiptarja.com]

Grafiku 8: Devijimet e Financimit të Deficitit Buxhetor



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Deficiti Buxhetor faktik përgjatë 5 viteve të fundit, jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 9: Deficiti Buxhetor faktik përgjatë 5 viteve të fundit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Deficiti Buxhetor Mujor, për vitin 2017, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 10: Deficiti Buxhetor Mujor, për vitin 2017



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Te ardhura	32,894	31,151	37,503	38,733	36,462	35,543	36,325	36,265	35,196	36,304	34,070	40,047
Shpenzime	25,634	30,157	39,398	34,635	40,623	39,147	37,797	37,590	37,620	37,281	41,095	60,433
Deficiti	7,260	994	-1,896	4,098	-4,162	-3,605	-1,472	-1,325	-2,424	-977	-7,025	-20,385

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sic shihet në paraqitjen e mësipërme, **Deficiti Buxhetor** ka arritur vlerën më të lartë në muajin **Dhjetor për 20,385 milionë** lekë dhe që përfaqëson **66% të Deficitit të Përgjithshëm Buxhetor.** Në referencë të ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, në nenin 4/1 "Parimet dhe rregullat fiskale citohet *"Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit"*, **konstatohet se për vitin 2017, ky nen i Ligjit organik nuk është shkelur jo vetëm në kuadrin makro, planifikimin**

[Shqiptaria.com]

fillestar, planin përfundimtar, por dhe në buxhetin e realizuar në nivel vjetor. Në lidhje me kontrollin e ekzekutimit të buxhetit në vit elektoral, konstatohet se, ekzekutimi i deficitit deri në fund të nëntë mujorit të parë të vitit buxhetor raportuar në vlerën 10,533 milionë lekë është brenda parametrave të përcaktuar më Ligjin 130/2016, ku përcaktohet se, ky deficit nuk duhet të jetë më i lartë se 80 për qind e deficitit vjetor. Treguesit e konsoliduar buxhetor, në harkun kohor të 5 viteve të fundit.

Grafiku 11: Realizimi i buxhetit në vite



	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Te ardhura	330,383	327,178	366,721	379,206	407,103	430,492
Shpenzime	376,241	394,118	438,849	437,408	433,773	461,410
Deficiti buxhetor	-45,858	-66,940	-72,128	-58,202	-26,670	-30,919

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Deficiti i raportuar rezulton të jetë sa 1.99% e PBB-së, cka në aspektin formal rezulton brenda limitit ligjor prej 2% të PBB-së. *Kemi konstatuar se niveli faktik i deficit është i nënvlerësuar me qëllim raportimin e tij brenda kufinjve ligjor, duke mos raportuar shpenzimet në nivelin e plotë të tyre si dhe duke ndërmarrë veprime riklasifikuese manuale në përgatitjen e treguesve fiskal për të netuar vlerën e deficitit me burimin e financimit të tij. Me qëllim mbajtjen e deficitit nën limitet e miratuara, duke mos shkurtuar shpenzimet, janë krijuar detyrime të prapambetura.* Nga analiza e të dhënave rezulton, Deficiti Buxhetor ka arritur vlerën më të lartë në muajin Dhjetor për 20,385 milionë lekë dhe që përfaqëson 66% të Deficitit të Përgjithshëm Buxhetor. Ky përqëndrim në muajin Dhjetor ka ardhur jo vetëm si rezultat i realizimit të fondeve në fund të vitit por vecanërisht i rregjistrimit të shpenzimeve të ndodhura më parë në këtë muaj. Rregjistrimi me vonesë i shpenzimeve apo mosrregjistrimi i tyre në vitin 2017 është trajtuar gjerësisht në këtë raport. **Si konkluzion vlerat faktike të deficit mujor të raportuar nuk japin një pasqyrim të drejtë të këtij treguesi dhe zbatimin e kërkesave ligjore në vite elektorale.**

[shqiptaria.com]

2. PROGRAMIMI BUXHETOR DHE REGJISTRIMI I TIJ NË SIFQ

Në mënyrë të përmbledhur procesi i përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të vitit 2017, sipas kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike miratuar me VKM nr.59, datë 27.01.2016, hap pas hapi dhe sipas afateve në respekt të kërkesave ligjore, jepet në vijim.

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal (KMF) për periudhën 2017-2019: Nga auditimi u konstatua se, Miratimi i Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2017-2019, është bërë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 03.02.2016, me 11 ditë vonesë referuar kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal (KMF) ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të Qeverisë. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal (KMF).

Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit të vitit 2017: Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjërë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Dokumenti i PBA hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë brenda periudhës afatmesme, që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve publike korrente dhe kapitale. Dokumenti i PBA-së, pasqyron kërkesat buxhetore të ministrive të linjës duke paraqitur me detaje qëllimet, objektivat, dhe produktet e programeve prej secilës prej Ministrive të linjës për vitet 2017, 2018 dhe 2019. Komitetit i Planifikimit Strategjik si strukturë pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesuar nga Kryeministri, luan një rol parësor në drejtim të miratimit të një sërë etapash të rëndësishme si: Kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën e PBA-së, Tavanet përgatitore dhe përfundimtare të PBA-së si dhe projekt dokumenti dhe dokumenti i rishikuar i PBA-së.

Mbi procedurat e hartimit dhe miratimit të Projektbuxhetit të vitit 2017: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.1490/2 datë 03.11.2016, ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave projektligjin "Për buxhetin e vitit 2017" të shoqëruar me relacionin shpjegues. Me Vendimin e KM, ky propozim ka kaluar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Çelja e buxhetit, sipas Ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017": Ligji nr.130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", është dekretuar nga Presidenti i Republikës ne dekretin nr.9905, datë 23.12.2016 dhe i është derguar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 6414, datë 18.01.2017 me subjekt "Dërgim dekreti dhe ligji". Nga auditimi u konstatua se, me miratimin e Ligjit të buxhetit te vitit 2017, treguesit e të Ardhurave dhe Shpenzimeve në total, rezultojnë në nivele më të ulët se ata të miratuara në kuadrin afatmesëm 2017-2019 dhe konkretisht:

1. Të ardhurat totale në vlerën 436,400 milionë lekë janë ulur me 2,3 % ose 10,375 mijë lekë krahasuar me fazën e parë të PBA 2017-2019, ku ishin parashikuar për 446,775 mijë lekë ndërkohë krahasuar me dokumentin e rishikuar të PBA-së 2017-2019, të ardhurat pothuajse nuk kanë ndryshuar.

2. Shpenzimet në total në vlerën 467,600 milionë lekë janë ulur 0,5% ose 2,188 mijë lekë krahasuar me fazën e parë të PBA 2017-2019, ku ishin parashikuar për

[Shqiptaria.com]

469,788 mijë lekë dhe krahasuar me dokumentin e rishikuar të PBA 2017-2019, shpenzimet janë ulur në 0,4% ose në masën 1,943 mijë lekë.

3. Deficiti buxhetor gjatë vitit 2017, është parashikuar të rritet në rreth 4,524 milionë lekë, nga 26,676 milionë lekë në buxhetit faktik 2016, në 31,200 milionë lekë në vitin 2017. Ky deficit është parashikuar të financohet nga 65% fonde të brendshme dhe 35% fonde të jashtme.

Për vitin 2017, buxheti përbëhet nga: Buxheti i Shtetit, Buxheti vendor dhe fondet speciale dhe Kompensimi i pronarëve. Ndërsa duke bërë një bashkim të pjesëve përbërëse të buxhetit, shuma e buxhetit sipas Ligjit 130/2016, datë 15.12.2016, rezulton sipas tabelës:

Tabela 1: Buxheti 2017 *mln lekë*

	Buxheti 2017 Ligji 130/2016	Të ardhurat	Shpenzimet	Deficiti
1	Buxheti i shtetit	337,600	368,799	-31,200
2	Buxheti vendor	40,900	40,900	0
3	Sigurimet shoqërore	114,264	114,264	0
4	Sigurim suplementar	5936	5936	0
5	Sigurim shëndetësor	38,122	38,122	0
6	Kompensimi i pronave	3,800	3,800	0
	Totali	**540,622**	**571,821**	**-31,200**

Diferenca për 104,222 milionë lekë, (540,622 milionë lekë minus 436,400 milionë lekë) përfaqëson transferta nga buxheti i shtetit për llogari të pushtetit vendor, sigurimeve shoqërore, suplementare dhe shëndetësore si dhe kompensimit të pronave. Vlera për 1,050 milionë lekë përfaqëson të ardhura nga transferimi i rentës të cilat bëjnë pjesë në të ardhurat e buxhetit të shtetit. Në këtë Ligj (neni 20) është përcaktuar **kufiri për rritjen vjetore të totalit eksistues të borxhit të shtetit** dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta. Ky kufi për vitin 2017, është 31,669 milionë lekë si vijon: Për huamarrjen e brendshme vjetore dhe Mbështetjen Buxhetore deri në 41,229 milionë lekë. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfitueses deri në 500 milionë lekë. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja deri në minus 10,030 milionë lekë. Tabela në vijim paraqet kufirin e borxhit publik për vitin 2016.

Tabela 2: Kufiri për borxhin publik *mln lekë*

Kufiri për borxhin publik	Vlera
Per humarrje e brendëshme vjetore dhe Mbeshtetjen Buxhetore	41,229
Per rritjen vjetore te garancise të shtetit në dobi të paleve te treta	500
Per huamarrjen neto per financimin e projekteve te huaja	-10,030
Totali	**31,699**

Shpenzimet e Buxhetit për vlerën 467,600 milionë lekë, grupuar sipas llojit të shpenzimit paraqiten:

Tabela 3: Shpenzimet e Buxhetit grupuar sipas llojit të shpenzimit *mln lekë*

Llogaria	Përshkrimi i shpenzimit	Totali	%
600+601	Pagat, Sig. Shoqerore dhe Shendetesore	68,930	14.7%
602-606	Mallra, Sherbime, Subvencione, te tjera Korrente	227,938	48.7%
230,231	Shpenzime Kapitale	73,430	15.7%
	Shpenzime te tjera te pa klasifikuara	97,302	20.8%
	Totali	**467,600**	**100.0%**

Në zërin "Shpenzime te tjera te paklasifikuara" (Totali) janë përfshirë: pagesat për shërbimin e borxhit, kontigjencaper politika pagash dhe pensionesh, fondi rezervë, dhe shpenzimet e pushtetit vendor. Ministria e Financave, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit*

buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar për zbatimin e Buxhetit të vitit 2017, udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, në zbatim të kompetencave që i jepen nga ligji organik i buxhetit, referuar edhe ligjit vjetor të dekretuar, bën shpërndarjen e fondeve buxhetore, sipas klasifikimit buxhetor për institucionet sa vijon: a) Për njësitë e qeverisjes qendrore, bën shpërndarjen e të gjitha fondeve buxhetore, b) Për njësitë e qeverisjes vendore bën shpërndarjen e fondeve për transfertën e pakushtëzuar. Çelja e detajimi fillestar i shpenzimeve është bërë për çdo institucion të qeverisjes qendrore me shkresat e Ministrisë së Financës, në bazë të shkresave dhe kërkesave të çdo institucioni buxhetor.

Buxheti sipas ndryshimeve me akte normative:

Aktit normativ nr. 01, datë 16.08.2017, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017". Në nenin 101, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë citohet "Këshilli i Ministrave, **në rast nevoje dhe urgjence**, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve."

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore, deri në fund të vitit 2017, parashikohet të rriten me **2,000 milionë lekë** shifër kjo e cila parashikohet të arrihet nga të ardhurat nga pushteti vendor.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore deri në fund të vitit 2017 parashikohen të rriten për **2,000 milionë lekë**. Me aktin normativ nr. 2, të buxhetit të miratuar me ligjin 130/2016, deficiti buxhetor nuk ka ndryshuar por ka ndryshuar struktura e mbulimit të tij. Kështu financim i brendshëm i deficitit buxhetor është rritur me 700 milionë lekë dhe është pakësuar financimi i huaj me 700 milionë lekë.

Akti Normativ nr. 3, datë 06.11.2017 "Për disa ndryshime në ligjin 130/2016 për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar. Nevoja dhe urgjenca për nxjerrjen e Aktit Normativ, nr. 03, datë 06.11.2017, sipas relatimit të Ministrisë së Financave konsiston edhe në faktin se: Në rastin konkret, miratimi i Qeverisë së re dalë pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 25 Qershorit 2017, kulmoi në riorganizimin e Këshillit të Ministrave dhe për rrjedhojë ristrukturimin e përbërjes së tij. Kësisoj, bazuar në VKM-të e reja të fushave të përgjegjësive respektive, disa ministri pushuan së ekzistuari duke u ripozicionuar nëpër ministritë e reja përthithëse, si nga pikëpamja organike ashtu edhe nga ajo buxhetore. Ky ripozicionim, deri në këtë moment i rregulluar procedurialisht nëpërmjet orientimeve/ udhëzimeve specifike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sa i përket funksionimit praktik të njësive shpenzuese ekzistuese, është i domosdoshëm të legjitimohet dhe institucionalizohet nëpërmjet rishikimit të ligjit të buxhetit për vitin 2017. Në këto kushte, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2017. Me miratimin e Aktin Normativ nr. 03, datë 06.11.2017, deficiti buxhetor, krahasuar me Ligjin nr. 130/2016, financimi i brendshëm është pakësuar me 11,301 milionë lekë ndërsa financimi i jashtëm është shtuar me 11,300 milionë lekë.

[Shqiptaria.com]

Tabela 4: Shpenzimet e Buxhetit grupuar sipas llojit të shpenzimit *mln lekë*

DEFICITI	Ligji i Buxhetit	Akt Normativ 1	Akt Normativ 3	Diferenca Ligji/AN 03.
	-31,200	-31,200	-31,200	
Financim i Brendshem	20,230	20,930	8,929	11,301
Financim i Huaj	10,970	10,270	22,270	-11,300

Në mënyrë tabelare është paraqitur gjithë procesi i përgatitjes, miratimit të buxhetit të vitit 2017 dhe ndryshimeve të tij me Akte Normative.

Tabela 5: Buxheti përgjatë vitit 2017 *mln lekë*

ZERAT		PBA /Kuadri Makro/ Faza I	PBA e Rishikuar	Projekt Buxheti	Ligji i Buxhetit	AN 01.	AN 03
A	**TOTALI I TE ARDHURAVE**	**446,775**	**436,087**	**436,001**	**436,400**	**438,400**	**442,900**
I	**Të ardhura nga ndihmat**	**15,100**	**15,100**	**13,800**	**13,800**	**13,800**	**13,000**
II	**Të ardhura tatimore**	**405,745**	**399,057**	**397,801**	**398,200**	**400,200**	**405,500**
1	Nga Tatimet& Doganat	304,812	300,144	299,000	299,400	299,400	299,400
2	Nga Pushteti Vendor	19,748	15,424	15,401	15,400	17,400	20,900
3	Nga Fondet Speciale	81,185	83,489	83,400	83,400	83,400	85,200
III	**Të ardhura Jotatimore**	**25,930**	**21,930**	**24,400**	**24,400**	**24,400**	**24,400**
B	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**469,788**	**465,657**	**467,199**	**467,600**	**469,600**	**474,100**
I	**Shpenzimet korrente**	**396,471**	**393,740**	**389,799**	**390,169**	**387,769**	**393,370**
1	Personeli	72,551	72,746	74,782	74,830	75,130	74,969
2	Interesat	47,954	46,554	42,000	42,000	37,900	37,900
3	Shpenzime operative dhe mirembajtje	43,922	44,687	44,459	44,687	44,887	44,988
4	Subvencione	1,600	2,170	2,330	2,330	2,330	2,339
5	Shpenzime per fondet Speciale	161,109	160,609	162,100	162,122	161,522	163,322
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	45,835	43,674	40,828	40,900	42,900	46,400
7	Shpenzime te tjera	23,500	23,300	23,300	23,300	23,100	23,452
II	**Fondi Rezerve/Kontigjenca**	**4,000**	**4,300**	**1,500**	**1,500**	**2,700**	**2,400**
III	**Shpenzime Kapitale**	**64,317**	**62,617**	**74,400**	**74,431**	**74,131**	**73,330**
IV	**Detyrime te prapambetura**	**5,000**	**5,000**				
V	**Huadhenie neto per energjine**			**1,500**	**1,500**	**4,500**	**4,500**
VI	**Fond Shpronesimi 2017**					**500**	**500**
C	**DEFICITI**	**-23,013**	**-29,570**	**-31,198**	**-31,200**	**-31,200**	**-31,200**
1	Financim i Brendshem	29,992	39,549	19,759	20,230	20,930	8,929
2	Financim i Huaj	-6,980	-9,980	11,440	10,970	10,270	22,270

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi mbi programimin buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe planifikimin fillestar të buxhetit të vitit 2017 me ndryshimet e pasqyruara gjatë vitit, KLSH gjykon se,

a. dokumenti i PBA 2017-2019, është hartuar në mënyrë formale duke venë në dyshim standardet dhe vërtetësinë e programimit të produkteve. Konstatohet se, dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019, ka probleme në drejtim të respektimit të kërkesave dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 08, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" dhe Udhëzimit plotësues nr.4/2, datë 08.07.2016 më konkretisht këto problematika adresohen në drejtim të formulimit të qëllimit të politikës, objektivave të programit si dhe produkteve të programit. Konstatohen raste kur, kosto e produkteve ka një luhatje të madhe nga njëra faze në tjetrën të PBA-së, pavarësisht se sasia e produktit mbetet e pa ndryshuar. Në lidhje me këto fenomene, në shkresën nr.15475, datë 10.11.2006, të dërguar pranë Këshillit të Ministrave për shqyrtim dhe miratim "Dokumenti i rishikuar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019" nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, nuk ka shpjegime. Konstatohet se, nuk është pjesë e VKM-së nr. 938, datë 28.12.2016 "Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar 2017-2019", shtojca 6, "Shpenzime sipas produkteve" e programit 01130 "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme ", program të cilin e menaxhon Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

b. Nga auditimi mbi regjistrimin e Planit të Buxhetit të shtetit për vitin 2017, sipas Tabelës 4, "Treguesit Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar" të Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017" në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), u konstatua se, ky plan paraqitet të jetë regjistruar me diferenca të konsiderueshme. Ky fakt tregon se, Drejtoria Përgjithshme e Buxhetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk ka monitoruar procesin e regjistrimit të të dhënave të planifikimit buxhetor në SIFQ, veprim i cili mbart riskun e kryerjes së shpenzimeve nga ana e njësive shpenzuese pa pasur një plan shpenzimi, që do të thotë shkeljen e Ligjit Organik të Buxhetit si dhe krijim i detyrimeve të prapambetura.

Më konkretisht kemi :

- Referuar Tabelës nr. 4, të Aktit Normativ nr. 03, të ardhurat e përgjithshme për vitin 2017, paraqiten në vlerën 442,901 milionë lekë, ndërkohë ky zë **në SIFQ**, paraqitet për 408,800 milionë lekë pra me një diferencë për **34,101 milionë lekë** më pak se Akti Normativ nr.03.
- Referuar Tabelës nr. 4, të Aktit Normativ nr. 03, Shpenzimet për vitin 2017, paraqiten në vlerën 474,101 milionë lekë, ndërkohë ky zë **në SIFQ**, paraqitet për 459,627 milionë lekë pra me një diferencë për **14,474 milionë lekë** më pak se Akti Normativ nr. 03.
- Referuar Tabelës nr. 4, të Aktit Normativ nr. 03, Deficiti për vitin 2017, paraqiten në vlerën 31,200 milionë lekë, ndërkohë ky zë **në SIFQ**, paraqitet për **50,826 milionë lekë** pra me një diferencë për **19,626 milionë lekë** më shumë se Akti Normativ nr.03.

c. KLSH, gjykon se, **Aktet Normative në fund të vitit u japin mundësinë institucioneve të ndërmarrin angazhime buxhetore pas datës 15 Tetor 2017, në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit, të ndryshuar, por që nuk arrijnë t'i realizojnë ato, duke mbartur në këtë mënyrë riskun e realizimit fiktiv të tyre si dhe riskun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.** Nga auditimi u konstatuan **3 raste** në vlerën totale **për 50 milionë lekë,** kontrata të cilat janë lidhur dhe realizuar në periudhën kohore 28-31 Dhjetor 2017, të cilat logjikisht janë të pa mundura të realizohen.

- Konstatohet se, kontrata e projektit të investimit me kod M140310 "Furnizim vendosje te komunikimit me radio" i programit 3440 "Sistemi i burgjeve" në vlerën **16,760 mijë lekë** i Ministrisë së Drejtësisë, me operatorin ekonomik është lidhur me datë **28.12.2017**, ndërkohë që në mbyllje të vitit buxhetor me datë 31.12.2017, pra për një afat kohor **për dy ditë** kjo kontratë rezulton të jetë e realizuar në vlerën 11,154 mijë lekë.
- Konstatohet se, kontrata e projektit të investimit me kod M260395 "Sinjalistika e infrastrukturës turistike" i programit 4760 "Zhvillimi i turizmit" në vlerën **11,540 mijë lekë** i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me operatorin ekonomik është lidhur me datë **26.12.2017**, ndërkohë që në mbyllje të vitit buxhetor me datë 31.12.2017, pra për një afat kohor për 4(katër) ditë kjo kontratë rezulton të jetë e realizuar në vlerën 9,160 mijë lekë.
- Konstatohet se, kontrata e projektit të investimit me kod M560435 "Hartimi i projekteve për rrugët rurale" i programit 6210 "Programe Zhvillimi" në vlerën **30,000 mijë lekë** i Fondit të Zhvillit Shqiptar, me operatorin ekonomik është lidhur me datë **27.12.2017**, ndërkohë që në mbyllje të vitit buxhetor me datë

[Shqiptaria.com]

31.12.2017, pra për një afat kohor për 3(tre) ditë kjo kontratë rezulton të jetë e realizuar në vlerën 30,000 mijë lekë.

d. Nga auditimi mbi planifikimin, detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2017, për disa institucione KLSH ka konstatuar veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 08, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" dhe Udhëzimin plotësues nr. 4/2, datë 08.07.2016 dhe konkretisht nenin 65 ku citohet: "Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti mban parasysh këtë radhë prioritare**:** a- investimet në proces nga viti i kaluar, b- objektet e paraqitura në Kuvend gjatë shqyrtimit të projekt buxhetit", dhe nenin 66 ku citohet: "Nëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të projekt buxhetit të vitit, NPA e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve të publikuara."

- Referuar të dhënave të regjistruara në SIFQ, konstatohet se, në zbatim të Ligjit 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" janë çelur projekte investimi me financim të brendshëm në vlerën **5,094.9 milionë lekë**, projekte të cilat rezultojë të mbyllur me miratimin e Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 "Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2017, të miratuar me Ligjin 130/2016", fakt i cili tregon për **një buxhetim të dobët dhe formal** nga ana e ministrive të linjës. Gjithashtu konstatohet se, ka projekte investimi të cilat janë çelur për herë të parë me miratimin e Aktit Normativ Nr. 03, datë 06.11.2017 "Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2017, të miratuar me Ligjin 130/2016", dhe realizuar përgjithësisht **në vlerë ekzakte** sa vlera totale apo pjesore e faturave që presin çeljen për tu regjistruar (Shihni rastin e Bashkisë Gjirokastër më poshtë për fatura që regjistrohen dhe likuidohen në mënyrë pjesore). Referuar kontratave dhe faturave të regjistruar në SIFQ, konstatohet se këto projekte investimi janë kontrata në vazhdim nga vitet e kaluara, në vlerën **6,830.8 milionë lekë,** kryesisht të FZHR-së. Ky fakt tregon për çelje në SIFQ që legjitimojnë plotësisht apo pjesërisht shpenzime të ndodhura dhe njohura më parë, të cilat duhet të ishin shoqëruar me planin buxhetor përkatës.
- KLSH, ka konstatuar se, **për disa institucione, megjithëse vlera e miratuar e fondeve të investimeve kapitale me financim të brendshëm ka qenë e njëjtë si në projektbuxhetin e vitit 2017, ashtu edhe me miratimin e buxhetit sipas Ligjit 130/2016, lista e përfundimtare e investimeve kapitale të miratuara me ligj, është e ndryshme nga lista e miratuar në projekt buxhetin e vitit 2017**. Konstatohet të jenë çelur **5 projekte investimi** në vlerën **91,8 milionë lekë** të cilat nuk kanë kaluar procesin e miratimit të investimeve publike.

Për Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave:

Projekti i investimit me kod M051467 "Blerje pajisje laboratorike " me vlerë **18,1 milionë lekë** i programit 4220 "Siguria ushqimore" rezulton të jetë çelur me buxhetin e vitit 2017, pavarësisht se ky projekt nuk rezulton të jetë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit e po këtij viti. Gjithashtu referuar shtojcës 01/A "Lista përmbledhëse e projekteve te investimeve publike me financim të brendshëm të parashikuar" të dokumentit të PBA 2017-2019, faza II të depozituar nga ky institucion pranë MFE, ***ky projekt nuk rezulton të jetë në këtë listë.*** Në mbyllje të vitit, ky projekt rezulton të mos jetë realizuar.
a) Projekti i investimit me kod M051475 "Lumi Devoll, 100 metra pranë urës së trenit " me vlerë **33,3 milionë lekë** i programit 4240 "Menaxhimi i

infrastrukturë së kullimit dhe ujitjes" rezulton të jetë çelur me buxhetin e vitit 2017, pavarësisht se ky projekt nuk rezulton të jetë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit e po këtij viti. Gjithashtu referuar shtojcës 01/A "Lista përmbledhëse e projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm të parashikuar" të dokumentit të PBA 2017-2019, faza II të depozituar nga ky institucion pranë MFE, ***ky projekt nuk rezulton të jetë në këtë listë***. Në mbyllje të vitit, ky projekt rezulton të jetë realizuar në masën 100%.

b) Projektet e investimit me kod M051468 "Rikonstruksion përshtatje 4 zyrave" me vlerë me vlerë **28,2 milionë lekë** dhe projekti me kod M051435 "Rikonstruksion përshtatje ambientesh" me vlerë **4,2 milionë** lekë, të programit 4220 "Siguria ushqimore" rezultojnë të jetë çelur me buxhetin e vitit 2017, pavarësisht se, këto projekte rezultojnë të jetë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin në vlerën 10 milionë lekë me përshkrimin "Rikonstruksion i 15 zyrave neper rrethe". Gjithashtu referuar shtojcës 01/A "Lista përmbledhëse e projekteve te investimeve publike me financim të brendshëm të parashikuar" të dokumentit të PBA 2017-2019, faza II të depozituar nga ky institucion pranë MFE, *ky projekt nuk rezulton të jetë në këtë listë.* Në mbyllje të vitit, ky projekt rezulton të mos jetë realizuar.

c) Projekti i investimit me kod M051477 "Dunavec, mbi grykëderdhjen e përroi Voskop" i programit 4240 "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes" rezulton të jetë çelur me buxhetin e vitit 2017 me vlerë **8 milionë lekë,** pavarësisht se, ky projekt *nuk rezulton të jetë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin* e vitit e po këtij viti. Gjithashtu referuar shtojcës 01/A "Lista përmbledhëse e projekteve te investimeve publike me financim të brendshëm të parashikuar" të dokumentit të PBA 2017-2019, faza II të depozituar nga ky institucion pranë MFE, ky projekt nuk rezulton të jetë në këtë listë. Në mbyllje të vitit, ky projekt rezulton të jetë realizuar në vlerën 7,8 milionë lekë.

d) Projekti i investimit me kod M051479 "Skema Ujitëse e fushës se Milotit, Mamurrasit, Drojës me Kanalin Kryesore U 11**"** i programit 4220 "Siguria ushqimore" rezulton të jetë çelur me buxhetin e vitit 2017 me vlerë **26,1 milionë lekë,** pavarësisht se në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit e po këtij viti ky projekt rezulton të jetë planifikuar në vlerën **42,4 milionë lekë.**

Për Ministrinë e Brendshme:

Në listën e investimeve kapitale me financim të brendshëm **të projekt buxhetit** është përfshirë edhe projekti i ri "Rikonstruksioni i godinës së DPQ Shkodër" në vlerën 101,7 milionë lekë të programit 3140 "Policia e shteit". Konstatohet **se me celjen e buxhetit** të vitit 2017, ky projekt nuk është çelur dhe në vënd të tij është shtuar disa projekte të tjera.

Në listën e investimeve kapitale me financim të brendshëm të projekt buxhetit është përfshirë edhe projekti M160922 "Rikonstruksioni i godinës së Komisariatit Nr. 06, i Drejtorisë së Përgjithshme" në vlerën 40,3 milionë lekë të programit 3140 "Policia e shteit". Konstatohet se me çeljen e buxhetit të vitit 2017, ky projekt është celur dhe në vlerën 122,4 milionë lekë pra për 82,1 milionë lekë më shumë dhe me Aktin Normativ nr. 03, datë 06.11.2017, ky projekt është shtuar për 30,3 milionë lekë, duke kaluar në vlerën 152,8 milionë lekë. Referuar të dhënave të pagesave në SIFQ, konstatohet se kontrata në lidhje me këtë projekt është lidhur më datë 27.12.2016, pra është një **kontratë**

[Shqiptaria.com]

në vazhdim. Referuar "Regjistrit të realizimit të prokurimeve publike", të publikuar nga APP, me datë 27.01.2017, konstatohet se kjo kontratë ka një afat kohor 15 muaj. Konstatohet se, përgjatë vitit 2017, ky projekt rezulton **i realizuar në vlerën 122,4 milionë lekë.**

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë:

Konstatohet se, kontrata e projektit të investimit me kod M064079 "Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjeve urbane", i programit 6220 "Menaxhimi i mbetjeve urbane" projekt i **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë** i çelur me **Aktin Normativ nr. 03**, datë 06.11.2017, rezulton të jetë realizuar në vlerën **162,772 mijë lekë**. Referuar të dhënave në SIFQ, konstatohet se kjo kontratë është **regjistruar në dy data të ndryshme** të vitit 2017 pra e copëtuar dhe konkretisht në datën 18.12.2017 dhe datën 29.12.2017 në vlerat 55,000 mijë lekë dhe në vlerën 108,382 mijë lekë. Gjithashtu konstatohet se, kjo kontratë rezulton e regjistruar në sistem në **prill të vitit 2018** me numër 1006001-1800002 **dhe vlerë 2,258,316 mijë** lekë nën përshkrimin "Migrim nga Ministria e mjedisit kontratë vazhdim 5553/5 dt 24.10.2016", pra kjo kontratë është kontratë në vazhdim nga vitet e kaluara. Referuar sa më lart, arrihet në përfundimin se, në SIFQ, në lidhje me këtë projekt kontrata është regjistruar e copëtuar.

Për Bashkinë Gjirokastër:

Nga auditimi u konstatua se, projekti i investimit me kod M991358 Rikonstruksion i "Blv. 18 Shtatori dhe degëzimeve të rrugëve Rexhep Qosja dhe Gole Gushi" i programit "Infrastruktura vendore dhe Rajonale" rezulton të **jetë çelur dhe realizuar** në të njëjtën vlerë për **93,200 mijë lekë.** Nga auditimi i të dhënave të SIFQ-së u konstatua se, në vitin 2017 **Bashkia Gjirokastër** ka likuiduar me datë 12.12.2017, faturën nr. 34, datë 30.05.2017 në vlerën 93,200 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se kjo faturë është likuiduar edhe në vitin 2018 konkretisht në datën 08.05.2018 për vlerën **22,651 mijë lekë**. Pra referuar sa më lart konstatohet se ky investim **ka qenë një investim në proces** dhe si i tillë nuk është respektuar Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit" neni 65 citohet: "Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti mban parasysh këtë radhë prioritare: a- investimet në proces nga viti i kaluar.

e. KLSH konstaton se, **devijimet e shumta që kanë pësuar të ardhurat dhe shpenzimet që nga faza fillestare e planifikimit të tyre, deri në fazën e realizimit faktik, si dhe devijimet e shumta në mënyrën e mbulimit të financimit të deficitit buxhetor nga financim të brendshëm në atë të huaj, tregojnë për mungesë të aftësisë buxhetuese dhe menaxhuese të financave publike**. Ky fenomen është konstatuar si për zërat e shpenzimeve, ashtu edhe për të ardhurat. Në fazën e parë të PBA 2017-2019, **të ardhurat** u planifikuan në vlerën 446,775 milionë lekë, ndërkohë që me Ligjin e Buxhetit të vitit 2017, u miratuan në vlerën 436,400 milionë lekë. Me Aktin Normativ nr.3, të ardhurat u parashikuan në vlerën 442,900 milionë lekë, ndërkohë që, referuar Tabelës së Treguesve të Konsoliduar Fiskalë, u realizuan në vlerën 430,492 milionë lekë, pra 12,408 milionë lekë më pak. Mos realizimi i të ardhurave ka çuar në shkurtim **të shpenzimeve**, të cilat janë realizuar në vlerën 461,410 milionë lekë, nga 474,100 milionë lekë të planifikuara me Aktin Normativ nr.3, pra 12,691 milionë lekë më pak, ose janë realizuar në masën 98,7% nga planifikimi fillestar. **Deficiti buxhetor** gjatë për vitin 2017, ishte parashikuar në vlerën 31,200

milionë lekë dhe referuar Tabelës së Treguesve të Konsoliduar Fiskalë, është realizuar në masën 30,919 milionë lekë ose realizuar në masën 99,1%. Krahasuar me vitin 2016, deficiti buxhetor është rritur në masën 4,249 milionë lekë ose është rritur në masën 16%. Ky deficit është realizuar 6% nga financim i brendshme, kur me Ligjin Fillestar të Buxhetit duhej të ishte financuar në masën 65%. Gjithashtu rreth 66% të deficitit të përgjithshëm buxhetor është realizuar në muajin Dhjetor, në vlerë 20,385 milionë lekë nga 30,919 milionë lekë gjithsej.

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë si përgjegjëse për hartimin e dokumentit të PBA-së, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që:

-hartimi i këtij dokumenti kaq të rëndësishëm, të mos jetë një proces formal dhe në letra, por një proces efektiv i cili do të ndihmojë procesin për të kaluar drejt një buxheti kredibël.

-Së bashku me dokumentin e PBA-së së rishikuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me devijimet që kanë pësuar zërat e treguesve makroekonomik nga njëra fazë në tjetrën përmes një tabele të standartizuar.

-Vazhdimin e trajnime në shkallë të gjerë për të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore në lidhje me hartimin e dokumentit të PBA-së

-Të shikohet si **prioritet krijimi i Këshillit Fiskal**, si organ i pavarur me nivel të lartë profesional në fushën e manaxhimit të financave publike.

2. Nga Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të merren masa jo vetëm organizative por edhe disiplinore për të gjitha rastet kur cenohet saktësia e Treguesve të Konsoliduar Fiskalë, në mënyrë që të konsolidohet një praktikë e mirë drejt një buxheti që reflekton një llogari të financave publike, të besueshme, gjithëpërfshirëse, korrekte dhe të kujdesshme.

- Qeveria duhet të marrë masa për mos nxjerrjen e Akteve Normative me fuqinë e ligjit pas datës 01 Tetor të vitit ushtrimor me qëllim shmangien e risqeve të të realizimeve fiktive të shpenzimeve apo krijimin e detyrimeve të prapambetura.
- Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat e duhura për përmirësimin dhe funksionimit e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me planifikimin dhe detajimin e fondeve për investimet publike.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë të gjitha masat për përmirësimin e metodologjisë së përdorur për planifikimin e të ardhurave buxhetore në mënyrë që të eliminoje devijimet e shumta ndërmjet të ardhurave të vlerësuara në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal dhe të ardhurave të mbledhura nga Administrata Tatimore dhe Doganore.
- Në ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", të parashikohen qartë masa administrative dhe disiplinore ndaj personave përgjegjës për çelje fondesh në SIFQ jo në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit dhe PBA.

[Shqiptaria.com]

3. IMPLEMENTIMI I BUXHETIT

Zbatimi i Buxhetit të Shtetit për vitin 2017, duke u krahasuar me një vit më parë, me PBA-në në të dy fazat, me ligjin fillestar, me zërat kryesorë, rezulton si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6: Zbatimi dhe devijimet e buxhetit të shtetit të vitit 2017 *mln lekë*

	ZERAT	B. Faktik 2016	PBA / Faza I	PBA e Rishikuar	Projekt Buxheti	Ligji i Buxhetit	AN1	AN3	Buxheti Faktik 2017	Devijimi P/Fakt
		1				2			3	4=3-2
A	**TOTALI I TE ARDHURAVE**	**407,021**	**446,775**	**436,087**	**436,001**	**436,400**	**438,400**	**442,900**	**430,492**	**-5,909**
I	**Të ardhura nga ndihmat**	**14,639**	**15,100**	**15,100**	**13,800**	**13,800**	**13,800**	**13,000**	**11,085**	**-2,716**
II	**Të ardhura tatimore**	**369,884**	**405,745**	**399,057**	**397,801**	**398,200**	**400,200**	**405,500**	**398,628**	**427**
1	Nga Tatimet& Doganat	275,780	304,812	300,144	299,000	299,400	299,400	299,400	293,386	-6,015
2	Nga Pushteti Vendor	14,951	19,748	15,424	15,401	15,400	17,400	20,900	18,447	3,046
3	Nga Fondet Speciale	79,153	81,185	83,489	83,400	83,400	83,400	85,200	86,795	3,394
III	**Të ardhura Jotatimore**	**22,498**	**25,930**	**21,930**	**24,400**	**24,400**	**24,400**	**24,400**	20,778	**-3,623**
B	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**433,697**	**469,788**	**465,657**	**467,199**	**467,600**	**469,600**	**474,100**	**461,410**	**-6,191**
I	**Shpenzimet korrente**	**368,720**	**396,471**	**393,740**	**389,799**	**390,169**	**387,769**	**393,370**	**382,287**	**-7,883**
1	Personeli	67,540	72,551	72,746	74,782	74,830	75,130	74,969	72,642	-2,189
2	Interesat	36,259	47,954	46,554	42,000	42,000	37,900	37,900	31,904	-10,097
3	Shpenzime operative dhe mirembajtje	44,329	43,922	44,687	44,459	44,687	44,887	44,988	43,441	-1,247
4	Subvencione	1,725	1,600	2,170	2,330	2,330	2,330	2,339	2,310	-21
5	Shpenzime per fondet Speciale	152,591	161,109	160,609	162,100	162,122	161,522	163,322	162,146	23
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	43,580	45,835	43,674	40,828	40,900	42,900	46,400	46,487	5,586
7	Shpenzime te tjera	22,696	23,500	23,300	23,300	23,300	23,100	23,452	23,357	56
II	**Fondi Rezerve/Kontigjensa**	**0**	**4,000**	**4,300**	**1,500**	**1,500**	**2,700**	**2,400**		**-1,501**
III	**Shpenzime Kapitale**	**59,478**	**64,317**	**62,617**	**74,400**	**74,431**	**74,131**	**73,330**	**68,455**	**-5,977**
IV	**Detyrime te prapambetura**		**5,000**	**5,000**						**-1**
V	**Huadhenie neto per energjine**	**5,499**			**1,500**	**1,500**	**4,500**	**4,500**	**9,217**	**7,716**
VI	**Fond Shpronesimi 2017**						**500**	**500**	**1450**	**1,449**
	DEFICITI	**-26,676**	**-23,013**	**-29,570**	**-31,198**	**-31,200**	**-31,200**	**-31,200**	**-30,919**	**280**
	Financim i Brendshem	9,176	29,992	39,549	19,759	20,230	20,930	8,929	1,806	-18,425
	Financim i Huaj	17,500	-6,980	-9,980	11,440	10,970	10,270	22,270	29,113	18,142
	PPB		**1,637,160**	**1,606,011**	**1,596,382**	**1,596,382**	**1,596,382**	**1,555,202**		

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

3.1 MBI REALIZIMIN E TË ARDHURAVE BUXHETORE TË VITIT 2017

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, në vlerën 430,492 milion lekë, referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar dhe planifikimit fillestar të buxhetit, të analizuar sipas zërave paraqiten si vijon:

Tabela 7: Të ardhurat buxhetore 2017 dhe dinamika e tij kundrejt vitit 2016 *mln lekë*

Nr.	TOTALI TE ARDHURAVE	Fakti 2016		Plani Fillestar		Fakti 2017		Plan/Fakt	Fakti 2017
		%	1	%	2	%	3	4=3-2	5=3-1
			407,103		436,401		430,492	-5,909	23,389
I.	Te ardhura nga ndihmat	4%	14,721	3%	13,800	3%	11,085	-2,715	-3,636
II.	Te ardhura tatimore	91%	369,884	91%	398,201	93%	398,629	428	28,745
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	75%	275,780	69%	299,400	68%	293,386	-6,014	17,606
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	32%	131,390	32%	141,200	32%	139,541	-1,659	8,151
2	Tatimi mbi Fitimin	7%	29,151	7%	29,200	7%	31,645	2,445	2,494
3	Akcizat	10%	41,896	11%	46,700	10%	45,105	-1,595	3,209
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	8%	31,412	8%	36,200	7%	32,102	-4,098	690
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	9%	35,794	9%	39,700	9%	38,502	-1,198	2,708
6	Taksa Doganore	2%	6,137	1%	6,400	2%	6,492	92	355
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	4%	14,951	4%	15,400	4%	18,447	3,047	3,496
1	Takse mbi Pasurine	1%	4,678	1%	5,272	1%	4,879	-393	201
2	Biznesi i vogel	0%	598	0%	283	0%	296	13	-302
3	Taksa Lokale	2%	9,675	2%	9,846	3%	13,273	3,427	3,598
II.3	Te ardh nga fondet speciale	19%	79,153	19%	83,400	20%	86,796	3,395	7,643
1	Sigurimi Shoqeror	16%	66,688	16%	70,268	17%	74,000	3,732	7,312
2	Sigurimi Shendetsor	3%	10,820	3%	11,132	3%	11,602	470	782
3	Fondi i kompesimit te pronareve	0%	1,645	0%	2,000	0%	1,194	-806	-451
III.	Te ardhura Jotatimore	6%	22,498	6%	24,400	5%	20,778	-3,622	-1,720
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0%	1,095	0%	1,000	0%	908	-92	-187
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	4%	15,001	4%	15,470	3%	13,789	-1,681	-1,212
3	Dividenti	0%	83	0%	800	0%	178	-622	95
4	Tarifat sherbimeve	1%	2,738	1%	3,300	1%	2,332	-968	-406
5	Te tjera	1%	3,581	1%	3,830	1%	3,570	-260	-11

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

shqiptaria.com

Duke marrë në konsideratë ndryshimet që ka pësuar plani fillestar i buxhetit me Aktet Normative si dhe realizimin faktik të vitit 2016, të ardhurat kanë ndryshuar si më poshtë vijojnë:

Tabela 8: Dinamika e të ardhurave sipas kategorive kryesore *mln lekë*

Te ardhura buxhetore	Fakt 2016	Ligji Buxhetit	Akt Normativ	Fakti 2017	Diferenca	Realizimi
		1	2	3	4=3-1	
Të ardhura nga ndihmat	14,721	13,800	13,000	11,085	-2,715	80%
Nga Tatimet& Doganat	275,780	299,400	299,400	293,386	-6,014	98%
Nga Pushteti Vendor	14,951	15,400	20,900	18,447	3,047	120%
Nga Fondet Speciale	79,153	83,400	85,200	86,796	3,396	104%
Të ardhura Jotatimore	22,498	24,400	24,400	20,778	-3,622	85%
Total Të Ardhura	**407,103**	**436,400**	**442,900**	**430,492**	**-5,908**	**99%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar, konstatohet se të **ardhurat në buxhetin faktik** në vlerën **430,492 milion lekë**, sipas grupeve për vitin 2017 përbëhen:

Grafiku 12: Të ardhurat e përgjithëshme sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Pra siç shihet edhe grafikisht, të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat janë burimi kryesor i të hyrave në buxhetin e shtetit, dhe janë burimi kryesor për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve nga ana e institucioneve publike.*"Të Ardhurat nga Tatimet", për vitin 2017, në pasqyrën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë shtuar në vlerën 22,988.3 milion lekë, shifër kjo e arkëtuar nga parapagimet e subjekteve tatimpagueses për vitin 2018 dhe që përfaqëson 7,8 % të të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat, ose 5,3% të të ardhurave totale të vitit 2017.*

II. Të Ardhurat Tatimore, zënë peshën kryesore ose 93%, të të gjithë të ardhurave, në vlerë 398,629 milion lekë, kundrejt 398,200 milion lekë të planifikuara në ligjin nr. 130/2016. Pra të ardhurat tatimore janë realizuar në masën 100%. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2016, këto të ardhura janë rritur me 28,745 milion lekë më shumë ose janë rritur në masë 8% më shumë. Trendi i realizimit të të ardhurave tatimore për 6 vjet, rezulton. Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të ardhurave tatimore paraqitet.

[shqiptaria.com]

Grafiku 13: Të ardhura tatimore në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Të Ardhurat Tatimore përbëhen nga:

1. Të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat, në masën 293,386 milion lekë ose 68,2% të totalit të të ardhurave.
2. Të ardhura nga Pushteti Vendor, në masën 18,447 milion lekë ose 4,2% të totalit të të ardhurave.
3. Të ardhura nga Fondet Speciale në masën 86,796 milion lekë ose 20,2% të totalit të të ardhurave.

II.1.A Të ardhurat e buxhetit të shtetit nga doganat, janë realizuar **në vlerën 159,090 milion lekë**, referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe Treguesve Fiskalë të Konsoliduar e planifikimit fillestar të buxhetit, të analizuar sipas zërave paraqiten si vijon:

Tabela 9: Të ardhura buxhetore nga dogana *mln lekë*

Te ardhura buxhetore	Fakt 2016	Ligji Buxhetit	Akt Normativ	Fakti 2017	Diferenca	Realizimi
		1	2	3	4=3-1	
TVSH	97,539	101,100	102,517	104,586	3,486	102%
Akciza	41895	46,700	46,700	45,680	-1,020	98%
Taksë Doganore	6,135	6,400	6,400	6,491	91	101%
Taksë nacionale (renta)	2,804	2,100	2,100	2,333	233	111%
Total Të Ardhura	**148,427**	**156,300**	**157,717**	**159,090**	**2,790**	**100,9%**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Krahasuar me planin përfundimtar, të ardhurat doganore për vitin 2017, janë realizuar në masën 100.9%, pra 1,370 milion lekë më shumë, ose 2,790 milion lekë më shumë kundrejt planit fillestar.

Referuar të dhënave të mësipërme, plani fillestar i të ardhurave doganore për vitin 2017, është parashikuar në vlerën 156,300 milion lekë, i cili në krahasim me planin e të ardhurave të vitit 2016 ka pësuar rritje në masën me 0.78%, ose në vlerë absolute në shumën 1,210 milion lekë. Në planifikimin e të ardhurave sipas zërave, në krahasim me vitin e mëparshëm buxhetor, të ardhurat nga TVSH, janë planifikuar me një rritje të lehtë në masën 0.01%, ose në vlerë absolute në shumën 799 milion lekë, të ardhurat nga akciza kanë pësuar rritje në masën prej 1,09%, ose në vlerë absolute në shumën 2,047 milion lekë, ndërsa zëri i të ardhurave nga renta minerale është planifikuar me rënie në masën prej - 1,3%, ose në vlerë absolute 2,000 milion lekë.

Nga auditimi në DPD konstatohet se planifikimi i të ardhurave nuk kryhet nga vetë institucioni, por treguesit jepen të gatshëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Gjatë vitit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë bërë ndryshime me akte normative në zbatim të ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", në rritje të planit të ardhurave referuar shkresës nr.4560 prot., datë 04.04.2017, shkresës nr.4673/1 prot., datë 26.04.2017,

[shqiptaria.com]

shkresës nr. 5860 prot., datë 27.04.2017, shkresës nr.13371 prot., datë 29.09.2017, shkresës nr.13371/1 prot., datë 13.10.2017 dhe me shkresës 17544 prot., datë 04.12.2017.

Treguesit e të ardhurave doganore gjatë tre viteve të fundit, analizuar sipas zërave paraqitet si vijon:

Tabela 10: Treguesit e të ardhurave doganore gjatë tre viteve të fundit mln lekë

Te ardhura buxhetore	Viti 2015		Viti 2016		Viti 2017	
	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
TVSH	101,759	95.347	100,301	97,539	102,517	104,586
Akciza(neto)	44,900	39.027	44,653	41,895	46,700	45,680
Taksë Doganore	5,323	5.795	6,036	6,135	6,400	6,491
Taksë nacionale (renta)	4,218	3.875	4,100	2,804	2,100	2,333
Total Të Ardhura	**156,200**	**144.044**	**155,090**	**148,427**	**157,717**	**159,090**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se, vetëm në vitin ushtrimor janë realizuar të ardhurat nga doganat, me një tejkalim të lehtë prej 0.9%, ndërsa në vitet e mëparshme realizimi ka qenë nga 92% deri 95%. Të ardhurat fiskale doganore për vitin 2017, janë realizuan **10,663 milion lekë më shumë se vitin 2016,** ose rreth 6.9 % më shumë se viti i kaluar.

1. Të ardhurat nga TVSH-ja përbëjnë rreth 66% të totalit të të ardhurave doganore, kundrejt planit janë realizuar 2,069 milion lekë më shumë, ose në masën 102%, ndërsa krahasuar me vitin e kaluar janë realizuar rreth 7,047 milion lekë më shumë. Të ardhurat nga TVSH-ja sipas klasifikimit të artikujve kryesorë:

Tabela 11: Të ardhurat nga TVSH-ja sipas klasifikimit të artikujve kryesorë mln lekë

Artikulli	2017	2016	Diferenca	Në %
Energji elektrike	4,579	1,757	2,822	160.60%
Metalet Baze	9,592	7,319	2,274	31.10%
Te tjera	16,788	15,668	1,120	7.10%
Gaz	1,643	1,044	599	57.40%
Automjete te perdorura	5,510	4,941	569	11.50%
Veshje e tekstile	3,831	3,371	460	13.60%
Plastika dhe artikujt e saj	4,247	3,888	359	9.20%
Konstruksionet metalike	3,025	2,691	333	12.40%
Birre importi	1,072	828	244	29.50%
Kimikatet	2,545	2,326	220	9.40%
Cigaret	4,858	4,643	215	4.60%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Ndikim pozitiv në realizimin e të ardhurave doganore nga TVSH kanë dhënë: Energjia elektrike me 2,822 milion lekë; Metalet bazë me 2,274 milion lekë; Të tjera me 1,120 milion lekë; Autoveturat e përdorura me 569 milion lekë; Gazi i lëngët me 599 milion lekë; Veshje &Tekstile me 460 milion lekë; Plastike dhe artikujt me 359 milion lekë. *Ndërsa produktet që kanë dhënë efekt negativ kanë qenë:* Karburantet në import me 2,200 milion lekë; Kompjuterat dhe PC me 175 milion lekë; Plehëruesit me 180 milion lekë, etj.

2. Të ardhurat nga Akciza: Të ardhurat neto nga akciza u realizuan në masën 45,680 milion lekë, nga 46,701 milion lekë që ishte plani, ose rreth 1,021 milion lekë më pak, ndërsa krahasuar me faktin e vitit 2016, të ardhurat nga akciza janë 3,785 milion lekë më shumë, si më poshtë:

Tabela 12: Të ardhurat nga akciza mln lekë

Emertimi	Fakt 2016	Plan 2017	Fakt 2017	Fakt-Plan	2017-2016
Akciza Bruto	42,328	46,701	46,259	442	3,931
Rimbursime	433	-	579		146
Akciza Neto	41,895	46,701	45,680	-1,021	3,785

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

[Shqiptaria.com]

Produktet kryesorë të akcizës të cilat *kanë gjeneruar të ardhura më të larta* krahasuar me një vit më parë janë: Karburantet prodhim vend; vazi i lëngët; vigaret; birra e importit; duhani i importit; verë importi. I vetmi produkt akcize i cili ka *gjeneruar më pak të ardhura* nga akciza është karburanti i importit me minus 5,4 miliard lekë (nga operimi i rafinerisë vendase), humbje e cila është kompensuar nga të ardhurat nga akciza prodhim vendi, prej 5,4 miliard lekë. Gjatë 2017 janë dhënë 578.7 milion lekë rimbursime nga 433 milion lekë që janë dhënë në vitin 2016, ku 56% e zë rimbursimi i akcizës për biokarburantet, 42% e zë rimbursimi për serat me ngrohje, si dhe përjashtimi nga akciza i lëndëve djegëse në sektorin e peshkimit.

3.Të ardhurat nga Renta. Të ardhurat nga renta minerale janë realizuar në shumën 2,332 milion lekë nga 2,100 milion lekë që ka qënë planifikimi, ose 233 milion lekë më shumë, ndërsa krahasuar me vitin 2016 të ardhurat nga renta janë rreth 470 milion lekë më pak. Të ardhurat nga renta minerale përbëhen nga renta e naftës bruto dhe të ardhurat nga renta minerale e produkteve të tjera, që për vitin 2017 të ardhurat nga renta e naftës bruto kanë rezultuar me mosrealizim për 25.4%, ndërsa renta e produkteve të tjera me tejkalim në masën 2%.

4. Të ardhurat nga Taksa Doganore për vitin 2017, janë realizuar në masën 6.491 milion lekë nga 6,400 milion lekë që ka qënë plani i periudhës, ose 91 milion lekë më shumë dhe 356 milion lekë më shumë se një vit me parë.
Treguesit e të ardhurave doganore sipas degëve doganore për vitin 2017 paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 13: Të ardhurat sipas degëve doganore *mln lekë*

Degë Doganore	Plani	Realizimi	Diferenca	Ne %
1	2	3	4=(3-2)	5=(3/2)
Tiranë	57,083	59,540	2,457	104
Rinas	2,646	2,533	-113	96
Durrës	57,517	56,034	-1,483	97
Shkodër	4,011	4,052	41	101
Pogradec	1,519	1,632	113	107
Gjirokastër	11,546	11,523	-23	100
Korçë	551	591	40	107
Kapshticë	2,561	2,725	164	106
Vlorë	4,698	4,464	-234	95
Fier	9,776	9,591	-185	98
Sarandë	221	233	12	105
Elbasan	2,537	2,895	358	114
Lezhë	952	1,275	323	134
Berat	665	594	-71	89
Kukës	1,209	1,185	-24	98
Peshkopi	207	206	-1	99
Tri Urat	19	17	-2	92
Totali	**157,718**	**159,090**	**1,372**	100.9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Sipas degëve kryesore, rezulton se me performancë më të mirë në mbledhjen e të ardhurave paraqiten degët doganore: Tiranë me 104%, Lezhë me 134%, Elbasan me 114%, Kapshticë me 106%, etj, Ndërsa degë doganore që rezultojnë me mosrealizim të të ardhurave evidentojmë: Durrës me 97%, Vlorë me 95%, Rinas me 96%, Berat me 89%, etj.

Nga auditimet në administratën doganore në qendër dhe në degë kanë rezultuar veprime e mosveprime në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit doganor, si dhe të dispozitave tjera ligjore e nënligjore mbi bazën e të cilave e ushtron

[shqiptaria.com]

veprimtarinë, ***që kanë sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në total 2,138.8 milion lekë,*** përkatësisht: në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën 105 milion lekë, në Degën Doganore Tiranë në shumën 1,056.6 milion lekë, në Degën Doganore Fier në shumën 504.2 milion lekë, në Degën Doganore Durrës në shumën 385.9 milion lekë, në Degën doganore Vlorë në shumën 82.7 milion lekë dhe në Degën Doganore Rinas në shumën 4.4 milion lekë. Gjatë auditimeve tona ka rezultuar kjo problematikë kryesore në sistemin doganor:

1. Procedurat e vlerësimit doganor nuk kanë siguruar një sistem të drejtë, uniform dhe neutral, duke aplikuar përdorimin e vlerave doganore fiktive, arbitrare dhe të pabazuara. Nga sektori operacional por jo vetëm, me qëllim standartizimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazine, nuk është bërë një **analizë** e thelluar, referuar pikës 1, sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të MF *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme...",* mbi të cilën duhej të mbështetej kjo **analizë**. Shmangiet kryesore në sistemin e vlerësimit doganor vijnë për arsyet e mëposhtme: praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *"Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..",* nxjerrë për këtë qëllim; praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD; praktika doganore me grup artikujsh nga i njëjti eksportues për një dërgesë, të cilat janë trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0%, jo në përputhje me kërkesat e nenit 22 të Ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006, të MSA të RSH dhe KE, hyrë në fuqi më 01.04.2009; protokolli 4 lidhur me Përkufizimin e Konceptit të "Produkteve Origjinuese" dhe "Mbi rregullat e origjinës preferenciale", kushtet për lëshimin e një deklarate faturë ku citojmë: "...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€..."; nuk janë rillogaritur të sakta deklarimet doganore taksa doganore kombëtare, taksa e ambalazhit TAM; Praktika doganore të cilat edhe pse artikujt janë të kuotuar në bursë, janë trajtuar me transaksion; praktika doganore me artikuj plastik të deklaruar nën çmimin e lëndës së parë dhe praktika doganore ku artikujt me origjinë EU, të klasifikuar në kapitullin ***02*** të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave *"Mishi dhe të brendëshmet e ngrënshme të mishit"* janë trajtuar me transaksion edhe çmimi i deklaruar CIF paraqitet nën çmimin e plehut organik apo çmimi nga NEU në të njëjtën periudhë është deklaruar shumë më i lartë. ***Efektet negative financiare, kanë rezultuar gjithsej në shumën 1,417 milion lekë, nga të cilat vetëm për artikullin*** *"Mishi dhe të brendëshmet e ngrënshme të mishit", janë në vlerën* ***492 milion lekë, ose 34.7 % e totalit.***

2. Mangësi në Sistemin e mbikëqyrjes së proçedurave të ndjekura në zbatim **të ligjit për akcizat në Republikën e Shqipërisë (*produktet energjitike)*** kryesisht:
- Për operatorët ekonomik të pajisur me autorizim për Magazinë Fiskale për prodhimin e ***produkteve energjitike*** në Fier, në momentin e revokimit të autorizimit, nuk janë bërë përllogaritjet e detyrimeve të akcizës për produktet

[Shqiptarja.com]

energjitike sipas kërkesave të dispozitave ligjore me *efekt negativ financiar në shumën 212 milion lekë.*

- Konstatohen shmangie të Sistemit të mbikëqyrjes së regjimit në Magazinat e Lira në Porto Romano, Durrës, pasi nga krahasimi mes sasisë teorike të përfshirë në kontabilitetin e stokut dhe sasive reale të konstatuara nga administrata doganore, rezultuan diferenca progresive dhe 3-mujore të artikujve të importuar dhe të depozituar në këto magazina, të cilave nuk u është dhënë destinacion doganor; në proces verbalin e inventarizimit fizik mungon dokumenti i llogaritje së humbjeve dhe firove të deklaruara nga subjekti dhe të verifikuara nga administrata doganore; nga shqyrtimi i certifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor të lëshuara nga Laboratori Doganor lidhur me mostrat e marra për analizim për artikujt "karburante ", për shkak te densitetit sipas certifikatës së laboratorit doganor, rezultojnë diferenca në sasi me pasojë në pagesën e detyrimeve doganore që paguhen për mallrat *që transportohen dhe depozitohen në magazinat e lira doganore,* veprime këto, që kanë sjellë *efekte negative financiare në shumën 85.4 milion lekë.*

3. Mangësi në përllogaritjen e rentës minerare për artikullin "Naftë Bruto" në deklaratat e eksportit nga subjekti "*Bankers Petroleum" dhe* "*Transantlik Oil*" krahasuar kjo me çmimin e publikuar të Bursës së Reuters (*platts*) për artikullin "*Nafte Bruto*" sipas kushtit të lëvrimit FOB, në ***shumën prej 2,241 milion lekë.*** Nga Komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave nuk rezultojnë të publikuara të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin "Naftë Bruto" të deklaruar per eksport për mallra me origjinë nga "*Prodhimi Vendas Shqipëri*" sipas kushtit të lëvrimit FOB. Megjithëse nga Autoriteti Doganor Vlorë është kërkuar verifikim doganor për 121 praktika doganore pranë selive të kompanive pritëse ose importuese për eksportet e kryer nga subjekti "Bankers Petroleum", nuk është kryer garantimi për pjesën e detyrimit doganor të munguar që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe.

4. Mangësi në procedurat e ***mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike*** në Tiranë dhe Vlorë, si rezultat i mosrespektimit të afateve dhe sasive autorizuese që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike të përpunimit aktiv dhe pasiv me një ***efekt negative financiar në shumën 239 milion lekë.***

5. Konstatohet se niveli i borxhit doganor në vitin 2017, është në shifra mjaft të larta, ku në fund të periudhës ushtrimore detyrimet e papaguara të trashëguara janë gjithsej në shumën 23,946.5 milion lekë, ose 4,251 raste dhe që i përkasin 2,187 subjekteve. Kjo vlerë përbëhet nga detyrime doganore në vlerë 6,163.3 milion lekë, penalitete në vlerë 15,192 milion lekë dhe kamatë vonesa në vlerë 2,591.4 milion lekë. Në krahasim me treguesit e borxhit të vitit 2016, rezulton një paksim në shumën 841.3 milion lekë, kryesisht nga efekti i amnistisë fiskale sipas ligjit nr. 33/2017, datë 30.03.2017 *"Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshmme në doganë, si dhe procedurëne heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore",* nga i cili ka përfituar **896 *subjekte,*** që i përkasin **1,136 vendimeve administrative** të nxjerra nga degët doganore, me një **shumë totale 1,827,197,885 lekë.** Nivelet më të larta të borxhit doganor i kanëDegët Doganore Fier me rreth 46.56%, Tiranë 19.51%, Durrës 13.91%, Lezhë 7.36%, Vlorë 3.10%, Berat 2.14%, Korçë 1.83%, Shkodër 1.48% etj. Konstatohet se masat e marra nga DPD për mbledhjen e borxhit doganor kanë qenë të pakta dhe joefektive, si dhe ka munguar bashkëpunimi me institucionet e tjera.

II.1.B Të ardhurat e buxhetit të shtetit nga tatimet, janë realizuar **në vlerën 131,869 milion lekë**, referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Treguesve Fiskalë të Konsoliduar e planifikimit fillestar të buxhetit. Plani i të ardhurave totale për tu mbledhur nga administrata tatimore për vitin 2017 paraqitet në vlerë bruto 221.7 miliard lekë (sipas shkresës së fundit ardhur nga MFE me nr.prot 17543, datë 04.12.2017) prej të cilave rimbursimi i TVSH-së është planifikuar në shumën 16.6 miliardë lekë. Gjatë vitit 2017 plani i të ardhurave për administratën tatimore ka ndryshuar 6 herë duke u rritur në vlerë totale me 0.66 miliard lekë krahasuar me planin fillestar. Ndryshimi më i madh paraqitet në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar i cili është rritur në vlera bruto me 2.1 miliard lekë ose 10.3% ndërkohë që plan i rimbursimit është rritur me 6.6 miliard lekë gati 66% më tepër se planifikimi fillestar. Midis ndryshimeve vërehen luhatje të theksuara nga treguesit e mëparshëm. Pa ndryshim nga plani fillestar, paraqitet tatimi mbi Fitimin, Të ardhurat Personale, Taksa e Qarkullimit dhe Lojrat e Fatit. Në vijim paraqesim tabelën përmbledhëse të të Ardhurave Tatimore të realizuara dhe krahasimin me planifikimin e tyre (sipas ligjit 130/2016 datë 15.12.2016 "Për Buxhetin e Vitit 2017") si dhe krahasueshmërinë në masë dhe vlerë me të ardhurat faktike të realizuara një vit më parë (2016).

Tabela 14: Të ardhurat tatimore *mln lekë*

Te ardhurat buxhetore	Fakt 2016	Ligji i Buxhetit	Akt Normativ	Fakti 2017	Diferenca	Realizimi
		1	2	3	4=3-1	
TVSH (bruto)	42,795	50,100	55,285	48,935	-1,165	97,7%
TVSH (neto)	33,910	40,100	36,683	35,044	-5,056	87,4%
Rimbursimi i kryer	8,886	10,000	16,602	13,891	3,891	138,9%
Tatim Fitimi	29,246	29,200	29,200	31,599	2,399	108,2%
Ardhura personale	31,501	36,200	36,200	32,144	-4,056	88,8%
Taksat Nacionale	10,994	37,600	37,600	12,418	-4,676	33,0%
Taksa Qarkullimit dhe Karburantit	16,406			15,156		
Lojrat e Fatit	4,767			5,350		
Te tjera pa identifikuar	15			-		
Denimet Administrative	167			158	158	
Te Ardhurat Tatimore (neto)	127,006	143,100	141,683	**131,869**	**-11,231**	92,2%
Kontributet e Sigurimeve	74,945	78,250	80,050	82,817	4,567	105,8%
D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	**201,951**	**221,350**	**221,733**	**214,687**	**(6,663)**	**97,0%**

Në lidhje me ndryshimet në planin e të ardhurave tatimore nuk ka akt normativ, por në çdo rast ky ndryshim është shoqëruar sipas shkresave përkatëse të cituara në tabelën e mësipërme. Ndryshimi i fundit mbi të cilën DPT ka raportuar realizimin e të ardhurave për vitin 2017, është **i datës 04.12.2017.**

Tabela 15: Ndryshimet e planit 2017 *mln lekë*

Nr.	NDRYSHIMET E PLANIT 2017 nga ana e ish Ministrisë së Financave sot MFE						
	Shkresat	Nr.136	Nr.1127, 1121	Nr. 4561	Nr.5860	Nr.13372	Nr. 17543
Nr.	Datat	01,01,2017	30,01,2017	04,04,2017	27,04,2017	29,09,2017	04,12,2017
1	**Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)**	50,100	50,100	49,788	49,788	55,925	55,285
	- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	40,100	40,100	39,788	39,683	39,323	38,683
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	10,000	10,000	10,000	10,105	16,602	16,602
2	**Akciza**						
3	**Tatim mbi Fitimin**	29,200	29,200	29,200	29,200	29,200	29,200
4	**Ardhura Personale**	36,200	36,200	36,200	36,200	36,200	36,200
5	**Biznesi i Vogel**						
6	**Toka Bujqesore**						
7	**Ndertesat**						
8	**Taksat Kombëtare**	13,300	13,300	13,300	13,300	13,300	13,300
9	**Taksa Qarkullimit dhe Karburanitit**	19,300	19,300	19,300	19,300	19,300	19,300
10	**Taksa Solidaritetit**						
11	**Lojrat e Fatit**	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
12	**Te tjera pa identifikuar**						
13	**Denimet Administrative**						

B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	143,100	143,100	142,788	142,683	142,323	141,683
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	78,000	78,250	78,250	78,250	78,250	80,050
D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	221,100	221,350	221,038	220,933	220,573	221,733

Nga administrata tatimore (të ardhurat neto) konstatohet mosrealizim në mbledhjen e të ardhurave tatimore në vlerën **11,230,681 mijë lekë** ose e thënë ndryshe me mosrealizim prej 7,84 %. Pra midis planifikimit fillestar dhe faktit paraqitet një ndryshim me efekte të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Ndërmjet llojeve të tatimit të cilat kanë performancë negative veçojmë TVSH-në (neto) e cila është dhe tatimi kryesor që përcakton dhe trendin e të ardhurave tatimore me mosrealizim në masën 12,6% ose **5,055,546 mijë lekë**, e cila pasohet nga Taksa Qarkullimit dhe Karburantit (që në evidencë paraqitet si shume e tre tatimeve dhe konkretisht:TQK +TN +LF) me një realizim prej 32,923,831 mijë lekë dhe me mosrealizim në masën 12,4 % ose **4,676,169 mijë lekë** si dhe Tatimi mbi të Ardhurat Personale me mosrealizim në masën 11.2% ose **4,055,946 mijë lekë**. Kontributet e sigurimeve shoqërore rezultojnë me realizim prej 105,8 %, krahasuar me planin fillestar ose **4,567,476 mijë lekë më shumë**.

Tabela 16: Realizimi i planit në nivel DRT-je *mln lekë*

Nr.	DRT	Të ardhura Total			Të ardhura Neto			Sigurime Shoqërore		
		Fakt	Plan	Devijimi në %	Fakt	Plan	Devijimi në %	Fakt	Plan	Devijimi në %
1	Berat	3,349	3,506	-4.48%	826	962	-14.15%	2,151	2,109	1.98%
2	Diber	3,186	2,889	10.27%	1,299	1,081	20.15%	1,790	1,713	4.47%
3	Durres	12,637	12,460	1.42%	4,170	4,008	4.04%	7,247	6,952	4.24%
4	Elbasan	6,158	6,003	2.58%	1,565	2,074	-24.53%	3,786	3,684	2.76%
5	Fier	7,221	7,836	-7.84%	1,813	2,648	-31.54%	4,352	4,168	4.41%
6	Gjirokaster	2,479	2,489	-0.42%	835	836	-0.08%	1,566	1,553	0.83%
7	Korce	5,145	5,160	-0.29%	1,700	1,730	-1.76%	3,209	3,230	-0.65%
8	Kukes	1,841	1,674	9.97%	625	488	28.00%	1,177	1,131	4.07%
9	Lezhe	3,253	3,085	5.44%	1,131	1,019	11.04%	2,046	1,981	3.27%
10	Sarande	1,581	1,490	6.08%	601	636	-5.47%	945	845	11.88%
11	Shkoder	5,350	5,291	1.12%	1,494	1,366	9.38%	3,528	3,500	0.81%
12	Tirane	83,154	86,518	-3.89%	50,591	55,228	-8.40%	29,864	27,515	8.54%
13	DTM	88,524	95,234	-7.05%	63,403	67,772	-6.45%	18,462	18,992	-2.79%
14	Vlore	4,700	4,700	0.00%	1,835	1,835	-0.02%	2,696	2,677	0.71%
	Total	228,578	238,335	-4.09%	131,888	141,683	-6.91%	82,817	80,050	3.46%

Sikurse paraqitet në tabelën e mësipërme, Drejtoritë Rajonale me performancë negative në mbledhjen e të ardhurave gjatë vitit 2017 në totalin e krahasuar me planifikimin për të ardhurat tatimore janë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, DRT Fier, DRT Tiranë, DRT Berat. Tatimi mbi vlerën e shtuar paraqet

ishqiptarja.com

mosrealizim të konsiderueshëm në DRTM, DRT Fier, DRT Elbasan, DRT Durrës, DRT Tiranë. Tatimi mbi Fitimin për vitin 2017 paraqitet me realizim pozitiv kjo si rezultat edhe i ndryshimeve ligjore të ndërmarra **nga administrata tatimore lidhur me penalizimin në rast të mospagimit të kësteve mujore në afat.** Për vitin 2017 konstatohet një performancë më e mirë në mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat kanë tejkaluar planifikimin e tyre në masën 3.46%. Efekt pozitiv në realizimin e objektivave të dy zërave të mësipërm është ndikuar edhe nga ligji i faljeve i aplikuar prej DPT gjatë vitit 2017.

Konstatojmë se për shpëndarjen e planit të të ardhurave në nivel drejtorie DPT *nuk disponon një metodologji të miratuar*. Për këtë qëllim nga strukturat përkatëse është zbatuar një metodologji mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparëshme për secilën DRT, ku plani i ardhur nga Ministria e Financave shpërndahet bazuar në pjesën që zë çdo drejtori në nivel 10 vjeçar dhe 3 vjeçar për secilin zë të të ardhurave dhe Sektori Statistikës në DPT vendos variantin e tij të shpërndarjes së planit i cili më pas miratohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Grupit të Punës dhe më tej për miratim tek drejtori i Përgjithshëm. Kjo mënyrë e përdorur nga DPT merr parasysh vetëm të ardhurat faktike dhe nuk korrigjohet me asnjë element tjetër si numrin e tatimpaguesve për secilën drejtori, të ardhurat e realizuara prej tyre, qarkullimin gjithsej, investimet strategjike apo elemente të tjerë si ndryshimet në juridiksionet e subjekteve gjatë vitit për disa tatimpaguesve të mëdhenj të cilat krijojnë mosrealizime të konsiderueshme në disa DRT etj. Në gjykimin tonë kjo mënyrë shpërndarje evidenton nevojën për një qasje më të drejtë dhe transparente të planeve me akte rregullativë të mirëpërcaktuar dhe nuk mund të lihet në gjykime subjektive të cilat mund të çojnë në shpërndarje të padrejtë dhe të ndikojnë në ulje të performancës për ato drejtori të cilat efektivisht nuk mund ta realizojnë atë. Me rëndësi të lartë nga ana jonë shihet dhe *ri-shpërndarja* konform të njëjtave kritere sa trajtuar më sipër, të ndryshimeve në planin vjetor nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të cilat sa vërehet janë të shpeshta.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare, i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), për vitin 2017 janë konstatuar mangësi dhe parregullsi:

1. Konstatohet se procesi i rimbursimit të TVSH, paraqitet me thyerje të afateve dhe radhës së rimbursimit, vlera financiare të miratuara për rimbursim të cilat qëndrojnë "pezull" dhe jo në llogaritë përkatëse si dhe çertifikim i gabuar i kredive tatimore për kontratat e koncesionit përpara se Shteti Shqiptar të njohi vlerat e investimit për to. Thyerje të radhës të rimbursimit pothuajse në të gjitha rastet e pagesave në shumën **13,774 milion lekë**, kjo jo vetëm sipas afateve të parashikuara ligjore, por edhe nga data e miratimit të rimbursimit pas plotësimit të kushteve procedurale të administratës tatimore. Mosrespektimi ka ndikime të rëndësishme në marëdhëniet administratë-tatimpagues, krijon selektivitet, ekspozon njësinë drejt risqeve financiare por gjithashtu pasqyron një model aspak pozitiv në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji, ku vet administrata tatimore e cila efektivisht duhet të jet "gardian" i tij e thyen në mënyrë të vetëdijshme atë.

2. Sipas të dhënave të disponuara më datë 31.12.2017 rezultojnë 901 kërkesa të miratuara me shumën e kërkuara 22,859 milion lekë prej të cilave është miratuar

[Shqiptarja.com]

për rimbursim shuma 22,490 milion lekë ose 98.3% e shumës së kërkuar. Shuma për kompensim paraqitet 1,528 milion lekë ndërsa 20,963 milion lekë paraqet vlera e TVSH-së të miratuar të palikujduar nga ana e DPT-së. Më datë 01 Janar 2017 vlera e stokut të TVSH-së së rimbursueshme mbartur prej vitit 2016 i likujduar totalisht gjatë vitit 2017 paraqitet 4,232 milion lekë. **Pra shuma e palikujduar dhe e mbetur stok në fundin e vitit 2017, llogaritet në rreth 11,421 milion lekë.** Megjithëse kjo shumë ka plotësuar kushtet ligjore për rimbursim dhe është çertifikuar nga administrata tatimore ajo nuk rezulton e evidentuar në regjistrat e detyrimeve të DPT-së si angazhim i marrë.Vlera e mësipërme për arsye teknike në sistemin tatimor C@ts është e "ngrirë" duke e hequr kredinë nga llogaria e tatimpaguesit në këtë sistem pavarësisht se nuk është përpiluar urdhërpagesa nga ana e DPT Format nr.4 dhe likuidimi i kësaj shume ende nuk është kryer. Kjo vlerë përfaqson të drejta të subjekteve përfitues dhe detyrime të DPT ndaj tyre, por nuk pasqyrohet si detyrim i lindur dhe i kontabilizuar "de facto" prej DPT më datë 31.12.2017 por qëndron pezull në mënyrë të pajustifikuar në këtë datë duke denatyruar situatën financiare të njësisë publike por dhe të tatimpaguesit njëkohësisht.

3. Dhënien e padrejtë e rimbursimeve të TVSH në shumën **2,054 milion lekë,** në lidhje me HECET. Rimbursim në shkelje të procedurave të kontrollit për subjektet eksportues në shumën **3.5 milion lekë.**

4. Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në DPT nuk disponon informacion në nivel tatimpaguesi lidhur me borxhin në nivel tatimpaguesi dhe masat e marra nga DRT-ja përkatëse. Konstatohet se informacioni për masat shtrënguese në tërësi administrohet mbi pasqyra të përgjithshme dhe jo mbi baza individuale çka e humbet mundësinë për monitorim të drejtë dhe efikas të tyre. Legjislacioni tatimor ka një përcaktim të qartë për hapat dhe afatet që duhen ndjekur për mbledhjen me forcë të borxhit tatimor. Drejtoria e Borxhit në DPT nuk ka ushtruar funksionin e saj mbikqyrës të drejtorive respektive në DRT me informacione dhe inspektime duke mos përmbushur detyrimet e saj ligjore dhe administrative. Megjithëse borxhi midis dy datave ka një rënie prej 51.6 miliard lekë nëse do të llogarisim dy efektet e jashtme për uljen e borxhit tatimor përkatësisht

- ligjin e faljes nr.33/2017 i cil ka dhënë një efekt prej 49,8 miliard lekë por edhe dhe
- borxhin tatimor i pretenduar si i transferuar (i fshirë nga rregjistrat e borxhit të DPT) prej **12,367 milion lekë**,

Vlera e borxhit tatimor në fundin e vitit 2017 paraqitet 15.6 miliard lekë ose **10 miliard lekë më tepër se gjendja e trashëguar prej vitit 2016**. Pra stoku i borxhit si rezultat i administrimit dhe mbikqyrjes të DPT, zhveshur kjo nga efekti i jashtëm, paraqitet me rritje në masën 7 pikë përqindje në raport me borxhin e fund vitit 2016 duke zënë rreth 1/10 e borxhit në fund të vitit 2017.

5. Në vlerësimin e situatave me mospërputhje në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit (2017), për subjektet që kanë kryer transaksione gjatë vitit ushtrimor, në kundërshtim me ligjin e procedurave tatimore. Vetëm për një subjekt i cili është në Top-listën e debitorëve, ka një borxh të fshehur dhe njëkohësisht një vlerë të munguar të Tatim Fitimit, për vitin 2017 në shumën **5,723 milion lekë**.

6. Struktura të Hetimit Tatimor të cilat kryejnë funksione që bine ndesh me sa pretendohet me hetim tatimor. Ka një moskuptim apo keqfunksionim duke zhvendosur vëmendjen nga zbulimi i skemave të mashtrimit drejt rolit të

lensipteria.com

thjeshtuar të vizitave tatimore. Problematika e kësaj strukture shikohet që në mënyrën e konceptimit dhe frymës së veprimit të strukturave që operojnë në to.

II.2.Të ardhura nga Pushteti Vendor janë realizuar për 18,447 milion lekë, kundrejt 15,400 milion lekë të planifikuar sipas planit fillestar, ose realizuar në masën 19,8%, ose më shumë për 3,047 milion lekë. Trendi i realizimit të këtyre të ardhurave për 6 vjet rezulton si vijon:

Tabela 17: Të ardhurat e pushtetit vendor *mln lekë*

Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Të ardhurat e pushtetit vendor	10,859	10825	12,447	11,700	14,951	18,447
Dif. nga viti i mëparshëm	-932	-34	1,622	-747	3,251	18,447
Në % nga viti mëparshëm	92%	100%	115%	94%	128%	123%

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të Ardhurave nga Pushteti Vendor paraqitet:

Grafiku 14: Të ardhurat e pushtetit vendor në vite *mln lekë*



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

II.3. Të ardhura nga Fondet Speciale, të cilat janë realizuar për 86,796 milion lekë, kundrejt 83,400 milion lekë të planifikuar, ose realizuar planin në masën 104,1%, pra 3,393 milion lekë më shumë. Trendi i realizimit të këtyre të ardhurave për 6 vjet paraqitet si në vijim.

Grafiku 15: Të ardhura nga fondet speciale në vite

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

III. Të Ardhurat jo Tatimore janë të ardhura që zënë 4,8 % të të ardhurave gjithsej, ose 20,778 milion lekë, kundrejt 24,400 milion lekë të planifikuara, realizuar në masën 85,2%, ose 3,622 milion lekë më pak. si në vijim: Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të këtyre të ardhurave për 6 vjet rezulton:

Grafiku 16: Të ardhura nga fondet speciale në vite

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Të ardhura nga Banka e Shqipërisë (Fitimi neto i BOA)

[Shqiptaria.com]

Fitimit neto i Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, ka rezultuar në vlerë **908,214 mijë lekë** dhe është derdhur në buxhetin e shtetit, në llogarinëe Unifikuar të Thesarit (TSA) "Depozitë qeverie", sipas kritereve ligjore dhe brenda afatit të përcaktuara në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar. Për çdo vit financiar, fitimi neto i Bankës së Shqipërisë llogaritet pasi të zbriten nga të ardhurat shpenzimet e bëra për vitin financiar dhe pas veçimeve për borxhe të dyshimta e pa shpresë arkëtimi, masën e zhvlerësimit të mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë, si dhe kontributin për fondet e pensionit të personelit; shpenzimet e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës për qëllime të tjera që konsiderohen si të nevojshme për Bankën e Shqipërisë. **Trendi i realizimit të fitimit neto** të Bankës së Shqipërisë, ka ardhur **çdo vit në ulje**, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 18: Fitimi neto i BOA *mln lekë*

Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Fitimi neto i BOA	6, 433	3,031	1,350	1,895	908	900
Dif. në vlerë nga viti i mëparshëm		-3402	-1681	545	-987	-8
Dif. në % nga viti mëparshëm		-53%	-55%	+40%	-52%	-0.9%

Rezultati financiar, përfituar nga shuma e të ardhurave neto, minus shpenzimet administrative, e duke zbritur nga ky rezultat edhe shpenzimet për provigjione dhe sistemime për vitet 2016 dhe 2017, me zëra të ardhurash dhe shpenzimesh dhe difereca midis tyre, ka rezultuar sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 19: Të ardhurat dhe shpenzimet *mijë lekë*

	Të ardhurat dhe shpenzimet	2016	2017	Dif. (17-16)
1	Të ardhura neto nga interesat (të ardhura-shpenz)	1,757,340	1,925,191	167,851
2	Të ardhura neto nga tarif. e kom. (të ardhura-shpen)	13,466	27,102	13,636
3	Të ardhura neto nga operacionet bankare	1,515,685	1,334,294	-181,391
I	**Shuma e të ardhurave neto** (1+2+3)	**3,286,492**	**3,286,587**	**95**
II	**Totali i shpenzimeve Administrative**	**2,304,481**	**2,356,793**	**52,312**
III	**Të ardhurat neto-fitimi bruto (I-II)**	**982,011**	**929,794**	**-52,217**
IV	**Shpenzime për provigjone dhe sistemime**	**73,797**	**29,304**	**-44,493**
1	Shpenz neto për provigj (shtesa minus rimarje)	73,797	15,358	-58,439
2	Shpenzime për sistemime të tjera	0	13,946	13,946
	Fitimi neto (III-IV)	**908,214**	**900,491**	**-7,723**

Burimi: Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhëna të mara nga subjekti i audituar.

Të ardhurat neto janë ritur në vitin 2017 me 95 mijë lekë, ose afërsisht sa niveli i vitit 2016. Shpenzimet administrative janë ritur me 52,312 mijë lekë, ose 2.3% më shumë se viti 2016. Fitimi bruto ka rezultuar **më pak** për 52,217 mijë lekë, ose 5.3% më pak se viti 2016. **Fitimi neto** (minus provigjione dhe sistemime) ka rezultuar më pak për 7,723 mijë lekë, ose 0.9% më pak se viti 2016.

***a**. Fitimit neto i Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, ka rezultuar në vlerë **908,214 mijë lekë** dhe është derdhur në buxhetin e shtetit, në llogarinë e Unifikuar të Thesarit (TSA) "Depozitë qeverie", sipas kritereve ligjore dhe brenda afatit të përcaktuara në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", pra brenda 4/ mujorit të parë të vitit 2017.*

***b**. Për vitin 2017, megjithëse të ardhurat neto janë në të njëjtin nivel sa të ardhurat e vitit 2016, shpenzimet administrative janë ritur me 2.3%, ose më shumë për 52,312 mijë lekë, si rezultat dhe fitimi bruto është më i vogël se ai i vitit 2016 për 5.3%, apo 52,217 mijë lekë në pak.*

***c.** Provigjionet neto në vitin 2017 janë llogaritur, njohur e kontabilizuar për 15,358 mijë lekë në krahasim me 73,797 mijë lekë njohur, miratuar e*

shqiptaria.com

kontabilizuar në vitin 2016, pra njohur dhe miratuar më pak për 58,241 mijë lekë, ose 79% më pak se në vitin 2016.
***d**. Shpenzime për sistemime e rezerva janë miratuar e kontabilizuar në vitin 2017 për 13,946 mijë lekë, ndërsa një vit në parë nuk ka miratime të tilla.*

Derdhja e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë në buxhetin e shtetit për vitin 2017, është bërë sipas kritereve ligjore dhe brenda afatit në shumën 908,214 mijë lekë. Ajo që konstatohet nga auditimi është sembështetur në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 19, datë 15.03.2018 "Për rialokimin dhe Alokimin e disa prej Rezervave të BSH", është miratuar që shuma prej 2,505 milion lekë në llogarinë "Rezerva nga Godinat" do të përdoret për mbulimin e vlerës së amortizimit vjetor shtesë të ndërtesave, duke u pakësuar cdo vit me këtë vlerë kundrejt fitimit për tu shpërndarë, deri sa të shkojë drejt zeros. Edhe pse për vitin 2017, BSH i ka transferuar qeverisë shumën prej rreth 52 milion lekë, konstatojmë se, shpërndarja e shumës rreth 80 milion lekë sa i takon rimarrjes në të ardhura, nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, për Buxhetin e Shtetit (rreth 40 milion lekë/vit) e ndërprerë që nga viti 2015[1], ka vijuar edhe këtë vit të mos jetë subjekt miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe likuidimi i saj është shtyrë në kohë. Pra në këtë gjykim, Buxhetit të Shtetit duhej t'i transferoheshin të paktën edhe 80 milion lekë për vitet 2015 dhe 2016.

Një pjesë e të ardhurave nga privatizimi të krijuara përgjatë vitit 2017 nuk kanë shkuar për kryerjen e investimeve kapitale sipas kufizimeve të vendosura në Ligjin e Buxhetit, por kanë financuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt privatizimin në shumën 90,396 mijë lekë. KLSH ka konstatuar se të ardhurat nga privatizimi në shumën 407,015 mijë lekë janë përdorur në shumën 90,396 mijë lekë, ose në masën 22% për shlyerjen e vendimeve gjyqësore me objekt çështjet e privatizimit.

Ky konstatim u analizua në drejtim të praktikave të shoqëruara me autorizimin për përdorimin e të ardhurave nga privatizimi dhe kërkesën për rritje të autorizuar të përdorimit të këtyre të ardhurave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.02.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar"*, ku është vendosur kufizimi për përdorimin e të ardhurave nga privatizimi, citojmë pikën 2 të nenit 4/1 "Parimet dhe rregullat fiskale", ..."*Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor.* ***Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike."***

[1] Konstatuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, për vitin 2016

[Shqiptaria.com]

3.2 SHPENZIMET BUXHETORE

Referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar, konstatohet se **shpenzimet e buxhetit faktik** në vlerën **461,410 milion lekë**. Niveli i realizimit të shpenzimeve sipas zërave, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 20: Realizimi i shpenzimeve *mln lekë*

Nr.	E M E R T I M I	Fakt 2016	Ligji 130/2016	AN 03+VKM	Realizimi 2017	Plan Fakt 2017	Fakt 2017/Fakt 2016	Realizimi %
		1	2	3	4	5=4-2	6=4-1	7
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**433,773**	**467,600**	**474,101**	**461,410**	**-6,190**	**27,637**	**98.71%**
I.	**Shpenzime Korrente**	**368,720**	**390,169**	**393,591**	**382,287**	**-7,882**	**13,567**	98.02%
1	**Personeli**	**67,540**	**74,830**	**74,166**	**72,642**	**-2,188**	**5,102**	97.08%
	Paga	58,215	58,640	63,856	62,581	3,941	4,366	106.72%
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	9,325	10,290	10,310	10,061	-229	736	97.77%
	Fondi i vecante i pagave	0	400					
	Politika te reja pagash		5,500					
2	**Interesat**	**36,259**	**42,000**	**37,900**	**31,904**	**-10,096**	**-4,355**	75.96%
	Te Brendshme	25,526	25,100	22,000	21,415	-3,685	-4,111	85.32%
	Te Huaja	10,733	12,900	11,900	10,489	-2,411	-244	81.31%
	Kontigjence per risqet e borxhit		4,000	4,000		-4,000	0	0.00%
3	**Shpenzime Operative**	**44,329**	**44,687**	**44,303**	**43,441**	**-1,246**	**-888**	97.21%
4	**Subvecionet**	**1,725**	**2,330**	**2,354**	**2,310**	**-20**	**585**	99.14%
5	**Shpenzime per fonde speciale**	**152,591**	**162,122**	**164,405**	**162,146**	**23**	**9,554**	100.01%
	Sigurime Shoqerore	114,276	117,600	121,200	119,081	1,481	4,805	101.26%
	politika te reja pensionesh	0	2,600		0	-2,600	0	0.00%
	Sigurime Shendetsore	34,796	38,122	39,405	39,090	968	4,294	102.54%
	shpenzim per kompensim pronaresh	3,519	3,800	3,800	3,974	174	455	104.58%
6	**Shpenzime per Buxhetin Vendor**	**43,580**	**40,900**	**46,816**	**46,487**	**5,587**	**2,907**	113.66%
7	**Shpenzime te tjera sociale**	**22,696**	**23,300**	**23,646**	**23,357**	**57**	**661**	100.24%
	Pagesa e Papunesise	691	800	536	345	-455	-346	43.13%
	Ndihma Ekonomike	20,026	20,500	20,758	20,714	214	688	101.04%
	Kompesim per shtresat ne nevoje	1,979	2,000	2,352	2,298	298	319	114.90%
8	**Trensferime kapitale**			0	**169**	169	169	
II.	**Fondi Rezerve,Kontigjenca**	0	**1,500**	**98**	**0**	**-1,500**	**0**	**0**
	Fondi Rezerve		1,000	98		-1,000	0	0.00%
	Rezerve per reformen ne drejtesi		500			-500	0	0.00%
III	**Shpenzime Kapitale**	**59,452**	**74,431**	**73,462**	**68,455**	**-5,976**	**9,003**	92.10%
	Financimi Brendshem	39,118	46,661	48,192	45,589	-1,072	6471	97.70%
	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	626	1,000	700	588	-412	-38	58.80%
	Financimi Huaj	20,334	26,770	24,570	22,278	-4,492	1,944	83.22%
	Per sektorin e energjise:	3,390				0		
	Huadhënie Neto	**5,601**	**1,500**	**5,500**	**9,217**	**7,717**	**3,616**	
	Hua e dhene per energjine	2,250	1,500	5,500	5,511	4,011	3,261	
	te tjera	3,351			3,706	3,706	355	
V	**Fondi I shpronesimeve**			**1450**	**1,450**	**-1,450**		

Burimi: Ministria e Finanvave dhe Ekonomisë

Grafiku 17: Shpenzime të përgjithëshme sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1. Shpenzimet korrente: janë shpenzimet për personelin, për interesat, shpenzimet operative të mirëmbajtjes, shpenzimet për subvencionet, shpenzimet për fondet speciale, shpenzime për buxhetin e pushtetit vendor

[shqiptaria.com]

dhe shpenzimet e tjera, të cilat zënë rreth 82% të shpenzimeve të planifikuara gjithsej dhe 82,9% të shpenzimeve faktike gjithsej**.** Kështu shpenzimet korrente janë realizuar në vlerë **382,287 milion** lekë, nga 390,169 milion lekë të planifikuara sipas ligjit nr. 130/2016, ose realizuar në masën 98,2% me një mosrealizim kundrejt planit me 7,882 milion lekë, ose 2% më pak se plani. Grafiku në vijim paraqet ecurinë e Shpenzimeve korente në vite.

Grafiku 18: Shpenzimet korrente në vite *mln lekë*



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

1.1 Shpenzimet e Personelit janë realizuar në masën 97,08% pra në vlerë 72,642 milion lekë kundrejt 74,830 milion lekë e planifikuar dhe 67,540 milion lekë realizuar një vit më parë. Pra këtë vit kemi një mos-shpenzim në këtë zë prej 2,188 milion lekë (ose rreth 2,9%), krahasuar me planin. Trendi i realizimit të shpenzimeve të personelit për 6 vjet, rezulton si vijon:

Grafiku 19: Shpenzime personeli në vite *mln lekë*



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë vitit 2017 janë realizuar 5,102 milion lekë më shumë për personelin, se në vitin 2016 ose 7,5% më shumë.

a.Shpenzimet për pagat janë pjesë e rëndësishme e shpenzimeve të personelit dhe janë realizuar në masën 106,72%, ose 3,941 milion lekë më shumë, pra janë realizuar në vlerë 62,581 milion lekë nga 58,640 milion lekë të planifikuara.

b.Kontributi i sigurimeve shoqërore është realizuar në masën 97,7%, ose 229 milion lekë më pak, pra janë realizuar në vlerë 10,061 milion lekë nga 10,290 milion lekë të planifikuara.

2. Shpenzimet për interesat zënë 6,8% të shpenzimeve të planifikuara fillimisht dhe 6.9% të shpenzimeve faktike. Ato janë realizuar për 31,904 milion lekë, nga 42,000 milion lekë të planifikuara dhe 36,259 milion lekë realizuar një vit më parë. Pra ky zë rezulton i realizuar në masën 76% ndaj planit, me një mosrealizim kundrejt planit prej 10,096 milion lekë. Trendi i realizimit të shpenzimeve për interesat për 5 vjet, rezulton si në vijim:

[Shqiptarja.com]

Grafiku 20: Shpenzimet për interesat



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë vitit 2017, këto shpenzime janë realizuar më pak se në vitin 2016 për 4,355 milion lekë, ose rreth 12% më pak. Shpenzimet për interesa përbëhen nga 67% ose 21,415 milion lekë interesa të brendshme dhe 33% ose 10,489 milion lekë interesa të huaja.

2.1. Shpenzimet për interesat e brendshme janë realizuar për 21,415 milion lekë, nga 25,100 milion lekë të planifikuara dhe 25,526milion lekë realizuar një vit më parë, ose realizuar në masën 85,32% me një mosrealizim kundrejt planit me 3,685 milion lekë.

Grafiku 21: Shpenzimet për interesat e brendshme



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

2.2. Shpenzimet për interesat e huaja janë realizuar për 10,489 milion lekë, nga 12,900 milion lekë të planifikuara, ose realizuar në masën 881,3% me një mosrealizim kundrejt planit me 2,411 milion lekë. Në krahasim me vitin 2016, konstatohet një pakësim në shpenzimet për interesat e borxhit të huaj prej 888milion lekë.

3.Shpenzimet operative të mirëmbajtjes zënë 9,3% të shpenzimeve të planifikuara dhe 9,4% të shpenzimeve faktike. Në këtë zë, përfshihen të gjitha shpenzimet e tjera korrente të institucioneve publike, që nuk janë paga për personelin, por të domosdoshme për funksionimin e institucionit dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarin. Gjatë vitit 2017, ato janë realizuar për 43,441 milion lekë, nga 44,687 milion lekë të planifikuara dhe 44,329 milion lekë realizuar një vit më parë. Këto shpenzime në vitin 2017 janë realizuar për 888 milion lekë më pak se në vitin 2016, ose rreth 2% më pak.

4.Shpenzimet për Subvencionet zënë 0.5% të shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara. Ato janë realizuar për 2,310 milion lekë, nga 2,330 milion lekë të planifikuara dhe realizuar 99,1% me një mosrealizim kundrejt planit me 20 milion lekë.

5.Shpenzimet për fondet speciale zënë 34,7% të shpenzimeve të planifikuara dhe 35,1% të shpenzimeve faktike. Ato janë realizuar për 162,145 milion lekë, nga 162,122 milion lekë të planifikuara dhe 152,591 milion lekë realizuar një vit më parë, ose realizuar në masën 100% Trendi i realizimit të shpenzimeve Fondeve të veçanta për 5 vjet, rezulton kështu:

lsnipteria.com

Grafiku 22: Shpenzimet për fondet speciale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në vitin 2017 këto shpenzime janë realizuar 9,554 milion lekë më shumë se në vitin 2016, ose 6,2% më shumë.

5.1. Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar për 119,081 milion lekë, nga 117,600 milion lekë të planifikuara dhe 114,276 milion lekë realizuar një vit më parë, ose tejkaluar planin në masën 101,2% , ose me 1,481 milion lekë më shumë.

5.2. Shpenzimet për sigurimet shëndetësore janë realizuar për 39,090 milion lekë, nga 38,122 milion lekë të planifikuara dhe 34,798 milion lekë realizuar një vit më parë ose realizuar në masën 102,54% me një realizim kundrejt planit me 968 milion lekë.

5.3. Shpenzimet për kompensimin e pronarëve janë realizuar për 3,974 milion lekë, nga 3,800 milion lekë të planifikuara dhe 3,519 milion lekë realizuar një vit më parë, ose realizuar në masën 104,58% me një tejkami kundrejt planit me 174 milion lekë.

6.Shpenzime të tjera sociale, zënë 5% të shpenzimeve të planifikuara dhe po 5,1% të shpenzimeve faktike. Ato janë realizuar për 23,357 milion lekë, nga 23,300 milion lekë të planifikuara dhe 22,696 milion lekë realizuar një vit më parë, ose realizuar në masën 100%. Në vitin 2017 këto shpenzime janë realizuar më shumë se në vitin 2016 për 661 milion lekë, ose 2% më shumë.

7. Shpenzimet e buxhetit vendor. Për vitin 2017, sipas treguesve fiskalë të konsoliduar janë raportuar shpenzime për buxhetin vendor të realizuara në shumën 46,487 milion lekë nga 46,400 mijë lekë të planifikuara me sipas Aktit Normativ nr.3 dhe 46,816 milion lekë pas shpërndarjes së Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës. Trendi i shpenzimeve vendore rezulton në rritje, konkretisht gjatë vitit 2017 ky zë është rritur me 6,7 % krahasuar me vitin 2016.

Grafiku 23: Shpenzime të pushtetit vendor



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet Kapitale janë realizuar në vlerën **68,455 milion lekë** nga 74,431 milion lekë të planifikuara sipas buxhetit fillestar ose janë realizuar në masën 92 %. Grafiku në vijim Grafiku në vijim paraqet trendin e realizimit të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm dhe të Huaj në 5 vitet e fundit.

[shqiptarja.com]

Grafiku 24: Shpenzimet kapitale në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzime kapitale me financim të brendshëm Trendi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar rezulton në rritje. Konkretisht gjatë vitit 2017, ky zë është rritur me 18 % krahasuar me vitin 2016. Grafiku në vijim paraqet trendin e realizimit të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm në 5 vitet e fundit.

Grafiku 25: Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm mln lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzime kapitale me financim të huaj Financime të huaja, konsiderohen të gjitha ato burime financiare, që i jepen Qeverisë Shqiptare, ose institucioneve të tjera qeveritare, në formën e kredive ose ndihmave (grante) nga institucione financiare ndërkombëtare, qeveritë e vendeve të ndryshme, institucione apo organizma jopublike. Të gjitha të ardhurat nga huatë dhe grantet kur lëvrimi i tyre bëhet nëpërmjet transferimit të parave, kanalizohen nëpërmjet *llogarive speciale* të hapura në emër të Ministrisë së Financave për çdo projekt në Bankën e Shqipërisë. Llogaritë speciale nuk janë llogari pagesash, por vetëm për kanalizimin dhe regjistrimin e disbursimeve nga financimet e huaja. Njësitë e zbatimit paraqesin një kërkesë në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit për çeljen e një llogarie speciale në Bankën e Shqipërisë. Kërkesa për hapjen e llogarisë speciale shoqërohet me vendimin e të Këshillit të Ministrave i cili bën miratimin e marrëveshjes së grantit ose ligjin që ka ratifikuar marrëveshjen e kredisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me propozim të Ministrisë së linjës, njofton donatorin/kreditorin për personat e autorizuar për tërheqjen e fondeve nga kredia/granti.

Të gjitha transaksionet që lidhen me financimet e huaja, regjistrohen dhe raportohen nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të cilat janë në rolin e agjencive zbatuese, që nga momenti i nënshkrimit te tyre, lëvrimit, përdorimit dhe shlyerjes se tyre. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore nëpërmjet njësive të zbatimit të projekteve, janë te detyruara të raportojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të gjitha të dhënat e kërkuara brenda afateve të caktuara. Për njësitë e zbatimit që zgjedhin skemën e pjesshme të thesarit me kërkesë të njësive të zbatimit bëhet transferimi i fondeve nga llogaria speciale në Bankën e Shqipërisë, në llogarinë operative në bankat e nivelit të dytë të hapura për zbatimin e projektit. Për projektet me skemë të plotë të thesarit me mbërritjen e fondeve në llogaritë speciale, me kërkesën e

Shqiptaria.com

njësive të zbatimit bëhet kalimi pjesor ose total i vleftave nga llogaria speciale, në llogarinë e depozitës së qeverisë, në zërin "Financime të huaja".

Disbursime: konsiderohen të gjitha të ardhurat (hyrjet në para ose në natyrë) nga çdo donator ose kreditor në favor të projektit përkatës. Disbursime direkte: konsiderohen të gjitha të ardhurat që vijnë fizikisht në vendin tonë.

Disbursime indirekte: konsiderohen të gjitha të ardhurat disponibël që adresohen për llogari të projektit e shpenzohen direkt nga donatori ose kreditori pa u bërë hyrje në Shqipëri. Këto lloj të ardhurash janë në çdo rast të barabarta me shpenzimet indirekte.

Trendi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar rezulton në rritje. Konkretisht gjatë vitit 2017, ky zë është rritur me 9,5 % krahasuar me vitin 2016. Grafiku në vijim paraqet trendin e realizimit të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm në 5 vitet e fundit.

Grafiku 26: Shpenzimet kapitale me financim të huaj mln lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në një analizë më të detajuar në terma të realizimit mujor të shpenzimeve për investime, rezulton se pjesa më e madhe e investimeve kapitale është përqendruar në muajin dhjetor. Grafiku në vijim paraqet realizimin mujor të investimeve kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj për vitin ushtrimor 2017.

Grafiku 27: Realizimi i shpenzimeve kapitale sipas muajve *mln lekë*



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit të shtetit nëpërmjet raportimit të treguesve fiskalë të realizuar, rezultoi se:

1.a. Letër Kreditë-të në mbyllje të vitit ushtrimor përdoren për mos djegien e fondeve dhe njëkohësisht për të rritur fiktivisht zërin Investime Kapitale në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar në vlerën 211,049 mijë lekë.

Në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, konstatohet se, për vitin 2017 është ulur përdorimi i letër kredisë në krahasim me vitet e shkuara. Nga auditimi me përzgjedhje i kampionit të të dhënave të investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara për vitin 2017 të regjistrua në SIFQ, konstatohen se, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe SHIK, kanë përdorur Letër

[Shqiptaria.com]

Kredi për realizimin e investimeve dhe shpenzimeve operative në periudhën e fundit të vitit dhe konkretisht në periudhën 28-31 Dhjetor 2017.

-për likuidimin e projekteve të investimit në vlerën **198,674 mijë lekë** për kontrata e lidhura në datën **28 dhe 29 dhjetor të vitit 2017** për projekte të cilat nuk rezultojnë të kenë kaluar procedurat e miratimit të investimeve publike si dhe të mos jenë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit 2017. Përdorimi i L/C tregon se kemi të bëjmë pagesën e një garancie të vlerës së investimit të pritshëm dhe jo me një investim të realizuar siç është raportuar nga ana e ministrive duke deformuar në këtë mënyrë Tabelën e Treguesve Fiskalë në zërin "Shpenzime Kapitale".

-për likuidimin e shërbimeve operative në vlerën **12,375 mijë lekë** (Ministria e Mbrojtjes) për kontrata e lidhura në datën **28 dhe 29 dhjetor të vitit 2017.** Megjithëse kjo vlerë rezulton të jetë gjendje në BNII, në Tabelën të Konsoliduar Treguesve Fiskalë kjo vlerë është shprehur si e realizuar në zërin e Shpenzimeve Operative.

Konstatohet se, për vitin 2017, me LC nuk është bërë asnjë pagesë nga bankat e nivelit të dytë, pra gjendja e llogarisë në këto banka duhet të ishte e barabartë me vlerën totale të LC-së së përdorur pra 211,049 mijë lekë. Referuar të dhënave në SIFQ, konstatohet se, shtesa në bankat e nivelit të dytë në muajin dhjetor 2017, si rrjedhojë e përdorimit të LC-së për vitin 2017 është në vlerën **23,962 mijë lekë** pra për **187,087 mijë lekë më pak.** Kjo pasi pagesat e LC-së janë kryer në muajin Janar 2018 duke përdorur fondet buxhetore të vitit 2017, ndërkohë në SIFQ regjistrimi i hyrjes në Bankat e Nivelit të II-të së kësaj vlere, është regjistruar në vitin 2018 pra do të raportohet në të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme në zërin "Të tjera" të burimeve të brendshme të financimit të këtij viti. Në udhëzimin nr. 8, datë 13/01/2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017", të Ministrit të Financave, citohet :"Gjendja me 31 dhjetor e llogarive të veçanta në pronësi të njësive shpenzueses të qeverisjes së përgjithshme që krijohen nga përdorimi i formës së pagesës me Letër Kredi si më sipër raportohet në të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar të qeverisjes së përgjithshme në zërin "Të tjera" të burimeve të brendshme të financimit.

1.b. Nga auditimi me përzgjedhje i kampionit të marrë konstatohet se, për vitin 2017, janë angazhuar fonde të planifikuara si investime për kryerjen e shpenzimeve operative si, shpenzime për paga dhe sigurime, shpenzime postare, të telefonisë celulare, shpenzime udhëtimi, dieta etj në vlerën 1,536,083 mijë lekë.

2b.1. Shumat e **deklaruara si investime kapitale me financim të brendshëm** në vlerën **77,605 mijë lekë** janë të angazhuara **në shpenzime operative,** duke rritur llogarinë e investimeve në proces si pasojë e klasifikimit jo të duhur në llogarinë kontabël, sipas përshkrimit të bërë nga njësitë e zbatimit të projekteve. Shpenzimet operative të lartpërmendura nuk kontribuojnë në krijimin e një aktivi, duke qenë se nuk plotësohen kushtet për njohjen e një aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar. Në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me krijimin e aseteve të paprekshme si studime ose kërkimore patenta, software, licenca. Referuar pagesave të regjistruara në databazë-n e SIFQ, nga auditimi me përzgjedhje te kampionit konstatohet se**,**

Në zërin 230 "Shpenzime për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuara", janë përfshirë pa të drejtë në vlerën **10,739 mijë lekë**, pagesa të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e **shpenzimeve operative**.
Në zërin 231 "Shpenzime për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara", janë përfshirë pa të drejtë në vlerën **66,866 mijë lekë**, pagesa të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e **shpenzimeve operative**.
2b.2. Shumat e **deklaruara si investime kapitale** me financim të huaj në vlerën **1,458,478 mijë lekë** janë të angazhuara në **shpenzime operative,** duke rritur llogarinë e investimeve në proces si pasojë e klasifikimit jo të duhur në llogarinë kontabël, sipas përshkrimit të bërë nga njësitë e zbatimit të projekteve.

Konstatohet se**:**

Treguesit e investimeve kapitale me Financim të Huaj**/**Kredi janë mbivlerësuar në masën **706,186 mijë lekë.**
Treguesit e investimeve kapitale me Financim të Huaj**/**Grande janë mbivlerësuar në masën **752,376 mijë lekë.**

1.a Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të ushtojë kontrollet mbi ministritë e linjës dhe të marrë masat e nevojshme, në mënyrë që, Letër Kredia të mos deklarohet si nje investim i realizuar në momentin e pagesës, por në momentin e realizimit faktik të investimit. Në mënyrë që të përmirësohet informacioni në lidhje me shpenzimet kapitale, KLSH rekomandon:
1.b Ministri i Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme për nxjerrjen e një udhëzimi, në të cilin të përcaktohet qartë se çfarë duhet të trajtohet si projekt investimi. Gjithashtu ky udhëzim duhet të obligojë institucionet buxhetore që gjate planifikimit të projekteve të paraqesin ndaras edhe koston operative gjate realizimit të projektit dhe pas përfundimit të projektit. Fuqizimin e mëtejshëm të rolit të Drejtorisë së Buxhetit pranë MFE, në vlerësimin e projekteve dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe krijimin e një mekanizmi për kontrollin e cilësisë të të dhënat të projekteve kapitale.

2: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit të shtetit nëpërmjet raportimit të treguesve fiskalë të realizuar, rezultoi se në SIFQ në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar janë kryer pagesa në vlerën 26,921 mijë lekë pas datës 31 janar 2018. Konstatohet se**,** nga SIFQ, në kundërshtim me LOB, më datë **01.02.2018,** në lidhje me investimet publike me financim të brendshëm janë kryer pagesa në **vlerën 11,952 mijë lekë** dhe me datë **05.02.2018,** në lidhje me investimet publike me financim të brendshëm janë kryer pagesa në **14,969 mijë lekë.**

2: Strukturat Drejtueses të Ministri i Financave dhe Ekonomisë të marrë të gjitha masat e nevojshme për nxjerrjen e përgjegjësive për këto veprime.

3.Nga auditimi u konstatua se, të gjitha transaksionet të cilat lidhen me financimet e huaja, që nga momenti i nënshkrimit te tyre, lëvrimit, përdorimit dhe shlyerjes se tyre janë regjistruar dhe raportuar nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore bazuar në udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003, "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e Financimeve të Huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj" ndërkohë që ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008
a. Konstatohet se, ky udhëzim është në zbatim të ligjit organik të buxhetit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" ndërkohë që ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr.

[Shqiptaria.com]

9936**,** datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar. Gjithashu në udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e Financimeve të Huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj" citohet: "Celja e fondeve të financimeve të huaja bëhet në zërin investime, por ndjekja dhe regjistrimi kryhet nga njësia e zbatimit dhe nga dega e thesarit, sipas natyrës së shpenzimit"

b. Në nenin 69, të udhëzimit nr. 02, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" citohet:"Menaxhimi i projekteve me financim të huaj, pavarësisht se ato zbatojnë rregullat e sistemit të thesarit apo zbatohen jashtë tij (skema e plotë ose e pjesshme e tij**)** i nënshtrohen të gjitha rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim për menaxhimin e fondeve publike , me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet përkatëse." Në kapitullin V.III "Planifikimi I Investimeve Publike", të udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" pika 1 citohet: "Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike përcaktojnë ciklin e projekteve të investimeve si edhe në detaje te gjitha hapat që duhet të ndërmerren për përgatitjen e propozimeve për projekte investimi. Projekti përbën një/ose grup aktivitetesh të cilat realizojnë një/ose më shumë produkte në një afat kohor të caktuar si pjesë e programeve të shpenzimeve publike. Projektet mund të kërkojnë si shpenzime kapitale ashtu edhe shpenzime korente, këto të fundit si gjatë fazës kryerjes së investimit ashtu edhe pas kohës së përfundimit të tij."

3.a. Strukturat Drejtueses te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të adresojnë problematikën në drejtim të Njësive Zbatueses të Projekteve me Financim të Huaj në mënyrë që këta të fundit marrin masa për deklarimin e saktë të projekteve duke i pasqyruar ato realisht në zërat e investimeve kapitale apo në zërat e shpenzimeve operative sipas rastit.

3.b. Ministri i Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e udhëzimit nr. 02, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" duke shtuar nenin : "Në mbyllje të projektit të investimit, nga ana e Njësitë e Zbatimit të Projektit me Financim të Huaj duhet të raportohet qartë sistemi i llogarisë 230 "Shpenzime në proces".

4: KLSH ka konstatuar se në vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk raportohen dhe nuk deklarohen si shpenzim në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kjo krijon kushtet për akumulimin e kamatvonesave si pasojë e vonesës në shlyerjen e tyre, nënvlerësimin e shpenzimeve të vitit dhe deficitit të vitit buxhetor, pagesën e tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vulllnetar të vendimeve dhe thyerje të radhës së shlyerjes së vendimeve dhe selektivitet në përzgjedhjen e vendimeve për pagesë (mosrespektimi i FIFO). Në shumë institucione nuk ekziston databaza e vendimeve gjyqësore në mënyrë që nga ana e KLSH të raportohet efekti i detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë, në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.1 datë 04.06.2014 *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".* Problematikat kryesore janë të lidhura me vendimet gjyqësore për largimin e padrejtë nga puna të punonjësve dhe ato të lidhura me çështjet e privatizimit të pronës shtetërore. Vendimet gjyqësore me objekt të tyre rikthimin në punë të punonjësve nuk zbatohen, megjithë ekzistencën e vendeve vakante në

strukturat e institucioneve përkatëse, duke lejaur akumulimin e vazhdueshmë të pagave në formën e detyrimeve ndaj gjyqfituesve. Efekti i pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2017 për largim të padrejtë të punonjësve nga puna nëpëmjet llogarive të shpenzimeve operative vlerësohet në rreth 2 miliard lekë dhe për vendimet e tjera gjyqësore në rreth 1 miliard lekë. Në auditimin e zhvilluar në MFE u konstatua se detyrimet e padeklaruara nga mos ekzekutimi i vendimeve të gjykatave për rikthim në pozicionin e punës ishin rreth 70 milion lekë, megjithëse përgjatë periudhës objekt auditimi paraqiteshin rreth 50 vende vakante mesatarisht. Vendimet e tjera të shlyera lidheshin me obligime që rrjedhin nga vitet e kaluara duke mos reflektuar shpenzimin real vjetor për vendime gjyqësore. Për vendimet gjyqësore me objekt çështjet e privatizimit nuk ka një informacion në lidhje me detyrimet e shtetit , pasi nga auditimi në Minsitrinë e Financave dhe Ekonomsië u konstatua se nuk ka një databazë të këtyre vendimeve dhe informacioni mungonte. Në të njejtën linjë, edhe për vendimet gjyqësore me objekt ceshtjet e Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut u konstatua se vendiem gjyësore të miratuara për pagesë nga viti 2016, rezultonin sipas detyrimeve të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pa kontabilizuara për rreth 500 milion lekë. Për vendimet gjyqësore të cilat nuk janë të autorizuara për pagesë, KSLH e ka të pamundur të vlerësojë efektin, duke qenë se ato nuk regjistrohen në databazë të vendimeve gjyqësore dhe as në kontabilitet.

4. *KLSH parashtron rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm të vendimeve gjyqësore dhe futjen e tyre në procesin e ekzekutimit buxhetor, duke marrë parasysh efektin e mundshëm në vitet e ardhshme në formën e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe trajtimin e plotë të përgjegjësisë në lidhje me vendimmarrjen me kosto financiare të nënpunësve publike, në të njejtën linjë me kërkesën e vazhdueshme për hartimin dhe miratimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale". Kjo pasi është konstatuar se në të giitha subjektet që ekzekutojnë vendimet gjyqësore nuk përcaktohet përgjegjësia në lidhje me detyrimet që lidhen me to, në kundërshtim edhe me kërkesat e Udhëzimit Standart të Zbatimit të Buxhetit, në të cilin kërkohet nxjerrja e përgjegjësive nga ana e Titullarëve të institucioneve për cdo rast të vendimeve gjyqësore.*

5. KLSH ka konstatuar tejkalim të grantit të Buxhetit të Shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike me 6,199 milion lekë, nga të cilat fakti nga fondi i mbartur për FZHR nga viti 2016 në shumën 4,652 milion lekë, i pa shoqëruar me plan buxhetor për vitin 2017. Nga auditimi mbi shpenzimet e pushtetit vendor konstatohet se niveli i realizimit të shpenzimeve të financuara nga granti i buxhetit të shtetit për pushtetin vendor është në shumën 28,575 milion lekë, nga 22,376 milion lekë të planifikuar në formën e transfertave. Transfertat e pakushtëzuara janë planifikuar në shumën 15,635 milion lekë sipas tabelës shoqëruese nr. 3, të Aktit Normativ nr. 3 ndërkohë që transfertat specifike janë planifikuar në shumën 6,741 milion lekë. Realizimi faktik i shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta paraqitet me realizim në shumën 17,912 milion lekë nga rreth 24,024 milion lekë të planifikuara me Akt Normativ nr.3 duke përfshirë edhe planin e të ardhurave nga transferimi i rentës. Mos realizimi në këto burime financimi paraqitet në rreth 6,112 milion lekë. Nga auditimi i të dhënave në SIFQ konstatohet se pjesë e tejkalimit të transfertave të pakushtëzuara përkundrejt planit të miratuar është shpenzimi i fondeve për infrastrukturën vendore dhe rajonale, për pjesën e projekteve të mbartura nga viti 2016. Sipas të dhënave të referuara nga Drejtoria e

[shqiptarja.com]

Përgjithshme e Thesarit, vlera e realizimit faktik të projekteve të mbartura nga viti 2016 është në shumën 4.7 miliard lekë. Në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar shoqëruese në planin e miratuar me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" , konstatohet se nuk është paraqitur plani për projektet e fondit të zhvillimit rajonal të mbartur nga viti 2016. Megjithëse janë kryer shpenzime përgjatë muajve, ndryshimet përkatëse nuk janë reflektuar duke hapur plan për këtë zë që akumulon shpenzime për buxhetin vendor, si pasojë e fondit të mbartur, nëpërmjet rritjes së deficitit, ose nëpërmjet shkurtimit të zërave të tjerë të shpenzimeve për të mbajtur deficitin të paprekur. Konstatohet se me ndryshimet e ligjit nr 130/2016 nuk janë marrë masa për hapjen e planit për këtë zë të shpenzimeve buxhetore, nëpërmjet shkurtimit të zërave të tjerë të shpenzimeve buxhtore, por janë hapur edhe projekte të reja me Aktin Normativ Nr.3 të paplanifikuara më parë**. Mbajtja nën kontroll e totalit të shpenzimit** për buxhetin vendor është realizuar nëpërmjet kufizimit të shpenzimeve për këto njësi, duke vendosur limit për shpenzimet e buxhetit vendor sipas shkresës nr.15973, datë 09.11.2017, gati 3 ditë pas Aktit Normativ nr.3 datë 06.11.2017, ku u është komunikuar Degëve të Thesarit dhe njësive të vetqeverisjes vendore një limit sipas bashkive përkatëse i përdorimit të cash-it për pjesën e mbetur të vitit sipas tabelës bashkëngjitur. Në këtë tabelë rezulton se për periudhën 10.11.2017 e deri në fund të vitit buxhetor limit i përdorimit të cash është caktuar në masën 3.4 miliard lekë. Kjo shkresë rezulton të jetë iniciuar nga Drejtoria e Financave Vendore në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, strukturë e cila nuk ka asnjë kompetencë në lidhje me përcaktimin e sasinë e nevojshme të cash dhe tagër të kufizimit të kryerjes së shpenzimeve në rast të dokumentimit të tyre. Argumenti i vendosjes së këtij limit sipas përgjigjes së Drejtorisë së Financave Vendore paraqitet për qëllime makrofiskale, ndërkohë që kompetenca e vendosjes së kufizimeve për qëllime makrofiskale është e Kuvendit. Nga ana tjetër konstatohet që teprica e cash për periudhën e kufizimit është në nivele të larta nga 33 deri në 12 miliard lekë, sipas konfirmimit edhe nga strukturat e thesarit, përgjegjëse për menaxhimin e likuditetit. Për këto shpenzime faktike, nuk është përfshirë plan në tabelën e treguesve fiskalë edhe pas dy ndryshimeve me Akt Normativ të ligjit të buxhetit, megjithëse plani për to ishte paracaktuar që të mbartej deri në muajin Dhjetor 2017 dhe pas rakordimit me degët e Thesarit do të përcaktohej shuma e tij, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", i ndryshuar. Ky kufizim ka krijuar kushtet për frenimin e kryerjes së shpenzimeve dhe akumulimin e detyrimeve të reja të prapambetura për pushtetin vendor në fund të vitit, ku vlera e detyrimeve të prapambetura për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme paraqitet në shumën 19 miliard lekë në fund të vitit 2017.

5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë kuadrin ekzistues në lidhje me financimin e fondit të zhvillimit të rajoneve, duke përfshirë në planin e mbartur nga vitet e kaluara planifikimin përkatës përgjatë periudhës aktuale buxhetore. Në cdo rast të shmanget praktika e kufizimit të kryerjes së shpenzimeve të cilat janë të miratuara, referuar planifikimit dhe tepricave të larta të likuditetit.

6. KLSH ka konstatuar nënvlerësim të deficitit si pasojë e tejkalimit të kufijve të huamarrjes së jashtme me efekt në tejkalimin e shpenzimeve kapitale me financimin të huaj në shumën 3,793 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se sipas raportimeve në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2017 rezulton se

realizimi i treguesve të huamarrjes së huaj për vitin 2017 në terma bruto për kredinë për financim projektesh rreth 27,200 milion lekë, ndërkohë që plani për këtë zë të huamarrjes sipas tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar, shoqëruese të Aktit Normativ nr.3 paraqitet në shumën 17,570 milion lekë. Huaja e marrë për financimin e projekteve të huaja, sipas raportimit faktik në treguesit fiskal të konsoliduar paraqitet në shumën 23,407 milion lekë. Duke mos paraqitur vlerë reale të huas së marrë për projekte të huaja për vitin 2017 në treguesit fiskalë të konsoliduar në zërin e huas së marrë për financimin e projekteve, rrjedhimisht janë nënvlerësuar financimi i deficitit në shumën 3,793 milion lekë dhe në të njëjtën kohë deficiti i raportuar është nënvlerësuar me 3,793 milion lekë. Në këtë mënyrë të dhënat e paraqitur në treguesit fiskalë janë të pasaktë, sipas raportimeve nga strukturat e thesarit, bazuar edhe në diferencat në akt-rakordimin ndërmjet strukturave të borxhit dhe të thesarit. Në kërkesën për arsyetimin e këtyre mosraportimeve me efekt në treguesit fiskalë nga ana e strukturave përkatëse të thesarit është sqaruar se këto diferenca ekzistojnë si pasojë e raportimit nga PIU-t përkatës në Drejtorinë Operacionale të Thesarit në Janar 2018. Kjo argumenton faktin që disbursimet e konstatuara nga KLSH për vitin 2017, nuk janë raportuar në periudhën e duhur, duke u raportuar për llogari të vitit ushtrimor 2018, megjithëse konfirmimet përkatëse nga kreditorët dhe disbursimi përkatës është kryer në vitin 2017. Në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 22.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017", pika 23, përcakton që *"Procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njësive të qeverisjes së përgjithshme duhet të përfundojë brenda datës 15.02.2018."* Megjithëse procesi i rakordimit dhe regjistrimit në SIFQ përfundon në 15.02.2018, konstatohet se shuma prej 3,793 milion lekë nuk është raportuar në periudhën e duhur. Mos përfshirja e të dhënave të plota në tabelën e treguesve fiskal për vitin 2017, nëpërmjet raportimit të huas së disbursuar në vitin 2017 në për llogari të periudhës ushtrimore 2018, ka shkaktuar raportimin e treguesve jo të plotë dhe të saktë për vitin 2017. Gjithashtu nga analiza e urdhër prokurimeve të rregjistruara në SIFQ u konstatuan **206 prokurime në vlerë 6.3 miliardë lekë** të ndërmarra pas datës 15.10.2017 në shkelje të nenit 51 të Ligjit të Buxhetit pavarësisht se me nenin 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore" mund të fillojnë/ vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar.

Në kushtet kur nuk regjistrohet PBA (sa më sipër është shtjelluar) nuk të japim siguri nëse këto prokurime janë në përputhje me VKM apo në shkelje të LOB.

Tabela 21: Institucionet që kanë ndërmarrë procedura prokurimi pas datës 15.10.2017 sipas SIFQ

Institucioni	Numri i rasteve	Vlera në mijë lekë
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit (3535)	69	3,507,436
Agjencia per Zhvillimin Bujqesor dhe Rural (AZHBR) (3535)	12	5,460
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (3535)	2	42,312
Aparati i Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise (3535)	3	13,207
Aparati i Ministrise se Brendshme (3535)	10	30,704
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (3535)	6	126,007
Aparati i Ministrise se Mbrojtjes (3535)	4	38,441
Aparati Ministrisë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (3535)	5	10,026
Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise (3535)	5	5,878
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	20	687,871
Bashkia Tirana (3535)	70	1,803,049
Total	206	6,380,392

[shqiptaria.com]

Sa më lartë gjetja u verifikua dhe me të dhënat e marra nga APP: Referuar tabelës “”prokurimet e publikuara” ku **rezultojnë në total 51 raste me vlerë fondi limit pa TVSH 2.3 miliardë lekë të publikuara pas datës 15.10.2017.**

Tabela 22: Institucionet që kanë ndërmarrë procedura prokurimi pas datës 15.10.2017 sipas APP

NR	Autoriteti Kontraktor	Lloji Proçedurës	Tipi i Kontratës	Numri i rasteve	Fondi Limit në mijë lekë
1	Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit	I Hapur	Shërbime	2	116,436
2	Autoriteti Rrugor Shqiptar	Kërkesë për Propozim	Mallra	1	4,872
		Shërbim Konsulence	Shërbime	4	15,551
3	Bashkia Tirane	I Hapur	Mallra	2	166,413
			Punë Civile	8	1,294,495
			Shërbime	4	146,618
		I Hapur mbi Kufi	Shërbime	1	521,962
		Kërkesë për Propozim	Mallra	16	33,224
			Punë Civile	1	8,333
			Shërbime	9	8,117
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Banka Boterore)	Kërkesë për Propozim	Shërbime	2	12,015
5	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	I Hapur	Mallra	1	13,859
	Total			51	2,341,897

Rastet e mësipërme mbeten gjithësesi objekt i mëtejshëm investigimi për të verifikuar nëse ato janë prokurime pjesë e projekteve me plan buxhetor 3 vjeçar të miratuar.

6. Nga ana e Ministrisë së Finacave dhe Ekonomisë të korrigjohen shumat e raportuara në zërin e shpenzimeve kapitale me financim të huaj apo huamarrjes neto si pasojë e raportimit jo në periudhën e duhur të projekteve me financim të huaj në formën e huas dhe në të njëjtën kohë dhe në seksionin e financimit të deficitit nëpërmjet disbursimeve për huan e marrë për projekte të huaja. Të dhënat në lidhje me raportimet e huas së huaj të disbursuar apo ripagesat e mundshme të jenë të reflektuara në bazë të konfirmimeve të kreditorëve përkatëse, edhe në rastet e mos marrjes së masave të nevojshme për mos raportimin në kohë të projekteve me financim të huaj nga njësitë përkatëse. Marrja e masave ndaj personave përgjegjës për vonesat në çdo rast të përfshijë masa administrative dhe jo tërheqje vëmendje ndaj personave përkatës.

7: KLSH ka konstatuar tejkalim të planit shpenzimeve për pushtetin vendor si pasojë e shpenzimeve të pa planifikuara me burim financimi kapitullin 2, nga financimi i huaj në shumën 1,646 milion lekë, i raportuar në huadhënien neto pa planin përkatës.

Nga auditimi konstatohet se me ligjin nr.130/2016 të ndryshuar, janë planifikuar fondet për shpenzimet e buxhetit vendor në shumën 46,400 milion lekë. Pjesë e fondeve të planifikuara është edhe tranferta e pakushtëzuar dhe granti specifik i buxhetit në shumën 22,376 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se në planifikimin e këtyre trasfertave nuk është përfshirë disbursimi përkatës i nënhuasë së marrë në pushtetin vendor për projektin e Bulevardit verior të Tiranës në shumën 1,646 milion lekë. **Në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar sipas SIFQ** konstatohet se ky projekt është i raportuar në shumën 1,646 milion lekë në seksionin e shpenzimeve të buxhetit vendor të financuara nga kapitulli 2, financimi i huaj. **Nga analiza e raportit të**

treguesve fiskalë të konsoliduar të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezulton se fakti në lidhje me këtë projekt në zërin e shpenzimeve të pushtetit vendor është 0 lekë, pasi ai është raportuar në zërin e huadhënies neto në shumën 1,646 milion lekë, duke u riklasifikuar nga jashtë pas raportimit në fiskale. Në këtë mënyrë, shpenzimet e zërit për buxhetin vendor janë nënvlerësuar në shumën 1,646 milion lekë, duke sjellë efektin e mbulimit të tejkalimit të planit të buxhetit vendor me 1,646 milion lekë si pasojë e riklasifikimit. Këto vepirme konstatohet të jenë kryer si pasojë e mosplanikimit të shpenzimeve të buxhetit vendor të financuara nga kapitulli 2 me anë të Aktit Normativ nr.3. Raportimi konstatohet të jetë kryer në kundërshtim me planin sipas ligjit nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, duke nënvlerësuar shpenzimet e raportuara në shpenzimet e buxhetit vendor me 1,646 milion lekë.

7: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kryhen veprimet rregulluese në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar të raportuar, në përputhje me planifikimin fillestar të fondeve dhe raportit të nxjerrë nga SIFQ në shumën 1,646 milion lekë. Fondet e financimit të huaj për pushtetin vendor të raportohen si pjesë e shpenzimeve për pushtetin vendor dhe jo në zërin e huadhënies neto, sikurse miratohen nga Kuvendi.

[Shqiptarja.com]

3.3 FONDI I KONTIGJENCËS DHE REZERVËS

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit (FRBSH) dhe Fondi i Kontigjencave (FK) janë pjesë përbërëse e Buxhetit Vjetor të Shtetit dhe e Pasqyrës Vjetore Fiskale të tij. Këto Fonde, pjesë integrale e shpenzimeve vjetore të Buxhetit të Shtetit dhe e Raprtit Vjetor të Realizimit të tij, miratohen, ndryshohen e raportohen në Kuvendin e Shqipërisë. Ligjërisht shuma e këtyre fondeve duhet të jetë deri në masën 3% e shumës të fondeve të miratuara buxhetore.

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit (FRBSH) dhe Fondi i Kontigjencave (FK) **planifikohen** çdo vit nga Ministria e Financës, **përdoren** me kërkesa të institucioneve qendrore dhe **miratohen** nga Ministria e Financës dhe Këshilli i Ministrave. Për vitin 2017, mbështetur në legjislacionin dhe aktet normative, Fondi i Kontigjences dhe Rezerves, është programuar dhe realizuar si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 23: Fondi i Kontigjences dhe Rezerves për vitin 2017 *mln lekë*

Nr.	Struktura Buxhetore	Ligjin nr.130/2016	A.N nr.2 2017	A.N nr.3 2017	Përdorimi me VKM, me shkresa	Alokimi 2017	Diferenca (plan/përd)
I	**Fondi rezervë. (49)**	**1,500**	**2,700**	**2,400**	**2,302**	**2,302**	**98**
1	Te paparashikuara	1,000	1,200	1,300	1,213	1,213	87
2	Për gjyqësorin	500	500	100	89	89	11
3	Për emergj. natyrore	0	1,000	1,000	1,000	1,000	0
II	**Fondi kontigjencave**	**12,500**	**13,500**	**12,300**	**8,217**	**8,217**	**4,083**
1	Për risqet e borxhit	4,000	4,000	4,000	0	0	4,000
2	Për investime	0	1,000	0	0	0	0
3	Fond per ritjen e pagave	5,500	5,500	5,300	5,291	5,291	9
4	" indeksim e pensioneve	2,600	2,600	2,600	2,600	2,600	0
5	Fondi vecantë i pagave	400	400	400	326	326	74
	Shuma I+II	**14,000**	**16,200**	**14,700**	**10,519**	**10,519**	**4,181**

Burimi: Tabela hartuar nga grupi i auditimit, në bazë të dhënave të subjektit.

Me ligjin fillestar të buxhetit Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe fondet e kontigjencave janë planifikuar për **14,000 milionë lekë**, ku fondi rezervë zë 10.8% të totalit të tyre. Me aktin normativ nr.2, këto fonde janë programuar në vlerë **16,200 milionë lekë**, pra janë shtuar për 2,200 milionë lekë, ose më shumë se programimi fillestar për **15.7%.** Kështu fondi rezervë është shtuar për 1,200 milionë lekë, ose 80%, ndërsa fondi i kontigjencave me 1,000 milionë lekë për investime, ose 8% më shumë. Programimi përfundimtar i këtyre fondeve, i realizuar me aktin normativ nr.3, i ka zbritur këto fonde në **14,700 milionë lekë**, pra janë zvogëluar për 1,270 milionë lekë, ose **8% më pak** më pak se akti normativ nr.2. Kështu fondi rezervë është pakësuar për 300 milionë lekë, ose 11.2% më pak, ndërsa Fondi i Kontigjencave është pakësuar me 1,200 milionë lekë për investime, ose 8.9% më pak. Janë përdorur gjithsej në vlerë **10,519 milionë lekë**, pra më pak se programimi përfundimtar i tyre, në vlerë 4,181 milionë lekë, **ose 28.4% më pak**. Kështu fondi rezervë nuk është përdorur për 98 milionë lekë, ose 4.1% më pak, ndërsa fondi i kontigjencave nuk është përdorur për 4,083 milionë lekë, ose 33.2% më pak. Alokimi i këtyre fondeve ka rezultuar në vlerën e përdorimit.

Për 2017, përdorimi i këtyre fondeve është bërë në këta **artikuj buxhetorë**, si në tabelën e mëposhtme:

Shqiptaria.com

Tabela 24: Fondi rezervë i përdorur sipas artikujve buxhetor *mln lekë*

Nr.	Zërat e shpenzimeve	FRBSH (1)	FK(2)	Totali (1+2)	Në %/ totalit
I	**Shpenzime personeli**	**88.89**	**5,291.45**	**5,380,341**	**51.15**
II	**Shpenzime të tjera korente**	**2,080.91**	**2,925.50**	**5,006.42**	**47.59**
602	Shpenzime operative dhe mirëmbajtje	555.65	0.00	555.65	5.28
603	Suvensione	14.98	0.00	14.98	0.14
604	Transferta të brendshme	1,254.49	2,600.00	3,854.49	36.64
605	Transferta të jashme	11.50	0.00	11.50	0.11
606	Ndimë financiare	244.29	325.50	569.79	5.42
III	**Shpenzime për Investime**	**132.07**	**0.00**	**132.07**	**1.26**
	Shuma (I+II+III)	**2,301.88**	**8,216.95**	**10,518.83**	**100.00**

Trendi i përdorimit të këtyre fondeve për 6 viteve rresht 2012-2017, vlerat e përdorura të Fondi i Kontigjences dhe Rezerves, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 28: Dinamika e përdorimit të fondeve për periudhën 2012-2017 *mln lekë*



Po në të njëjtin trend është edhe koeficienti i përdorimit të këtyre fondeve me totalin e fondeve të miratuara të buxhetit të shtetit, por kanë ruajtur kufirin ligjor prej 3%.

Nga auditimi i dosjeve të vendimeve për përdorimin e F**ondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit** rezultoi:

1. Në **5 VKM,** në vlerë **19 milionë lekë,** ose rreth **1%** e vlerës së këtij fondi, Vendimet e Këshillit të Ministrave, janë marrë me vonesë për likuidimin e vendimeve të GJEDNJ, duke sjellë pagesën e **424.7 mijë lekëve për kamat vonesat në likuidimin e tyre.** Vlera e kamat vonesave llogaritur për kohën midis marrjes së Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe kohës së përcaktuar për likuidim në Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është përgjegjësi e strukturave të Avokaturës së Shtetit dhe vonesat në marrjen e VKM për likuidimin e tyre.

2. Në **3 VKM,** në vlerë **136,755 mijë lekë, ose 5.9%** e vlerës së këtij fondi, në dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave, **nuk janë relacionet shpjeguese** për shpenzimet që kërkohen nga institucionet përfituese për përdorimin e këtij fondi, në kundërshtim me udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit. Në këto vendime, nuk specifikohet natyra e shpenzimeve, kriteret dhe mënyra e llogaritjes si dhe arsyetimi mbi pamundësinë e financimit nga buxheti 2017, si më poshtë:

- Në VKM me nr.608, datë 27.10.2017 "Për miratimin e kontratës së qirasë së ri negociuar, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Shoqërisë "Continental Group sha", në vlerë 19,255 mijë lekë;
- Në VKM me nr.499, datë 27.10.2017 "Për dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Qeverinë e SHBA-ve, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta dhe përmbytjet në Shtator të vitit 2017", në vlerë 11,500 mijë lekë (Ministria e Jashtme);

[Shqiptaria.com]

- Në VKM me nr.746, datë 13.12.2017 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2017", në vlerë 176,000 mijë lekë (Ministria e Shëndetësisë).

3. Në **4 VKM,** në vlerë **212,254 mijë lekë,** ose **9.2%** e vlerës së këtij fondi, dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave, **nuk kanë preventiv shpenzimesh** nga institucionet përfituese për përdorimin e këtij fondi, në kundërshtim me udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit, si më poshtë:

- Në VKM me nr.608, datë 27.10.2017 "Për miratimin e kontratës së qirasë së rinegociuar, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Shoqërisë "Continental Group sha", në vlerë 19,255 mijë lekë (Ministria e Financës dhe Ekonomisë).
- Në VKM me nr.499, datë 27.10.2017 "Për dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Qeverinë e SHBA-ve, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta dhe përmbytjet në Shtator 2017", në vlerë 11,500 mijë lekë (Ministria e Jashtme).
- Në VKM me nr.746, datë 13.12.2017 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2017", në vlerë 176,000 mijë lekë (Ministria e Shëndetësisë).
- Në VKM me nr.302, datë 05.04.2017 "Për financimin e pistës së atletikës në stadiumin "Loro Borici", Shkodër", në vlerë 75,499 mijë lekë (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

4. N**ë 4 VKM,** në vlerë **210,747 mijë lekë,** ose **9.2%** vlerës së këtij fondi, **nuk janë miratimet e Ministrisë së Financave për përdorimin e këtij fondi**, si më poshtë:

- Në VKM me nr.670, datë 16.11.2017 "Për një shtesë fondi për buxhetin e vitit 2017 për bashkitë Patos dhe Roskovec, për dëmshpërblimet e familjeve, banesat e të cilave janë dëmtuar nga lëkundjet e tokës", në vlerë 73,992 mijë lekë (Ministria e Brendshme);
- Në VKM me nr.608, datë 27.10.2017 "Për miratimin e kontratës së qirasë së rinegociuar, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të doganave dhe shoqërisë "Continental Group"SHA", në vlerë 19,255 mijë lekë (Ministria e Financës dhe Ekonomisë);
- Në VKM me nr.499, datë 27.10.2017 "Për dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Qeverinë e SHBA-ve, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta dhe përmbytjet në Shtator 2017", në vlerë 11,500 mijë lekë (Ministria e Jashtme);
- Në VKM me nr.746, datë 13.12.2017 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit 2017", në vlerë 176,000 mijë lekë (Ministria e Shëndetësisë).

5. Në **4** Vendime të Këshillit të Ministrave, në vlerë **162,128 mijë lekë**, ose 7% të vlerës së këtij fondi, **fondi rezervë është përdorur si "shtesë buxheti",** fonde të cilat, duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të buxhetit. Këto vendime janë si më poshtë:

- Në VKM me nr.708, datë 01.12.2017 "Për një shtesë fondi për buxhetin e vitit 2017, miratuar për Kryeministrinë (AMA) ", në vlerë 40,000 mijë lekë (Kryeministria);
- Në VKM me nr.608, datë 27.10.2017 "Për miratimin e kontratës së qirasë së ri negociuar, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Shoqërisë "Continental Group sha", në vlerë 19,255 mijë lekë (Ministria e Financës dhe Ekonomisë);

- Në VKM me nr.302, datë 05.04.2017 "Për financimin e pistës së atletikës në stadiumin "Loro Borici", Shkodër", në vlerë 75,499 mijë lekë (Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- Në VKM me nr.204, datë 15.03.2017 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe transferimin e tij nga MZHU te Bashkia Tiranë, për realizimin e pagesës së detyrimit të prapambetur për shoqërinë "Urbaplan"", në vlerë 27,374 mijë lekë (Ministrinë e Zhvillimit Urban);

6. Në **2 dosje** të Vendime të Këshillit të Ministrave, në vlerë **90,478 mijë lekë**, ose **3.9%** të vlerës së këtij fondi, fondi rezervë është përdorur edhe pse gjatë shqyrtimit të relacionit dhe projektit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, u gjeten mangësi dhe u propozuan ndryshime, nga institucioni kërkues i këtij fondi nuk ishin sqaruar apo plotësuar mendimet e MOF në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të përdorimit të fondit rezervë. Këto vendime janë si më poshtë:

- Në VKM me nr.302, datë 05.04.2017 "Për financimin e pistës së atletikës në stadiumin "Loro Borici", Shkodër, në vlerë 75,499 mijë lekë (Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- Në VKM me nr.674, datë 22.11.2017 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për DSHQ", në vlerë 14,979 mijë lekë.

Nga auditimi i dosjeve të Vendimeve për përdorimin e Fondit të Kontigjencave, rezultoi: Për vitin 2017, fondet e kontigjencave nuk janë përdorur sipas përcaktimeve të ligjit organik të buxhetit: për nevojën e financime të reja, apo për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave dhe as sipas përcaktimeve të Ligjit vjetor nr.130, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar me akte normative, ku Fondi i Kontigjencës është miratuar në vlerën 4,000 milionë lekë "Kontigjenca për risqet e borxhit" dhe 1,000 milionë lekë për investime me Aktin Normativ nr.2, datë 16.08.2017. Nga MFE nuk jepet shpjegim pse fondi i kontigjencave nuk është përdorur sipas planifikimit në ligjin vjetor dhe ligjit organik të buxhetit.

Përdorimi i Fondit të Kontigjencës është me strukturë dhe vlera të ndryshme **për 6 vite** të marrë në analizë, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 25: Dinamika e strukturës së fondit të kontigjencës së përdorur *mln lekë*

	Struktura Buxhetore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	Për risqet e borxhit	2,245.87	636.67	1,488.03	0.00	0.00	0.00
2	Likj.VGJEDNJ	0.00	0.00	0.00	1,160.70	2,044,23	0.00
3	Likj. arbitr nderk	0.00	0.00	0.00	140.44	16.06	0.00
4	Fond per ritjen e pagave	754.54	649.01	999.98	0.00	122.00	5,291.45
5	Indeksim e pensioneve	1,500.00	1,411.00	998.00	0.00	0.00	2,600.00
6	Fond i veçantë i pagave	1,036.85	136.43	209.81	205.90	139.29	325.50
	Shuma	**5,537.26**	**2,833.21**	**3,695.82**	**1,507.04**	**2,321.58**	**8,216.95**

Në strukturën e përdorimit të këtij fondi, kanë rezultuar zëra me kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, në kundërshtim me pikën 16, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet: *"Fondi Kontigjencës është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë zbatimit të buxhetit, apo për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese"*, si më poshtë:

Në zërin "Për mbulimin e risqeve të borxhit", për vitin 2012 është përdorur në vlerë prej 2,245.87 milionë lekë dhe në vitin 2014 është përdorur në vlerë

[shqiptaria.com]

1,488.03 milionë lekë, me kriteret e përdorimit të Fondit Rezerve të Buxhetit të Shtetit. Në zërin "Likuidime të VGJEDNJ" dhe "Likuidime të Arbitrazhit Ndërkombëtar", për vitin 2015 është përdorur në vlerë 1,160.7 milionë lekë dhe për vitin 2016 është përdorur në vlerë 2,044.23 milionë lekë, me kriteret e përdorimit të Fondit Rezerve të Buxhetit të Shtetit.

a. Për vitin 2017, por edhe shumë vite më parë me radhë, përdorimi i Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit (FRBSH), është bërë me mangësi e shkelje si nga institucionet kërkuese të përdorimit të tij (institucionet qëndrore,duke paraqitur projekt vendime pa dokumentacioni ligjor) ashtu edhe nga institucionet miratuese të këtij fondi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke mos vendosur klauzola për alokimin e këtij fondi në udhëzimet e zbatimit të buxhetit dhe Këshilli i Ministrave, ku miraton VKM për përdorimin e tij, pa miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

b. Këtë vit, Fondi i Kontigjencave (FK), që sipas ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë zbatimit të buxhetit, apo për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese, për mbulimin e risqeve të borxhit, nuk u realizua. Edhe vite më parë ky fond nuk është përdorur sipas ligjit organik të buxhetit, po me kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit.

[Shqiptarja.com]

3.4 FONDI I TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Fondi i të Përndjekurve Politikë për vitin 2017 është realizuar në vlerën **2,298 milionë lekë** sipas Tabelës Fiskale, nga 2,352 milionë lekë (ose realizuar 98%) të planifikuara në aktin Normativ Nr.3 apo 2,000 milionë lekë planifikuar me ligjin nr.130/2016 datë 15.12.2016, "*Për buxhetin e vitit 2017*"

Fondi i të Përndjekurve Politikë shpërndahet në bazë të ligjit nr.9831 datë 11.12.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar me ligjin nr. 94/2014 datë 24.7.2014 dhe me Ligjin nr.27/2017 datë 23.3.2017, VKM nr.419, datë 14.4.2011, si dhe Udhëzimit nr.5 datë 15.04.2016 të Ministrit të Financave.

Konstatohet se në zbatim të Aktit Normativ nr.3 "Për Buxhetin e Vitit 2017" janë çelur 2,352 milionë lekë për pagesat e dëmshpërblimeve.

Tabela 26: Fondi i ish të Përndjekurve Politikë *mln lekë*

ZERAT	PBA/ Kuadri Makro/ Faza I	PBA e Rishikuar	Projekt Buxhet	Ligji i Buxhetit	AN 02	AN03
Fondi i ish të Përndjekurve Politikë	2,038	2,038	2,038	2,038	2,038	2,390
Pagesa Dëmshpërblimi	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,352
Shpenzime Administrative	38	38	38	38	38	38

Nga auditimi konstatohet se, baza ligjore për Fondin e ish të Përndjekurve Politikë është e paplotësuar dhe me probleme. Pas ndryshimeve të rëndësishme në ligj të vitit 2014 ende nuk kanë dalë aktet nënligjore përkatëse. Për periudhën nga 2009 deri në 2017, janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për shpërndarje dëmshpërblimesh (26 VKM), me një vlerë detyrimi të njohur nga Shteti Shqiptar ndaj ish të Përndjekurve Politikë dhe të papaguar ende në fund të vitit 2017 është 31,449.7 milionë lekë. Nëse buxhetimi dhe çelja e fondit të ish të përndjekurve do të vazhdojë të mbajë ritmet e deritanishme të cilat janë pasqyruar në tabelën më poshtë me afërsisht 2 miliardë lekë në vit ky detyrim do të mund të shlyhet vetëm pas 16 vitesh.

Megjithatë duhet theksuar se ky nuk është detyrimi final ndaj ish të përndjekurve politikë, pasi nga Ministria e Drejtësisë pretendohet se ka akoma rreth 300 dosje të kategorisë parësore dhe rreth 24,000 dosje të kategorisë joparësore që presin të shqyrtohen në rrugë administrative. Deri në vitin 2017 është miratuar dëmshpërblim për rreth 7,382 dosje çka na bën të kuptojmë se mund të flitet për trajtimin e më pak se 30% të totalit të dosjeve. Më poshtë jepet ecuria e shpërndarjes së fondit që nga momenti i miratimit të ligjit.

Tabela 27: Ecuria e shpërndarjes së fondit të ish të Përndjekurve Politikë *mln lekë*

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Fond i Miratuar	3,170	1,400	1,800	1,700	3,000	1,800	2,000	2,000	2,352
Realizimi	2,200	1,000	1,494	1,700	2,991	1,764	2,010	2,000	2,298
% e Realizimit	69%	71%	83%	100%	99.7%	98%	100.5%	100%	98%

[shqiptaria.com]

Grafiku 29: Fondi i Fondi i të Përndjekurve Politikë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Realizimi i fondit të ish të përndjekurve politikë për vitin 2017 sipas tre burimeve: Tabelës Fiskale, Bankave të Nivelit të Dytë dhe Sistemit E-dëmmpshpërblime rezulton me diferenca të pashpjeguara dhe konkretisht:

Tabela 28: Realizimi i fondit të ish të përndjekurve politikë për vitin 2017 mln lekë

ZERAT	E-dëmshpërblime	Tabela Fiskale	Banka të Nivelit të Dytë
Fondi i ish të përndjekurve politikë	2,300	2,298	2,295

Nga auditimi konstatohet se Fondi i të Përndjekurve Politikë gjatë vitit 2017, ka pasur kthime të fondeve në vlerën 30.4 milionë lekë. Nga këto, 6 milionë lekë janë kthyer gjatë vitit dhe janë kontabilizuar si shpenzime me minus në llogarinë speciale të ish të përndjekurve politikë dhe 24 milionë lekë të kthyera kryesisht gjatë muajve nëntor dhe dhjetor janë kontabilizuar në muajin shkurt të vitit pasardhës si të ardhura për thesarin. Këto fonde kanë qëndruar për një peridhë jo normale prej 1-2 muaj në bankat e nivelit të dytë si likujditete në udhëtim bazuar në datat e listave përfundimtare emërore të miratuara. Mos korrigjimi në kohë i këtyre pagesave të kthyera ka bërë që kjo vlerë të jetë e përfshirë në realizimin e fondit në Tabelën Fiskale, duke na dhënë kështu një vlerë jo realiste dhe të mbivlerësuar të realizimit të fondit artificialisht me 24 milionë lekë.

Shpërndarja e fondit për vitin 2017 midis dy kategorive ka qënë në raportin 74% (1,697 milionë lekë) për kategorinë parësore dhe 26% (604 milionë lekë) për kategorinë joparësore, me një diferencë të vogël prej 4% dhe 6% nga parashikimi ligjor (70% me 30%). Nga evidenca e marrë nga sistemi E-dëmshpërblime me pagesat e vitit 2017, dhe testimet e shumta me subjektet përfituese të kategorisë parësore konstatohet se Paragrafi i Dytë, Neni 1, i Ligjit Nr.94/2014 që përcakton se *"Me kryerjen e pagesës, për të gjitha subjektet parësore, brenda kështit më të ulët, fillon pagesa e kështit pasardhës e kështu me rradhë"*, nuk është zbatuar dhe pa përfunduar shpërndarja brenda kështit më të ulët për të gjitha subjektet e kategorisë parësore është vazhduar me shpërndarjen e kësteve pasardhëse, për arsye se proçedura e parashikuar në Udhëzimin Nr.5 datë 15.04.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për shpërndarjen e këtij fondi përcakton se subjektet përfituese duhet të paraqesin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dëshminë që janë gjallë çdo tre muaj.

[Shqiptarja.com]

3.5 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për "Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale" sipas Tabelës Fiskale është realizuar në vlerën 10,726 milionë lekë, prej të cilave 6,073 milionë lekë janë financim nga ligji nr.130/2016 datë 15.12.2016, "*Për buxhetin e vitit 2017*" me planifikim prej 9,500 milionë lekë dhe 4,652 milionë lekë janë realizim i fondit të mbartur prej 6,876 milionë lekë dhe fondit të pashpërndarë nga viti 2016 prej 999 milionë lekë.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor, funksionimi i të cilit rregullohet në Aneksin 3 të Ligjit 130/2016 "Për Buxhetin e Vitit 2017" si dhe vendimet e Komitetit të Zhvillimit Rajonal.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2017, nuk ka financuar një nga tre shtyllat bazë të saj "Programi i Mbështetjes për Ekonominë". Në ndryshim nga viti 2016 programi i vitit 2017, nuk shoqërohet me peshën specifike të secilës politikë duke minimizuar akoma edhe më tej kuadrin rregullator të FZHR. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve megjithëse është burim financimi për gjashtë programe buxhetore, vetëm programi "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" është i identifikueshëm dhe del si zë më vete në tabelën fiskale, kurse të gjitha projektet e tjera të cilat financohen nga FZHR nëpërmjet programeve të tjera buxhetore raportohen të padiferencuara dhe në një zë me të gjitha shpenzimet e tjera kapitale. Pra, është e vështirë të identifikohet vlera totale e investimeve që financon FZHR çdo vit.

Për vitin 2017, FZHR ka pasur tre burime financimi: *a. Fondin e FZHR të parashikur në ligjin buxhetin e vitit 2017; b. Fondin e mbartur nga vitet e kaluara në 2017 të projekteve në vazhdim të programit "Infrastruktura vendore dhe rajonale"; dhe c. Fondin e Pashpërndarë të programit "Infrastruktura vendore dhe rajonale" në vitin 2016*. **Në Tabelën Fiskale** nuk rezulton i reflektuar Plani për Fondin e Mbartur dhe Fondin e Pashpërndarë nga viti 2016 respektivisht prej 6,876 milionë dhe 999 milionë, por rezulton i hedhur vetëm Plani i financimit të vitit 2017 prej 7,400 milionë, si dhe realizimet respektive.

Tabela 29: Fondi sipas fazave të buxhetimit dhe akteve respektive mln lekë

Inrastruktura Vendore dhe Rajonale	PBA /Kuadri Makro/ Faza I	PBA e Rishikuar	Projekt Buxheti	Ligji i Buxhetit	AN 02	AN 03	Realizimi
Financim 2017	9,500	9,500	9,500	9,500	8,900	7,400	6,073
Fond i Mbartur+Fond i Pashpërndarë në 2016	0	0	0	0	0	0	4,652

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tabela Fiskale.

Konstatohet se evidenca Plan/Fakt e Drejtorisë së Thesarit nuk rakordon me evidencën Plan/Fakt të Drejtorisë së Buxhetit për programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale", si pasojë të dhënat nuk janë të plota dhe është bërë një një prezantim jo i sinqertë i treguesve fiskal dhe të dhënave të nevojshme për qëllime të vendimmarrjes, në kundërshtim me Ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".

Në evidencën Plan/Fakt të Drejtorisë së Thesarit është raportuar për të tre burimet e financimit me vlerë plani prej 14,300 milionëë lekë dhe realizim prej 10,726 milionëë lekë, por konstatohet se mungon informacion për disa projekte

[shqiptare.com]

të veçanta, ndërkohë që në evidencën Plan/Fakt të Drejtorisë së Buxhetit është raportuar vetëm për dy burimet e para të financimit dhe konkretisht plani ka vlerën 14,278 milionëë lekë kurse realizimi ka vlerën 10,961 milionëë lekë duke rezultuar me një diferencë prej 22,607,191 lekë në Plan dhe një diferencë prej 235,203,821 lekë në fakt.

Raportimi i Planit të këtij fondi prej 7,400 milionëë, është paraqitur në Tabelën Fiskale, nën zërin "Shpenzime Kapitale", ndërsa Fondi i Mbartur prej 6,876 milionëë lekë dhe Fondi i Pashpërndarë prej 999 milionëë lekë rezulton pa Plan në Tabelën Fiskale. Për më tepër, Fondi i Mbartur në 2017 për Programin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale", i pashoqëruar me plan buxhetor ka pësuar ndryshime gjatë vitit përtej afateve të përcaktuara në Udhëzimin Plotësues nr.8 datë 13.01.2017 "Për Zbatimin e Buxhetit", Pika 12 dhe vlera e tij nuk mund të përcaktohet saktë.

Programi i "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" është raportuar në Tabelën Fiskale për të gjithë vlerën prej 10,726 milionë lekë, nën zërin "Shpenzimet e Buxhetit Vendor", ndërkohë që për qëllime informuese do të duhej të ishte ndarë kjo vlerë sipas pjesëve respektive midis "Shpenzimeve Kapitale" dhe "Shpenzimeve të Pushetit Vendor". Për më tepër konstatohet se në këtë vlerë mungon dhe nuk është përfshirë realizimi i disa projekteve fondet e të cilave janë rishpërndarë me Vendim të Këshillit të Ministrave, VKM Nr.229 datë 21.03.2017 për 625.4 milionë lekë dhe VKM Nr.318 datë 12.04.2017 për 99.7 milionë lekë.

Mbartja e realizimit të këtij fondi në 2017, e pa shoqëruar me mbartjen e planit respektiv, ka sjellë një sërë pasojash me impakt të lartë në "Shpenzimet e Pushtetit Vendor". Fondi i Mbartur nga vitet e kaluara në bazë të evidencës së sjelle nga Drejtoria e Financave Vendore i miratuar nga Ministri i Financave më datë 20.02.2017 është 6,720.5 milionë lekë. Konstatohet se kjo vlerë ka të pareflektuar fondin e mbartur të tre projekteve në përbërje të listës prej 17.5 milionë lekësh si dhe vlerën e mbartur të 13 projekteve të tjera të ndryshuar me pesë shkresa gjatë vitit me miratim të Ministrit prej 138 milionë lekësh. Ndërkohë në tabelën me evidencë përfundimtare të Fondit të Mbartur sjellë nga Drejtoria e Financave Vendore pas konstatimeve të mësipërme vlera e Fondit të Mbartur është 6,878 milionë lekë, vlerë e cila përsëri ndryshon me vlerën e përllogaritur të Fondit të Mbartur pas sistemimeve të ndryshimeve të mësipërme prej 6,876 milionë lekë, me një diferencë prej 1.5 milionë lekësh të pashpjeguar. Trendi ndër vite i këtij programi paraqitet si më poshtë.

Tabela 30: Trendi sipas Qarqeve "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale"

Nr.	Qarku	2015	2016	2017
1	Berat	5%	9.7%	5%
2	Dibër	2%	1.6%	1%
3	Durrës	9%	8.5%	8%
4	Elbasan	6%	14.9%	10%
5	Fier	11%	20%	17%
6	Gjirokastër	37%	13.1%	7%
7	Korcë	4%	7%	16%
8	Kukës	7%	11.2%	2%
9	Lezhë	2%	1.4%	4%
10	Shkodër	3%	2.1%	4%
11	Tiranë	2%	1.9%	19%
12	Vlorë	11%	7.9%	8%
				100%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Grafiku 30: Trendi sipas Qarqeve "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale"



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

3.6 Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Planifikimi, miratimi dhe realizimi i shpenzimeve dhe të ardhurave për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2017, si dhe realizimet e dy viteve më parë, janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 31: Planifikimi, miratimi dhe realizimi i shpenzimeve dhe të ardhurave për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2017 *mln lekë*

	Emërtimi			Viti 2017					
		Fakti 2015	Fakti 2016	Tavanet	Faza I dhe II	Mir. KA	Ligji 2017	Ligji me ndrysh.	Fakti 2017
I	**TOT.SHPENZIMEVE**	**107,309**	**114,276**	**119,609**	**120,510**	**120,200**	**120,200**	**121,200**	**119,081**
1	Shpenzime për përfitime	88,904	93,457	101,619	102,280	102,046	102,046	101,428	100,174
2	Shpe per progra të tjera	11,497	13,687	10,200	10,446	10,041	10,041	11,989	11,829
3	Shp për skemën suplemle	4,892	4,973	5,540	5,537	5,823	5,823	5,423	4,933
4	Shpenzime administrative	2,016	2,159	2,250	2,247	2,290	2,290	2,360	2,144
II	**TOT. TË ARDHURAVE**	**108,629**	**115,361**	**119,609**	**120,510**	**120,200**	**120,200**	**121,200**	**122,261**
1	Nga kontributet	60,148	68,118	69,295	71,120	70,268	70,168	71,868	73,556
2	Nga buxheti i shtetit	48,481	48,978	50,314	49,390	49,932	50,032	49,332	48,705

Me ligjin fillestar shpenzimet dhe të ardhurat janë programuar në vlerë 120,200 milionë lekë, i njëjtë me ligjin me ndryshime në total, por duke ndryshuar zërat e shpenzimeve dhe të ardhurave;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 119,081 milionë lekë pra shpenzimet janë ritur me 4.2% në krahasim me një vit më parë;
- Realizimi i të ardhurave në masën 122,261 milionë lekë pra 6% më shumë se një vit më parë, ndërsa kontributet 8% më shumë se një vit më parë.

Gjatë auditimit të programimit të buxhetit të ISSH u konstatua:

1. Programimi afat mesëm i ISSH, ka vështirësi në përllogaritjen e tij sepse ende nuk ka një bazë të plotë të të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë, dhe për pasojë edhe baza e vlerësuar për efekt të përllogaritjes së pensionit, kalkulohet rast pas rasti.

[shqiptaria.com]

Mbi bazë parashikimesh përllogaritet edhe numri i invalidëve, pensioneve familjare etj, si dhe e pensioneve të parakohshme e suplementare, numri i të cilëve varet nga reformat që parashikojnë institucione të tjera si ushtria, policia, administrata publike etj.

Për numrin e pensioneve të reja pleqërisë, për të cilët ka informacion të plotë nga regjistri i shtetasve, përsëri ka problematika planifikimi, që lidhen me paraqitjen e kërkesave për përfitimet, sepse rreth 40% e popullsisë shqiptare të regjistruar, gjendet jashtë shtetit.
Për këto arsye dhe të tjera, programi buxhetor i sistemit të sigurimeve shoqërore, mbetet të shqyrtohet e rishqyrtohet e ndryshohet deri në ditën e miratimit në kuvend. Veç kësaj ky program, për shkak të madhësisë së shifrave edhe pasaktësitë nëpërqindje të vogla, sjellin efekte financiare shumë të larta.
2. Faza e parë e programimit afat mesëm në këtë institucion, **nuk ka obliguar dhe angazhuar asnjëherë strukturat e varësisë** së këtij institucioni**,** por vetëm strukturën qëndrore të saj, e cila parashikon dhe programon në kohë afat-mesme shpenzimet e ISSH. E njëjta gjë ka ndodhur dhe për fazën e parë të PBA 2017-2019.
3. Deri në vitin 2017, **programi i të ardhurave** si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve, të cilat mblidhen nga **DPT**, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe për rrjedhojë, **ISSH ka marë tregues të gatshëm** për të ardhurat. Si rezultat në programimin e të ardhurave të vitit 2017, kishte rezerva e kjo u konstatua me faktin që, megjithëse programimi i tyre u shtua me akte normative, përsëri të ardhurat nga kontributet që u mblodhën nga DPT, janë tejkaluar me mbi 2.8 miliardë lekë.
4. Ritja e vogël e të ardhurave nga **sigurimi i fermerit dhe sigurimi vullnetar** është përgjegjësi e strukturave që merën me kontributet në ISSH, e sidomos e ritjes së përgjegjshmërisë së inspektorëve në këtë sektor; Domosdoshmërisë për një ripërcaktimin e termit "fermer" nga Ministria e Bujqësisë; Rishikimit të skemës së pensioneve për fermerët, shoqëruar me ndryshimet ligjore për këtë proces.
5. ISH ka përcaktuar faktorët kryesorë, që ndikojnë në **ritjen e shpenzimeve të vitit 2017**, kundrejt vitit 2016, të cilët janë: Politika e rritjes së pensioneve, e cila parashikohet të ketë një efekt financiar prej 2,600 milionë lekë; Pensionistët përveç pensionit mujor, marin edhe një serë të ardhurash të tjera të formës së kompensimeve, ose programeve, ndërkohë që rreth 90 mijë pensionistë kryefamiljarë marin edhe kompensime të veçanta të ritjes së çmimit të energjisë elektrike, në shumën 1,288 lekë në muaj.
Auditimi i të ardhurave të sigurimeve shoqërore për vitin 2017.
I. Nga kontributet e sigurimet shoqërore dhe të tjera, në vlerë 73,556 milionë lekë ose 60%, të derdhura nga subjektet fizike e juridike, privatë e buxhetore, kontribues të bujqësisë dhe vullnetarë dhe të ardhura të tjera, të cilat grumbullohen 95% nga strukturat e DPT dhe 5% nga strukturat e ISSH).
II. Nga Financimet të buxhetit të shtetit, në vlerë 48,705 milionë lekë ose 40%, të cilat shërbejnë për mbulimin e disa skemave të pensioneve dhe financime nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve.
Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 dhe të konfirmuara përfundimisht nga DPT dhe MFE, por edhe për tre vite më parë, ndryshimet e tyre nga viti në vit, si për kontributet dhe financimet, janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

lsh.gov.al

Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 dhe të konfirmuara përfundimisht nga DPT dhe MFE, por edhe për tre vite më parë, ndryshimet e tyre nga viti në vit, si për kontributet dhe financimet, janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 32: Dinamika e të ardhurave të realizuara *mln lekë*

		2014		2015		2016		2017	
	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	**Në%**	**Në vlerë**	**Në%**	**Në vlerë**	**Në%**	**Në vlerë**	**Në%**	**Në vlerë**
1	Nga DPT	48	53,103	56	57,563	55	63,901	58	70,543
2	Nga ISSH (bujqësi & vullnetar)	7	8,035	2	2,375	2	2,337	2	2,610
	Të ardhurat nga Kontributet	**55**	**61,138**	**58**	**59,938**	**57**	**66,238**	**60**	**73,153**
3	Të ardhura të tjera	1	582	0	210	0	145	0	402
I	**NGA KONTRIBUTET & TË TJERA**	**56**	**61,720**	**58**	**60,148**	**57**	**66,383**	**60**	**73,556**
-	*Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë*				*-1,572*		*+6,235*		*7,172*
-	*Ndryshimi në % nga një vit më parë*			*+2%*	*-2.6%*	*-1%*	*+10.4%*	*+3%*	*+10.8%*
1	**Financime për mbulimin e skemave**	**17**	**18,097**	**19**	**18,968**	**19**	**21,885**	**15**	**18,146**
a	kontribute te buxhetit	3	3,292	3	2,876	3	3,712	3	3,237
b	grant nga buxheti per pagesa te posacme	10	10,815	11	11,090	12	13,365	8	9,858
c	grant nga buxheti per trajtime te vecanta	4	3,990	5	5,002	4	4,808	4	5,051
2	**Grant nga buxheti per mbulim e deficitit**	**27**	**29,618**	**23**	**23,466**	**24**	**27,093**	**25**	**30,559**
II	**FINANC NGA BUXHETI I SHTETIT**	**44**	**47,715**	**42**	**42,434**	**43**	**48,978**	**40**	**48,705**
-	*Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë*			*-2%*	*-5,281*		*6,544*		*-273*
-	*Ndryshimi në % nga një vit më parë*				*-11%*	*+1%*	*+15.4%*	*-3%*	*-0.6%*
	TOTALI TË ARDHUR& FINANCIMI.	**100**	**109,435**	**100**	**102,582**	**100**	**115,361**	**100**	**122,261**
-	*Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë*				*-6,853*		*+12,779*		*6,900*
-	*Ndryshimi në % nga një vit më parë*				*-6.3%*		*+12.5%*		*+6%*

Të ardhurat (hyrat) gjithsej për vitin 2017 janë realizuar në vlerë **122,261 milionë lekë,** nga 115,361 milionë lekë të realizuara një vit më parë, pra janë realizuar këtë vit 6,900 milionë lekë, ose **6% më shumë** se në vitin 2016, të ndara:

- Të ardhurat nga kontributet dhe të tjera për vitin 2017, zënë 60% të të hyrave në këtë institucion, janë realizuar për 73,556 milionë lekë, nga 66,383 milionë lekë realizuar një vit më parë, pra janë realizuar më tepër për 7,173 milionë më shumë, ose rreth 11% më shumë se në vitin 2016;
- Financime nga buxheti i shtetit për vitin 2017, janë realizuar për 48,705 milionë lekë, nga 48,978 milionë lëkë, realizuar një vit më parë, pra janë realizuar për 273 milionë më pak, ose 0.6% më pak se në vitin 2016.

Të dhënat mbi numrat e kontribuesve:

Numri mesatar i kontribuesve sipas degëve për vitin 2017, të krahasuar me një vit më parë parë, janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 33: Numri mesatar i kontribuesve sipas degëve për vitin 2017

SUBJEKTET	Nr. mes vjetor 2016	Nr. mes vjetor 2017	Dif. 2017	me 2016
Publike	155,401	158,002	2,601	1.6
Private	445,763	481,467	35,704	8
Totali (kontribues nga DPT)	**601,164**	**639,469**	**38,305**	**6.4**
Të vetëpunësuar në bujqësi	53,168	58,528	5,360	10.1
Të siguruar vullnetarë	7,323	8,027	704	9.6
Të siguruar të tjerë (nga shteti)	40,780	41,015	235	0.6
Kontribues nga PASH	15,851	16,959	1,108	7
TOTALI	**718,286**	**763,998**	**45,712**	**6.4**

Numri mesatar vjetor i kontribuesve për vitin 2017 është 763,998 kundrejt 718,286 kontribues që ishte një vit më parë me nje rritje prej 45,712 kontribuesish, ose rreth 6.4% më shumë se një vit më parë. Raporti i kontribuesve për 1 përfitues, për vitin 2017 tregoi përmirësime duke u rritur nga 1.23 kontribues për 1 përfitues, në 1.17 që ishte në vitin 2016.

1. Kontributet (të ardhurat) e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve (DPT), të ndara me sektorin publik dhe privat, sigurimin suplementar,

[shqiptaria.com]

planin e faktin e 2017, të krahasuar me faktin e një viti më parë, kontributet janë analizuar si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 34: Kontributet (të ardhurat) e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve mln lekë

Nr.	Kontribuesit	Fakt 2016	2017		Ndryshimet faktit 2017 me:			
			Plan	Fakt	Planin 2017		Fakt 2016	
					vlerë	Në %	vlerë	Në %
I	**Sektori Publik**	**28,026**	**30,066**	**30,427**	**361**	**1.2**	**2,401**	**8.6**
1	Buxhetore	23,138	25,766	26,267	501	1.9	3,129	13.5
2	Jo Buxhetore	3,678	4,300	4,160	-140	-3.3	482	13.1
II	**Sektori privat**	**35,709**	**37,850**	**38,803**	**953**	**2.5**	**3,094**	**8.7**
1	Bisnes i madh	29,723	31,400	33,711	2,311	7.4	3,988	13.4
2	Biznesi i Vogël	5,986	6,450	5,092	-1,358	-21.1	-894	-15.0
III	**Sigurim Suplementar**	**1,204**	**1,250**	**1,314**	**64**	**5.1**	**110**	**9.1**
IV	**Të tjera**	**164**	**0**	**190**	**190**	**-**	**26**	**15.9**
	Totali (I+II+III+IV)	**63,893**	**69,166**	**70,734**	**1,568**	**2.3**	**6,841**	**10.7**

Drejtoria e Kontributeve, referuar analizave të lëvizjes dhe dinamikës së tregut të punës, pjesmarjes së individëve dhe sidomos të analizës së pagave mesatare, mbi të cilat llogariten dhe paguhen kontributet, *evidenton problematika, si dhe evazion fiskal, kryesisht:*

a. Në subjektet e biznesit të madh, subjektet fason, në disa subjekte që zhvillojnë veprimtari profesionale, në medja etj, ku rezervat për rritjen e të ardhurave nga kontributet janë për t'u ndjekur nga të dy institucionet si nga DPT dhe ISSH, me qëllim rritjen e të ardhurave të fondit nga kontributet.

b. Konstatohet se ka **mungesa në numrin e listëpagesave** vjetore që duhet të dërgojë DPT-ja në ISSH dhe veçanërisht këto të identifikuara për vitin 2014, ku mungojnë një sasi e konsiderueshme listëpagesash dhe kryesisht për muajt tetor - nëntor. Për këtë çështje është vënë në dijeni zyrtarisht DPT-ja dhe po merren masat që ky informacion të kalohet, pasi ato listëpagesa gjenden në bazën e të dhënave të DPT-së. Kjo çështje është në proces zgjidhje teknike, por ka krijuar problematika në përdorimin online të kësaj baze, për caktimin e pensioneve të atyre personave që kanë mungesa. Krahas kësaj shqetësuese mbetet mungesa e informacionit për ato raste kur subjektet gjenden me detyrime të papaguara, ose të paguara pjesërisht, pasi gjendemi përpara situatës së mungesës së periudhave të sigurimit. (analiza e debitorëve). Mangësi dhe probleme të mbartura të periudhave të kaluara, në marrëdhëniet ndërmjet organeve të sigurimeve shoqërore dhe organet tatimore dhe që aktualisht janë në ndjekje nga Degët e Kontributeve në DRSSH dhe në ISSH dhe duke u bërë rast pas rasti rregullimi dhe plotësimi i tyre.

c. Problematike mbetet çeshtja e **listë pagesave të munguara të formatit letër** të periudhës 2006-2012, ndërsa gjatë vitit 2017, janë saktësuar dhe përditësuar inventarët e mungesave dhe për këtë janë njoftuar rregullisht Drejtoritë Rajonale Tatimore. Në fund të 2017, rezultojnë gjithsej **1,810,880 listë/pagesa të munguara** dhe nga këto: 1,703,858, ose rreth 95% janë listë/pagesa të munguara të të vetëpunësuarve (biznes i vogël); 101,226, ose rreth 6% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private); 5,796 janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë).

d. Drejtoria e Financë**, kontabilizimin e kontributeve nga DPT** e ka realizuar me 131 kërkesa për trasferta kontributesh, e kjo në varësi të kërkesave ditore të shpenzimeve në llogarinë 512100 "Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesarit TSA", në vlerë **70,734,052,482 lekë.**

Në vijim Manuali Kontabël i ISSH, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.758/2, datë 04.03.2004, mbi të cilin ISSH mbështetet për kontabilizimin e transaksioneve dhe llogarive, parashikon se çdo nënllogari pasqyron përfitimet që rrjedhin nga një nen i veçantë i ligjit nr.7703, datë 11.05.1993. Por gjatë auditimit kemi konstatuar se, nëtabelën fiskale dhe në llogarinë vjetore të ISSH, **nuk janë parashikuar llogari të ardhurash sipas degëve** që parashikon ky ligj. Pra Drejtoria e Financës në ISSH, kontributet e derdhura nga DPT, nga personat juridike e fizikë, subjektet publikë dhe privatë dhe sistemimet e mëvonshme të këtyre kontributeve, **nuk i rregjistron në kontabilitet me nr.llogarish të specifikuar për çdo lloj kontributi**, por i rregjistron në një llogarinë 512100 "Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesari-TSA", llogari e cila nuk jep sigurinë analitike të krijimit të të ardhurave. Si pasojë, në pasqyrat financiare të konsoliduara të ISSH, kjo shumë reflektohet në mënyrë joanalitike, në kundërshtim me ligjin nr.7661, datë 10.04.1998 "Për kontabilitetin".

e. Nga drejtoria e kontributeve të këtij institucioni, është raportuar se **numri i subjekte debitore** në vitin 2017 është 63,531, në vlerë **9.1 miliardë lekë,** ndërsa në vitin 2016 ka qenë 9.3 miliard lekë.

Debitorët e sigurimeve shoqërore që evidentohen në DPT, prodhojnë një problem mjaft të madh social dhe financiar për organet e sigurimeve shoqërore, sepse pas subjekteve debitorë dhe shumave të papaguara të kontributeve, janë një numër i konsiderueshëm personash të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, por ka efekt financiar, sepse deri tani, fondit të sigurimeve shoqërore, nuk i janë vënë në dispozicion rreth 9.1 miliard lekë detyrime kontributive të prapambetura.

Për këtë vit, po dhe në vazhdimësi ISSH ka bërë bërë prezent organeve eprore problemin shqetësues të numrit të lartë dhe detyrimeve të prapambetura për kontribute të papaguara, të subjekteve debitorë në organet tatimore. Këta janë debitorë të krijuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruara dhe të pa derdhura në ISSH, ose kontribute të deklaruar më shumë se sa janë derdhur për llogari të ISSH, e të pa shoqëruara me listë pagesat përkatëse, **në kontabilitetin e këtij institucioni nuk janë të rregjistruar**, por janë vetëm si evidencë statistikore në Drejtorinë e Kontributeve të tij.

f. Debitorë në organet tatimore të vitit 2017, të krahasuar me vitin 2016, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 35: Detyrimet e papaguara nga subjektet *mln lekë*

Nr	EMERTIMI	Detyrimet e papaguara nga subjektet						Dif. krahasuese 2017- 2016	
		2015		2016		2017			
		Nr. i subj.	Në vlerë	Nr. subj.	Në vlerë	Nr. i subj	Në vlerë	Nr. i subj	Në vlerë
I	**Sektori Publik**	**1,368**	**1,712**	**1,993**	**2,127**	**987**	**1,146**	**-1,006**	**-981**
1	Buxhetore	1,168	1,253	1,776	1,659	743	809	-1,033	-850
2	Jobuxhetore	200	459	217	468	244	337	27	-131
II	**Sektori Privat**	**55,479**	**8,815**	**119,547**	**14,245**	**6,2544**	**9,706**	**-57003**	**-4542**
3	Biznes i madh	11,752	6,252	23,386	9,428	15,675	6,970	-7,711	-2,458
4	Biznes i vogel	43,727	2,563	96,161	4,817	46,869	2,733	-49,292	-2,084
	GJITHSEJ (I+II)	**56,847**	**10,527**	**121,540**	**16,372**	**63,531**	**10,849**	**-58,009**	**-5,523**

Megjithëse ka ulje të vlerës së përgjithëshme të debitorëve, detyrimi kontributiv pra principiali, kundrejt situatave krahasuese të mësiparshme, është pakësuar

vetëm për rreth 267 milionë lekë, pjesa tjetër e pakësimeve janë gjoba dhe interesa.

Debitorët e krijuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruara dhe të pa derdhura, ose të deklaruar më shumë e të derdhura me pak, <u>në financën e këtij institucioni, nuk janë të rregjistruar</u>**,** por janë vetëm si evidencë statistikore në Drejtorinë e Kontributeve të këtij institucioni.

2. Realizimi i kontributet sigurimeve shoqërore, të mbledhura e kontabilizuara në ISSH, janë të organizuara dhe të ndara: Kontribute të vetpunësuarve në bujqësi; Kontribute të siguruarve vullnetarë; Të ardhura të tjera. Këto të ardhura të planifikuara në buxhetin vjetor 2017, të realizuar nga ISSH në drejtoritë rajonale, janë të evidentuara si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 36: Realizimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore *mln lekë*

Nr.	Rajonet	GJITHSEJ		Ndrysh fakt-plan		Vet/sigurur bujqësi		Sigur.vullnetar		Të tjera	
		plan	fakt	Në vlerë	Në%	plan	fakt	plan	Fakt	plan	fakt
1	Shuma rajone	2,852.0	2,697.8	-154.2	95	2,382.0	2,193.7	470.0	482.9	0.0	21.1
2	Shuma të tjera	0.0	190.9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	190.9
	shuma	**2,852.0**	**2,888.7**	**-154.2**	**95**	**2,382.0**	**2,193.7**	**470.0**	**482.9**	0.0	**212.0**

Nga auditimi rezultoi:

a. Kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi, për vitin 2017 në vlerë sipas bilancit përmbledhës (llogaritë 753 kontribute &711 kamat vonesa), janë realizuar **2,126.67 milionë lekë** dhe nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Financës ndjek dhe kontabilizon në pasqyrat financiare vetëm vlerën e likuijduar, nga fermerët, <u>duke lënë jashtë kontabilitetit të dhënat mbi debitorët e krijuar si pasojë e gabimeve</u>, ndjekja e të cilëve vijon të bëhet vetëm nga dega e kontributeve të institucionit. Moskontabizlimi i debitorëve për diferencat e papaguara shtrembëron vlerën e regjistruar të debitorëve në kontabilitet. Diferenca e konstatuar nga ana jonë, janë pragun e materialitetit për të ardhurat, e megjithatë merr rëndësi sa i takon <u>rregullimit të procesit në tërësi</u>**,** që lidhet me ndjekjen e debitorëve (gjurmimin e zërit respektiv) dhe minimizimin e riskut që ky fenomen paraqet nëse shtrihet në të gjitha njësitë shpenzuese.

Debitorët e mbetur në organet e sigurimeve shoqërore ISSH, pra numri i debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi ka një ulje prej 3,745 fermerë, ndërsa detyrimeve e papaguara kanë një ritje për vitin 2017 prej 558 milionë lekë, si në tabelën e mëposhme:

Tabela 37: Ndryshimet e detyrimeve të debitorëve për kontributet *mln lekë*

Nr.	E m ë r t i m i	Nr. fizik	Det. gjithësej	Nga këto:	
				Detyr. Kontr.	Kam/von
1	**Gjendja progresive në fillim të vitit 2017**	**34,196**	**1,769**	**1,753**	**16**
2	Shtuar gjatë 2017	453	984	977	7
3	Pakësuar në 2017	4,198	427	424	3
4	**Gjendja progresive në fund të vitit 2017**	**30,451**	**2,327**	**2,306**	**21**
	Diferenca nga një vit më parë	*-3,745*	*558*	*553*	*5*

b. Të ardhurat e kontributeve nga Sigurimi Vullnetar (llogaria 753& 711 kamatvonesat) për vitin 2017, në vlerë sipas bilancit përmbledhës janë realizuar **482.92 milionë lekë,** nga 470 milionë lekë të programuara dhe nga 418 milionë lekë të realizuara një vit më parë. Kjo vlerë e kontributeve vazhdon të jetë minimale, sepse pjesa dërrmuese e klientëve të skemës (kryesisht janë kontribues emigrantë), sigurohen vetëm për të mbuluar minimumin prej 15

lshqiptaria.com

vitesh për përfitim të pensionit të pjesshëm dhe më pas largohen nga skema e kontributeve.

c. Të ardhura të tjera të hyra në **ISSH** për vitin 2017 (llogaritë 752,765,711,710,719 dhe llogaria 116) janë realizuar në vlerë **212.61 milionë lekë**, përbëhen nga: Kontributet nga subjekte të tjera, ISSH (llogaria 752/0100), në vlerë 18.50 milionë lekë; Të ardhura nga interesat, në vlerë 191.39 milionë lekë (llogaria 765), e cila përbëhet:Të ardhura nga interest e depozitave, në vlerë 56.29 milionë lekë (llogaria 765/101); Të ardhura nga interesat e ankandeve në blerjen e titujve të qeverisë, në vlerë 135.09 milionë lekë, (llogaria 765/102); Të ardhura të tjera, në vlerë 2.73 milionë lekë (llogaritë 711-të ardhura nga komisione për shërbime, 710- të ardhura nga pronësia, 719-të ardhura jo tatimore dhe 116- të ardhura nga shitja e aktiveve të trupëzuara), janë të ardhura të kontabilizuar edhe në drejtoritë Rajonale dhe në buxhetin e Përgjithshëm.

3. Të ardhurat për mbulimin e skemave të veçanta të pensioneve dhe mbulimin e deficitit. Këto hyrje përbëjnë financimet e buxhetit të shtetit, dhe për vitin 2017 janë 48,705 milionë lekë, ose zënë **40%** të totalit të të ardhurave (të hyrave).

a. Të ardhura **për mbulimin e skemave të pensioneve**, për vitin 2017, në vlerë **18,146 milionë lekë**, është programuar për çdo lloj skeme, po në këtë vlerë dhe terheqja e tyre, është e barabartë me planifikimin. Shuma e transfertat të kontabilizuara ishte sa shuma e rakordimeve midis Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Thesarit në MFE, në po këtë shumë.

b. Të ardhura për **mbulimin e deficitit** për vitin 2017, në vlerë **30,559 milionë lekë,** është programuar për 2 lloj skeme, po në këtë vlerë dhe terheqja e tyre ka rezultuar 626.5 milionë më pak se planifikimi.

U audituan të gjitha trasfertat nga "llogaria e unifikuar e thesarit TSA" dhe ishin të plotësuara me dokumentacionin e domosdoshëm ligjor, por duke krahasuar të dhënat e gjeneruara nga sistemi i Thesarit (Ministria e Financave) **për klasën 604**, me të dhënat e gjeneruara nga sistemi "Oracle" i ISSH (aplikuar vetëm nga Drejtoria e Financës në ISSH, pasi drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore ende vijojnë të punojnë me excel) dhe me të dhënat e evidencës fiskale, të përgatitur nga Njësia e Buxhetit të Përgjithshëm në ISSH për këtë kategori të ardhurash, rezultoi se vlera totale e transfertave nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficit edhe për mbulimin e skemave ishte e njëjtë në shumën 48,705 milionë lekë, por e specifikuar në llogari të ndryshme sipas transfertave kishte diferenca dhe dy problematika:

Sistemi i Thesarit dhe ISSH në disa raste kanë mospërputhje të klasave 604 dhe 7, të cilat në fakt duhet të përputhen plotësisht, pasi vetëm kështu mund të gjurmohet të ardhurat dhe përdorimi i tyre sipas destinacionit të planifikuar nga burime të ndryshme. Konstatohen diferenca edhe në vlera individuale për secilën llogari, edhe pse vlera totale e transfertës nga buxheti i shtetit rakordon me të ardhurat e ISSH.

Problematikat e mësipërme diktojnë nevojën e krijimit të një nomenklature të përbashkët llogarish e nënllogarish, mes ISSH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për transfertat nga buxheti i shtetit si për mbulimin e deficit, ashtu edhe për mbulimin e skemave të pensioneve**.**

B. Realizimi i total shpenzimeve të skemës së pensioneve për vitin 2017 rezultoi në në vlerë 119,081milionë lekë, ose rreth 99.2% ndaj planit fillestar prej 120,000

[shqiptarja.com]

milionë lekë, ose realizuar më pak për 919 milionë lekë; ndërsa u realizuan akoma më larg planit të rishikuar prej 121,200 milionë lekë, konkretisht me 2,119 milionë lekë më pak, ose realizuar rreth 98,2% ndaj planit të ndryshuar. Ndërsa krahasuar me një vit më parë,shpenzimet e vitit 2017, janë më shumë se viti 2016 për 4,805 milionë lekë, ose rreth 4% më shumë.

Realizimi i shpenzimeve për përfitime për vitin 2017 rezultoi në vlerën 100,174 milionë lekë, ose rreth 98% ndaj planit fillesar prej 102,046 milionë lekë, ose rreth 1,877 milionë lekë më pak; ndërsa krahasuar me planin e ndryshuar prej 101,428 milionë lekë ky zë u realizua në masën 98,8%, ose 1,259 milionë lekë më pak. Shpenzimet për përfitime në vitin 2017, u rritën me 6,712 milionë lekë në krahasim me një vit më parë.

Realizimi i shpenzimeve për programe të tjera për vitin 2017 rezultoi në vlerën 11,829 milionë lekë, ose rreth 118% ndaj planit fillesar prej 10,041 milionë lekë, ose rreth 1,788 milionë lekë më shumë; ndërsa krahasuar me planin e ndryshuar prej 11,989 milionë lekë ky zë u realizua në masën 98.7%, ose 160 milionë lekë më pak. . Shpenzimet për programe të tjera në vitin 2017, u ulën me 1,858 milionë lekë në krahasim me një vit më parë.

Realizimi i shpenzimeve për skemën suplementare për vitin 2017 rezultoi në vlerën 4,939 milionë lekë, ose rreth 85% ndaj planit fillesar prej 5,823milionë lekë, ose rreth 884 milionë lekë më pak; ndërsa krahasuar me planin e ndryshuar prej 5,423milionë lekë ky zë u realizua në masën 91%, ose 484 milionë lekë më pak. Shpenzimet për skemën suplementare në vitin 2017, u ulën me rreth 34 milionë lekë në krahasim me një vit më parë.

C. Deficiti i degës së pensioneve për vitin 2017 rezultoi në shumën 27,458 milionë lekë, ose rreth 817 milionë lekë më pak nga plani fillestar prej 28,275 milionë lekë. Ky tregues u rrit me 317 milionë lekë apo rreth 1% më shumë, në krahasim me vitin 2016, ku deficiti ishte 27,141.5 milionë lekë, ndërsa në raport me PBB[2]-në ky tregues është përmirësuar nga 1.77 pikë në vitin 2016, në 1.03 pikë në vitin 2017. Rezultat i rritjes së deficitit, krahasuar me një vit më parë, është rritja më shumë e shpenzimeve me 6,752 milionë lekë, se rritja e të ardhurave me 6,435 milionë lekë. Faktorë që kanë ndikuar në rritjen e deficitit në vitin 2017, ndër të tjera janë:

- rritja e shpenzimeve të pensioneve me rreth **1,900 milionë lekë** si pasojë e indeksimit, 4 muaj më herët se vitet e tjera (ndërsa për 4 vite rresht nga 2013-2016, indeksimi është bërë në muajin gusht, për vitin 2017, ky indeksim u bë në muajin mars) [3]; si dhe

- mosrealizimi i të ardhurave me **rreth 900 milionë lekë,** si pasojë e rritjes së pagës minimale për efekt pensioni 3 muaj më vonë nga indeksimi i pensioneve. Gjykojmë të arsyeshme nga pikpamja metodologjike që, në momentin e rritjes/indeksimit të pensioneve, te behet edhe rritja/indeksimi i pages minimale.

Për të shmangur risqe që lidhen me politizimin e procesit të indeksimit, si dhe për të minimizuar impaktin e procesit në rritjen e deficitit si pasojë e shtimit të muajve por edhe luhatjeve të vetë koeficientit të indeksit në muaj të ndryshëm të vitit, theksojmë nevojën e aplikimit të indeksimit të pensioneve dhe politikave

[2] PBB = 1,555,200 milionë lekë

[3] VKM 130 date 1 mars 2017

Ishqiptarja.com

që lidhen me këtë proces, në periudha të njëjta cdo vit, sikundër eshe është vepruar deri në vitin 2016.

Deficiti i degës së pensioneve të fshatit rezultoi në shumën 11,371.11 milionë lekë, nga 11,593.2 milionë lekë një vit më parë, ose rreth 222 milionë lekë më pak, apo 2% më pak se një vit të parë;

Deficiti i degës së pensioneve të qytetit rezultoi në shumën 16,087.08 milionë lekë, nga 15,548.3 milionë lekë një vit më parë, ose rreth 539 milionë lekë më shumë, apo 3% më shumë se një vit të parë.

1. Deficiti i degës së pensioneve të fshatit, edhe pse në vlerë nominale, rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar[4], deficiti i skemës konsiderohet i lartë nëse konsiderojmë që skema mbulon vetëm 21.4% të numrit të përgjithshëm të përfituesve. Në fund të vitit 2017 të ardhurat nga dega e pensionit të fshatit kanë mbuluar vetëm 23% të shpenzimeve të kësaj dege, nga 22% që mbuluan një vit më parë. Ndërsa skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, dhe përthith 85% të shpenzimeve shpenzime (pra me një diferencë prej 10% të ardhura mbi shpenzimet), ky raport paraqitet <u>në kah të kundërt</u> për skemën e fshatit, ku kjo e fundit rezulton të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve. Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%. Kjo pasi periudha e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, për efekt pensioni, njihet e njëjtë si për të vetëpunësuarit në qytet, pavarësisht se tarifa e kontributit vjetor të tyre është mesatarisht rreth 57% më e ulët se e qytetit, dhe diferenca për kontributet e tyre mbulohet nga buxheti i shtetit.

2. Deficiti i degës së pensioneve të qytetit është në shumën 16,087 milionë lekë, nga 15,548 milionë lekë që ishte një vit më parë, pra këtë vit deficiti është më shumë për 539 milionë lekë, ose 3% më shumë se një vit më parë. Rezultat i rritjes së deficitit, krahasuar me një vit më parë, është rritja e shpenzimeve me rreth 8% më shumë, ose me 6,649 milionë lekë dhe rritja e të ardhurave 9% më shumë ose me 6,110 milionë lekë (pra rritja e shpenzimeve ka tejkaluar rritjen e të ardhurave me 539 milionë lekë). Në fund të vitit 2017 të ardhurat nga dega e pensionit të qytetit kanë mbuluar rreth 81.5% të shpenzimeve të kësaj dege, nga 80,7% që mbuluan në vitin 2016.

[4]Përmirësimi ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve nga 53,168 që ishin në vitin 2016, në 58,528 në vitin 2017, duke dhënë një impakt të vlerësuar prej 203,6 milionë lekë në kontributet e vitit korent.

[shqiptarja.com]

3.7 Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Programi Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ka parashikuar shpenzime të skemës në shumën 37,500 milionë lekë, të ballancuara me të ardhurat, të cilat do të përballohen 11,305 milionë lekë nga fondet e veta dhe 26,195 milionë lekë nga kontributi i buxhetit të shtetit.

Buxheti i FSDKSH-së, i miratuar me ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016, është në vlerën 38,122 milionë lekë, i ballancuar midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe zë 2.4% të PBB, i parashikuar për financimin e shpenzimeve në dy programet kryesore: **kujdesin shëndetësor parësor dhe kujdesin shëndetësor spitalor.** Në ligjin vjetor të buxhetit është përcaktuar se detajimi dhe përdorimi i fondit për sherbimin spitalor, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga analiza e trendeve dhe tendencave, në krahasim me programin e vitit 2016, buxheti i FSDKSH-së është rritur në vlerë absolute për 3,611 milionë lekë, ose në masë relative 10%, ndërsa krahasuar me faktin e vitit 2016, buxheti është rritur me 11%.

Gjatë vitit 2017 buxheti i FSDKSH ka pësuar ndryshime, pas të cilave plani përfundimtar paraqitet si më poshtë:

Tabela 38: Ndryshimet e buxhetit të FSDKSH *mln lekë*

Zërat e buxhetit	sipas PBA2017-2019	Plani fillestar 2017 miratuar me ligjin vjetor VKA nr. 1, dt 27.01.2017	VKA nr. 5, datë 27.01.2017 (paketat sp. publike)	Akti Normativ nr.3 VKA nr.69, datë 19.12.2018	Plan vjetor përfundimtar 2017
I. Te ardhurat gjithsej	**37.500**	**38.122**	**0**	**200**	**39.405**
1. Kontributi i sigurimeve shendetesore	**11.305**	**10.954**		**200**	**11.154**
2.Kontribut I Buxhetit te Shtetit	**26.195**	**26.990**	**0**		**28.073**
Paresor	8.075	8.097			8.549
Spitalor	18.120	18.893	0		19.524
Spitalet	14.720	14.578	1.006		16,588
paketa, bonus, VKM, PPP	3.400	3.590	-1.006		2.936
Rezerve		725	0		0
3. Te ardhura te tjera+sig.vull		**178**			**178**
II. Shpenzimet gjithsej	**37.500**	**38.122**	**0**	**200**	**39.405**
1. Rimbursimi i barnave (likuidimi)	**9.400**	**9.400**		**700**	**10.100**
2. Shpenzime per kujdesin paresor	**8.080**	**7.783**		**-139**	**8.061**
Financim I qsh:	7.194	6.906		-139.	7.184
Kontrolli baze	886	877			877
3. Shpenzimet administrative	**850**	**879**			**879**
4. Investime	**250**	**367**		**-361**	**6**
5. Shpenzime per Spitalin Durres	**800**	**800**			**835**
6. Financime per Sherbimin Spitalor (thesar)	**18.120**	**18.893**	**0**		**19.524**
paga (600)	7.070	6.734	144		7.565
sigurime (601)	1.180	1.121	23		1.246
mallra e sherbime (602)	6.470	6.724	839		7.777
Paketat	2.600	2.252	-1.006		1.398
rimbursime VKM	60	50			50
transferta per individe (mjeke specialiste)	40	15			15
pagesa e sherb. PPP	700	1.273			1.473
Rezerve spitalori		724			0

Burimi: Drejtoria Ekonomike në FSDKSH

lshqiptaria.com

Nga analiza e të dhënave të mësipërme,rezulton se në planifikimin e shpenzimeve buxhetore, peshën më të lartë specifike e kanë zënë shpenzimet spitalore për 51.7 %, ndjekur nga ato të rimbursimit të barnave 24,6 % dhe kujdesit parësor 20.4%.

Në planifikimin e të ardhurave peshën më të lartë specifike në planifikim e kanë zënë transfertat e buxhetit të shtetit për 70.8% dhe diferenca prej 29,2 % përbëhet nga kontributet e të tjera.

Nga auditimi mbi hartimin e buxhetit, konstatohet:

-Megjithëse në udhëzimet e FONDIT për hartimin dhe zbatimin e buxhetit përcaktohet se ky proces ndjek rrjedhën e Udhëzimeve të Ministrit të Financave për hartimin e konstatohet se, edhe pse buxhetit i fondit në dy programe buxhetore, nuk janë ngritur EMP-et, si për hartimin e PBA e projektbuxhetit të vitit dhe për zbatimin e tij, me arsyetimin se në EMP-et e ngritura në Ministrinë e Shëndetësisë janë 4 përfaqësues të FONDIT.

PBA dhe projektbuxheti nuk janë diskutuar dhe miratuar në GMS, po kështu dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, në moszbatim të kërkesave të ligjit organik të buxhetit dhe të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Janë miratuar me ligjin vjetor të buxhetit 622 milionë lekë më shumë shpenzime për rimbursimin e barnave për një kategori jo kontribuuese në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të VKM nr. 946, datë 28.12.2016 "Për disa shtesa në vendimin nr. 955, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore'" me një ndikim në shumën 600 milionë lekë, **por nga strukturat përkatëse në FOND nuk ka një analizë se sa janë këta përfitues, sipas kategorive përkatëse dhe përfitimi në vlerë i secilës kategori.**

Tabela 39: Realizimi i buxhetit të FSDKSH *mln lekë*

Buxheti per vitin 2017	Fakti 2016	Plani vjetor 2017	Fakt vjetor 2017	Në %	Peshe specifike (fakt)
I. Te ardhurat gjithsej	**35,922**	**39,405**	**38,228**	**97**	**100**
1. Kontributi i sigurimeve shendetesore	**10,699**	**11,154**	**12,268**	**110**	**32.1**
2.Kontribut I Buxhetit te Shtetit	**24,969**	**28,073**	**25,869**	**92.1**	**67.7**
Paresor	8,020	8,549	6,782	79.3	17.7
Spitalor	16,949	19,524	19,087	97.8	49.9
Spitalet		16,588	16,424	99	43
terheqje për paketa, bonus, VKM, PPP		2,936	2,663	90.7	7
3. Te ardhura te tjera+sig.vull	**254**	**178**	**91**	**51.5**	**0.2**
II. Shpenzimet gjithsej	**34,796**	**39,405**	**39,090**	**99.2**	**100**
1. Rimbursimi i barnave (likuidimi)	**8,671**	**10,100**	**10,088**	**99.9**	**25.8**
2. Shpenzime per kujdesin shendetesor paresor	**7,638**	**8,061**	**8,021**	**99.6**	**20.5**
3. Shpenzimet administrative	**787**	**879**	**866**	**98.5**	**2.2**
paga e shperblime (600)	516	581	575	99	
sigurime (601)	83	95	94	98.2	
mallra e sherbime (602)	187	203	197	97.1	
4. Investime	**71**	**6**	**1**	**17**	**0**
Ndertim Montime	1	0	0	0	
Pajisje per zyrat	70	2	1	50	
Rezerve		4	0		
5. Shpenzime per Spitalin Durres	**770**	**835**	**835**	**100**	**2.1**
6. Financime per Sherbimin Spitalor (thesar)	**16,859**	**19,524**	**19,279**	**98.7**	**49.3**
paga (600)	6.595	7,565	7,531	99.5	
sigurime (601)	1,080	1,246	1,230	98.7	
mallra e sherbime (602)	7,685	7,777	7,663	98.5	

[shiptaria.com]

Paketat	1,274	1,398	1,364	97.6	
rimbursime VKM	53	50	24	48.1	
transferta per individe (mjeke specialiste)	7	15	10	67	
pagesa e sherb. PPP	165	1,473	1,457	98.9	
III. Diferenca te ardhura – shpenzime	**+1,126**	**0**	**-862**		

Burimi: Drejtoria Ekonomike në FSDKSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se të ardhurat janë realizuar në masën 97%, ose 1,177 milionë lekë më pak nga plani, ndërsa kundrejt vitit 2016 janë 2,306 milionë lekë më shumë.

Në strukturën e të ardhurave të vitit 2017, peshën specifike më të lartë e zënë të ardhurat nga kontributi i shtetit me 67.7%. Kontributet e sigurimeve shëndetësore zënë rreth 32.1 %, ndërsa grupimi i të ardhurave të tjera zë rreth 0.2 %.

Në krahasim me vitin 2016 të ardhurat faktike në total janë rritur 6.4 %, ose në vlerë absolute rreth 2,306 milionë lekë, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore rezultojnë me rritje në masën 14.7 %, ndërsa kontributi i shtetit ka pësuar një rritje prej rreth 3.6 %. Në vlerë absolute, të ardhurat nga kontributet kanë pësuar rritje 1,569 milionë lekë, ndërsa kontributi i shtetit ka pësuar një rritje prej 900 milionë lekë.

Shpenzimet faktike gjatë vitit 2017 në krahasim me faktin e vitit 2016 janë rritur në vlerën 4,295 milionë lekë, ose 39,090 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2016, nga 34,796 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2016. Rritjen më të lartë e kanë pësuar:

-shpenzimet për kujdesin shëndetësor spitalor në total jane rritur me 2,485 milionë lekë ose 14%.

-Shpenzimet për rimbursimin janë rritur me 1,417 milionë lekë, ose 16.3%.

-Shpenzimet për shërbimin parësor janë rritur me 383 milionë lekë, ose 5%.

Nga analiza e të dhënave nga auditimi, rezulton **se peshën kryesore në strukturën e shpenzimeve** e zenë shpenzimet për shërbimin spitalor me 51.5 % të totalit ose në vlerë absolute janë shpenzuar 20,114 milionë lekë, ose 98.9 % e parashikimit. Rimbursimi i barnave renditet në vendin e dytë me 10,088 milionë lekë (99.9% e parashikimit), ose 25.8% të totalit, Kujdesi parësor, apo financimi i qendrave shendetësore renditet në vend të tretë me 20.5 % të totalit, me 8,021 milionë lekë, ose 99.6% e parashikimit. Shpenzimet e administratës së FSDKSH zënë 2.2% të totalit të shpenzimeve, ku për vitin 2017 janë shpenzuar gjithsej 866 milionë lekë, ose 98.5% e programimit, ndërsa investimet janë realizuar në vlerë absolute për 1.3 milionë lekë, ose rreth 50% e programimit të rishikuar.

Nga auditimi për zbatimin dhe realizimin e buxhetit u konstatua:

-Nga auditimi konstatohet se ndërsa planifikimi i shpenzimeve të rimbursimit si për PBA dhe projektbuxhetin vjetor është bërë i ndarë sipas kategorive të rimbursimit (pensionistë, veteranë, të punësuar, fëmijë 0-14 vjeç, studentë, invalidë, etj.), në detajimin e buxhetit vjetor plani i rimbursimit është çelur në total i pa ndarë në kategori dhe në muaj.

-Me VKA nr. 1, datë 27.01.2017 është miratuar shpërndarja e buxhetit sipas zërave, si në të ardhura dhe shpenzime duke mbajtur rezervën e parashikuar. Me këtë vendim shpenzimet për rimbursimin e barnave janë çelur vetëm katër mujorin e parë dhe diferenca është kaluar në rezervë të pashpërndarë.

ishmbarja.com

Gjithashtu është përcaktuar që këto shpenzime do të çelen të ndara në katër mujor, duke bërë më parë një analizë për nivelin e rimbursimit në secilën drejtori rajonale. Konstatohet se nga FONDI në muajin qershor është çelur shpenzimi i parashikuar për 8/mujorin pa një analizë të thelluar për realizimet, tejkalimet, problematikën në secilën degë, etj.

-Me VKM nr. 18, datë 11.01.2017 është miratuar detajimi i shpenzimeve të shërbimit spitalor sipas spitaleve në zëra buxhetor, i shpenzimeve në total: të paketave që do të ofrohen në shërbimi spitalor publik dhe privat; shpenzimet për shërbimet që kryhen nëpërmjet Partneritetit Publik Privat, sikurse janë dializa dhe sterilizimi i seteve mjekësore dhe bonuset që parashikohen tu jepen mjekëve.

Në këtë VKM parashikohet që buxheti i paketave parashikohet në global dhe me çmimin e miratuar me VKM dhe do të shpërndahet nga Këshilli Administrativ i FONDIT, por dhe ky në zëra buxhetor shpenzimesh(paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative), pra **edhe pse në pamje të parë paraqitet dhe relatohet së shpenzimet spitalore po parashikohen në bazë të kostifikimit të tyre duke hartuar paketa, në fakt buxhetimi vazhdon të bëhet më praktikën historike të planifikimit, atij mezëra buxhetorë shpenzimesh. Për më tepër që në shpenzimet për paketat u shtohen spitaleve shtetërore dhe marzh fitimi, i cili nuk bën sens në planifikimin buxhetor, por as në konceptin e spitalit publik si institucion jo fitimprurëse.**

-Nga auditimi u konstatua se: Për vitin 2017, për shërbimin **e Check-up,** për rastet e pakryera nga koncesionari, FONDI i ka likuiduar këto raste me vlerën e plotë, **duke mos marrë në konsideratë rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2016,** sipas të cilave koncesionari duhej të ishte paguar vetëm për vlerën e shpenzimeve fikse për çdo kontroll bazë dhe jo për vlerën e shpenzimeve variabël të parashikuar që llogariten rreth 400 lekë për **Check up** (pa TVSH), pasi koncesionari nuk ka kosto materiale për këto raste, fakt që do të kishte **ulur koston për buxhetin në vlerën 63.4 milionë lekë,** (158,395 raste të pakryera*400 lekë/rast).

Nga FONDI, vijon të pranohen dhe likuidohen faturat tatimore mujore të **Check-up,** lëshuar nga koncesionari, në vlerën totale 876 milionë lekë, në të cilën përfshihet edhe TVSH në masën 20% mbi vlerën e shërbimit shëndetësor, ndërkohë që ky furnizim shërbimi duhet të trajtohet si Furnizim i Përjashtuar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, sipas përcaktimit ligjor në Nenin 51 pika c) e Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R.SH", i ndryshuar, **duke krijuar kosto shtesë në buxhet, që për vitin 2017 llogaritet në shumën 146 milionë lekë.**

Gjatë vitit 2017 nëpërmjet shërbimit spitalor janë kryer shpenzime edhe për mbulimin e shërbimeve të dializës, paketave në institucionet shëndetësore jopublike, si dhe të PPP, konkretisht:
-Për paketën e dializës në spitalet jopublike janë likuiduar 1,157 milionë lekë, për 99,937 seanca;
-Për koncesionarin "D. V.", në 5 spitale rajonale i janë likuiduar 410 milionë lekë, për 36,619 seanca;
-Referuar të dhënave të FONDIT rezulton se, paketat e tjera janë realizuar për 805 raste në spitalet jo publike, duke ju likuiduar 141 milionë lekë.
-Gjatë vitit 2017, janë likuiduar shpenzimet për shërbimin e sterilizimit të sallave dhe të instrumentave kirurgjikalë, gjithsej në shumën 1,135 milionë

[Shqipëria.com]

lekë, për 57,113 sete kirurgjikale, shërbim i cili kryhet nga "S... " sh.p.k në cilësinë e Konçensionarit.

Referuar të dhënave të pasqyrave financiare, konstatohet se llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit" paraqitet me tepricë Debitore në shumën 1,864.8 milionë lekë, që është rezultat negativ i FSDKSH (Drejtoria Qendrore) e kjo si rrjedhojë e transferimit më pak nga programimi i të ardhurave të buxheti për mbulimin e shpenzimeve të parësorit Ky është viti i parë në të cilin FSDKSH paraqitet me rezultat financiar negativ.

Efektet negative në administrimin e skemës.

Nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në vendimmarrjet e organeve drejtuese të këtij institucioni, në menaxhimin e burimeve njerëzore, në administrimin e fondeve të rimbursimit të barnave, në monitorimin e kontratave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore lidhur me detyrat funksionale të punonjësve të Fondit, si dhe evidentohet dobësim i sistemeve të kontrollit gjatë vitit 2017, në të gjitha aspektet e funksionimit të këtij institucioni, që ka sjellë *efekte negative për buxhetin e shtetit* **shumën 3,865 milionë lekë,** si më poshtë:

1*. Rritje galopante e vlerës së Rimbursimit për vitin 2017, por jo e numrit të përfituesve nga skema.* Nga të dhënat e vëna në dispozicion prej Fondit, për vitin 2017, konstatohet rritje e vlerës së rimbursimit në shumë absolute për 1,992 milionë lekë, ndërkohë që nuk kemi ndryshim të çmimit të barnave dhe numri i përfituesve ka rënë me 720 pacientë krahasuar me vitin 2016, edhe pas futjes në skemë të kategorisë 39 "Person me sëmundje kronike". Vlera prej ***1,992 milionë lekë,*** përbën një rritje prej 23.6% të shpenzimeve për rimbursimin e barnave krahasuar me vitin e mëparshëm. Në kushtet e përdorimit të këtyre fondeve jo për qëllimin e parashikuar në buxhet, e shoqëruar nga ulja e numrit të përfituesve në skemë, kur çmimet e LBR-së nuk kanë pësuar ndryshime gjatë kësaj periudhe, ku numri i recetave është rritur vetëm me 3.4% në krahasim me një vit më parë, mungesës së analizave sektoriale, si dhe në kushtet e mungesës totale të ushtrimit të kontrolleve nga strukturat e Fondit në kundërshtim me dispozitat ligjore të evidentuara gjatë këtij auditimi, tregon më së paku një keqmenaxhim të fondeve publike në vlerën 1,992 milionë lekë. Kjo dukuri bëhet më e theksuar prej muajit Qershor 2017 dhe në vazhdim.

2. *Pasoja negative të konsiderueshme në buxhetin e shtetit nga mos- hyrja në fuqi e Listës LBR 2017 megjithëse e miratuar nga Fondi.*

Me vendimin nr. 42 datë 21.03.2017 KA-ja ka miratuar Listën e barnave që rimbursohen nga Fondi për vitin 2017 dhe masën e mbulimit të tyre. Nga auditimi konstatohet se; sipas dokumentacionit Lista e Barnave të Rimbursueshme për vitin 2017 megjithëse e miratuar me vendimin e KA-së dhe e dërguar për procedim të mëtejshëm në Ministrinë e Shëndetësisë nuk rezulton e miratuar prej Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2017 duke mos hyrë efektivisht në fuqi për asnjë moment.

Bazuar në dokumentacionin, vënë në dispozicion të grupit të auditimit, cituar më sipër rezulton se, LBR-ja e vitit 2017 nuk ka hyrë në fuqi si rezultat i mosdakordësive të shprehura në formë shkresore midis Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Shëndetësisë për aspekte teknike të procedimit nga ana e Fondit në

lshqiptaria.com]

miratimin e paketës së barnave të rimbursueshme. Theksojmë që çmimet CIF të barnave të rimbursueshme të aplikuara në LBR-në 2017 kanë një rënie të përllogaritur në masën 4.1% krahasuar me çmimet e aplikuara në LBR-në 2016. Mosmiratimi i LBR 2017 ka cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm autonominë e Fondit për administrimin e paketave të sigurimit të detyrueshëm parashikuar në nenin 13 të Ligjit 10383 datë 24.02.2011, por ka krijuar pasoja negative të konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Në gjykimin tonë mosproçedimi në kohë nga ana e Ministrive respektive për miratimin e kësaj liste ka bërë që efektivisht çmimet e ndryshuara për barna të kësaj liste të mos aplikohen. Për periudhën 9-mujore, Prill-Dhjetor 2017 në të cilën rregullisht duhet të kishte hyrë në fuqi lista e re LBR 2017 bazuar në konsumin mesatar/mujor të barnave, mos-hyrja në fuqi e saj ka sjellë efekte negative në buxhetin e shtetit në shumën e llogaritur ***rreth 409 milionë lekë,*** si dhe ka ndikuar negativisht në vlerat e bashkëpagesës të personave përfitues të skemës.

Mungon metodologjia per hartimin e listes se barnave të rimbursueshme, nuk legjitimohen marzhet e fitimit dhe procesi është i shoqëruar me probleme të shumta procedurale.

3. *Mosreflektim i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditime të mëparshme me pasoja të konsiderueshme në buxhetin e shtetit.*

Nga auditimi i ushtruar në FSDKSH, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr. 264/9, datë 29.09.2017 "*Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, përputhshmëri dhe rregullshmëri financiare e aktivitetit*", për aktivitetin e vitit 2016, janë lënë për zbatim 28 rekomandime, të cilat janë pranuar nga titullari 28 rekomandime, ose 100% e tyre. *Nga rekomandimet e pranuara janë zbatuar 5 prej tyre, ose 18 %, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, ose 3%, janë në proces zbatimi 11 rekomandime, ose 40 % e tyre dhe nuk janë zbatuar 11 rekomandime, ose 39 % e tyre*.
Përmendim se, në auditimet e mëparshme sipas Vendimeve të Kryetarit të KLSH-së nr. 134, datë 04.10.2016 dhe nr. 129, datë 28.09.2017, është konstatuar problematika në zbatimin e kontratës koncesionare të ***Check up-it,*** referuar pagesës së koncesionarit për realizimin e të paktën 475 mijë kontrolleve në vit, ose 39,583 kontrolle në muaj. Megjithë zgjerimin e fashës së popullatës në vijim lidhur me përfitimin e këtij shërbimi, konstatohet se edhe për vitin 2017, nuk është arritur numri prej 39,583 kontrolle të parashikuara në muaj, pasi gjatë kësaj periudhe janë realizuar vetëm 26,383 kontrolle në muaj, kjo ka sjellë që pagesa prej 292 milionë lekë (me Tvsh) për 158,395 raste të parealizuara të sjellë një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit.

Ndërkohë që po të ishte vepruar sipas ***rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2016,*** *koncesionari duhej të ishte paguar vetëm për vlerën e shpenzimeve fikse për çdo kontroll bazë dhe jo për vlerën e shpenzimeve variabël të parashikuar që llogariten rreth 400 lekë për* ***Check up*** *(pa TVSH), pasi koncesionari nuk ka kosto materiale për këto raste, fakt që do të kishte ulur koston për buxhetin në vlerën 63.4 milionë lekë, (158,395*400) ndërsa për periudhën 2015-2017 kjo parregullsi arrin në shumën* ***182 milionë lekë.***

Tabela 40: Kostot materiale për periudhën 2015-2017

Nr.	Viti	Mesatare mujore sipas kontratës	Mesatare mujore ne fakt	Nr. Muajsh	Numër kontrollesh sipas kontratës	Numër kontrollesh në fakt	Numër kontrollesh të likujduar	Kontrolle të faturuar por të pakryer	Kosto fikse për njësi (pa TVSH)	Vlera e kostos fiske perfituar padrejtesisht
1	2015	39,583	24,442	10	395,830	244,420	244,420	151,410	400	60,564,000
2	2016	39,583	27,463	12	474,996	329,556	329,556	145,440	400	58,176,000
3	2017	39,583	26,383	12	474,996	316,601	310,123	158,395	400	63,358,000
Shuma					**1,345,822**	**890,577**	**884,099**	**455,245**	**400**	**182,098,000**

Shënim: *Për vitin 2015, mesatarja mujore e kontrolleve të kryera në fakt, nëse do të zhvishej nga 2 muajt e parë të fillimit të implementimit të paketës përkatësisht, muajt Mars dhe Prill, në të cilët janë kryer 4,219 dhe 9,087 kontrolle bazë, do të rezultonte për 28,889 kontrolle në muaj, pra me një performancë mujore më të lartë se vitet pasardhëse 2016, 2017.*

Nga auditimi konstatohet se, edhe për vitin 2017, vijon të pranohen dhe likuidohen faturat tatimore mujore të *Check-up*, lëshuar nga koncesionari, në vlerën totale 876 milionë mijë lekë, në të cilën përfshihet edhe TVSH në masën 20% mbi vlerën e shërbimit shëndetësor, ndërkohë që ky furnizim shërbimi *duhet të trajtohet si Furnizim i Përjashtuar nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, sipas përcaktimit ligjor në Nenin 51 pika c) e Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH", i ndryshuar*. KLSH i ka rekomanduar FONDIT në auditimin e mëparshëm të kërkojë interpretimin teknik nga DPT lidhur me këtë mënyrë faturimi. Interpretimi i dërguar nga DPT, në gjykimin tonë nuk paraqet frymën e ligjit, si dhe nuk përmbush kërkesat teknike për rastin konkret. Kështu që në gjykimin tonë, vijimi i praktikës së pranimit dhe likuidimit të faturave të Check-up, si një shërbim i tatueshëm me TVSH, vijon të krijojë kosto shtesë në buxhet, që për vitin 2017, llogaritet në shumën *146 milionë lekë*, ndërsa për periudhën e deritanishme të shtrirjes së kontratës vlera arrin në ***413.7 milionë lekë***, si më poshtë:

Tabela 41: TVSH e përjashtuar

Nr.	Viti	Numër kontrollesh sipas kontratës	Çmimi për Check Up (pa TVSH)	Vlera e tatueshme e faturuar	TVSH e llogaritur	Total faturim
1	2015	395,830	1,537	608,390,710	121,678	730,068.8
2	2016	474,996	1,537	730,068,852	146,013.8	876,082.6
3	2017	474,996	1,537	730,068,852	146,013.8	876,082.6
Shuma		**1.345.822**	**1537**	**2,068,528,414**	**413,705,683**	**2,482,234,097**

Konstatohet se, pavarësisht rritjes së fashës së përfituesve, numri i personave të cilët marrin këtë shërbim nga viti në vit ka pësuar rënie, duke ndikuar në rritjen e pagesave për raste të pakryera nga ana e Fondit. Në total koncesionari ka përfituar në mënyrë të padrejtë në 455,245 raste koston fikse të kontrolleve të pakryera për këtë shërbim, si dhe Tvsh-në e të gjithë rasteve të faturuara. Në total vlera e parregullsive përllogaritet në shumën 595.8 milionë lekë.

4. *Mosreflektim i çmimeve të reja nga FONDI me pasoja në buxhetin e shtetit.*

Nga auditimi konstatohet se, VKM nr. 380, datë 25.05.2016 "Për miratimin e listës së barnave qe rimbursohen nga FSDKSH" i ndryshuar në pikën 7 të tij, përcakton se, nëse gjatë periudhës kur ky vendim është në fuqi, ulen çmimet për barnat e paregjistruara të listës ose barnat alternativë e vetme që tregtohen në farmacitë e spitalit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me njoftim të Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, reflekton uljen e çmimit të barit në listë. Fondi ka miratuar listën e barnave të rimbursueshme për vitin 2017 dhe e ka dërguar këtë listë në Ministrinë e

Shëndetësisë për procedim në Këshillin e Ministrave. Megjithëse LBR-ja e vitit 2017 nuk është miratuar gjatë vitit, për arsye të cilat nuk varen prej Fondit, çmimet e reja duhet të ishin reflektuar rregullisht prej tij, sipas përcaktimit ligjor në pikën nr.7 të VKM nr. 380 pasi Fondi është pjesë e Komisionit të Çmimit të Barnave. Mosreflektimi i çmimeve të reja ka sjellë si pasojë kosto shtesë në buxhet, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në shumën ***132 milionë lekë.***

5. ***Vendimmarje e Këshillit Adminsitrativ për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm në kundërshtim me Ligjin material dhe Statutin***, në një mbledhje të jashtëzakonshme, si kandidaturë e vetme dhe pa votim të fshehtë, duke mos kryer veprimet paraprake për përmbushjen e kritereve të parashikuara në ligj nga ana e kandidatit për këtë post të rëndësishëm publik.

6. ***Mosveprime dhe Rimbursime të kryera në mënyrë të parregullt të cilat kapin vlerën e 700 milionë lekë.*** Nga auditimi i zbatimit të kontratave nga dhënësit e kontraktuar nga Fondi u konstatua se:

a. Mënyra e interpretimit të kontrolleve, të cilat janë bazuar në klauzolat e kontratës së re F/2016 dhe kontratës F/2015 dhe shtojcës F /2015 ,për periudhen të cilën kjo kontratë mbulon, grupet e kontrollit kanë pranuar që shkeljet, edhe pse i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në kontratë të mos merren parasysh për zgjidhjet e kontratave, **duke i argumentuar si shkelje të cilat i përkasin periudhës së kontratës paraardhëse.** Në bazë të kapitullit "*Detyrime specifike*" të Kontratës F/2015, pika 16, ka mundësuar vazhdimësinë e Kontratës F/2016 të sapolidhur dhe rrjedhimisht, rezultatet dhe sanksionet për kontrollet e kryera janë vendosur sipas kësaj kontrate duke e mbyllur të gjithë fenomenin e diferencave me disa gjoba minimale dhe me mbajtjen në muajin pasardhës të shumave të rimbursuara padrejtësisht. Në këtë mënyrë, janë mbyllur diferencat minus dhe plus në inventaret kontabël dhe nga ana e Fondit janë vendosur penalitete të papërfillshme për subjektet kundërvajtëse *dhe këto subjekte kanë vazhduar të rimbursohen normalisht nga FSDKSH-ja.* Për 12 farmacitë të cilat janë kontrolluar nga ana e DKPF-së gjatë vitit 2017, dhe kanë rezultuar me diferenca në ***plus*** dhe ***minus*** mbi përcaktimet e parashikuara në kontratën F/2016 dhe Shtojcën, DKP-ja nuk ka marrë masën e ndëprerjes së kontratës sipas rekomandimeve të lëna edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH-së (për vitin 2016). Mosndërprerja e kontratës dhe rimbursimi i këtyre farmacive nga ana e FSDKSH-së i bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kontraktuale të kontratës me farmacitë llogaritet kap vlerën prej ***144 milionë lekë***.

b. Me shkresën me Nr. 1821 Prot., datë 14.04.2016, të Drejtorisë Juridike të FSDKSH-së, është bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt: *Kallëzim të kryerjes së veprës penale të "Mashtrimit", "Mashtrimit në subvencione" dhe "Fallsifikim të Dokumentave Shëndetësore".* për farmacitë "**A", "B. P", "C 'S", "E. F. 2", "G & L " dhe "N 2"**.

Përveç përcaktimeve në Kontratën F/2015 , referimi i këtyre farmacive për ndjekje penale në Prokurori duhej të ishte bërë shkak për të mos e lidhur Kontratën F/2016 e cila ka filluar zbatimin pas hyrjes në fuqi të LBR-së 2016 , pra në muajin qershor të vitit 2016 ekzaktësisht dy muaj më vonë , pas kallëzimit penal të bërë për këto farmaci nga ana e FONDIT. Në kapitullin "*Kriteret*", pika 14 e kësaj kontrate,F/2016.

Pavarësisht së është lidhur Kontrata F/2016, këtyre farmacive nuk u është pezulluar aktiviteti sipas klauzolës "*Pezullim Aktiviteti*" të kësaj kontrate. Kjo pikë është trajtuar nga grupi I KLSH-së gjatë auditimit të mëparshëm , por nga

ana e FONDIT nuk është ndërmarrë asnjë veprim administrativ për nderprerjen e këtyre kontratave të lidhura padrejtësisht.
Rimbursimi i farmacive të cilat janë në proçedim penal nga organi i akuzës për të cilat FSDKSH duhet të kishte marrë masën e moslidhjes së kontratës, por ka vijuar rimbursimin e tyre në kundërshtim me dispozitat e kontratës me farmacitë për periudhën Mars-Dhjetor 2017 kap vlerën prej ***223 milionë lekë.***
c. Në vazhdimësi është konstatuar moszbatimi i masës për ***ndërprerjen e kontratave*** nga ana e Drejtorisë Rajonale të Fondit Tiranë, për farmacitë që kanë shitur barna që u ka kaluar afati i skadencës, veprim që ka vijuar normalisht megjithëse për këto subjekte duhet të merrej masa e menjëhershme e ndërprerjes së kontratës prej periudhës Gusht 2016 deri në dhjetor 2017. Rimbursimi për periudhën Gusht 2016-Shkurt 2017 ka qenë në shumën 206 milionë lekë për 20 subjektet farmaceutike të trajtuar në auditimin e mëparshëm. Rekomandimi i lënë nga DAB e FSDKSH-së por dhe nga KLSH nuk ka gjetur zbatim nga Drejtoria Rajonale e Fondit Tiranë, e cila duhet të kishte ndërprerë marëdhëniet kontraktuale me këto farmaci. Për të njëjtat subjekte për periudhën mars 2017-dhjetor 2017 vlera e rimbursuar padrejtësisht nga ana e FSDKSH kap vlerën ***333 milionë lekë.***
7. Konstatohet mungesë e pajustifikuar bashkëveprimi nga ana e Fondit me organet tatimore kundër paligjshmërisë dhe evazionit fiskal.
Në kontrollet e kryera nga DKPF-ja, janë konstatuar diferenca inventarësh ***në minus***, (*gjendja fizike e mallrave barnave është më e vogël se gjendja kontabël*), në shumën 47 milon lekë të padeklaruara nga shitja e barnave, dhe diferenca ***në plus***, (*gjendja fizike e mallrave barnave është më e madhe se gjendja kontabël*), në shumën 6 milionë lekë**,** për të cilat nuk është përcaktuar origjina apo burimi i këtyre tepricave. Në dosjet e kontrolluara, nuk ka asnjë dokumentacion në të cilin të shpjegohet, të arsyetohet dhe të dokumentohet origjina e tepricave. Grupet e kontrollit, ***nuk e kanë evidentuar burimin e tepricave të pajustifikuara me dokumentacionin*** që përbën provë ligjore. Prej tyre është pranuar rregullisht, se këto barna janë pjesë e LBR-së 2016, nga depot farmaceutike kanë hyrë në formë të rregullt në farmaci, të shoqëruara me dokumentacionin tatimor përkatës, pra është pranuar në heshtje se këto teprica janë shkaktuar si rezultat veprimeve të parregullta të bëra me daljet (shitjet e tyre). Për të dyja llojet e diferencave në inventarë, nuk janë njoftuar organet tatimore, sipas kontratës. Mosnjoftimi i organeve tatimore një veprim i përsëritur ky nga Fondi dhe i rikonstatuar nga grupi i KLSH-së për diferencat ***në minus***, ka bërë që Farmacitë të krijojnë shmangie të detyrimeve tatimore. Në bazë të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", (i ndryshuar), vlera e shitjeve të padeklaruara sjell shmangie të tatimit mbi fitimin, në masën 15% të vlerës së padeklaruar të shitjes së mallrave (barnave). Diferencat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera përbëjnë vlerë të pallogaritur dhe të paarkëtuar në Buxhetin e Shtetit. Vlera e shmangies gjithsej për diferencat *në* ***plus*** dhe ***minus*** arrin në ***13 milionë lekë.***
8. ***Në 30 raste Këshilli Administrativ ka miratuar me vendim, rimbursim të barnave përtej kufizimeve në përdorim, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit***, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me një vlerë ***rreth 139.5 milionë lekë***. Me këto vendime janë rimbursuar barna të cilat janë të përfshira në listën e barnave të rimbursueshme në fuqi dhe si të tilla vendimmarrjet e KA-së janë të panevojshme dhe në tejkalim të kompetencave, por njëkohësisht procedura e përzgjedhjes së rasteve për rimbursim nga një komision i posaçëm gjykojmë është diskriminues dhe i pambështetur në ligj.

3.8 Mbi administrimin e buxhetit të një sive të vetë qeverisjes vendore

Të ardhura nga Pushteti Vendor janë realizuar për 18,447milion lekë, kundrejt 15,400 milion lekë të planifikuar sipas planit fillestar, ose realizuar në masën 119,8%, ose më shumë për 3,047 milion lekë. Trendi i realizimit të këtyre të ardhurave për 6 vjet rezulton si vijon:

Tabela 42: Dinamika e të ardhurave të realizuara të pushtetit vendor mln lekë

Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Të ardhurat e pushtetit vendor	10,859	10825	12,447	11,700	14,951	18,447
Dif. nga viti i mëparshëm	-932	-34	1,622	-747	3,251	18,447
Në % nga viti mëparshëm	92%	100%	115%	94%	128%	123%

Këto të ardhura përbehen nga:

a.Taksa lokale realizuar për 13,273 milion lekë, kundrejt 9,675 milion lekë të planifikuar, ose realizuar në masën 134,8%, ose më shumë për 3,427 milion lekë.

b.Tatimi mbi Pasurinë (ndërtesat) realizuar për 4,879 milion lekë, kundrejt 5,272 milion lekë të planifikuar, ose realizuar në masën 92,5%, ose më pak për 393 milion lekë

c.Tatimi mbi Biznesin e vogël realizuar për 296 milion lekë, kundrejt 283 milion lekë të planifikuar, ose realizuar në masën 104,7%, pra 13 milion lekë më shumë.

3.8.1 Administrimi i të ardhurave dhe decentralizimi vendor

Në **27 bashkitë** e audituara për qëllime të Raportit të Zbatimit të Buxhetit 2017, realizimi i të ardhurave të miratuara me vendimet respektive të këshillave bashkiak, nga vlera 8,240 milion lekë të ardhura të planifikuara, është në masën 4,975 milion lekë ose në masën 60%.

Deviacioni në nivelin e të ardhurave të realizuara, krahasuar me planifikimin është në vlerën 3,265 milion lekë, deviacion që reflekton një problematikë të shtuar në lidhje me administrimin e taksave dhe tarifave vendore si e ardhur e munguar në buxhetet e këtyre bashkive dhe pengesë në realizimin e projekteve të planifikuara në shërbim të komunitetit, konkretisht grafiku:

Grafiku 31: Realizimi i të ardhurave



Burimi: KLSH

Nga auditimet e ushtruara në **27 bashki**, konstatohet se planifikimi i të ardhurave nuk është bërë i studiuar, pasi ka pasur rezerva në përcaktimin e planit të taksave e tarifave vendore, ku për disa lloj taksat e tarifa vendore nuk është pasur parasysh realizimi i vitit të mëparshëm, ndërkohë që në 70% të subjekteve të audituara nuk janë parashikuar të ardhurat nga abonentët familjarë, nuk është marrë parasysh vënia nën administrim e aseteve (resurseve). Ndërkohë që

[Shqiptaria.com]

konstatohet keq menaxhim i sipërfaqeve pyjore, kullosore, hapësirave për plazhe, të sipërfaqes së tokës bujqësore të ndarë për numrin e familjeve si dhe taksave të tjera sipas rëndësisë së tyre. Këto problematika janë konstatuar në Bashkitë: Belsh në vlerën 37.7 milion lekë, Këlcyrë në vlerën 25.3 milion lekë, Kukës në vlerën 26.3 milion lekë, Has në vlerën 3.3 milion lekë, etj. Në zonat bregdetare ka devijime në deklarimin e sipërfaqeve për plazhet e dhëna me qira, mbi të cilat llogariten detyrimet e subjekteve, përmendim Bashkitë Lezhë, Vlorë, Rrogozhinë etj.

Gjatë auditimeve të ushtruara (27 bashki), janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore të mbledhjes së të ardhurave fiskale në vlerën 2,019 milion lekë, nga e cila me dëm ekonomik në vlerën 335 milion lekë, përmendim të ardhurat nga mos menaxhimi i kontratave të qirasë për pyje/ kullota në vlerën 716.5 milion lekë me dëm ekonomik vlera 42.3 milion lekë, taksën e shfrytëzimit të mjeteve në vlerën 30 milion lekë (dëm ekonomik), nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit në vlerën 7.7 milion lekë (dëm ekonomik), nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (nga ALUIZNI-t) në vlerën 411 milion lekë me dëm ekonomik vlera 396 milion lekë, nga dhënia me qira e hapësirave për plazhe në vlerën 21.4 milion lekë me dëm ekonomik vlera 19 milion lekë, qira objekti në vlerën 22.2 milion lekë me dëm ekonomik vlera 12.5 milion lekë, qira tokë bujqësore 102.7 milion lekë me dëm ekonomik vlera 11.6 milion lekë, etj.

Gjithashtu konstatohet se pasuritë e kaluara me VKM në pronësi të këtyre njësive vendore, ku në disa raste janë dhe të hipotekuara dhe të dhëna me qira nuk është bërë i mundur zbatimi i kushteve të kontratës duke lënë detyrimet kontraktore të pa arkëtuara dhe rritur nivelin e borxhit. Konstatohet dhe raste të cilat këto pasuri administrohen nga persona të tretë dhe nga njësitë vendore nuk është marrë asnjë masë për evidentimin e këtyre pronave dhe lidhjen e kontratave të qirasë, për të bërë të mundur realizimin e të ardhurave në favor të këtyre njësive. Disa nga bashkitë ku janë konstatuar shkelje me vlerë më të lartë përmendim; Bashkia Belsh në vlerën 432 milion lekë nga e cila me dëm ekonomik vlerën 13.3 milion lekë, Kamzë në vlerën 318.8 milion lekë, nga e cila me dëm ekonomik në vlerën 316.7 milion lekë, Vlorë në vlerën 255.5 milion lekë, nga e cila me dëm ekonomik vlera 16.6 milion lekë, Fier në vlerën 50 milion lekë, Lushnjë në vlerën 45 milion lekë, Lezhë në vlerën 32.6 milion lekë, Vau i Dejës në vlerën 68.9 milion lekë, nga e cila me dëm ekonomik vlera 22.5 milion lekë, Durrës në vlerën 16.9 milion lekë, nga e cila me dëm ekonomik në vlerën 12 milion lekë, Kuçovë në vlerën 63.3 milion lekë (mungesë të ardhurash), etj.

3.8.2 Shpenzimet e pushtetit vendor

Për vitin 2017, sipas treguesve fiskalë të konsoliduar janë raportuar shpenzime për buxhetin vendor të realizuara në shumën 46,487 milion lekë nga 46,400 milion lekë të planifikuara me sipas Aktit Normativ nr.3 dhe 46,816 milion lekë pas shpërndarjes së Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës.

Tabela 43: Shpenzime per Buxhetin Vendor *mln lekë*

Përshkrimi	Ligji nr.130/2016	Akti Normativ nr.2	Akti normativ nr.3	Realizimi faktik
Shpenzime per Buxhetin Vendor	**40,828**	**42,900**	**46,400**	**46,487**
Granti nga buxheti i shtetit per pushtetin vendor	20,178	20,350	22,376	28,575
Fond i pakushtezuar	*13,500*	*15,635*	*15,635*	
Grant Specifik	*6,678*	*6,715*	*6,741*	
Fondi per Zhvillimin e Rajoneve				

[shqiptaria.com]

Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	15,400	15,400	20,900	17,912
Buxheti Lokal (Te ardhurat nga transferimi i rentes)	450	350	324	
Buxheti Lokal (Nga te ardhurat jo-tatimore)	2,800	2,800	2,800	
Reforma e Decentralizimit	2,000	2,000		

Nga auditimi mbi shpenzimet e pushtetit vendor konstatohet se niveli i realizimit të shpenzimeve të financuara nga granti i buxhetit të shtetit për pushtetin vendor është realizuar në shumën 28,575 milion lekë, nga 22,376 milion lekë të planifikuar në formën e transfertave. Transfertat e pakushtëzuara janë planifikuar në shumën 15,635 milion lekë sipas tabelës shoqëruese nr. 3 të Aktit Normativ nr. 3 ndërkohë që transfertat specifike janë planifikuar në shumën 6,741 milion lekë. **Tejkalimi i këtij zëri paraqitet në shumën 6,199 milion lekë në shpenzimet e kryera nga pushteti vendor dhe të financuara nga transferta e buxhetit për pushtetin vendor.** Nga ana tjetër konstatohet se realzimi faktik i shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta paraqitet me realizim në shumën 17.9 miliard lekë nga rreth 24 miliard lekë të planifikuara me Akt Normativ nr.3 duke përfshirë edhe të planin e të ardhurave nga transferimi i rentës. Mos realizimi në këto burime financimi paraqitet në rreth 6 miliard lekë. Nga auditimi i të dhënave në SIFQ konstatohet se pjesë e tejkalimit të transfertave të pakushtëzuara përkundrejt planit të miratuar është shpenzimi i fondeve për infrastrukturën vendore dhe rajonale, për pjesën e projekteve të mbartura nga viti 2016. Sipas të dhënave të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, vlera e realizimit faktik të projekteve të mbartura nga viti 2016 është në shumën 4.7 miliard lekë.

Në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar shoqëruese në planin e miratuar me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" , konstatohet se nuk është paraqitur plani për projektet e Fondit të Zhvillimit Rajonal të mbartur nga viti 2016. Ky efekt në mbajtjen e planit në kontroll në total për shpenzimet e buxheti vendor është kompensuar nga mungesa e shpenzimeve të raportuara, të financuara nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2017 të ardhurat e pushtetit vendor janë realizuar në shumën 18,447 milion lekë nga 20,900 milion lekë të planifikuara me një mosrealizim në shumën 2,454 milion lekë.

Në këtë mënyrë duke qenë se mosrealizimi i të ardhurave është më i ulët se tejkalimi i shpenzimeve të realizuara nga trasfertat, rezulton se shpenzimet e financuara nga trasfertat e buxhetit të shtetit, nuk paraqiten të mbështetura me plan. Nga auditimi kostatohet se efektin kryesor në këtë tejkalim e ka Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, i cili nuk rezulton të jetë i planifikuar për pjesën e fondit të mbartur të trashëgueshëm nga viti 2016. Fondi i mbartur në shumën 6,878 milion lekë dhe realizim faktik prej 4,267 milion lekë dhe fondi i pashpërndarë nga FZHR e vitit 2016 me plan 1,000 milion lekë dhe realizim 386 milion lekë të përdorura për financimin e projekteve të reja në vitin 2017, të dyja të raportuara nën zërin e pushetit vendor janë efekti kryesor në tejkalimin e planit për vitin 2017 në zërin e shpenzimeve të realizuara nga pushteti vendor të financuara nga transferta e buxhetit qendror.

Për këto shpenzime faktike, nuk është përfshirë plan në tabelën e treguesve fiskalë edhe pas dy ndryshimeve me Akt Normativ të ligjit të buxhetit, megjithëse plani për to ishte paracaktuar që të mbartej deri në Qershor 2017 dhe pas rakordimit me degët e Thesarit do të përcaktohej shuma e tij, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017". Megjithëse janë kryer shpenzime përgjatë muajve, ndryshimet përkatëse nuk janë reflektuar duke

[shqiptarja.com]

hapur plan për këtë që akumulon shpenzime për buxhetin vendor, si pasojë e planit të mbartur, nëpërmjet rritjes së deficitit si pasojë e shtesës së këtij plani ose nëpërmjet shkurtimit të zërave të tjerë të shpenzimeve për të mbajtur deficitin të paprekur. Konstatohet se as shtesa e planit duke rritur deficitin dhe as shkurtimi i shpenzimeve të tjera duke mbajtur të njejtin nivel deficiti nuk është kryer, por në fakt deficiti raportohet pa tejkalim si pasojë e këtyre shpenzimeve faktike pa plan. Një gjë e tillë dokumentohet edhe me minutat e takimit të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit me shkresë nr.2 datë 14.04.2017 sipas së cilës është parashtruar *"U diskutua për mënyrën e mbulimit të fondeve të trashëguara nga viti 2016 (të rakorduara rishtazi) në zbatim të legjislacionit në fuqi në vlerën 14.7 miliard lekë e përbërë nga fonde të qeverisjes qendrore, vendore dhe FZHR. Nga buxheti u prononcua se në bazë të analizës së treguesve fiskalë mujorë të konsoliduar në vijim do të rishikonte buxhetin në shkurtim të fondeve disponibël në fund të periudhës përkatëse".* Ky argument, përforcon faktin që Drejtoria e Buxhetit, ka qenë në dijeni të nevojës për mbulimin me plan të fondeve të trashëguara për FZHR nga viti 2016 në vitin 2017, megjithatë nuk ka marrë masat e nevojshme për krjimin e planit nëpërmjet shkurtimit të fondeve të tjera disponibël, as me Aktin Normativ nr.2 dhe as me Aktin Normativ nr.3.

Për më tepër, nga auditimi rezulton se me Aktin Normativ nr.3 janë hapur projekte të reja investimi, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara më parë dhe nuk janë financuar projektet kapitale të FZHR. Për të mbajtur të paprekur deficitin e vitit 2017, sipas planifikimit në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vititi 2017", të ndryshuar, nuk janë marrë masat e nevojshme në mënyrë që të reduktoheshin shpenzimet kapitale me financim të brendshëm me ndryshimet përkatëse të planit, por është lejuar kryerja e shpenzimit pa plan për shpenzimet e programit të infrastrukturës vendore dhe rajonale të mbartura nga viti 2016. Nga ana tjetër, shpenzimet e tjera të buxhetit vendor janë kryer sipas planifikimit përkatës në lidhje me performancën e të ardhuave nga pushteti vendor, duke mos krijuar hapësira për shkrutimin e këtyre shpenzimeve. Instrumenti i përdorur për të mbajtur në kontroll shpenzimet e pushetit vendor, për të mos korrigjuar shpenzimet kapitale me financim të brendshëm është ai i kufizimit të kryerjes së shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor, nëpërmjet vendosjes së limitit në përdorimin e cash.

Në këtë mënyrë, me shkresën nr.15973, datë 09.11.2017, gati 3 ditë pas Aktit Normativ nr.3 datë 06.11.2017, u është komunikuar Degëve të Thesarit dhe njësive të vetqeverisjes vendore një limit sipas bashkive përkatëse i përdorimit të cash-it për pjesën e mbetur të vitit sipas tabelës bashkëngjitur. Në këtë tabelë rezulton se për periudhën 10.11.2017 e deri në fund të vitit buxhetor limit i përdorimit të cash është caktuar në masën 3.4 miliard lekë. Kjo shkresë rezulton të jetë iniciuar nga Drejtoria e Financave Vendore në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, strukturë e cila nuk ka asnjë kompetencë në lidhje me përcaktimin e sasinë e nevojshme të cash dhe tagër të kufizimit të kryerjes së shpenzimeve në rast të dokumentimit të tyre. Për më tepër, nga analiza e gjendjes së llogarisë së qeverisë (TSA) në Bankës e Shqipërisë konstatohet se teprica e llogarisë paraqitet likuiditete në nivele tepër të larta në për periudhën objekt kufizimi, konkretisht në fund të muajit tetor 34 miliard lekë, në fund të muajit nëntor 26 miliard lekë dhe në fund të muajit dhjetor 11 miliard lekë. Ky konstatim është i mbështetur edhe në përgjigjen e strukturave të thesarit në lidhej me konstatimin grupit të auditimit në të cilën shprehen se në shkresë është shprehur gabimisht limit i cash sepse gjendje likuiditeti ka pasur me bollëk.

Në përgjigjen e strukturave të Drejtorisë së Financave Vendore sipas emailit të datës 13.08.2018 në lidhje me këtë fakt argumentohet se *".....Drejtoria e Financave Vendore merret me shperndarjen e planit buxhetor te transfertave te miratuara me ligj per NJQV-te. ....Gjithashtu, per qellime makro-fiskale me fimen e Ministrit te Financave dhe Ekonomise eshte vendosur nje limit ne planin e shpenzimeve vendore ne 2 muajt e fundit te vitit 2017...."*. Në këtë mënyrë, rezulton se për qëllime të mbajtjes në kontroll të shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor, janë vendosur kufizime mbi të drejtën për të shpenzuar, për fonde të cilat janë miratuar për tu shpenzuar me Akt Normativ nr.3. Frenimi i regjistrimit të shpenzimeve është raportuar edhe në auditimin paralel në DPTH, ku janë konstatuar deklarime me vonesë të tyre, në përgjigje të së ciëls nga përfaqësuesit e Drejorisë së Përgjithshme të Thesarit shprehen se *"fenomeni është më i përhapur tek institucionet vendore për shkak të vendosjes së limitit për muajt Nëntor-Dhjetor 2017 për kufirin e shpenzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit sipas shkresës nr.15973 datë 09.11.2017".*

Ky kufizim ka krijuar kushtet për frenimin e kryerjes së shpenzimeve dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura që sipas deklarimit për pushtetin vendor në fund të vitit, ku vlera e detyrimeve të prapambetura të përgjithshme paraqitet në shumën 16 miliard lekë. Planifikimi i gabuar është i shtrirë edhe në drejtim të planifikimit të përgjithshëm, si pasojë e faktit që me Akt Normativ nr.3 jo vetëm që nuk është bërë buxhetimi i kontratave ekzistuese, por janë hapur projekte të reja të pa kaluara në procedurat e miratimit të menaxhimit të investimeve publike, duke krijuar kushtet për akumulimin e detyrimeve që burojën nga këto projekte të reja, si pasojë e diferencës së shkurtër kohore për kalimin e fazave nga prokurimi, lidhja e kontratës, marrja në dorëzim, faturimi dhe më pas pagesa.

Në lidhje me këto fakte konstatohet se shpenzimet e mbartura nga fondi për FZHR i vitit të kaluar, të raportuara në zërin e pushteti vendor për rreth 4.7 miliard lekë nuk janë shoqëruar asnjëherë me plan buxhetor por janë celur zërin e shpenzimeve të buxhetit vendor pa mbështetje në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, dokumentuar nëpërmejt tejkalimit të zërit të transfertës së pakushtëzuar.

Nga auditimi konstatohet se me ligjin nr.130/2016 të ndryshuar, janë planifikuar fondet për shpenzimet e buxhetit vendor në shumën 46,400 milion lekë. Pjesë e fondeve të planifikuara është edhe tranferta e pakushtëzuar dhe granti specifik i buxhetit në shumën 22,376 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se në planifikimin e ëktyre trasfertave nuk është përfshirë disbursimi përkatës i nënhuasë së marrë në pushtetin vendor për projektin e Bulevardit verior të Tiranës në shumën 1,646 milion lekë. Në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar sipas SIFQ kosntatohet se ky projekt është i raportuar në shumën 1,646 milion lekë në seksionin e shpenzimeve të buxhetit vendor të financara nga kapitulli 2, financimi i huaj. Nga analiza e raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë reuzlon se fakti në lidhje me këtë projekt në zërin e shpenzimeve të pushtetit vendor është 0 lekë, pasi ai është raportuar në zërin e huadhënies neto në shumën 1,646 milion lekë, duke u riklasifikuar nga jashtë pas raportimit në fiskale. Në këtë mënyrë, shpenzimet e zërit për buxhetin vendor janë nënvlerësuar në shumën 1,646 milion lekë, duke sjellë efektin e mbulimit të tejkalimit të planit të buxhetit vendor me 1,646 milion lekë. Një gjë e tillë është kryer si pasojë e mosplanikimit

[shqiptarja.com]

të shpenzimeve të buxhetit vendor të financuara nga kapitulli me anë të Aktit Normativ nr.3.

Buxheti vendor faktik për vitin 2017 paraqitet si në vijim:

Tabela 44: Buxheti vendor faktik për vitin 2017 *mln lekë*

Shpenzimet e buxhetit vendor	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Diferenca 2017/2016
Shpenzime Korrente	**20,858**	**26,740**	**30,204**	**3,464**
Personeli	10,870	15,906	19,118	3,212
Shpenzime operative dhe te mirëmbajtjes	9,277	9,988	10,132	144
Subvencione	126	106	142	36
Te tjera	585	740	812	72
Shpenzime Kapitale	**13,208**	**16,819**	**16,283**	**-536**
Totali	**34,066**	**43,559**	**46,487**	**2,928**

Trendi i shpenzimeve vendore rezulton në rritje, konkretisht gjatë vitit 2017 ky zë është rritur me 6,7 % krahasuar me vitin 2016.

Tabela 45: Shpenzime të pushtetit vendor për vitin 2017 *mln lekë*

Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Shpenzime të pushtetit vendor	27,333	29,787	32,985	34,066	43,559	46,487
Dif. nga viti i mëparshëm	-786	2,454	3,198	1,081	9,493	2,928
Dif. në % nga një vit më parë	97.20%	109.00%	110.70%	103.28%	128%	106.72%

Për buxhetin e vitit 2017, në **33 subjekte të pushtetit vendor**, nga të cilat 28 bashki, 2 prefektura, 1 këshilla qarku dhe 2 ndërmarrje në vartësi,auditimet e ushtruara nga KLSH, janë përqendruar kryesisht në zbatimin e ligjshmërisë, lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore të vëna në dispozicion, në përfundim të të cilave krahas punës së bërë janë konstatuar edhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi. Këto shkelje kanë sjellë një dëm ekonomik në total në vlerën prej ***350.5 milion lekë***, nga e cila vlera prej ***58.6 milion*** lekë përfaqëson mungesë të ardhurash (qira, taksat vendore, taksa e ndikimit në infrastrukturë etj), duke mbetur si shkelje ligjore në fushën e shpenzimeve buxhetore vlera **292 milion lekë**, të cilat sipas natyrës **së shkeljeve paraqiten**:

-*Në fushën e pagave* dhe shpërblimeve në vlerën **401** mijë lekë, ku përmendim Bashkinë Rrogozhinë në vlerën 341 mijë lekë, etj

-*Pagesa të kundërligjshme* në shpenzimet operative në vlerën **6 milion** lekë, ku përmendim Bashkitë: Rrogozhinë në vlerën 4.9 milion lekë, Pustec në vlerën 0.7 milion lekë, Lezhë 0.2 milion lekë etj.

Megjithëse që nga viti 2009 e në vazhdim, zhvillimi i procedurave të prokurimit publik realizohet me mjete elektronike (online), ende konstatohen shkelje në zhvillimin e procedurave, të cilat përveç mungesës së kapaciteteve profesionale (për arsye të mos trajnimit mjaftueshëm të stafit që merren me zhvillimin e procedurave të prokurimi publik), kanë si shkak edhe shkeljet e kërkesave ligjore nga njësitë e prokurimeve (NJP) në hartimin e dokumenteve standarde të tenderëve, anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave (KVO) në përzgjedhjen e operatorëve fitues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,udhëzimet e Këshillit Ministrave dhe Agjencisë së Prokurimit Publik të dala në zbatim të tij. E njëjta situatë konstatohet edhe për procedurat e prokurimit për blerjet e vogla.

Shqiptaria.com

Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017 nga Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, janë audituar 33 subjekte, të cilat kanë zhvilluar gjithsej 555 procedura prokurimi me vlerë 10,138 milion lekë. Nga procedurat e zhvilluara, janë audituar 347 prej tyre, në vlerën 8,722 milion lekë, ose 62 % të numrit të procedurave, apo 86 % të vlerës së kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë. Nga auditimi janë konstatuar me shkelje 203 procedura prokurimi, me dëm ekonomik në vlerën 285,121 mijë lekë, prej së cilës vlera 147 milion lekë për shkelje të procedurave të prokurimit në 13 subjekte në kualifikimin/skualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe vlera 129.084 mijë lekë, nga mos zbatimi i rregullave në fushën e ndërtimit, kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit në 21 Subjekte.

Punime të pakryera por të likuiduara nga buxheti i njësisë vendore, kryesisht janë konstatuar në bashkitë: Belsh në vlerën 55,854 mijë lekë, Vlorë në vlerën 38,018 mijë lekë, Rrogozhinë në vlerën 7,690 mijë lekë, Mallakastër në vlerën 6,892 mijë lekë etj. Shkeljet e procedurave ligjore në fushën e prokurimeve konsistojnë me shkelje 79 procedura në drejtimet e mëposhtme: në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit 97 procedura; në fazën e zhvillimit të procedurave të tenderit në 66 procedura; në fazën e zbatimit punimeve në 40 procedura.

Nga auditimet e ushtruara nga KLSH, rezulton se në mjaft njësi të vetëqeverisjes vendore, është akumuluar një borxh i konsiderueshëm, nëpërmjet krijimit të faturave të palikuiduara ndër vite, për arsye te kryerjes së punimeve apo shërbimeve pa u siguruar më parë fondet e nevojshme për kryerjen e tyre. Në bilancet e Bashkive rezultojnë mjaft detyrime të krijuara nga viti 2012 e para, por prej tyre, nuk ka një analizë të borxhit të krijuar në çdo vit nga pamjaftueshmëria e aftësisë paguese, faktorët që kanë ndikuar në krijimin e kësaj vështirësie financiare etj. Nga auditimet e kryera rezulton se për 28 Bashkitë e audituara deri në datë 31.12.2017, paraqitet një borxh (fatura të pa likuiduara dhe vendimet gjyqësore) në vlerën **2,994 milion lekë**. Rreth 70 % të këtij borxhi e zënë 5 Bashki, respektivisht Bashkia: Lezhë në vlerën 680 milion lekë, Kamëz në vlerën 504.8 milion lekë, Durrës në vlerën 405.5 milion lekë, Vlorë në vlerën 369.9 milion lekë, Lushnjë në vlerën 203.3 milion lekë, Fier në vlerën 152 milion lekë, Kuçovë në vlerën 147.8 milion lekë etj.

[shqiptaria.com]

4. MOS ZBATIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË SANKSIONUAR ME LIGJ NË SISTEMIN E THESARIT

Urdhër prokurimet rregjistrohen në thyerje të afatit ligjor, konstatuar 579 raste ose 80% të rregjistrimeve në SIFQ, në shumën 15.4 miliardë lekë nga 13 BI-online ku vecojmë: *Bashkia Tiranë (284 raste) dhe AKSHI (123 raste).*

Nga të dhënat e auditimit me burim sistemin SIFQ, rezultojnë 1164 rekorde urdhër-prokurimesh, nga të cilat 876 të rregjistruara me numër unik transaksioni në vlerën prej 28,602 milion lekë. Vetëm 725 rekorde urdhër-prokurimesh ose 692 urdhër prokurime unike rezultojnë të lidhura me një numër kontrate në vlerën 23,573 milion lekë. Në totalin e 24080 kontratave të rregjistruara ky numër urdhër-prokurimesh zë vetëm 3% të totalit të kontratave të rregjistruara gjatë vitit 2017. Kjo për arsye se Urdhër –prokurimet rregjistrohen vetëm nga institucionet me akses direkt në SIFQ (BI online).

Tabela 46: Urdhër prokurime të regjistruara në SIFQ në thyerje të afatit ligjor

Institucioni	2007-2016		VITI 2017		Total UP	
	Nr. UP	Vlera në milion lekë	Nr. UP	Vlera në milion lekë	nr.UP	vlera UP
Bashkia Tirana	226	4,808,466	58	894,487	284	5,702,953
Agjencia Kombëtare e Shoqërise së Informacionit (AKSHI)	77	1,714,263	46	2,993,245	123	4,707,508
Autoriteti Rrugor Shqiptar	15	2,660,038	14	823,065	29	3,483,104
Aparati Ministrise së Drejtësisë	-	-	4	312,941	4	312,941
Aparati i Ministrise së Infrastruktures dhe Energjisë	3	206,978	21	290,722	24	497,699
Aparati Ministrisë së Punës*	-	-	10	158,423	10	158,423
Aparati i Ministrisë së Brendshme	-	-	16	137,613	16	137,613
Aparati i Ministrise së Arsimit, Sportit dhe Rinise	4	10,842	7	122,127	11	132,969
Aparati Ministrise se Financave dhe Ekonomise	3	10,488	29	77,549	32	88,037
Aparati i Ministrise se Mbrojtjes	2	17,675	15	76,204	17	93,879
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	2,000	7	57,121	8	59,121
Aparati i Keshillit te Ministrave	-	-	11	57,905	11	57,905
Agjencia per Zhvillimin Bujqesor dhe Rural	-	-	10	38,761	10	38,761
Total	**331**	**9,430,749**	**248**	**6,040,164**	**579**	**15,470,913**

Gjithashtu, KLSH konstaton se rregjistrimet e urdhër–prokurimeve janë formale pasi në mbi 80% të rasteve ato janë rregjistruar pas firmosjes së kontratës, pra urdhër- prokurimi është rregjistruar në SIFQ formalisht vetëm për efekt të plotësimit të fushave që lejojnë më pas krijimin e dokumentit kontratë dhe pagesë respektive:

- 565 urdhër-prokurime me data 1- 3480 ditë më të vonshme se data e lidhjes së kontratës në shumën 15.4 miliardë lekë dhe 14 urdhër-prokurime rezultojnë të rregjistruara në të njëjtën ditë me firmosjen e kontratës në shumën 65 milion lekë.
- 25 prej këtyre urdhër prokurimeve kanë vlerë zero pra janë të pavlefshme për testime të tjera,

Përveç sa më sipër, konstatohen mungësi në cilësinë e të dhënave të rregjistrimit, me raste pa përshkrim të objektit të prokurimit apo me data të pavlefshme.

Lshiptaria.com

Mungesë informacioni dhe raportimi mujor për urdhër-prokurime të njësive pa akses direkt në SIFQ

Në përputhje me Ligjin nr.9936 "ligjit nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 149 i tij, cdo institucion shpenzues duhet të paraqitet në Degën e Thesarit për të marrë vulën e konfirmimit të fondeve disponibël përpara se të fillojë proçesin e prokurimit. Për institucionet pa akses direkt në SIFQ ky process nuk dokumentohet pasi nuk ekziston mundësia (fusha) për rregjistrimin e këtij dokumenti, rrjedhimisht nuk ka informacion nëse çdo prokurim ka filluar pasi janë konfirmuar fondet disponibël në Thesar, gjë do të shmangte marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të faturave të prapambetura.

Aktualisht, Drejtoria e Thesarit nuk ushtron kontroll, nuk mbledh informacion për prokurimet e shpallura dhe kontratat e pritshme, informacion që duhet raportuar në zbatim tëNenin 37, të të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 13.01.2017, në të cilin citohet se: "*Dega e Thesarit informon strukturën përgjegjëse të në Ministrinë e Financave, një herë në muaj, brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës, mbi urdhrat e prokurimit të miratuara prej saj, sipas strukturës buxhetore*". Ky informacion do të shërbente për monitorimin e zbatimit të buxhetit, menaxhimin e likuiditetit, planifikimin koherent të programeve buxhetore të ardhshme, shmangien e rishpërndarjeve buxhetore të shumta.

Nga auditimi i të dhënave të urdhër–prokurimeve të rregjistruara gjatë 7 mujorit të parë të vitit 2018, KLSH konstaton se problemi i mosrregjistrimit të të gjithë urdhër-prokurimeve nga të gjitha institucionet dhe mosrregjistrimi në afatet e përcaktuara me qëllim konfirmimin dhe bllokimin e fondeve buxhetore disponibël vazhdon të mbetet. Kështu, DTH vazhdon të mos ketë rekorde nëse institucionet pa akses direkt në SIFQ janë paraqitur pranë Degëve të Thesarit për të konfirmuar fondet disponibël përpara shpalljes së procedurës së prokurimit në APP. Sipas drejtimit të DPTH, kjo procedurë është nën kontrollin e APP në momentin e kontrollit të dokumentacionit për fillimin e procedurave të prokurimit dhe është përgjegjësia e APP për të mos pranuar urdhër-prokurime pa vulën e thesarit. Vetë Drejtoria e Thesarit nuk ka kontroll, informacion për prokurimet e shpallura dhe kontratat e pritshme, gjë që duhej paraqitur në raportimet faktike të planit buxhetit, në pasqyrat financiare të konsoliduara si angazhime të pritshme dhe duhej të monitorohej në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Buxhetit me qëllim planifikimin koherent të programeve buxhetore të ardhshme, shmangien e rishpërndarjeve buxhetore të shumta si dhe menaxhimin e likuiditetit.

Urdhër prokurime të rregjistruar vetëm për vlerë të barabartë me fondet në dispozicion ndryshe nga vlera e prokuruar: 9 raste me diferencë në vlere në SIFQ vs APP prej 2.3 miliardë lekë

Me qëllim testimin e plotësisë dhe saktësisë së të dhënave mbi angazhimet jo vetëm në lidhje me zbatimin e afateve të rregjistrimit por edhe të saktësisë së vlerave dhe plotësisë së raportimit në SIFQ me përfshirje të të gjitha angazhimeve të prokuruara gjatë vitit 2017 u kërkua te APP dhe na u vu në dispozicion lista e prokurimeve të mbyllura dhe kontratat respektive të nënshkruara gjatë vitit 2017. Nga krahasimi i këtyre të dhënave me të dhënat e marra nga SIFQ u konstatuan mospërputhje në datat e kontratës, në datat e urdhër-prokurimeve dhe ajo që është më e rëndësishme në vlerat e kontratave.

[shqiptaria.com]

Nga krahasimi i të dhënave të SIFQ me të dhënat e APP, nga 41 raste të zgjedhura në 16 prej tyre rezulton se urdhër-prokurimet janë të rregjistruara në vitin 2017 në APP ndërsa në SIFQ janë rregjistruar në vitin 2018. Dhe në 9 raste vlera e kontratës e rregjistruar në APP është e ndryshme nga ajo e rregjistruar në SIFQ me një diferencë prej 1.7 miliardë lekë (më pak).

Tabela 47: Urdhër prokurime të regjistruara në SIFQ krahasuar me APP

Nr	Objekti i Prokurimit	Autoriteti Kontraktor	Data Publikimit te Prokurimit	Data e UP sipas SIFQ	Vlera kontrates sipas APP me tvsh në mijë lekë	Vlera e kontrates sipas SIFQ në mijë lekë
1	Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV	Bashkia Tirane	19/07/2017	21/04/2018	838,801	43,636
2	Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II	Bashkia Tirane	19/07/2017	19/04/2018	612,427	33,138
3	Rikonceptim i parkut të lojrave të fëmijëve dhe parkim publik nën tokë në rrugën e Elbasanit	Bashkia Tirane	06/10/2017	10/03/2018	331,429	8,760
4	Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme "Andon Z. Çajupi	Bashkia Tirane	22/09/2017	08/08/2017	143,721	208
5	"Linearizimi i menaxhimit të aseteve në inst. e varësisë të Bashkisë Tiranë"	Bashkia Tirane	16/10/2017	11/07/2018	51,336	7,170
6	Sistemi elektronik i inventarizimit, rregjistrimit të aseteve të Bashkisë Tiranë".	Bashkia Tirane	16/10/2017	11/07/2018	51,000	5,249
7	"Rehabilitim dhe veshje me asfalt i rruges Fushe Arrez (K/Hadroit) "	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	06/02/2017	n/a	924,502	777,199
8	"Ndertim Asfaltim i rruges Cerrik Belsh – Dragot –Kucove –Ure Vajgurore"	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	03/05/2017	n/a	892,384	810,789
9	Lot3 Sodium chloride 0.9% - 500 ml	Ministria e Shendetesise (QSUT)	23/02/2017	n/a	133,179	8,745
	Total				**3,978,782**	**1,694,896**

Duke vlerësuar si tepër shqetësues dhe me risk të lartë për raportimet e zbatimit të buxhetit, menaxhimit të likuiditetit kontratat u investiguan me qëllim identifikimin e shkakut të një praktike të tillë të rregjistrimit të pjesshëm (copëzuar) të vlerave të tyre. Për këtë qëllim, u kërkua informacion në lidhje me celjet buxhetore të secilit prokurim/kontratë të përzgjedhur nga kampioni i të dhënave të APP dhe rregjistruar në SIFQ nga ku u konstatua se në momentin e prokurimit të kontratës celja buxhetore disponibel ishte shumë më e vogël se vlera e prokurimit dhe kontratës së nënshkruar. Kështu, rezultuan **6 raste me diference në vlerë prej 1.38 miliardë lekë midis velerës së prokuruar dhe celjes buxhetore nga të cilat 5 raste janë të projekteve të Bashkisë Tiranë me diferencë në vlera të celjeve buxhetore prej 0.667 miliardë lekë.**

Nga auditimi në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u konstatuan dy kontrata të lidhura gjatë vitit 2017 me vlerë rreth 174 milinë lekë të paraportuara në SIFQ, të pambështetura plotësisht me çelje buxhetore dhe për më tepër procedura e prokurimit fillon pa u rregjistruar urdhër- prokurimi në SIFQ.:

Tabela 48: Kontrata të regjistruara në SIFQ krahasuar me çeljet buxhetore

Nr.	Nr. Kontratës në SIFQ	Objekti i Prokurimit	Autoriteti Kontraktor	Vlera kontratës sipas APP me tvsh	Vlera e kontratës sipas SIFQ	Buxheti në momentin e prokurimit	PBA 2018	PBA 2019	Diferenca: Vlerë kontrate vs Celje Buxhetore
1	2101001-1800152	Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV	Bashkia Tirane	838,801	43,637	650,000	653,000	658,000	**(188,801)**
2	2101001-1800084	Rikonceptim i parkut të lojrave të fëmijëve dhe parkim publik - rrugën e Elbasanit	Bashkia Tirane	331,430	8,760	9,092	-	-	**(322,338)**

lsqiptaria.com

3	2101001-1700179	Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme "Andon Z. Çajupi	Bashkia Tirane	143,722	208	30,000	-	-	**(113,722)**
4	2101001-1800264	"Linearizimi i menaxhimit të aseteve në institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë"	Bashkia Tirane	51,336	7,170	30,000	-	-	**(21,336)**
5	2101001-1800265	Sistemi elektronik i inventarizimit, rregjistrimit dhe përdorimit të aseteve të Bashkisë Tiranë".	Bashkia Tirane	51,000	5,249	30,000	-	-	**(21,000)**
6	55475	"Rehabilitim dhe veshje me asfalt i rruges Fushe Arrez (K/Hadroit)	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	924,503	777,200	210,611	-	-	**(713,892)**
		Total		**2,340,791**	**842,223**				**(1,381,088)**

Fakte këto që mbështetin konstatimet e mësipërme në lidhje me copëzimin e kontratave dhe arsyen e rregjistrimit të tyre me vlera jo të plota por të barabarta me fondin disponibël në shkelje të procedurës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 2 për konfirmimin në Thesar të fondeve disponibël përpara shpalljes së procedurës së prokurimit si dhe konstatimet për rregjistrimet e pasakta në SIFQ të kontratave me vlera të barabarta me celjet buxhetore ose me vlerën e faturës për tu paguar dhe jo me vlerën e plotë të prokuruar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH. Për më tepër, kur angazhimet e marra janë të pambështetura me fonde buxhetore sipas ligjit, nuk njihen si detyrime të shtetit.

Mbartja e kontratave shumëvjecare me vlera jo të plota dhe të copëzuara sipas faturave të lëshuara

Në zbatim të Udhëzimit nr.8 datë 13.01.2017, neni 37, kontratat për investime duhet të rregjistrohet për vlerën e saj të plotë dhe e shoqëruar me planin e pagesave në vite (angazhimet për 3 vite). Në vitin 2016 me lindjen e detyrimit të të gjithë njësive për rregjistrimin e kontratës në SIFQ, cdo kontratë duhej të rregjistrohej në SIFQ për vitin korrent 2016 me vlerën e barabartë me celjen buxhetore vjetore dhe planin e pagesave sipas PBA. Nëse projekti nuk kishte plan buxhetor të miratuar diferenca rregjistrohej në vitin 2017 me qëllim mospërfshirjen në treguesit fiskal**.** Kjo kërkoi gjithashtu dhe pastrimin e balancave të kontratave të lidhura para vitit 2016. Për këtë qëllim u bënë rakordimet me degët e thesarit me qëllim evidentimin e vlerave të mbetura të secilës kontratë në vazhdim. Nga investigimi i balancave hapëse për disa projekte dhe i pagesave të kryera më pas përgjatë vitit 2017 rezultoi se këto vlera nuk janë marrë nga kontrata fizike të depozituara në Degët e Thesarit azhornuar me pagesat e kryera por n**ë të vërtetë ato janë bazuar në llogaritjen : fatura të paguara (për pjesën e zbatuar të projekteve) + fatura të prapambetura (të papaguara për punime tashmë të kryera).**

Në vijim rregjistrimi i cdo faturë e re apo deklarimi (pagesa) efaturave të prapambetura (të pa përfshira me parë në fazën e rakordimit, azhornon dhe vlerën totale të angazhimit. Pra rakordimi i fillim vitit 2017 nuk ishte në të vërtetë rregjistrim i vlerave reale të mbetura sipas kontratës fizike. Ky fenomen u konstatua kryesisht për projektet e ndërtimit të rrugëve me institucion kontraktor: Autoritetin Rrugor Shqiptar, Fondi i Zhvillimit Shqiptar dhe shumë Bashki. Nga një vështrim i kujdesshëm i veprimeve për pagesat e lidhura me **këto kontrata dhe vlerat e rregjistruara konstatohet se në më të shumtën e rasteve ato identifikohen apo mbarten vetëm në momentin e rregjistrimit të faturës në sistemin SIFQ**. Kjo pasi sistemi kushtëzon që cdo urdhër-shpenzim

[Shqiptaria.com]

(faturë) të mund të rregjistrohet vetëm pasi është rregjistruar më parë kontrata (urdher-blerja).

Pra vlera e angazhimeve të raportuara nga SIFQ nuk paraqet vlerën e plotë dhe të saktë të angazhimeve në rang sistemi buxhetor.

Më shqetësues është fakti se ky fenomen nuk konstatohet vetëm tek kontratat e mbartura ndër vite por edhe tek ato të lidhura dhe të rregjistruara rishtaz gjatë vitit 2017. U konstatuan edhe raste ku vlera e angazhimit e publikuar në raportin e monitorimit për Dhjetor 2017, nuk korrespondon me vlerën e kontratës në SIFQ. Rasti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë:

Projekti M064079 "Impjanti i prodhimit të energjisë nga mbetjet, Fier""
Realisht kontrata figuron e rregjistruar në SIFQ 2 herë në vitin 2017 përkatësisht:
Numer 1006001-1700005 me vlerë **108,382,960 lekë- datë 18/12/2017**
Numer 1006001-1700022 me vlerë **55,000,000 lekë- datë 29/12/2017**
Vlera reale e plotë e kontratës 2,258,316,000 lekë rregjistruar 28/4/2018
Vlera e raportuar në ëebsite 1,505,544,000 lekë- si angazhim (Nëntor)

Dega e Thesarit Tiranë shpjegohet se "*... specialistja e Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit ka gjeneruar nga SIFQ pamjen e kontrates, ku.. rezulton vlera e plote e kontratës prej 4,516,621,317 leke për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit". Me ristrukturimin e ministrive kjo kontrate do të vazhdohej (në vlerën e mbetur prej **3.801.160.387** leke) nga MIE (me kod institucioni 1006001 dhe sipas listës në varësi te kesaj ministrie me kod projekti të ndryshuar M064079), e cila i regjistron vetë ne SIFQ te gjitha transaksionet, sepse është "on line*"

Pavarësisht shpjegimit nga të dhënat e PO nuk gjejmë mbartje prej 3.8 miliard lekë. Nëse veprimet e mbartjes jane kryer në vitin 2018 atëherë lind pyetja pse pagesat e dy faturave prej 163.3 (108.3+55) milionë lekë janë kryer nga MIE në vitin 2017 dhe mbi bazen ë kujt kontrate?

Fenomeni i rregjistrimit të kontratës së copëzuar me shuma të barabarta sa vlera e faturave për t'u paguar dhe ekzaktësisht të barabarta me fondin buxhetor disponibël konstatohet dhe në rastin e Autoritetit Rrugor Shqiptar për projektin **M061501** për të cilin në muajin Prill- Dhjetor shfaqen/rregjistrohen fatura të reja në total 137 milion lekë ndërkohë që fondi disponibël është **vetëm 50 milion** dhe paguhen vetëm 42 milion lekë. Në një rast të vetëm konstatojmë disa problematika: rregjistrimin e copëzuar të kontratës, ndryshime të vlerave të angazhimit nga 0.94 miliardë në 1.003 miliardë në 0.95 miliardë e në fund të dhjetorit 1.04 miliardë lekë, fatura të prapambetura pa fonde buxhetore 95 milion, **shkurtim të fondeve buxhetore me AN3 ndërkohë që projekti mbart detyrime**, mos rregjistrim të planit të pagesave për 2017-2019. Në këto kushte nuk dihet apo nuk mund të konkludojmë se sa në të vërtetë është vlera totale e këtij angazhimi dhe detyrimet e prapambetura të lidhura me të.

Pasaktësitë në regjistrimin e angazhimeve në vlerë dhe afate regjistrimi nga përdoruesit e autorizuar të sistemit: BI online po edhe BI offline që kryejnë veprime nëpërmjet Degeve të Thesarit janë në shkelje të Udhëzimit nr.2 dt. 6.2.2012, pikës 176 *dhe* 178. Në këto kushte, ajo që mund të konkludojmë nëpërmjet testeve thelbësore dhe analitike, është fakti se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nuk disponon të dhëna të plota mbi vlerën totale të anagazhimeve ndaj palëve të treta të sistemit publik si dhe të faturave të lidhura me to që mund të jenë lëshuar por nuk janë rregjistruar për shkak të

mungesës së fondeve disponibël, nuk kryen kontrolle të plota të dokumentacionit si autorizuese e e fundit e veprit pas aprovimeve të NA-ve dhe NZ-ze respektive, si dhe SIFQ si aplikacion akomodon rregjistrime pjesore te kontratatve jo vetëm në mbartje në fillim të vitit.

Rregjistrime vetëm për vlerë të fondeve në dispozicion:

- **Raste të tjera të copëzimit të kontratave në rregjistrim:**

Nga auditimi it të dhënave të angazhimeve, kontratave dhe pagesave respektive KLSH ka investiguar dhe konstatuar dhe fenomenin e rregjistrimit të kontratave në të njëjtën ditë ose 1-2 diferencë në kohë me rregjistrimin e faturës së parë. Pra institucionet me akses apo jo në SIFQ edhe pse në dijeni të afateve ligjore për rregjistrimin e cdo dokumenti për investim: nga urdhër-prokurime deri te fatura në mënyrë të vetëdijshme nuk i zbaton këto afate. Për tepër konstatohen raste të rregjistrimit të kontratës me vlera të barabarta me faturën dhe jo me vlerën reale të prokuara dhe kontraktuar psh rasti i Bashkisë Tiranë dhe:

• Njësia shpenzuese: "Bashkia Tiranë":	
-Kontrata e firmosur më	28/12/2017 (sipas Buletinit javor të APP)
-Vlera e kontratës	**612,427,235 lekë** (sipas Buletinit javor të APP)
-Vlera e kontratës në Thesar	**33,138,470 lekë** (sipas SIFQ)
-Kontrata rregjistruar në Thesar	21/04/2018 (sipas SIFQ)
-Fatura e rregjistruar në Thesar	23/04/2018 (sipas SIFQ)
-Pagesa e kryer më	26/04/2018 (sipas SIFQ)
• Njësia shpenzuese: "Bashkia Tiranë":	
-Kontrata e firmosur më	28/12/2017 (sipas Buletinit javor të APP)
-Vlera e kontratës	**838,800,920 lekë** (sipas Buletinit javor të APP)
-Vlera e kontratës në Thesar	**43,636,512 lekë** (sipas SIFQ)
-Kontrata rregjistruar në Thesar	21/04/2018 (sipas SIFQ)
-Fatura e rregjistruar në Thesar	24/04/2018 (sipas SIFQ)
-Pagesa e kryer më	26/04/2018 (sipas SIFQ)

Kështu Bashkia Tiranë është në shkelje të: 1) rregjistrimi brenda 5 ditëve i kontratës së lidhur 2) mosrregjistrim të vlerës së plotë të kontratës (angazhimit).

• Njësia shpenzuese: "Fondi i Zhvillimit Shqiptar":	
-Kontrata e firmosur më	25/04/2017 (sipas SIFQ)
-Vlera e kontratës	**924,502,776 lekë** (sipas Buletinit javor të APP)
-Vlera e kontratës në Thesar	**777,199,776 lekë** (sipas SIFQ)
-Kontrata rregjistruar në Thesar	12/10/2017 (sipas SIFQ)
-Fatura e rregjistruar në Thesar	12/10/2017 (sipas SIFQ)
-Pagesa e kryer më	13/10/2017 (sipas SIFQ)

- **Raste të tjera të copëzimit të faturës në rregjistrim:**

Një tjetër fenomen i konstatuar është rasti i pagesave pjesore me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël dhe mbartjen e detyrimit të mbetur në vitin pasardhës. Kështu në të dhënat e pagesave nga SIFQ, për Bashkinë Gjirokastër e cila nuk ka akses në SIFQ (BI Offline) veprimet janë kryer fizikisht nga Dega e Thesarit Gjirokastër ku me paraqitjen e faturës rregjistrimi është bërë pjesor dhe rrjedhimisht dhe pagesa me vlerë të barabartë me fondin disponibël:

Kështu rasti i projektit të investimit me kod M991358 Rikonstruksion i "Blv. 18 Shtatori dhe degëzimeve të rrugëve Rexhep Qosja dhe Gole Gushi" I programit "Infrastruktura vendore dhe Rajonale" rezulton të jetë celur dhe realizuar në të

[Shqiptaria.com]

njëjtën vlerë për 93,200 mijë lekë. Nga auditimi I të dhënave të SIFQ-së u konstatua se, në vitin 2017 bashkia Gjirokastër ka likuiduar me datë 12.12.2017, faturën nr. 34, datë 30.05.2017 në vlerën 93,200 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se kjo faturë është likujduar edhe në vitin 2018 konkretisht në datën 08.05.2018 për vlerën 22,651 mijë lekë. Pra referuar sa më lart konstatohet se ky investim ka qënë një investim në proces dhe si i tillë nuk është respektuar Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit" neni 65 citohet: "Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti mban parasysh këtë radhë prioritare: a- investimet në proces nga viti i kaluar.

Numër i lartë i rregjistrimit të kontratave të lidhura para vitit 2016: 2034 raste me vlerë 18.6 miliard lekë nga të cilat 387 raste të kontratave të lidhura në vitet 2007-2015 me vlerë 5.3 miliard lekë

Nga të dhënat e sistemit SIFQ rezultuan gjithsej **24080 kontrata unike** të rregjistruara gjatë periudhës 1.1.2017-31.12.2017 (625 rekorde nuk u morën parasysh për shkak të pavlefshmërisë së vlerës së kontratës rregjistruar me 0 ose 1 lek). Nga analiza e datës së kontratës fizike e nxjerrë po nga sistemi SIFQ rezultojnë 2034 rregjistrime të kontratave të lidhura para vitit 2017 me vlerë **18.6 miliardë lekë**, nga të cilat 1647 raste të kontratave të lidhura gjatë vitit 2016 dhe vlerë totale 13.3 miliardë lekë dhe 387 raste të kontratave të lidhura **gjatë periudhës 2007-2015 me vlerë totale 5.3 miliardë lekë.** Këto kontrata të rregjistruara për herë të parë në sistemin SIFQ në vitin 2017 janë kontrata shumëvjecare të pa shoqëruara me planin e pagesave ose angazhime të institucioneve të paraportuara më parë në sistem SIFQ, për shkak të mungesës së fondeve për realizimin e tyre. Në mënyrë të detajuar sipas viteve të angazhimit (datë firmosje kontrate) dhe statusit respektiv më 31.12.2017, numri dhe vlera e kontratave të mbartura, të rregjistruara gjatë vitit 2017 paraqitet si më poshtë ku sipas institucioneve veçojmë: **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Rrugor Shqiptar) me vlerë 4.3 miliardë lekë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore me vlerë 7 miliard lekë.**

Tabela 49: Numri dhe vlera e kontratave të mbartura, të rregjistruara gjatë vitit 2017

	Statusi "i maturuar"	Statusi "aktiv"	Total			
Viti i kontrates	Vlera në mijë lekë	Nr. Kontratave	Vlera në mijë lekë	Nr. Kontratave	Vlera në mijë lekë	Nr. Kontratave
2017	13,287,847	8,462	59,438,861	13,584	72,726,708	22,046
2016	1,776,980	551	11,589,807	1,096	13,366,787	1,647
2015	380,049	44	1,766,730	117	2,146,779	161
2014	33,122	17	151,807	45	184,929	62
2013	13,259	4	2,610,500	60	2,623,759	64
2012	5,365	7	72,034	35	77,399	42
2011	4,980	9	57,263	14	62,243	23
2010	11,405	11	11,322	6	22,727	17
2009	567	1	21,696	7	22,263	8
2008	7,000	2	531	2	7,531	4
2007			114,798	6	114,798	6
Total	**15,520,574**	**9,108**	**75,835,350**	**14,972**	**91,355,923**	**24,080**

Edhe pse disa prej këtyre kontratave mund të jenë realisht kontrata të mbartura për projekte në vazhdim, nga raportet e gjeneruara nga sistemi SIFQ nuk është e mundur identifikim i tyre me qëllim të testimeve të mëtejshme. Në sistemin SIFQ, që prej muajit Prill 2016, janë shtuar fusha për të rregjistruar kontratën në mënyrë të plotë, megjithatë, informacioni i lidhur me të nuk futet në sistem në momentin e rregjistrimit dhe kontabilizimit të kontratës nga të gjitha insitucionet dhe degët e thesarit, me përjashtim të disa institucioneve që

kanë akses në sistemin SIFQ (BI online). Pavarësisht nga kjo numri i kontratave të viteve të mëparshme mbetet i lartë nëse këtë fakt e analizojmë në korrelacion me numrin e lartë të faturave të prapambetura (të lëshuara para vitit 2016) të paguara në vitin 2017, Fakt që tregon se kemi të bëjmë me kontrata të lidhura ndër vite pa fonde buxhetore si dhe se strategjia për eleminimin dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetuara të ndërrmarë nga Qeveria Shqiptare dhe e mbështetur nga FMN, ka dështuar.

Tabela 50: Kontrata të mbartura ndër vite

	Lloji shpenzimit (në mijë lekë)		
Viti i fatures	**23 (Investim)**	**60 (mallra-sherbime)**	**Total**
2016	5,153,242	2,066,208	7,219,450
2015	689,926	144,765	834,691
2014	277,667	61,976	339,643
2013	164,224	37,413	201,637
2012	62,080	23,202	85,282
2011	28,929	4,680	33,610
2010	10,861	5,808	16,669
2009	4,193	1,545	5,738
2008	5,087	664	5,751
2007	710	143	853
2005		2,785	2,785
2004		5	5
2001		80	80
Total	**6,387,846**	**2,349,273**[5]	**8,746,193**

Përvec mungesës së kontrolleve të aplikacionit SIFQ mungojnë udhëzimet për degët e thesarit në gjurmën e auditimit (procedurat e punës) për raportimin e këtyre rasteve me argumentin se kjo është përgjegjësi e institucionit dhe "*..sistemi SIFQ është një sistem operacional zbatues dhe jo një sistem menaxherial sinjalizues*[6] "!!

Raportimi i investimeve publike[7] i pasaktë ku mungon plani i pagesave sipas PBA-së në 90% të projekteve të listuara, vlera plotë e angazhimit të projektit të ri dhe vlera e saktë e kontratave të mbartura.

Nga intervista me përgjegjësen e Drejtorisë së Mbështetjes së Biznesit mësojmë se në sistemin SIFQ, që prej muajit Prill 2016 janë shtuar fusha për të rregjistruar kontratën në mënyrë të plotë dhe sipas skedulit të pagesave dhe PBA-së së miratuar. Kjo si domosdoshmëri kontrolli dhe monitorimi jo vetëm për buxhetin faktik por dhe për qëllim planifikimi të buxhetit të vitit të ardhshëm. Aktualisht ky kontroll nuk përdoret dhe informacioni për shpërndarjen në vite të kontratës plotësohet në mënyrë rastësore dhe i jo i detyrueshëm.

Aktualisht, kur kontrata rregjistrohet me shumën e saj të plotë, sistemi (punonjësja e Thesarit për BI off-line) përputh vlerën e vitit të parë me fondin limit të celur për vitin aktual dhe më pas kërkon vitin e 2-të dhe të 3-të për planin buxhetor afatmesëm. Në rast se nuk gjendet asnjë shumë e rregjistruar për 2 vitet në vijim vlera e mbetur e kontratës rregjistrohet si rezervë në vitin 2020 (2021). Në këtë mënyrë ekziston rreziku që çdo institucion rregjistron kontratat vetëm kur ka fonde të disponueshme dhe vetëm për vlerën

5 Vlera e paguar për ekzekutim vendimesh gjygjësore e përfshirë në këtë shifër është 190,817 mijë lekë

6 Sipas observacioneve të Drejtorisë së Operacioneve pranë Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit

7 Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: Progresi i investimeve publike

[shqiptaria.com]

disponibël, dhe jo direkt kur ndërmerr një angazhim dhe me vlerën e plotë të tij.

Nga konsolidimi i tabelave për periudhen Janar-Dhjetor 2017, nga MFE raportohen gjithsej 6282 projekte unike për investime (llogaria 230 dhe 231) në shumën rreth 284 miliardë lekë (project-to-date) ose 7223 fonde/projekte individuale e shpërndara në institucione. Ky raport nuk ka informacion nëse këto projekte janë të përfunduara apo në vazhdim si dhe informacioni për planin e pagesave 3-vjecar 2017-2019, në 90% të rasteve është i paplotësuar.

Në konkluzion, mund të themi se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me udhëzimin e dhënë Degëve të Thesarit për prekje të periudhave të ardhshme jashtë raportimit të treguesve fiskal (viti 2020 apo 2021) ka krijuar një artificë në sistem i cili jep mundësinë institucioneve (BI online) dhe Degëve të Thesarit për rregjistrimin jo korrek të angazhimit ndër-vite. Shumat e rregjistruara dhe raportuara si angazhime (commitment) për vitin 2020 dhe 2021 paraqiten në tabelën në vijim në një total prej 17.8 miliardë lekë. Theksojmë se burimi i këtij informacioni është tabela e investimeve publike e publikuar në faqen zyrtare të MFE të konfirmuara me tabelat e marra nga specialistja përgjegjëse për nxjerrjen e raportit cdo muaj.

Tabela 51: Angazhimet e raportuara në SIFQ

Institucioni qendror	Nr. Projekteve	Angazhimi rregjistruar për v.2020 (në mijë lekë)	Angazhimi rregjistruar për v. 2021 (në mijë lekë)
Ministria e Transportit dhe Infrastruktures	1099	4,026,693	9,328,662
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	266	359,479	2,653,916
Ministria e Kultures	199	8,960	427,396
Ministria e Mbrojtjes	147	6,678	281,267
Ministria e Shendetsise	1418	58,762	43,754
Ministria e Arsimit dhe Sportit	588	18,671	29,248
Ministria e Brendshme	348	30,176	41,975
Ministria e Bujqësise, Zhvillimit Rural	659	4,691	18,048
Ministria e Drejtesisë	207	154,332	24,522
Ministria e Mjedisit	158	29,416	19,031
Institucione të tjera Qeveritare	209	269,355	1,266
Drejtoria e Arkivit te Shtetit	25	262	
Drejtoria e Përgjithshme e RTSH	4	506	
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	19	5,140	-
Ministria e Energjisë dhe Industrise	157	87	-
Ministria e Financave	363	-	5,031
Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	217	1	5,523
Total	**6282**	**4,973,210**	**12,879,639**

Tabelat e progresit të investimeve publike publikohen çdo muaj në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si një detyrim raportimi periodik. Nga auditimi i këtyre raporteve, u konstatua se të dhënat në faqen zyrtare të MFE janë azhornuar deri për periudhën Janar- Tetor 2017 dhe për për tre-mujorin e fundit të vitit 2017 u azhornuan gjatë periudhës së auditimit (Korrik 2018). Vazhdojnë të mungojnë të dhënat për 6-mujorin e parë të vitit 2018.

Legjitimimi me AN2 dhe AN3 të projekteve pa fonde në 90 raste me vlerë rreth 0.7 miliard lekë:

Nga analiza e raporteve të monitorimit të kontratave shumë vjeçare u konstatuan dhe raste të kryerjes së pagesave për projekte të cilat nuk kanë patur çelje me Ligjin e Buxhetit për vitin 2017. Të gjitha rastet e analizuara

Isnoipitaria.com

individualisht janë konfirmuar me databazën e pagesave të vitit 2017 me burim sistemin SIFQ. Të gjitha këto raste i janë vënë në dispozicion strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit me e-mail dhe më pas janë dërguar me Akt-konstatimin e datës 15.8.2018. Për çdo rast është kërkuar shpjegim dhe dokumentacion mbështetës për urdhërimin e pagesave pasi ato mund të jenë në shkelje të ligjit nr.9936 dt.26.6.2008 "Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Nga përgjigja me e-mail Drejtoria e Thesarit argumenton kjo drejtori përgjigjet për buxhetin faktik ndërsa nga Drejtoria e Buxhetit u dërguan 7 shkresa të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë ku urdhërohet transferimi i fondeve për projektet në analizë, si shembull i argumentimit të çeljeve buxhetore në Muajin Maj-Qershor. Pavarësisht nga kjo, këto çelje buxhetore janë përfshirë në Aktin-normativ nr.2 ose nr.3. Në gjykimin tonë nëse këto transferime do të ishin brenda kriterit: i njëjti projekt, i njëjti institucion, nuk do të paraqiteshin në AN2 apo AN3 si rishpërndarje apo çelje buxhetore për projekte të reja. Gjithashtu, nga shqyrtimi i projekteve me çelje buxhetore sipas AN2 dhe AN3 përkundrejt pagesave të kryera në SIFQ, konstatohet se konstatohen çelje buxhetore me vlera të barabarta me detyrimet e prapambetura të projekteve të mbartura nga vitet e mëparshme. P.sh: 6 projekte të Autoritetit Rrugor Shqiptar (M063550 , M063553 M063554 , M063556 , M063557 , M063558) në total çelje buxhetore prej 185 milion lekë; 1 projekt i Ministrisë së Mjedisit: M120730 në total 167 milion lekë, korrespondojnë ekzaktësisht me vlerat e faturave të paguara të cilat mbajnë data më të hershme se data e miratimit të fondit buxhetor.

Në lidhje me moszbatimin e afateve të rregjistrimit të kontratave në Degët e Thesarit në 72% të rasteve me vlerë 62.9 miliardë lekë.

Në zbatim të pikës 17 të Udhëzimit specifik nr.26 dt. 20/11/2012 "*Pas miratimit nga nepunesi zbatues dhe nepunesi autorizues i njesise brenda **pese diteve** pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si me siper paraqitet ne gjuhen shqipe (ne rastin e kontratave të lidhura ne gjuhe te huaj) bashke me njoftimin perfundimtar zyrtar per shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjese per thesarin ne dege*", në vijim janë analizuar dhe grupuar data të kontratave të rregjistruara me datën e krijimit në sistem ku rezultojnë gjithsej 16795 raste ose 72% e gjithë kontratave të rregjistruara gjatë vitit 2017 në shkelje të afateve të përcaktuara me vlerë 62.9 miliardë lekë në udhëzimin e sipërcituar.

Edhe pse në këtë numër nuk përfshihen kontratat e rregjistruara mbi 360 ditë pasi ato janë prezumuar si kontrata shumëvjecare, përsëri numri i rasteve të shkeljes së afateve mbetet tepër i lartë me impakt në raportimin e angazhimeve, parashikimit të likuiditetit dhe limitit mujor të pagesave, krijimit të faturave të prapambetura dhe kostot shtesë lidhur me to[8]. Sipas institucioneve rastet e shkeljeve të afateve paraqiten si më poshtë ku numri më i lartë të shkeljeve konstatohet në njësitë e qeverisjes vendore: tipikisht Bashkia Tiranë, Durrës etj.

[8] Ligji nr. 48/ 2014 Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare

[shqiptaria.com]

Tabela 52: Ditë-vonesat të rregjistrimit të kontratave në Thesar (në mijë lekë)

Institucioni	Dite-vonesat të rregjistrimit të kontratave në Thesar					
	6-30 dite		31-360 ditë		mbi 360 ditë	
	nr	Vlerë	nr	Vlerë	nr	Vlerë
Njësi të Qeverisjes vendore	**2,592**	**7,944,861**	**2,557**	**11,110,272**	**438**	**1,573,949**
nga e cila:						
Bashkia Durrës	*107*	*748,233*	*11*	*113,509*		
Bashkia Tiranë	*8*	*69,026*	*153*	*4,942,888*	*152*	*1,103,583*
Ministria e Shëndetsise	**1,842**	**4,047,532**	**1,177**	**2,286,847**	**32**	**41,110**
nga e cila: QSUT	*315*	*2,362,950*	*123*	*746,036*		
Ministria e Brendshme	**1,119**	**2,199,983**	**553**	**836,259**	**6**	**19,291**
Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë	157	1,163,265	196	9,476,645	18	3,132,015
Ministria e Financave dhe Ekonomise	460	210,138	205	350,752	21	329,241
Ministria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave	437	588,518	243	445,265	7	3,764
Ministria e Arsimit dhe Sportit	500	621,338	328	428,176	6	4,502
Ministria e Drejtesise	424	497,611	161	343,824	9	14,505
Ministria e Kultures	159	186,298	107	1,079,245	3	11,480
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	48	144,779	29	30,606	2	400
Ministria e Mbrojtjes	412	2,462,487	213	609,850	1	62
Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise	395	146,670	224	308,960	1	13
Ministria për Evropen dhe Puneve Jashtme	16	9,066	27	34,851	-	-
(ish)Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregetise dhe Sipermarrjes	32	37,053	49	53,824	1	980
(ish)Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	95	23,451	82	58,250	-	-
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	3	6,376	64	9,931,234	26	110,321
Institucione te tjera Qeveritare	118	240,134	105	2,594,606	30	864,489
Institucione të pavarura	1,104	1,063,516	562	1,397,271	36	404,291
Total	**9,913**	**21,593,077**	**6,882**	**41,376,738**	**639**	**6,510,584**

Mos rregjistimi i faturave brënda afateve ligjore konstatuar rreth 24 mijë raste të moszbatimit të afatit 30 ditor të dërgimit të faturave në Thesar me vlerë 29,1 miliardë lekë dhe 393 raste të kryerjes së pagesave përtej afatit 30 ditor nga Degët e Thesarit.

Ligji Nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet konraktore e tregtare*" neni 7, parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit. Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të këtyre afateve si nga ana e njësive shpenzuese ashtu edhe nga Degët e Thesarit. Nga një total prej 181 mijë pagesa të rregjistruara gjatë vitit 2017 vetëm për investime dhe mallra rezultojnë rreth **23,701 urdhër-blerje me vlerë 29.1 miliardë lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor**. Nga analiza e rasteve në shkelje të afatit 30 ditor vërehet se ky fenomen është më i përhapur në Institucionet vendore me një numër prej 11,550 transaksionesh në vlerën 9,830,649 mijë lekë , ku vetëm Bashkia Tiranë ka 1564 raste e ndjekur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar me 904 raste. Ky fenomen vazhdon të vihet re edhe gjatë vitit 2018.

Gjithashtu, shkelje të afateve për kryerjen e pagesave konstatohen edhe në Degët e Thesarit me 393 raste me vlerë 514,616 mijë lekë me tejkalim të afatit 30 ditor të kryerjes së pagesës nga momenti i dorëzimit nga institucionet të faturës për regjistrim dhe pagesë në SIFQ.

Shtëpia.com

Kryerja e pagesave për fatura të grupuara në një urdhër shpenzim: 131 raste në vlerën 1.4 miliardë lekë

Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2017, konstatohet se janë likuiduar me një urdhër shpenzim disa fatura njëkohësisht, kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet në periudhën në të cilën ai është kryer dhe lind detyrimi. Kështu nga fusha "Përshkrimi" janë konstatuar 131 raste të likujdimit të disa faturave njëkohësisht në një urdhër shpenzim në vlerën 1.4 miliardë lekë. Në tabelën e mëposhtme evidentohen institucionet me numrin e rasteve të likujdimeve të disa faturave njëkohësisht dhe vlera e faturave të likujduara. Nga analiza e faturave te likujduara me një urdhër shpenzim konstatohet se vetëm zërin e shpenzimeve për AQT (230 dhe 231) janë bërë pagesa në grup në 40 raste me vlerë 1 miliardë lekë[9].

Nuk ka informacion për raste në të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka identifikuar dhe tërhequr vëmëndjen për këtë parregullsi. Kjo krijon mundësinë e mosidentifikimit të qartë dhe unik të një fature/detyrimi, kohën kur ka ndodhur shpenzimi dhe nuk lejon monitorim të progresit të realizimit kontratave në mënyrë korrente. Gjithashtu kjo mund të shkaktojë keqklasifikime të llojit të shpenzimit të kryer duke prekur llogari ekonomike të gabuara.

Tabela 53: Institucionet që kanë likujduar disa fatura njëkohësisht (vetëm llog.230 dhe 231)

Institucioni	Shuma në mijë lekë	Nr. Pagesave ne grup
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	976,521	29
Aparati Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural (3535)	58,744	5
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve (3535)	34,337	1
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (3535)	12,440	1
Inspektoriati Shteteror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujerave ne nivel qendror (3535)	2,948	1
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	2,695	1
Njesia e Zbatimit te Projektit "Banesa me Qellim Social" Durres (0707)	280	1
ALUIZNI- Drejtoria Lushnje (0922)	164	1
Total	1,088,129	40

Lidhur me respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës (FIFO)

Sipas Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt. 6.2.2012, pika 166 *"Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë dhe pika 167: "Me pas, struktura përgjegjëse për thesarin vijon me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të rregjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve në sistemin informatik financiar (hyrje e parë - dalje e parë)".* Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën me përzgjedhje një tremujor pagesash (Tetor–Dhjetor 2017) dhe nga një total prej 107,791 transaksione u përzgjodhën 3,733 transaksione (vetëm duke marrë parasysh llogarinë 231, 602- llogaritë shpenzime për mallra dhe shërbime), ku u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të rregjistruara në data të mëvonshme ndërkohë që në system janë të

9 KLSH ka përjashtuar rastet e pagesave në grup për shpenzime utilitare: energji, ujë etj.

[Shqiptaria.com]

rregjistruara fatura në data më të hershme. Ky fenomen viher re qartazi në rastin e Bashkisë Rrëshen ku sic paraqitet edhe në tabelë rregullisht cdo muaj ka shtyrje në kohë të pagesave 30-90 ditë:

Tabela 54: Shtyrjet në kohë në pagesat e Bashkisë Rrëshen përgjatë vitit 2017

	Data e Pagesës											
Data e Krijimit	**Janar**	**Shkurt**	**Mars**	**Prill**	**Maj**	**Qershor**	**Korrik**	**Gusht**	**Shtator**	**Tetor**	**Nëntor**	**Dhjetor**
Janar	2,556	1,558	3,710									
Shkurt		35,211	3,015			267						
Mars			82,644	2,794		24						
Prill				71,262	1,301	2,530	1,153					
Maj					74,946	2,061	544		1,438	1,114		
Qershor						141,415	22,576				1,782	
Korrik							54,057				655	
Gusht								7,655	6		76	190
Shtator									60,446	950	345	
Tetor										51,855	211	7,956
Nëntor											21,803	
Dhjetor												33,346

Në lidhje me këtë cështje Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit shprehet se duhet marrë parasysh afatet dhe nivelet nëpër të cilat duhet të kalojë urdhër-shpenzimi deri në ekzekutim pagese apo dhe rastet e kthimit për saktësim dhe plotësim dokumentacioni. Në gjykimin e audituesve të KLSH ky argument nuk qëndron pasi afati 30 ditor i përcaktuar me ligj është mëse i mjaftueshëm për të gjithë hapat e procedurës dhe nuk justifikon rastet e rregjistrimit psh: në muajin Prill dhe pagesa në muajin Korrik etj.

Mbi rregjistrimin dhe raportimin e stokut të faturave të prapambetura. Niveli i stokut i konstatuar në fund të vitin 2017 është raportuar nga MFE 16.4 miliardë por sipas procedurave të testimit rezulton të jetë të paktën në vlerën 19 miliardë lekë.

Në fillim të vitit 2017, i është urdhëruar institucioneve shpenzuese dërgimi i informacionit të faturave të prapambetura pranë Degëve të Thesarit si pjesë e strategjisë për menaxhimin e faturave të prapambetura. Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka përpiluar një Manual udhëzues përdorimi përfundimtar "*Mbi regjistrimin, ngarkimin dhe postimin në sistem të detyrimeve të prapambetura*", sipas të cilit institucionet rregjistrojnë faturat në Thesar ku ky i fundit i kontabilizon ato jo mbi bazë trasaksioni por si balanca kontabël në një llogari të hapur enkas për këto fatura; grupi 486, llogaria 4864 "*shpenzime të periudhave të ardhshme-fatura të prapambetura*". Kjo balancë paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara më 31.12.2017, klasa 4 në shumën **16.4 miliardë lekë**. Me qëllim testimin e saktësisë dhe plotësisë së kësaj shifre u intervistuan specialistët e **DPTH të cilët shpjegojnë se raportimi është kompetencë e titullarëve të institucioneve dhe nuk mund të garantojnë nëse kjo balancë është përfaqësuese e plotë e gjithë detyrimeve të prapambetura në rang sektori publik dhe nuk jepet garanci nëse njësitë ekonomike kanë deklaruar në Thesar të gjithë faturat e prapambetura dhe ato të krijuara rishtas deri në datën e raportimit.**

Referuar manualit të cituar më lart, në momentin që një faturë e prapambetur autorizohet për t'u paguar nga NA atëherë me dërgimin e dokumentacionit në Thesar veprimi i parë i rregjistrimit në llogarinë 4864 stornohet, fatura rregjistrohet si transaksion dhe paguhet. Mbi bazën e këtij informacioni, grupi i auditimit analizoi pagesat e kryera gjatë vitit 2017 ku u konstatuan **6857 pagesa të faturave dhe detyrimeve të prapambetura në shumën 8.7 miliardë lekë. Ndërkohë u analizuan pagesat e kryera gjatë 7-mujorin 2018 ne zërin**

shpenzime kapitale ku rezulton se pagesat e lidhura me fatura që mbajnë datë 2017 janë në vlerë rreth 11.5 miliardë lekë (rregjistruar në periudhën Shkurt- Korrik 2018), duke treguar që gjatë vitit 2017 detyrimet e prapambetura janë rritur dhe jo të gjitha deklarimet e faturave të prapambetura nga Institucionet janë të sakta dhe të plota. Si rrjedhim kjo balancë duhej të ishte raportuar të paktën 19 miliardë lekë. Kjo shifër në gjykimin e grupit të auditimit është më e lartë duke marrë në konsideratë pasaktësitë e konstatuara në datat e faturave. Kështu nga 179 raste të konstatuara me data faturash jo të sakta 46 prej tyre me vlerë totalë 0.3 miliardë lekë ishin fatura apo detyrime të prapambetura të cilat mund të identifikohen si të tilla vetëm nga përshkrimi pasi në sistem janë hedhur me data korrente (të pasakta).

Gjatë auditimit, në vijim të testimit të plotësisë dhe saktësisë së vlerës së rregjistruar dhe raportuar si detyrime të prapambetura u evidentua një dokument i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, shkresë e dërguar 61 bashkive për dërgimin e informacionit të faturave të prapambetura historike thuhet se stoku i faturave të prapambetura për njësitë e qeverisjes vendore më 31.12.2015 ishte 12.2 miliardë lekë nga të cilat 1.05 miliardë lekë ishin detyrime të prapambetura lidhur me cështje gjygjësore (pa përcaktuar llojin e çështjes: largim nga puna, etj). Kjo shkresë dhe të dhënat e saj u analizuan dhe u krahasuan me të dhënat që disponojmë nga sistemi SIFQ për balancën e detyrimeve për çështje gjygjësore më 31.12.2017 si dhe pagesat e kryera (pakësime) për vendime para dhe në vitin 2015. Rezultati paraqitet me një total pagesash të kryera prej 0.228 miliardë lekë në dy vite dhe balanca e raportuar në 31.12.2017 do të llogarisnim një balancë hyrëse më 31.12.2015 prej 1.2 miliardë lekë në total për të gjithë Bashkitë. Devianca prej 15% e shifrave në dy data të ndryshme, tregon se raportimi është dinamik dhe, njësitë vazhdojnë dhe raportojnë detyrime të prapambetura por në mënyrë selektive, dmth në momentin që vendosin të paguajnë detyrimin dhe jo si një detyrim ligjor. Nisur nga analiza e kontratave dhe urdhër-prokurimeve të rregjistruara, vonesat në rregjistrim, mbartja e angazhimeve[10] ekzistuese shumëvjecare jo në fillim të vitit por vetem nëse projektit i konstatohet një faturë e cila dërgohet për pagesë mund të themi me siguri të arsyeshme se edhe pse balanca e faturave të prapambetura në Qershor të vitit 2018 është shumë më i ulët, risku i krijimit të detyrimeve të reja është i lartë. Sipas të dhënave të llogarisë 4864 **kemi një shtesë prej 1 miliardë lekë detyrime të reja të rregjistruara gjatë vitit 2018**. Përsëri, procesi dhe niveli i monitorimit nga Drejtoria e Thesarit është minimal dhe nuk garanton se kjo shtesë detyrimesh është e plotë krahasuar kjo dhe me problematikat e konstatuara me stokun e angazhimeve të kontratave të reja dhe shumëvjecare të monitoruara dhe publikuara nga Drejtoria e Raportimit financiar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesari, trajtuar sa më lartë.

Pagesa të kryera në Shkurt 2018 për llogari të vitit 2017, veprim ky në kundërshtim më Ligjin e Buxhetit 9936 dt. 26.6.2008, në total 26 milion lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor nr. 9936 dt.26.6.2008 cdo vit Drejtoria e Thesarit, Buxhetit dhe e Harmonizimit përpilojnë një Udhëzim për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të shtetit. Për vitin 2017 ky udhëzim është udhëzimi nr.23 dt.22.12.2017 ku në nenit 24 të

[10] Udhëzimi specifik nr.26, dt.20.11.2012 "Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë

[shqiptaria.com]

tij përcaktohen afatet e rakordimeve për cdo shpenzim të kryer dhe të ardhura (23.1.2018), publikimii shpenzimeve faktike për çdo njësi (26.1.2018) dhe gjenerimit të informacionit financiar disponibël/ pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme (31.1.2018). Nga analiza e të dhënave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion rezulton se janë kryer rregjistrime dhe pagesa përtej këtyre afateve me qëllim përdorimin e fondeve buxhetore të vitit 2017. Me një urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.17/1 dt.20.1.2018, pika 1 "Mbi afatin e mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2017 është shtyrë afati i përcaktuar në nenin 24 të Udhëzimit nr. 23 dt.22/1/2017**. Ky urdhër ka lejuar rregjistrimin e transaksioneve deri në dt.1.2.2018 kjo në kundërshtim me Ligjin për buxhetin nr.9936 dt.26.6.2008 neni 52**[11]**.** Një përmbledhje e numrit të transaksioneve dhe vlerave përkatëse të rregjistruara pas datës 31.1.2018 paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 55: Transaksionet e rregjistruara pas datës 31.1.2018

Ministria e linjës	Institucioni	Nr. rasteve	Vlera totale pagesave në lekë
Ministria e Mbrojtjes	Reparti Ushtarak Nr.1001 Tiranë	5	7,973,640
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Agjensia Kombëtare e Bregdetit	2	4,515,540
Ministria e Financave dhe Ekonomise	Aparati Drejt.Përgj.Doganave	2	2,924,100
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Bashkia Belsh	1	6,825,601
Ministria e Shendetesise	Spitali Elbasan	2	1,972,228
Avokati i Popullit	Avokati i popullit	1	29,500
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	Bashkia Cërrik	1	905,503
Ministria e Brendshme	Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan	4	58,551
Ministria e Bujq. dhe Zhvillimit Rural	Drejtoria e Bujqësisë Elbasan	1	46,800
Ministria e Drejtesisë	Drejtoria e Mbikqyrjes së Shërbimit të Provës	1	7,392
Ministria e Drejtesisë	I.E.D.P Elbasan	1	141,600
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dega e Thesarit Elbasan	1	14,000
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dogana Elbasan	1	100,000
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shk. Pr "Ali Myftiu" Elbasan	1	210,000
Ministria e Shëndetësisë	Bashkia Fushë-Arrëz	2	152,000
Ministria e Shëndetësisë	Dega e Kujdesit Parësor Elbasan	3	182,440
Ministria e Shëndetësisë	ISHSH Rajonal Elbasan	6	91,488
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Dega Rajonale e Insp.Shtetëror te Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Elbasan	6	72,376
Zyra e Admin. të Buxhetit Gjyqësor	Gjykata e rrethit Elbasan	1	214,114
Total pagesa Shkurt 2018 (GL2017)		**42**	**26,436,873**

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit justifikohen disa raste që kanë të bëjnë me Agjensinë Kombëtare të bregdetit dhe Avokatin e Popullit si cështje teknike të kryerjes së veprimeve në SIFQ pas orarit zyrtar.

[11] Ligji nr.9936 dt.26.6.2008 neni 52 "..Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit tëbuxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës. Shpenzimet e fondeve të miratuara të Buxhetit të Shtetit dhe të buxhetit vendor
realizohen deri në fund të vitit buxhetor. Shlyerja e angazhimeve, me përfundimin e afatit të parashikuar në paragrafin më lart, realizohet me fondet e miratuara për vitin buxhetor pasardhës, me përjashtim të
rasteve kur shpenzimi është kryer përpara mbarimit të vitit buxhetor. Në këtë rast, pagesa kryhet brenda datës 31 janar të vitit buxhetor pasardhës. Kjo periudhë shërben për përgatitjen e dokumentacionit bazë dhe për kryerjen e pagesës"

shqiptaria.com

Mosmarrja e masave administrative, të vlerësuara nga KLSH në të paktën 7 miliardë lekë, nga NPA për shklejet e ligjit në menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve ligjore për parandalimin e detyrimeve të prapambetura, kur jemi në situatën ku konstatohen vetëm 173 shkresa "tërheqje vëmëndje" të dërguara nga NPA kundrejt 23,701 raste të faturave të dorëzuara me vonesë.

Në rastet e këtyre shkeljeve të: afatit 5 ditor të rregjistrimit të kontratës nga data e shpalljes së fituesit si dhe të afateve të dorëzimit të faturave brenda afatit 30 ditor, Degët e Thesarit njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit e cila më pas përpilon një shkresë drejtuar institucionit përgjegjës për tërheqje vëmëndje të parregullsisë dhe shkeljes së konstatuar duke cituar dhe bazën ligjore të saj, shkresë kjo e firmosur nga Nëpunësi i Parë Autorizues. Nga informacioni, në asnjë rast nuk rezulton të jetë marrë nga NPA ndonjë masë për institucionet me raste përsëritje apo me kontrata me vlera të mëdha dhe impakt të konsiderueshëm në raportimin e buxhetit faktit dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Konsideruar faktin se këto shifër mbeten tepër të larta edhe gjatë vitit 2018, i bën këto shkresa formale dhe ngarkesë pune ineficente për sektorin që i përpilon duke neglizhuar faktin se mosrespektimi i afateve ndikon në sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për kryerjen e pagesave përkatëse, krijon detyrime për të cilat do të paguhen kamatëvonesa në zbatim të ligjit 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare". Numri i rasteve të raportuara nga DPTH për evidentimin e problemit me qëllim marrjen e masave disiplinore dhe administrative nga NPA, është tepër minimal nëse i referohemi impaktit që kanë 23701 raste të vonesave të faturave dhe 16795 raste të kontratave të rregjistruara me vonesë. Si dy tregues të matjes së performancës së njësive publike dhe përgjegjësive që rrjedhin për Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për monitorimin e indikatorëve të performancës, të miratuara me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.89 dt. 28.12.2015, KLSH konstaton se nuk raportohen informacione mbi asnjë masë të marrë kundrejt NA-ve të institucioneve që pengojnë dërgimin e faturave në thesar dhe nuk zbatojnë afatet e rregjistrimit të kontratave të angazhimeve brenda afatit ligjor. Shkresat pasi dërgohen nuk monitorohen dhe për më tepër kjo detyrë konsiderohet si kompetencë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Neni 71, gërma (f dhe gj) e Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë', i ndryshuar, parashikon gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 1 deri në 3 paga mujore (për rregjistrimin me vonesë të kontratave) dhe 3 deri 7 paga për moszbatim të afateve të dorëyimit të urdhër-shpenzim. Kështu, gjoba të përllogaritura për cdo vonesë në dorëzim të faturës në Thesar vlerësohet të ishin minimalisht rreth 7 miliard (23,701*100,000leke*3paga).

[shqiptaria.com]

5. PROKURIMI PUBLIK

Për vitin 2017, Autoritetet Kontraktore për plotësimin e nevojave për shërbime mallra e punë civile prokuruan me procedurat e prokurimit elektronik 109.6 miliardë lekë (fondi total limit)[12]. Shqipëria gjatë vitit 2017 arriti një Produkt të Brendshëm Bruto (PBB) 1,555 miliardë lekë[13]. Nga krahasimi i vlerës së prokuruar me PBB rezulton se vetëm 7% e PBB është prokuruar me procedurat e prokurimit elektronik.

Grafiku 32: Krahasimi i Fondit total të Prokuruar me PBB



Burimi: APP

Krahasuar me të dhënat e vendeve të rajonit, rezulton se fondi buxhetor i shpenzuar duke përdorur procedurat e prokurimit publik shkon mesatarisht nga 6.5-13% të PBB.

Grafiku 33: Krahasimi i Fondit total të Prokuruar me PBB për vendet e rajonit



Burimi: APP, INSTAT

Grafiku 34: Krahasimi i Fondit total të Prokuruar me Buxhetin e Shpenzimeve për vendet e rajonit



Burimi: APP

[12]Burimi APP

[13]Bazuar në të dhënat e siguruaranga INSTAT mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB)

[shqiptarja.com]

Tabela 56: Fondit i Prokuruar ne raport me PBB dhe Buxhetin e Shpenzimeve

Vëndi	Prokurime/PBB	Buxheti i shpenzime/PBB	Prokurime/ BuxhetShpenzime
Albania	7%	29%	24.3%
Bosnia and Herzegovina	7.10%	41%	17.2%
Croatia	13%	46%	28.0%
Kosovo	6.50%	27%	23.8%
FYR Macedonia	7.80%	32%	24.6%
Montenegro	6.90%	48%	14.3%
Serbia	8.40%	41%	20.3%

Nga krahasimi me vendet e rajonit konstatohet se me gjithë eksperiencën dhe punën e bërë niveli i përdorimit të prokurimit elektronik krahasuar me vendet e rajonit ngelet i ulët. Gjatë vitit 2017 me objektiv rritjen e konkurrencës u lancua përherë të parë aplikacioni "e-Procurement Albania" për ofertimin në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet smartphone. Numri total i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në procedurat e shpallura me fitues nga Autoritetet Kontraktore për vitin 2017, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është **169.364**. Gjatë vitin 2017 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar **18.337 operatorë ekonomikë** të rinj vendas, të cilët janë regjistruar në SPE, automatikisht pas regjistrimit të tyre në QKB dhe **75** operatorë ekonomikë të huaj, të cilët janë regjistruar direkt në SPE. Rritja e numri të operatorëve ekonomikë të regjistruar rishtazi në SPE, ka ndikim në rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.
Përdorimi i procedurave me **Negocim pa Shpallje Paraprake** nga Autoritetet Kontraktore. Gjatë vitit 2017, Autoritetet Kontraktore kanë vazhduar të përdorin në një shkallë të lartë procedurën me negocim pa shpallje paraprake e cila zë 31.8% të numrit total të procedurave të prokurimit, të zhvilluara gjatë vitit 2017 apo 8.3% të vlerëstotale.

Konstatohet se në 67% e rasteve të përdorimit të kësaj procedure janë për mbulimin e nevojave të fillim vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.
Përdorimi i kësaj metode për të "mbuluar nevojat" e fillimit te vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve mbart risqet: keq planifikimet e nevojave dhe shmangien e konkurrencës, me pasojë efektivitet shume të ulët të prokurimit.
Nga analiza krahasimore e përdorimit të procedurës ***"Me Negocim pa Shpallje Paraprake"*** nga Autoritetet Kontraktore gjatë tremujoreve të parë të viteve 2017 dhe 2018 tregojnë se megjithë uljen e fondit të përdorur me këtë procedurë gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 niveli i efektivitetit të prokurimit ngelet i ulët.

Grafiku 35:Procedurat e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake



Burimi: APP

AK dhe APP duhet të analizojë shkaqet e këtij fenomeni duke ngushtuar hapësirat ligjore që lejojnë keq përdorimin e kësaj procedure prokurimi. Gjatë

[shqiptarja.com]

vitit 2017 janë shpallur (publikuar) 7 317 procedura prokurimi për shërbime mallra e punë civile me strukturë:

Grafiku 36: Procedurat e prokurimit në vitin 2017



Burimi: APP

Për sa më sipër janë alokuar 109.6 miliardë lekë për plotësimin e nevojave të AK për Punë Civile, Shërbime e Mallra të ndara:

Grafiku 37: Vlera e procedurave te prokurimit në vitin 2017



Burimi: APP

Tabela 57: Procedurat e prokurimit në vitin 2017 *mln lekë*

Lloji i procedurës	Nr	**Fondi limit total**	Shërbime	**I Ndarë**	
				Mallra	Punë Civile
I Hapur Lokal	2323	86,473.00	11,449.58	25,686.76	49,337.11
Kërkesë për Propozim	4828	10,349.51	2,568.82	4,880.36	2,900.33
Shërbim Konsulence	137	1,646.29	1,646.29	-	-
I Hapur mbi Kufi	29	11,150.34	4,475.67	5,273.20	1,401.48
TOTAL	**7317**	**109,619.60**	20,140.36	35,840.32	53,638.92

79 % të vlerës së Procedurave të shpallura e zënë procedura i hapur lokal (32% në numër procedure) ndërsa lloji më i përhapur në numër 66% e zë Kërkesa për propozim (9% në vlerë). Nga 7.317 procedura të publikuara me fond limit total 109.6 miliardë lekë rezulton se 19% të procedurave apo 20 miliardë lekë janë anulluar, ecuria e procedurave paraqitet:

[shqiptarja.com]

Grafiku 38: Ecuria e procedurave te prokurimit në vitin 2017



Burimi: APP

Tabela 58: Ecuria e procedurave te prokurimit në vitin 2017 mln lekë

Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit	%
Nr. Total i Procedurave të Anulluara	2428	20,309.7	19
Nr. Total i Procedurave të vazhduara	4889	89,309.9	81
Total i Procedurave të publikuara	7317	109,619.6	

Shkalla prej 19% e anullimit të procedurave tregon se puna e Autoriteteve Kontraktore për përgatitjen e procedurave (përcaktimi i nevojave, studimi i tregut, hartimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin) është e pa mjaftueshme dhe ka nevojë për përmirësim. Mos kryerja në kohë e investimeve duhet të kosiderohet jo vetëm si mos efektivitet në përdorimin vlerave por impakti negativ i tyre ka një spektër me të gjërë dhe kërkon një analizë rast pas rasti nga AK dhe APP për nxjerjen e arsyeve të këtyre dështimeve me qëllim përmirësimin e kornizës rregullatore të zhvillimit të tyre.

Shpërndarja sipas llojit të procedurës së prokurimit (realizimi)

Tabela 59: Realizimi i procedurave te prokurimit në vitin 2017 mln lekë

Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit	Fondi i Prokuruar
I Hapur Lokal	1,734	75,418	68,593
Kërkesë për Propozim	2,897	7,376	6,713
Sherbim konsulence	87	1,375	1,323
I Hapur mbi kufi	31	9,013	8,402
TOTAL	**4,749**	**93,183**	**85,030**

Shpërndarja e prokurimeve sipas Autoriteteve Kontraktore

Në procedurat e prokurimit kanë marrë pjesë 559 Autoritete Kontraktore me fond të prokuruar total 85 miliardë lekë për mallra shërbime. Vetëm 20 Autoritete Kontraktore kanë përdorur 53 miliardë lekë apo 62% të fondit të prokuruar.

Tabela 60: Shpërndarja e prokurimeve sipas Autoriteteve Kontraktore mln lekë

Nr.	Autoriteti Kontraktor	Fondi Prokuruar pa TVSH	%
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Banka Boterore)	7,995	9.4
2	Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike	7,414	8.7
3	Bashkia Tirane	6,022	7.1
4	Ministria e Puneve te Brendshme	5,954	7
5	Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane	4,365	5.1
6	Autoriteti Rrugor Shqiptar	4,233	5
7	Operatori i Sistemit te Transmetimit OST	2,745	3.2

[Shqiptaria.com]

8	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	2,512	3
9	Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve Tirane	1,457	1.7
10	SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane	1,279	1.5
11	Bashkia Durres	1,104	1.3
12	Drejtoria Rajonale e OSHEE Durres	1,039	1.2
13	Bashkia Kamez	957	1.1
14	Ministria e Mbrojtjes	899	1.1
15	Drejtoria Rajonale e OSHEE Burrel	842	1
16	ALBCONTROL SH.A. (ish A.N.T.A)	837	1
17	Bashkia Elbasan	819	1
18	Sh.AAlbpetrol	778	0.9
19	Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise	749	0.9
20	Bashkia Vlore	736	9.4
Totali		**52,735**	**62%**

Efektiviteti i procedurave të prokurimit publik viti 2017

Tabela 61: Efektiviteti i procedurave të prokurimit publik viti 2017

Nr.Totali Proç. të fituara	4749
Fondi total limit (mln leke)	93,182.6
Fondi total i prokuruar (mln leke)	85,030
% qe ze Fond ii prokuruar ndaj Fondit limit	91,3
Fondi total i kursyer (mln leke)	8,152
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	8,7

Grafiku 39: Efektiviteti i procedurave të prokurimit publik viti 2017



Burimi: APP

Tabela 62: Efektiviteti i procedurave të prokurimit publik viti 2017 në përqindje

Efektiviteti	Nr. i rasteve	Fondi i prokuruar në mln lekë
rreth 0%	975	17,167
1-5%	1546	32,284
6-35%	7304	26,347
36-99%	257	2,368

Përmirësimi i planifikimit të procedurave të prokurimit

Planifikimi i kujdesshëm dhe në kohën e duhur i procedurave të prokurimit është një nga kushtet kryesore për rritjen e eficencës në përdorimin e fondeve publike. Shpërndarje e kryerjes së publikimit te procedurave për muajt Janar - Dhjetor 2017.

[shqiptarja.com]

Grafiku 40: Ecuria e procedurave të prokurimit publik viti 2017



Burimi: APP

Nga analizimi i procedurave të publikuara, të kryera e përfunduar me lidhje kontrate për muajt Janar - Dhjetor 2017 rezultojnë me risk të lartë 828 procedura (apo 17% te totalit) me fond të prokuruar 17 miliardë lekë (22%) të cilat janë lidhur në muajt janar, shkurt e dhjetor.

Grafiku 41: Ecuria e procedurave të prokurimit publik viti 2017



Burimi: APP

Më hollësisht:

- 393 procedura (8%) me fond të prokuruar 8,767.7 milionë lekë, te lidhura në muajt janar-shkurt rezultojnë me risk të lartë, pasi koha për përgatitjen e dokumentacionit përkatës si dhe zhvillimit të procedurave se prokurimit është e limituar.
- Paraqesin risk të ulët në lidhje me kohën e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit përkatës dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit 3921 procedura me fond të prokuruar 68,014.3 milionë lekë të cilat janë lidhur në muajt mars-nëntor.
- Paraqesin risk të lartë si rezultat i kohës së limituar për zbatimin e kontratave 435 procedura (9%), me fond të prokuruar 8,248.5 milionë lekë (10%), të cilat janë lidhur në muajin dhjetor 2017.

Procedurat e prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore

Procedurat e prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore nga 58 Autoritetet Kontraktore janë zhvilluar 506 procedura prokurimi me fond limit total 87 miliardë lekë duke arritur një efektivitet prej 9%. Nga analiza e shpërndarjes se këtyre procedurave rezulton se vetëm 10 operatorë ekonomike kane fituar 40% të fondit të prokuruar 993 milionë lekë me efektivitet 0%

[shqiptaria.com]

Grafiku 42:Procedurat e prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore



Burimi: APP

Nga analiza e efektivitetit rezulton se 484 procedura kanë rezultuar me efektivitet të ulët (0 ose rreth 0).

Grafiku 43: Efktiviteti i procedurave të prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore



Burimi: APP

Procedurat e prokurimit për barna,reagente e pajisje mjekësore 65 Operatore Ekonomike kanë fituar 494.procedura prokurimi me fond te prokuruar 2,446 milionë lekë me efektivitet 0. Nga analiza e shpërndarjes së procedurave te prokurimit te barnave e paisjeve mjekesore me efektivitet 0 rezulton se vetëm 5 Operatorë Ekonomike kanë fituar 282 procedura (nga 494 totali me efektivitet 0) duke përfituar 40% (apo 2,446 milionë lekë) të fondit të prokuruar. Në tabelën e mëposhtme paraqiten 20 operatorët kryesore ekonomike të cilët kanë fituar 339 procedura prokurimi për barna e paisje mjekesore me total 2 miliardë lekë.

Tabela 63: Operatorët ekonomikë fitues të procedurave për barna e paisje mjekesore

Nr.	Operatori fitues	Numri i procedurave te fituara	Fondi prokuruar në mln lekë
1	GTS-GAZRA TEKNIKE SHQIPTARE SH.P.K.	4	214
2	"MEGAPHARMA"	53	201
3	MEDFAU	7	195
4	SAER MEDICAL	5	193
5	M E D I C A M E N T A	6	157
6	LEKLI	16	128
7	BIOMETRIC ALBANIA	30	117
8	ALFARMAKOS	13	94
9	T R I M E D	18	85

klsh.qtarja.com

10	FLORFARMA	15	75
11	GENIUS SHPK	20	66
12	REJSI FARMA	23	66
13	MREZNE TEHNOLOGIA VERSO LLC	1	62
14	MONTAL	22	58
15	ARLI INTERNACIONAL	1	57
16	KRIJON	10	56
17	EUROMED	7	50
18	ALDOSCH - FARMA	75	45
19	AMERICAN HOSPITAL	1	41
20	EDNA - FARMA	12	40

Zhvillimi i procedurave të prokurimit mbi fondin limit

Nga analizimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit për vitin 2017 rezultojnë se në 14 raste fondi i prokuruar (609,887,131) është më i madh se fondi limit (395,611,677) në vlerën -214,275,454.

Tabela 64: Operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit për për barna e paisje mjekesore

Nr.	Objekti i prokurimit	Autoriteti Kontraktor	Fondi limit pa TVSH (në lekë)	Fondi Prokuruar pa TVSH (në lekë)	Operatori fitues
1	Sigurimi i jetës dhe i shëndetit	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,173	1,058,200	SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
2	Sigurimi i pronës	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,373	1,191,078	SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
3	Sherbimi i ruajtjes me roje private te ambienteve te Teatrit Kombetar	Teatri Kombetar	2,418,117	134,607,480	N. S.S (NDREU SECURITY Shërbime)
4	MIREMBAJTJE RUTINE AUTOMJETESH	Reparti I Policise RENEA Tirane	2,403,010	16,553,538	SERVIS - AUTO 2000
5	RIKONSTRUKSION I RRUGES SE FSHATIT NIHNAT	Bashkia Konispol	1,377,145	1,651,176	MANE/S
6	Zhvillimi i rrjetit shperndares 20 kv TM/TU ne Agjensine Elbasan LOTI 3	Drejtoria Rajonale e OSHEE Elbasan	148,360,337	177,516,191	ERGI
7	Rikonstruksioni i Rrjetit te Furnizimit me Uje te Qytetit Konispol	Bashkia Konispol	158,339,371	186,901,165	AGI KONS
8	Rikonstruksion rruge fshati Xarre	Bashkia Konispol	1,198,263	1,409,880	ARTI
9	SISTEMIMI DHE RRETHIMI I SIPERFAQES SHTESE TE VARREZAVE NE FSHATIN SHALES	Bashkia Konispol	1,691,132	1,969,584	ILIRIA/D
10	RIKONSTUKSIONI I RRUGES SE FSHATIT MURSI	Bashkia Konispol	2,402,116	2,764,776	KALIVIOTI
11	RIKONSTRUKSION "RRUGE E RE ''LAGJIA E SHKOLLES KONISPOL	Bashkia Konispol	3,584,395	4,100,640	ILIRIA/D
12	Sherbimi i ruajtjes me roje civile ne DDD	Dega e Doganes Durres	2,501,393	2,790,042	NAZERI - 2000
13	Ruajtja fizike e pasurive te sekuestruara / konfiskuara me shërbim 24 ore/7 dite	Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara	28,413,659	31,090,203	GLOBAL SECURITY SH.P.K
14	Rikonstruksion i shkolles, kopeshtit, ndertim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit ne shkollen Mehmet Bajraktari, NJA Shales, Bashkia Cerrik	Bashkia Cerrik	42,920,193	46,283,178	BELADI

Nga ky verifikim rezulton se sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e nevojshëm për mos lejimin e hedhjes të të dhënave gabim, apo të rasteve ku është lidhur kontratë pa pasur fondin limit të nevojshëm.

Nga krahasimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga APP me të dhënat me burim sistemin SIFQ për autoritetet kontraktore si Bashkia Tiranë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Shëndetësisë (QSUT), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, evidentohen këto fenomene:

[Shqiptaria.com]

1. Data e regjistrimit të Urdhër Prokurimit në SIFQ është me e hershme se data e publikimit të Prokurimit në APP.
2. Data e nënshkrimit të kontratës sipas SIFQ është me e hershme se data e nënshkrimit të kontratës në APP.
3. Vlera e kontratës sipas SIFQ është më e vogël se vlera e kontratës sipas APP.
4. Vlera e kontratës sipas APP është më e vogël se buxheti në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Marrëveshjet Kuadër

Gjatë vitit 2017, autoritetet kontraktore kanë vazhduar të përdorin Marrëveshjen Kuadër, të fokusuar kryesisht në shërbimin e blerjes së biletave të udhëtimeve, konsulence, shërbime shëndetësore, apo riparime automjete e pajisje. Në muajin Dhjetor 2017 autoritetet kontraktore filluan me përdorimin e Marrëveshjeve Kuadër, të fokusuar në shërbimin e Ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private gjithashtu gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 është përdorur në 453 raste nga AK përdorimi i Marrëveshje Kuadër edhe për rastet e Minikontratave me vlerë totale të kontratës prej 205,571,021 lekë. Me konkretisht përdorimi i kësaj procedure për vitin 2017 paraqitet:

Tabela 65: Marrëveshje Kuadër të shpallura dhe të nënshkruara Janar-Dhjetor 2017

	Publikuar		Lidhur kontratë			
	Numër	Fondi total Limit i prokuruar (vlera në mln lekë)	Numër	Fondi total limit i prokuruar (vlera në mln lekë)	Vlera totale e fituar (vlera në mln lekë)	Efektiviteti%
I Hapur Lokal	21	492.7	13	373.6	352.7	6
Kërkesë për Propozim	38	154.8	21	88.2	88.2	0
Shërbim Konsulence	2	132.8	3	132.8	113.6	14
Totali	61	780.3	36	594.6	554.5	7

Krahas punës se kryer nga AK dhe APP për të stimuluar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, si një instrument i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të vazhdueshme të autoriteteve kontraktore nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese, shikohet se shkalla e përfundimit të procedurave është rreth 44% (në nr. dhe vlerë) me një efektiviteti në nivele relativisht të ulët (7%).Për sa konstatohet kërkohet që përzgjedhja e nevojës për zbatimin e marrëveshjeve kuadër të shikohet rast pas rasti me objektiv krahas sigurimin në kohë të shërbimeve mallrave edhe rritjen e transparencës konkurrencës e efektivitetit të kësaj procedure. Nga ana e APP kërkohet që pas një analize të hollësishme të situatës si dhe përdorimit të eksperiencave me të mira të vendit e të huaja kryejë shikimin e kuadrit rregullator e Marrëveshjes Kuadër.

Risk në zhvillimet e vitit 2017-2018 për përqendrimin e prokurimeve publike

Gjate vitit 2017 me VKM nr. 673 datë 22.11.2017 u ngarkua AKSHI që përcaktojë specifikimet e pajisjeve për projektet e teknologjisë se informacionit për institucionet e administratës se lartë publike dhe për institucionet e varësisë si dhe do të zhvillojë procedurat e prokurimit për to. Në fillim të vitit 2018 me VKM nr. 81. datë 14.02.2018 krijohet Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) e cila ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të

ISHMTARIA.COM

vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës. ABP i ngarkohet detyra e unifikimit të specifikimeve, kryerjes së procedurave të prokurimit dhe monitorimin e zbatimit të kontratave.

Mbi matjen e performancës në procedurat e prokurimit punime civile zëri "Rrugë-Ura"

Nga auditimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit elektronik që kanë çuar në lidhje kontrate rezulton se për punime civile, zëri "Rrugë-Ura" janë prokuruar 386 procedura me fond limit pa TVSH **24,9 miliardëlekë** dhe fond të prokuruar pa TVSH **20,9 miliardë lekë** duke siguruar një efektivitet 16% (në këtë analizë janë përjashtuar 4 rastet efektivitetit negativ të mëposhtme).

Grafiku 44: Efektiviteti i procedurave të prokurimit për punime civile, zëri "Rrugë-Ura"



Burimi: APP

Tabela 66: Efektiviteti i procedurave të prokurimit për punime civile, zëri "Rrugë-Ura"

Efektiviteti	Nr. irasteve	Fondi i prokuruar në mln lekë
rreth 0%	35	20,914.8
1-5%	141	5,900.7
6-20%	94	5,965.3
21- 49%	112	6,393.7

Nga auditimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit elektronik që kanë çuar në lidhje kontrate rezulton se për punime civile zëri "rrugë"me efektivitet negativ janë prokuruar 4 procedura me fond limit pa TVSH 8,561,919 lekë dhe fond të prokuruar pa TVSH 9,926,472 lekë.

Tabela 67: Rastet me efektivitet negativ të procedurave të prokurimit për punime civile, zëri "Rrugë"

Nr.	Objektiiprokurimit	AutoritetiKontraktor	Tipi ikontratës	LlojiiProcedurës	Fondi limit pa TVSH	FondiProkuruar pa TVSH	Operatori fitues	Efektiviteti
1	RIKONSTRUKSION I RRUGES SE FSHATIT NIHNAT	Bashkia Konispol	Punë Civile	Kërkesë për Propozim	1,377,145	1,651,176	MANE/S	-20
2	RikonstruksionrrugefshatiXarre	Bashkia Konispol	Punë Civile	Kërkesë për Propozim	1,198,263	1,409,880	ARTI	-18
3	RIKONSTUKSIONI I RRUGES SE FSHATIT MURSI	Bashkia Konispol	Punë Civile	Kërkesë për Propozim	2,402,116	2,764,776	KALIVIOTI	-15
4	RIKONSTRUKSION "RRUGE E RE ''LAGJIA E SHKOLLES KONISPOL	Bashkia Konispol	Punë Civile	Kërkesë për Propozim	3,584,395	4,100,640	ILIRIA/ D	-14
	Totali				8,561,919	9,926,472		

Procedura e përdorur :

- "i hapur lokal" 97% në vlerë dhe 62% në numër procedurash
- "kërkesë për propozim" 3% në vlerë dhe 38% në numër procedurash

Ishqiptarja.com

Grafiku 45: Shpërndarja e fondit të prokuruar për punime civile zëri "Rrugë-Ura" për vitin 2017 sipas OE

Burimi: APP

Nga analiza e shpërndarjes së këtyre procedurave rezulton se vetëm 5 operatorë ekonomike kanë fituar 20 % të fondit të prokuruar 4,3 miliardë lekë me efektivitet 16 %.

Gjetjet në procedurat e prokurimit nga Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Në auditimet e ushtruara është audituar zbatimi i ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike më burim të brendshëm financimi me fondet buxhetore të vitit 2017. Nga procedurat e prokurimit të audituara, rreth 80% të vlerës së tyre e zënë tenderët "*Procedurë e hapur*", 10% tenderët me procedurë "*kërkesë për propozim*", 10% tenderët me procedurë "*me negocim me dhe pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*". Për vitin ushtrimor 2017 janë zhvilluar 111 procedura prokurimi, me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 109,908,915 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar, janë audituar 57 procedura prokurimi me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 109,778,008 mijë lekë ose 99% e vlerës. Nga auditimi u konstatuan me shkelje 38 procedura në vlerën 97,961,726 mijë lekë ose 89% e fondeve të audituar dhe rezultuan gjithsej 34 shkelje të procedurave të prokurimit nga të cilat 18 shkelje janë konstatuar në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit, 8 shkelje në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe 8 shkelje në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve, arkivimit të dosjeve.

- Për vitin ushtrimor 2017 janë zhvilluar 11 procedura prokurimi "*Procedurë e hapur*", me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 88,164,436 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar me këtë procedurë, janë audituar 6 procedura me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 88,101,246 mijë lekë ose 99% e vlerës. Nga auditimi u konstatuan me shkelje 5 procedurave në vlerën 88,100,625 mijë lekë ose 99% e fondeve të audituar dhe rezultuan gjithsej 5 shkelje të procedurave të prokurimit nga të cilat 3 shkelje janë konstatuar në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit dhe 2 shkelje në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve, arkivimit të dosjeve.
- Për vitin ushtrimor 2017 janë zhvilluar 14 procedura prokurimi "*Me negocim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*", me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 179,874 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar me këtë procedurë, janë audituar 14 procedura me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 182,851 mijë lekë ose 100% e vlerës. Nga auditimiu

konstatuan me shkelje 2 procedurave në vlerën 806 mijë lekë ose 1% e fondeve të audituara dhe rezultuan gjithsej 10 shkelje të procedurave të prokurimit nga të cilat 4 shkelje janë konstatuar në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit 5 shkelje në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe 1 shkelje në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve, arkivimit të dosjeve.

- Për vitin ushtrimor 2017 janë zhvilluar 14 procedura prokurimi "*Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*", me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 10,675,127 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar me këtë procedurë, janë audituar 5 procedura me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 10,650,808 mijë lekë ose 99% e vlerës. Nga auditimi u konstatuan me shkelje 3 procedurave në vlerën 8,768,187 mijë lekë ose 82% e fondeve të audituara dhe rezultuan gjithsej 11 shkelje të procedurave të prokurimit nga të cilat 8 shkelje janë konstatuar në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit dhe 3 shkelje në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve, arkivimit të dosjeve.

- Për vitin ushtrimor 2017 janë zhvilluar 17 procedura prokurimi "*Kërkesë për propozim*", me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 10,875,944 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar me këtë procedurë, janë audituar7 procedura me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 10,830.9 milionë lekë ose 99% e vlerës. Nga auditimi u konstatuan me shkelje 6 procedura në vlerën 1,084,921 mijë lekë, 10% e fondeve të audituara dhe rezultuan gjithsej 8 shkelje të procedurave të prokurimit nga të cilat 3 shkelje janë konstatuar në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit 3 shkelje në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe 2 shkelje në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve, arkivimit të dosjeve. Në menyrë të detajuar sipas institucioneve:

Ministria e Brendshme

Nga auditimi, u konstatuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat konsistojnë:

- Ministria e Brendshme, për shërbimin e kryer në zbatim të kontratës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile ka paguar subjektin "Xion IT Systems AG'' Austri, direkt në llogarinë e tij në Austri në vlerën rreth 258,244 mijë lekë, pa TVSH dhe njëkohësisht ka paguar për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerën e TVSH rreth 51,648 mijë lekë, veprim i cili ka sjell shmangien e tatimit në burim nga ky subjekt dhe mos derdhjen e tij në buxhetin e shtetit, në vlerën rreth 38,244 mijë lekë.

- Nga buxheti i vitit 2016 të MB, janë shpenzuar në rreth 41,862 mijë lekë, për pagimin e shoqërisë "VIVA Helikopter" ("Aquila & Victory Invest"). Kjo vlerë është kontraktuar pa procedura prokurimi për kryerjen e shërbimit ajror të fikjes së zjarreve që kanë rënë në territorin e vendit në muajin gusht-shtator të këtij viti. Gjatë kryerjes së shërbimit, u konstatua shkelje ligjore, me pasojë rritje të kostos së shërbimit në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 48,739 Euro ose rreth 7,976 mijë lekë. Po kështu edhe në buxhetin e vitit 2017, janë shpenzuar 27,318 mijë lekë, përsëri për pagimin e shoqërisë "VIVA Helikopter" ("Aquila & Victory Invest") e kontraktuar edhe këtë herë pa procedura prokurimi, për shërbimin ajror të fikjes së zjarreve që kanë rënë në muajit korrik-gusht të këtij viti. Për realizimin e këtij shërbimi në vitin 2017, janë marrë angazhime financiare në vlerën rreth 101,108 mijë lekë për të cilat nuk janë fonde disponibel të planifikuara në buxhetin Ministrisë apo të premtuara nga Këshilli i Ministrave për tu financuar nga buxheti i shtetit, si dhe gjatë

[shqiptaria.com]

kryerjes së shërbimit, u konstatua shkelje ligjore, me pasojë rritje të kostos së këtij shërbimi në vlerën rreth 45,000 mijë lekë.
- Gjatë zbatimit të punimeve për "Restaurim i Godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme", u konstatuan punë të pakryera dhe të paguara, duke i shkaktuar buxhetit të shteti dëm ekonomik në vlerën rreth 1,122 mijë lekë, si dhe përdormi pa efektivitet dhe pa ekonimicitet të fondeve buxhetore në vlerën rreth 20,495 mijë lekë.

Avokatura e Shtetit

Nga auditimi mbi përzgjedhjen e studiove ligjore të huaja për mbrojtjen e Shtetit shqiptar nga padite e dy kompanive të huaja në arbitrazhet ndërkombëtare, e konkretisht kompanitë AAGL dhe EFT, të cilat kanë paditur respektivisht Ministrinë e Financave dhe OSHEE, KLSH konstaton se çështjet nuk kanë karakter të veçantë teknik që të mbrohen nëpërmjet përzgjedhjes dhe kontraktimeve me studio të huaja ligjore. Përzgjedhja e këtyre studiove në kundërshtim me ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 dhe VKM nr. 392, datë 08.04.2009, "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale" ka sjellë si pasojë rritje artificiale të shpenzimeve buxhetore në shumën prej 3,740,000 euro.
- Nga auditimi për respektimin e dispozitave ligjore për lidhjen e dy kontratave me studiot ligjore private të huaja në vlerën prej 2,340,000 euro, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV "Tatimi i mbajtur ne burimin e te ardhurave, neni 33 "Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat" pika 1, nuk ka parashikuar kryerjen e ndalesës së tatimit në burim në masën 15 % mbi të ardhurat e realizuara në shumën 351,000 Euro, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga studiot ligjore dhe evazion fiskal për të ardhurat buxhetore.
- Nga verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimit të mëparshëm me shkresë të KLSH-së, nr.264/8, datë 12.10.2015, në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria "Vetro Energy PTE Ltd" në procedurat e zhvilluara për privatizimin e shoqërisë "Albpetrol" sha, Patos", rezultoi që nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për realizimin e rekomandimit të lënë nga KLSH.

Midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-MZHETTS, sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur disa korrespondenca në lidhje me këtë problematikë, me shkresat nr. 8276/2, datë 30.10.2015; nr. 8291/2, datë 20.11.2015; nr. 2564/1, datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, me të cilat është kërkuar marrje informacioni për dosjen e privatizimit të Albpetrol sh.a, dhe jo mbi ecurinë për të përshpejtuar nga ana ligjore mundësimin e arkëtimit të garancisë së kontratës, në vlerën 85 milion Euro nga Vetro Energy PTE Ltd", duke vazhduar dhe riskuar të humbasin kohë, që të kalojnë të gjitha afatet procedurale, dhe për pasojë çështja të bëhet e pakërkueshme, rrjedhojë kjo e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar.
- Nga auditimi mbi vlerësimin e realizimit të aktivitetit për vitin 2016 të Zyrës së Përfaqësimit të Avokaturës së Shtetit pranë gjykatave shqiptare në nivel kombëtar, u evidentuan raste juridike që kanë sjellë çështje gjyqësore të humbura, në disfavor të Shtetit Shqiptar, të shkaktuara si pasojë e mangësive dhe dobësive të vendimeve dhe akteve juridike-administrative të

institucioneve të administratës publike. Avokatura e Shtetit, ndonëse i ka përfaqësuar çështjet juridike, që në fillim i ka konsideruar dhe vlerësuar si çështje juridike të humbura, për shkak të mangësive dhe dobësive të akteve juridike-administrative të institucioneve të administratës publike, të përgatitura nga punonjës të pakualifikuar dhe të papërgjegjëshëm. Këto veprime të administratës shqiptare kanë sjellë rëndimin e mëtejshëm të shpenzimeve buxhetore, në vlerën prej 69,443,100 lekë e barazvlefshme me 15%, të vlerës totale prej 462,954,000 lekë ndaj dëmit të shkaktuar në Buxhetin e Shtetit nga çështjet e humbura.

Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes realizon procedura prokurime civile prokurime ushtarake dhe procedura prokurimi të klasifikuara sekret klasifikuar". Procedurat e prokurimi civile për mallra shërbime dhe punë janë zhvilluar nëpërmjet sistemit elektronik, në zbatim të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", procedurat prokurimi për qëllime ushtarake për mallra shërbime dhe pune, janë zhvilluar me procedurë me negocim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 521 datë 08.08.2007 "Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit Publik", dhe procedurat e prokurimit "sekret shtetëror" për mallra shërbime dhe pune janë zhvilluar me negocim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror" dhe VKM nr. 701, datë 22.10.2014 "Për miratimin e rregullave "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale". Nga auditimi, u konstatua se, në procedurat që zhvillohen në zbatim të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, efekti i garës nga konkurrenca është dukshëm pozitiv dhe kjo tregohet mbi të gjitha në kursimin e fondeve që shkon nga 19 % deri në 40% në vit. Ndërsa për procedurat që nuk zbatohen ky ligj, pra procedurat nuk janë zhvilluar në sistemin elektronik të APP, por me "Zarfa në dorë" efekti i garës nga konkurrenca, është dukshëm negative, çka tregohet mbi të gjitha në fitimin e tenderëve me vlerë të plotë dhe kursimi i fondeve në këto raste është pothuaj se 0 (zero). Risku në procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuarat sekret, në krahasim me procedurat prokurimit sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 është shumë i lartë sepse në këto procedura negociohet direkt me operatorin të parazgjedhur fitues. Duhet theksuar se, të gjitha procedurat e prokurimit si ato civile, ushtarake apo sekrete janë realizuar nga të njëjtët Komisione të Hartimit të DT dhe të njëjtët Komisione Vlerësimi të Ofertave. Për të nxjerrë në dukje efektet negative që kanë ardhur në buxhetin e shtetit si pasoje e punës me dy standarde të Autoritetit Kontraktor, morëm në analizë, disa zëra konkrete të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe i krahasuam me të njëjtat zëra të disa mallrave shërbimeve dhe punëve të realizuara nëpërmjet procedurave ushtarake dhe sekrete. Nga ky krahasim dhe llogaritje rezultoi se, kostot e mallrave, shërbimeve dhe punëve të realizuara me procedurat e prokurimeve ushtarake dhe të klasifikuarat sekret "I Kufizuar" janë minimalisht, rreth 10-20% ose në vlerë mbi 720 milion lekë më të larta, për shkak se, këto mallrave, shërbimeve dhe punë nuk janë prokuruar nëpërmjet sistemit elektronik të APP. (ndërsa në vitin 2015, janë rreth 120 milion lekë dhe në vitin 2016, janë rreth 240 milion lekë). Nisur nga këto probleme, KLSH, ka kërkuar në mënyrë imediate marrja e një sërë masave për përmirësime ligjore sepse është pikërisht baza ligjore që lejon realizimin e procedurave pa konkurrencë, vakumi

[shqiptaria.com]

i të cilave është shfrytëzuar mjaftë mirë nga AK, duke sjell kështu, efekte negative të konsiderueshme në dëm të buxhetit të shtetit.

Këto rekomandime konsistojnë:
Në hartimin e një projekt-ligji të veçantë për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë duke u bazuar në Direktivën e BE-së për Prokurimin në fushën e Mbrojtjes dhe në ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik". Ky projekt-ligj duhet të synoj:

- Procedura fleksibël prokurimi, rregullat e kualifikimit, përzgjedhjes, shpalljes së fituesit dhe kushtet e realizmit të kontratës të përshtatura me nevojave kombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë.
- Një kuadër i qartë dhe transparent të prokurimit për të nxitur konkurrencën dhe vlerën për para;
- Pajtueshmëria me ligjin e prokurimit publik të BE-së dhe me praktikat më të mira të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;
- Çmime më të ulëta dhe cilësi më të mirë të mallrave, shërbimeve dhe punëve të prokuruara, dhe standardizimin e vlerave të kontratave, duke pasur prioritet vlerat e kontratave të mëparshme të realizuara nga MM apo institucione të tjera, në zbatim të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".
- Shqyrtim të pavarur të ankesave të operatorëve ekonomik, dhe të paktën të drejtën e ankimit dhe shqyrtimit të tyre nga komisioni i prokurimit publik apo në një shkallë të dytë e gjyqësorit.

Ministria e Kulturës

Në fushën e prokurimeve publike për mallra shërbime dhe punë për shkak të shkeljeve të rregullave të prokurimit publik janë përdorur pa efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën 80,427,729 lekë. Ministria e Kulturës në përgjigje të një "Propozim të pa kërkuar" të bërë nga subjekti "HAKO" për marrjen me qira të një objekti, magazinë (e cila nuk është monument kulture), pranë Qytetit Antik të Butrintit me qëllim vënien e saj në shfrytëzim për aktivitet tregtar, ka shqyrtuar dhe miratuar projekt/zbatimin "Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunksionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit". Vendndodhja e këtij objekti është në nënzonën "A" të Parkun Kombëtar të Butrintit, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Baza ligjore ku është mbështetur dhënia me qira e këtij objekti është Udhëzimi i Ministrit të Kulturës nr. 5110, datë 13.10.2015 "Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi". U konstatua se, ky udhëzim nuk ka fuqi juridike sepse, nxjerrja e tij nga Ministria e Kulturës është bërë pa pasur autorizim nga Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", me qëllim rregullimin dhe plotësimin e procedurës së dhënies me qira/enfiteozë si dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës.

[shënim]

6. RAPORTIMI I BORXHIT PUBLIK

6.1 Kufijtë e borxhit publik për vitin 2017

KLSH konstaton se nuk janë respektuar kufijtë e huamarrjes vjetore të vendosura me ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, duke marrë më shumë hua se autorizimi për të marrë hua, me një mbi realizim në rreth 9,173 milionë lekë, si pasojë e disbursimeve më të mëdha të projekteve me financim të huaj se plani i tyre i ndryshuar.

Nga auditimi mbi respektimin e kufizimeve për borxhin shtetëror dhe garancinë shtetërore të huasë konstatohet se nuk janë respektuar kufijtë e vendosura në lidhje me të drejtën për të marrë borxh të ri, duke tejkaluar këto kufij. Në nenin 9 "Kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huasë", të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, *"Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar është përcaktuar që *"Kufizimet për shumën e borxhit shtetëror dhe për shumën e garancive shtetërore të huave përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit. Kufizimet e parashikuara të borxhit i referohen në radhë të parë, shumës së borxhit dhe shumës së garancive të marra rishtazi dhe, në radhë të dytë, shumës së përgjithshme të borxhit shtetëror dhe të garancive të papaguara në fund të vitit…*" Të njejtat kërkesa për disiplinimin e rritjes së borxhit janë referuar edhe nenin 58 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në të cilin citohet se *"Në ligjin e buxhetit vjetor vendoset kufiri për:a) borxhin e ri të qeverisjes qendrore, për t'u marrë në vitin buxhetor; b) totalin e borxhit të qeverisjes qendrore; c) garancitë e reja për t'u lëshuar gjatë vitit buxhetor, nga Qeveria qendrore; ç) totalin e shumës së garancive të qeverisjes qendrore. d) borxhin e emetuar për të mbuluar humbjet e bankës qendrore nga rivlerësimi i valutave.*

Në ligjin nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" të ndryshuar, janë përcaktuar kufijtë e huamarrjes vjetore si në vijim:

Tabela 68: Kufinjtë e huamarrjes sipas akteve ligjore për 2017 *mln lekë*

Treguesit e borxhit	Ligji nr. 130/2016	Akti Normativ nr. 2	Akti Normativ nr. 3
Kufiri për rritjen totale	31,699	31,699	45,623
Hua marrje vjetore dhe mbështetje ndërkombëtare	41,229	41,929	42,849
Hua neto për financimin e projekteve	(10,030)	(10,730)	(11,650)
Rritja e garancive të shtetit	500	500	2,774
Vlerësimi i stokut të përgjithshëm	1,103,025	1,103,025	1,112,189

Nga auditimi i realizuar, konstatohet se huammarrja e jashtme për projekte për financimin e deficitit nuk ka respektuar kufijtë e planit të vendosura me Aktin Normativ Nr.3 për huanë e marrë për projekte specifike. Rritja vjetore e borxhit është në tejkalim të autorizimit nga Parlamenti për të marrë hua përgjatë vitit 2017, megjithë efektin favorizues në ulje të stokut të borxhit. **Në këtë mënyrë, huamarrja afatgjatë e marrë për projekte paraqitet në tejkalin të kufijve të vendosur për rritjen vjetore, sipas së cilës janë planifikuar 17,570 milionë lekë, ndërkohë që realizimi paraqitet në shumën 23,407 milionë lekë sipas raportimeve të thesarit dhe 27,200 milionë lekë sipas raportimeve të borxhit.**

[shqiptarja.com]

Referuar planit të kufijve të huammarrjes dhe ndryshimeve me Aktin Normativ nr. 3 konstatohet se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit vjetor të buxhetit edhe sipas kufijve total të huamarrjes ku në mënyrë të përmbledhur paraqiten:

Tabela 69: Realizimi i huamarrjes dhe devijimet nga aktet ligjore *mln lekë*

Lloji financimit	Plani fillestar	Ndryshim i A.N 2	Ndryshimi A.N 3	Realizimi	Tejkalimi/mosrealizimi
Hua-marrje e brendshme	20,229	20,579	20,579	16,285	-4,294
Hua afatgjate (e marre) per projekte	18,970	17,570	17,570	27,200	9,630
Ripagesat	-29,000	-28,300	-28,300	-25,769	2,531
Mbeshtetje buxhetore	21,000	21,000	33,000	31,306	-1,694
TOTALI	**31,199**	**30,849**	**42,849**	**49,022**	**6,173**

Masa e tejkalimit të kufijve të huamarrjes shtetërore sipas pikës a) të nenit 58 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është shkaktuar nga tejkalimi i **huasë së marrë për financimin e projekteve, që përbën disbursimin bruto për projektet me financim të huaj në shumën 9,630 milionë lekë.** Të gjithë zërat e tjerë mbi të cilët janë vendosur kufijtë për rritjen vjetore nëpërmjet financimit të deficitit, financimi i brendshëm, ripagesat për projekte me financim të huaj dhe mbështetja buxhetore, rezultojnë se janë respektuar duke u paraqitur me nën realizim dhe që kanë ndikuar edhe në uljen e efektit total të tejkalimit të kufijve të huamarrjes totale vjetore në shumën 6,173 milionë lekë. Gjatë vitit 2017, efekti në total në tejkalim të huasë së autorizuar për të marrë dhe asaj të marrë faktikisht është në shumën 6,173 milionë lekë sipas tabelës së mësipërme me financimin nga zërat të cilat kanë impakt në deficit. Mosrealizimi i huamarrjes së brendshme, mbështetjes buxhetore dhe nivelit të planifikuar të ripagesave ka kompensuar në ulje efektin e tejkalimit të planit për financimin e huaj në shumën 9,630 milionë lekë.

Nga auditimi konstatohet se sipas raportimeve në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2017 rezulton se realizimi i treguesve të huamarrjes së huaj për vitin 2017 në terma bruto për kredinë për financim projektesh rreth 27,200 milionë lekë, ndërkohë që sipas raportimit faktik në treguesit fiskal të konsoliduar paraqitet në shumën 23,407 milionë lekë. Mos paraqitja e vlerës reale të huasë së marrë për projekte të huaja për vitin 2017 në treguesit fiskalë të konsoliduar, ka nënvlerësuar financimin e deficitit me rreth 3.793 milionë lekë dhe në të njejtën kohë deficiti i raportuar është nënvlerësuar me 3.793 milionë lekë. Kemi konstatuar se të dhënat e paraqitura në treguesit fiskalë janë të pasakta, kur i referohemi raportimeve nga strukturat e thesarit. Ky efekt nuk është paraqitur në raportin e SIFQ për vitin 2017, duke qenë se të dhënat e raportuara nga projektet për këtë diferencë. Një gjë e tillë është konfirmuar edhe në akt-rakordimin ndërmjet strukturave të boxhit dhe të thesarit.

Disbursimet e konstatuara nga KLSH për vitin 2017, nuk janë raportuar në periudhën e duhur, duke u raportuar për llogari të vitit ushtrimor 2018, megjithëse konfirmimet përkatëse nga kreditorët dhe disbursimi përkatës është kryer në vitin 2017. Ky raportim është mbështetur në Urdhrin nr.17 datë 18.01.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në të cilën citohet që "Të dhënat e raportimit të financimit të huaj të paraqitura pas afatit të miratuar të përfshihen në raportimin e të dhënave të treguesve fiskalë për vitin 2018". Në udhëzimin nr. 23 datë 22.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017" është përcaktuar një rakordim edhe ndërmjet strukturave të thesarit dhe borxhit për të evidentuar ato projekte të cilat nuk

kanë raportuar në thesar. Referuar rakordimit ndërmjet strukturës së borxhit dhe strukturës së thesarit në lidhje me projektet me financim të huaj, diferencat e mësipërme janë të paraqitura për projektet në vijim në monedhën origjinale.

Tabela 70 : Rakordimet sipas projekteve midis strukturave të thesarit dhe borxhit

ID	Pershkrimi	Thesari	Monedha	Borxhi
08/04	Projekti I kanalizimeve te Tiranes se madhe	1,682,934,147.00	JPY	1,719,083,058.00
11/02	Segmenti Tirane-Elbasan	45,555,038.13	USD	49,154,808.02
11/09	Segmenti Tirane-Elbasan		USD	36,766.00
13/03	Ndertimi I Segmentit Rrugor Qukes-Qafe Plloce,	20,438,652.43	USD	28,289,051.45
14/02	Ndertimi I Segmentit Rrugor Qukes-Qafe Plloce,	11,405,474.99	USD	11,405,474.99
12/06	Modernizimi I Asistences Sociale	370,451.36	EURO	5,720,451.36
06/23	Porti i Durresit (BEI)	905,317.15	EURO	115,579.22
13/06	Tirana Northern Blv & River Generation	12,358,028.53	EURO	12,358,028.53
14/07	Projekti I Mikrofinances ne Shqiperi,kredi		USD	2,000,000.00
14/07.1	Projekti I Mikrofinances ne Shqiperi,kredi	2,500,000.00	USD	500,000.00
15/10/IBRD	Sherbimet me ne qender qytetarin		EURO	4,950,000.00
15/10/IBRD	Sherbimet me ne qender qytetarin	885,652.77		885,652.77
16/03	Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi	1,500,000.00	EURO	1,659,500.00
17/01	Zhvillimi i politikave te konkurrueshmerise		EURO	65,800,000.00
17/06	Zhvillimi i politikave financiare		USD	100,000,000.00
08/09	Siguria e Digave, IDA	1,632,077.80	EURO	1,632,077.80
12/01	Dam Safety Project	4,941,447.73	EURO	6,037,434.61
14/13	Projekti per Rimekembjen e Energjise, Komponenti 4	150,000.00	EURO	36,905,575.23
14/13	Projekti per Rimekembjen e Energjise, Komponenti 3 OST	948,200.00	EURO	
14/13	Projekti per Rimekembjen e Energjise, Komponenti 2 OSHEE	12,539,139.21	EURO	
14/13	Projekti per Rimekembjen e Energjise, Komponenti 1 KESH	10,180,958.16	EURO	

Duke qenë se në akt-rakordimin përkatës është marrë dijeni për ekzistencën e shumave të disbursuara dhe të paraportuara nga projektet përkatës, pasqyrimi i treguesve të pasaktë në tabelën e treguesve fiskalë nuk justifikohet me klasifikimin në periudhën jo të duhur kontabël. Në udhëzimin e Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 22.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017", pika 23 përcakton që "Procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgiegjëse të thesarit, borxhit dhe njësive të qeverisjes së përgjithshme duhet të perfundoje brenda datës 15.02.2018." Në këtë mënyrë, të gjitha raportimet e projektve me financim të huaj për këtë direferencë nuk janë raportuar në përputhje procedurat e implementuara për kryerjen e veprimeve rregulluese dhe konsoliduese përpara hartimit të pasyrës së treguesve fiskalë të konsoliduar. Në raportimin në lidhje me Borxhin Faktik të vitit 2017, për të dhënat e paraqitura nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, nuk referohet e njejta shume e evidentuar edhe më sipër. Në nenin 61 të ligjit nr.9936 datë 26.06.1993 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përcaktohet që shpenzimet njihen në momentin e konstatimit të tyre. Në këtë mënyrë, shpenzimi në lidhje me projektet me financim të huaj ka ndodhur në vitin 2017 në formën e shpenzimit kapital. Për të njejtin tregues, disbursimet e vitit 2017 për huanë e marrë për projekte me financim të huaj, Ministria e Financave ka dy raportime të ndryshme. Për qëllime të realizimit të deficitit huaja e marrë për projekte është raportuar në shumën 23,407 milionë

[Shqiptarja.com]

lekë dhe për qëllime të raportimit të borxhit huaja e marrë për projekte është raportuar në shumën 27,200 milionë lekë. Efekti i vlerësuar i këtyre mos raportimeve të të dhënave të plota për aktivitetin 12 mujor të Buxhetit të Shtetit vlerësohet jo vetëm në tejkalim të shpenzimeve kapitale dhe huadhënies neto (kryesisht për projektet me financim sektorin energjitik), por edhe në drejtim të deficitit të deklaruar, duke e nënvlerësuar atë.

6.2 Vlerësimi i riskut

KLSH konstaton se ndryshimet e shpeshta të strukturës dhe reduktimi i organikës së kësaj Drejtorisë së Menaxhimit të Borxhit nuk kontribuon në mirëmenaxhimin e borxhit publik. Përfshirja nën Drejtorinë e Buxhetit dhe bashkimi me këtë drejtori nuk ka kontribuar në mirëorganizimin e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave sipas nevojës për reduktimin e risqeve që shoqëron këto aktivitete. Drejtoria e Menaxhimit të Borxhit, për periudhën e parë të vitit 2017, ka funksionuar në bazë të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 41 datë 17/03/2016 deri në Shkurt 2017. Në vijim, drejtoria ka funksionuar si Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik, me Urdhërin e Kryeministrit Nr.8, datë 31.01.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave. Me procesin e riorganizimit të ministrive është hartuar struktura e re me Urdhërin e Kryeministrit Nr.161, datë 05.10.2017 *"Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë".* Për periudhën e funksionimit me strukturën e miratuar me Urdhërin Nr.8, datë 31.01.2017, Drejtoria e Përgjithshe e Borxhit Publik është e organizuar nën Drejtorinë e Huamarrjes në të cilën janë planifikuar 9 pozicione pune nga të cilat rezultojnë të plotësuara 7 përgjatë periudhës së funksionimit dhe në Drejtorinë e strategjisë dhe monitorimit të borxhit, në të cilën janë planifikuar 9 pozicione dhe rezultojnë të plotësuara 7 prej tyre. Me ndryshimet sipas strukturës organike të miratuar me Urdhërin e fundit Nr.161 datë 05.10.2017 Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik është shkrirë dhe është bashkuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit duke formuar Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik. Drejtoria e Huamarrjes dhe Drejtoria e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit janë organizuar në nivel sektorësh me ndryshimet e reja, duke u përbërë respektivisht nga 1 përgjegjës sektori dhe 7 specialist dhe 1 përgjegjës sektori dhe 6 specialist, duke reduktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve nga 19 punonjës në 16 punonjës.

6.3 Programimi i huamarrjes nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar në kohë kalendaret e organizmit të ankanadeve përgjatë vitit 2017, konkretisht:

- Me shkresën nr.17305 datë 15.12.2016 është dërguar kalendari i emetimeve për periudhën Janar-Mars 2017, ndryshuar me shkresën e datës 10.01.2017 ku është shtuar në muajin Janar zhvillimi i një ankandi për obligacione në Euro të pa parashikuar në kalendarin e mëparshëm në shumën 40-50 milionë Euro.
- Me shkresën nr. 3502 datë 15.03.2017 është dërguar kalendari i emetimeve për periudhën Prill-Qershor 2017, dhe me shkresën nr. 7886 datë 31.05.2017 është dërguar një ndryshim i këtij kalendari për muajin Qershor 2017.
- Me shkresën nr. 8628 datë 13.06.2017 është dërguar kalendari i emetimeve për periudhën Korrik-Shtator 2017,
- Me shkresën nr.12537 datë 13.09.2017 është dërguar kalendari i emetimeve për periudhën Tetor-Dhjetor 2017.

Afatet për dërgimin e kalendarëve për zhvillimin e ankandeve për emetimin e titujve të brendshëm janë respektuar në përputhje me nenin 9 të marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave "Për organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve".

Për vitin 2017, **janë programuar** për t'u shpallur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, 58 ankande të titujve të qeverisë (bono thesari dhe obligacione) dhe në vijim me ndryshimet përkatëse janë programuar 59 ankande. *Në kalendarin fillestar* në vlerë 333,159 milionë lekë, të ndarë për bono thesari për 227,100 milionë lekë dhe obligacione për 106,059 milionë lekë. *Në kalendarin e ndryshuar* në vlerë 340,000 milionë lekë, ose 2% më shumë se kalendari fillestar, të ndara për bono thesarin për 227,100 milionë lekë dhe për obligacione për 112,900 milionë lekë.

Për vitin 2017, kalendarët e ankandeve dhe ndryshimet e tyre për titujt e qeverisë në lekë dhe monedhë të huaj, janë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 71: Instrumentat e borxhit të brendshëm sipas planifikimit fillestar dhe ndryshimeve *mln lekë*

Lloji i instrumentit	Planifikuar	Rishikuar	BOA	BOA rishik
Bono Thesari 3-mujore	2,500	2,500		
Bono Thesari 6-mujore	34,300	34,300	24,396	34,995
Bono Thesari 12-mujore	190,300	190,300	24,395	24,396
Obligacione 2-vjeçare	48,600	48,600		
Obligacione 2-vjeçare në EURO	5,959	12,800		
Obligacione 3-vjeçare	3,000	3,000		
Obligacione 5-vjeçare	28,500	28,500		
Obligacione 7-vjeçare	9,000	9,000		
Obligacione 10-vjeçare	11,000	11,000		
TOTALI	**333,159**	**340,000**	**48,791**	**59,391**

Për vitin 2017, ndryshimet e kalendarit fillestar me kalendarin e ndryshuar të titujve të qeverisë, ka rezultuar për më shumë për 6,841 milionë lekë për 2 ndryshime të kalendarit. Ndryshimet e kalendarit gjatë vitit 2017, kanë ndodhur në muajin Janar kur është shtuar një emetim i ri në obligacione 2-vjeçare për 40-50 milionë Euro dhe në muajin Qershor ku është shtuar pjesa e bonove të thesarit me maturim 12-mujor ofruar për shitje Bankës së Shqipërisë në shumën 900 milionë lekë. Janë shpallur për tu emëtuar për vitin 2017 shuma prej 340,000 milionë lekë, nga të cilat 95 milionë Euro, me një ulje të lehtë me vitin 2016, ku janë programuar 357,900 milionë lekë, nga të cilat 35 milionë Euro. Rënia është si rezultat i plotësimit të nevojave për huammarrje nëpërmjet instrumentave të borxhit të jashtëm, me një ulje në vlerë absolute prej 17,900 milionë lekë, ndërkohë që pesha e instrumentave të brendshëm në monedhë të huaj të programuar për të emëtuar është rritur me 60 milionë Euro.

Megjithë programimin në përputhje me dispozitat ligjore përsa i përket ankandeve dhe financimit të brendshëm, problematika janë konstatuar në programimin e huamarrjes së jashtme, e lidhur kjo edhe me gjendjen e likuiditetit. Konstatohet se nevojat për financime nuk planifikohen sic duhen, duke marrë në konsideratë dhe disbursimin për borxhin e jashtëm, duke shkaktuar tepricë të panevojshme likuiditeti në llogarinë e qeverisë. Nga auditimi konstatohet se nevojat për huamarrje nuk përcaktohen sipas nevojave reale dhe flukseve hyrëse e dalëse që nuk marrin në konsideratë faktorët e drejtë, duke akumuluar teprica të panevojshme likuiditeti përgjatë periudhës objekt auditimi.

[shqiptaria.com]

Këto teprica likuiditeti në valutë e ekspozojnë stokun e mjeteve monetare kundrejt riskut të kursit të këmbimit, ku vetëm për vitin 2017, në treguesit fiskalë të konsoliduar është raportuar një humbje nga rivlerësimi i tepricave të likuditeteve në valutë si pasojë e uljes së kurseve të këmbimit në fund të vitit në shumën 2.848 milionë lekë. Kjo humbje nga lëvizja e kursit në rënie përgjatë vitit është mundësuar nga mbajtja e likuiditeteve të larta, ku gjendja e mjeteve monetare në të katër monedhat paraqitet mbi 12,000 milionë lekë në fund të vitit 2017 dhe përgjatë vitit arrin edhe në vlera prej 45 miliard lekë. Akumulimi i tepricave vjen si rezultat i disbursimeve të borxhit të jashtëm në valutë në formën e mbështetjes buxhetore, kryesisht nga FMN për pjesën e transhit të fundit dhe Banka Botërore sipas transheve përkatës të disbursuar në vlerën e 65 milionë Euro dhe 100 milionë USD. Grafikisht konstatimi paraqitet për të tre monedhat në valutë, pa paraqitur efektin e llogarisë në lek:

Grafiku 46: Gjendja e likuiditetit sipas 4 monedhave

a. EURO:

b. USD:



c. SDR:



[shqiptaria.com]

Pjesa më e madhe tepricës së likuditeteve paraqitet në Euro dhe SDR.

Uljet graduale të tepricës pasqyrojnë shlyerjet për nevoja kryesisht të lidhura me shërbimin e borxhit ndërkohë që uljet e menjëhershme në data të caktuara pasqyrojnë uljen si pasojë e konvertimit nëpërmjet instrumentave SWAP, sikurse konstatohet në periudhën e parë të vitit për SDR dhe në periudhën e fundit të vitit për USD, dhe në filllim dhe në fund të vitit për Euro. Shtesa më e madhe e llogarive në valutë paraqitet në periudhën Shtator-Tetor, si pasojë e disbursimit të mbështetjeve buxhetore, të cilat janë konvertuar në vijim në lekë nga USD dhe janë mbajtur kryesisht në Euro pa u konvertuar, periudhë në të cilën konstatohen teprica mbi 100 milionë Euro, mbi 100 milionë USD dhe mbi 30 milionë SDR gjendje. Këto konvertime janë pasqyruar edhe në kundërvleftë në tepricën e llogarisë në lekë, gjendja e të cilës përgjatë vitit dhene ne grafik.

d. LEKË



Akumulimi i tepricave në valutë dhe sigurimi i likuditetit paraqet kosto shtesë edhe në drejtim të interesit që paguhet për marrjen e huave nga të cilat sigurohet likuiditetit. Për më tepër, në kushtet e tepricave të larta të likuiditetit konstatohet se nuk merren masa për investimin e tyre në instrumenta afatshkurtër për të reduktuar koston që rezulton nga interesat për sigurimin e likuiditetit. Ky fakt tregon për rrezikun e lartë nga kursi i këmbimit që vjen si rezultat i rritjes së huamarrjes së jashtme, ndaj të cilit ekspozohen financat publike. Në nenin 8 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar përcaktohet që "Teprica e mjeteve monetare, përkohësisht të lira, të llogarive të qeverisjes së përgjithshme në Bankën e Shqipërisë investohet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave". Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se ka teprica përkohësisht të lira të mjeteve monetare, këto teprica nuk menaxhohen sic duhet për tu investuar, por konvertohen në monedhën vendase, nëpërmjet përdorimit të instrumentave SWAP, që paraqesin kosto shtesë në drejtim të marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me efekte të konsiderueshme për Ministrinë, si pasojë e aplikimit të kurseve të këmbimit në maturim, objekt i regullimeve me normën e interesit ndërbankar, sipas së cilës, kursi forward është gjithnjë më i lartë se kursi spot.

Menaxhimi i likuiditetit ndërmjet monedhave specifike dhe përcaktimi i nevojave për konvertime paraqitet me menaxhim të dobët ku si pasojë e konvertimeve nëpërmjet përdorimit të instrumentit SWAP me Bankën e Shqipërisë janë akumuluar interesa nga diferenca e kurseve të ofruar Spot-Forward në shumën

567 milionë lekë. Nga auditimi është konstatuar se kjo humbje nga kurset e këtyre instrumentave është raportuar në formën e të ardhurave nga kurset e këmbimit duke u pasyruar në llogarinë 766 në formën e një të ardhure negative. Akumulimi i kësaj humbje dhe raportimi në formën e të ardhurës së realizuar negative është realizuar duke kredituar llogarinë e të ardhurave me shenjë negative, duke u pasqyruar edhe në tepricën e llogarive të rezultatit me shenjë negative. Një gjë e tillë është përdorur duke qenë se për realizimin e një humbje të tillë nuk ka plan, në mënyrë që të raportohet si shpenzim i periudhës, për ato pagesa për interesa që i janë kryer Bankës së Shqipërisë. Përdorimi i llogarive të të ardhurave me shenjë negative, për të justifikuar konvertimet e panevojshme në shuma përtej pagesave standarte të likuiditeteve në valutë, krijon një pretedent me risk në drejtim të administrimit të të ardhurave buxhetore dhe është në kundërshtim me parimet bazë të kontabilitetit. Përgjatë vitit 2017, është vazhduar në drejtim të përdorimit të instrumentave SWAP me Bankën e Shqipërisë në të tre monedhat e huaja në të cilat administrohet TSA, megjithëse, vlen për tu theksuar që kostoja e përdorimit të këtyre instrumentave është reduktuar me 50% në krahasim me një vit më parë, ku kosto në buxhetin e shtetit arriti mbi 1 miliard lekë.

Krijimi i rezervave monetare të papërdorura, për të cilat paguhen interesa rezulton me kosto të panevojshme për buxhetin e shtetit dhe ekspozim të mëtejshëm ndaj riskut të kursit të këmbimit. Për më tepër, KLSH, në vëzhgim të takimeve të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuditetit, sipas propozimeve për emëtimin në vijim për vitin 2018 të Eurobondit me vlerë 500 milionë Euro, konstaton se efekti i tepricës së likuiditetit të krijuar në valutë për vitin 2018 do të jetë edhe më i fortë. Disbursimi i këtij financimi do të godasë treguesit fiskalë në mbështetjen buxhetore, dhe duke qenë në kushtet e kufijve të huammarrjes së definuar, do të ushtrojë presione për reduktim të madh në drejtim të huamarrjes së brendshme. Në të njejtën kohë do të ulet kërkesa për fonde në tregun e brendshëm nga qeveria dhe do të shtohet teprica e rezervës valutore në sistem, duke dhënë efekte të ndjeshme edhe në kursin e këmbimit. I njejti skenar i konstatuar për vitin 2017 si pasojë e krijimit të tepricave të panevojshme të likuditetit, që shoqërohen me kosto interesash, kosto konvertimi nga SWAP dhe kosto oportune të mosinvestimit rrezikon të përsëritet edhe në vitin 2018, duke dhënë efekte të njëpasnjëshme edhe në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë.

6.4 Treguesit kryesorë të borxhit publik dhe shërbimit të borxhit

Stoku i borxhit publik të raportuar për vitin 2017 paraqitet i nënvlerësuar bazuar në respektimin e kërkesave ligjore për raportimin e tij dhe në respektim të standarteve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe ato të lidhura me raportimn e borxhit publik. Në këtë mënyrë, mosfinancimi i detyrimeve të prambetura nënvlerëson stokun e borxhit të marrë për financimin e shpenzimeve të padeklaruara. Nga ana tjetër, borxhi me të drejtë konvertimi në asete të shtetit, mbetet një tjetër komponent i rëndësishëm që kërkon vlerësim të vazhdueshëm për sasinë në qarkullim të bonove të privatizimit. Mungesa e implementimit të plotë të standarteve të raportimit në lidhje me PPP me mbështetje buxhetore, implikon risqe në drejtim të financimit të nevojshëm në vijimësi të kontratave afatgjata me kushte detyruese dhe flukesh të përcaktuara. Borxhi Publik përgjatë vitit 2017, ka ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë në terma bruto, si pasojë e shtesës së huammarjes në formën e mbështetjes buxhetore, huasë së marrë për projekte me financim të huaj dhe huasë së marrë

në tregun e brendshëm nëpërmjet instrumentave të borxhit, krahasur në raport me shlyerjet përkatëse si pasojë e maturimeve. Sipas raportimeve stoku i borxhit publik, konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit 2018, duke përfshirë bonot e thesarit, obligacionet, kredinë e huaj për projekte, garancitë e brendshme dhe të jashtme si dhe borxhin e pushtetit vendor është në shumën 1,088,095 milionë lekë, përkundrejt 1,066,567 të vlerësuar në fund të vitit 2016. Ecuria e stokut të borxhit, sipas përbërësve të tij në raport me PBB paraqitet sipas tabelës në vijim:

Tabela 72: dinamika e stokut të borxhit sipas përbërësve *mln lekë*

Viti	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi publik	885,083	977,957	1,043,212	1,066,566	1,088,095
Borxhi i qeverisë qëndrore	884,632	977,102	1,042,272	1,065,710	1,087,342
Borxhi i pushtetit lokal	391	855	940	857	753
PBB	1,350,053	1,394,419	1,434,740	1,472,791	1,555,200
Stoku I borxhit / PBB (%)	65.6	70.1	72.7	72.4	70.0

Nga publikimi i të dhënave vlerësohet një shtesë në stokun e borxhit në krahasim me një vit më parë, po efekti në uljen e treguesit të stokut të borxhit në raport me PBB lidhet me zgjerimin më të madh të PBB krahasuar me shtesën e borxhit. Vlen të theksohet fakti se në treguesit e borxhit të vitit 2016, PBB e deklaruar është më e madhe se PBB e deklaruar në treguesit e borxhit të vitit 2017 për vitin 2016, që ka sjellë edhe raportimin në nivelin e 71.01% të raportit të borxhit ndaj PPB për vitin 2016. Në këtë mënyrë, ulja e raportit të borxhit të këtij viti në masën 2.4% sikurse është raportuar, nuk i atribuohet uljes së stokut të borxhit, por i atribuohet ndryshimit të PBB së përdorur për vitin 2016 sipas dy raportimeve, nga i cili raporti i borxhit faktik 2016 raporton një nivel prej 71.01% ndërkohë që raporti i borxhit faktik 2017 për efekt të analizës me vitin 2016 raporton një nivel prej 72.4%. Nga auditimi i regjistrit të borxhit konstatohet se efekti kryesor në uljen e stokut e ka dhënë kryesisht kursi i këmbimit me të cilin është vlerësuar borxhi i jashtëm shtetëror, për efekt vlerësimi në fund të vitit, i cili krahasuar me një vit më parë paraqitet në ulje pothuase për të gjitha monedhat në raport me lekun. Konstatimi në lidhje me përmirësimin e treguesit të borxhit si pasojë e rritjes më të madhe PBB të deklaruar është paraqitur në mënyrë grafike në vijim:

Grafiku 47: Dinamika e rritjes vjetore të borxhit dhe PBB



Ulja e treguesit të borxhit të mësipërm ka ardhur si rezultat i rritjes më të ulët të stokut të borxhit se zgjerimi i prodhimit të brendshëm bruto përgjatë vitit 2017, pasi në vlerë absolute të dy përbërësit e këtij raporti janë rritur në krahasim me një vit më parë.

Nga auditimi konstatohet se deri në fund të vitit 2017, sipas vetëdeklarimeve të enteve buxhetore, të raportuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë akumuluar detyrime të prapambetura në shumën 16 miliard lekë dhe sipas auditimit të KLSH vlera e detyrimeve të prapambetura ka rezultuar në shumën

[shqiptarja.com]

19 miliard lekë. Këto detyrime të prapambetura në referencë të nenit 61 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë janë shpenzime, pasi ato njihen në çastin e konstatimit të tyre, pavarësisht momentit të pagesës. Në vijim në referencë të nenit 12 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", deficiti përkufizohet si diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e detyrimeve të prapambetura, si shpenzim i konstatuar, nuk është raportuar në tabelën e treguesve fiskalë, por është raportuar si shpenzim i periudhave të ardhshme. Nëse për analogji do të përdorej shlyerja e detyrimeve të prapambetura në vitin 2015, detyrimet e prapambetura janë raportuar në tabelën e treguseve fiskalë në rubrikën e shpenzimeve, për të cilën është marrë borxh i ri për shlyerjen e tyre. Për detyrimet e rilindura në vitin 2017, të akumuluara nga insitituciones buxhetore, nuk rezulton të jetë ndjekur i njejti standart, sipas së cilit duhej të ishte marrë borxh për shlyerjen e tyre. Në këtë argument, vlera prej 19 miliard lekë përbën shtesë të borxhit të shtetit ndaj të tretëve, për shlyerjen e të cilit, megjithëse është konstatuar detyrimi nuk është marrë borxh. Nëse për financimin e këtyre pagesave do të ishte marrë borxh, stoku i borxhit publik të raportuar, nga 1,088 miliard lekë, do të ishte në rreth 1,104 miliard lekë, i cili në raport me PBB do të jepte një tregues të borxhit në nivelin mbi 71%. *Nëse marrim në konsideratë edhe shlyerjen e stokut të rimbursimit të TVSH në vlerë 11 miliardë lekë (trajtuar në seksion më vetë), borxhi publik do të jepte një tregues në nivelin 72% të PBB.* Në strategjinë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", është vendosur objektivi i arritjes së borxhit publik në nivelin 65.5% të PBB në fund të vitit 2017. Konstatohet se që nga hartimi i strategjisë niveli i borxhit publik është luhatur rreth niveleve 70-74% e PBB.

Monitorimi i treguesit të borxhit është tepër i rëndësishëm që të kryhet duke marrë në konsideratë edhe implimet buxhetore që lidhen me koncensionet.

Në këtë mënyrë, cdo kontratë e lidhur për koncensionet është një kontratë me flukse detyruese disavjecare, për të cilën nevojitet financimi i realizimit të projektit. Referuar të dhënave aktuale në lidhje me 11 kontratat koncensionare rezulton se shpenzimet faktike nga buxheti i shtetit rezultojnë në shumën 6,493 milionë lekë, ndërkohë që projeksionet në lidhje me mbështetjen e nëvojshme buxhetore të këtyre pagesave paraqesin një trend që dyfishohet deri në vitin 2021 sipas informacionit të administruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh edhe projektet për të cilat është dhënë miratimi nga ana e MFE për mbështetjen buxhetore të nevojshme të cilat pritet të hyjnë në fuqi vitin e ardhshëm rezulton se këto pagesa bashkë me dhënien e miratimit në parim nga ana e MFE për 4 kontrata të reja, parashikohet që të rezultojnë me flukse dalëse në shumën 18,115 milionë lekë në vitin 2021. Grafikisht tendenca e shpenzimeve që kërkojnë financim nëpërmjet këtyre dy kontratave sipas dy skenarëve të analizuar më sipër paraqitet:

[shqiptaria.com]

Grafiku 48: Trendi i shpenzimeve për tu financuar



Për këtë arsye, në planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit është e rëndësishme që të merren në konsideratë këto kosto financiare që mbartin këto projekte, megjithëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk raporton në përputhje me standartet ndërkombëtare të raportimit, që kërkojnë që këto kontrata të raportohen në stokun e borxhit publik.

Në strategjinë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", e përgatitur nga Ministria e Financave, me ndihmën e ekspertëve të Bashkimit Europian dhe e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 908 17 dhjetor 2014, është vendosur objektivi i arritjes së borxhit publik në nivelin 65.5% të PBB për vitin 2017. Niveli i borxhit publik faktik në 72% të PBB përgjatë vitit 2017 (duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe stokun e rimbursimit të TVSH), tregon për një mospërmbushje të objektivave të vendosura në lidhje me këtë komponentet tepër të rëndësishëm në kuadër të mirëmenaxhimit të financave publike.

6.5 Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore

Stoku i borxhit të Qeverisjes Qendrore përgjatë vitit 2017, paraqitet në rritje sikurse është evidentuar edhe më sipër 21,633 milionë lekë duke arritur një stok prej 1,087,342 milionë lekë, përkundrejt 1,065,709 milionë lekë në fillim të vitit. Duke marrë parasysh klasifikimin e borxhit në të garantuar dhe jo të garantuar si dhe të brendshëm e të jashtëm, treguesit e borxhit të qeverisjes qendrore paraqiten:

Tabela 73: Treguesit e borxhit të qeverisjes qendrore *mln lekë*

Viti	2013	2014	2015	2016	2017
Stoku i brendshëm shtetëror	500,868	538,641	520,936	530,834	546,939
Stoku i brendshëm i garantuar	19,918	26,033	30,439	30,286	30,117
Stoku i jashtëm shtetëror	332,500	383,922	465,306	481,407	490,518
Stoku i jashtëm i garantuar	31,406	28,507	25,591	23,182	19,768
Stoku i borxhit te qeverisjes qendrore	**884,692**	**977,103**	**1,042,272**	**1,065,709**	**1,087,342**

Për vitin 2017 shtesa në huamarrje është realizuar kryesisht nëpërmjet instrumentave të brendshëm, ku shtesa e borxhit të brendshëm paraqitet në total në shumën 15,936 milionë lekë. Shtesa e stokut të brendshëm shtetëror paraqitet në shumën 16,105 milionë lekë ndërkohë që stoku i brendshëm i garantuar ka pësuar ulje në shumën -169 milionë lekë si pasojë e rivlerësimit me kurs të këmbimit në ulje. Shtesa e stokut të borxhit të jashtëm vlerësohet në shumën 5,697 milionë lekë e përbërë nga një rritje në stokun e jashtëm shtetëror

[Shqiptaria.com]

në shumën 9,111 milionë lekë dhe një ulje në stokun e jashtëm të garantuar në shumën -3,414 milionë lekë. Shtesa e borxhit të jashtëm shtetëror i atribuohet kryesisht mbështetjes buxhetore, ndërkohë që efekt në një rritje kaq të ulët vlerësohet të ketë efekti favorizues i kursit të këmbimit. Nëse i referohemi treguesve të borxhit, shtesat vjetore të huasë së jashtme në formën e mbështetjes buxhetore dhe huasë së marrë për projekte paraqiten në shumën 58,600 milionë lekë, ndërkohë që ripagesat e prinicipalit vlerësohen në rreth -25,800 milionë lekë. Në këtë mënyrë shtesa e borxhit të ri vlerësohet për neto në borxhin e jashtëm shtetëror në shumën 32,800 milionë lekë, ndërkohë që shtesa e stokut krahasuar me një vit më parë vlerësohet me rreth 9,111 milionë lekë. Diferenca prej 23,700 milionë lekë, vlerësohet efekti favorizues në uljen e stokut të borxhit shtetëror të jashtëm për vitin 2017 si pasojë e kursit në ulje të këmbimit të lekut në raport me monedhat e huaja. Nga ana tjetër garancitë e jashtme shtetërore paraqiten në ulje si pasojë e pagesave të principalit të kryera nga buxheti i shtetit dhe në të njejtën kohë efektit favorizues të kursit të këmbimit.

6.6 Borxhi i brendshëm shtetëror

Për vitin 2017, janë emëtuar në tregun e brendshëm tituj shtetërore në vlerën 323 miliard lekë në total. Sipas raportimit në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar, 16.4 miliard lekë të kësaj huamarrje janë përdorur për financimin e deficitit, ndërkohë që pjesa tjetër është përdorur për rifinancimin e titujve të maturuar sipas intrumentave të brendshëm. Në terma bruto, bonot e thesarit, si instrumenta afatshkurtër janë përdour në rreth 218 miliard lekë për huamarrjen e brendshme ndërkohë që obligacionet raportohen në vlerën e 105.3 miliard lekë. Me qëllim dhënien e sigurisë në lidhje me maturimet dhe emëtimet sipas ankandeve të bonove të thesarit dhe obligacioneve nga ana e grupit të auditimit u kryen teste ku u krahasuan regjistri i borxhit sipas katërmujorit përkatës dhe baza e të dhënave të ankandeve të ushtruar në Bankën e Shqipërisë sipas regjistrit të titujve për vitin 2017.

Stoku i borxhit të brendshëm dominohet kryesisht nga instrumentat afatgjatë me një vlerë stoku në fund të vitit 2017 në shumën 351,892 milionë lekë, përkundrejt 195,047 milionë lekë të stokut të instrumentave afatshkurtër. Të krahasuara në raport me të njejtën periudhë të vitit më parë, stoku i instrumentave të tregut të brendshëm në milionë lekë paraqiten:

Tabela 74: Stoku i instrumentave të tregut të brendshëm *mln lekë*

Instrumenti	2016	2017	Ndryshimi
Bono thesari	**209,408**	**195,047**	**-14,361**
3 mujore	2,342	0	-2342
6 mujore	21,219	11,071	-10,148
12 mujore	185,847	183,975	-1,872
Obligacione	**321,427**	**351,892**	**30,465**
2 vjecare	83,674	95,474	11,800
3 vjecare	28,920	24,673	-4,247
5 vjecare	98,428	103,120	4,692
7 vjecare	63,232	71,669	8,437
10 vjecare	47,173	56,956	9,783
Total instrumentave te brendshem	**530,835**	**546,939**	**16,104**

Për vitin 2017, strategjia e zgjatjes së maturitetit të borxhit është zbatuar duke qenë se është ulur stoku i bonove të thesarit në krahasim me vitin 2016 në shumën 14,361 milionë lekë dhe në të njejtën kohë është rritur stoku i instrumentave të brendshëm me 30,465 milionë lekë në krahasim me një vit më parë. Peshën specikike më të lartë në drejtim të reduktimit të huamarrjes

Ishqiptarja.com

afatshkurtër e kanë bonot e thesarit me maturim 6-mujor të cilat janë reduktuar me 10,148 miliard lekë dhe në të njejtën kohë nuk janë emëtuar instrumenta afatshkurtër me maturim 3-mujor të cilat të jenë stok në 31.12.2017, përveç një emëtimi që është maturuar përgjatë vitit. Në të njejtën linjë është shoqëruar edhe rritja e instrumentave afatgjatë ku peshën specifike më të lartë e kanë rritja e obligacioneve me maturim 2-vjecar në shumën 11,800 milionë lekë, instrumentave me maturim 10-vjecar në shumën 9,783 milionë lekë dhe instrumentave me maturim 7-vjecar në shumën 8,437 milionë lekë. Në të gjithë ankandet e zhvilluar përgjatë vitit 2017 janë emëtuar instrumenta afatgjatë me normë kuponi fiks. Në terma afatgjatë kjo strategji rezulton efikase përkundrejt riskut të normës së interesit në rast të rritjes së tyre.

6.7 Garancitë e brendshme

Stoku i borxhit të garantuar të brendshëm paraqitet me një ulje të lehtë e cila është ekskluzivisht e lidhur me uljen si pasojë e mbicmimit të monedhës vendase, pasi në monedhë origjinale paraqitet në të njetjën masë në krahasim me vitin e kaluar. Garancitë e brendshme janë të gjitha me përfitues KESH sha dhe përfaqësojnë linja kredie afatshkurtra dhe me norma interesi tregtare. Huadhënësi për këto garanci janë bankat e nivelit të dytë.

Nga 30,117 milionë lekë që paraqitet stoku i garancive të brendshme në fund të vitit 2017, rreth 9,387 milionë lekë prej tyre paraqitet në Euro, e cila sipas kundërvleftës përkatëse paraqitet në shumën 74 milionë Euro.

6.8 Borxhi i jashtëm shtetëror

Niveli i borxhit të jashtëm shtetëror sipas raportimeve paraqitet në shumën 510,286 milionë lekë, nga të cilat stoku i borxhit të jashtëm në shumën 490,518 milionë lekë dhe stoku i jashtëm i garantuar në shumën 19,768 milionë lekë. Referuar raportimeve në lidhje me disbursimet, të audituara në raport me të dhënat e sistemit të menaxhimit të borxhit, rezulton se janë dibursuar në total për gjatë vitit 2017 shuma prej 58.7 miliard lekë, nga të cilat 31.4 miliard lekë në formën e mbështetjes buxhetore dhe 27.2 miliard lekë në formën e kredisë për financimin e projekteve.

Tabela 75: Stoku i borxhit të jashtëm *mln lekë*

ID	Pershkrimi	Lloji disbursimit	Shuma
17/06/IBRD	Zhvillimi i politikave të sektorit financiar	Mbeshtetje buxhetore	11,315.18
14/03/IMF	Extended Arrangement	Mbeshtetje buxhetore	9,869.91
17/01/IBRD	Programi për politikat e zhvillimit të konkurrencës	Mbeshtetje buxhetore	8,797.52
11/02/IDB	Rruga Tiranë-Elbasan	Hua projektesh	5,869.51
14/13/IBRD	Fuqizimi i Sistemit Elektrik Shqiptar	Hua projektesh	4,931.78
13/03/IDB	Rruga Qukës - Qafë Plloçë	Hua projektesh	3,319.18
08/04/JAPAN	Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve, Tiranë	Hua projektesh	1,825.99
13/06/AbuDhabi	Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës	Hua projektesh	1,647.16
14/01/IBRD	Projekti i Investimeve në sektorin ujor	Hua projektesh	1,539.38
14/02/SaudiArab	Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan-Qukës-Qafe Plloçë	Hua projektesh	1,367.62
12/09/IBRD	Projekti Shpërndarjes dhe Burimeve Ujore	Hua projektesh	1,353.27
15/05/CEB	Punët e komunitetit IV	Hua projektesh	1,165.55
Te tjera	Te tjera projekte dhe mbeshtetje buxhetore		5,728.57

[shqiptarja.com]

Vlera më e madhe e disbursimeve i atribuohet disbursimeve në formën e mbështetjes buxhetore nga FMN dhe Banka Botërore, ndërkohë që projektet kryesore të cilat paraqesin një realizim prej 22 miliard lekë përfaqësohen nga huatë për rrugët Tiranë-Elbasan, Qukës-Qafë Plloçë, huatë për sistemin energjitik dhe huaja e Bulevardit verior të Tiranës dhe ato për sektorin e ujësjellsave. Në lidhje me ripagesat e principalit konstatohet se janë paguar sipa raportimeve në treguesit fiskalë të konsoliduar shuma prej 25,769 milionë lekë në formën e shlyerjeve të principalit.

KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 5,391 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2017, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse. Problematike situata është konstatuar në lidhje me marrëdhëniet e nënhua, për kreditë e nënhuazuara, ku marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se nuk respektohen nga ana e nënhuamarrësve duke akumuluar detyrime të vazhdueshme edhe përgjatë vitit 2017. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2017. Stoku i deyrimeve që përfituesit kanë ndaj shtetit në fillim të vitit paraqitet në shumën 11,352 milionë lekë, ndërkohë që në fund të vitit paraqitet në shumën 16,924 milionë lekë, me një rritje prej 50% brenda vitit 2017. Nga totali i pagesave të kryera për principalin dhe interesat e mësipërme, vetëm për marrëveshjet e nënhuasë dhe arkëtimi në vitet 2010-2017 respektivisht prej tyre dhe teprica e detyrimeve të akumuluara paraqitet:

Grafiku 49: Dinamika e pagesave të buxhetit dhe stoku i detyrimeve për 2010-2017



Ulja në vitin 2014 i atribuoet shuarjes me kompensim të detyrimeve të ndërsjellta ndërmejt kompanive të sektorit energjitik dhe institucioneve buxhetore dhe jo shlyerjes së detyrimeve të të tretëve ndaj shtetit si pasojë e marrëdhënieve të nëhuasë apo mbështetjeve buxhetore për sektorin energjitik

Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2017. Në këtë mënyrë të dhënat në lidhje me të drejtat e shtetit për të arkëtuar përkundrejt marrëveshjeve përkatëse tregojnë rritje të së drejtës për të arkëtuar në krahasim me një vit më parë. Të analizuara sipas sektorëve të nënhuasë dhe institucioneve zbatuese të marrëveshjeve të nënhuasë, detyrimet paraqiten për shtesën vjetore të vitit 2017:

Tabela 76: Ndryshimet e stokut të të drejtave për tu arkëtuar përgjatë vitit 2017

Institucioni	Detyrimi fillestar 2017 ne ALL	Detyrimi fund 2017 ne ALL	Rritja vjetore
Energjia	**5,229,985,210**	**9,396,270,672**	**4,166,285,462**
KESH	3,677,333,902	6,760,919,120	3,083,585,219

OST	1,552,651,308	2,635,351,551	1,082,700,243
Ujesjelles	**4,908,346,171**	**5,656,160,483**	**747,814,312**
Ujesjellesi Vlore	1,527,996,482	1,743,435,628	215,439,146
Ujesjellesi Korce	780,427,219	1,002,124,589	221,697,370
Ujesjellesi Durres	1,040,332,237	1,147,491,752	107,159,514
Te tjera ujesjelles	1,559,590,233	1,763,108,514	203,518,281
Pushteti vendor	**1,389,830,376**	**1,826,815,864**	**436,985,487**
Te tjera vendori	39,040,901	55,905,475	16,864,574
Bashkia Tirane	1,350,789,475	1,770,910,389	420,120,913
Mikrokredi/ FAF	**1,539,578**	**40,908,141**	**39,368,563**
Armo	**3,289,804**	**4,506,144**	**1,216,340**
TOTALI	**11,532,991,139**	**16,924,661,302**	**5,391,670,163**

Vlerën më e madhe e rritjes i atribuohet sektorit energjitik në shumën 4,166 milionë lekë për marrëveshjet e nënhuasë me KESH dhe OST, ndjekur nga pushteti vendor në shumën 437 milionë lekë dhe sektori i ujësjellsave në shumën 747 milionë lekë. Në nenin 30 "Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare", të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është përcaktuar që "...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave". Nga auditimi kostatohet se për vitin 2017, masat e marra për arkëtimin e detyrimeve ekzistuese kanë qenë të pamjaftueshme për aq kohë sa janë krijuar detyrime të reja në shumën 5,391 milionë lekë. Një situatë e tillë bëhet edhe më problematike në kushtet e lëshimit të garancive për institucione në paaftësi paguese si OST, ku megjithëse stoku i detyrimeve ndaj shtetit është rritur me 1,083 milionë lekë në vitin 2017, është lëshuar një garanci në shumën 50 milionë Euro.

Nga auditimi është konstatuar se në zërin e treguesve fiskalë "Huadhënie neto" janë raportuar disbursime dhe ripagesa, të cilat janë planifikuar në zëra të tjerë të treguesve fiskalë dhe në të njejtën kohë të nënvlerësuar, me qëllim kryesor mbulimin e tejkalimit të planit në zërat e tjerë buxhetorë dhe mbulimin e tejkalimit të deficitit faktik. Plani i miratuar me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" është detajuar në shpenzime kapitale me financim të huaj ndërsa fakti i tyre është raportuar në zërin huadhënie neto. Plani përfundimtar në këtë zë sipas ligjit nr.13/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", i ndryshuar paraqitet në shumën 5,500 milionë lekë ndërkohë që fakti i raportuar në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar paraqitet në shumën 9,217 milionë lekë. KLSH ka llogaritur në këtë zë edhe efektin e mosraportimit të vlerës së saktë të disbursimeve dhe ripagesave, e cila për të njejtët projekte klasifikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë paraqitet në shumën 12,322 milionë lekë. Këto tregues janë të paraqitur në seksionin e huadhënies neto në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar si në vijim:

Tabela 77: Treguesit fiskalë të huadhënies neto

Përshkrimi	Plan AN.3	Plani AN.3 + F.R	Realizimi fiskale	Realizimi borxhi
Huadhenie neto	**4,500**	**5,500**	**9,217**	**12,322**
Hua e dhene per energjine nga burime te huaja	3,000	3,000	4,906	6,840
Hua e dhene per energjine nga burime te brendshme	3,000	4,000	1,500	2,500
Hua e dhene te tjera	0		3,074	3,244

Hua e dhene pushteti vendor			1,646	1,647
Hua e kthyer nga sektori energjitik	-1,500	-1,500	-895	(895)
Hua e kthyer nga pushteti vendor			-76	(76)
Hua e kthyer te tjera	0	**0**	-938	(938)

Nga ana tjetër konstatohet se diferencat në raportimet e disbursimeve për projektet me financim të huaj për të tre sektorët janë si pasojë e mosraportimeve të sakta në kohë për disbursimet, e evidentuar edhe në seksionin e disbursimeve të huasë së marrë për projekte me financim të huaj, ku për projektet e klasifikuara si nënhua, nga strukturat e thesarit raportohen disbursime për nënhuanë në shumën 9,626 milionë lekë, ndërkohë që nga strukturat e borxhit për të njejtat projekte të nënhuasë raportohen disbursime në shumën 11,731 milionë lekë përgjatë vitit 2017. Nga auditimi në lidhje me huadhënien neto konstatohet se planifikimi fillestar në lidhje me këta tregues ka qenë vetëm për huadhënien neto për energjinë nga burime të huaja dhe të brendshme dhe pjesa e planifikuar për tu kthyer si pasojë e disbursimeve/huave të dhëna në periudhat e mëparshme. Në raportimin sipas treguesve fiskalë të konsoliduar konstatohet se janë përfshirë edhe huaja e dhënë për pushtetin vendor dhe të tjera dhe pjesa përkatëse e kthyer nga këto sektorë, pa pasur një plan përkatës të miratuar më parë. Në këtë mënyrë rezulton se disbursimet kanë qenë të paplanifikuara në masën që ato janë realizuar, pasi edhe nëse merret në konsideratë fakti që plani ka ekzistuar në financimin e huaj të insitucionit fillestar, realizimi në total, edhe po të merret në konsideratë efekti i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, sjell një tejkalim në masën 105% të planit sikurse është pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme. Tejkalimi vjen gjithashtu si rezultat i raportimit të disbursimeve për projektet e nënhuasë të lidhura me pushtetin vendor (të planifikuara në zërin "Shpenzime për pushtetin vendor") në shumën 1,646 milionë lekë dhe me të tjera projekte (të planifikuara në zërin "Shpenzime kapitale me financim të huaj") në shumën 3,074 milionë lekë. KLSH ka konstatuar gjithashtu se riklasifikimi i faktit është kryer jashtë SIFQ, duke kryer rregullime jashtë raportit standart të sistemit mbi treguesit fiskalë të konsoliduar. Në lidhje me huanë e kthyer, nga subjektet nënhuamarrëse konstatohet se është riklasifikuar nga pozicioni i financimit të deficitit në zërin e huadhënies neto me qëllim mbulimin e tejkalimit të deficitit, ku vlera e kthyer prej 1,909 milionë lekë, nënzë i financimit të deficitit është riklasifikuar me qëllim mbulimin e tejkalimit të tij,përkundrejt shumës prej 262 milionë lekë të arkëtuar nga OSHEE për huatë edhëna në vitet e kaluara në formën e mbështetjes buxhetore. Diferencat në raportimet e disbursimeve për projektet me financim të huaj për të tre sektorët janë si pasojë e mosraportimeve për projektet e mëposhtëm:

Tabela 78: Diferencat në raportimet e disbursimeve sipas projekteve *mln lekë*

ID	Projekti	FISKALE	BORXHI
14/07.1/IDB	Projekti I Mikrofinances ne Shqiperi,kredi	281.39	59
14/07/IDB	Projekti I Mikrofinances ne Shqiperi,kredi	0	239
08/04/JAPAN	Projekti I kanalizimeve te Tiranes se madhe	1,678.07	1,826
13/06/AbuDhabi	Bulevardi Verior dhe Rehabilitimi I Lumit te Tiranes	1,646.70	1,647
08/09/IDA	Siguria e Digave, IDA	217.47	219
09/09/KfË	Linja 400 Kv Shqiperi-Kosove (09/09 KFË)	463.85	467
09/10/KfË	Linja unazore 110 Kv e Shqiperise se Jugut 09/10 kfe	194.36	197
09/11/KfË	Linja unazore 110 Kv e Shqiperise se Jugut 09/11 KFË	58.06	59
14/13/IBRD	Projekti I Rimekembjes se Energjise,komp.2	1,670.83	4,932
	Projekti I Rimekembjes se Energjise Huaja IBRD 8429 AL Komponenti 1	1,356.61	0
	Projekti per Rimekembjen e Energjise, Komponenti 3	126.35	0
12/11/EBRD	Siguria e Digave, EBRD - BERZH	159.69	162
12/01/IBRD	Dam Safety Project (projekti I sigurise se digave)	658.45	804

Shqiptaria.com

12/04/KfË	Programi I infrastruktures bashkiake II (Kamez Lushnje Berat Kucove Fier Sarande)	353.71	321
12/05/KfË	Programi I infrastruktures bashkiake II (Kamez Lushnje Berat Kucove Fier Sarande)	0	35
10/08/KfË	Infrastruktura Bashkiake I (Fier Gjirokaster Sarand Lezhe)	663.45	665
10/10/KfË	Ujesjelles kanalizime Pogradec, faza III	96.82	97
TOTALI		**9,625.81**	**11,731**

Efekti i këtyre raportimeve jo të sakta është i lidhur drejtpërdrejt me thyerjen e deficitit, në anën e shpënzimeve të nënvlerësuara në raportim. Këto nënvlerësime janë të lidhura me disbursimin e financimit të huaj për projekte specifike, e lidhur në të njejtën kohë edhe me tejkalimin e kufijve në huamarrje e evidentuar më sipër.

6.9 Garancitë e huaja shtetërore të huasë dhe huamarrja vendore

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2017 garancitë e huaja janë ulur në terma bruto me 3.583 milionë lekë. Ulja e këtyre garancive nuk është realizuar si pasojë e pagesave të kryera nga huamarrësi, por nga buxheti i shtetit, në rolin e garantuesit të këtyre marrëveshjeve të huasë, në kushtet e dështimit për të paguar nga ana e detyruesit kryesor. Pagesat e kryera nga buxheti i shtetit ndër vite për garancitë dhe arkëtimet për këto pagesa të kryera nga detyruesi kryesor paraqiten:

Grafiku 50: Dinamika e garancive dhe i stokut për 2010-2017





Përgjatë të gjithë periudhës në analizë konstatohet se situata në lidhje me garancitë paraqitet problematike duke filluar që nga viti 2011, dhe me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për mbështetjen e sektorit energjitik, aftësia paguese mbetet e ulët. Nga ana tjetër, përsa i përket uljes së stokut të detyrimeve për garancitë të paraqitur në vitin 2015, konstatohet se është shuarja me kompensim e detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet kompanive të sektorit energjitik dhe detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj këtyre kompanive. Megjithë uljen e sokun në këtë periudhë, stoku i detyrimeve ne 31.12.2017 rezulton se është në të njejtën situatë si 2 vitë më parë, kur u realizua kjo shuarje e detyrimeve me kompensim, si pasojë e akumulimit të detyrimeve të reja me reth 4 miliard lekë në 2 vjet.

Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2017 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjitik. Pothuajse e gjitha ulja e stokut të garancive të huaja i atribuohet pagesave të kryera në Buxheti i Shtetit i vitit 2017. Megjithë performancën e dobët dhe paaftësinë paguese të subjekteve përfituese të garancive, konstatohet se në vitin 2017 është lëshuar një garanci e re, për OST, edhe pse kërkesat ligjore parashikojnë një analizë të detajuar ekonomiko-financiare si kriter në lëshimin e garancive. Për vitin 2017 gjendja e detyrimeve

[Shqiptaria.com]

në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 5,722 milionë lekë në 8,552 milionë lekë, me një rritje vjetore prej 2,831 milionë lekë ose 49.5%. Referuar institucioneve dhe projekteve specifike me problematikat më të mëdha konstatohet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 79: Ndryshimi i detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore për 2017 mln lekë

Institucioni/projekti	Detyrimet 01.01.2017	Detyrimet 31.12.2017	Shtesa e detyrimeve
Ministria e Energjisë dhe Industrisë (KESH, OST)	**4,278.41**	**6,939.36**	**2,660.94**
Elektrifikimi i Zonave Rurale	276.48	495.11	218.64
Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë I	-	16.13	16.13
Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë II	-	351.46	351.46
TEC-i Vlorë	2,436.14	3,637.87	1,201.72
Transmetim, Shpërndarje e Energjisë	899.83	1,358.70	458.87
Hidrocentrali mbi Lumin Drin	175.14	275.93	100.79
Nënstacioni i Transmetimit të Energjisë	490.82	804.15	313.33
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	**1,117.23**	**1,250.74**	**133.51**
Furnizimi me Ujë i Tiranës II	675.99	759.91	83.92
Ujësjellësi i Tiranës I	432.19	481.78	49.59
Rehabilitimi I rrjetit hidrik te Tiranes	9.05	9.05	-
Hekurudha Durrës	**207.36**	**232.25**	**24.89**
Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit	207.36	232.25	24.89
Ministria e Financave (ndihme ne mallra)	**65.40**	**71.20**	**5.81**
Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime Krujë	**53.15**	**58.66**	**5.52**
Grand Total	**5,721.55**	**8,552.22**	**2,830.67**

Në nenin 43 "Kthimi i garancisë shtetërore të huasë" të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është përcaktuar që "Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrit të Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar ti kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë.

Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të. Nga auditimi kostatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e bëra në këtë nen, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2017, por edhe është rritur me 2.8 miliard lekë. Kjo humbje evidentohet edhe në drejtim të projekteve specifike, si në rastin e TEC Vlorë i cili ka edhe rritjen më të lartë të stokut të detyrimeve, për të cilin nevojitet një strategji specifike për reduktimin e akumulimit te detyrimeve, identifikimin e arsyeve të performancës së dobët dhe marrjen e masave për shlyerjen e tyre. Konstatohet se masat e marra janë të pa mjaftueshme për zgjidhjen e situatës së krijuar ku risku i kreditit të këtyre institucioneve është mjaft i lartë.

Megjithë konstatimet e mësipërme, problematika zgjerohet duke marrë parasysh edhe lëshimin e garancisë së re përgjatë vitit 2017 për OST që paraqitet në situatë financiare të rënduar për aq kohë sa ka detyrime të akumuluara ndaj shtetit dhe është përballë paaftësisë paguese për detyrimet e krijuara rishtazi përgjatë vitit 2017. Me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të

ndryshuar, janë vendosur edhe kufijtë për rritjen e garancive të shtetit në përmbushje edhe të pikës c) të nenit 58 të ligjit Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në shumën 2,774 milionë lekë, për garancitë e reja për t'u lëshuar gjatë vitit buxhetor, nga Qeveria Qendrore, ndërkohë që gjatë vitit 2017 shuma e garancisë së mësipërme të lëshuar është 50 milionë Euro ose 6,647.5 milionë lekë, ndërkohë që nuk janë vendosur kufizime sipas përcaktimeve të bëra në lidhje me stokun e garancive.

Po i njëjti konstatim vlen edhe më riskoz për financat publike për garancinë e dhënë ndaj KESH për kontratën e huasë datë 30.06.2016 në shumën 218 milionë Euro, e cila është bërë efektive në vitin 2018. Ky konstatim është i mbështetur edhe në nenin 35, 36 dhe 37 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ku citohet se *"...Cdo huamarrës që kërkon marrjen e një garancie shtetërore të huasë, në bazë të këtij ligji, paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar, për ti mundësuar Ministrit të Financave të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi. ...Kur dokumentacioni është i plotë, Ministri i Financave, në bazë të analizës ekonomike-financiare të materialeve, është i detyruar që, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë...Analiza ekonomike-financiare, e përmendur në nenin 36 të këtij ligji përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti në rast se jepet garancia..."*

Në këtë mënyrë, konstatohet se treguesit financiarë janë të dobët dhe risku i kreditit është i lartë në rastin e OST dhe KESH, megjithë këtij fakti është lëshuar garancia për 50 milionë Euro dhe 218 milionë Euro respektivisht, disbursueshme vitet e ardhshme.

Nga auditimi konstatohet se stoku i huasë së pushtetit vendor në bankat e nivelit të dytë në fund të vitit 2017 vlerësohet në shumën 753 milionë lekë me një ulje të lehtë në krahasim me një vit më parë, stoku i të cilit ishte 857 milionë lekë. Gjatë vitit 2017 nuk rezulotjnë kredi të reja të miratuara për njësitë e vetqeverisje vendore. Kjo rezulton e lidhur me aftësinë dhe performancën e dobët të pushteti vendor si në drejtim të krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe kapacitetin e vogël për ripagesën e detyrimeve aktuale edhe në formën e marrëveshjeve të nënhuasë. Në këtë mënyrë stoku i vitit 2017 është i përbërë nga të njejtat kredi si një vit më parë, me një shumë të reduktuar si pasojë e shlyerjeve të pasqyruara edhe në seksionin e financimit të deficitit për shlyerjet e pushtetit vendor në shumën 104 milionë lekë.

6.10. Shpenzimet për interesa

Shpenzimet për interesa përgjatë vitit 2017, kanë rezultuar me rënie në krahasim me vitin e kaluar duke shënuar vlerën prej 31,904 milionë lekë, përkundrejt 36,259 milionë lekë që rezultuan një vit më parë. Ulja e peshës së instrumentave afatshkurtër ka kontribuar drejtpërsëdrejti në uljen e shpenzimeve të interesave të brendshëm, si pasojë e titujve që maturohen brenda vitit dhe kanë flukse dalëse interesi brenda vitit. Rreth 48 miliard lekë e obligacioneve janë me kupon të ndryshueshëm sipas stokut në fund të vitit 2017 dhe ndryshimi i normës bazë në ulje, reflektohet direkt në pagesa më të ulëta për kuponat e indeksuara sipas marzhit përkatës. Raportimet mbi shpenzimet për interesa për borxhin e brendshëm dhe interesa për borxhin e huaja paraqiten në milionë lekë:

[shqiptaria.com]

Grafiku 51: Dinamika e interesave për borxhin për periudhën 2013-2017



6.10.1 Interesat e borxhit të brendshëm

Pjesa më e madhe e interesave për shërbimin e borxhit të brendshëm është e akumuluar në drejtim të interesave për kuponat e obligacioneve në rreth 17,868 milionë lekë për vitin 2017, përkundrejt 3,546 milionë lekë të paguara për interesate bonove të thesarit. Në vjijm janë paraqitur të dhënat mbi interesat e paguara përgjatë vitit 2017 sipas instrumentave të borxhit të brendshëm në milionë lekë:

Tabela 80: Interesat e paguara përgjatë vitit 2017 *mln lekë*

Interesa në tregun e brendshëm	**21,414.59**
Interesa bono thesari ne total	**3,546.43**
Interesa bono thesari 3-mujore	14.72
Interesa bono thesari 6-mujore	310.62
Interesa bono thesari 12-mujore	3,221.09
Interesa obligacione ne total	**17,868.16**
Interesa obligacione me afat maturimi nga 1 deri 5 vjet	9,460.28
Interesa obligacione me afat maturimi 6 deri 10 vjet	8,407.88

Të krahasuar me një vit më parë, shpenzimet për interesat e bonove të thesarit për vitin 2017 paraqiten në shumën 3,546 milionë lekë, përkundrejt 8,501 milionë lekë që rezultuan në vitin 2016. Në bonot e thesarit, pjesa më e madhe e shpenzimeve të interesit është realizuar për bonot e thesarit me maturim 12-mujor me rreth 3,221 milionë lekë që përbën 91% të shpenzime për interesa për instrumentat afatshkurtër. Kursimi në shpenzimet e interesit të këtyre instrumentave konstatohet se vjen si rrjedhojë e uljes së stokut të bonove të thesarit me maturim 6-mujor, i cili është reduktuar në krahasim me një vit më parë me gati 50%, nga 21,219 milionë lekë në 11,071 milionë lekë.

Shpenzimet për interesa për vitin 2017 shënuan një rritje të lehtë për sa i përket kuponave të obligacioneve kurse shuma e raportuar për vitin 2017 është 17,868 milionë lekë, përkundrejt 17,025 milionë lekë të raportuara për vitin 2016. Përsa i përket interesave të obligacioneve konstatohet se janë në proporcion të drejtë duke i ndarë instrumentat me afat maturimi nga 1 deri në 5 vjet dhe nga 6 deri në 10 vjet.

Në këtë mënyrë, për vitin 2017 për kuponat e obligacioneve me afat maturim 1 deri në 5 vjet janë shpenzuar 9,460 milionë lekë, me një ulje përkundrejt kuponave për të njejtat instrumenta në vitin 2016 në shumën 10,326 milionë lekë. Shpenzimet për interesa për obligacione me afat maturimi 6 deri në 10 vjet për vitin 2017 rezultuan në shumën 8,408 milionë lekë, me një rritje në krahasim më një vit më parë, në të cilën u raportuan 6,699 milionë lekë shpenzime interesi për këto instrumenta. Në këtë mënyrë, efekti që ka sjell rritjen e shpenzimeve të

istoritaria.com

interesit për këto instrumenta vlerësohet të jetë në rritjen e stokut të obligacioneve me afat maturimi 2-vjecar.

Shpenzimet e interesit të pushtetit vendor për huatë afatgjata të marra në sektorin bankar vlerësohet të jenë në vlerën 46 milionë lekë për vitin 2017.

6.10.2 Interesat e borxhit të jashtëm

Shpenzimet për interesa për shërbimin e borxhit të jashtëm vlerësohen të jenë në shumën 10,489 milionë lekë, nga të cilat vetëm shpenzimet e interesit për Eurobondin paraqiten në shumën 3,450 milionë lekë, që përbëjnë rreth 30% të shpenzimeve për interesa për borxhin e jashtëm.

6.10.3 Bonot e privatizimit

Bonot e privatizimit janë letra me vlerë të shtetit shqiptar me të drejtë konvertimi në aktive të shtetit, sipas përdorimit qëllimor të tyre në procesin e privatizimit të pronës shtetërore. Legjislacioni zbatues në lidhje me bonot e privatizimit përcaktohet në: Ligjin nr. 7918, datë 13.04.1995 *"Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 "Për emëtimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe Dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 "Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995 "Për emëtimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit"*, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Ne nenin 4 të ligjit nr. 7918, datë 13.04.1995 *"Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 "Për emëtimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe Dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 "Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995 "Për emëtimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit"* është cilësuar që këto letra me vlerë janë të formës jo emërore. *Në nenin 7 të këtij ligji është përcaktuar kompetenca e Këshillit të Ministrave për të përcaktuar me vendim procedurat e emëtimit dhe shpërndarjes së bonove,* rregullat e përdorimit në procesin e privatizimit, si dhe rregullat e tjera të nevojshme në zbatim të këtij dekreti.

Konstatohet se Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk disponon informacion në lidhje me gjendjen e emëtuar të bonove të privatizimit, gjendjen e emëtuar por të pashpërndarë, sasinë e bonove të përdorura dhe asgjësuara ndër vite dhe sasinë aktuale të bonove të privatizimit në qarkullim. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se nuk ka procedura konfirmimi dhe rakordimi me palët e përfshira në procesin e pranimit, atyre që evidentojnë përdorimin dhe atyre institucioneve që kryejnë asgjësimin e këtyre letrave me vlerë, konkretisht bankat e nivelit të dytë dhe Bankën e Shqipërisë.

I vetmi informacion i publikuar në lidhje me këto letra me vlerë nga ana e Minsitrisë së Financave paraqitet në faqen zyrtare sipas së cilës raportohet se:

- Në total janë emëtuar 74.9 miliard lekë bono privatizimi
- Janë shpërndarë publikut 51.2 miliard lekë
- Nga 51.2 miliard lekë janë përdorur nga publiku 10 miliard lekë në proces privatizimi ndërkohë që mbeten të shpërndara dhe të papërdorura pjesa tjetër prej 41 miliard lekë.

[Shqiptarja.com]

Nga të dhënat e administruara nga Banka e Shqipërisë, si palë e ngarkuar me printimin dhe asgjësimin e këtyre letrave me vlerë konstatohet se:

Tabela 81: Bonot e privatizimit të emetuara

Pershkrimi	Prerjet ne numer sipas vlerës nominale				Gjithsej ne cope	Gjithsej ne vlere (mijë lekë)
	40,000	20,000	15,000	10,000		
Prodhuar faza e pare		326,700	529,900	630,000	1,486,600	20,782,500
Prodhuar faza e dyte	1,350,000	426,000			1,776,000	62,520,000
Shuma e printuar gjithsej	**1,350,000**	**752,700**	**529,900**	**630,000**	**3,262,600**	**83,302,500**
Furnizuar Bankat Tregtare	**1,148,294**	**668,870**	**481,550**	**619,100**	**2,917,814**	**72,723,410**
Gjendja ne BSH ne 31.12.2017	**201,706**	**83,830**	**48,350**	**10,900**	**344,786**	**10,579,090**
Bono te derguara per asgjesim pas perdorimit	**341,028**	**324,289**	**297,937**	**315,498**	**1,278,752**	**27,750,935**
deri ne 12/2004	69,415	174,526	240,417	263,408	747,766	12,507,455
2005-05/2015	168,964	99,993	38,318	30,679	337,954	9,639,980
05/2015-31.12.2016	78,649	38,770	17,202	18,411	153,032	4,363,500
01/2017-12/2017	24,000	11,000	2,000	3,000	40,000	1,240,000
Urdher asgjesimi nr.7040 date 19.11.2004	69,415	174,526	240,417	263,408	747,766	12,507,455
Urdher asgjeismi nr.3123 date 11.05.2015	168,964	99,993	38,318	30,679	337,954	9,639,980
Urdher asgjesimi nr.2833 date 30.05.2016	55,649	28,770	12,202	14,411	111,032	3,128,500
Urdher asgjesimi nr. 5812 date 21.12.2016	23,000	10,000	5,000	4,000	42,000	1,235,000
Asgjesuar deri 12/2016	**317,028**	**313,289**	**295,937**	**312,498**	**1,238,752**	**26,510,935**
Ne pritje te asgjesimit 12/2017	**24,000**	**11,000**	**2,000**	**3,000**	**40,000**	**1,240,000**
Bono te pakthyera ne BSH deri 12/2016	**831,266**	**355,581**	**185,613**	**306,602**	**1,679,062**	**46,212,475**
Bono te pakthyera ne BSH deri 12/2017	**807,266**	**344,581**	**183,613**	**303,602**	**1,639,062**	**44,972,475**

Diferenca kryesore ndërmjet dy institucioneve qëndron në shifrat e raportuara mbi sasinë fillestare të emëtuar dhe gjendjen e bonove të cilat janë shpërndarë dhe janë ende pa kthyer për asgjësim në Bankën e Shqipërisë. Në këtë mënyrë, nga ana e Bankës së Shqipërisë raportohet të jenë shpërndarë për tu emëtuar 72.7 miliard lekë, ndërkohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton së janë emëtuar 74.9 miliard lekë bono privatizimi.

Të dhënat e publikuara janë kontradiktore edhe për sasinë e përdorur deri në vitin 2015. Ministria e Financave dhe Ekonomisë sipas raportimit të bërë në Mars 2015 deklaron se në procesin e privatizimit janë përdorur 10 miliard lekë, ndërkohë që sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë rezulton se deri në Maj 2015 janë asgjësuar rreth 22 miliard lekë bono privatizimi. Nga ana tjetër, sipas raportimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në vitin 2015 rezulton se janë emëtuar por nuk janë shpërndarë rreth 23.7 miliard lekë (74.9 miliard lekë të emëtuara – 51.2 miliard të shpërndara publikut), ndërkohë që sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë pas kërkesës së grupit të auditimit rezulton gjendje të emëtuara por të pashërndara gjendje në arkën stok rreth 10.6 miliard lekë.

lsnqiptaria.com

Banka e Shqipërisë sqaron se nga viti 2004 nuk ka shpërndarë më bono. Në këtë mënyrë, duke qenë se nga viti 2004 nuk janë shpërndarë më bono, dhe sasia e bonove të pashpërndara është 10.6 miliard që nga viti 2004 e deri më sot, informacioni zyrtar i paraqitur nga Banka e Shqipërisë është i ndryshëm nga ai i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që pohon se shuma e bonove të emëtuara por të pashpërndara është në shumën 23.7 miliard lekë, me një diferencë prej 13.1 miliard lekë bono privatizimi. Në këtë mënyrë, diferencat e mësipërme janë tepër domethënëse për dobësitë që e kanë përcjellë procesin e emëtimit, shpërndarjes, përdorimit dhe asgjësimit të bonove të privatizimit. Efekti i këtyre ndryshimeve në të dhënat e publikuara mbetet edhe më problematik duke marrë në konsideratë faktin që Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton që janë të shpërndara dhe të papërdorura në Mars 2015 rreth 41 miliard lekë, ndërkohë që Banka e Shqipërisë vlerëson se janë aktualisht të shpërndara dhe të pakthyera në vitin 2017 rreth 45 miliard lekë bono privatizimi. Efekti i shumës prej 4 miliard lekë në mosrakordim mund të jenë më së paku bono privatizimi të cilat janë përdorur po nuk janë sjellë për asgjësim në Bankën e Shqipërisë, të cilat në çdo kohë mund të rifuten në treg.

Në nenin 1 të VKM nr. 283 datë 30.04.1996 "Për dorëzimin dhe asgjësimin nga Banka e Shqipërisë të bonove të privatizimit mbas përdorimit"është përcaktuar që **të gjitha bonot e privatizimit të grumbulluara** në Bankën Kombëtare Tregtare dhe në Agjesinë Kombëtare të Privatizimit, **mbasi të jenë përdorur, do të dorëzohen në Bankën e Shqipërisë**. Në vijim në nenin 2 është përcaktuar asgjësimi nga ana e Bankës së Shqipërisë në përputhje me rregullat që veprojnë edhe për vlerat monetare, duke patur në përbërje të komisionit të asgjësimit edhe punonjës të Ministrisë së Financave. Për të siguruar që të gjitha bonot e përdorura janë asgjësuar nevojitet një procedurë rakordimi ndërmjet njësive që evidentojnë përdorimin dhe atyre që realizojnë asgjësimin. Bankat tregtare dorëzojnë në BSH sipas VKM, sasitë e grumbulluara prej tyre, sipas dokumentacionit përkatës për këtë qëllim (dërgesa me prerje dhe sasi) dhe jo dokumentacionin e përdorimit qëllimor të tyre.

Grupi i auditimit, me qëllim rakordimin dhe kryqëzimin e të dhënave dërgoi kërkesë për informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të së cilës në terma sasior u referua vetëm vlera e bonove të përdorura përgjatë vitit 2017 në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike e cila referoi se për vitin 2017 vlera e bonove të privatizimit e përdorur në procesin e privatizimit të pronës publike e rakorduar edhe me Raiffeisen Bank është në shumën 82.3 milionë lekë. Nga ana tjetër, në Bankën e Shqipërisë rezulton se janë dorëzuar bono privatizimi nga ana e Bankës Credins në shumën 1.24 miliard lekë për vitin 2017. Lejimi i përdorimit të bonove të privatizimit në Bankën Credins dhe pranimi i bonove të privatizimit për asgjësim nga Banka Credins është në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr. 283 datë 30.04.1996 "Për dorëzimin dhe asgjësimin nga Banka e Shqipërisë të bonove të privatizimit mbas përdorimit" është përcaktuar që *"Të gjitha bonot e privatizimit të grumbulluara e të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare dhe në Agjensinë Kombëtare të Privatizimit, mbasi të jenë përdorur, do të dorëzohen në Bankën e Shqipërisë.*

Nga auditimi rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e mësipërme duke qenë se janë pranuar për asgjësim bono privatizimi nga subjekte të cilat nuk janë të autorizuara për pranimin e tyre. Nga ana tjetër evidentohet edhe fakti i mosdorëzimit të bonove të grumbulluara përgjatë vitit në banka të tjera të nivelit të dytë. Mos dorëzimi i bonove të përdorura përgjatë vitit dhe të

[Shqiptaria.com]

grumbulluara nga Raiffesen Bank, mbështet konstatimin mbi monitorimin e dobët të këtij procesi dhe efektet e mundshme të rifutjes në qarkullim që ka mosdorëzimi në kohë i bonove të privatizimit për asgjësim. Në këtë mënyyrë, duke qenë se nuk ka një procedurë rakordimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë (përgjegjëse për asgjësimin), Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (përgjegjëse për evidentimin e shumave të përdorura) si dhe bankave të nivelit të dytë të autorizuara (përgjegjëse për pranimin e bonove të përdorura), nuk krijohet siguri që të gjitha bonot e përdorura përgjatë vitit, të pranuara në bankat e nivelit të dytë, të jenë dorëzuar për asgjësim në Bankën e Shqipërisë.

[shqiptarja.com]

7. ADMINISTRIMI I SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR

Sektori i energjisë në paaftësi paguese

Viti 2017, paraqet një performancë jo të mirë të kompanive me kapital shtetëror të cilat veprojnë në sektorin energjitik. Risku i kreditit të këtyre kompanive ka vendosur në vështirësi buxhetine shtetit duke kryer pagesa të vazhdueshme në lidhje me garancitë jo performuese si dhe në formën e mbështjeve buxhetore. Referuar pozicionit financiar dhe obligimeve që këto kompani kanë ndaj shtetit, krahasuar dhe me një vit më parë, situata paraqitet:

Tabela 82: Borxhi i sektorit të energjisë sipas shoqërive *mijë lekë*

LLOJI I TË DREJTËS	KESH	OST	OSHEE	TOTALI
Nenhua	3,677,334	1,552,651		5,229,985
Garanci	2,887,762	1,390,652		4,278,414
Mb. Buxhetore	2,500,000			2,500,000
Borxh Tatimor	8,363,592		10,442,684	18,806,276
TOTALI 31.12.2016	17,428,688	2,943,304	10,442,684	30,814,675
Nenhua	6,760,919	2,635,352		9,396,271
Garanci	4,408,912	2,530,443		6,939,355
Mb. Buxhetore	1,500,000		2,500,000	4,000,000
Borxh Tatimor	2,928,405		6,081,070	9,009,475
TOTALI 31.12.2017	15,598,236	5,165,795	8,581,070	29,345,101

Rritja vjetore e mbështetjes buxhetore ndaj OSHEE është realizuar me dy kredi në formën e mbështetjes buxhetore në shumën 2.5 miliard lekë. Rritja e detyrimeve prej nënhuave nga ky sektor paraqitet në rreth 4 miliard lekë, ndërkohë që rritja e detyrimeve nga garancitë vlerësohet 2.6 miliard lekë

Sektori i ujësjellësave

Kompanitë me kapital shtetëror përgjegjëse për administrimin e veprimtarisë së ujësjellës kanalizimeve vlerësohet që në një pjesë të tyre të kenë performancë të dobët për sai përket marrëdhënieve të nënhuasë dhe në të njejtën kohë dhe garancive për projekte specifike. Të drejtat e shtetit për të arkëtuar nga këto kompani në krahasim me një vit më parë paraqiten:

Tabela 83: Dinamika e nënhuasë dhe garancivenë sektorin e ujësjellsave *mln lekë*

Viti	Nenhua	Garanci	TOTALI
2016	4,908	1,170	**6,079**
2017	5,656	1,309	**6,966**

Institucioni	Detyrimi 01.01. 2017	Detyrimi 31.12.2017	Rritja vjetore
Ujesjelles	4,908	5,656	748
Ujesjellesi Vlore	*1,528*	*1,743*	*215*
Ujesjellesi Korce	*780*	*1,002*	*222*
Ujesjellesi Durres	*1,040*	*1,147*	*107*
Te tjera ujesjelles	*1,559*	*1,763*	*204*

Për Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitit 2017, nga Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike janë përfshirë 14 subjekte (këtu do të përfshihen dhe auditimet që do evadohen brenda datës 30.09.2018), për të cilat ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 2,300,463 mijë lekë dhe përdorim pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike në vlerën 208,793 mijë lekë.

[Shqiptaria.com]

Gjatë vitit 2017, KLSH ka audituar subjektet e mëposhtme

1 Albpetrol SHA (Evaduar në 2016)
2 KESH SHA (Evaduar në 2017)
3 KESH SHA (Evaduar në 2018)
4 Ujësjellës Kanalizime SHA Shkodër
5 Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar
6 Porti Detar SHA Vlorë
7 Porti Detar SHA Sarandë
8 Hekurudha Shqiptare SHA
9 Ujësjellës Kanalizime SHA Korçë
10 Spitali Rajonal Vlorë
11 Spitali Psikiatrik "AliMihali" Vlorë
12 Spitali Rajonal Fier
13 Spitali Rajonal Shkodër
14 Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"

1. Në fushën e Energjitkës dhe Hidrokarbureve. Pjesë e subjekteve të përfshira në kategorinë e energjisë janë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) SHA dhe Albpetrol SHA. Për vitin buxhetor 2017, për këto subjekte ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 2,196,012 mijë lekë dhe përdorim pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike në vlerën 162,832 mijë lekë.

- Për shoqërinë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)" SHA. Auditimi në Shoqërinë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)" SHA Tiranë, ka patur objekt "Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare" për periudhën nga data 01.01.2017 deri me datë 31.12.2017.
-Pavarësisht angazhimit të kësaj shoqërie për optimizimin e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, dhe megjithëse vërehet dukshëm se treguesit e performancës ekonomiko-financiare janë përmirësuar, përsëri kjo shoqëri mbetet në situatë të vështirë financiare për shkaqe të natyrës ligjore dhe rregullatore, jashtë kontrollit të shoqërisë, ku me kryesorët jane: i) mostrajtimi i borxheve të mëdha të akumuluara në funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë, ii) moscaktimi i një çmimi të arsyetuar shitje energjie që të reflektojë/mbulojë kostot e operimit dhe veprimtarisë statutore dhe ligjore të kësaj shoqerie, iii) ngadalësimit të zbatimit të reformave të sektorit në frymën e parashikimeve të Ligjit nr 43/2015, pra është vonuar derregullimi i veprimtarisë së kësaj shoqërie dhe iv), si dhe ngarkimit të detyrimeve financiare tej mundësive të shoqërisë
Nga auditimi u konstatuan dhe shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore me një dëm ekonomik për "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën 1,694 milionë lekë ose 12,700,635 euro, si dhe efekt negativ financiar nga nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjes me shoqërinë "Energji Ashta" dhe proceset gjyqësore për zgjidhje të pa arsyeshme të kontratave të punësimit në vlerën 151,467 mijë lekë ose 1,135,435 euro. Shkaku i kësaj situate: ERE me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka krijuar problematikë serioze në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe VKM nr. 244 datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik", i ndryshuar, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të shoqërisë "KESH" SHA, si dhe të Shtetit, pasi me vendimet e saj të deritanishme "Për miratimin e rregullave të tregut", paraqet paqartësi dhe madje konflikt të vetë dispozitave të rregullave të tregut, të cilat nuk janë hartuar në frymën e Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nuk janë përshtatur me

periudhën tranzitore, e cila do të sillte kalimin normal në rregullat përfundimtare miratuar sipas modelit të tregut, duke u shfaqur si rregulla në zbatim të parashikimeve të Ligjit të vjetër. Konkretisht: Vendimi i ERE nr.111 datë 01.07.2016 "Mbi lënien në fuqi të Vendimeve nr.139, nr.141, nr.145, nr.146, nr.147, nr.148, datë 26.12.2014, Vendimi i ERE nr.136, datë 15.08.2016 "Për miratimin e kontratës TIP për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga Shteti/KESH SHA dhe furnizuesit e shërbimit universal OSHEE SHA për periudhën 01.07.2016-31.12.2016. Edhe pse, përveç detyrimit ligjor në rolin e monitoruesit të shoqërive publike të tregut të energjisë, ERE ka përfituar nga Shoqëria "KESH" për periudhën viti 2014-2016, vlerën 101,406,642 lekë, në zbatim të tarifave rregullatore të vendosura çdo vit nga vetë ajo. Problematika të tjera të konstatuara me dëm ekonomik:

1. Në fushën e transaksioneve shit/blerjes së energjisë elektrike në vlerën 1,582,301 mijë lekë, ose 11,861,327 euro, shkaktuar si rrjedhojë e Marrëveshjes me Shoqërinë "OST" e miratuar me vendim të Bordit të ERE nr. 79/2016 "Për shërbimet ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik" në vlerën 1,204,546 mijë lekë ose 9,029,580 euro, si dhe nga mos miratimi plotësisht i të gjitha aktet nënligjore e rregullatore në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ka krijuar mundësinë që kompanitë EFT AG, GEN-I Tiranë, AXPO Beograd, dhe GSA etj, ta blejnë energjinë nga Shoqëria "KESH" SHA me çmim në vlerat 11.11 deri në 61.14 euro dhe tja shesin Shoqërisë "OSHEE" SHA në vlerën 56.6 deri në 95.5 euro, me një dëm pa mundësi arkëtimi në vlerën 377,755 mijë lekë ose 2,831,747 euro.

2. Në fushën e prokurimeve publike në vlerën 99,345 mijë lekë ose 744,718 euro, shkaktuar si rrjedhojë rëndimit padrejtësisht kostos së investimit dhe zbatimit të kontratave të prokurimit për punët civile.

3. Privatizimi i magazinës Shkozet i kryer nga Ministria e Financave dhe regjistrimi nga ZVRPP Durrës, kryer jo vetëm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke krijuar një dëm ekonomik për shoqërinë "KESH" SHA dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën 12,618 mijë lekë, ose 94,590 euro.

- Për shoqërinë Albpetrol SHA, pjesë e këtij raporti është vetëm 3 mujori i fundit i vitit 2016, për arsye se për shkak të pengesave artificiale nga vetë shoqëria Albpetrol SHA, në nisjen e auditimit të planifikuar gjatë vitit 2017, nuk u bë i mundur raportimi i këtyre vlerave në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitit 2016.

Dëm ekonomik i konstatuar është vlerën **500,193 mijë lekë**, i konstatuar nga auditimi i zbatimit të kontratave koncensionare për marrëveshjet hidrokarbure, si dhe nga ankandet për shitjen e naftes bruto.

Si pasojë e shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara gjerësisht në raportin e auditimit i është shkaktuar shoqërisë Albpetrol sh.a, një dëm ekonomik në vlerën totale **rreth 501,700,000 lekë** si dhe përdorim pa efektivitet dhe pa ekonomicitet të fondeve publike në vlerën totale **12,053,033 lekë**. Në mënyrë të detajuar, dëm ekonomik dhe përdorim pa efektivitet dhe pa ekonomicitet paraqitet si më poshtë:

-Në zbatim të kontratës nr. 531/10, datë 02.03.2016, për shitjen e sasisë së naftës prej 30.000 Tonë, nga data 02.03.2016 deri në datën 19.12.2016, Albpetroli i ka shitur naftë bruto shoqërisë "Porto Romano Oil" në sasinë 30.551,143 Ton dhe ka arkëtuar të ardhura nga shitja e kësaj sasie 658,447,853.248 lekë, pa TVSH dhe 777,723,724.438 lekë, me TVSH dhe

[shqiptaria.com]

kontratës nr. 7805/15, datë 17.12.2016, për shitjen e sasisë së naftës prej 167,000 Tonë, nga data 17.12.2016 deri në datën 30.12.2016, Albpetroli sh.a, i ka shitur naftë bruto shoqërisë "Porto Romano Oil" në sasinë 8.899,73 ton dhe ka arkëtuar të ardhura nga shitja e kësaj sasie, 251,314,044.87 lekë, pa TVSH dhe 301,576,853.85 lekë, me TVSH.

Nafta e shitur është tërhequr nga shoqëria "Porto Romano Oil" në stacionet e naftës brenda Albetrolit. Nga sasia totale e shitur, kanë shkuar për eksport vetëm 1.398,642 Ton. Për këtë sasi në përudhje me kontratën nga faturat e shitje janë zbritur, kostot e transportit, magazinim, stokimit, etj, që janë përcaktuar në kontratë 3.53 USD/Fuçi ose 22.1684 USD /Toni. Duhet theksuar, që kostot e transportit magazinim, etj, prej 22.1684 USD/Toni, janë kosto shitje të të planifikuara nga ASH në dokumentet e ankandit, të cilat janë kryer në fakt dhe duheshin zbritur, sepse nafta prej 1.398,642 Ton nga pikat e lëvrimit të Albpetrolit është transportuar, magazinuar, ngarkuar, etj, në anije në Portin e Vlorës bazuar dhe këto shpenzime janë të justifikuar në dokumentet shoqërues, si fatura tatimore shitje, fatura doganore,etj.

Ndërsa, e gjithë sasia tjetër e naftës e tërhequr nga këto stacione është transportuar për përpunim në tregun e brendshëm në rafinerinë ARMO, në Ballsh. Nga çmimi i shitjes së naftës brent, çdo fature shitjeje i janë zbritur, kostot e transportit magazinim, stokimit, etj, të cilat përfaqësojnë koston e planifikuar, të transportit nga pikat e grumbullimit të Albpetrolit në portin e Vlorës dhe koston e planifikuar të magazinimit në këtë Port nëse nafta do të shkonte për eksport.

Pra për sasinë e shitur në tregun e brendshëm, janë zbritur gabimisht për te dy kontratat shpenzime transporti në vlerën 1,469,755 USD të cilat nuk janë arkëtuar në llogaritë e Albpetrolit, por janë përfituar padrejtësisht nga shoqëria blerëse "Porto Romano Oil".

Po kështu nuk duhet të zbriteshin edhe kostot e planifikuara të magazinimit, stokimit, etj, të cilat sipas Dokumenteve të Ankandit përfaqësojnë shpenzimet e planifikuara që do të kryheshin nga Albepetroli në pikën e grumbullimit në Portin e Vlorës deri në ngarkimin e Anijes. Në fakt, sipas faturave të pagesave, këto shpenzime nuk janë kryer as nga Albetroli dhe as nga vetë shoqëria blerëse "Porto Romano Oil" sepse, nafta bruto e tërhequr nga stacionet e Albpetrolit ka shkuar direkt në rafinerinë ARMO në Ballsh dhe nuk është kryer asnjë shpenzim për magazinimin e kësaj sasie nafte.

Pra për sasinë e shitur në tregun e per te dy kontratat janë zbritur gabimisht edhe shpenzime magazinimit, stokimit, etj, në vlerën 2,696,331 USD.

2. Në fushën e Infrastrukturës. Pjesë e subjekteve të përfshira në kategorinë e infrastrukturës janë Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC), Hekurudha Shqiptare SHA, Porti Detar SHA Sarandë, Porti Detar SHA Vlorë, Ujësjellës Kanalizime SHA Shkodër dhe Ujësjellës Kanalizime SHA Korçë.

Për vitin buxhetor 2017, për këto subjekte ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 92,394 mijë lekë dhe përdorim pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike në vlerën 45,056 mijë lekë.Për auditimin e ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar Auditimi në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar, ka patur objekt "Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare" për periudhën nga data 01.01.2017 deri me datë 31.12.2017, nga ku

rezultuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi të cilat kanë ndikuar në performancën e këtij institucioni, ardhur kjo edhe si pasojë e ndryshimit të shpeshtë të drejtuesve kryesorë të Institucionit. Nga auditimi u konstatuan dhe shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore me një dëm ekonomik për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën 75,484 mijë lekë, si dhe efekt negativ financiar në vlerën 19,852 mijë lekë. Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar shkeljet me dëm ekonomik, ka rezultuar:

1. Në fushën e të ardhurave në vlerën 52,357 mijë lekë, vlerë e cila përbëhet nga të ardhurat e realizuara por të papërdorura që AAC i detyrohet ndaj Buxhetit të Shtetit për vitin buxhetor 2017. Në lidhje me këtë detyrim, nga strukturat drejtuese të AAC, nuk janë marrë masa për kalimin e këtyre fondeve për llogari të Buxhetit të Shtetit, duke i mbajtur këto fonde në llogari rrjedhëse në bankat e nivelit të dytë, në lekë dhe valutë.

2. Në fushën e prokurimeve publike në vlerën 14,450 mijë lekë, shkaktuar si rrjedhojë e shkeljeve të rezultuara në procedurat e prokurimit publik dhe realizimit të tyre.

3. Në fushën e shpërblimeve në vlerën 8,677 mijë lekë, që përbën shpërblimin për lejen vjetore të pakryer, edhe pse punonjësit e institucionit e kanë kryer lejen vjetore. Efekti negativ financiar në vlerën 19,852 mijë lekë, ka ardhur si pasojë e pagesave për shpenzime operative të kryera në kundërshtim me parimet e menaxhimit financiar publik.

3. Në fushën e Shëndetësisë. Pjesë e subjekteve të përfshira në kategorinë e shëndetësisë janë Spitali Rajonal Vlorë, Spitali Psikiatrik "AliMihali" Vlorë, Spitali Rajonal Fier, Spitali Rajonal Shkodër dhe Qendra Universitare "Shefqet Ndroqi" Tiranë.Për vitin buxhetor 2017, për këto subjekte ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 12,056 mijë lekë dhe përdorim pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike në vlerën 905 mijë lekë. Disa nga gjetjet kryesore që KLSH ka konstatuar në fushën e shëndetësisë janë:

-Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në funksionimin e strukturave drejtuese, konstatohet se: Rregullorja e funksionimit të Spitaleve, nuk është miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, por në shumë raste është miratuar nga drejtuesit e spitaleve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 23; Në shumë raste nuk janë marrë masa për ngritjen e Këshillit Administrativ të Spitalit, e për pasojë detyrat e këtij këshilli janë kryer nga drejtuesit e Spitalit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë"; si dhe në shumë raste nuk janë marrë masa për miratimin e Rregullores së funksionimit të komisionit mjekësor, në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë".

-Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, konstatohet se spitalet në kryerjen e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të kontratës, kryesisht nuk kanë mundur të vërtetojnë, argumentojnë dhe dokumentojnë se nevoja ekstreme apo situata emergjente ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të vetë AK, si dhe nuk kanë vërtetuar nevojën e kryerjes së këtyre procedurave, e për pasojë këto procedura nuk duheshin zhvilluar me negocim por duhet të zhvilloheshin procedura të hapura në zbatim të LPP. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e mos kryerjes së trajnimeve të stafit që merret me procedurat e prokurimin publik.

-Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore, konstatohet se në dhënien me qira të ambienteve nga

[shqiptaria.com]

spitalet, nuk është zhvilluar në përputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore", për arsye se në shumë raste nuk janë zhvilluar procedura konkurimi, janë lidhur nga vetë spitalet kontrata mbi 1-vjeçare dhe mbi 200 m^2, në tejkalim të kompetencave administrative nga drejtuesit e spitaleve, janë lidhur kontrata qiradhënieje pa marrë më parë miratimin e Ministrit të Shëndetësisë, si dhe nuk është ndjekur zbatimit i këtyre kontratave në mënyrë të duhur nga instancat drejtuese të spitaleve.
-Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave, konstatohet se nuk është marrë miratimi i Ministrit për punësimet dhe largimet e kryera nga drejtuesit e spitaleve, si dhe nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, janë shkaktuar efekte financiare negative në vlera të konsiderueshme për buxhetet e spitaleve.
- Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin Portual Durrës është konstatuar **<u>për vitin buxhetor 2017</u>**, **dëm ekonomik** në vlerën **126,577 mijë lekë** dhe **efekte financiare negative** në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **66,507 mijë lekë**.

Të ndarë sipas kategorive, dëmi ekonomik paraqitet si më poshtë vijon:

- Shpenzime operative në vlerën 1,386 mijë lekë,
- Në fushën e investimeve (prokurime publike dhe zbatim kontratash) në vlerën 124,675 mijë lekë,
- Në fushën e të ardhurave nga qiraja në vlerën 516 mijë lekë.

Efekti financiar negativ, i ndarë sipas kategorive paraqitet si më poshtë vijon:

- Të ardhura nga qiratë & privatizimi, koncesionet në vlerën 4,282 mijë lekë,
- Paga dhe shpërblime në vlerën 62,135 mijë lekë,
- Shpenzime Operative në vlerën 90 mijë lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave koncensionare, u konstatua se:
Detyrimi që Konçesionari "EMS-APO" duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 2,069,371,737 lekë. Deri në datën 27.07.2018, nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MIE, si autoritet kontraktor për këtë kontratë koncesionare për investimin e kryer.
Detyrimi që Konçesionari AFTO duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 4,143,000 EURO. Deri në datën 27.07.2018, nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MIE, si autoritet kontraktor për këtë kontratë koncesionare, për investimin e kryer.
Detyrimi që Konçesionarit DCT duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 32,500,000 USD. Deri në datën 27.07.2018, nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MIE, si autoritet kontraktor për këtë kontratë koncesionare, për investimin e kryer.
Për këtë situatë, nga APD i është kërkuar informacion zyrtar njësisë së zbatimit të projektit pranë MIE, me shkresën nr. 2362 prot, datë 30.05.2018, e cila nuk ka vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni në lidhje me investimet e kryera nga kompanitë koncesionare EMS-APO, DCT, edhe pse është një detyrim kontraktual.

Shqiptaria.com

-Në 4 raste nga zhvillimi i procedurave të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 10,846 mijë lekë.
-Në 10 raste, zbatimi i kontratave për punë/mallra/shërbime, është kryer jo në përputhje me kontratën e lidhur, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 113,829 mijë lekë.
-Në një rast, nuk janë paguar detyrimet kontraktuale në vlerën 516 mijë lekë, për dhënien me qira të sheshit, vlerë e cila përbën dëm ekonomik përllogarit të APD.
-Drejtori të Përgjithshëm Ekzekutiv në kundërshtim me marrëveshjen konçensionare, ka autorizuar dhe ka lejuar procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjve të erës nga kompania EMS-APO dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër terminalet e tij, sipas profilit të mallrave. APD-ja disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjve të erës, duke krijuar një të ardhur të munguar për APD-në dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën 4,281,902 lekë.
-Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, u konstatua efekt financiar negativ në vlerën 62,135 mijë lekë, ardhur si pasojë e zgjidhjes së pa arsyeshme të kontratave të punësimit në vlerën 13,820 mijë lekë, pagesa shpërblime për punonjësit dhe anëtarët e Këshillit Drejtues në vlerën 42,644 mijë lekë dhe punësim mbi strukturën organike të miratuar në vlerën 5,671 mijë lekë.

[shqiptarja.com]

8. KEQADMINISTRIMI I SKEMËS SË RIMBURSIMIT TË TVSH

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në kundërshtim me pikën 4 të nenit 125 të Rregullores nr. 19 datë 22.02.2017 "Për Funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore" nuk disponon një regjistër të standardizuar të miratuar me të dhëna të plota mbi kërkesat e regjistruara për rimbursim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Megjithëse dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e rimbursimit të TVSH si datë kërkese i referohen datës së kërkesës elektronike, prej DPT vijohet ende me datat e kërkesës shkresore në kundërshtim me këto dispozita.

Prej grupit të auditimit u kërkua informacion i plotë lidhur me rastet e kërkesave për rimbursim, numrin e atyre të aprovuara, në proçes, të refuzuara etj. Prej DRTVSH na janë vënë në dispozicion 2 tabela me përmbajtje të ndryshme si për sa i përket numrit të rasteve të trajtuara por edhe gabime sa i përket të dhënave identifikuese të subjekteve apo dhe shumave të tyre. Nga ana tjetër të dhënat e tabelave të dërguara nuk rakordojnë me të dhënat e regjistrit elektronik të gjeneruar prej sistemit C@ts. *Këto mospërputhje nuk i japin audituesit të jashtëm një siguri të arsyeshme lidhur me rastet dhe vlerat e trajtuara nga ana e DRTVSH-së për rimbursim*.

Nga të dhënat e rregjistrit fillestar të kërkesave për rimbursim rezulton sa paraqitur në tabelë.

Tabela 84: Rregjistrit fillestar të kërkesave për rimbursim

Nr.	Emertimi	Ne numer	Ne vlere (mln lekë)
1	Kërkesa për rimbursim të miratuara	901	22,859
2	Kërkesa për rimbursim të pamiratuara nga kontrolli	13	115
3	Tërheqje nga kerkesa per rimbursim	3	78
4	Kërkesa për rimbursim në proçes kontrolli	27	6,221
5	Për trajtim nga ana e DRT Tirane	1	15
Shuma		945	29,288

Stoku i kërkesave për rimbursim TVSH në fund të vitit 2016, të miratuar dhe të pa likujduar rezulton në vlerën 4,233 milionë lekë. Për vitin 2017, rezulton se është kërkuar dhe çertifikuar për rimbursim vlera 22,490 miliardë lekë e cila përbëhet nga vlera e transferuar për detyrime të tjera 1,528 miliardë lekë dhe për likujdim nga kërkesat vetëm të vitit 2017 ka rezultuar vlera 20,963 miliardë lekë. Gjatë vitit 2017, janë likujduar gjithsej 13,774 milionë lekë. Nga analiza e të dhënave konstatohet se kanë mbetur pa likujduar deri më datë 31.12.2017, kërkesa të miratuara në vlerën **11,422 milionë lekë** (stoku). Megjithëse kjo shumë ka plotësuar kushtet ligjore për rimbursim dhe është çertifikuar nga administrata tatimore ajo nuk rezulton e evidentuar në regjistrat e detyrimeve të DPT-së si angazhim i marrë. Vlera e mësipërme për arsye teknike në sistemin tatimor C@ts është e *"ngrirë"* dhe nuk paraqitet në kredinë tek llogaria e tatimpaguesit në këtë sistem pavarësisht se prej DPT nuk është lëshuar urdhërpagesa Format nr.4 dhe likuidimi i kësaj shume ende nuk është kryer. Kjo vlerë përfaqson të drejta të subjekteve përfitues dhe detyrime të DPT ndaj tyre, por nuk pasqyrohet si detyrim i lindur dhe i kontabilizuar *"de facto"* prej DPT më datë 31.12.2017 por qëndron *pezull* në mënyrë të pajustifikuar në këtë datë duke denatyruar situatën financiare të njësisë publike por dhe të tatimpaguesit njëkohësisht.

Nga auditmi konstatohet se, sipas të dhënave elektronike të DPT të gjeneruara prej sistemit informatik C@ts të përpunuara nga ana jonë konstatohet në 586

raste nga 901 kërkesa të trajtuara, janë tejkaluar afatet e rimbursimit për një vlerë rimbursimi prej **11,171 milionë lekë.** Kjo vlerë përfaqëson 65% të kërkesave ose rreth 50% të vlerës totale të rimbursimit për vitin 2017. Kështu n**ë 30 raste** kërkesat e depozituara kanë marrë aprovimin e parë në sistem prej inspektorit për miratimin e shumës së rimbursuar por nuk rezultojnë veprime të tjera për ngrirjen e shumës së kredisë. Konstatohen tejkalime të afateve në të gjitha këto praktika me mbi 100 dite në 300 ditë vonesë. Vlera e rimbursimit e cila duhet të shqyrtohej brenda afateve 30-60 ditë paraqitet **77 milionë lekë**. **Në 131 raste** kërkesat e depozituara kanë marrë aprovimin e parë në sistem për miratimin e shumës së rimbursuar por këto raste nuk rezultojnë të përfunduara në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në të cilat parashikohet një afat nga 30 deri në 60 ditë për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim në varësi të kategorizimit të aktivitetit exportues/joeksportues. Konstatohen tejkalime të afateve në të gjitha këto praktikat me mbi 90 dite në 550 ditë vonesë. Vlera e cila duhet të rimbursohej brenda afateve 30-60 ditë paraqitet **561 milionë lekë**. **Në 425 raste** kërkesat e depozituara elektronikisht kanë marrë aprovimin përfundimtar në sistemin informatik tatimor C@ts mbi afatin maksimal 60 ditor, afat i cili shkon deri në 405 ditë pa marrë në konsideratë kohën kur është kryer pagesa e cila nuk paraqitet në formular, por që bëhet në kohë më të vonshme se plotësimi i të dhënave elektronike. Vlera e cila është proçeduar në thyerje të afateve të parashikuara ligjore paraqitet **10,533 milionë lekë**.

Nëse do ti referohemi likujdimeve të kryera gjatë vitit 2017 rezulton se pothuajse në të gjitha rastet e pagesave prej 13,774 milionë lekë, kemi thyerje të radhës së rimbursimit nisur jo vetëm prej afateve të parashikuara ligjore por edhe datës së miratimit të rimbursimit pas plotësimit të kushteve proceduriale të administratës tatimore. Mosrespektimi ka ndikime të rëndësishme në marëdhëniet administratë-tatimpagues, krijon selektivitet, ekspozon njësinë drejt risqeve financiare por gjithashtu pasqyron një model aspak pozitiv në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji, ku vet administrata tatimore e cila efektivisht duhet të jet "*gardian*" i tij e thyen në mënyrë të vetëdijshme atë.

Risk të lartë në vlerësimin tonë si auditues të jashtëm shtetëror paraqet edhe procesi i trajtimit nga ana e administratës tatimore të rasteve të rimbursimit të TVSH-së për kontratat koncesionare në fushën e energjisë (HEC), ku nga ana kësaj administrate çertifikohet dhe paguhet TVSH-ja për vlera punimesh të cilat tejkalojnë vlerat e kontraktuara me Shtetin Shqiptar të cilat janë të pamirtuara prej organeve kompetente sipas detyrimeve kontraktuale por dhe legjislacionit të fushës përkatëse. Konstatohet se mungojnë analizat dhe vlerësimet e hollësishëm të punimeve referuar projekteve, grafikut të punimeve të paraqitura etj. Në shumicën e rasteve grupet e kontrollit për këta tatimpagues të cilat kërkojnë vlera të mëdha financiare dhe kanë një numër të lartë transaksionesh përbëhen vetëm nga një inspektor duke rritur riskun operacional për trajtimin e duhur të tyre dhe duke e bërë kontrollin formal.

Megjithëse vlerat e punimeve për veprat e ndërtimit nuk janë përfunduar dhe testuar ende, për to vijon rimbursimi i TVSH-së pavarsisht riskut teknik për funksionimin e tyre dhe garantimin e të ardhurave të tatueshme në vijim të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit. Më poshtë paraqiten të dhënat analitike lidhur me pjesën dhe vlerën që këto kërkesa zënë në totalin e rimbursimit vjetor.

[shqiptarja.com]

Tabela 85: Pesha specifike e HEC-ve në totalin e rimbursimeve për vitin 2017

Emërtimi	Tatimpagues HEC-e	Gjithsej për vitin 2017	Pjesa që zënë HEC-et në %
Numri i kërkesave	15	901	1.7%
Vlera e miratuar në milionë lekë	4,993	22,491	22.2%

Prej shumës së mësipërme tatimpaguesi "A.A.E" SHA zë rreth 81.5% të vlerës totale të kërkuar prej tatimpaguesve HEC-e ose 18.1% të rimbursimit të miratuar në rang kombëtar. Nga auditimi u konstatua se, Tatimpaguesi "A.A.E" SHA rezulton të ketë depozituar pranë DPT kërkesën shkresore e cila mban nr. 2855 Prot datë 07.02.2017, për rimbursimin e TVSH-së kreditore të investimit të realizuar. Objekti është financimi, projektimi, ndertimi, vënien në punë, prodhimi, furnizimi, administrimi, mirembajtjen e hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fangut, dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Koncensionari tek Autoriteti Kontraktues, në zbatim të kësaj kontrate koncesioni.

Në vijim me shkresën nr. 2855/2 prot datë 21.02.2017 "për veprim" drejtuar DRT Tiranë, tatimpaguesi është kaluar për kontroll tatimor. Kontrolli tatimor është ushtruar në vend për TVSH periudha 01.01.2013 – 31.12.2016, e cila është e njëjtë me kërkesën për rimbursim të kërkuar prej subjektit. Kontrolli tatimor i mbajtur nga inspektori i kontrollit të DRT-Tiranë z. S.M, i asistuar edhe prej inxhinierit të autorizuar z.G.G është evaduar më datë 05.09.2017 dhe është dërguar në DPT ku është regjistruar me nr. 2855/5 prot datë 19.09.2017. Nga ana e kontrollit është përcaktuar shuma e njohur për rimbursim TVSH-je prej **4,072 milionë lekë**. Në total subjektit gjatë vitit 2017 subjektit i janë likujduar 749,982,475 lekë prej të cilave pagesat për kërkesën e vitit 2017 paraqiten 634,196,620 lekë ose rreth 15.6 % e shumës së miratuar për rimbursim.

Nga auditimi i kësaj praktike rimbursimi, dokumentacionit pjesë e praktikës si dhe të dhënave të subjektit në sistemin informatik C@ts konstatohet se

a. Nga ana e DRT-Tiranë për periudhën 01.01.2013-31.08.2015, është ushtruar efektivisht rikontroll tatimor në mënyrë të padrejtë dhe pa miratimin me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 85 të Ligjit 9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar pikat 85.2.

b. Sipas përshkrimit në raport kontroll por dhe të dhënave të publikuara rezulton se, me Vendimin nr. 365 datë 04.05.2011 Këshilli i Ministrave ka miratuar kontratën e koçesionit midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, në rolin e autoritetit kontraktues me bashkimin e përkohshëm të shoqërive "A.E.A.S" dhe "A.E" shpk në rolin e koçesionarit. Kontrata e lidhur midis palëve mban datën 02.05.2011 dhe nr. 5446 Rep dhe nr.1944 Kol. Në pikën 9 të kësaj kontrate është përcaktuar edhe vlera e investimit në shumën *16,322,955,740* lekë ose 100,020,746 Euro. Me Vendimin nr.5 datë 20.12.2012 KKT ka miratuar lejen e infrastrukturës për ndërtimin e 5 hidroçentraleve, Gojan, Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fangu në rrethin Pukë dhe Mat. Kontrata bazë koçesionare e lidhur midis palëve gjatë periudhave në vijim ka ndryshuar disa nga termat e saj dhe konkretisht me shtesë kontratën e koçesionit nr.1963 Rep dhe 417/4 Rep datë 16.05.2013 miratuar me VKM nr. 442 datë 22.05.2013 janë kryer ndryshimet në nenin 4 të saj "Periudha e Koçesionit", në vijim me shtesë kontratën e koçesioni nr.217 Rep dhe 68/1 Kol. datë 20.01.2017 miratuar me

VKM nr. 51 datë 25.01.2017 në të cilën midis të tjerave është ulur numri i hidroçentraleve nga 5 të tillë në 3 duke lënë në fuqi hidroçentralet e Peshqeshit, Ura e Fanit, Ura e Fangut dhe duke hequr hidroçentralet e Gojanit e Gjegjanit. Po kështu është ndryshuar neni 9 "Vlerësimi i investimeve" ku vlera e investimeve shkon në shumën *210,184,740 Euro*, ndryshime ka pësuar gjithashtu dhe neni 14 i kontratës bazë, "Sigurimi i Kontratës". Në Pasqyrat Financiare të depozituara nga ana e Shoqërisë për vitin 2016 në sistemin C@ts, rezulton se vlera e investimeve të paraqitura në Aktivet e Shoqërisë më datë 31.12.2016 konkretisht zëri "Aktive Afatgjata Materiale" paraqitet në shumën 28,959,587,233 lekë ndërsa TVSH e arkëtueshme në shumën 4,108,435,416 lekë. Të dy këto poste paraqiten në shumën totale 33,068,022,649 lekë pra 2-fishi i vlerës së parashikuar në kontratën bazë të konçesionit neni 9 i saj. Megjithëse rritja e vlerës së investimit ka ndryshuar duke u rritur afërsisht 2.1 herë krahasuar me vlerën fillestare, ky ndryshim ka ndodhur në muajin Janar 2017 ndërkohë që vlera deri në 31.12.2016 kishte kapërcyer limitet e parashikuara në kontratën bazë. Kontradiktor paraqitet fakti që në momentin e kontrollit realizimi i punimeve është në përshkruar i realizuar afërsisht në masën 96% të tij ndërkohë që vlera e investimit është rritur me rreth 110 milionë euro. Në raport kontrollin tatimor nuk sqarohet fakti nëse janë kryer punime në 2-hidroçentralet të cilët nuk do të përfundojnë dhe nëse janë kryer cila është vlera e realizuar e tyre dhe zërat e punimeve përkatëse pasi nuk do të jenë në vijim objekt i kontratës konçesionare. Pra deri më datë 31.12.2016 nga ana e konçesionarit janë drejt përfundimit 3 hidroçentrale të cilë kanë kushtuar 2 herë më tepër se kostoja e planifikuar për 5-hidroçentrale të tillë në kundërshtim kjo me përcaktimet në nenin 9 të Kontratës Bazë.

Për sa më sipër njohja nga ana DPT të TVSH-së për investimin total, i cili ende nuk ka përfunduar ende por ka tejkaluar koston e parashikuar të vlerës së investimit duke arritur 2-fishin e saj pa u mbuluar për periudhën me një shtesë marrëveshje (e realizuar pas faktit dhe jashtë periudhës së kontrollit) në gjykimin tonë përbën një preçedent të gabuar, si në rastin konkret por dhe për raste të ngjashme vijim, duke çertifikuar kështu vlera investimesh të konçesionarit përpara se Shteti Shqiptar nëpërmjet përfaqësuesve të tij të miratojë paraprakisht këto vlera investimi sipas shtesë kontratave me Vendim të Këshillit të Ministrave. Veprimet, vlerësimet dhe procedurat e ndjekura nga ana e inspektorëve kontrollues në këtë rast kanë rezultuar me rimbursim në mënyrë të padrejtë të një vlere investimi të paaprovuar ligjërisht nga Shteti Shqiptar deri më datën 31.12.2016. Për këtë, vlera e TVSH-së e cila paraqitet në kushte të mungesës së ligjshmërisë shkon në 50 % të vlerës totale të TVSH-së së krediturar nga ana e subjektit në këtë datë e llogaritur minimalisht në shumën **2,054 milionë lekë**.

c. Konstatohen zgjatje të afateve për përfundimin e kontrollit tatimor, të cilat nuk rezultojnë me shtesë të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Nga auditimi i procedurave të rimbursimit të TVSH për vitin 2017, vetëm për një kampion prej 17 rastesh të përzgjedhur nga subjektet që janë rimbursuar në likuiditet u konstatua se janë rimbursuar në shkelje të procedurave të kontrollit tatimpaguesit A.K, me aktivitet: **"**Eksport fruta perime", DONI FRUITS me aktivitet: "Tregti me shumicë dhe pakicë i frutave dhe perimeve si dhe import-eksporti i tyre", V.T, me aktivitet: "Transporti rrugor i mallrave" dhe "MOBILERI T. SH.P.K", me një vlerë parregullsish në shumën **3 milionë lekë** dhe parregullsi në zbatimin e afateve të pagesës së vlerave të miratuara të rimbursimit nga DPT

të cilat e ekspozon njësinë drejt një risku për pagesë detyrimesh të panevojshme për shumën **39 milionë lekë.**

Për tatimpaguesin transportues "V.T" paraqiten mospërputhje të deklaratave të tvsh-së me librat e shitjes së tatimpaguesit, të cilat rezultojnë të pasistemuara nga administrata tatimore edhe pas dhënies së rimbursimit dhe rrjedhimisht edhe pas kryerjes së kontrollit nga DRT-të. Për këtë tatimpagues sipas materialit të kontrollit dhe sistemit informatik tatimor C@ts rezulton që teprica e kërkuar e rimbursuar përfaqson tvsh-në e mallrave të importuara me qëllim rishitje. Kjo vlerë rimbursimi ka kaluar "me sukses" të gjithë filtrat e riskut të DMR dhe riskut të DRTVSH-së megjithëse akt-veidentimi i inspektores paraqet nevojën për kryerjen e një kontrolli tatimor në vend që këtë rast. Për tatimpaguesin prodhues "MOBILERI T. SH.P.K" nuk janë respektuar afatet e përcaktuara ligjore si nga DRT-Tiranë ashtu edhe nga DRTVSH me një tejkalim prej 120 ditësh kalendarike nga kërkesa e kryer elektronikisht. Nuk rezulton vendosur penalitet konform përcaktimeve ligjore Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar pika 115.1 dhe 115.1.2. Tatimpaguesi është klasifikuar në mënyrë të padrejtë nga DRTVSH si "joeksportues" duke zgjatur artificialisht afatin e miratimit të rimbursimit nga 30 ditë në 60 ditë.

Nisur nga fluksi i kërkesave për rimbursim brenda një viti, që këta subjekte bëjnë si rezultat i llojit të aktivitetit (eksportues mbi 70%), si dhe konfuzioni që krijohet nga moszbatimi i afateve si në DPT ashtu edhe në DRT-të respektive. Për të gjitha rastet e trajtuara ka tejkalim të afateve të kryerjes së kontrollit për verifikimin dhe miratimin e shumave të kërkuara për rimbursim. Parashikimi jo i saktë në program kontrolli të numrit të kërkesave për rimbursim që shqyrtohen nga inspektorët përkatës, ka sjellë ndryshime të programeve të kontrollit pa miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

[shqiptarja.com]

9. RAPORTIMI I TË DREJTAVE TË LIGJSHME TË SHTETIT

9.1 Borxhi tatimor

Në lidhje me auditimin e detyrimeve tatimore u grumbulluan evidenca në zbatimit të kërkesave të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", dhe bazuar në të dhënat të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në 31 Dhjetor 2017, paraqitet si më poshtë:

Tabela 86: Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në 31 Dhjetor 2017 *mln lekë*

LLOI I TATIMIT	Detyrime te papaguara 31 Dhjetor 2016	Detyrime te shtuara gjate vitit 2017	Detyrime të pakësuara gjatë vitit 2017				Vlera totale Detyrime te papaguara 31 Dhjetor 2017	Ne proces gjyqesor
			Arketuar	Kthyer per sistemim	Akcize	Falur nga ligji nr 33/2017		
Tatim Fitimi	34,875	13,297	4,209	1,927	-	15,251	26,784	2,032
TVSH	52,129	13,502	5,433	4,720	-	20,900	34,579	5,874
Sig.Shoqerore	14,131	9,411	7,608	693	-	4,068	11,173	86
TAP	3,109	1,294	604	406	-	1,767	1,626	114
Te tjera	42,823	12,254	3,799	9,781	12,316	7,839	21,343	2,803
Shuma	**147,068**	**49,759**	**21,652**	**17,527**	**12,316**	**49,826**	**95,506**	**10,909**

Konstatohet se borxhi midis dy datave ka një rënie prej 51.6 miliardë lekë për shkak të efekteve të Ligjit të faljes nr.33/2017 në vlerën prej 49,8 miliardë lekë por dhe fshirjes së borxhit tatimor me justifikimin e borxhit "të transferuar" drejt DPD në vlerën **12.3 miliardë lekë.**

Detyrimet e papaguara (borxhi tatimor) në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 15.6 miliard lekë ose **10 miliardë lekë** më tepër nga gjendja e trashëguar në fund të vitit 2016. Pra konstatohet se situata e borxhit si rezultat i administrimit dhe mbikqyrjes të DPT, zhveshur kjo nga efektet e amnistisë fiskale, paraqitet me rritje në masën 7 % në raport me fillimin e vitit. Në total kjo shtesë zë rreth 1/10 e borxhit në fund të vitit 2017.

Në mënyrë grafike është paraqitur krahasimi i nivelit të borxhit sipas llojit të tatimit për vitet 2016 dhe 2017.

Grafiku 52: Krahasimi i nivelit të borxhit për 2016 dhe 2017



Debitorët ndaj skemës së Sigurimeve Shoqërore, në fund të vitit 2017, të krahasuar me vitin 2016, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

[Shqiptaria.com]

Tabela 87: Debitorët ndaj Sigurimeve Shoqërore sipas sektorëve *mln lekë*

Nr	EMERTIMI	Detyrimet e papaguara nga subjektet						Dif. krahasuese 2017-2016	
		2015		2016		2017			
		Nr. i subj.	Në vlerë	Nr. subj.	Në vlerë	Nr. i subj.	Në vlerë	Nr. i subj	Në vlerë
I	**Sektori Publik**	**1,368**	**1,712**	**1,993**	**2,127**	**987**	**1,146**	**-1,006**	**-981**
1	Buxhetore	1,168	1,253	1,776	1,659	743	809	-1,033	-850
2	Jobuxhetore	200	459	217	468	244	337	27	-131
II	**Sektori Privat**	**55,479**	**8,815**	**119,547**	**14,245**	**6,2544**	**9,706**	**-57003**	**-4542**
3	Biznes i madh	11,752	6,252	23,386	9,428	15,675	6,970	-7,711	-2,458
4	Biznes i vogel	43,727	2,563	96,161	4,817	46,869	2,733	-49,292	-2,084
	GJITHSEJ (I+II)	**56,847**	**10,527**	**121,540**	**16,372**	**63,531**	**10,849**	**-58,009**	**-5,523**

Megjithëse ka ulje të vlerës së përgjithëshme të debitorëve, detyrimi kontributiv pra principiali, kundrejt situatave krahasuese të mësiparshme, është pakësuar vetëm për rreth 267 milionë lekë, pjesa tjetër e pakësimeve janë gjoba dhe interesa. Debitorët e krijuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruara dhe të pa derdhura, ose të deklaruar më shumë e të derdhura me pak, <u>në financën e këtij institucioni, nuk janë të rregjistruar</u>**,** por janë vetëm si evidencë statistikore në Drejtorinë e Kontributeve të këtij institucioni.

Konstatohet se gjatë realizimit të amnistisë fiskale, janë fshirë nga rregjistrat e borxhit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, detyrimet e akcizës për 49 tatim pagues me vlerë 12.3 miliardë lekë (këtu përfshihen detyrime, penalitete dhe kamatvonesa), në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.33/2017 *"Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore".* Në plotësim të kërkesave të Ligjit nr.33/2017 miratuar në 30.03.2017 dhe hyrë në fuqi në 19.04.2017, ka dalë Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.14 datë 03.05.2017. Në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka përcjellë nëpërmjet shkresës nr.11562/1 Prot. datë 16.06.2017, drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, detyrimet e tatimpaguesve të akcizës, me listën e tatimpaguesve me detyrimet përkatëse në mënyrë analitike, duke ju referuar kërkesave të pikës 4 të Kreut V të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 14 datë 03.05.2017, ku citohet se "*Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të dërgojë zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave detyrimet e tatimpaguesve për akcizë/gjobë/ kamatëvonesë e dënim administrativ për periudhën tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014 sipas periudhave që i përkasin. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këtë tatim do të zbatojë procedurën e fshirjes/shuarjes pjesore të detyrimeve të akcizës, në zbatim të dispozitave të nenit 6 të ligjit"*.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka reaguar me shkresën "Kthim Përgjigje" me nr.14634/1 datë 23.06.2018, nëpërmjet së cilës informon se DPD, <u>nuk mund të zbatojë procedurën e fshirjes/shuarjes së detyrimeve të akcizës për detyrime të cilat nuk janë të kontabilizuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate</u> kjo referuar përcaktimeve të nenit 9 "Fshirja/shuarja e detyrimeve të pagueshme në doganë", të Ligjit nr.33/2017 ku përcaktohet se *"Fshihen/shuhen nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, të <u>papaguara ndaj administratës doganore dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate deri në datën 31 dhjetor 2010"</u>, dhe* nenit 10 "Pagesa e detyrimit dhe fshirja/shuarja me kusht e detyrimeve të pagueshme në

doganë" ku përcaktohet se *"Detyrimet e pagueshme në doganë, të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2014, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë detyrimi i pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjobat, kamatëvonesat dhe interesat kompensues"*. Shkresa e mësipërme drejtuar Z.Curri Zv.Drejtor i Përgjithshëm i është bërë me dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave.

Me shkresën nr. 11562/3 Prot. datë 05.07.2017, Drejtoria e Përgjithsme e Tatimeve i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave lidhur me detyrimin e saj për përcjelljen e detyrimeve të akcizës në DPD dhe vijimin me procedurat e fshirjes/shuarjes së detyrimeve. Kjo shkesë i është bërë me dije Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave. Me shkresën nr.9187/2 datë 25.07.2017 Ministria e Financave ka mbajtur qëndrimin e saj duke cituar pikën 4 të Udhëzimit të nr.14 datë 03.05.2018 dhe duke shtuar në fund *"merrni masa mbi zbatimin e procedurave të përcaktuara respektivisht për insttucionet tuaja, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura"*

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr.14634/4 datë 31.07.2017 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ka propozuar ndryshimin e Udhëzimit nr.14 datë 03.05.2017, për të fasilituar procedurën e fshirjes së borxhit të akcizës nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (institucioni që sipas ligjit "Për akcizat" ka detyrim për mbledhjen e borxhit të akcizës edhe pas datës 1 tetor 2012"). Me shkresën nr.17495/1 Prot. datë 30.08.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar një shkresë e tretë duke rikonfirmuar dhe saktësuar listën e plotë analitike të detyrimeve.

Ministria e Financave, si hartuese e udhëzimit nuk rezulton të ketë marrë asnjë nismë për trajtimin e problematikës së dalë, megjithëse është vënë në dijeni të "ngërçit" mes dy institucioneve lidhur me interpretimet e kundërta sa i përket Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14 datë 03.05.2017 lidhur me Kreun V, pika 4 e tij.

Me shkresën nr.27162/2 datë 12.12.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me detyrimet për akcizën e tatimpaguesit ARMO kërkohet *"ashtu si i keni hedhur ne sistem në "Taksë Kombëtare" ashtu bëni dhe anullimin sipas procedurave përkatëse" firmosur nga zv.Drejtori i Përgjithshëm.*

Me shkresën nr.2240 prot, datë 29.01.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe vë në dijeni Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë se në vijim të frymës së bashkëpunimit të ofruar, raporton se pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk është paraqitur asnjë subjekt nga lista e dërguar për debitoërt e akcizës për të paguar detyrimin në mënyrë që të përmbushi kushtet për të përfituar nga falja/fshirja/shuarja e detyrimeve sipas Ligjit nr.33/2017.

Në këto kushte fshirja nga rregjistrat e borxhit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e detyrimeve të akcizës për 49 tatim pagues nga 10 Drejtori Rajonale Tatimore me vlerë 12.3 miliardë lekë (këtu përfshihen detyrime, penalitete dhe kamatvonesa), ku 90% të vlerës e zënë subjektet ALOIL, Euroil, Transoilgroup dhe ARMO, është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Duhet të theksojmë se këto detyrime akcize i përkasin periudhave 2011-2014 të mbajtura në regjistra të kontabilitetit jashtë sistemit informatik tatimor pasi sistemi i mëparshëm tatimor SIT nuk e kishte të përfshirë deklarimin e akcizës

[shqiptarja.com]

ndërsa sistemi i ri C@ts ka filluar të funksionojë në muajin Janar 2015 pasi prej periudhës Tetor 2012 dhe në vijim kjo taksë administrohet prej DPD. Është kërkuar që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë masat e nevojshme për rimarrje të vlerës së akcizës prej **12.3 miliardë lekë në vlerën e borxhit.**

Efektet e Ligjit të faljes nr.33/2017 janë në vlerën 49.8 miliardë lekë. Kanë përfituar rreth 194,654 tatimpagues në shumën 49,826 milionë lekë për lloje të ndryshme detyrimesh tatimore apo penalitetesh, prej të cilave shuma e falur vetëm për 50 tatimpaguesit përfitues më të mëdhenj nga dispozitat e këtij ligji paraqitet 21,961 milionë lekë që përbën rreth 44% të shumës totale të falur. Duhet të theksojmë se procesi i faljes së detyrimeve tatimore nuk u auditua nga ana jonë në mënyrë specifike lidhur me procedurat e ndjekura nga ana e DPT por grupi i auditimit përpunoi evdiencat e përmbledhura të vëna në dispozicion nga kjo strukturë, për të evidentuar këtë proces dhe efektet të cilat ky ligj ka dhënë në borxhin tatimor mbulimin e tij në numër tatimpaguesish si dhe dhe për të vlerësuar efektivitetin e tij, në përputhje kjo me drejtimet e programit të auditimit. Nga përpunimii të dhënave që na u vunë në dispozicion lista e 50 tatimpaguesve përfitues më të mëdhenj nga Ligji i Faljes nr.33/2017 paraqitet si më poshtë.

Tabela 88: Lista e përfituesve më të mëdhenj nga Ligji i Faljes *mijë lekë*

Nr	TATIMPAGUES	FALJA	KOMPENSIM	TOTALI
1	A.R.M.O.	1.686.937		1.686.937
2	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	1.514.649	2.663.925	4.178.574
3	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	1.127.843	4.275.362	5.403.205
4	KELI	727.512		727.512
5	DEGA NE SHQIPERI E SHOQERISE TECNIMONT S	691.201		691.201
6	ER - AR	516.261		516.261
7	AURORA - 98	507.521		507.521
8	B E B	424.168		424.168
9	SHALA-E-CO	401.765		401.765
10	TIRANA - ELEKTRONIK - 02	376.527		376.527
11	GEOTEC ALBANIA BRANCH	367.000		367.000
12	Dega ne Shqiperi e AEGEK CONSTRUCTIONS	357.819		357.819
13	ALUSHI - 2A	350.393		350.393
14	LINK - FOODS	310.873		310.873
15	KALIVAC GREEN ENERGY SHPK	282.053		282.053
16	VODAFONE ALBANIA	276.492		276.492
17	B.E.S.D.	260.348		260.348
18	U & EMANAGEMENT	258.266		258.266
19	MAR-05 SHPK	221.827		221.827
20	FURNIZIM FILIALI TELEKOMIT	200.174		200.174
21	ALPINE BAU GMBH, FILIALI TIRANE	198.162		198.162
22	BELLE AIR	173.859		173.859
23	BECHTEL & ENKA	173.732		173.732
24	BET-07	172.456		172.456
25	BALAFAS INDUSTRIAL CONSTRUCT.	169.486		169.486
26	B.P-LOLAJ	168.542		168.542
27	BE - HA - SE	167.391		167.391
28	TESTIL FLOR	165.549		165.549
29	LIBERTY SPORT	160.153		160.153
30	SMART SHPK	155.856		155.856
31	ALBPETROL SHA	155.803		155.803
32	KRIVA -SH.V	154.634		154.634
33	NEK & CO	152.393		152.393
34	MIGRANTI 2010	152.164		152.164
35	K R I S T A L	145.956		145.956
36	ZALBA	144.211		144.211
37	DELTA TELECOM	137.797		137.797
38	MARCO	136.069		136.069
39	ALOIL	135.631		135.631
40	PDS	113.628		113.628
41	KLODI	110.687		110.687

Shqiptarja.com

42	SOEPRO J.V.	109.007		109.007
43	MT CONSTRUCION	107.937		107.937
44	HAKLAJ	106.958		106.958
45	EUROIL SHA	106.033		106.033
46	GJERKAJ-2	105.594		105.594
47	KUID	105.329		105.329
48	ALBTRUMINKO	96.859		96.859
49	SE-GA-LI	90.522		90.522
50	RROG-SEGRO	89.652		89.652
		15.021.681	**6.939.286**	**21.960.967**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Sipas të dhënave të drejtorisë së mbledhjes me forcë të borxhit në totalin prej 137.633 subjekteve debitore gjendje më 31 Dhjetor 2017, konstatohet se 61.773 subjekte (me status aktiv) zene 45%, te numrit total te subjekteve debitor dhe me nje vlerë prej 44,927 milionë lekë ose 47% të masës totale të borxhit. 75.860 subjekte (me status pasiv) zene 55 % te numrit totalit te subjekteve debitor dhe me nje vlerë prej 50,578 milionë lekë ose 53% të masës totale të borxhit. Nga analiza e të dhënave, vërejmë se vetëm 10 Subjekte, të cilët përbëjnë 0.01% të totalit të subjekteve 137.633 për vitin 2017, krijojnë 27.3% të shumës total të borxhit tatimor. Vlera më e madhe e borxhit rezulton në DRT Tiranë dhe Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj të cilët zënë rreth 74% të borxhit total.

Tabela 89: Lista e kompanive me detyrimet më të larta *mijë lekë*

Nr	TATIMPAGUES	STATUSI	DATA E NDRYSHIMIT TE STATUSIT	BORXHI 31.12.2017
1	A,R,M,O,	Pasiv	2017-11-26	8,432,083
2	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	Aktiv	2007-12-10	6,081,070
3	EFOR - K SHPK	Pasiv	2016-05-06	4,895,062
4	IONIAN REFINING AND TRADING COMPANY - IRTC	Aktiv	2016-06-13	4,681,854
5	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	Aktiv	1996-06-17	2,928,405
6	KOTERRI	Pasiv	2012-10-31	1,788,017
7	TOP BAST	Aktiv	2007-08-09	1,730,202
8	GEOTEC ALBANIA BRANCH	Aktiv	2010-06-11	1,434,942
9	FULLPET	Pasiv	2016-05-06	1,074,242
10	BELLE AIR	Aktiv	2005-06-17	1,069,521
11	BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD	Aktiv	2004-07-28	829,657
12	KURBINI	Pasiv	2017-05-26	777,552
13	ENERGJI SHPK	Pasiv	2018-06-26	708,321
14	ANIKA MERCURIA REFINERY ASSOCIATED OIL	Pasiv	2017-05-26	706,590
15	TPD-Trading Petrol & Drilling	Aktiv	2012-06-07	675,416
16	FRANGAJ - INTERNATIONAL	Pasiv	2016-09-19	657,653
17	AMLA-2013	Pasiv	2016-05-06	620,185
18	Simmons Edeco Limited, Dega ne Shqiperi	Aktiv	2000-11-08	610,512
19	XHOILLOTO	Pasiv	2016-06-22	570,146
20	interbast	Pasiv	2016-05-06	525,343
21	BAJO TRANS	Aktiv	2016-12-07	514,668
22	EURO PETROL	Pasiv	2017-05-26	488,266
23	KUID	Pasiv	2017-08-26	472,858
24	Dega ne Shqiperi e AEGEK CONSTRUCTIONS S,A	Aktiv	2008-04-18	447,220
25	ERALDI-2010	Pasiv	2016-05-06	398,647
26	C,A,E,	Aktiv	2007-09-04	397,694
27	GOLD PLUS	Pasiv	2016-05-06	371,656
28	GENKLAUDIS SH,A,	Aktiv	2007-07-11	369,994
29	CROËN ACQUISITIONS	Pasiv	2017-05-26	368,603
30	SCHLUMBERGER OVERSEAS S,A	Aktiv	2005-06-02	368,258
31	TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY	Pasiv	2015-03-19	354,381
32	GEND 2012	Pasiv	2016-05-06	338,567
33	"HOXHA"	Pasiv	2016-05-06	311,128
34	SATURN GAMES	Pasiv	2017-04-26	298,887
35	Shell Upstream Albania B,V	Aktiv	2012-06-07	298,783
36	Serenissima Construzioni Tirana	Aktiv	2011-11-09	295,882
37	TGV & T-2014	Pasiv	2016-09-19	287,667
38	VIS & OLT KONSTRUKSION	Aktiv	2016-05-08	286,801

[shqiptaria.com]

39	Edil Quattro	Aktiv	2008-07-16	271,800
40	A,K,F, PETROLEUM	Aktiv	2013-09-26	266,014
41	AGONSET	Aktiv	2012-05-08	253,660
42	TEA CONSTRUCTION & PETROL	Pasiv	2017-12-26	246,706
43	REPARTI USHTARAK 4303	Aktiv	2007-09-18	240,086
44	ALSAT	Aktiv	2002-02-07	239,558
45	KCA Deutag Drilling GmbH Dega ne Shqiperi	Aktiv	2012-04-03	233,893
46	Qendra e Distribucionit Ushqimor	Pasiv	2017-10-26	228,882
47	REPARTI USHTARAK 4001	Aktiv	2005-05-24	225,894
48	Viking International Limited Albania	Aktiv	2013-12-26	216,996
49	ELIDA - 2017	Pasiv	2016-08-11	203,461
50	Ener AL Sh,p,k	Pasiv	2016-05-06	203,005
	Totali			**50,296,686**

50 tatimpaguesit e listuar më sipër të cilët përbëjnë 0,036% të numrit gjithsej subjekteve me borxh për vitin 2017, zënë rreth 52,7 % të vlerës totale të borxhit tatimor ose 50,297 milionë lekë nga 95,506 milionë lekë

Konstatojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon informacion të mjaftueshëm për analizimin dhe vlerësimin e Borxhit Tatimor në nivel Kombëtar, megjithëse disponon të gjithë mekanizmat e nevojshëm ligjorë dhe administrativë për monitorimin në kohë dhe me efikasitet të këtij borxhi, Në gjykimin tonë Drejtoria Përkatëse në DPT duhet të luante një rol më aktiv në monitorimin e veprimtarisë së mbledhjes së borxhit nga Drejtoritë Rajonale dhe marrjen e masave përkatëse për uljen e borxhit tatimor, i cili gjatë periudhës objekt auditimi ka një trend rritës,

Mënyra e administrimit të këtij procesi në mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në ndjekjen e veprimeve proçeduriale nga ana e administratës tatimore duke mos ezauruar në kohë dhe me efikasitet të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në ligjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e borxhit, Për vitin 2017 janë vendosur masa shtrënguese për 168,580 raste të cilat janë të përsëritura disa herë në të njëjtin tatim pagues, Arkëtimi i borxhit nga masat shtrënguese eshte 14,114 milionë lekë ndërkohe që total arkëtime për vitin 2017 janë 39,179 milionë lekë, Diferenca janë arkëtime të kësaj periudhe për te cilat masat shtrënguese janë bërë në vitin 2016 e më parë, Gjatë vitit 2017, janë mbledhur vetëm 7,4% e vlerës së totalit të masave shtrënguese,

9.2 Borxhi doganor

Nga auditimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave rezulton se, në fund të periudhës 31 Dhjetor 2017, detyrimet e papaguara janë në shumën 23,947 milionë lekë, ose 4,251 raste që i përkasin 2,187 subjekteve. *Nëse do të krahasonim të dhënat kundrejt vitit 2016 do të na rezultonte një paksim në total i borxht doganor në shumën 841 milionë lekë, kryesisht nga efekti i amnistisë fiskale.*

Tabela 90: Ndryshimet e borxhit doganor për vitin 2017 *Në milionë lekë*

EMËRTIMI	Detyrime te papaguara 31 Dhjetor 2016	Detyrime te shtuara gjate vitit 2017	Detyrime të pakësuara gjatë vitit 2017				Vlera totale Detyrime te papaguara 31 Dhjetor 2017
			Arketuar	Kthyer per sistemim	Akcize	Falur nga ligji nr 33/2017	
Detyrime Doganore	6,751	572		-	-		6,163
Penalitete	15,135	1,213		-	-		15,192
Kamatëvonesa	2,902	346		-	-		2,592
Shuma	**24,788**	**2,131**	**1,145**	**-**	**-**	**1,827**	**23,947**

Borxhi doganor sipas vendimeve të marra nga degët rajonale doganore **evidentohet dhe kontabilizohet në total si borxh doganor dhe jo i ndarë si**

[shqiptaria.com]

burimit të krijimit të saj (pra i ndarë si borxh si detyrim nga akcize apo taksë doganore). Sektori i monitorimit të borxhit nuk ka të dhëna për sa i përket borxhit sipas burimit të krijimit duke e bërë të pa mundur krahasimin e të dhënave në lidhje me subjektet që zënë një peshë të konsiderueshme në krijimin e të ardhurave dhe atyre subjekteve që kanë detyrime të konsiderueshme doganore e që kanë përfituar nga ligji nr. 33/2017, datë 30.03.2017 "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore". Struktura e borxhit doganor në fund të periudhës ushtriore 2017, përbëhet nga borxhi doganor 6,163 milionë lekë, penalitetet në vlerën 15,192 milionë lekë dhe kamatvonesa në vlerën 2,592 milionë lekë pra duke arritur në një vlerë totale prej **23,947 milionë lekë.**

Po ti referohemi borxhit doganor sipas Degëve Doganore, përbërja e tij reflektohet në të dhënat e tabelës së mëposhtme. Duket qartë se borxhin kryesor e kanë subjektet ndaj Degës së Doganës Tiranë me 19.5% të vlerës së borxhit total ose 4,670 milionë lekë, Dega e Doganës Durrës me 14% të vlerës së borxhit total, apo 3,331 milionë lekë dhe Dega Doganore Fier me 47% të vlerës së borxhit me 11,149 milionë lekë.

Tabela 91: Borxhi doganor sipas Degëve *mln lekë*

	Detyrime te papaguara 31 Dhjetor 2016			Detyrime te papaguara 31 Dhjetor 2017		
DEGA	**Raste**	**Totali**	**%**	**Raste**	**Totali**	**%**
Tirane	1,667	4,644	18.74	1,550	4,671	19.51
Rinas	23	2	0.01	21	21	0.01
Durrës	966	3,357	13.54	889	3,331	13.91
Shkodër	174	452	1.82	131	354	1.48
Pogradec	39	69	0.28	54	13	0.05
Kakavije	414	419	1.69	312	386	1.61
Korçe	167	512	2.07	109	439	1.83
Kapshtice	174	106	0.43	105	57	0.24
Vlore	199	839	3.39	174	742	3.10
Fier	298	11,407	46.02	327	11,149	46.56
Sarande	61	107	0.43	107	124	0.52
Elbasan	130	258	1.04	103	212	0.89
Lezhe	84	1,681	6.78	91	1,764	7.36
Berat	104	656	2.64	73	512	2.14
Kukës	69	91	0.37	83	74	0.31
Peshkopi	25	113	0.46	31	104	0.43
Tre urat	110	72	0.29	91	14	0.06
TOTALI	**4,704**	**24,788**	**100**	**4,251**	**23,947**	**100**

Nga detyrimet e papaguara të mësipërme rezultojnë që 65 raste në shumë 481 milionë lekë, ose 2% e detyrimeve totale të trashëguara janë detyrime nga TVSH-ja e shtyrë, ndërsa për 1,531 raste në shumën prej 16,212 milionë lekë, ose 67.70% e detyrimeve totale të trashëguara kanë dalë nga urdhërat e ekzekutimit për 17 degë doganore. Gjithashtu, nga totali i detyrimeve ndër vite të trashëguara, 517 raste, në shumën totale 12,000 milionë lekë, ose 50.11% e detyrimeve totale janë detyrime nga mallrat e akcizës (nga shkeljet në zbatim të ligjit nr. 61, datë 25.04.2012 "Për akcizën në RSH", i ndryshuar dhe 405 raste, në shumën 127 milionë lekë janë detyrime të papaguara nga çdoganimi i automjeteve.

Nga auditimi nuk rezulton i evidentuar si borxh në DPD, detyrimi tatimor i akcizës në shumën prej **12,029 milionë lekë, i periudhës Janar 2011 deri më Dhjetor 2014**, që sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i është transferuar për fshirje DPD, pasi është refuzuar marrja në evidencë e këtij borxhi tatimor që me

[Shqiptaria.com]

shkresën nr.14634/4 prot., datë 31.07.2017, fakt që i është bërë me dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi i të dhënave të Sektori i Monitorimit të Borxhitm, rezulton se 20 debitorët më të mëdhenj të dognave paraqiten si më poshtë:

Tabela 92: Lista e debitorëve më të mëdhenj mijë lekë

Nr.	Emri Subjektit	Gjendja më 31.12.2016				Paguar	Gjendja më 31.12.2017	Në % ndaj totalit
		Detryim Doganor	Penalitet	Interesa	Shuma Totale			
1	DEVERON OIL DHE TE TJERE	1,594,622	3,288,776	182,033	5,065,431	-	5,065,431	21%
2	BANKERS PETROLEUM	595,106	1,770,351	53,880	2,419,336	5,056	2,414,280	10%
3	ARMO	355,398	1,487,755	275,871	2,119,024	-	2,119,024	9%
4	ADA PETROL	390,215	780,430	319,004	1,489,650	-	1,489,650	6%
5	SATURN GAMES	156,213	757,477	120,010	1,033,699	-	1,033,699	4%
6	M/T "ERA-1" (VOLDOMYR DEMAKOV)	222,572	667,717	109,684	999,973	-	999,973	4%
7	TEA CONSTRUKTION	242,756	485,511	27,383	755,650	-	755,650	3%
8	A&G GROUP	115,405	374,395	64,244	554,045	2,992	551,053	2%
9	KUINDA	97,748	293,245	-	390,994	-	390,994	2%
10	A&A OIL 10	129,595	259,190	-	388,784	-	388,784	2%
11	UNITED COMPANY	40,856	204,479	138,320	383,655	-	383,655	2%
12	CASH & CARRY	55,578	277,481	37,108	370,167	-	370,167	2%
13	ENARVI SHA	72,869	266,074	74,058	413,001	44,751	368,250	2%
14	EUROPA CASINO 2010	59,890	265,498	39,099	364,487	-	364,487	2%
15	ARBI D	49,619	160,140	18,944	228,703	2,393	226,310	1%
16	ARLER COMPANY	38,376	115,128	47,877	201,382	-	201,382	1%
17	BAT SHOES	63,443	126,086	3,166	192,696	-	192,696	1%
18	KURUM INTERNATIONAL	76,857	235,182	38,337	350,375	161,092	189,283	1%
19	AGONSET	149,340	2,749	19,707	171,796	5,265	166,531	1%
20	ATLAS	105,387	12,813	25,0487	143,248	4,204	139,044	1%
	Totali	**3,017,222**	**8,541,703**	**1,411,742**	**12,970,666**	**225,754**	**12,744,912**	**74%**

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se, 74% të totalit të borxhit e zënë detyrimet e këtyre 20 debitorëve të mëdhenj, ku peshën kryesore e zënë subjektet: Deveron Ol dhe të tjerë me 21% ndaj totalit të borxhit, Bankers Petroleum me 10%, Armo me 9%, Ada Petrol me 6%, Satum Games me 4%, etj. Gjatë vitit 2017, borxhi doganor është rritur shtuar në shumën 2,131 milionë lekë në këtë ***shtesë*** peshën kryesore e zë borxhi doganor i Degës Doganore Tiranë me rreth 46.62%, Fieri rreth 17.44%, Durrësi rreth 11.99%, Lezhë rreth 3.42%, Elbasan rreth 2.61%, Sarandë rreth 1.67%, Kakavijë rreth 1.17% etj.

Detyrimet e papaguara deri më 31 Dhjetor 2016, **janë pakësuar** 2,972 milionë lekë përbërë nga borxhi doganor 1,169 milionë lekë, penalitete 1,235 milionë lekë dhe kamate vonesa 568 milionë lekë. Në pakësimin total peshën kryesore e kanë Dega Doganore Tiranë rreth 32.53%, Fieri rreth 21.19%, Shkodër rreth 8.74%, Durrësi rreth 8.31%, Berat rreth 6.33%, Vlorë rreth 4.82%, Elbasan rreth 3.46%, Korçë rreth 2.98%, etj.

Ulja e borxhit doganor ka ardhur në shumën prej ***489 milionë lekë*****,** që i përkasin pakësimeve të detyrimeve doganore si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore të fituara nga subjektet dhe të anullimit të disa vendimeve të degëve doganore dhe shuma prej ***1,827 milionë lekë,*** e cila vjen si rezultat faljeve të detyrimeve nga zbatimi i ligjit 33/2017, datë 30.03.2017 *"Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore".*

Nga zbatimi i ligjit 33/2017 *kanë përfituar* **896** ***subjekte*** që i përkasin **1,136 vendimeve administrative** të nxjerra nga degët doganore**,** si më poshtë:

a. Në zbatim të **nenit 9** të ligjit nr.33/2017 – Fshirja /shuarja e detyrimeve të pagueshme doganore, ***janë falur nëpërmjet 388 vendime administrative në shumën 1,231 milionë lekë, të cilat*** përfaqësojnë detyrimet e pa paguara ndaj administratës dhe të kontabilizuara deri në datën 31.12.2010, për detyrimet lidhur me produktet e duhanit të kontabilizuar deri më datën 31.12.2016, detyrimet për TVSH e shtyrë dhe të papaguar për makineritë e pajisjet të kontabilizuara deri më 31.12.2016.

b. në zbatim **të nenit 10** të ligjit ligjit nr.33/2017- Pagesa e detyrimit dhe fshirja /shuarja me **kusht** e detyrimeve të pagueshme në doganë, janë ***falur 748 vendime me shumë 596 milionë lekë*** dhe përfaqësojnë të gjitha detyrimet e pagueshme të papaguara ndaj administratës doganore dhe të kontabilizuara nga periudha 1 Janar deri në datën 31.12.2014, kundrejt kushtit të pagesës së detyrimit deri më 31.12.2017, për 138 vendime, me shumën e paguar prej 108 milionë lekë. Nga amnistia fiskale borxhi doganor është pakësuar në shumën 1,827,198 mijë lekë, ku 50.5% të tij e zënë 20 subjektet si më poshtë:

Tabela 93: Efektet e amnistisë fiskale sipas subjekteve *mijë lekë*

Nr.	Emri subjketit	Detryim doganor	Penalitet	Interesa	Shuma totale	Shuma e paguar	Shuma per tu paguar	Detyrim i paguar si kusht	Shuma e falur	% ndaj totalit
1	PROTRANS ALBANIA	72,443	18,245	57,437	148,125	-	148,125		148,125	8.11%
2	ARMO	-	104,903	11,557	116,460	-	116,460		116,460	6.37%
3	ENERGY PARTNERS...	88,989	50	-	89,039	4,130	84,909		84,909	4.65%
4	ENERGY PLUS	60,168	50	-	60,218	-	60,218		60,218	3.30%
5	ENERGY SHPK	36,279	100	22,209	58,588	-	58,589		58,589	3.21%
6	ILDI	23,823	12,112	19,257	55,192	80	55,112		55,112	3.02%
7	ALITA	33,767	-	20,336	54,103	5,000	49,103		49,103	2.69%
8	GROUP	26,943	-	16,760	43,702	54	43,648		43,648	2.39%
9	TRANS BETON	-	38,740	4,854	43,594	-	43,594		43,594	2.39%
10	ARBI D	7,344	36,721	2,905	46,970	-	46,970	7,344	46,970	2.57%
11	ASA	31,719	150	7,816	39,686	5,571	34,115		34,115	1.87%
12	HYDRO ENERGJI	54,899	50	575	55,524	26,411	29,113	11,405	29,113	1.59%
13	KURTI ZALL	4,067	12,202	10,266	26,536	-	26,536		26,536	1.45%
14	GUSMARI	18,980	-	5,117	24,097	-	24,097		24,097	1.32%
15	KOLE LECI	3,206	16,029	-	19,235	-	19,235		19,235	1.05%
16	QERAMIK ALBANIA	12,315	-	6,399	18,714	-	18,714		18,714	1.02%
17	KLUBI VLLAZNIA	8,062	-	9,958	18,020	-	18,020		18,020	0.99%
18	ELVIS MM	11,771	-	6,884	18,655	1,676	16,979		16,979	0.93%
19	CITY PARK	42,366	200	14,670	57,237	42,366	14,870	42,366	14,870	0.81%
20	DILINDA	3,118	6,336	4,901	14,355	-	14,355		14,355	0.79%
	Totali	**540,260**	**245,888**	**221,901**	**1,008,050**	**85,288**	**922,762**	**61,115**	**922,762**	**50.50%**

Nga administrata doganore masa më efikase për arkëtimin e borxhit është pezullimi i NIPT-it në sistemin Asycuda World të subjekteve deri në shlyerjen e të gjitha detyrimeve, *por nga të dhënat e disponuara apo nga rritje e treguesve të borxhit kjo nuk ka rezultuar efektive.* Gjatë vitit 2017 janë arkëtuar me forcë detyrimet për 204 Urdhëra Ekzekutimi në shumën totale 32 milionë lekë. Në përpjekje për të rikuperuar borxhin dhe sipas shkresës nr.22449/1 prot, datë 29.09.2015, është kërkuar nga DPD, Degëve Doganore të aplikojnë lidhje të aktmarrëveshjeve në zbatim të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, për shlyerjen me këste të borxhit, ku deri në fund të periudhës ushtrimore janë lidhur gjithsej 117 aktmarrëveshje dhe janë arkëtuar 105 milionë lekë. *Nga auditimi rezulton se nuk ka informacion* në drejtim të monitorimit të kontratave të lidhura nga degët doganore me zyrat përmbarimore në lidhje me ekzekutimin e detyrimeve të subjekteve debitore ndaj DPDoganës, ku vetëm për vitin 2017 janë dërguar gjithsej 1,348 urdhëra ekzekutimi.

[Shqiptaria.com]

9.3 Borxhi (tatimor) ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore

Në **27 bashkitë** e audituara, niveli i borxhit paraqitet në **vlerën 2,187 milionë lekë** i cili vjen gjithmonë në rritje nga njëri vit në tjetrin, dhe janë të ardhura të munguara në buxhetet e këtyre bashkive dhe njëkohësisht janë të ardhura të cilat në një pjesë të bashkive nuk parashikohen në planin e të ardhurave të vitit vijues. Nga vlera totale e këtij borxhi, detyrimet nga abonentët familjarë zënë vlerën **1,064,967 mijë** lekë ose 49 % e totalit të detyrimeve. Një pjesë e konsiderueshme e këtij borxhi tatimor është të krijuar gjatë viteve të mëparshme dhe periudhë të gjatë, ku përmendim Bashkinë Korçë debitorë pa shpresë arkëtimi për 491 subjekte me vlerë 77,607 mijë lekë, debitorë mbi 3 vite për 221 subjekte me vlerë 37,179 mijë lekë, debitorë nga 1 deri në 3 vite për 645 subjekte me vlerë 46,795 mijë lekë dhe debitorë mbi një vit për 55 subjekte me vlerë 25,561 mijë lekë.

Në të gjitha subjektet e audituara është konstatuar se nga strukturat e administratës të bashkive, për vjeljen e detyrimeve ndaj subjekteve debitorë nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme ligjorë, si; bllokimi i llogarive bankare, vendosja e barrës siguruese në Drejtoritë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo ZVRPP, mos aplikim të gjobave për mos pagesën në afat, nuk janë bërë kallëzime penale ndaj tatimpaguesve të cilët nuk paguajnë taksat vendore për disa vjet me radhë, **ku nga KLSH-ja** në mënyrë permanente në të gjithë auditimet e kryera janë rekomanduar masa për vjeljen e detyrimeve fiskale, në zbatim të dispozitave ligjore.

Në mjaft bashki u kemi rekomanduar Këshillave Bashkiake që për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të caktojnë si agjent tatimor Ujësjellës SHA, nëpërmjet lidhjeve të marrëveshjeve, rekomandim i KLSH i cili ka gjetur zbatim dhe si efekt i këtij rekomandimi janë rritur në mënyrë të konsiderueshme niveli i arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore,ku mund të përmendim: Bashkitë, Vlorë, Himarë, Lezhë, etj.

Megjithë punën e bërë ende edhe gjatë vitit 2017 mjaft bashki paraqiten me vlerë detyrimesh për mos pagim taksave dhe tarifave vendore ku përmendim **bashkitë**:

-*Lushnjë* në vlerën 460,870 mijë lekë, nga e cila abonentët familjarë në vlerën 326,436 mijë lekë, -*Vlorë* në vlerën 243,548 mijë lekë, nga e cila abonentët familjarë në vlerën 86,377 mijë lekë,
-*Korçë* në vlerën 188,143 mijë lekë, nga e cila abonentët familjarë në vlerën 42,986 mijë lekë,
-*Fier* në vlerën 168,354 mijë lekë, nga e cila abonentët familjarë në vlerën 122,853 mijë lekë,
-*Lezhë* në vlerën 134,042 mijë lekë, nga e cila abonentët familjarë në vlerën 30,717 mijë lekë,
-*Rrogozhinë* në vlerën 122,018 mijë lekë, nga e cila abonentët familjarë në vlerën 96,299 mijë lekë,
-*Divjakë* në vlerën 122,017 mijë lekë nga e cila abonentët familjarë në vlerën 96,298 mijë lekë,
-*Durrës* në vlerën 113,667 mijë lekë.

Vijon të mbetet problem fakti se në disa bashki nuk është ndërtuar një sistem tatimor i informatizuar dhe cilësor me qëllim që të sigurojë administrim të drejtë të të ardhurave dhe të mundësojë siguri të mjaftueshme operacionale, për trajtim të njëjtë të subjekteve objekt të taksave dhe tarifave vendore. Mos hapja

e regjistrave për subjektet me leje minerale që shfrytëzojnë sipërfaqe pyjore/kullosore me të dhënat e kontratave për sipërfaqen e shfrytëzueshme. Mos regjistrimi i subjekteve në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) janë shmangur detyrimet e tyre për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, me pasojë mungesë të ardhurash në buxhet në vlerën 4,633 mijë lekë, ku përmendim bashkitë: Divjakë në vlerën 247 mijë lekë, Belsh në vlerën 1,865 mijë lekë, Kamzë në vlerën 2,082 mijë lekë dhe Rrogozhinë në vlerën 439 mijë lekë, etj.

[shqiptarja.com]

10. RAPORTIMI I BUXHETIT

10.1 Mbi mungesën e bazës ligjore të raportimit financiar

Në Udhëzimin nr.23 datë 22.12.2017 *"Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017",* konstatohet vetëm një ndryshim krahasuar me Udhëzimin e një viti më parë, respektivisht në Nenin 27 ku shtohet "*Për të gjitha Ministritë dhe institucionet për të cilat gjatë vitit 2017 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimet e programeve buxhetore në Aktin Normativ nr.3, datë 06.11.2017, rakordimi i planit për buxhetin e vitit 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të bëhet me ministritë dhe institucionet që i administrojnë këto fonde aktualisht*". Përvec formalitetit të konstatuar, theksojmë se Udhëzimi rregullon rakordimin e planit buxhetor por jo kontabilitetin. Nisur nga fakti se Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nuk ka hartuar ndonjë udhëzim tjetër të posaçëm për të trajtuar çështjen e ndryshimeve strukturore para mbylljes së vitit fiskal, gjykojmë se e ka gjykuar të mjaftueshëm se me përcaktimin se kush rakordon planin buxhetor kjo do të mbulonte dhe rregullimin kontabël të përthithjes dhe konsolidimit të pasqyrave financiare 11-mujore të Ministrive dhe programeve që pushuan së ekzistuari pas Nëndorit 2017. Konstatohet se nuk kanë gjetur rregullim çështje si:

Kush do të mbyllte pasqyrat financiare 11-mujore?! Afatin e dorëzimit të tyre, nëse duhej të përcaktohej një periudhë tranzicioni për përpunimin e të pasqyrave, për transferimin kontabël dhe fizik të inventarëve dhe aktive të qëndrueshme. Kush do të ishte personi përgjegjës për përgatitjen dhe miratimin e tyre?! Si veprohet me punonjësit e larguar apo të transferuar në Ministrinë e re me një detyrë dhe tagër tjetër?!

Këto aspekte kanë qënë objekt i auditimit financiar të KLSH në aparatin e MFE gjatë periudhës shkurt-maj 2018, duke evidentuar mos adresim të cështjeve të mësipërme dhe përgjegjësinë e DH/MFK sipas Ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Udhëzimi nr.8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" është iniciuar me ngritjen e grupit të punës me Urdhrin nr. 142 dt. 17.11.2017 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e bazës rregullatore të kontabilitetit publik për një periudhë tranzitore, deri në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS)". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion: dosje e cështjeve të ndjekura në lidhje me kontabilitetin dhe përmirësime të tjera ligjore; nuk rezulton të jetë e plotësuar me minutat mbledhjeve të grupeve të punës apo relacione "dhënie mendim" apo versione finale të miratuara të udhëzimeve të përpiluara apo të analizës të sipërpërmëndur. Në kushtet kur prej disa vitesh është shtruar cështja se sistemit publik shqiptar i mungojnë standardet e kontabilitet të miratuara, nuk disponojmë nga DH/MFK ndonjë mbledhje të dedikuar të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për propozimin e hartimit të një dokumenti të tillë tranzitor, duke përcaktuar çfarë konkretisht rregullon ai, cfarë ndryshimesh sjell?! Pika 2 thotë "rivënie në zbatim të rregullave në fushën e kontabiliteti publik", ndërkohë që ngrihen cështjet: *A kanë qënë të përpiluara dhe të detyrueshme për zbatim më parë këto rregulla dhe kur pushuan së zbatuari?! Cila është përcaktuar si periudhë tranzitore?! Cilat IPSA janë përshtatur/adaptuar?!* Në këtë Udhëzim, pika 8 thuhet se

"Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me: *njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; si dhe njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre. Pra kemi të bëjmë me një "cash basis" të modifikuar.* Nëse ky udhëzim sjell ndryshime në njohjen trajtimin dhe mënyrën e kontabilizimit të transaksioneve të caktuara atëherë Udhëzimit i duhej të plotësoj me parashikim të një periudhë tranzicioni si cdo praktikë ndërkombëtare e Bordeve rregulluese dhe mbikqyrëse që nxjerr një standard apo letër pune shpjeguese për të shmangur konfuzion në interpretim dhe për një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme brenda një viti ushtrimor.

Gjithashtu, në Udhëzimin nr.23 datë 22.12.2017 pika 30, konfirmohet se baza ligjore, rregullatore për përgatitjen e pasqyrave financiare është Udhëzimi nr. 14 datë 2006, i rishikuar 2007, 2008, i Ministrit të Financave "Mbi përgatitjen dhe publikimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për institucionet qëndrore, vendore dhe njësitë e zbatimit të projekteve për marrëveshjet me donatorët e huaj". Nga shqyrtimi i ndryshimeve të vitit 2007 dhe 2008 në Udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006, konstatuam se ndryshimet e vitit 2008 shfuqizuan pikat 8 dhe 9 e rubrikës I-rë, përkatësisht: "*Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrine e Financave, mbi bazën e informacionit të depozituar, harton brenda datës 15 Qershor 2007 përmbledhëset e llogarive vjetore 2006 në keto nivele; Për Ministritë dhe Institucionet e tjera qëndrore; Për ISSH dhe ISKSH Për njësite e menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj; Për organet e Qeverisjes Vendore", dhe "Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave mbi bazën e të gjithë informacionit të hartuar e depozituar* ***bën konsolidimin e pasqyrave*** *financiare të vitit 2006 në nivel qëndror e lokal dhe i raporton ato brenda datës 15 Korrik 2007".* Udhëzimi nr.14 i datës 28.12.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 10 datë 27.2.2008, nuk parashikon një pikë se kush bën konsolidimin e pasqyrave financiar duke mbetur përsëri me Udhëzimet e përvitshme për mbyllje të llogarive të buxhetit nga Thesari. Një tjetër sqarim që nuk parashikohet nga DH/MFK është raporti/lidhja midis Udhëzimi nr. 14 datë 28.12.2006 dhe Udhëzimi nr. 8 datë 9.3.2018. A janë ata plotësues të njëri tjetrit apo ai më i hershmi shfuqizohet.

Lidhur me parimin e njohjes dhe rregjistrimit të shpenzimit. Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017, në pikën pikën 1/b përcakton *"Në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen: Të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të rregjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave (accrual basis)".* Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018, në pikën 37, përcakton *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë cash (cash basis), me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët".* Ndërkohë në pikën 42, gjejmë të cilësuar "*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të*

[Shqiptarja.com]

pafinancuara (commitment), për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", në varësi të natyrës së tyre". Këto cilësime i gjejmë në shkelje të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni 61 ku thuhet se shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes pra jo të pagesës. Fakti që nuk ka fonde disponibël për pagesë nuk është arsye që këto shpenzime të njihen si shpenzime të periudhave të ardhshme pasi ato në të vërtetë kanë ndodhur.

Në lidhje me Standardet e Kontabilitetit Publik në Strategjinë MFP 2014-2020 thuhet se: Qëllimi i standardeve është të përmirësojnë cilësinë e raportimit të përgjithshëm financiar nga institucionet e sektorit publik, duke çuar në vlerësime më të informuara të vendimeve të Qeverive për alokimin e burimeve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Megjithëse plani kohor i strategjisë aktuale është deri në vitin 2020, do të merren masa përgatitore me qëllim miratimin gradual të këtyre standardeve ndërkombëtare. Deri në fund të periudhës së auditimit (qershor 2018) ende nuk është përmbushur faza e 1: krijimi i një strukture/funksioni të vecantë për kontabilitetin publik pranë Ministrisë së Financave për mbikqyrjen e kontabilitetit në qeveri në përgjithësi dhe kalimin bazuar në SEKP në vecanti. Raporti vjetor i KBFP për vitin 2017 citon se do të ngrihet një sektor me tre specialistë në strukturën e DH/KBFP gjatë vitit 2018. Ndërkohë Bordi i Mbikqyrjes së KBFP tashmë i krijuar prej 2016, nëse do të kishte funksionuar jo vetëm me 3 mbledhje gjithësej, do të kishte filluar punën e tij me grumbullimin e gjithë udhëzimeve në vite për të unifikuar së paku referimin e neneve[14] të Kushtetutës, ligjeve dhe VKM ku ato bazohen.

Në lidhje me bashkëpunimin me KLSH për çështje të kontabilitetit, konstatojmë se Bordi i KBFP nuk ka zbatuar pikën të rregullores ku thuhet se ai duhet të ftojë përfaqësues të KLSH në rastet kur trajtohen çështje të kontabilitetit. Parashikimet dhe fazat e implementimit të IPSAS, në kuadër të projektit duhet të bëhen transparente dhe objektivat afat-shkurtër dhe afat-mesëm të drejtorisë në lidhje me kontabilitetin të ndërtohen në terma konkretë mbi to. Referuar pasaportës së indikatorëve të përpiluar nga SIGMA, DH/MFK duhet të parashikojë raportimin e ecurisë së implementimit të IPSAS.

10.2 Raportimi i treguesve fiskalë

- Treguesit fiskalë jo në përputhje me të dhënat e SIFQ
- Treguesit fiskalë të keqraportuar dhe keqklasifikuar me qëllim ruajtjen e limiteve të zërave buxhetor dhe deficitit

KLSH ka konstatuar riklasifikime të kryera jashtë raportit standart të SIFQ, të kryera manualisht me qëllim mbulimin e tejkalimit të planit të disa zërave buxhetorë, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në të cilin citohet se "Sistemi informatik financiar i Qeverisë (SIFQ)" është sistemi financiar, nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit"

Zërat kryesore buxhetore të cilat paraqiten në tejkalim dhe të raportuara në seksione të ndryshme të tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar përfshijnë

[14] Neni 78: "1 Kuvendi vendos me shumicën e votive, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përvec rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. Neni 83

[shqiptarja.com]

kryesisht shpenzimet kapitale me financim të huaj, huadhënien neto, shpenzimet për pushtetin vendor, deficitin dhe huanë e kthyer nga projektet si në vijim:

Tabela 94: Zërat buxhetorë të raportuar me diferenca *mln lekë*

Treguesi	Plan A.N.3	Plani An.3+F.R+F.K	Fakti SIFQ	Fakti publikuar ne fiskale
Vendori duke perfshire financimin e huaj	**46,400**	**46,816**	**48,132**	**46,487**
Shpenzime kapitale	**73,330**	**73,462**	**76,436**	**68,455**
Financim I brendshem	48,060	48,192	45,589	45,589
Financim te huaj	24,570	24,570	30,258	22,278
Nga TR arsimit te larte	700	700	589	589
Net Lending	**4,500**	**5,500**	**1,500**	**9,217**
Hua e dhene	6,000	7,000	1,500	11,126
Hua e kthyer	(1,500)	(1,500)	-	(1,909)
Deficiti	**(31,199)**	**(31,299)**	**(32,827)**	**(31,012)**
PBB	**1,596,382**	**1,596,382**	**1,555,202**	**1,555,202**
Deficiti/PBB	**-1.95%**	**-1.96%**	**-2.11%**	**-1.99%**

- Shenzimet për pushtetin vendor paraqiten në shumën 48,132 milionë lekë në SIFQ dhe janë të raportuara në shumën 46,487 milionë lekë në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Nga auditimi rezulton se një pjesë e diferencës, ekziston për shkak të raportimit të shpenzimeve me burim financimi të huaj të vendorit në zërin e huadhënies neto në formën e huasë së disbursuar për vendorin. Me anë të riklasifikimit të kryer nga MFE jashtë SIFQ tejkalimi i planit të pushteti vendor i paraqitur sipas SIFQ është mbuluar për këtë zë, duke denatyruar informacionin financiar përkundrejt fondeve të miratuara.Tabela e treguesve fiskalë të konsoliduar e raportuar, ka diferenca nga tabela e treguesve fiskalë sipas raportit të SIFQ, ku ndërhyrjet janë realizuar nga jashtë. Riklasifikimi i këtyre zërave është në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" sipas së cilit, raportimi i zbatimit të buxhetit realizohet nëpërmjet SIFQ dhe në të njejtën kohë me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, sipas së cilit nuk janë miratuar fondet për shpenzimin kapital të pushtetit vendor nga financimi i huaj.

-Shpenzimet kapitale me financim të huaj paraqiten në shumën 30,258 milionë lekë sipas SIFQ, ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar janë paraqitur në shumën 22,278 milionë lekë, duke i raportuar nën planin përfundimtar të tyre në shumën 24,570 milionë lekë. Tejkalimi i këtyre shpenzimeve të riklasifikuara është paraqitur në zërin e huadhënies neto në formën e huassë së dhënë për dy sektorët e tjerë përveç vendorit në të cilën është realizuar nënhuadhënia.

- Huaja e kthyer në shumën -1,909 milionë lekë e raportuar në zërin hua e kthyer nga huadhënia neto, paraqitet e keqklasifikuar, duke qenë se sipas raportit të SIFQ, raportohet poshtë zërit të deificitit në zërin të tjera edhe riklasifikimi i saj ka efekt në shtesën e deficitit me 1,909 milionë lekë. Nga ana tjetër, hua e kthyer nga huatë e dhëna si mbështetje buxhetore nga vitet e kaluara vlerësohet të jetë në shumën 262 milionë lekë. Efekti neto në deficit si pasojë e raportimit jo të saktë vlerësohet të jetë në shumën 1,647 milionë lekë si diferencë ndërmjet huasë së kthyer për projektet e huaja me huasë së kthyer nga mbështetja buxhetore.

- Në zërin e huadhënies neto, është raportuar mbështetje buxhetore për sektorin energjitik nga burime të brendshme në shumën 1,500 milionë lekë,

[shqiptaria.com]

ndërkohë që nga auditimi është konstatuar se mbështetja buxhetore faktike për vitin 2017 rezulton në shumën 2,500 milionë lekë. Efekti i keqklasifikimit prej 1,000 milionë lekë është raportuar në llogarinë (604-transferta), duke raportuar për të njejtin transaksion në dy llogari të ndryshme buxhetore. Klasifikimi i gabuar nuk vlerësohet me ndikim në deficit, por në cilësinë dhe saktësinë e tregusve të raportuar të shpenzimeve, duke qenë se plani sipas përdorimit të Fondit Rezervë është pasqyruar në zërin e huadhënies neto (shtesa e planit nga 4,500 milionë lekë në 5,500 milionë lekë), ndërkohë që realizimi i tij është pasqyruar në shpenzimet e buxhetit për trasnfertat, megjithëse transaksionet e mësipërme janë hua në bazë të marrëveshjeve përkatëse me OSHEE, si përfituese e financimit.

-Huaja e dhënë për sektorin energjitik nuk është raportuar e plotë duke qenë se nuk janë përfshirë efektet e mosraportimit të projekteve me financim të huaj në shumën 1,934 milionë lekë. Huaja e dhënë për sektorin të tjera nuk është raportuar e plotë duke qenë se nuk janë përfshirë efektet e mosraportimit të projekteve me financim të huaj në shumën 170 milionë lekë, e cila duhet të riklasifikohet në zërin e shpenzimeve kapitale e gjitha. Së bashku me efektin e keqklasifikimit dhe mosraportimit të projekteve shtohet zëri shpenzime kapitale me finanim të huaj në shumën 3,244 milionë lekë. Huaja e disbursuar e raportuar në zërin e shpenimeve kapitale, jo në formën e huadhënies neto, nuk është raportuar e plotë duke qenë se nuk janë pëfshirë efektet e mosraportimit të projekteve me financim të huaj në shumën 1,689 milionë lekë (3,793 -1,934 = 1,689). Huaja totale e tejkaluar si pasojë e mospasqyrimit të disbursimeve përkatëse si pasojë e tre efekteve të mësipërme vlerësohet me efekt në deficit në shumën 3,793 milionë lekë (1,689 +1,934 + 170), duke qenë se raportimet e projekteve specifike nuk janë raportuar për llogari të vitit buxhetor 2017, kur është kryer edhe disbursimi sipas konfimimeve të strukturave të borxhit, por janë raportuar në vitin 2018. Kjo ka nënvlerësuar tre zëra buxhetorë, huadhënien neto, shpenimet kapitale me financim të huaj dhe deficitin e raportuar.

- Shpenzimet e konvertimit të monedhave në shumën 567 milionë lekë janë raportuar në formën e të ardhurës nga këmbimi valutor em shenjë negative, duke nënvlerësuar seksionin e të ardhurave të tjera. Nga ana tjetër, konstatohet se këto transaksione janë të pambuluara me fondet buxhetore përkatëse, duke qenë se kosto e konvertimit për vitin 2017, si rrjedhojë e kontratave SWAP paraqitet keqklasifikuar.

- Në total efekti i tejkalimit të deficitit të raportuar vlerësohet në shumën 5,440 milionë lekë, e përbërë nga 3,793 milionë lekë si pasojë e diferencave në disbursime ndërmjet vlerave të pasqyruara si shpenzim nga thesari në krahasim me borxhin dhe 1,647 milionë lekë si pasojë e riklasifikimit të arkëtimit nga marrëveshjes së nënhuasë si pasojë e riklasifikimit. Si rrjedhojë, deficiti i vlerësuar rezulton në shumën 36,452 milionë lekë, duke tejkaluar kufijtë e vendosur me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar. Në të njejtën kohë ndryshon edhe raporti i deficitit në raport me PBB duke arritur vlerën prej 2.41%, duke kaluar kufirin prej 2%, në kundërshtim me nenin 4/1 "Parimet dhe rregullat fiskale të ligjit nr.9936 datë 26.26.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, *pa marrë në konsideratë efektin e detyrimeve të prapambetura.* Në tejkalim të planit të vendosur me Akt Normativ nr.3 paraqiten edhe shpenzimet kapitale me

financimt të huaj, seksioni të tjera i deficitit si dhe huaja e dhënë dhe huaja e kthyer për energjinë.

Tabela 95: Efektet e detyrimeve të prapambetura dhe shpenzimeve të paraportuara *mln lekë*

Treguesi	Plan A.N.3	Plani An.3+ F.R+F.K	Fakti SIFQ	Fakti publikuar ne fiskale	Fakti KLSH riklasifikim	Fakti KLSH riklasifikim +shpz pa raportuara
Vendori duke perfshire financimin e huaj	**46,400**	**46,816**	**48,132**	**46,487**	**48,133**	**48,133**
Shpenzime kapitale	**73,330**	**73,462**	**76,436**	**68,455**	**71,530**	**73,389**
Financim I brendshem	48,060	48,192	45,589	45,589	45,589	45,589
Financim te huaj	24,570	24,570	30,258	22,278	25,352	27,211
Nga TR arsimit te larte	700	700	589	589	589	589
Net Lending	**4,500**	**5,500**	**1,500**	**9,217**	**6,406**	**9,078**
Hua e dhene	6,000	7,000	1,500	11,126	6,406	9,340
Hua e kthyer	(1,500)	(1,500)	-	(1,909)	-	(262)
Deficiti	**(31,199)**	**(31,299)**	**(32,827)**	**(31,012)**	**(32,921)**	**(36,452)**
PBB	**1,596,382**	**1,596,382**	**1,555,202**	**1,555,202**	**1,555,202**	**1,555,202**
Deficiti/PBB	**-1.95%**	**-1.96%**	**-2.11%**	**-1.99%**	**-2.12%**	**-2.34%**

- Mosraportimi i detyrimeve të prapambetura

Detyrimet e prapambetura dhe stoku i rimbursimit të TVSH, trajtuar më hollësisht në pjesët e tjera të këtij raporti, nuk është përfshirë në llogaritjet më sipër. *Nëse detyrimet e prapambetura të krijuara gjatë vitit 2017 të paguara në 7 mujorin e parë të 2018 (11.5 miliardë lekë) dhe rritjen e stokut të rimbursimit të TVSH gjatë 2017 (7.2 miliardë lekë) do të ishin raportuar në treguesit fiskal si shpenzime të periudhës, niveli i deficitit të raportuar do të qe të paktën 3.54% e PBB-së. Në përfundim, treguesi nga evidencat e marra niveli i raportuar në treguesit fiskal nuk jep një pamje të drejtë të deficit buxhetor për vitin 2017 dhe rruajtjes së limiteve në vite elektorale.*

10.3 Raportimi i pasqyrave financiare të shtetit

- Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dërguar pranë Kontrollin e Lartë të Shtetit në lidhje me Raportin vjetor të zbatimit të buxhetit 2017, konstatohet se, *edhe për vitin 2017, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, nuk janë pjesë e këtij raporti.*
- Konstatohet ***një mungesë disavjeçare e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të Qeverisë***.
- Në kushtet kur procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është një objektiv kombëtar, dhe ndërkohë që, kuadri legjislativ «acquis communautaire» mbi raportimin financiar i BE-së evolon në mënyrë domethënëse, mungesa disavjeçare e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit në gjykimin tonë tregon se, përpjekja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë drejtim është larg emergjencës që reflekton kjo situatë. Përveç kësaj, në një kohë kur krijimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale si dhe forcimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor të raportimit financiar janë shumë të rëndësishme për aderimin në BE, konstatohet se, në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit i cili ka ndër përgjegjësitë e tij kontabilitetin publik dhe raportimin financiar ju suprimuam pozicionet e punës së dy specialistëve të dedikuar për kontabilitetin, duke krijuar në këtë mënyrë një riskt operacional të lartë dhe hapësira për të mos përmbushjen e misionin kryesor atë të kujdesit për

[shqiptare.com]

një raportim financiar të besueshëm dhe cilësor bazuar në parimet kryesore të kontabilitëtit në sektorin publik.

- Mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik rregullohet mbi bazë të "*Planit kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal dhe Institucioneve Shtetërore Qendrore dhe Lokale dhe njësive që varen prej tyre*" të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.04.1998, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 248, datë 10.04.1998 të Këshillit të Ministrave*". Duhet theksuar se VKM nr. 248, datë 10.04.1998 dhe VKM nr. 25, datë 20.01.2001 janë hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 3, 5, dhe 74, të Ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993 "*Për kontabilitetin*", Ligj i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 9228, të datës 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006. **Pra bazë mbi të cilën rregullohet kontabilitetit publik është e shfuqizuar,** konstatim ky i bërë vite me rradhe nga KLSH.
- Konstatohet mungesa e një manuali të kontabilitetit publik i cili do të bënte të mundur vendosjen e rregullave dhe procedurave kontabile për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare në mënyre që të kishim konsistencë të trajtimit kontabël dhe përdoruesit të orientoheshin mbi rregulla unike për mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar.
- Konstatohet dhe pranohet nga vetë Drejtoria e Thesarit se:
- Ka diferenca midis Pasqyrave Fizike (manuale) të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë. Diferenca që sipas të dhënave të marra në institucion konsistojnë në njohjen e të ardhurave pasi në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ pasqyrohen të ardhurat mbi bazë cash (arkëtimet e vitit), ndërsa pasqyrat fizike (manuale) të institucioneve buxhetore pasqyrojnë të drejtat e konstatuara..
- E njëjta problematikë konstatohet edhe tek njohja e shpenzimeve për të cilat shpjegohet se pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ pasqyrojnë shpenzimet faktike të vitit, ndërsa pasqyrat fizike (*manuale*) të institucioneve buxhetore pasqyrojnë detyrimet e konstatuara dhe të pa paguara (*tipike janë pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo detyrimi për tatim mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzim në muajin dhjetor të vitit dhe që paguhen nga buxheti në vitin e ardhshëm*).
- *Nga auditimi u konstatua se,* ***Njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë vazhduar kontabilizimin e transaksioneve financiare për periudhat e mbyllura më parë përgjatë gjithë vitit 2017.***
- Vlera totale e Aktiveve në celje të periudhës ushtrimore 2017,ose e thënë ndryshe, totali i aktiveve të vitit 2016, e konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me datë 21.07.2017, ishte në vlerën 1,484,679,794,768 lekë, ndërkohë që po kjo drejtori më datë 23.07.2018, konfirmon se totali i aktiveve të vitit 2016, është në vlerën 1,490,836,270,201 lekë pra me një diferencë për 6,156,475,433 lekë më shumë.
- Përgjatë vitit 2017, nga shitja e pronës shtetërore, në llogarinë 116 "Shitja e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara" të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kontabilizuar të ardhura në vlerën **407,015 mijë lekë**, kjo pasi shitja e pronës shtetërore kryhet vetëm nga Ministria e

Financave dhe Ekonomisë. ***Nga auditimi u konstatua se, për aktivet e shitura, të cilat nuk janë pronë e Aparatit të MFE, nuk është bërë kontabilizimi i hyrjes së këtyre aktiveve*** duke krijuar në këtë mënyrë anomali në pasqyrat financiare. Gjithashtu Pasqyrat financiare të MFE nuk pasqyrojnë drejt rezultatin (fitim ose humbje) nga shitja e këtyre aseteve objekt i procedurave të privatizimit, sikurse përcaktojnë kërkesat e kuadrit të raportimit financiar.

- Nga Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u konstatua se, me urdhër shpenzimin nr. 143, datë 06.03.2017, është bërë **pagesa në vlerën 155,595 mijë** në favor të përfituesit Black Sea Trade and Development Bank me përshkrimin "Pagesë për Bankën e Detit të Zi për rritjen e aksioneve të Republikës së Shqipërisë". Kjo pagesë është raportuar ***në llogarinë 605 "Transerime korrente me jashtë"***, ndërkohë që referuar natyrës së transaksionit **ajo duhej të *ishte klasifikuar në llogarinë e aktiveve afatgjata financiare në formën e pjesëmarrjeve në kapital.*** Efekti i trajtimit të gabuar kontabël ndër vite i këtij transaksioni ***në vlerën 700,178 mijë lekë*** ka rezultuar në aktive afatgjata financiare të pa pasqyruara në pozicionin financiar

- Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Brendshme , Ministria e Mbrojtjes dhe SHIK, kanë përdorur **Letër Kredi** për likuidimin e projekteve të investimit në vlerën 198,6 milionë lekë për kontrata e lidhura në datën 28 dhe 29 dhjetor të vitit 2017 **duke e kontabilizuar atë në zërin 231 Aktiv të Trupëzuara.** Gjithashtu konstatohet se, për vitin 2017, Ministria e Mbrojtjes ka përdorur **Letër Kredi** edhe për likuidimin e **shërbimeve operative në vlerën 12,3 milionë lekë** duke e kontabilizuar përdorimin e **Letër kredisë si një shpenzim operativ.**Përdorimi i L/C tregon se kemi të bëjmë ***pagesën e një garancie*** të vlerës së investimit të pritshëm dhe jo me një investim apo shpenzim të realizuar sic është raportuar nga ana e ministrive duke deformuar në këtë mënyrë pasqyrat financiare të shtetit

- Për vitin 2017, janë angazhuar fonde të planifikuara si investime (në llogarinë 230 Shpenzime për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuara), për kryerjen e shpenzimeve operative si shpenzime për paga dhe sigurime, shpenzime postare , të telefonisë celulare, shpenzime udhëtimi, dieta etj. ***Shumat e deklaruara si investime kapitale janë të angazhuara në shpenzime operative, duke rritur llogarinë e investimeve në proces si pasojë e klasifikimit jo të duhur në llogarinë kontabël, sipas përshkrimit të bërë nga njësitë e zbatimit të projekteve***. Shpenzimet operative të lartpërmendura nuk kontribuojnë në krijimin e një aktivi, duke qenë se nuk plotësohen kushtet për njohjen e një aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar. Në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me krijimin e aseteve të paprekshme si studime ose kërkimore patenta, softëare, licenca, marka

- Nuk kemi prekur të dhënat e **aktiveve të trupëzuara** sepse referuar problematikave të konstatuara në institucione të të gjitha niveleve ku nuk ka një pamje të qartë të këtyre zërave, nuk ka një ndjekje të transferimeve të tyre dhe aq më pak nuk ka vlerë reale të këtyre aktiveve e dimë që vlera e pasqyruar në këto grupe nuk tregon vlerën reale të pasurisë shtetërore. *Për vitin 2017, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka një metodologji për vlerësimin e aseteve e cila duhet të shërbejë si bazë për përgatitjen e inventarit të aseteve si për qeverisjen e përgjithshme ashtu edhe për atë vendore.*

[shqiptaria.com]

10.4 Auditimi financiar i pasqyrave të aparatit të MFE

KLSH ka konstatuar devijime materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që rezultuan në një opinion të kundërt duke qenë se nuk paraqesnin situatën dhe përformancën financiare për vitin 2017. Shpenzimet nuk regjistrohen në momentin që konstatohen por ato regjistrohen në momentin që paguhen, duke krijuar efekte në nënvlerësim të detyrimeve për sa i përket tepricave në çelje dhe mbyllje të periudhave ushtrimore. Shkak i këtyre gjetjeve në pjesën më të madhe të rasteve ishte mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme si dhe mbivendosja e drejtimit në këto kontrolle. Defiçencat e theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, kanë sjellë detyrime të pakontabilizuara për vendime gjyqësore, fatura investimesh dhe fatura të shpenzimeve operative, çka duke marrë parasysh nivelin e materialitetit dhe shkallën e gjerë të përhapjes së tyre, i bëjnë pasqyrat financiare të pasakta. Ndër problematikat kryesore të evidentuara në kuadër të kuadrit të raportimit financiar publik paraqiten:

-Nga auditimi i kampioneve të përzgjedhur u konstatuan fatura të mbërritura dhe të paregjistruara në vlerën 700,781 mijë lekë, nga të cilat, fatura investimesh të realizuara, të pa regjistruara as si investim pjesor i kryer dhe as si detyrim në fund të vitit raportues në shumën 90,137 mijë lekë, fatura të shpenzimeve operative të cilat nuk janë regjistruar si shpenzim në pasqyrën e performancës dhe as detyrim në fund të vitit në shumën 4,426 mijë lekë dhe-detyrime të pakontabilizuara për vendimet gjyqësore me objekt të tyre rikthimin në punë të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht, për 19 prej tyre, për një periudhë 3 vjeçare në shumën 70,915 mijë lekë.

-MFE ka raportuar përgjatë vitit 2017, në llogarinë 116 "Shitja e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara" të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ardhura në vlerën 407,015 mijë lekë nga shitja e pronës shtetërore, për aktivet e shitura, të cilat nuk janë pjesë e aseteve të pasqyrave financiare të Aparatit të MFE.

-Pjesëmarrjet në kapitalin e institucioneve financiare si në rastin e Black Sea Trade and Development Bank në vlerën 155,595 mijë për vitin 2017 nuk raportohen si rritje e aktiveve afatgjata financaire, por raportohen si shpenzim i periudhës. Efekti i trajtimit të gabuar kontabël ndër vite i këtij transaksioni në vlerën 700,178 mijë lekë ka rezultuar në aktive afatgjata financiare të pa pasqyruara në pozicionin financiar.

-Hua e dhëna Fodnit Kombëtar dhe kthimi i tyre nuk raportohen si e drejtë për të arkëtuar dhe si shlyerje e të drejtës në maturim të saj, por raportohen si shpenzim dhe e ardhur. Në të ardhurat e krijuara për 2017 është regjistruar dhe kontabilizuar edhe llogaria 778/100 "Të ardhura-korrigjime nga viti i kaluar", në vlerë 20,555 mijë lekë, e cila nuk është vlerë të ardhurash, por një "hua" e dhënë nga Ministria e Financës për fondet IPA në qershor të vitit 2016. Në pasqyrën e performancës është raportuar si shpenzim në formën e transfertës drejt të tretëve në vlerën 84,512 mijë lekë, pagesë në favor të Fondit Kombëtar për fondet IPA për financimin afatshkurtër. Ky trasferim fondi është një shumë e dhënë hua me kushtin për t'u kthyer brenda një afati të caktuar dhe raportimi nuk është bërë si një e drejtë për të arkëtuar, por si një shpenzim i periudhës në formën e transfertës.

lehqipteria.com

-Parapagimet e kryera për zhvillimin e proceseve gjyqësore të shtetit shqiptar janë raportuar si shpenzim operativ, duke keqklasifikuar raportimin e tyre në shumën 14,338 mijë lekë.

- Është konstatuar se fondet për projekte me financim të huaj paraqiten me keqklasifikim në raportimin për efekt buxheti (gabim i konstatuar që në fazën e planifikimit e deri në raportim) në shumën 106,100 mijë lekë, ku raportohen si investime fonde të ekzekutuara në trajnime dhe konsulenca.

- Fondet e angazhuara në projekte me financim të huaj në shumën 154,120 mijë lekë, zbatuar nga CFCU, pjesë e strukturës organizative të MFE nuk janë raportuar në pasqyrat financiare.

[shqiptarja.com]

11. RIORGANIZIMI I MINISTRIVE DHE PROBLEMET E KONSTATUARA

Riorganizimi i Ministrive përgjatë vitit 2017 është realizuar nëpërmjet VKM përkatëse për secilën ministri në të cilën janë përcaktuar fushat e përgjegjësisë. Konsolidimi i aktivitetit operativ dhe investues të vitit është pasqyruar edhe në Aktin Normativ Nr. 3 datë 06.11.2017, në të cilën janë pasqyruar programet respektive për secilën ministri përthithëse të ministrive të mbyllura. Në lidhje me pozicionin financiar konstatohet se, *nuk janë nxjerrë aktet e nevojshme ligjore për mbështetjen e konsolidimit të të drejtave, aseteve dhe detyrimeve të entiteteve raportuese të mbyllura.*

11.1 Probleme të konsolidimit kontabël dhe buxhetor dhe mungesa e vijueshmërisë institucionale rasti i përthithjes në Ministritë e riorganizuara

Procesi i rioganizimit ka sjellë ndryshime me krijimin e Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Evropës dhe Punës të Jashtme. Nga auditimet e zhvilluara nga KLSH është konstatuar se procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare dhe të buxhetit është realzuar vetëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është formuar nga bashkimi i ish-Minsitrisë së Energjisë dhe Industrisë, ish-Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e cila përthithi një pjesë të ish-MZHETTS dhe një pjesë të ish-MMSR-së nuk e ka kryer procesin e konsolidimit si në drejtim të pozicionit ashtu edhe në drejtim të përformancës financiare. Asetet, të drejtat, detyrimet e mundshme që lidhen me programet specifike të përthithura nga ish-ministritë nuk rezultojnë të jenë përthithur dhe kosoliduar në sistemin kontabël të aparatit të MFE. Kjo ka krijuar kushtet e copëzimit të aseteve, ku një pjesë e investimit është pasqyruar në pasqyrat financiare të MFE dhe pjesa tjetër nuk është raportuar fare në kuadër të kostos së mbartur në pasqyrat financiare. Edhe pse nga aparati i ish-MZHETTS u hartua lista e aseteve, ajo nuk u konsolidua dhe nuk u raportua në pasqyrat financiare të aparatit të MFE për vitin 2017 me një efekt prej rreth 300 milion lekë, pavarësisht Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për konsolidimin e aseteve. Në të njëjtin akt, është urdhëruar edhe konsolidimi i aseteve të ish-MMSR që i korrespondojnë fushave të përgjegjësisë të përthithura sipas programeve specifike, i cili rezulton të mos jetë ekzekutuar si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga ana e përfaqësuesve të ish-MMSR (në MSHMS) me grupin e ngarkuar për zbatimin e urdhrit (sipas memos përkatëse drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë). Në të njëjtën kohë edhe integrimi i të drejtave për të arkëtuar apo detyrimeve të mundshme konstatohet të mos jetë realizuar duke e shndërruar në kaotik procesin e raportimit financiar publik, në drejtim të ushtrimit të të drejtave të ligjshme mbi debitorët apo evidentimin dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Për sa i përket aktiviteti vjetor, problematika u konstatua në dy drejtime:

-***Investime në proces*** të realizuara në vitin 2017 nga ish-aparatet e ministrive të mësipërme sipas programeve të përthithura, **të papërfshira** në pasqyrat financiare të aparatit të MFE, rezultuar nga lëvizja e cash-it në thesar është në shumën **710,497 mijë lekë**, nga të cilat 73,735 mijë lekë për investime në aktive të qëndrueshme të patrupëzuara dhe 636,762 mijë lekë për investime në aktive të qëndrueshme të trupëzuara.

-***Shpenzime operative të papërfshira*** në pasqyrën e performancës rezultojnë në shumën **302,631 mijë lekë**, nga të cilat 260,427 mijë lekë shpenzime operative

Shqiptaria.com

të ish MZHETTS në programet e përthithura të aparatit dhe 42,203 mijë lekë shpenzime operative të ish-MMSR për pjesën e programeve të përthithura të aparatit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila përthithi një pjesë të aktivitetit të ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale në të njëjtën mënyrë si MFE nuk e ka kryer procesin e përthithjes për programet respektive të marra nga ish-MMSR dhe asetet koresponduese. Pasqyrat financiare për vitin 2017 janë hartuar duke lënë jashtë raportimit financiar asetet, të drejtat, detyrimet e ish-aparatit të MMSR dhe në të njëjtën kohë edhe për aktivitetin operativ e investues të vitit 2017. **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** e cila përthithi një pjesë të aktivitetit të ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale në të njëjtën mënyrë si MFE nuk e ka kryer procesin e përthithjes për programet respektive të marra nga ish-MMSR dhe asetet koresponduese. Pasqyrat financiare për vitin 2017 janë hartuar duke lënë jashtë raportimit financiar asetet, të drejtat, detyrimet e ish-aparatit të MMSR dhe në të njëjtën kohë edhe për aktivitetin operativ e investues të vitit 2017. Punonjësit e ish-MMSR rezulton të mos kenë kryer dorëzimin e detyrës në momentin e largimit nga puna, si rrjedhojë procesi invetarizimit për aktivet e qëndrueshme dhe qarkulluese të ish MMSR-së, referuar urdhrit të Titullarit të këtij institucioni, mbeti jo i plotë duke u përqëndruar vetëm në gjendjen fizike të aseteve në disa zyra pa cmime dhe vlerë sipas gjendjes kontabile nga ish MMSR.. Efekti i ***aktivitetit investues dhe operativ të pa pasqyruar*** vlerësohet në rreth **1.8 miliard lekë** për 11-mujorin e ekzekutuar nga ***Aparati i ish-MMSR.*** Efekti i aseteve të pakonsoliduara, sipas raportimit të vitit 2016 (pasi raportimi 11-mujor për sih-MMSR nuk është kryer) vlerësohet në rreth ***1 miliard lekë***. Kjo vlerë nuk merr parasysh efektin 11-mujor për vitin 2017 të realizuar nga viti 2017 për aktivitetin investues me ndikim në pozicionin financiar në shpenzimet në proces për rritjen e aktiveve.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rezulton të ketë kryer konsolidimin si pasojë e përthithje së aktiviteti nga aparatet të cilat u shkrinë si pasojë e ndryshimit të fushave të përgjegjësisë. KLSH ka konstatuar se bashkimi është kryer në bazë të raportimeve të secilës njësi individuale të aparatit të ish-MZHU, ish-MEI dhe ish-MTI për aktivitetin 11-mujor dhe pasqyrave financiare deri në Nëntor 2017. Të gjitha veprimet janë pasqyruar, megjithëse nuk janë integruar në sistemin kontabël, me anë të eviencave të konfirmuara nga jashtë, ku për asetet e transferuara nga ish-MZHU dhe ish-MEI të cilat u përthithën nga aparati i MTI është kryer edhe verifikimi fizik. Të drejtat dhe detyrimet vlerësohet të jenë konsoliduar sipas raportimeve të secilës njësi individuale të shkrirë.. Me kalimin e njësive të reja të varësisë për vitin 2017 janë hartuar edhe pasqyrat financiare të konsoliduara, sipas njësive përkatëse të varësisë të përthithura.

KLSH, konstaton se,

a) Në lidhje me projektin e investimit "Ndërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë" përgjatë periudhës 10 mujore Janar-Tetor 2017, nga ish Ministria e Mjedisit janë kryer pagesa në vlerën 505,262 mijë lekë, ndërkohë që për periudhën Dhjetor 2017, në lidhje me këtë projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë kryer pagesa në vlerën 131,309 mijë lekë.

b) Në lidhje me projektin e investimit "Dhënies me koncension e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie" konstatohet se, përgjatë periudhës 10 mujore Janar-Tetor 2017, nga ish Ministria e Mjedisit janë kryer pagesa në vlerën 590,000 mijë lekë,

ndërkohë që për periudhën Dhjetor 2017, në lidhje me këtë projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë kryer pagesa në vlerën 162,770 mijë lekë.

Tabela në vijim paraqet dinamikën e projekteve të investimit nga faza e planifikimit fillestar me Ligjin e Buxhetit të vitit 2017 deri në realizimin e tyre për vitin 2017.

Tabela 96: Dinamika e projekteve të investimit *Në mijë lekë*

Kodi	Pershkrimi	Progr.	Kod. Projekti	Projekti	Ligji	AN03	Fakti
26	Ministria e Mjedisit	5320	M260351	Dhënies me koncension e ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie"	590,000	590,000	590,000
6	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	6220	M064079			163,383	162,770
26	Ministria e Mjedisit	5320	M260326	"Ndërtimi dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë"	553,119	505,262	505,262
6	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	6220	M064078			155,628	131,309

Referuar sa më lart, konstatohet se, financimi i këtyre dy projekteve koncensionare është kryer nga programi 5320 "Programe për mbrojtjen e mjedisit " i ish Ministrisë së Mjedisit për 10 muajt e parë të vitit, në vlerën totale 1,095,262 mijë lekë dhe për 2 muajt e tjerë të vitit financimi i këtyre dy projekteve është kryer nga programi 6220 "Menaxhimi i mbetjeve urbane" të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në vlerën 294,079 mijë lekë.

Pra: *Akti Normativ nr. 3, datë 06.11.2017 bëri të mundur copëtimin e investimit të vitit dhe investimit total të mbartur në vite duke kaluar investimet nga njëra ministri në tjetrën , megjithëse* ***Ministria e Mjedisit dhe Minsitria e Infrastrukturës dhe Enegjisë nuk rezulton të jenë të përfshira në konsolidime ndërmjet njëra tjetrës.*** *(programi 5320"Programe për mbrojtjen e mjedisit "i Ministrisë së Mjedisit, nuk ka kaluar në MIE, por në MIE kanë kaluar vetëm projektet e investimit të lartpërmendur pjesë e këtij programi).*

Konstatohet se, në Pasqyrat Financiare të Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit vlera e këtyre aktive është pakësuar për ***2,141,404 mijë lekë*** *referuar pagesave të bëra në lidhje me këto investime, ndërkohë që kjo shtesë aktivesh* ***nuk është pasqyruar në Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ekonomisë.***

Ministria e Turizimit dhe Mjedisit e cila ka përthithur një pjesë të aktivitetit të ish-MZHETTS nuk ka pasur ndikim në aparatin e saj si pasojë e përthithjes së programeve buxhetore duke qenë se këto programe kanë financuar njësi varësie të ish-MZHETTs, të cilat me ndryshimin e fushave të përgjegjësisë kaluan në varësi të MTM. Ndryshimi i varësisë nuk vlerësohet të ketë efekt në konsolidim duke qenë se kryhet nga njësi të pavarura raportuese të cilat kanë përfshirë të gjithë aktivitetin 12 mujor të këtyre programeve. Konsolidimi si pasojë e përthithjes është reflektuar edhe në pasqyrat financiare të konsoliduara të cilat i kanë reflektuar ndryshimet për përthithjen e këtyre dy njësive.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit rezulton në përthithje të një programi nga ish-MZHU i cili është shoqëruar me transferimin e funksioneve të monitorimit të tij. Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale, i transferuar, ekzekutohet nga ana e njësive të qeverisjes vendore dhe raportimi nëlidhje me asetet e krijuara nga ky program realizohet nga këto njësi. Në këtë mënyrë, ndryshimi i njësisë së monitorimit të programit nuk është shoqëruar me problematika në drejtim të pasqyrave financiare.

lsh.gov.al

12. PËRMBLEDHJE E SHKELJEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

12.1 Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm në buxhetin e shtetit dhe detyrimet debitore deri më 31.12.2017

I.	TË ARDHURA TË MUNGUARA PËR BUXHETIN E SHTETIT	000/lekë
1	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR	12,748
2	NGA SHKELJET E LEGJISLACIONIT NË MBLEDHJEN E SIGURIMEVE SHOQËRORE	
3	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E KODIT DOGANOR	2,136,644
4	NGA KEQADMINISTRIMI I PRONËS SHTETËRORE TË DHËNË ME QERA DHE KONCESIONE	2,499,022
5	NGA SHKLEJET NË ZBATIM TË LEGJISLACIONET PER TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE	39,984
6	NGA KEQADMINISTRIMI I PROJEKTEVE ME FINANCIM TË HUAJ	55,875
7	TË TJERA	76,418
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË MUNGUARA ME EFEKT NË BUXHETIN E SHTETIT, VITI 2017	**4,820,691**

II.	DËMI EKONOMIK PËR BUXHETIN E SHTETIT	000/lekë
1	NË SHPENZIMET PËR PAGA, SIGURIME DHE SHPËRBIME	11,289
2	NË SHPENZIMET OPERATIVE	62,301
3	NË FONDIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR	156,970
4	NË SHPENZIMET PËR INVESTIME	572,723
5	NË ZBATIMIN E PROJEKTEVE ME FINANCIM TË HUAJ	252,871
6	TË TJERA	183,225
	TOTALI I DËMIT TË KONSTATUAR ME EFEKT NË BUXHETIN E SHTETIT, VITI 2017	**1,239,379**

TOTALI I DËMIT (I+II) = 6,060 milionë lekë

III.	TË DHËNAT MBI SHTESËN E DETYRIMEVE DEBITORE	000/lekë
1	VLERA E BORXHIT TATIMOR NË SEKTORIN E TATIMEVE (DPT)	10,500,000
2	VLERA E BORXHIT DOGANOR NË SEKTORIN E DOGANAVE (DPD)	1,000,000
	SHTESA E DETYRIMEVE PËR VITIN 2017	**11,000,000**

12.2 Të ardhura apo shpenzime të realizuara në kushtet e parregullsive në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, me efekte negative për buxhetin e shtetit e vitit 2017

I.	EFEKTE NEGATIVE NË TË ARDHURAT E BUXHETIT	000/lekë
1	NGA SHKELJET E REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE (MFE)	15,866,118
2	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR	30,409,381
3	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E AMINISTISË FISKALE	12,029,713
4	NGA KEQADMINISTRIMI I PRONËS SHTETËRORE TË DHËNË ME QERA DHE KONCESIONE	292,858
5	NGA SHKLEJET NË ZBATIM TË LEGJISLACIONET PER TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE	2,429,599
6	NGA KEQADMINISTRIMI I PROJEKTEVE ME FINANCIM TË HUAJ	27,937
7	TË TJERA	717,583
	TOTALI I EFEKTEVE NË ZBATIM TË BUXHETIT TË SHTETIT, VITI 2017	**61,773,189**

[Shqiptarja.com]

II.	**EFEKTE NEGATIVE PËR SHPENZIMET E BUXHETIT**	000/lekë
1	NGA SHKELJET E REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE (MFE)	62,697,242
2	NË SHPENZIMET PËR PAGA, SIGURIME DHE SHPËRBIME	256,302
3	NË SHPENZIMET OPERATIVE	3,226,255
4	NË FONDIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR	
6	NË SHPENZIMET PËR INVESTIME	2,651,446
7	NË ADMINISTRIMIN E BUXHETIT NË PUSHTETIN VENDOR	0
8	NË KONCESIONIMIN E PRONËS SHTETËRORE	0
	TË TJERA (shpenzime nga ngritja e platformës së panevojshme në MAS)	**123,350**
	TOTALI I EFEKTEVE NË ZBATIM TË BUXHETIT TË SHTETIT, VITI 2016	**68,954,595**

TOTALI I MOS EFEKTIVITETIT (I+II) = 130,727 milionë lekë

[shqiptarja.com]

[shqiptarja.com]

PJESA E DYTË

MBI MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

[Shqiptaria.com]

[shqiptarja.com]

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë aktivitetit të tijj auditues zbaton standarded ndërkombëtare ISAI dhe praktikat më të mira të EUROSAI dhe INTOSAI të cilat e vënë theksin tek auditimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm si faktor kryesor për mirëqeverisjen e fondeve publike si dhe një garanci për përgjegjshmërinë dhe transparencën e enteve publike. Ky objektiv është patur në konsideratë gjatë vlerësimit të funksionimit të sistemit të auditit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", *i ndryshuar* me ligjin 110/2015 datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" *përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit* në njësitë publike të Republikës së Shqipërisë, *si dhe përgjegjësitë menaxheriale* për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, *me qëllim përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.*

Fusha e zbatimit të këtij ligji, shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme; shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për miratimin e udhëzimeve e të manualeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë publike, që mbulojnë në mënyrë të veçantë: metodologjinë për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me standardet e kontrollit të brendshëm, të pranuara ndërkombëtarisht; formën, përmbajtjen dhe afatet për raportimin periodik të nëpunësi i parë autorizues rreth funksionimit, përshtatshmërisë, efiçencës dhe efektivitetit të sistemeve ekzistuese të menaxhimit financiar dhe kontrollit, parregullsitë e gjetura dhe masat e marra; formën, përmbajtjen dhe mënyrën e paraqitjes së deklaratës për cilësinë dhe kushtet e kontrolleve të brendshme për vitin paraardhës; dokumentet standarde të gjurmëve të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara në të gjitha njësitë publike; procedurat standarde për një kontabilizim të plotë, të vërtetë, të saktë dhe në kohën e duhur të të gjitha transaksioneve të njësitë publike; procedurat standarde për ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumenteve financiare në njësitë publike, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi; procedurat standarde për ruajtjen, dokumentimin, qarkullimin, shitjen dhe nxjerrjen jashtë qarkullimit të aktiveve në njësitë publike; funksionet dhe detyrat e strukturës përgjegjëse për financat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në cilësinë e autoritetit përgjegjës, Ministri i Financave mbështetet në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si pjesë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik. Kjo strukturë i raporton nëpunësit të parë autorizues dhe ministrit përgjegjës të financave. Për qëllime të këtij Raporti u auditua, aktiviteti DH/AB dhe MFK i paraqitur në Raportin Vjetor "Mbi sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2017", u vlerësuan konkluzionet dhe opinioni i paraqitur në këtë raport.

Shqiptaria.com

1. MBI NIVELIN E AUDITIT TE BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

1.1 Organizimi dhe shtrirja e NJAB-ve në sektorin publik

Konstatuam se nuk ka një analizë të plotë për shtrirjen e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Baza ligjore aktuale nuk siguron pavarësinë, cilësinë e auditimit rrjedhimisht nuk garanton ngritjen e strukturave eficente.

Konstatohen pasaktësi dhe analizë e cekët si për planifikimin, kapacitetet, nivelin e gjetjeve dhe nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

Nga auditimi konstatohet se struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, DH/AB, nuk ka një analizë të plotë të sektorit publik për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe cilësinë e tij në rang kombëtar. Situata mbetet e njëjta megjithëse këtë fakt e kemi ngritur edhe në raportin e vjetshëm. Raporti i paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi sistemin dhe mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme është bazuar vetëm në 119 njësi (entitete publike). Për sa kohë nuk përcaktohen kapacitetet audituese dhe mbulimi me auditim në shkallë sistemi me njërën nga format e përcaktuara në nenin 10 "Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm" të Ligjit 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*", nuk mund të shprehemi se cfarë % të njësive që duhet të mbulohen me shërbim auditimi të brendshëm përfaqëson numri 119 mbi të cilën përgatitet raporti vjetor.

Konstatohen njësitë të vetëqeverisjes vendore të cilat nuk kanë mbulim me auditim, nuk kanë struktura si rasti i Bashkive Poliçan, Has, Pukë, Konispol, Rrogozhinë dhe Delvinë apo kanë struktura të cilat nuk janë funksionale përmendim Bashkitë Cërrik, Belsh dhe Kurbin. Raportohen 15 Institucione të Pavarura, që nuk ka mbulim me shërbimin e auditimit të brendshëm në një nga format e parashikuara në ligj, ndërsa për shoqëritë publike me kapital shtetëror nuk ka informacion të plotë.

Për mbulimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me kapacitete audituese sipas përcaktimeve ligjore, konstatohet se, gjatë këtij viti 38 njësi ose 32% e totalit të NJAB-ve e zhvillojnë veprimtarinë e tyre me më pak se tre auditues në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*". Kjo VKM ka përcaktuar edhe kriteret e krijimit të NJAB, dhe në pikën 3, të këtij vendimi është përcaktuar se: "*Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.*", çka do të thotë se, në çdo kohë në strukturat e auditimit të brendshëm në shkallë sistemi, mund të punësohen mbi 143 auditues të brendshëm të paçertifikuar ose në 3 auditues njëri mund të punësohet i pacertifikuar. Kjo hapësirë ka sjellë që në rang kombëtar rezulton se me rritjen e numrit të njësive AB të ngritura niveli i audituesve të çertifikuar ka rënë nga 90% në 77% në dy vitet e fundit ndërkohë që aktualisht në proces çertifikimi janë 36 auditues të punësuar dhe jashtë sistemin janë 1600 auditues të çertifikuar (1911[15] auditues të çertifikuar nga të cilët vetëm 308 të punësuar në sektorin publik). Kjo flet për qarkullim të shpeshtë të stafit të AB, punësimin vetëm për efekt të plotësimit të kriterit të çertifikimit apo emërimeve dhe largimeve politike.

Konstatohen 24 njësi me 1/3 ose më shumë staf me punonjës të pacertifikuar, përmendim Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Autoriteti Shendetesor Rajonal, Spitali i Traumës Tiranë,

[15] Sipas rregjistrit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

[shqiptarja.com]

Ujesjelles Kanalizime Tirane, Ujësjellës Kanalizime Shkodër, Bashkitë Ura Vajgurore, Dibër, Mat, Bulqizë, Shijak, Roskovec, Lushnjë, Divjakë, Tepelenë, Maliq, Kolonje, Pogradec, Kukës, Vau Dejës, Fushë Arrëz, Himarë dhe Sarandë.

Kjo situatë (e pranishme më shumë në organet e pushtetit vendor dhe njësitë e varësisë) cënon arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm në shkallë sistemi.

Tabela 1: Ecuria e njësive të auditimit 2013-2017

Përshkrimi/Vitet	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i njësive të auditimit	106	100	103	112	119
Pozicione të auditimit të plotësuara (në %)	95%	93.9%	92%	93%	93%
Auditues aktual të certifikuar (në %)	85%	82.9%	90%	76%	77%
Trendi (+/-)		-2%	8%	-18%	1%

Burimi: KLSH

Në raportin vjetor të KBFP për njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjejmë të cituar faktin se 10 njësi kanë drejtues të paçertifikuar por asnjë iniciativë apo tërheqje vëmendje për titullarët e njësive përkatëse. Ndërkohë të dhënat e përpunuara nga auditimi rezultojnë: 7 njësi me drejtues të pacertifikuar ku përmendim Spitali "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Spitali Rajonal Fier, Ujesjelles Kanalizime Pogradec, Bashkia Kuçovë, Bashkia Skrapar, Bashkia Klos, Bashkia Prrenjas. Ky numër do të rezultonte edhe më i lartë nëse merren në konsideratë njësitë e krijuara vetëm me një apo 2 auditues nga të cilët asnjëri nuk është i certifikuar.

Në nenin 13, pika 2 të Ligjit nr. 114/2015, është përcaktuar se: "*Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë*" dhe në pikën 3 është përcaktuar se: "*Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave*". Në zbatim të kësaj pike, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm në njësitë publike*", ku janë përcaktuar roli dhe autoriteti i Komitetit të AB, përbërja dhe funksionimi, si dhe kompetencat dhe raportimi. Në Kreun II-të "*Përbërja dhe funksionimi i KAB*", të këtij vendimi, pika 2, është përcaktuar se, "*Njësitë publike, të cilat kanë varësi funksionale nga një organ epror dhe kanë në strukturën e tyre NJAB nuk krijojnë komitete, por mbikëqyren nga komiteti i organit epror*". Në pikën 3, të kreut të III-të të këtij Vendimi, ku janë përcaktuar kompetencat dhe raportimi i Komitetit të Auditimit është cilësuar se: "*Komiteti i Auditimit të Brendshëm duhet të përgatisë, në fund të çdo viti, një raport përmbledhës për titullarin e njësisë publike, për veprimtarinë vjetore të komitetit*."

Nga sa më sipër konstatohet se, as në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe as në VKM nr. 160, datë 02.03.2016, *nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të matshme për krijimin e Komiteteve të Auditimit, duke e lënë në vullnetin e titullarëve të institucioneve, si dhe nuk cilësohet detyrimi i tyre për të raportuar në DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*. Megjithëse në auditimin e vjetshëm, u kërkua që DH/AB të kishte një rol aktiv në ngritjen dhe mirëfunksionimin e Komiteteve të Auditimit si një instrument që do të siguronte pavarësinë e strukturave dhe aktivitetit të audituesve të brendshëm, konstatohet se nuk ka hapa apo masa konkrete në këtë drejtim. Gjykojmë se DH/AB nuk ka arritur të kuptojë drejt rolin e saj udhëheqës dhe monitorues të

këtij sistemi të rëndësishëm. Për rrjedhojë megjithëse kanë kaluar mbi tre vite nga miratimi i ligjit të ri, janë krijuar vetëm 8 Komitete Auditimi, nga të cilat 5 prej tyre kanë raportuar në DH/AB. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka arritur ta vendosi në funksionim Komitetin e Auditimit. Raporti vjetor i përgatitur nga DH/AB nuk ka një analizë të plotë, referuar këtij "instrumenti", aktivitetit të Komiteteve të Auditimit.

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar përcakton krijimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, *me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik*. Neni 28, "Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", përcakton *".....Bordi shqyrton nevojën për miratimin e legjislacionit shtesë apo për përmirësimin e kuadrit rregullator të kontrollit të brendshëm financiar publik. Bordi diskuton rreth raportit vjetor për kontrollin e brendshëm financiar publik para se të miratohet nga Ministri i Financave..."* Bordi i Menaxhimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (BMKBFP), *ka patur një* aktivitet minimal dhe një arsye e këtij kontributi minimal më ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrjen por edhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm është formatimi i bordit me pjesëmarrje të gjerë të nëpunësve që kanë detyrim dhe obligim funksional për garantimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Kjo situatë kërkon vëmendjen e menjëhershme të Bordit dhe strukturës DH/AB për të bërë analizë dhe propozime konkrete për përmirësime ligjore në funksion të shndërrimit të sistemit AB në një vlerë e shtuar për sektorin publik dhe jo për tja lënë në dorë çdo gjë ndërgjegjësimit të titullarëve nëpërmjet trajnimeve. Këto përmirësime duhet të prekin komponentët:

1. Përgjegjësisë së titullarit për krijimin e njësisë AB në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Veçanërisht për njësitë e qeverisjes vendore që shpesh janë njësi të vogla me pamundësi për të ngritur NjAB me tre punonjës të merret në konsideratë bashkimi dhe krijimi i njësive të AB në rrang qarku me staf të mjaftueshëm dhe hierarkik që siguron pavarësinë, objektivitetin dhe cilësinë e auditimit.
2. Kriteret e punësimit duke ndryshuar (ulur) raportin 1/3 të audituesve të pacertifikuar për të shmangur emërime të AB pa eksperiencën e duhur, shpesh vetëm për qëllim të plotësimit të kriterit për të marrë çertifikatën e AB apo të emërimeve formale "me komandim" për një periudhë të përkohshme.
3. Parashikimin e dispozitave shtrënguese si masa disiplinore dhe organizative në funksion të zbatimit të Ligjit 114/2015 dhe Ligjit 10296 dt. 8.7.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 dt. 22.10.2015.
4. Rikonceptimi i Bordit të KBFP dhe vetë Drejtorisë së Harmonizimit të AB për një monitorim me impakt real në zhvillimin dhe administrimin e strategjive të sistemit AB në përputhje me kërkesat ligjore dhe strategjinë e MFP 2014-2020.

1.2 Planifikimi strategjik dhe vjetor

Në 12 (dymbëdhjetë) Institucione Qëndrore konstatuam mospërputhje në numrin e subjekteve për tu audituar mes planeve strategjike individuale të njësive dhe atij të konsoliduar, p.sh Ministria e Punëve të Jashtme (tani Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Integrimit Evropian, Ministira e Arsimit dhe

[Shqiptaria.com]

Sportit, Ministria e Kulturës, Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, Ministira e Mirqënies Sociale dhe Rinisë, Ministira e Mjedisist, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Punëve te Brëndshme. Ndërsa për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, u konstatua mospërputhje në 10 (dhjetë) prej tyre, përmendim Bashkia Gramsh, Bashkia Mat, Bashkia Gjirokastër, Bashkia Elbasan, Bashkia Tepelenë, Bashkia Divjakë, Bashkia Skrapar, Bashkia Lushnje, Bashkia Durrës, Bashkia Berat.

Konstatohen njësi që nuk kanë zbatuar afatin e dërgimit të planeve me një diapazon nga 1 ditë në 4 muaj (rasti i Albkontrollit). Me vonesë janë paraqitur planet nga njësitë e auditimit të DPD, Shoqëria e parë financiare e zhvillimit, DPT, Posta Shqiptare, etj. Ka subjekte të cilat gjatë vitit kryejnë rishikim të planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, por që konstatohet mungesë dokumentimi dhe arësyetimi të këtyre ndryshimeve. Gjykojmë se ndryshimi është pasojë e mosrealizimit të planeve më shumë se sa një domosdoshmëri për shkak të ndryshimeve të rëndësishme. Nga auditimi i një kampioni prej 18 dosjesh ndërmjet institucioneve që kanë bërë ndryshime, në 8 prej tyre nuk gjetëm memon argumentuese mbi ndryshimet e ndodhura. Në pjesën tjetër u konstatuan raste të mosdetajimit të planit fillestar dhe në këto kushte e patëm të vështirë të vlerësonim shkakun e ndryshimit të planit vjetor të miratuar në këto institucione.

U konstatuan pasaktësi të reflektimit të ndryshimeve të planit në të dhënat e konsoliduara, i referohemi rastit të ISSH dhe FSDKSH, fakt që shoqërohet me pasaktësi në raportin vjetor të hartuar. Gjatë vitit raportohen të jenë realizuar 149 angazhime me kërkesë të titullarëve të institcionit, ose 11% e të gjithë auditimeve të realizuara nga këto struktura.

Raporti mbi funksionimin e sistemit te kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për vitin 2017, raporton realizimin e planit në masën 100.1%, duke krahasuar nivelin e auditimeve të realizuara 1.360 kundrejt 1.358 auditimeve të programuara.

Tabela 2: Numri i auditimeve të realizuara

		Lloji i auditimeve						
	Gjithsej	A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek.Informacionit	A. të kombinuara	Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit
Realizimi (raporti vjetor, 2017)	1360	403	65	144	6	579	14	149

Po të shikojmë me një analizë të hollësishme konstatohen 46 struktura janë me mos realizim të planeve të auditimit ku përmendim Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive, ALUIZNI, ALBCONTROL, Drejtoria e Rezervave, Universiteti "A. Moisiu" Durrës, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Shërbimi.Kombëtar i Punësimit, Spitali Rajonal Elbasan, Universiteti i Tiranës, Bashkia Prrenjas, Bashkia Vorë, Bashkia Roskovec, Bashkia Divjakë, Bashkia Korçë, Bashkia Sarandë, ndërsa në 61 raste konstatuam raste të raportuara me tejkalim deri në 200% të planeve, përmendim rastin e Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqesisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtesisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, QSUT "Nënë Tereza", Ujësjellës

shqiptaria.com

Kanalizime, Durrës, Bashkia Mat, Bashkia Elbasan, Bashkia Fier, Bashkia Dropull, Bashkia Kolonjë, Bashkia Pogradec, Bashkia Malësi e Madhe dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Taksave Vendore, Tiranë. Duhet të theksojmë se 10 njësi nuk kanë raportuar asnjë aktivitet auditimi si Universiteti i Tiranës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Klos, Prrenjas, Tropojë etj të cilat kanë kryer zero aktivitet përgjatë vitit 2017, njësi këto me një numër punonjësish prej 12 auditues (paga vjetore e përllogaritur 16,380 mijë lekë).

1.3 Mbi vlerësimin e cilësisë së auditit të brendshëm

DH/AB shprehet raport se "...*Përveç vlerësimit të jashtëm të cilësisë, vlerësimet e brendshme janë një element shumë i rëndësishëm i cili siguron monitorimin dhe mbikqyrjen e punës së audituesve në vijimësi.* DH evidenton*: se 40 njësi AB ose **30%** e sistemit AB nuk garantojnë sigurojnë kontrollin e vlerësimin e cilësisë"*. Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 auditues dhe 26 njësi me 2 auditues pra gjithsej 48 njësi ose **40%** e sistemit AB janë në shkelje të Ligjit nr.114/2015 dhe nuk garantojnë kontrollin e brendshëm të cilësisë. Në vijim, grupi i auditimit ka shqyrtuar evidencat duke marrë në konsideratë dhe faktorin "*aftësi dhe kapacitete profesionale*" ku evidentojmë se për 15 njësi që vërtetë plotësojnë kriterin ligjor 2+1 të audituesve të punësuar por raporti: auditues të paçertifikuar kundrejt numrit total audituesish është mbi 1/3 sipas kriterit ligjor. Këto njësi jo vetëm që janë në shkelje të VKM nr.83 dt.3.2.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", por duhen të merren në konsideratë kur flasim për vlerësim të cilësisë së auditimit dhe efiçensën e tij. Kemi konstatuar se 15 njësi AB, raportojnë një realizim plani 100-200% por me tregues performance shumë të dobët si psh: *përqindja mesatare e zbatimit të rekomandimeve prej 36% dhe gjetje në vlerë prej 17 milion lekë në total*. Raste të tilla si:

1) KESH sha me asnjë gjetje në vlerë nga auditi i brendshëm ndërkohë që nga raporti i auditimit të KLSH vetëm vlera e një gjetje me dëm ekonomik në një marrëdhënie kontraktore është 41.5 milion lekë,
2) Bashkia Kuçovë, Vorë me zero rekomandime në dy vjet,
3) Bashkia Kolonjë, me realizim 200% të planit të auditimit por vetem me 11 rekomandime që do të thotë që ka patur dhe auditime me as edhe 1 (një) gjetje dhe rekomandim. Fakti që kjo njësi ka kryer 28 auditime në 12 muaj, koha mesatare për një auditim ka qënë 0.4 muaj pra në më pak se 10 ditë, lind pyetja a kanë qënë këto angazhime auditimi apo inspektime?
4) Bashkia Dibër me 0% rekomandime të zbatuara**,**
5) Bashkia Malësia e Madhe në 14 auditime (175% realizim plani) ka dhënë gjithsej 13 rekomandime pra më pak se 1 (një) rekomandim për auditim dhe për më tepër raporton vetëm 1 (një) të zbatuar**.**

Këto fakte, duhet të silleshin në vëmëndje në Raportin vjetor të KBFP dhe të paraqiteshin në analizë dhe opinion me profesionalizëm dhe transparencën e duhur në funksion të zbatimit të përgjegjësisë ligjore që kjo drejtori ka për përpilimin e këtij raporti.

Nëse këto 15 njësi, ku efiçensa shumë e ulët është evidente, i shtohen numrit të njësive të raportuara më lart si njësi që nuk garantojnë sigurimin e cilësisë së auditimit e çojnë në 63 njësi apo **53% të sistemit të AB ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion, rrjedhimisht ky sistem është ineficent.** E llogaritur mbi bazën e kostos mesatare për një auditues sipas Planit Strategjik 2017-2020: 1300.6 lekë, **totali i kostos së auditimeve të kryera nga njësitë e**

[shqiptaria.com]

mësipërme është 526,744 mijë lekë dhe treguesi i dobishmërisë së auditimit do të ishtë 14.9 lekë/1 lekë të shpenzuar (duke supozuar se dëmet e vlerësuara janë të arkëtueshme).

Manuali i Auditimit të Brendshëm Publik përcaktohet se "*Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë NJAB, - të paktën një herë në 5 vjet; .....*" DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB në përputhje me standardet ndërkombëtare të miratuara gjatë vitit 2017 duhej të kishte vlerësuar jo më pak se 23 NJAB (119:5). Fakti që, gjatë këtij viti nga DH/AB, janë kryer vetëm 5 kontrolle të cilësisë ose rreth 22% e detyrimit të përcaktuar sipas manualit, tregon se kjo strukturë me kapacitetet që ka, e ka të pamundur të arrijë përmbushjen e objektivit prej 23 vlerësime të jashtme të cilësisë.

Konstatohet se për vitin 2017, janë kryer vlerësime të cilësisë në bashkëpunim me ekspertë të SIGMAS-s, në Ministrinë e Shëndetësisë, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, në Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe në Bashkitë Berat dhe Fier. Sipas intervistave përzgjedhja është bazuar në metologji por nuk specifikohen kriteret e përzgjedhjes. Konstatohet se dosjet e auditimit, nuk janë të gjithë dokumentat zyrtare të auditimit, si projekt raporte dhe raporte finale. Cilësojmë nevojën e unifikimit të opinionit për këto lloj misionesh, duke shmangur në këto kushte situatën e konstatuar me ARRSH-në, ku në dy projekt-raporte janë dy rezultate të ndryshme, njëherë me ngjyrë të verdhë e cila vlerëson përputhjen e pjesshme me kriterin, por përmirësim të nevojshëm në fusha të caktuara dhe herën tjetër ngjyrë portokalli që vlerëson përputhjen në disa fusha që kërkojnë përmirësime kritike (të domosdoshme) duke mos formalizuar një opinion përfundimtar zyrtar për vlerësimin e kryer.

1.4 Rezultatet e Auditit të Brendshëm në rang sistemi

Bazuar në të dhënat e raportuara pranë DH/AB për vitin 2017, strukturat e 119 njësive të auditimit të brendshëm përmes 400 audituesve që ushtrojnë funksionet në to, kanë konstatuar një nivel dëmi ekonomik në shkallë sitemi prej 7,848 milion lekë, vlerë që krahasuar me vitin 2016, është 3.7 herë më e lartë. Megjithatë, analiza tregon se në këtë vlerë shuma prej 6,029 milion lekë i përket një auditimi të kryer nga NJAB e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në auditimin e ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, fakt që tregon se në shkallë sistemi niveli i shkeljeve të konstatuara vetëm 1,819 milion lekë dhe më i ulët se viti 2016 ose më i ulti në 5 vitet e fundit. Edhe në numër 6.286 rastet e konstatuara me dëm ekonomik për gjatë vitit 2017, janë më të ulta se numri prej 9.421 rastet e raportuara për vitin 2016.

Tabela 3: Vlera e dëmit për një periudhë 5 vjeçare, të dhënat e 2017 ***me ARRSH***

Në mijë lekë

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	7.848.500
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

Tabela 4: Vlera e dëmit për një periudhë 5 vjeçare, të dhënat e 2017 ***pa ARRSH***

Në mijë lekë

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	**1.819.500**
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400

Shenjtaria.com

Vlera e dëmeve të konstatuara nga strukturat e auditimit të brendshëm nuk është tregues domethënës për efiçencën e sistemit, kjo referuar literaturës apo praktikave ndërkombëtare, megjithatë në kushtet e Shqipërisë duhet të lexohet si ineficencë dhe varësi e plotë e këtyre strukturave nga titullarët e institucioneve, nëse i referohemi gjetjeve me dëme ekonomik të konstatuara nga audituesit e jashtëm shtetëror (KLSH), në po të njëjtat subjekte.

Në konkluzion, opinioni i dhënë në Raportin vjetor të KBFP nga DH/AB: "*Gjetjet me dëm ekonomik kanë një rritje të konsiderueshme krahasuar me gjetjet e vitit të mëparshëm. Kjo si pasojë e frymës Qeverisëse për të luftuar korrupsionin. Gjithashtu, ndikim ka patur dhe rritja e aftësisë profesionale të audituesve të brendshëm, thellimi i njohurive në fushat specifike, ashtu edhe në aksesin e pakufizuar në përdorimin e dokumentacioneve dhe informacioneve në subjektet e audituara*" nuk qëndron dhe është i bazuar mbi një analizë sipërfaqësore duke lënë të patrajtuar çështjen eficencës dhe perfomancës së njësive sipas karakteristikave të tyre (njësi qëndrore, vendore apo të pavaruara) bazuar në numër gjetjesh kundrejt problematikave të ngritura nga auditimi i jashtëm (KLSH). Kjo do të shërbente si një instrument sinjalizues për mungesën e theksuar të pavarësisë dhe kompetencën e NjAB-ve dhe rrjedhimisht dhënien e rekomandimeve relevante për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në zbatim të ligjit të MFK neni 18, pika 3.

Gjatë këtij viti nga audituesit e brendshëm janë konstatuar 18 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara, kryesisht strukturat e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKU, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Posta Shqiptare sha, Albpetrol, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Bashkia Kukës. Pesë prej këtyre rasteve i janë drejtuar për investigim të mëtejshëm Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pesë raste prokurorive të rretheve përkatëse, rastet e tjera i janë drejtuar titullarëve të njësive publike, Agjensisë së Prokurimit dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse.

1.5 Zbatimi i rekomandimeve dhe ndjekja e tyre

Rekomandimet e dhëna nga NJAB për periudhën raportohen për rekomandimet e pranuara dhe të zbatuara gjithsej, sipas prioriteteve, por nuk pasqyrohen të dhënat për rekomandimet e papranuara dhe arsyet pse. Po ashtu nga auditimi i dosjeve u konstatua se, për pjesën më të madhe të njësive publike totali i rekomandimeve të dhëna për vitin ushtrimor, nuk janë hedhur fare ose janë të pasakta.

Përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien, por dhe në monitorimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të lëna, pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor. Është evidentuar se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 nga 47% në vitin 2016 ka arritur në 55%. Nga të dhënat që ka përpunuar NJH/AB, rekomandimet sipas llojit janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Rekomandime sipas llojit për vitin 2017

Përmirësim sistemesh	Përmirësim i kuadrit ligjor	Karateri organizativ	Për arkëtime	Të tjera
2238	377	2975	953	1798

Burimi: NjH/ AB përpunuar nga grupi auditimit

[Shqiptaria.com]

Treguesi i raportuar për zbatimin e rekomandimeve është pozitiv, pasi ato rezultojnë të pranuara në masën 99,6% dhe zbatueshmëria e tyre është në masën 55%.

Tabela 6: Zbatueshmëria e rekomandimevet për vitin 2017

Statusi i rekomandimeve	*Numri në nivel sistemi*	*Niveli në %*
Rekomandime të dhënë	**8371**	
Rekomandime të pranuar	8341	99
Rekomandime të zbatuar	4625	55
Rekomandime në proces zbatimi	3918	47

Burimi: NjH/ AB përpunuar nga grupi auditimit

Konstatohet se në Manualin e Auditit të Brendshëm, publikuar në vitin 2016, nuk është përcaktuar qartë çështja e zbatimit të rekomandimeve e as mënyra e raportimit të tyre. Ndjekja në dinamikë e zbatimit të rekomandimeve është një nga treguesit thelbësor të performancës dhe eficensës së auditimit të brendshëm për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Kjo mangësi zbeh rolin e auditimit të brendshëm si mbështetës i titullarit të institucionit në arritjen e objektivave të njësisë dhe bie ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin publik*", nenit 6, "*Roli i auditimit të brendshëm*", gërma "ç", ku përcaktohet *"ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna*", nenit 14, "*Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm*" gërma "iv", ku përcaktohet, "*iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;*", si dhe nenit 24 "*Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm"*, gërma "ë", ku përcaktohet se: "*ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësive të auditimit të brendshëm*".

1.6 Mbi indikatorët e performancës së AB në zbatim të Urdhërit nr. 89 datë 28.12.2015

Në lidhje me indikatorët e performancës së auditimit të brendshëm[16]: Indikatorët e AB kanë si synim matjen e performancës së strukturave të njësisë së auditit të brendshëm, mirë-funksionimin, efikasitetin dhe efiçencën e tyre në sektorin publik. Gjatë auditimit u konstatua se:

Indikatori 16 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 19 nuk parashikon vlerësim për njësitë që i kanë audituesit në proçes certifikimi dhe lë vend për gjykim dhe ndërhyrje në vlerësimin përfundimtar. Nga vlerësimi i 28 njësive AB ose 24% e gjithë njësive të AB: Përqindja e devijimit në kampion me 65% vetëm për grupin e Bashkive, e cila e aplikuar në totalin e njësive të vlerësuara 61, do të ndryshonte vlerësimin e përgjithshëm të indikatorit nr. 16 nga 53% në 44% .

Indikatori 20 i llogaritur sipas udhëzimeve në Aneksin 23 çon në rezultate dhe vlerësim të gabuar (mbivlerësim). I llogaritur sipas aneksit 23:

Indikatori "Kapacitetet e burimeve njerëzore të auditimit të brendshëm" = Pozicione vakante të AB/numrin total të AB të miratuar në strukturën e njësisë publike (%)

16 Struktura përgjegjëse e harmonizimit te auditimit te brendshëm, monitoron në nivel vjetor funksionimin e veprimtarise te strukturave te auditimit te brendshem ne sektorin publik. Ky monitorim kryhet nëpermjet analizës së përgjigjeve të pyetsorëve vjetorë të vetvleresimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, të cilat depozitohet cdo fillim viti pranë kësaj strukture.

[shqiptaria.com]

Kështu nëse në një njësi (bashki etj) struktura e AB-së miratohet nga titullari me 2 auditues, kjo njësi nuk raporton vende vakant edhe pse sipas Ligjit nr. 114/2015 njësia duhet të ngrihet me 2+1 auditues, rrjedhimisht indikatori për këtë njësi llogaritet 2/2=100% dhe vlerësohet me 30 pikë maksimale. Në këtë mënyrë indikatori nuk realizon realizon objektivin e tij sipas Metodologjisë pika 4.1: "vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitit të njësisë publike me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi". Në gjykimin e grupit të auditimit, ky indikator duhet të riformulohet për të vendosur një nivel të poshtëm "jo më pak se 3" për të vlerësuar drejtë njësitë që janë në shkelje të ligjit nr. 114/2015, aq më tepër që ky është i vetmi indikator që bën vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të të aktivitetit të titullarëve të njësive publike në lidhje me AB. Pavarësisht kufizimeve në buxhet dhe kapacitete për të ngritur një NjAB me tre specialistë, njësia raportuese nuk mund të vlerësohet me pikët maksimale.

Indikatori 19 Cilësia e raporteve të audituesve të brendshëm e përpiluar sipas Aneksit 22, në fakt plotësohet nga punonjësit e DH/AB pas leximit të 115 raporteve vjetore të dërguara nga NjAB-të. Pasi raportet shpërndahen midis 3 specialistëve, lexohen dhe në gjykimin e tyre bëhet vlerësimi në pikë sipas kësaj tabele: 0 - 2% : 30 pikë / 3 - 5% : 25 pikë/ 6 - 25%:15 pikë/ 26-50%:10 pikë/ 51-75%: 5 pikë/ 76-100%: 0 pikë. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përpunim të dhënash dhe intervalet në përqindje janë të pakuptimta. Në përmbledhje, vlerësimi i këtij indikatori për 77 njësi rezulton me mesatarisht 19 pikë. Në gjykimin tonë, përtej vlerësimit që mund të bëjnë 3 specialistë të cilët kryejnë edhe shumë detyra të tjera, mbi formatin dhe përmbajtjen e raporteve vjetore të AB-ve do të ishte më efektive dhe efiçiente kombinimi i këtij indikatori më një tregues tjetër cilësie dhe dobisë së punës së AB: ai i zbatimit të rekomandimeve. Ky indikator është i miratuar në Metodologjinë e vlerësimit të perfomancës dhe i rekomanduar nga SIGMA në pasaportën e indikatorëve.

DH/AB duhet të propozojë rishikimin e menjëhershëm të anekseve dhe shpjegimeve të dhëna në to me qellim përmirësimin e cilësisë së përpunimit të tyre, rritjen e saktësisë dhe relevancës së vlerësimit. DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në thellësi çështjen e efektivitetit dhe eficensës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Është e rëndësishme që aktiviteti i auditimit të brendshëm të marrë reagime nga palët kyçe të interesit mbi efektivitetin e auditimit dhe të bëjë rregullime të nevojshme dhe ti përcjellë tek të gjitha njësitë e AB dhe jo vetëm tek ato njësi që kanë qenë pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

DH/AB në rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP ku një nga shtyllat është AB, duhet menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik për komponentin AB, për t'u marrë në konsideratë matës relevant sasior dhe cilësor të efektivitetit dhe efiçencës.

2. MBI NIVELIN E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT NË SEKTORIN PUBLIK

2.1 Mbi funksionimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

Mbi konfliktin e interesit në funksionimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar përcakton krijimin e **Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar**

[Shqiptaria.com]

Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik. Ky bord përbëhet nga Ministri i Financave, në cilësinë e kryetarit të këtij bordi, Nëpunësi i Parë Autorizues, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar publik, drejtuesi i strukturës përgjegjëse të buxhetit, drejtuesi strukturës përgjegjëse për thesarin, tre anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave, me përvojë në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kontabilitetin dhe në fushën e auditimit të brendshëm. Bordi shqyrton nevojën për miratimin e legjislacionit shtesë apo për përmirësimin e kuadrit rregullator të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Bordi diskuton rreth raportit vjetor për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik para se të miratohet nga Ministri i Financave.

Me urdhër të Ministrit të Financave nr.68 datë 08.06.2016 "Për krijimin e Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik", është krijuar Bordi, i cili kryesohet nga Ministri i Financave dhe përbëhet nga anëtarët si vijon: znj. Gelardina Prodani, nëpunësi i parë autorizues; znj. Kesjana Halili, Drejtor i Përgjithshëm i DHKBFP znj. Mimoza Dhembi, Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit; z. Lavdim Sahitaj, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit; znj. Edlira Luci, eksperte; z. Julian Naqellari, eksperte; z. Erald Bezhani, eksperte. Kemi dy vite me rradhë që sjellim në vëmendje të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë si dhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë, që një formatim i tillë i bordit me pjesëmarrje të gjerë të nëpunësve që kanë detyrim dhe obligim të funksioneve të tyre mbikëqyrjen por edhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i japin karakteristikat e një bordi formal që nuk arrin të prodhojë një oponencën e duhur për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale. Kemi kërkuar që të vlerësohet edhe konflikti i interesit funksional. Ndërkohë që përgjigjia e strukturave drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është unike citojmë: "*Në strukturat e përmëndura, nga ana jonë nuk është konstatuar asnjë konflikt interesi. Në këtë raport nuk është paraqitur asnjë rast konkret i konfliktit të interesit por vetëm një gjykim i përgjithshëm....*" Nga ne është konsideruar e pa konceptueshme që strukturat që merren me garantimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e të cilave është edhe zbatimi i rregullave të etikës dhe parandalimi i konfliktit të interesit nuk kanë arritur të lexojnë konfliktin funksional. Shkurtimisht, për kë është i interesuar të lexojë, struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFK, në cilësinë e Sekretariatit të Bordit të KBFP, paraqet pranë këtij bordi problematikat e ndryshme të njësive publike, ndërkohë që drejtori i strukturës që përbën sekretariatin dhe përgatit Raportin vjetor për sistemet është pjesëmarrës në bord me të drejtë vote. Nënpunësi i Parë Autorizues është nënpunësi ku raportojnë të gjitha njësitë publike lidhur me nivelin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimin financiar, ndërkohë që miraton raportin për të cilin ka përgjegjësi direkte për mirëfunksionimin e sistemeve. Ndërkohë pjesë të funksionimit të sistemeve janë edhe drejtori i thesarit dhe drejtori i buxhetit të cilët japin siguri për sistemet për të cilat menaxhojnë dhe duhet të japin llogari. Në Bord të KBFP ekziston konflikti i interesit për shkak të lidhjes familjare por dhe lidhjeve të pune apo akademike që cënojnë objektivitetin dhe paanshmërinë në vendime, megjithatë edhe këtë vit, strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk arritën të lexojnë konflikt funksional në mënyrën se si është kompozuar Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Ky lloj konflikti është i dukshëm kur i referohemi edhe aktivitetit të kësaj strukture (vetëm dy mbledhje). Kështu konstatohet se është zhvilluar mbledhja

e parë e Bordit në datën 16.05.2017, me pjesëmarrjen e 7 anëtarëve, nga 8 që është numri total i tyre. Në këtë mbledhje është diskutuar mbi raportin vjetor të vitit 2016 dhe problematikat e identifikuara në inspektimet mbi vlerësimet e situatës së menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik. Mbledhja e dytë e këtij Bordi është zhvilluar me pjesëmarrjen e 6 anëtarëve sipas procesverbalit në datën 27.12.2017, dhe sipas axhendës është diskutuar mbi rishikimin e bazës ligjore në fushën e financave publike, ku më hollësisht janë trajtuar: Draft Udhëzimi për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, draft udhëzimi i kontabilitetit publik, zhvillimet e projektit mbi reformën e kontabilitetit publik (IPSAS), Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm, Programin e Trajnimit të Vijueshëm profesional të Audituesve të Brendshëm. Mbledhja e ardhshme e këtij bordi ishte planifikuar të zhvillohej në Shkurt të vitit 2018, por deri në fund të periudhës objekt auditimi (Maj 2018), nuk rezulton të jetë zhvilluar ndonjë mbledhje.

Konstatohet se opinioni i dhënë në Raportin Vjetor, lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit brendshëm financiar në sektorin publik, nuk reflekton situatën reale në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pasi nuk përfshin informacion institucionet e varësisë, duke bërë që treguesi i eficenses së sistemeve të kontrollit të mos jetë përfaqësues në rang sistemi publik.

Indikatorë të rëndësishëm si ata të zbatimit të buxhetit dhe eficensës së operacioneve të Thesarit janë të paplotësuar për shumë institucione dhe të raportuar me pasaktësi për disa të tjerë.

Metodologjia e monitorimit nuk është aplikuar sic duhet duke filluar me mungesw tw dokumentimit tw përzgjedhjes sw institucioneve, periudhën e monitorimit dhe numrin shumë të vogël të monitorimeve. Rezultatet e monitorimit konsolidohen vetëm për efekt të përgatitjes së Raportit vjetor dhe nuk janë aspak koherente dhe reflektuese

2.2 Analiza e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike.

Nga auditimi u konstatua se për shkak të ndryshimit të formatit të pyetësorit të vetëvlerësimit, me miratimin e manualit të ri të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, ky ndryshim nuk u shoqërura me një përshtatje të atij ekzistues në sistemin PIFC. Për këtë arsye, punonjësit e DH/MFK i hedhin manualisht të dhënat e gjeneruara nga subjektet sipas çdo pyetësori, proces ky që nuk garanton një cilësi të lartë për shkak të mungesës së sigurisë mbi gabimet e mundshme, për vetë përmbajtjen e detajuar që kanë këta pyetësorë, si dhe tanimë nuk sigurohen dot të dhënat në mënyrë të zgjeruar, sipas komenteve për çdo pyetje, pasi punonjësit konsolidojnë vetëm rezultatin në pikë. Për të analizuar shifrat e këtij raporti për efektivitetin e sistemit, rankimin e institucioneve, vlerësimin e numrit të njësive që janë përgjigjur me 4, 3, 2 apo 1 pikë sipas pyetjeve respektive, grupi i auditimit rillogariti dhe krahasoi shifrat e vënë në dispozicion nga njësia në sistemin PIFC, si dhe shifrat e raportuara në raportin vjetor të KBFP për njësitë publike. Gjithashtu, në mënyrë rastësore u siguruan disa pyetësorë të dërguar shkresërisht pranë DH/MFK, konkretisht: 8 Ministri Linje, 12 Bashki dhe Këshilla Bashkiakë, 10 Institucione të Pavarura, 11 institucione nga grupi 87, 5 njësi shpenzuese të mëdha.

Nga auditimi, u konstatuan diferenca mes të dhënave të dërguara shkresërisht nga njësitë publike, me ato të konsoliduara në sistemin PIFC nga punonjësit e DH/MFK. Në sistemin PIFC rezulton të jenë hedhur të dhëna për 126 institucione (nga 127 që janë në raportin vjetor), mungojnë të dhënat për Bashkinë Kavajë. Rezultoi se të dhënat për rankimin e institucioneve janë marë nga shkresat e dërguara nga njësitë, (përveç diferencave të konstatuara si më poshtë) duke mos përdorur të dhënat e konsoliduara në PIFC, pavarësisht se sipas punonjësve, ato konsolidohen për efekt të përgatitjes së raportit të KBFP. Këto diferenca lidheshin me rezultatin total të vetëvlerësimit, si dhe me rezultate në brendësi të pyetjeve por pa efekt në vlerësimin final. U konstatua se të dhënat e dërguara nga njësitë shkresërisht në protokollin e Ministrisë së Financës, nuk janë të njëjta me ato të konsoliduara në sistemin PIFC, përmendim institucionet si Këshilli i Qarkut Berat, Këshilli i Qarkut Elbasan, Bashkia Peqin, Bashkia Librazhd, Bashkia Tepelenë, Bashkia Kavajë, Bashkia Përrenjas, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Prokurimit Publik, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen

e të Dhënave Personale, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë etj. Nga krahasimi i të dhënave të dërguara nga njësitë, me të dhënat e përdorura për efekt të raportit vjetor të KBFP, u konstatua diferenca të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6: Diferenca në rezultate midis pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportimit sipas PIFC

Institucioni	Vlerësimi sipas shkresës	Vlerësimi në raportin KBFP[17]
Bashkia Përrenjas	89	95
ISUV	136	146
Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	147	139
Agjensia e Prokurimit Publik	147	148
Sekretariati Teknik i Ujit	136	138
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	141	145

Burimi. Grupi i auditimit

Edhe pse masa e devijimit të rezultateve nuk është në dukje materiale, fakti që qëllimi i raportit vjetor të drejtorisë është vlerësimi i situatës së menaxhimit financiar dhe kontrollit në rang vend, e bën edhe më të rëndësishëm nevojën për një saktësi të nivelit të lartë në shifrat e konsoliduara.

Raporti vjetor i KBFP cilëson *"Efektiviteti i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit llogaritet mbi bazën e pyetësorëve të vetëvlerësimit i cili përmban 39 pyetje. Çdo pyetje vlerësohet me pikë nga 1-4, ku vlerësimi minimal është 1 dhe vlerësimi maksimal është 4. Efektiviteti i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit llogaritet si mesatare e pikëve të pyetësorit të vetëvlerësimit për të gjitha njësitë publike të marra në analizë."*, por për llogaritjen në % të efektivitetit sipas komponentëve, në raport nuk është parashikuar mënyra se si do të kryhet kjo analizë. Nga intervistat me punonjësit e DH/MFK, u konkludua se llogaritet nëpërmjet numrit total të pikëve të vetëvlerësimit sipas pyetjeve përkatëse kundrejt pikëve maksimale të mundshme. Grupi i auditimit kreu një rillogaritje të vlerësimit në pikë të paraqitura nga DH/MFK në sistemin PIFC dhe shifrat e përdorura në raport për llogaritjen e komponentëve të MFK, duke i krahasuar me rezultatet e pasqyruara në raportin vjetor të KBFP, ku u konstatuan diferenca në të pestë komponentët e pyetësorit.

Gjithashtu, u konstatua se në raportin vjetor të KBFP, drejtoria nuk është shprehur me një analizë në planifikimin dhe raportimin e të dhënave për njësitë që janë përfshirë rishtaz në këtë raport (njësitë e grupit 87). Kështu, zgjedhja e subjekteve me buxhet të madh që janë përfshirë në raport për herë të parë për vitin 2017, ka qenë rastësore, si dhe specialistëve që përpunojnë të dhënat e raportit vjetor, nuk u është bërë me dije nëpërmjet urdhrave paraprakë, ndryshimet në strukturën dhe organizimin e raportit vjetor si dhe me kriteret sipas së cilave është kryer përzgjedhja e tyre.

Referuar ndryshimeve të organizimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, si dhe subjekteve të përfshira në raportin vjetor të drejtorisë, nuk është kryer një analizë e njësive të cilat janë krijuar rishtaz në vitin 2017 (referuar numrit total të institucioneve të përfshira nën grupin "Të pavarura", total: 47 institucione), apo mbi konsolidimin e kryer për ministritë e përthithura (nga 14 në 11), referuar edhe analizave që janë kryer në mënyrë progresive, për të cilat duhet të kryhet

17 Pikët e renditura si raporti KBFP i referohen rezultateve të vendosura në dispozicion nga DH/MFK për efekt të indikatorëve në komponentët e MFK.

Shqiptarja.com

një paragraf përshkrues për njësitë në të cilat bëhet krahasimi,në raportin vjetor të KBFP, kreu II , çështja 2.1, lidhur me komponentët e MFK.

2.3. Monitorimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Implementimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet pilot për vitin 2017.

DH/MFK në kuadër të implementimit të një sistemi modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në eksperiencën e fituar, nga projekti i binjakëzimit, realizoi implementimin e këtij sistemi në 6 institucione pilot të përzgjedhura (MPB, MTI, Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastër, Autoriteti i Konkurrencës dhe Avokati i Popullit). Ky proces do të fillonte gjatë muajit maj dhe do të vazhdonte deri në fund të vitit 2017, por sipas DH/MFK për shkak të qeverisë teknike ky proces nuk mundi të realizohej. Gjithashtu, nga ana e drejtorisë është vendosur se për shkak të ristrukturimit të ministrive, u reduktua numri i institucioneve të përzgjedhura si dhe është shtuar Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe në përfundim u vendosën për implementim institucionet: MB, MIE, Bashkia Vlorë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar; ku gjatë muajit dhjetor janë zhvilluar takimet vetëm me Autoritetin Rrugor Shqiptar, ndërsa për institucionet e tjera nuk është proceduar më tej me implementimin. Për institucionet të cilat u zgjodh të mos kryhej implementimi, nuk janë përgatitur relacione shpjeguese për arsyet e mos e implementimit të MFK për vitin 2017. Gjithashtu, evidentohet se në institucionet pilot të përzgjedhura është përfshirë edhe Autoriteti i Rrugor dhe Ministria e Brendshme, institucione këto të cilat kanë qenë pjesë e dy projekteve të mëparshme të realizuara nga drejtoria me ekspertë të huaj, përkatësisht: "Projektit të Binjakëzimit për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, financuar nga Bashkimi Europian 2009" në të cilin është zhvilluar testimi pilot i kuadrit ligjor për MFK (para miratimit) në Ministrinë e Brendshme, si dhe në projektin "Mbështetje për Ministrinë e Financave të Shqipërisë për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të fondeve publike" përfitues i së cilit ka qenë Autoriteti Rrugor Shqiptar. Përfshirja e institucioneve të cilat kanë qenë më parë pjesë e projekteve për implementimin e sistemit të MFK me asistencë të huaj, evidenton mos realizimin e qëllimit të pilotimit të MFK në to dhe rezultatet e raportuara të projekteve; si dhe formalitetin sipas së cilit kryhet përzgjedhja e institucioneve pilot.

Nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2017, lidhur me ecurinë e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për institucionet qëndrore dhe.institucione të vetëqeverisjes vendore është konstatuar sa më poshtë:

KOMPONENTI	Tipologjia e dobësive
MJEDISI I KONTROLLIT	– **Mungesë të reflektimit të ndryshimeve strukturore në rregulloret e brendshme të institucioneve duke sjellë mangësi në ndarjen e detyrave, përgjegjësive, linjën e raportimit, kontrollin e brendshëm dhe në menaxhimin e financave publike**: *Ministria e Brendshme, Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Instituti i Shëndetit Publik, Spitali Universitar i Traumës, Prokuroria e Përgjithshme, Universiteti Bujqësor i Tiranës, bashkitë Vlorë, Has, Lezhë, Korçë, Belsh, Kamzë, Konispol, Durrës* – **Mungesë e dokumentacionit për përcaktimin e nëpunësit zbatues**: *Avokatura e Shtetit*

[Shqiptarja.com]

	– **Mungesë të planit strategjik të zhvillimit institucional**: *Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë Korçë, Rrogozhinë, Belsh, Vlorë, Këlcyrë, Konispol, Kukës, Qarku Berat, Prefektura e Qarkut Vlorë dhe Durrës* – **Mungesë e programeve specifike për trajnimin e punonjësve/ administratës**: *Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Prokurimit Publik, Ministria e Integrimit Evropian, Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, Universiteti "Fan Noli" Korçë, Spitali Universitar i Traumës, Prokuroria e Përgjithshme* – **Vlerësime jo objektive për burimet njerëzore:** *Universiteti "Fan Noli" Korçë* – **Mungesë të Grupit të Menaxhimit Strategjik**: *Instituti i Shëndetit Publik* – **Mungesë dokumentacionit mbi takimet e GMS**: *Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme, Spitali Universitar i Traumës, Drejtoria Arsimore e Qarkut* Tiranë – **Mungesë e Kodit të Etikës/ Sjelljes**: *Ministria e Brendshme, Spitali Universitar i Traumës, prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Mbrojtjes*
MENAXHIMI I RISKUT	– **Mungesë e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut**, që kërcënojnë realizimin e objektivave: *Ministria e Brendshme, Drejtoria e Arsimit të Qarkut Tiranë, Spitali Universitar i Traumës, Universiteti "Fan Noli" Korçë, Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Mbrojtjes, bashkitë Kukës, Rrogozhinë, Belsh, Vlorë, Këlcyrë, Konispol, Qarku Berat, Prefektura e Qarkut Vlorë dhe Durrës* – **Mungesë të regjistrit të riskut i përditësuar**: *Agjencia e Prokurimit Publik, Spitali Universitar i Traumës, bashkitë Kukës, Rrogozhinë, Belsh, Vlorë, Këlcyrë, Konispol, Qarku Berat dhe Prefektura e Qarkut Durrës* – **Mungesë e strukturave përgjegjëse për menaxhimin e riskut**: *Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, Spitali Universitar i Traumës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, bashkitë Përrenjas, Rrogozhinë, Pucest, Konispol, Lushnjë* – **Mungesë trajnimesh për personelin përgjegjës për menaxhimin e riskut**: *Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Universiteti "Fan Noli" Korçë, Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë Përrenjas, Rrogozhinë, Pucest, Konispol, Lushnjë*
AKTIVITETET E KONTROLLIT	– **Mungesë e përcaktimit të qartë të proceseve të punës**: *Ministria e Brendshme, Drejtoria e Arsimit të Qarkut Tiranë, Universiteti 'Fan Noli" Korçë, Agjencia e Prokurimeve Publike, kryesisht ato që lidhen me ruajtjen e administrimin e pronës si në bashkitë Divjakë, Kamzë, Rrogozhinë, Belsh, Lezhë, Lushnjë, etj.* – **Nuk është hartuar dhe dokumentuar gjurma e auditimit**; *Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, Spitali Universitar i Traumës, Universiteti "Fan Noli"* – **Mungesa e rregullave të brendshme për delegimin e përgjegjësive**; *Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit*
INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	– **Mungesa e ndjekjes së hallkave sipas përgjegjësive**: *Ministra e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Spitali Universitar i Traumës, Insituti i Shëndetit Publik*

[shamtare.com]

	– **Mungesë e trajnimeve për kuptimin dhe zbatimin e ligjit mbi "Menaxhimin financiar dhe kontrollin":** *Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Spitali Universitar i Traumës, Instituti i Shëndetit Publik* – **Nuk janë hartuar procedurat për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre**: *Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme*
MONITORIMI	– **Mungesa e procedurave dhe kompetencës për vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin:** *Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, bashkitë Korçë, Rrogozhinë, Belsh, Vlorë, Këlcyrë, Konispol, Qarku Berat, Prefektura e Qarkut Vlorë dhe Durrës.* – **Mungesa e kompetencës tek njësitë e varësisë** : *Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës së Shtetit,* – **Mungesë të raportimit të njësive të varësisë:** *Spitali Universitar i Traumës, Instituti i Shëndetit Publik, apo të njësive: bashkitë Divjakë, Rrogozhinë, Konispol, Vlorë, Këlcyrë, etj.* – **Mos publikimi i raporteve të monitorimit**: *Drejtoria e Arsimit të Qarkut Tiranë*

2.4 Monitorimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe përgatitja e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollin në sektorin publik.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit ka kryer monitorimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në disa institucione për të vlerësuar nga afër ecurinë e zbatimit të nenit 18 të ligjit të MFK ku thuhet se Nëpunësi Autorizues duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Bazuar në manualin e MFK, DH/MFK është përgjegjëse për monitorimin sistematik të sistemeve të MFK-së në njësitë publike. Përgatitjen e raportit vjetor për NPA dhe Ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, mbi statusin e përgjithshëm të MFK-së, janë kryer monitorimet sipas shkresave dhe afateve të mëposhtme.

Tabela 7: Kalendari i monitorimeve të kryera

Nr	Institucioni	Periudhat e monitorimit
1	Bashkia Durrës- Shijak	30 Prill- 4 Maj 2018
2	Bashkia Elbasan- Peqin- Cërrik	3-6 Prill 2018
3	Bashkia Gjirokastër- Libohovë	10-13 Prill 2018
4	Bashkia Pogradec- Devoll	23-27 Prill 2018
5	Bashkia Kamëz- Krujë	30 Prill- 4 Maj 2018
6	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	16-20 Prill 2018
7	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	16-20 Prill 2018
8	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	30 Prill- 4 Maj 2018
9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	3-6 Prill 2018
10	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	3-6 Prill 2018
11	Autoriteti i konkurrencës	16-20 Prill 2018
12	Prokuroria e Përgjithshme	30 Prill- 4 Maj 2018
13	Avokati i popullit	30 prill- 4 Maj 2018
14	Kontrolli i Lartë i Shtetit	10-13 Prill 2018

Në zbatim të kuadrit të sipërcituar, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionet dhe materialet lidhur me monitorimet e kryera nga DH/MF, ku rezultoi se:

– Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me nenin 18, pika 1 e Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ku citohet se "Nëpunësi

[Shqiptaria.com]

autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji", dhe urdhrin nr. 89 të Ministrit të Financave "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike", pika 3. II ku citohet se "Raporti vjetor i konsoliduar për kontrollin e brendshëm hartohet bazuar në një sistem pikëzimi për çdo tregues të përcaktuar në këtë dokument (sipas formularit të kërkuar në Aneksin 1) dhe për çdo njësi qendrore apo vendore të monitoruar gjatë vitit, p.sh. për njësitë qendrore raportet që dorëzohen duhet të paraqiten në nivel grupi, i cili përfaqësohet nga mesatarja e pikëve të të gjithë sistemit (njësi qendrore + njësitë e varësisë), ndërsa për njësitë vendore do të jetë mesatarja e pikëve të njësisë: Bashki/Këshill qarku (aparat vendor + njësitë e varësisë).", rezultoi se në dokumentacionin e dërguar pranë kësaj drejtorie nuk ka evidenca nëse në pyetësorët dhe raportet e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga njësitë e nivelit të parë të qeverisjes së përgjithshme, mbi raportimin në mënyrë të konsoliduar, pra duke përfshirë rezultatet edhe për njësitë e varësisë. Specifikisht, u mor në shqyrtim pyetësori i vetëvlerësimit i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka qenë subjekt monitorimi nga DH/MFK për besueshmërinë e pyetësorit, dhe rezultoi se pyetësori është kryer për "Aparatin e Ministrisë së Financës" dhe monitorimi nuk ka kërkuar apo verifikuar nëse përfshinte institucionet e varësisë në përputhje me manualin. Nga intervista me punonjësit e DH/MFK, ata janë të paqartë në lidhje me konsolidimin dhe përfshirjen e njësive të varësisë në vetëvlerësimin nga institucionet qendrore, e reflektuar kjo edhe në konsolidimin e kryer nga ta për raportin vjetor të KBFP, ashtu edhe në monitorimet e kryera për besueshmërinë e pyetësorëve.

– Për përzgjedhjen e institucioneve që do të monitorohen, manuali i MFK udhëzon"Llogaritjen e numrit të njësive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK duke ndare ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFK ka planifikuar ë shpenzojë për vizitat në terren, si dhe duke u nisur nga kohëzgjatja e një vizite në terren.", dhe sipas përqindjes: 50% njësi publike nga grupi "i performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar|, 25% nga "performuesit e mirë". Nga auditimi nuk rezulton të jetë kryer dhe dokumentuar një analizë e tillë për përzgjedhjen e njësive që do të monitorohen. I vetmi dokumentacion që na u vu në dispozicion është memoja përcjellëse për planin e monitorimeve drejtuar Sekretares së Përgjithshme të MFE, ku vetëm janë listuar subjektet që do të monitorohen dhe datat përkatëse. Gjithashtu, u konstatua se në përzgjedhjen e njësive për monitorim, nuk janë marrë në konsideratë: -rezultatet e pyetësorëve të institucioneve varësi të Kryeministrisë (grupi 87), rezultatet e të cilave në raportin vjetor janë përfshirë në grupin e institucionet e pavarura; -rezultatet e pyetësorëve të Këshillave të Qarkut, të cilat në raportin vjetor janë përfshirë në grupin e bashkive; -njësitë shpenzuese të mëdha, rezultatet e së cilave kanë qenë një risi në raportin vjetor të KBFP për vitin 2017.

- Nga auditimi u konstatua se shkresat për njoftimin e kryerjes së vizitës në terren janë dërguar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në të njëjtën datë, në kundërshtim me aneksin 9 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i cili në pikën 2) Organizimi i vizitave në terren, çështja "Si realizohen vizitat (përgatitja, vizita rezultati)", ku citohet se " Dy javë para datës së vizitës në terren, Drejtoria e Harmonizimit të MFK, i dërgon shkresë kreut të subjektit me kërkesën për të përgatitur dokumenatet përkatëse dhe të caktojë një person kontakti në njësi për të ndihmuar ekspertin e DH/MFK, për shembull të sigurojë dokumentet për ekspertin, të organizojë takime dhe kështu me radhë.". Konkretisht për Bashkinë Elbasan Peqin Cërrik, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, njoftimi është dërguar 5 ditë përpara fillimit të punës në terren, ndërsa për Bashkinë Durrës- Shijak; Kamës- Krujë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Avokatin e Popullit, Prokurorinë e Përgjithshme, më shumë se 1 muaj përpara fillimit të punës në terren
- Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e Menaxhimit Financiar nuk janë përgatitur materialet për konkludimet e monitorimit, përcaktuar në manual si: "Në përfundim të vizitës në terren punonjësi i DH/MFK kryen një vlerësim të përgjithshëm mbi besueshmërinë e procesit të vetë vlerësimit të njësisë publike, i cili përfshihet në raportin vjetor të KBFP. Nga auditimi u konstatua se vizitat në terren, nuk janë shoqëruar me dokumentacionet përkatëse, protokolle takimesh, apo letra pune sipas aneksit 9 "Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren", pika 3, rezultati i të cilave konfirmon nivelin e besueshmërisë së rezultuar nga pyetësorët e vetëvlerësimit dhe verifikimit të kryer në terren.
- Nga auditimi u konstatua se monitorimet e njësive publike janë kryer në një periudhë shumë të reduktuar kohore, referuar afateve për dërgimin e pyetësorëve pranë drejtorisë (në fund të muajit shkurt), si dhe afatit për përfshirjen e rezultateve në raportin vjetor të KBFP (fund të muajit maj) dhe si rezultat, kjo periudhë duhet të përfshijë edhe konsolidimin e rezultateve, në mënyrë që të kryhet përzgjedhja në metodologjinë e sipërcituar (50% njësi publike nga grupi "i performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar|, 25% nga "performuesit e mirë"), dhe si rezultat ky monitorim kryhet vetëm për efekt të raportit vjetor, dhe jo në një monitorim të vazhdueshëm të kryer nga DH/MFK mbi grumbullimin e informacioneve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie, cituar edhe në kuadrin ligjor të sipërpërmendur.
- Në përfundim të vizitës në terren, Manuali i MFK udhëzon "hartimin nga punonjësit e DH/MFK të raportit për njësinë publike përkatëse, në të cilin krahas vlerësimit do të specifikohen edhe rekomandime konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të MFK. Ky raport i dërgohet zyrtarisht njësisë publike, e cila përgatit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, të miratuar nga NA e njësisë publike. Një përmbledhëse e raporteve të vizitave në terren, bëhet pjesë e raportit vjetor të KBFP, në një kapitull të vecantë", por në kundërshtim me manualin, Drejtoria e Harmonizimit pas përfundimit të monitorimeve në terren, rezultatet e tyre publikohen në raportin vjetor të KBFP, dhe më pas raportet i dërgohen njësive të monitoruara së bashku me pasqyrat e planit të tyre për zbatimin e rekomandimeve dhe implementimet në zbatim të përmirësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në monitorimet e vitit

2016, raportet u janë dërguar njësive në nëntor të vitit 2017, dhe në këto raporte, jo në të gjitha rastet ishte vendosur niveli i besueshmërisë së marrë nga vetëvlerësimi; nuk ishin plotësuar pasqyrat sipas së cilave punonjësit të bëjnë dokumentim të krahasimeve të pyetësorëve të dorëzuar nga njësia me situatën reale; por ishin bashkëlidhur vetëm rekomandimet e lëna për njësinë. Konstatojmë se edhe për monitorimet e kryera në periudhën objekt auditimi, u ndoq e njëjta praktikë. Raportet në përfundim të monitorimeve nuk u dërguan në njësitë e monitoruara, nuk u protokolluan dhe nuk ju vunë në dispozicion grupit të auditimit deri në fund të këtij auditimi, edhe pse rezultatet e këtyre monitorimeve janë përfshirë në raportin vjetor të KBFP për vitin 2017. Në këtë raport nuk shohim që DH/MFK të shprehet për raste kur vlerësimi i tyre ishte korrigjues nga ai i vetëvlerësimit.

– Në lidhje me ndjekjen e rekomandimeve të rezultuara gjatë monitorimit dhe raportit vjetor të KBFP, manuali udhëzon se ky proces do të kryhet në monitorimin e ardhshëm të njësive, por nisur nga numri i monitorimeve të kryera gjatë një viti, si dhe metodologjia sipas së cilës kjo përzgjedhje kryhet, ndjekja e rekomandimeve i përket një periudhe shumë të largët dhe që do të realizohet disa vite me vonë (mesatarisht 115 njësi publike që dorëzojnë pyetësorë/mesatarisht 15 monitorime në vit = 7 vjet. Pra ndjekja e rekomandimeve do të kryhet pas më shumë se 5 vitesh).

2.5 Mbi Regjistrin e NA dhe NZ sipas nenit 26, pika dh e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar

3.5.1 Nga auditimi u konstatua se referuar përgjegjësisë së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit mbi krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive publike, sipas nenit 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, grupi i auditimi shqyrtoi dy regjistrat sipas së cilave administrohen të dhënat e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive publike. Nga analizimi i tyre, u konstatua se ekzistonin problematika në saktësi dhe plotësinë e regjistrave. Kështu,

– regjistrat janë të organizuar në Excel, por me pamundësi përpunimi të dhënash, për shkak të formatit dhe paraqitjes të tyre në këto dokumente;
– të dhënat e pasqyruar për subjektet nuk janë të unifikuara në emërtime dhe përmbajtje;
– u konstatua duplikim të dhënash për të njëjtat institucione;
– mungesë e plotë e informacionit mbi arsimimin, pozicionin e punës, etj; (që përbëjnë dhe kriteret në emërimin e N.Z);
– mungesë e datave dhe shkresave konfirmuese për N.Z;
– mungesë e informacionit të plotë në rastet e nëpunësve të deleguar për një periudhë të përkohshme (mungesë në aplikimin e kontrolleve për sinjalizimin në mbarimin e afatit të delegimit);
– mangësi në përditësimin e të dhënave (ekzistojnë N.A dhe N.Z të konfirmuar, por të pa azhornuar në regjistrat përkatës).

Nga auditimi u konkludua se, referuar qëllimit për të cilin nevojiten këto dokumente, sipas kuadrit ligjor të sipërcituar, këto regjistra nuk plotësojnë kriteret minimale të ruajtjes dhe organizimit të dokumenteve elektronike.

[shqiptaria.com]

2.6 Mbi trajnimet e zhvilluara nga DH/MFK

DH/MFK ka zhvilluar një sërë trajnimesh në lidhje me tematika të ndryshme të lidhura me komponentët e MFK, të cilat përgatiten dhe referohen nga stafi i drejtorisë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nuk ka evidenca të kryerjes së trajnimeve sipas takimeve planifikuar për:

- Takimi në Elbasan (Elbasan, Cërrik, Belsh, Gramsh, Peqin, Librazhd, Prrenjas, Kavajë) në Qershor 2017;
- Takimi në Shkodër (Shkodër, Lezhë, Kurbin, Krujë, Mirditë, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe) në Qershor 2017;

Nuk rezultojnë të kenë qenë pjesëmarrës në këto aktivitete: përfaqësues të Urës Vajgurore, Kuçovë, Skrapar, Poliçan, Tiranë, Kamëz, Dibër, Patos, Cërrik, Belsh, Këlcyrë.

Në bashkëpunim me ASPA-n, Drejtoria e Harmonizimit ka zhvilluar trajnime me pjesëmarrje dhe tematika mbi Menaxhimin e Riskut, njohuri të përgjithshme mbi Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, Instrumentet e Implementimit të MFK dhe Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik. Gjithashtu janë ofruar edhe trajnime në institucione të veçanta në bazë të kërkesave të Institucioneve si: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (09.05.2017), në Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (Qershor 2017, dy cikle) për njësitë e vartësisë si dhe në Ministrinë e Ekonomisë (31.03.2017).

Lidhur me dokumentacionet e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Harmonizimit, referuar përgjegjësisë së saj ligjore për organizimin e trajnimeve, cituar në nenin 26, pika 1 c: "DH/MFK është përgjegjëse për përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve e të trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë publike", konstatohet se DH/MFK nuk disponon një regjistër apo dokument përmbledhës të të dhënave lidhur me trajnimet e kryera mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, sipas tematikave dhe pjesëmarrësve përkatës ndër vite. Gjithashtu, për trajnimet e kryera në bashkëpunim me ASPA-n, planifikimi i pjesëmarrësve dhe tematikave përcaktohet nga ASPA dhe punonjësit e Drejtorisë kontraktohen nga ky institucion vetëm për përgatitjen e materialeve dhe prezantimin e tyre. Pra, identifikimi i pjesëmarrësve dhe administrimi i dokumentacioneve që justifikojnë kryerjen e trajnimeve, administrohet nga ASPA, dhe jo nga DH/MFK. Krijimi i një regjistri ndër vite për trajnimet e kryera lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, i cili të pasqyrojë tematikat e prezantuara sipas pjesëmarrësve të institucioneve, do të mundësonte identifikimin më të saktë dhe efektiv të nevojave për këto trajnime nga përfaqësuesit e sektorit publik.

2.7 Nxjerrje e akteve në zbatim të buxhetit në kundërshtim me ligjin me efek legjitimimin e krijimit të detyrimeve të parapambetura

Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nëpërmjet Drejtorisë së MFK, përgjigjet për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik. Gjatë vitit 2017, raportohet hartimi i Udhëzimit nr.23 datë 22.12.2017 "Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017", si një detyrim ligjor i përvitshëm, në të cilën përcaktohen afatet dhe procedurat e nevojshme për mbylljen e llogarive vjetore nga njësitë publike dhe konsolidimi i tyre nga ana e Ministrisë së Financave. Nga shqyrtimi i neneve të këtij udhëzimi konstatojmë

[Shqiptaria.com]

se ky udhëzim, jo vetëm nuk përbën ndonjë përmirësim të legjislacionit në fushën e kontabilitetit por disa nene të tij janë në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe akteve nënligjore të tij.

Konstatojmë se përcaktimi "të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të rregjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave" bie në kundërshtim me Ligjin nr.9936 dt. 26.06.2008, neni 61 ku përcaktohet metoda e njohjes së shpenzimit: "Metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës..". Nëpërmjet këtij udhëzimi autorizohet mosrregjistrimi i faturave në raste kur nuk ka fonde disponibël, raste të cilat gjithashtu bien në kundërshtim me Nenin 40 "E drejta për të kryer shpenzime", Neni 50 "Angazhimet buxhetore", Neni 51 "Menaxhimi i shpenzimeve", Neni 52 "Kryerja e shpenzimeve" të Ligjit. Pra autorizohet mosrregjistrim i faturave, kur shpenzimi është realizuar në mungesë të fondeve duke krijuar detyrime të reja të prapambetura, dhe duke cënuar vërtetësinë e pasqyrave financiare.

Në pikën 19 dhe 20 të këtij Udhëzimi, autorizohet njohja dhe rregjistrimi i faturave të lidhura me shërbime apo punime të papërfunduara dhe të pamarra në dorëzim. Që të dy këto pika që aktualisht janë në kundërshtim njëra tjetrën për sa i përket kriterit të njohjes së shpenzimit (para apo pas marrjes në dorëzim të punimit), mbi të gjitha janë në shkelje të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Pika 20 përcakton: “Në rastet kur institucioni provon shpenzimin e ndodhur gjatë muajit dhjetor 2017 (fatura sipas pikës 19) brenda kufirit të fondeve disponibël, por procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimeve po të punimeve të kryera zgjasin përtej datës 29.12.2017, atëherë dega e thesarit pranon njohjen dhe rregjistrimin në SIFQ të shpenzimeve për llogari të vitit 2017” dhe Pika 19: “Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, NA të njësive të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve në degët e thesarit …. dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda dt. 28.12.2017”. Pavarësisht se pika 24 e Udhëzimit parashikon një rakordim mbi statusin e punimeve dhe sistemimet përkatëse ky është një kontroll pas faktit dhe le hapësirë për rregjistrim të faturave të pavlefshme për shërbime të pakryera apo punime që nuk janë marrë në dorëzim.

2.8 Mungesa e akteve te nevojshme për riorganizimin e ministrive

Megjithëse ka ndodhur një proces riorganizimi i Ministrive dhe disa institucioneve qëndrore (shoqëruar me përthithje programesh, aktivesh dhe detyrimesh), nga DH/MFK nuk është hartuar ndonjë udhëzim tjetër i posaçëm për të trajtuar çështjen e ndryshimeve strukturore para mbylljes së vitit fiskal. Kemi konstatuar vetëm një ndryshim krahasuar me Udhëzimin e një viti më parë në nenin 27 ku shtohet paragrafi “Për të gjitha Ministritë dhe institucionet për të cilat gjatë vitit 2017 ndryshuan fushat e mbulimit dhe përgjegjësitë në zbatim të VKM-ve përkatëse, gjë që u reflektua edhe në ndryshimet e programeve buxhetore në Aktin Normativ nr.3, datë 06.11.2017, rakordimi i planit për buxhetin e vitit 2017 me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të bëhet me ministritë dhe institucionet që i administrojnë këto fonde aktualisht”.

Shqiptaria.com

DH/MFK ka gjykuar të mjaftueshëm se me përcaktimin se kush rakordon planin buxhetor kjo do të mbulonte dhe rregullimin kontabël të përthithjes dhe konsolidimit të pasqyrave financiare 11-mujore të Ministrive dhe programeve që pushuan së ekzistuari pas Nëndorit 2017, megjithëse Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017 "Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit për vitin 2017" rregullon rakordimin e planit buxhetor por jo kontabilitetin.

Çështje si: kush do të mbyllte pasqyrat financiare 11-mujore, afati i dorëzimit të tyre nëse duhej të përcaktohej një periudhë tranzicioni për përpunimin e të pasqyrave, për transferimin kontabël dhe fizik të inventarëve dhe aktive të qëndrueshme, kush do të ishte personi përgjegjës për përgatitjen dhe miratimin e tyre: punonjësi i larguar apo i transferuar në Ministrinë e re me një detyrë dhe tagër tjetër kanë mbetur të patrajtuara dhe evidentojnë përgjegjësinë e DH/MFK sipas Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

2.9 Mungesa e kontributit për zhvillimet e kontabilitetit në sektorin publik

Raporti "Zhvillimi i Raportimit Financiar në Sektorin Pulik Shqiptar" megjithëse është produkt bashkëpunimi në kuadër të projektit me Bankën Botërore, PULSAR, BMF, SAFE dhe SECO, raportohet si detyra të realizuara gjatë vitit 2017. Pavarësisht kontributit të përfaqësimit të DH/MFK, nuk gjejmë të shprehur dhe dokumentuar shkallën e përafrimit të këtij produkti me Udhëzimin nr.8 i dt.9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", si udhëzim tranzitor deri në miratimin e plotë të IPSAS i propozuar dhe miratuar 7 muaj më vonë kësaj analize.

Konstatojmë se DH/MFK ka kontribuar në shqyrtimin dhe dhënë mendime në lidhje me Ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" nr.25/2018, megjithëse kjo iniciativë është e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, dhe dhënia e këtyre mendimeve nuk mund të konsiderohet kontribut në funksion të arritjes së objektivit të Drejtorisë për zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik. Qëllimi i ndryshimeve ligjore ishte përmirësimi i standardeve për kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin privat, përafrimi i tyre me direktivën nr. 2013/34/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 26 qershor 2013 "Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të ndërrmarrjeve.." duke mbështetur kështu angazhimet strategjike të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Nga shqyrtimi i neneve të direktivës dhe neneve të Ligjit të ri të kontabilitetit rezulton një përafrim i plotë i 11 neneve dhe i pjesshëm për 27 neneve nga 164 gjithsej. Aktualish ky ligj nuk sjell asnjë përmirësim në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik.

3. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT DHE SISTEMET E SAJ TË KONTROLLIT

Drejtoriae Përgjithshme e Harmonizimit reflekton mangësi dhe dobësi të aktivitetit të saj, në disa elementë të MFK. DH ka vendosur objektivat për vitin 2017 por përgjithësisht organizimi i strukturave AB dhe MFK rezulton të jetë jo i përshtatshëm për dimensionet dhe për karakterin e aktivitetit të drejtorisë. Konstatohen vakanca në specialistë ndërkohë që vetë drejtoria e shikon mungesën e kapaciteteve si pengesë për realizimin e objektivave të saj. Vendi i drejtorit të NJH/AB është vakant prej 6 muajsh. Delegimi i detyrave rezulton të jetë praktikë jo e rregulluar dhe e reflektuar në përshkrimet e punës në kushtet

[Shqiptarja.com]

kur një punonjës largohet. Të gjithë punonjësit janë në nivel specialisti pa hierarki raportuese apo rëndësisë së detyrave që ata kryejnë. Ngarkesa e secilit punonjës sipas përshkrimeve të punës nuk është rishikuar në mënyrë që të sigurojë ngarkesë të drejtë për secilin në funksion të eficensës së drejtorisë dhe cilësisë së produkteve së saj. Një punonjës kryen vlerësim të cilësisë së jashtme të AB, përpilon planet strategjike dhe vjetore të konsoliduara, trajnon në programin e certifikimit, merr pjesë në mbledhje të KKAB si anëtar, përpilon evidenca të konsoliduara për qëllim përpilimin e raportit vjetor, vlerëson dhe përpunon indikatorët e vlerësimit të aktivitetit AB etj. Ndërkohë që po sipas përshkrimeve të punës rezultojnë punonjës që kanë si detyrë vetëm analizën e raporteve vjetore të AB (mars-maj) dhe azhornimin e faqes së internetit me njoftime dhe udhëzime/urdhëra të nxjerra nga DH. Është ndërtuar rregjistri i risqeve por nga shqyrtimi i tij dhe i ngjarjeve të rëndësishme të ndodhura në sektorin publik gjatë vitit 2017, rezulton që ky rregjistër është një dokument pasiv dhe nuk është shqyrtuar në mënyrë dinamike nga DH/AB dhe MFK kjo me impakt lënien jashtë vëmëndjes dhe mosmenaxhimin e situatave si: ristrukturimi i Ministrive të linjës ku DH në rolin e saj udhëheqëse metodologjike duhej të kishte paraprirë me udhëzues efektet kontabël dhe financiare të këtyre ndodhive. Nuk është azhornuar ky rregjistër për të reflektuar efektet e qeverisë teknike në realizimin e objektivit të implementimit të sistemeve moderne pilot MFK. Objektiv ky i parealizuar.

Nga DH është parashikuar risku i mungesës së kapaciteteve në burime njerëzore në lidhje me realizimin e objektivit të përmirësimeve ligjore dhe metodologjike në fushën e kontabiliteit publik por nga problematika e udhëzimeve të nxjerra, me shkelje dhe jo të harmonizuara ndërmjet tyre, që sjellin konfuzion në zbatimin e parimeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar,në gjykimin tonë duhet ti shtohet gjithshtu dhe risku i mungesës së profesionalizmit dhe ekpertizës.

Mungojnë raportimet e brendshme dhe ato ndër-departamentale kryhen vetëm me e-mail. Mbajtja e dokumentacionit të aktiviteteve ka mangësi të theksuara në plotësi, përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe siguri (backup). Nga vlerësimi i cilësisë së analizave që rezultojnë të thjeshta statistikore vërehet nevoja e trajnimit të punonjësve për mënyrat efikase të përdorimit të informacionit dhe mbështetja me TI. Komunikimi brenda njësisë nuk është uniform; dhe stafi nuk është gjithmonë i vetëdijshëm për produktin/rezultatin e proceseve në të cilin ata kontribuojnë: rasti i përpunimit të pyetsorëve të vetëvlerësimit.

Pas viteve të para të ngritjes dhe konsolidimit si DH, shtylla e tretë e sistemit KBFP rrezikon të shndërrohet në një zyrë statistikore dhe e dedikuar për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm. Mbështetur nga një Bord KBFP pothuaj inekzistent, DH duhet të bëjë një analizë të thellë për rolin e saj me qëllim identifikimin e riskut strategjik të ekzistencës së saj.

4. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KLSH

Në auditimin e kryer në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brenshëm Financiar Publik, u shqyrtuan dhe u verifikuan veprimet dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit dhe strukturave të saj në lidhje me rekomandimet e përcjella me Vendimin nr.144 datë 30.09.2017, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit: "Për Auditimin e kryer në Drejtorinë e Harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi "Dhënien e opinionit në raportin e buxhetit të shtetit për AB dhe

MFK". U mor në shqyrtim gjithashtu dhe Plani i masave dërguar nga Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik nga i cili rezultoi se: nga 15 rekomandime, DH ka pranuar plotësisht vetëm 1 (një) rekomandim, ka pranuar pjesërisht 3 (tre) rekomandime dhe 11 (njëmbëdhjetë) rekomandime nuk janë pranuar. Në raportimin 6 mujor "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH" dërguar me shkresë dt.01.05.2018 konstatojmë se DH dhe drejtuesit e saj kanë paraqitur më shumë argumenta në mbështetje të mospranimit të rekomandimeve të KLSH duke rezultuar me vetëm 1 (një) rekomandim të pranuar dhe zbatuar pjesërisht. Duke u nisur nga fakti se jemi në një rast unikal, referuar të gjitha auditimeve të realizuara nga KLSH, ku subjekti i audituar ka pranuar vetëm 1 rekomandim, megjithëse nuk ka kundërshtuar asnjë nga gjetjet dhe konstatimet e grupit të auditimit, ballafaqimi i qëndrimeve është bërë më i zgjeruar. Qëndrimi i grupit të auditimit reflekton dhe situatën e konstatuar gjatë këtij auditimit dhe mundohet të theksojë se drejtimi i DH mbetet në mosveprim në lidhje me shumë cështje të trajtuara në mënyrë të përsëritur nga KLSH.

[Shqiptarja.com]

PJESA E TRETË

AUDITIMET E PERFORMANCËS

[shqiptarja.com]

[shqiptarja.com]

1. EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AZHBR

Qëllimi i auditimit: Efektiviteti i skemave kombëtare, u fokusua në shqyrtimin e detajuar të tre elementëve kyç në këtë proces: analiza e gjithë procedurës së dhënies së granteve (informim, aplikim, përzgjedhje, përfitim, verifikim, monitorim); çështjet rregullatore dhe të logjistikës së nevojshme; administrimi i burimeve njerëzore si dhe rolin e secilës drejtori dhe sektor nëpërmjet vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren të efektivitetit të tyre.

Objekti i Auditimit: Veprimtaria e AZHBR-së 2013-2017 gjatë gjithë procesit të aplikimit: informimi, pranimi, kontrolli administrativ i aplikimeve, kontrolli në terren para dhe pas financimit; më pas të monitorimit të ecurisë së financimit përgjatë një periudhe kohore të caktuar, në miradministrimin e fondeve të buxhetit të shtetit për zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve, përbëjnë objektin e këtij auditimi.

Rëndësia e auditimit: Paraqitja e problematikave të sektorit të bujqësisë, por kryesisht të problematikave që shoqërojnë dhënien e granteve do të mundësojë që jo vetëm të përmirësohet veprimtaria e AZHBR në tërësi, por edhe zhvillimi ekonomik dhe social në zonat rurale. Nëpërmjet këtij auditimi u adresuan rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit të organizimit, menaxhimit dhe administrimit me efektivitet të parave publike në zhvillimin e bujqësisë dhe të rajoneve.

Mesazhi i Auditimit: "Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nuk ka arritur efektivitetin e synuar nga menaxhimi dhe administrimi i fondeve buxhetore për skemat kombëtare. Menaxhimi i burimeve njerëzore ka shfaqur mangësi në strukturimin organik, formimin bazë, rekrutimin, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre etj.; kanë shfaqur mangësi vetë procedurat e subvencionimit për skemat kombëtare të analizuara në dinamikë për kushtet dhe kriteret e përfitimit, si dhe zbatimit të tyre nga ana e AZHBR; fondet e dhëna për informim kanë rezultuar jo efektive, pasi mjetet e komunikimit kanë qenë të kufizuara, informacioni i pamjaftueshëm dhe jo cilësor, nuk është menaxhuar siç duhet etj.; financimet për mbrojtjen e ullirit nuk rezultojnë efektive, pasi nuk janë zbatuar siç duhet procedurat e prokurimit, nuk është vepruar në përputhje me kuadrin rregullator, verifikimet dhe monitorimet për këtë skemë nga AZHBR kanë qenë me mangësi, duke rritur premisat për abuzime nga ana e institucionit; fondet e investimeve të përfituara nuk janë shfrytëzuar si duhet në aspektin ekonomik, për të gjeneruar më pas të ardhura të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e zinxhirit të vlerës që të mund të zhvillojnë projekte të besueshme për financim; ka munguar sektori i monitorimit për një periudhë 4-vjeçare, e si pasojë edhe monitorimi i skemave kombëtare të vogla dhe investimeve, duke e ulur ndjeshëm efektivitetin e fondeve të dhëna për ato."

Pyetja audituese: Sa ka kontribuar performanca e AZHBR në efektivitetin e granteve në zhvillimin bujqësor dhe rural?

2. CILËSIA E NDËRTESAVE SHKOLLORE

Qëllimi i auditimit është përmirësimi i mirëkuptimit të aktorëve të ndryshëm, për të kontribuar në zhvillimin e sistemit të arsimit dhe identifikimin e nevojave, që tu sigurojë nxënësve, një proces mësimor në kushte sa më të mira.

Objektivi i auditimit: Është pasqyrimi me realizëm dhe objektivitet i situatës së godinave shkollore duke analizuar problematikën dhe instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën.

[shqiptaria.com]

Rëndësia e auditimit: Është të bëjë vlerësimin e performancën së sistemit të arsimit e dhe ndihmuar sistemin e arsimit për një mësimdhënie dhe mësimnxënie që u siguron nxënësve të ardhmen e tyre.

Pyetja audituese:
A garantojnë godinat shkollore të sistemit parauniversitar një proces efecient mësimdhënës dhe mësimnxenës?

Mesazhi kryesor i këtij auditimi është: "Nxitje e reformave për vlerësimin e cilësisë së godinave shkollore parauniversitare, duke i cilësuar si "mësuesi i tretë" për ndikimin e tyre shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit aq delikat të mësimdhënies e mësimnxënies në sistemin e arsimit.

Sot sfida për arsimim sa më cilësor gjithëpërfshirës e të barabartë qëndron në rritjen bashkëpunimit të gjithanshëm të institucioneve qendrore e vendore, sipërmarrjeve e bizneseve, partnerëve të tjerë zhvillimorë, publikut, etj., për të kërkuar e përshtatur edhe lidhjen e godinave shkollore me shkallën arsimore, për të ndërtuar një sistem të godinash shkollore të hapur me zhvillimet e teknologjinë bashkëkohore që të lehtësojë arsimimin, sot e në të ardhmen në përputhje me sistemin e BE".

3. PERFORMANCA E MAS NË ZHVILLIMIN E SPORTIT

Objektivi i auditimit është paraqitja e plotë, reale dhe e paanëshme e shkallës së realizimit të politikave në favor të zhvillimit të sportit nga ana e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR).

Pyetja audituese:
A janë vjelë dhe shpenzuar siç duhet nga ana e MASR fondet për ushtrimin dhe zhvillimin e sporti?

Mesazh auditimi: Gjendja aktuale e sportit në Shqipëri vuan mungesën e vizionit dhe joefektivitetin e politikave për zhvillimin e tij nga ana e qeverive të ndryshme dhe Ministrisë përkatëse, fondet e pakta të akorduara çdo vit në favor të tij nga Buxheti i Shtetit, si dhe joefiçiensën në përdorimin e burimeve të ndryshme të fondeve për sportin.

Pushteti qendror dhe Ministria përgjegjëse i kanë dhënë sportit gjithmonë një rol dytësor në jetën e qytetarëve shqiptarë dhe sportistëve, elitarë apo amatorë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pavarësisht përpjekjeve, ka qenë joefektive sa i përket zhvillimit të sportit, duke bërë që shumat e vogla të granteve të alokuara për federatat, të mos përmbushin misionin e tyre në promovimin dhe ushtrimin normal të disiplinave përkatëse dhe rritjes së interesit nga ana e publikut. Institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore nuk garantojnë plotësisht kushtet për ushtrimin e aktiviteteve nga sportistët, nxënësit apo të rinjtë. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë nuk ka qenë plotësisht efiçiente në ndarjen e fondeve në dispozicion, duke mos kontribuuar mjaftueshëm në përmirësimin e infrastrukturës sportive.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit nuk kanë derdhur tërësisht për llogari të Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit, të ardhurat nga kompanitë e basteve përgjatë viteve 2013-2016, duke i shkaktuar buxhetit të MASR një efekt financiar negativ, joekonomicitet dhe të ardhura të munguara prej 22,964,841 lekësh. Të ardhurat e munguara të vitit korrent, deri në muajin Korrik 2017, janë 7,976,440 lekë, shumë kjo e destinuar për zhvillimin e sportit."

[shqiptarja.com]

4. KOSTIMI I SHËRBIMIT SPITALOR

Objektivi i auditimit është analizimi i kostimit të shërbimit spitalor dhe gjenerimi i rekomandimeve për optimizmin eficient të kostimit.

Mesazhi i auditimit: "Sistemi aktual i vlerësimit të kostove për shërbimet spitalore është një vlerësim që mbart shpenzime të tepërta dhe nuk reflekton kostot e vërteta, duke orientuar kërkesat e institucioneve shëndetësore spitalore drejt vlerësimit të shpenzimeve dhe jo sipas kostove të tyre. Mungesa e specialiteteve pranë shërbimeve në spitalet rajonale dhe bashkiake, si dhe mungesa e performancës së shërbimit parësor ka krijuar rritjen e kostove dhe përqendrimin e pacienteve në qendrën më të madhe universitare QSUT. Implementimi i paketave shëndetësore përbën një nismë të mirë për miratimin e protokolleve për këto paketa, por mënyra e vlerësimit financiar të tyre bie ndesh me ligjin e prokurimeve publike, duke rritur kostot e këtyre shërbimeve shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me Fondin edhe QSUT të angazhohen në hartimin dhe implementimin e protokolleve klinike për të gjitha shërbimet spitalore duke pasur si orientim modelin DRG dhe klasifikimin më të fundit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-10. Riorganizimi i hartës së spitaleve mbi bazën e treguesve të performancës së shërbimit spitalor përbën një kusht të nevojshëm dhe të domosdoshëm për uljen e kostove të tepërta për sistemin shëndetësor. Premisat e krijimit të një tregu shëndetësor do të çonte në ekuilibrin e kërkesë - ofertës duke rritur eficiencën, cilësinë e shërbimeve nga ofruesit e kujdesit shëndetësor për pacientë".

Pyetja audituese:
A realizohet siç duhet kostifikimi i shërbimit shëndetësor/spitalor?

5. CILËSIA E AJRIT

Objektivi kryesor i auditimit me temë cilësia e ajrit krahas përshkrimit të situatës së cilësisë së ajrit në Shqipëri, është vlerësimi i efektivitetit dhe eficiencës së politikave të vendosura për përmirësimin e cilësisë së ajrit, kostove dhe përfitimeve nga zbatimi i këtyre politikave si dhe monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit nga subjektet përgjegjëse.

Rendësia e auditimit të performancës me temë "Cilësia e ajrit" jep një panoramë të plotë mbi situatën legjislative në vend, përafrimin e legjislacionit shqiptar me BE-në dhe gjendjen reale të cilësisë së ajrit në Shqipëri, duke analizuar masat e marra nga institucionet që kanë për detyrë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e cilësisë ajrit të mjedisit.

Mesazhi i auditimit: ''Masat e marra nga qeverisja qendrore dhe lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vendin tonë nuk kanë qenë efektive dhe eficiente. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit (SKCA) e miratuar në vitin 2014, ende nuk është zbatuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e SKCA–së. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit nuk është miratuar dhe si rrjedhojë asnjë Bashki në Shqipëri nuk ka miratuar Planet Vendore të Veprimit të Cilësisë së Ajrit. Monitorimi i cilësisë së ajrit nuk i përmbush plotësisht standardet e vendosura nga direktivat përkatëse të BE-së. Vlerat e publikuara për Tiranën, ashtu si edhe për qytetet e tjera të Shqipërisë nga stacioni i lëvizshëm i AKM-së nuk janë përfaqësuese si vlera mesatare të tyre. Numri i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse. ISHMP nuk kryen inspektime sa i përket tejkalimit të normave të shkarkimeve të elementëve ndotës të ajrit sepse nuk zotëron asnjë mjet/laborator për matjen e këtyre shkarkimeve në terren. ISHP nuk ka kryer

Pyetja audituese:
A kanë qenë efektive dhe efiçiente masat e marra nga qeverisja lokale dhe qendrore për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe a janë këto masa në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar?

Tëndipërfaqe.com

asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës.''

6. UNIFIKIMI I PIKAVE DOGANORE ME KOSOVËN

Qëllimi i këtij *auditimi* konsiston në pasqyrimin e nivelit në të cilën ndodhet unifikimi i pikave doganore të vendit tonë me Kosovën, duke analizuar faktorë të ndryshëm dhe vlerësuar veprimtarinë e institucionecve qëndrore dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse të Kosovës, për të vendosur edhe një bashkim doganor mes dy shteteve.

Pyetja audituese:
A ka qenë efektive veprimtaria e autoriteteve shtetërore në drejtim të unifikimit të pikave doganore të Shqipërisë me Kosovën?

Mesazhi i auditimit: "Me gjithë përparimin e arritur në fushën e shkëmbimit tregtar dhe bashkëpunimit doganor, marrëveshjet e nënshkruara nuk përbëjnë një bazë të plotë rregullatore për unifikimin doganor me Kosovën, si në kuptimin teknik ashtu edhe në atë ekonomik. Marrëveshjet e nënshkruara karakterizohen nga një formë e shprehjes së vullnetit të mirë, por nuk janë pasqyruar në politika të mirëfillta qeveritare, të cilat do ta realizonin me përgjegjshmëri dhe me sukses bashkimin doganor me Kosovën. Konstatohet se nuk ka një angazhim të vazhdueshëm institucional, bazuar në një strategji të posaçme për unifikimin doganor me Kosovën, gjë e cila ka dëmtuar dukshëm besimin e bizneseve në dy anët kufirit.

Veprimtaria e Ministrisë së Financave e Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave në unifikimin e pikave doganore si proces teknik e operacional është e mangët dhe nuk ka krijuar premisat për një bashkim doganor të shpejtë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Nuk është hedhur hapi vendimtar, unifikimi i politikave fiskale, si parakusht për sigurimin e bashkimit doganor, i cili përbën një potencial për rritjen e shkëmbimit të mallrave, rritjen e ekonomisë për dy vendet, si dhe një parapërgatitje e proces maturimi për institucionet shqiptare për t'u bërë ballë sfidave që parashtron integrimi në tregun europian".

7. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Pyetja audituese:
A sigurohet me ekonomicitet borxhi publik dhe a përdoret me eficiensë ai?

Mesazhi i auditimit: *"Mos vlerësimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i një seti indikatorësh thelbësorë të qëndrueshmërisë dhe kostos së borxhit publik, nuk siguron ekonomicitet dhe efiçiensë në menaxhimin e tij. Rezultatet e treguesve përgjegjës për vlerësimin e qendrueshmërisë dhe kostos së borxhit publik si: Borxh i Jashtëm/ Eksporte, Borxh i Jashtëm/ Rezervave Valutore dhe Indikatori i Hendekut Primar Afatshkurtëer, tregojnë se aftësia ripaguese e ekonomisë sonë kundrejt borxhit publik, është në rënie. Këto rezultate lidhen drejtpërdrejtë me koston që përballon shteti për shlyerjen e interesave dhe principalit.*

Mos zbërthimi i strategjive afatmesme të menaxhimit të borxhit publik në plane konkrete veprimi dhe strategji alternative, nuk i mundësojnë Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë diversifikimin e risqeve për të arritur në një menaxhim efiçient të borxhit publik."

[shqiptaria.com]

8. IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË ANTIKORRUPSION

Mesazhi i auditimit: "SNKK dhe PV janë krijuar për të qenë në linjë me një nga 5 rekomandimet e BE-së dhe rezultati final i tyre duhet të reduktonte ndjeshëm korrupsionin në vend me anë të përfshirjes së të gjitha palëve të interesit. Pavarësisht këtij synimi, SNKK dhe rrjedhimisht PV që e detajon atë vuajnë planifikimin e dobët të objektivave të saj, specifikisht të objektivit A11 audituar nga KLSH. Ky planifikim i dobët shprehet në formulimin e nënobjektivave jo-SMART, moskonsultimin apo konsultimin fiktiv të palëve të interesit në hartimin e këtyre dokumenteve, mungesën e metodologjisë që përkthen objektivat operacionalë në strategjikë, mungesën e koherencës midis PV dhe SNKK, si edhe miratimit të kësaj Strategjie me akt nënligjor (VKM), ndërkohë që ajo parashtron detyra edhe për institucionet e pavarura nga ekzekutivi.

Pyetja audituese: Sa efektiv është adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore për zbatimin e objektivit A.11 të SNKK?

Në drejtim të implementimit, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (prej Shtatorit 2017 Ministria e Drejtësisë dhe më parë Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore), me rol kyç në hartimin, implementimin dhe monitorimin e SNKK dhe Planit të Veprimit, nuk kanë zotëruar asnjë hallkë të detyrave dhe përgjegjësive të veta, duke rezultuar në një Strategji të pazbatuar, pa monitoruar dhe rrjedhimisht të pa raportuar për arritjet dhe mosarritjet.

Prefekturat, si një nga palët kryesore në zbatimin e Strategjisë janë joaktive si në afatet, ashtu edhe cilësinë e raportimit dhe rezultojnë të mos kenë realizuar produktet finale të parashikuara.

Nga ana tjetër, edhe pse shoqërisë civile i janë lëvruar fonde nga buxheti i shtetit lidhur me çështjen antikorrupsion dhe specifikisht këtë Strategji, roli i saj pothuajse nuk ekziston. Ajo rezulton të mos jetë e përfshirë në procesin e hartimit të SNKK dhe atë të luftimit të këtij fenomeni dhe për rrjedhojë nuk ka kontribuar si vlerë e shtuar e kësaj Strategjie.

Duke e konsideruar të dështuar në masën më të madhe Strategjinë Antikorrupsion dhe Planin e Veprimit për ta vënë në jetë atë, si edhe për të siguruar implementimin e një nisme kaq jetike për vendin e për të eliminuar në vijimësi riskun e transferimit të KKK nga njëri institucion në tjetrin, KLSH rekomandon krijimin e një Agjencie Kombëtare Antikorrupsion. Kjo agjenci sugjerohet të jetë nën varësinë e Kryeministrit dhe përgjegjëse për rihartimin, rizbatimin dhe monitorimin e mëtejshëm të SNKK dhe PV, duke marrë fillimisht dakordësinë e Kuvendit për dokumentet strategjikë në formën e një Ligji të posaçëm."

9. VARFËRIA NË SHQIPËRI DHE ROLI I SHTETIT NË ZBUTJEN E SAJ

Rëndësia e auditimit: Varfëria, si një ndër problemet ekonomiko-sociale të vendit, mbështetet me programe të veçanta buxhetore, qëllimi i së cilave është identifikimi i drejtë i personave realisht të varfër, lehtësimi i gjendjes së tyre duke siguruar mbulimin përkatës, rritja e transparencës së procesit targetues dhe zhvillimi i hapësirave për ri-integrim social të këtyre individëve. Në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020, instrumenti kryesor për zbutjen e varfërisë është skema e ndihmës ekonomike (NE). Përmirësimi i indikatorëve për vlerësimin e familjeve të varfra dhe ekstremisht të varfra është një ndër objektivat kryesorë të krijimit dhe përshtatjes së skemës së NE gjatë viteve. Në këtë auditim u trajtua efektiviteti i këtij programi të përkujdesjes sociale, si një nga synimet strategjikë të qeverisë dhe eficencën praktike të këtij procesi në kontribut të mbulimit real të familjeve të varfra krahasuar me shportën e

konsumit të tyre dhe indikatorëve makroekonomikë, transparencën e administrimit të tij dhe dinamikën e programit për ri-integrimin social të përfituesve.

Objektiv i këtij auditimi janë strategjia dhe politikat e mbrojtjes sociale, me fokus skemën e NE, zbatimi i saj në praktikë dhe veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për implementimin e saj.

Qëllimi i auditimit: Skema e Ndihmës Ekonomike, si një nga mjetet që ka në dorë shteti për të ndihmuar individët e varfër, është në vetvete një zinxhir procedurash që përfshin institucione qendrore dhe vendore. Krijimi dhe vënia në punë e regjistrit elektronik kombëtar ndihmon në përshpejtimin e këtij procesi, si dhe në uljen e rasteve abuzive. Pilotimi i një skeme të re dhe më pas shtrirja e saj në të gjithë vendin duhet të shërbejë si një vlerë e shtuar për NE dhe për familjet e varfra. Referuar problemeve aktuale me targetimin jo transparent të individëve përfitues së NE dhe mungesës së mekanizmave të tjerë mbështetës për zbutjen e varfërisë, grupi i auditimit fokusoi problemin e performancës mbi efektivitetin e programit të MSHMS për varfërinë dhe eficiencën e institucioneve përgjegjëse në implementimin e procesit në praktikë, me qëllim që skema e mbrojtjes sociale të jetë sa më gjithëpërfshirëse, të ndihmojë familjet në nevojë në një masë të përshtatshme për të shmangë rastet abuzive sa më shumë të jetë e mundur.

Pyetja audituese:
A është efektive skema e Ndihmës Ekonomike si një ndër instrumentet për të zbutur varfërinë?

Mesazhi i auditimit: "Në Shqipëri nuk ka një vlerë të miratuar nga qeveria të minimumit jetik dhe kufirit të varfërisë, mbi të cilën të bazohen politikat dhe studimet e përkujdesit social."

Skema aktuale e Ndihmës Ekonomike, si instrument i MSHMS dhe institucioneve të varësisë për përkujdesjen sociale, nuk është efektive në zbutjen e varfërisë referuar numrit të familjeve që dalin nga skema për shkak të punësimit dhe përmirësimit të kushteve social-ekonomike të tyre. Ineficienca e sistemit elektronik lidhet me aplikimin e formulës së unifikuar të pikëzimit, e cila nuk është vlerësuar në bazë të kushteve koherente të familjeve në nevojë.

Mbështetja e qeverisë me programin e Ndihmës Ekonomike do të ishte efektive nëse kontributi do të vlerësohej paralelisht me nivelin e përgjithshëm të çmimeve, me produktet e shportës së konsumit dhe me studime dinamike për riintegrimin e individëve në shoqëri."

10. MENAXHIMI I MBETJEVE SPITALORE

Objektivi kryesor i auditimit të performancës me temë "Menaxhimi i mbetjeve spitalore" ka qenë përcaktimi nëse kuadri ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbetjeve spitalore është i përshtatshëm si dhe vlerësimi nëse subjektet nën auditim kanë performuar me efektivitet përgjatë periudhës 2015-2017.

Pyetja audituese:
A ka qenë efektiv menaxhimi i mbetjeve spitalore në QSUT, Spitalin Rajonal të Fierit dhe të Kukësit në vitet 2015-2017?

Menaxhimi i auditimit: "Menaxhimi i mbetjeve spitalore krahas vonesës së përditësimit dhe përputhjes së akteve ligjore e nënligjore me njëri-tjetrin por në disa raste edhe mungesës totale të tyre vuan edhe mungesën e zbatimit të këtyre politikave. Ministria e Turizimit dhe Mjedisit (MTM) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale (MSHMS) nuk kanë kapacitetet e duhura për të përditësuar dhe shoqëruar me akte nënligjore të mjaftueshme të gjithë kuadrin ligjor në lidhje me menaxhimin e mbetjeve spitalore. Ky është një konkluzion i pohuar para së gjithash nga vetë këto institucione. Edhe pse ekzistojnë një sërë aktesh nënligjore, një pjesë e tyre të përshkruara gjerësisht gjatë raportit të auditimit të performancës janë bazuar në ligje tashmë të shfuqizuara, çka sjell pamundësi në

Shqiptarja.com

zbatimin e tyre. Të tre spitalet pjesë e këtij auditimi dhe veçanërisht Spitali Rajonal i Kukësit dhe i Fierit kanë mangësi në respektimin e kuadrit ligjor e rregullator për të arritur standardet e kërkuara të menaxhimit të mbetjeve spitalore. Diferencimi, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore nuk bëhet në përputhje me kriteret ligjore dhe praktikat e mira. Mangësi të theksuara vërehen sidomos gjatë raportimit dhe dokumentimit të mbetjeve spitalore, shoqëruar kjo edhe me indiferencën e MSHMS, MTM dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve e Ujërave (ISHMPU). Një tjetër aspekt delikat dhe problematik është roli që kanë subjektet private të licensuar nga MTM për trajtimin/asgjësimin e mbetjeve spitalor. Gjatë auditimit grupi i auditimit ka evidentuar mjaft parregullsi (të përshkruara gjerësisht në raport) sa i përket përmbushjes së kritereve ligjore të këtyre subjekteve. MTM, AKM dhe ISHMPU nuk kanë asnjë informacion se ku përfundon hiri pas procesit të djegies së mbetjeve spitalore i cili konsiderohet ende si mbetje e rrezikshme."

11. PERFORMANCA E ARKIVIT TË SHTETIT

Auditimi me temë "Performanca e Arkivit të Shtetit" merr një *rëndësi* jetike duke patur parasysh se arkivi i shtetit është rrjeti kryesor që mundëson ruajtjen, përpunimin, administrimin dhe pasurimin e trashëgimisë historiko-kulturore të vendit.

Auditimi pati si *objektiv* matjen e performancës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe të Arkivave të Sistemit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së brendshme, me fokus nevojën e rikonceptimit ose jo të kuadrit ligjor për arkivat. U vlerësua, kështu: 1. Performanca e subjekteve nën auditim kah përmirësimet e shërbimit arkivor; 2. Ligjshmëria e reformave të fundit organizative dhe strukturore në arkivin e shtetit; 3. Efiçiensa dhe ekonomiciteti i ndryshimeve të ndërmarra në drejtim të ruajtjes dhe pasurimit të trashëgimisë historike, kulturore dhe administrative të vendit.

Konkluzioni i auditimit: "Rrjeti arkivor shfaq probleme të theksuara në infrastrukturën teknike dhe sigurinë fizike të ruajtjes së dokumenteve. Arkivat Vendore Shtetërore përfaqësojnë një sistem të amortizuar për shkak të mungesës së investimeve dhe të kulturës menaxheriale joefektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Pyetja audituese:
A është i nevojshëm një rikonceptim i legjislacionit dhe një "reformë territoriale" në rrjetin arkivor?

"Reforma territoriale" e arkivave vendore dhe licencimi i arkivave private janë miratuar në kundërshtim me Ligjin për arkivat dhe mbartin risqe të mëdha që minojnë efiçiensën dhe ekonomicitetin sa i përket ruajtjes, përpunimit dhe shërbimit të pasurisë dokumentare; për pasojë, Urdhri për ristrukturimin e arkivave vendore duhet të shfuqizohet, ndërsa VKM për licencimin e arkivave private duhet të ndryshohet.

Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Drejtësisë, megjithëse respekton Normat tekniko-profesionale, nuk ka kapacitete ruajtëse të mjaftueshme; Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme nuk përmbush as kushtet minimale të standardeve arkivore, duke patur nevojë për ndërhyrje të menjëhershme."

[shqiptaria.com]

12. PERFORMANCA E INSPEKTORIATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes kryesore:

"A kanë performuar mjaftueshëm institucionet përgjegjëse në garantimin e cilësisë së karburanteve përgjatë periudhës 01.06.2015-31.12.2017?"

Pyetja audituese: A kanë performuar mjaftueshëm institucionet përgjegjëse në garantimin e cilësisë së karburanteve përgjatë periudhës 01.06.2015-31.12.2017?

Mesazhi auditimi: "*Kontrolli i Lartë i Shtetit konstaton se ka progres të moderuar në garantimin e cilësisë së karburanteve për periudhën 01.06.2015 - 31.12.2017, për shkak se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka qenë mjaftueshëm efektive në këtë fushë si dhe ISHTI ka mangësi në veprimtarinë e tij, veçanërisht në plotësimin e logjistikës së nevojshme për të realizuar aktivitetet e planifikuara*."

13. REFORMA TERRITORIALE-ADMINISTRATIVE

Auditimi i performancës mbi "Funksionimin e bashkive në kuadër të reformës administrative-territoriale" i jep përgjigje *pyetjes* kryesore të auditimit "A janë realizuar objektivat e Reformës Administrative – Territoriale në funksion të autonomisë vendore të bashkive".

Pyetja audituese: A janë realizuar objektivat e Reformës Administrative – Territoriale në funksion të autonomisë vendore të bashkive?

Mesazhi i auditimit: "Reforma administrative-territoriale nuk ka reflektuar parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Për pasojë, rezultojnë mospërputhje mes objektivave të reformës dhe politikave fiskale dhe buxhetore të qeverisë qendrore të cilat kanë cenuar autonominë vendore duke minuar kështu forcimin e decentralizimit dhe autonomisë së bashkive.

Buxheti qendror alokon për NjQV rreth 1% e GDP-së që është niveli më i ulët rajonal, duke i penguar bashkitë në ushtrimin e plotë të kompetencave dhe në rritjen e nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Ndërmjet bashkive në rang vendi ekziston një pabarazi financiare dhe konstatohen ndërhyrje të pushtetit qendror në pushtetin vendor, me efekt negativ për buxhetin e bashkive dhe stabilitetin e autonomisë financiare.

Reforma Administrative-Territoriale nuk ka përmbushur objektivat: legjislacioni i ri nuk zbatohet plotësisht, procesi i përthithjes së funksioneve të reja, punonjësve, aktiveve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve nuk është arritur të realizohet me sukses. Në shumicën e bashkive rezulton nivel i ulët efektiviteti në mbledhjen e të ardhurave të veta dhe në përdorimin e fondeve në dispozicion."

14. URGJENCA MJEKËSORE

Pyetja audituese: A ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e urgjencës mjekësore në vendin tonë?

Mesazhi i auditimit: "Veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e urgjencës mjekësore në vendin tonë nuk ka qenë efektive.

Edhe pas 4 vitesh nga hyrja në fuqi e Ligjit për urgjencën mjekësore, MSHMS nuk ka miratuar standardet për infrastrukturën fizike, barnat, pajisjet mjekësore, si dhe burimet njerëzore të nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi në vendin tonë. Mosveprimi i MSHMS evidenton një mungesë përgjegjshmërie institucionale për të përmirësuar situatën e Urgjencës Mjekësore në Shqipëri, sidomos kundrejt veprimtarisë së vakët në drejtim të miratimit të protokolleve të urgjencës mjekësore, si edhe sa i takon rishikimit dhe përafrimit të legjislacionit të vendit tonë me atë evropian. MSHMS ka qenë totalisht inefektive për ato pak iniciativa që ka ndërmarrë në këtë fushë, për periudhën objekt auditimi.

Shqiptaria.com

Që nga momenti i krijimit, QKUM, pavarësisht përpjekjeve, nuk ka vepruar në mënyrë efektive me qëllim identifikimin e prioriteteve kyçe sa i takon planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarështetëror të unifikuar, duke arritur të ofrojë vetëm koordinim të pjesshëm për qytetin e Tiranës. QKUM nuk ka kryer rishikim të cilësisë së shërbimit të urgjencës në shkallë vendi dhe nuk ka ushtruar kontroll të brendshëm në të gjithë shërbimin e urgjencës mjekësore, duke penalizuar zhvillimin e këtij shërbimi, si edhe aktivitetin e vet në këtë drejtim. Ky institucion nuk ka qenë i aftë të ndërtojë një kanal komunikimi zyrtar me MSHMS, me qëllim përcjelljen e të gjitha problematikave të ndeshura në shtrirjen e shërbimit në shkallë vendi dhe në mbarëvajtjen e tij. Mosveprimi dhe neglizhenca e treguar shpreh qartë që ky institucion nuk ka gjeneruar impaktin e përcaktuar nga Ligji për përmirësimin e shërbimit të urgjencës mjekësore.

MSHMS dhe QKUM duhet fillimisht të veprojnë për të plotësuar me akte nënligjore Ligjin nr. 147/2014, "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore", me qëllim zbatimin e tij në rang vendi, në përfitim ekskluziv të qytetarëve taksapagues."

15. RECETA DHE NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Pyetja audituese: A ka ndikuar sistemi i recetës dhe nënshkrimit elektronik në efektivitetin e skemës së rimbursimit të barnave për periudhën 2017-2018?

Mesazhi i auditimit: "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me FSDKSH duhet të angazhohen aktivisht për shtrirjen, aplikimin dhe konsolidimin e recetës dhe nënshkrimit elektronik në të gjithë sistemin shëndetësor për barnat e rimbursueshme, pasi ato janë larg objektivave strategjikë të zhvillimit të shëndetësisë elektronike dhe detyrimeve kontraktuale, mbi afatet e implementimit të saj.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si përfaqësuese e interesave të shtetit dhe në rolin e monitoruesit të zbatimit të kontratës, ka mbajtur një rol pasiv, duke ia ngarkuar gjithë barrën e implementimit FSDKSH-së, e cila në vetvete, ka qenë sporadike dhe e paqartë në veprimet saj për realizimin e këtij detyrimi kontraktual.

MSHMS dhe FSDKSH nuk janë të qarta për një afat përfundimtar të aplikimit të këtij inovacioni shumë të rëndësishëm teknologjik në fushën e shëndetësisë. Mungesa e koordinimit midis dy institucioneve, si dhe mungesa e një plani të përcaktuar mirë nga ana e tyre, ka ndikuar në mosrespektimin e afatit kohor të aplikimit të saj në sistemin shëndetësor.

Përkundrejt një rritjeje të shkallës së implementimit gjatë fillimit të vitit 2018, kryesisht në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, receta elektronike është ende larg aplikimit në shërbimet shëndetësore për barnat e rimbursueshme. Mungesa e nënshkrimit elektronik për farmacitë mbetet një hallkë e dobët e këtij projekti, duke e larguar atë nga objektivat strategjikë të procesimit të shërbimeve shëndetësore pa letër (paperless).

MSHMS dhe Fondi duhet të angazhohen aktivisht për shtrirjen dhe aplikimin sa më parë të recetës elektronike në shërbimin spitalor dhe kryesisht atë të QSUT-së. MSHMS, FSDKSH në bashkëpunim me AKSHI-në duhet të digjitalizojnë gjithë hallkat e këtij procesi, duke mundësuar që projekti i recetës elektronike të ketë mundësi të bashkëveprojë me programet e tjera të shëndetësisë elektronike.

MSHMS dhe FSDKSH duhet të iniciojnë fillimin e projektit të kartelës elektronike duke e bërë më efektiv sistemin e recetës elektronike."

Shqiptarja.com

16. ZONAT E MBROJTURA BREGDETARE

Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve që lindin nga "Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit" i cili mund të konsiderohet si dokumenti strategjik për administrimin e këtij parku.

Objektivi i auditimi i performancës me temë "Zonat e mbrojtura Detare dhe Bregdetare" konsiston n` vler`simin dhe analiz`n e gjendjes reale të parkut kombëtar detar Karaburun- Sazan, nëpërmjet shqyrtimit dhe analizimit të masave të marra nga institucionet që kanë nën juridiksion menaxhimin e këtij parku. Ky auditim ka për *qëllim* të kontribuojë në zhvillimin e një menaxhimi sa më cilësor të parkut duke u përqendruar në përdorimin sa më optimal të burimeve në dispozicion për ruajtjen dhe zhvillimin e këtij ekosistemi dhe mbrojtjen nga kërcënimet që vijnë si pasojë e veprimtarive të pakontrolluara.

Pyetja audituese:

A ka rezultuar efektiv plani i menaxhimit të parkut kombëtar të ekosistemit natyror detar pranë gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së këtij ekosistemi?

Mesazhi i auditimit: Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan nuk ka qenë plotësisht në vëmendjen e Qeverisë dhe aktorëve të përfshirë në menaxhimin e tij. Kanë kaluar 17 vite nga krjimi i këtij parku por problemet janë pothuajse të njëjta. Gjendja dhe qendrueshmëria e këtij parku vijon të kërcënohet nga ushtrimi i veprimtarive të pakontrolluara dhe të pa rregulluara dhe ka një mungesë ndërgjegjësimi të përdoruesve të tij. Megjithëse disa nga faktorët kërcënues të përkeqësimit të ekosistemeve janë reduktuar, puna për administrimin e tij nuk ka qenë e koordinuar dhe jo të gjithë palët e përfshira në administrimin e PKD janë angazhuar maksimalisht. I gjithë ekosistemi i vijës bregdetare jug-perëndimore të vendit po kërcënohet vazhdimisht nën moton "Ekosistemet t'i përdorim, por jo t'i mbrojmë", si pasojë e politikave kontradiktore që janë hartuar deri më sot mbi këtë zonë.

[Shqiptaria.com]

Aneksi 1

Lista e Subjekteve të përfshira në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitit 2017

Nr	Lista e Subjekteve të përfshira në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitit 2017
1	Dega e Doganës Vlorë
2	Dega e Doganës Rinas
3	Dega e Doganës Fier
4	Dega e Doganës Durrës
5	Dega e Doganës Tiranë[1]
6	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
7	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve[2]
8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (*Auditim Financiar*)
9	Ministra e Financave dhe Ekonomisë "Mbi Zbatimin e Buxhetit të shtetit 2017"
10	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
11	Drejtoria Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
12	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
13	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
14	Banka e Shqipërisë[3]
16	Ministria e Punëve të Jashtme
17	Ministria e Arsimit
18	Ministria e Integrimit Evropian
19	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (Tematik)
20	Ministria e Drejtësisë
21	Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural (Tematik)
22	Ministria e Brendshme
23	Ministria e Kulturës
24	Ministria e Mbrojtjes[4]
25	Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara
26	Komisioni i Prokurimit Publik
27	Agjencia e Prokurimit Publik
28	Universiteti Politeknik i Tiranës
29	Universiteti "Fan Noli" Korçë
30	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik
31	Prokuroria e Përgjithshme
32	Drejtoria Arsimore Rajonale Qarku Tiranë
33	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
34	Spitali Universitar i Traumës
35	Avokatura e Shtetit
36	Instituti i Shëndetit Publik
37	Bashkia Durrës
38	Bashkia Krujë
39	Bashkia Divjakë
40	Bashkia Kukes
41	Bashkia Kamëz
42	Bashkia Rrogozhinë

[1] Në fazë Projekt Raporti.
[2] Në fazë Projekt Vendimi.
[3] Në fazë Projekt Vendimi.
[4] Në fazë Projekt Vendimi.

lsh.gov.al

43	Bashkia Përrenjas
44	Bashkia Vlorë
45	Bashkia Kuçovë
46	Bashkia Lezhë
47	Bashkia Lushnje
48	Bashkia Fier
49	Bashkia Mallakastër
50	Bashkia Konispol
51	Bashkia Këlcyrë
52	Bashkia Korçë
53	Bashkia Kolonjë
54	Bashkia Belsh
55	Bashkia Pustec
56	Bashkia Poliçan
57	Bashkia Vau-Dejës
58	Bashkia Maliq
59	Bashkia Has
60	Bashkia Malësi e Madhe
61	Bashkia Gjirokastër
62	Bashkia Memaliaj
63	Bashkia Përmet
64	Bashkia Dibër
65	Këshilli i Qarkut Berat
66	Institucioni i Prefektit Qarku Durrës
67	Institucioni i Prefektit Qarku Elbasan
68	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacioneve Bashkia Tiranë.
69	Drejtoria e Përgjithshme nr. 1, e Punëtorëve të Qytetit Bashkia Tiranë
70	Albpetrol sh.a
71	KESH sh.a
72	Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar
73	Autoriteti Portual Durrës
71	Trajtimi i studentëve nr. 2 sh.a Tiranë
72	Enti Kombëtar i Banesave
73	Projekti “Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë”, sh.a, Korçë
74	Projekti “Bulevardit verior të Tiranës dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës”
75	Projektet “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare të Vlorës” dhe “Mbushja me rërë e plazhit Vlorë”
78	Projekti “Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë”
79	Projekti “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet faza, III" në UK SHA Pogradec”
80	Projekti “Zhvillimi i sektorit privat”
81	Projekti "Zhvillimi i alpeve dhe zonave bregdetare" në Fondin Shqiptar të Zhvillimit
82	Porti Detar sh.a Vlorë
83	Porti Detar sh.a Sarandë
84	Hekurudha Shqiptare SHA
85	Spitali Rajonal Fier
86	Spitali Rajonal Shkodër
87	Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”
88	Spitali Rajonal Gjirokastër
89	Spitali Rajonal Vlorë
90	Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë
91	Qendra Spitalore Dr. Xhafer Kongoli Elbasan
92	Ujësjellës Kanalizime sh.a Korçë
93	Ujësjellës Kanalizime sh.a Vlorë

[shqiptaria.com]

94	Ujësjellës Kanalizime sh.a Shkodër
95	Ujësjellës Kanalizime sh.a. Durrës
97	Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër
98	ZVRPP Malësi e Madhe
99	ZVRPP Elbasan
100	ZVRPP Fier
101	ZVRPP Tiranë
102	ZVRPP Sarandë
103	ZVRPP Shkodër
104	ZVRPP Pogradec
105	ALUIZNI Vorë-Kamëz
106	ALUIZNI Fier
107	ALUIZNI Durrës
108	ALUIZNI Lushnje
109	ALUIZNI Dibër
110	ALUIZNI Kukës
111	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Shkodër
112	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Berat
113	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Korçë
114	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Dibër
115	Agjencia e Trajtimit të Pronave

[shqiptarja.com]